Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXVII nr. 86 / 2008

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXVII nr. 86 - 2008

Botues:

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës

Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-024

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:

Mr. Qemajl Morina

qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:

Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr.Pajazit Nushi,
Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahimi,
Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

Sekretar i redaksisë: ***Hajrullah Hoxha***

Lektor: Bislim Berisha

Korrektor: Skender Rashiti

Realizimi: **Shtëpia Botuese**

Operator kompjuterik: Nuhi Simnica

Shtyp: *Koha* - Prishtinë

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXVII nr. 86 / 2008

Prishtinë
2008

EDITORIAL

Qemajl Morina

KOSOVA SHTET SOVRAN DHE I PAVARUR

Që nga përfundimi i luftës në Kosovë, në qershor të vitit 1999, shqiptarët, kudo që jetojnë kanë jetuar në ankthin e pritjes së pavarësisë së Kosovës. Këtë ankth e kanë përjetuar edhe qytetarët tjerë të Kosovës, të cilët Kosovën e konsiderojnë atdhe të vetin. Sepse Kosova shtet i pavarur dhe sovran do të thotë prosperitet dhe ardhmëri më e mirë për të gjithë qytetarët e saj, pa e marrë parasysh përkatësinë e tyre kombëtare, fetare, apo gjuhën që ata e flasin. Një Kosovë sovrane dhe e pavarur do të thotë një vend më i pasur dhe më i begat për të gjithë, si për shumicën ashtu edhe për pakicat që jetojnë në të. Një Kosovë e njohur ndëkombëtarisht, do të thotë mirënjohje e bashkësisë ndërkombëtare për sakrificat dhe vuajtjet e popullit të Kosovës dhe qytetarëve te saj. Do të thotë prosperitet për të gjithë qytetarët si dhe për të ardhmen tonë të përbashkët.

Me deportimin e forcave okupuese serbe (ushtrisë, policisë dhe forcave paramilitare) nga Kosova, në qershor të vitit 1999, Serbia një herë e përgjithmonë është përshëndetur me Kosovën si koloni të saj, të cilën e kishte mbajtur që nga viti 1912. Megjithatë, ashtu siç na ka ndodhur shumë herë gjatë historisë, fuqitë e mëdha kanë vendosur në dëm të tonin dhe kundër interesave tona kombëtare. Andaj, deri diku

frika ka qenë e arsyeshme dhe me vend. Por, kësaj radhe qendrat e vendosjes, të udhëhequra nga Uashingtoni dhe Brukseli, qëndruan në anën tonë. Sepse, vazhdimisht gjatë historisë, ne ishim pala që me shekuj të tërë, kishim përjetuar padrejtësi dhe ishim nëpërkëmbur. Në anën tjetër, krimet, gjenocidi dhe dhuna sistematike shtetërore serbe ndaj një populli të pambrojtur, ishin shumë më të fuqishëm se sa efektet e mundshme që mund të bënte diçka propaganda serbe e përkrahur me fanatizëm vetëm nga Moska për ndryshimin e opinionit ndërkombëtar në kohën e internetit e satelitit.

Kësaj radhe, politika e jonë ishte e orientuar mirë në raport me qendrat e vendosjes. Ato, e kuptuan realitetin e historisë sonë, sakrificat, rezistencën tonë shekullore për një jetë dinjitoze, në këto hapësira si të gjithë popujt tjerë të rajonit. Ata u solidarizuan me ne, me vuajtjet, dhembjet dhe kalvarin e gjatë të historisë sonë nëpër të cilin kaluam për më shumë se një shekull dhe qëndruan me besnikëri në anën tonë.

Ishte momenti i fundit, që Evropa t'i korrigjojë gabimet e veta, që para më shumë se një shekulli kishte marrë në dëm të shqiptarëve dhe çështjes së tyre në kryeqendrat e vendosjes si në kongresin e Berlinit, Londrës dhe të Parisit. Brezat e rinj të politikanëve evropianë, e kishin kuptuar këtë gabim fatal të parëve të tyre, të cilët të udhëhequr nga parimet e përkatësisë fetare e kombëtare dhe të aleancave me fuqitë e asaj kohe kishin vendosur një baraspeshë të paqëndrueshme në Ballkanin e trazuar, në dëm të shqiptarëve. Ky ishte një rast shumë i mirë, ku Evropa e Bashkuar, kishte shansin ta korrigjonte një gabim të tillë shekullor. Ky hap u bë edhe fal angazhimit parimor edhe të SHBA-së, e cila gjatë tërë historisë u solidarizua me popullin shqiptar.

Të rralla janë rastet në histori, kur në një vend dhe popull i vogël, siç është Kosova dhe kosovarët, ka mundur që për kauzën e vet të mobilizojë një numër aq të madh të vendeve nga të gjitha meridianët e botës. Vet kjo do të thotë shumë për ne dhe për punën që është bërë deri në këtë kohë. Ky mobilizim është bërë, fal sakrificave dhe vuajtjeve të popullit tanë, për më shumë se një shekull, që populli ynë ka bërë në emër të pavarësisë së Kosovës. Bota ishte dëshmitare e masakrave të mëdha, që populli ynë përjetoi edhe gjatë dhjetëvjetëshit të

fundit të shekullit njëzet, siç ishin masakra Qirezit, Likoshanit, Prekazit, Reçakut, deri në dëbimin masiv të mbi një milion shqiptarëve gjatë bombardimeve të forcave të NATO-së. Këto krime, do të rëndojnë gjatë tërë historisë mbi ndërgjegjen e popullit serb, të cilët ende nuk patën guxim që së paku të distancohen nga krimet e bëra si dhe t'i kërkojnë falje popullit shqiptar për të gjithë ato të këqija që na janë bërë në emër të kombit serb dhe ortodoksizmit.

17 shkurti 2008 - datë historike

17 shkurti i vitit 2008 do të shënohet në analet e historisë sonë më të re kombëtare me shkronja të arta. Populli shqiptar i Kosovës, pas sa e sa përpjekjeve mbinjerëzore dhe me shumë sakrifica arriti ta realizojë ëndrrën e tij shekullore, që Kosovën ta shpallë shtet sovran dhe të pavarur. Ai këtë po e bënë sot, fal ndihmës dhe mbështetjes të shumë popujve paqedashës, të cilët janë për vendosjen e parimeve të drejtësisë në Evropën e Bashkuar. Populli i Kosovës, në të gjitha fazat e historisë së tij të gjatë ka treguar se është popull i denjë për qeverisjen e vendit të vet, por edhe i denjë për stabilitetin dhe vendosjen e paqes në rajon. Kosova, pas shpalljes së aktit të pavarësisë, si shteti më i ri në Evropë, por edhe në botë do të tregojë në praktikë se do të jetë faktor stabiliteti në rajon dhe më gjerë. Kosova do të ketë marrëdhënie të mira fqinjësore me të gjitha vendet rreth saj, duke përfshirë edhe Serbinë. Ekzistimi i pakicës serbe në Kosovë, dhe pakicës shqiptare në Serbi, si dhe interesat e përbashkëta në mes të dy vendeve do të bëjnë që euforia dhe emocionet e tanishme të kalojnë shumë shpejt dhe të dyja vendet të vendosin marrëdhënie të mira fqinjësore, duke i dhënë përparësi zgjidhjes së shumë problemeve të mbetura nga e kaluara, në radhë të parë zbardhja e fatit të personave të pagjetur.

Megjithë, reagimet e shumta nga Beogradi, Kosova dhe Serbia, në një të afërme të afërt apo të largët, do të gjenden së bashku në kuadër të familjes së madhe të vendeve evropiane. Por, atëherë do të konsiderohen si dy shtete sovrane dhe të pavarura. Vetëm një logjikë e matur e establishmentit politik të Beogradit, larg miteve të së kaluarës, do

t'ia hapte dyert Beogradit në drejtim të Brukselit. Beogradi, tash më në të gjitha variantet, Kosovën e ka humbur dhe ajo faktikisht asnjë herë nuk ka qenë pjesë e Serbisë, por ishte koloni që sundohej me forcat policore dhe ushtarake serbe, për më shumë se një shekull.

Sfidat pas pavarësisë

Pavarësia e Kosovës është vetëm hap i parë, në rrugën e saj të gjatë dhe të vështirë drejt pavarësisë së Kosovës. Periudha pas pavarësisë nuk do të jetë e lehtë. Para Kosovës dhe popullit të saj gjenden sfida të shumta. Ato filluan që në ditën e parë pas pavarësimit të saj. Federata Ruse dhe Serbia me tërë potencialin e tyre janë kundër pavarësimit të Kosovës. Rusia si anëtare e përhershme në Këshillin e Sigurimit të OKB-së me të drejtë vetoje, po e pengon nxjerrjen e një rezolute të re për Kosovën. Numri i shteteve që kanë njohur Kosovën shtet sovran dhe të pavarur ka arritur në dyzet. Me rëndësi është se deri më tash Kosovën e kanë njohur një numër i konsideruar i shteteve më të fuqishme të botës, në mesin e tyre edhe SHBA-të, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia etj. Që do të thotë se kjo është një njohje kualitative. Serbia në bashkëpunim me Federatën Ruse, po bënë çmos që njohja e Kosovës të pengohet sa më shumë që është e mundur, duke përdorur metoda prej më të ndryshmëve. Në këtë aspekt, deri diku edhe ato kanë pasur sukses. Kështu që disa shtete brenda vet Bashkimit evropian ende nuk e kanë njohur Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur. Por, ndikimi i tyre ka arritur edhe në disa vende tjera, sic janë shtetet anëtare të Konferencës së vendeve Islamike, Ligës Arabe, ku Kosova si shtet i ri me shumicë të popullatës myslimane ka pasur shpresa se do të njihet shumë shpejt dhe pa pengesa të theksuara. Për këtë nga institucionet e Kosovës lypset një angazhim më i madh për tejkalimin e këtyre pengesave duke krijuar kontakte direkte me këto shtete. Sepse njohja e pavarësisë së Kosovës nga një numër sa më i madh i shteteve anëtare të OKB-së është në dobi të saj dhe ia hap dyert e pranimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Pasi që nxjerrja e një rezolute të veçantë për Kosovën nëpërmes Këshillit të

Sigurimit të OKB-së është i pamundur për shkak të kërcënimit të Rusisë se ajo do ta përdor të drejtën e vetos.

Sfidë tjetër me rëndësi për Kosovën dhe të ardhmen e saj është edhe vështirësitë ekonomike me të cilat ballafaqohet ekonomia kosovare në këto tri dekadat e fundit. Kosova e pavarur po trashëgon një ekonomi pothuajse jofunksionale dhe të varfër. Rezultat i kësaj kemi një papunësi enorme të rinjve kosovar dhe një standard tejet të ulët. Papunësia arrin në mbi 60%, kurse mbi 15% e popullatës jetojnë në varfëri të skajshme. Andaj, për t'i tejkaluar të gjitha këto vështirësi ekonomike kërkohet prej qeverisë aktuale dhe institucioneve tjera shtetërore gjetjen e kapitalit të ri dhe përgatitjen e terrenit për investime të jashtme në Kosovë, për hapjen e vendeve të reja të punës. Mirëpo, investuesit dëshirojnë siguri për kapitalin e tyre, andaj në Kosovë duhet të krijohet një ambient i sigurt. Por, në anën tjetër duhet të sundojë ligji dhe të zhduket dukuria e korrupsionit si një e keqe tejet e dëmshme për shoqërinë tonë.

Për këtë mund të thuhet se shpallja e Kosovës, nga ana e Kuvendit, shtet sovran dhe i pavarur më 17 shkurt 2008, është vetëm fillim i një rrugëtimi të gjatë dhe me plot peripeci dhe vështirësi, për çka nga të gjithë ne lypset angazhim, mund dhe sakrifica për ndërtimin e shtetit më të ri në Evropë dhe në botë.

Qemajl Morina

KOSOVA-AN INDEPENDENT AND SOVEREIGN STATE

(Summary)

Since the end of the war in Kosova, in June 1999, the Albanians have eagerly anticipated the independence of Kosova. The independence of Kosova was eagerly anticipated by all its citizens, those who consider Kosova their motherland. An independent Kosova means greater prosperity and a better future for all its citizens, without distinction of any kind (nationality, religion, etc.). An independent Kosova means a wealthier place for all (the majority and the minorities). An internationally recognized Kosova means recognition of the sufferings of the people of Kosova. The independence of Kosova guarantees greater prosperity for its citizens and a better future for all.

كمال مورينا

كوسوفا دولة مستقلة و ذات سيادة

(خلاصة البحث)

منذ أن وضعت الحرب في كوسوفا اوزارها في يونيو من سنة 1999 عاش الالبانيون في رهبة في انتظار استقلال كوسوفا. و عاش هذه الرهبة معهم بقية سكان كوسوفا الذين يعتبرون كوسوفا وطنا لهم لان استقلال كوسوفا يعنى بالنسة لهم جميعا أكثر أزدهارا و تقدما بصرف النظر عن انتمائهم الدينى أو القومى أو التي يتكلمون بها. لان كوسوفا مستقلة و ذات سيادة تعنى حياة أفضل للغالبية و الاقليات أيضا و كوسوفا معترف بها من قبل المجتمع الدولى يعنى اعتراف من بقية الامم لتضحيات كوسوفا و ازدهارا للاجيال القادمة.

AKAID

Kasim Gërguri

ARSHI - krijesë madhështore

Falënderimi i qoftë Allahut një, i Cili është i Zoti i Arshit të madhëruar, i domosdoshëm në ekzistencën dhe përhershmërinë e Tij, falënderuar qoftë Allahu, i Cili sundon krijesat e Tij dhe nuk është i varur nga to, falënderuar qoftë Allahu, i Cili nuk përzihet me krijesat e Tij, falënderimi i qoftë Allahut që Islamin e zgjodhi fe për njerëzit, paqja dhe bekimet qofshin mbi Pejgamberin e Tij të fundit Muhamedin a.s, familjen, shokët dhe mbi të gjithë ata që e përcollën dhe e përcjellin deri në ditën e Kiametit.

Arshi ka qenë dhe mbetet ndër çështjet më të ndërlikuara te dijetarët islamë, me këtë çështje janë marrë pothuajse të gjitha gjeneratat e islamologëve, për këtë temë kanë diskutuar të parët dhe pasuesit dhe secili e ka komentuar nga prizmi i tij, gjithnjë duke u bazuar në versetet Kur'anore, ku Allahu xh.sh. e përmend Arshin në shtatë kaptina të Kur'anit dhe atë në:

1-Surtu El-A'raf, Ajeti 54, **ثم استوى على العرش**
2-Suretu Junus, Ajeti 3, **ثم استوى على العرش**
3-Suretu Er-Rra'd, Ajeti 2, **ثم استوى على العرش**
4-Suretu Ta Ha, Ajeti 5, **الرحمن على العرش استوى**
5-Suretu El-Furkanë, Ajeti 59, **ثم استوى على العرش**

6-Suretu Es-Sexhde, Ajeti 4, **ثم استوى على العرش**
7-Suretu El-Hadidë: 4. **ثم استوى على العرش**

Arshi në aspektin gjuhësor: Pasqyron shprehje për fronin e mbretit, siç thotë Allahu në Kur'anin e Tij fisnik: ***و لها عرش عظيم "e ajo kishte një fron të madh"*** *En-Neml: 23,* ai nuk është planet, as arabët nuk e kuptojnë këtë (si planet), e Kur'ani ka zbritur në gjuhën arabe, e ai është kolltuk madhështor të cilin e bartin melaiket. Ai është sikur kupolë e botës, dhe Ai është kulm (çati) e krijesave. (Allahu nuk është i nevojshëm për Arshin dhe çka ka pos Tij), argumentojmë me ajetin e Allahut:

فان الله غني عن العالمين "All-llahu nuk është i nevojshëm për njerëzit". *Ali Imran 97,* pastaj:

والله هو الغني الحميد "... All-llahu nuk ka nevojë për ju Ai është i falënderuari" *Fatir: 15,* e për këtë Allahu i Madhërishëm sqaron se krijimi i Arshit dhe ngritja e Allahut xh.sh. mbi të nuk e ka kuptimin e nevojës për të, por në këtë ka urtësi, të qenit e të lartit mbi të ulëtin nuk nënkupton që i ulëti të jetë i nevojshëm për të lartin ose rrethues i tij ose bartës i të lartit, dhe po ashtu nuk nënkupton që i larti të jetë i nevojshëm për të ulëtin. Shiko qiellin se si qëndron mbi tokë dhe nuk është i nevojshëm për të? Allahu është më i madhi dhe më meritori. [1]

Arshi në aspektin gjuhësor do të thotë: Fron i posaqëm për mbret, siq thotë edhe Allahu xh.sh. ***"E ajo kishte një fron të madh".*** *En-Nemël: 23.*[2]

Komentatorët e Kur'anit kanë thënë: Arshi është fron, ai është objekt i formësuar e ka krijuar Allahu xh.sh.dhe i ka urdhëruar melaiket që ta bartin ate, dhe ta madhërojnë Allahun me ibadet dhe tavaf (sjellje rreth tij, dhe bartje). Ngjajshëm siç ka krijuar Qabenë në tokë dhe

[1] Sherh El-Akideh El-Tahavijeh – Imam El-Kadi Ali bin Ali bin Muhamed Ebi El-Izz El-Dimeshki, Recensuar nga Dr. Abdullah Bin Abdulmuhsin El-Turki dhe Shuajb El-Arnauti, pjesa e II-të, Bot. IV-të Bejrut 1992, fq. 366-372

[2] Muaxhem Elfadh El-Akideh, Autor: Ebi Abdullah Amir Abdullah Falih, Përgatitur nga: Muhamed Abullah bin Abdurrahman bin Xhibrin, Botim I-rë 1997 Riad,Fq.278.

ka urdhëruar njerëzit për tavaf dhe kah ajo të drejtohen në namazet e tyre.[3]

Dijetarët islamë janë në kontradiktë lidhur me vendin, nga ta argumentojnë dhe thërrasin se Ai qëndron mbi Arsh, kurse Arshi te ta është kolltuk, i cili bartet nga melaiket, të cilat e rrethojnë atë, për këtë mbështeten në ajete Kur'anore:

وَالْمَلَكُ عَلَى أَرْجَائِهَا وَيَحْمِلُ عَرْشَ رَبِّكَ فَوْقَهُمْ يَوْمَئِذٍ ثَمَانِيَةٌ

"Dhe engjëjt qëndrojnë në skajet *(anët)* ***e tij, e atë ditë tetë*** *(engjëj)* ***e bartin mbi vete Arshin e Zotit tend".*** *El-Hakka: 17,* pastaj:

وَتَرَى الْمَلاَئِكَةَ حَافِّينَ مِنْ حَوْلِ الْعَرْشِ

"E do t'i shohësh engjëjt të rreshtuar përreth Arshit... " *Ez-Zumer: 75,* Pastaj:

الَّذِينَ يَحْمِلُونَ الْعَرْشَ وَمَنْ حَوْلَهُ

"Ndërsa ata *(engjëjt)* ***që e bartin Arshin edhe ata që janë përreth e tij..."*** *Gafir: 7,* dhe argumentojnë thëniet e tyre me thënien e Allahut:

الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَى

"*(E Ai është)* ***Mëshiruesi që qëndron mbi Arshin"*** *Ta-Ha 5*

Dhe me ngritje të duarve ku njerëzit i drejtojnë në drejtim të qiellit për lutje dhe mirësi të ndryshme.

Nga ana tjetër, ka të tillë që pretendojnë se Ai është në çdo vend duke u mbështetur në vërsetet Kur'anore:

مَا يَكُونُ مِن نَّجْوَى ثَلاَثَةٍ إِلاَّ هُوَ رَابِعُهُمْ وَلاَ خَمْسَةٍ
إِلاَّ هُوَ سَادِسُهُمْ وَلاَ أَدْنَى مِن ذَلِكَ

[3] Kitab El-Esma ve El-Sifat-Imam El-Hafidh ebi Beker Ahmed bin El-Husejn bin Ali El-Bejheki, Shtëpia botuese Ihja El-Turath el-Arabi Bejrut-Liban pa vit botimi fq.392)
Arshi është Arsh ashtu si i përket Allahut xh.sh.ne nuk kemi njohuri për fronin e Tij, kjo është më e pranuar për fenë tonë

"Nuk bëhet bisedë e fshehtë mes tre vetave e të mos jetë Ai i katërti; e as mes pesë vetave e të mos jetë Ai i gjashti, e as mes më pak vetave dhe as mes më shumë vetave, e të mos jetë Ai me ta, kudo që të jenë." *El-Muxhadeleh: 7.*

Pastaj:

وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ

"... dhe Ne jemi më afër tij se damari *(që rrah)* ***i qafës së tij."*** *Kaf: 16.*

Pastaj:

وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنكُمْ وَلَكِن لاَّ تُبْصِرُونَ

"E Ne jemi më afër tek ai se ju, por ju nuk shihni". *El-Vakiah: 85,* Pastaj:

وَهُوَ الَّذِي فِي السَّمَاء إِلَهٌ وَفِي الأَرْضِ إِلَهٌ وَهُوَ الْحَكِيمُ الْعَلِيمُ

"Ai është që në qiell është All-llah dhe në tokë All-llah, Ai është i urti, i dijshmi." *Ez-Zuhruf: 43.*

Dhe mendojnë që thëniet e tyre se Ai është në një vend e jo në tjetrin lind përkufizimi, dhe çdo send që është i kufizuar ka mangësi, sepse ai është më i madh ose më i vogël se vendi. E kjo është e papranueshme.

Nga ana tjetër, kemi dijetarë të cilët në asnjë mënyrë nuk e pranojnë përkufizimin-qëndrimin në asnjë vend dhe të gjitha vërsetet Kur'anore që kanë të bëjnë me vendin i pranojnë vetëm në mënyrë alegorike, në kuptimin e ruajtjes dhe mbizotërimit.

Imam Maturidiu lidhur me këtë çështje thekson: Kuptimi i çështjes ka të bëjë me tërësinë e gjërave në ekzistencë se çdo gjë është krijimtari e Allahut xh.sh. dhe nga kjo nxjerrim cilësinë e ngritjes, të lartësimit dhe Madhërisë së Tij, ku i Madhërishmi në mënyrë të përgjithshme thotë:

لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالأَرْضِ

"Ai është që vetëm Atij i takon sundimi i qiejve dhe i tokës". *El-Furkan: 2,* Pastaj:

رَبُّ السَّمَاوَاتِ وَالأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا وَرَبُّ الْمَشَارِقِ

"Zot i qiejve dhe i tokës e çka ka mes tyre dhe Zoti i lindjeve *(të yjeve)".* *Es-Saffat: 5,* pastaj:

هُوَ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ ***"... Krijues i çdo sendi... "*** *El-En'am: 102,* pastaj:

رَبِّ الْعَالَمِينَ ***"... Zotit të botëve"*** *El-Fatiha: 2,* pastaj:

وَهُوَ الْقَاهِرُ فَوْقَ عِبَادِهِ ***"Ai është mbizotërues ndaj robërve të Tij."*** *El-Én'am: 18,* etj.

Nga ana tjetër, Allahu xh.sh. na flet në formë të përcaktuar-veçantë, në kuptimin e fisnikërisë, të nderimit, privilegjit dhe respektit, me këtë duke u bazuar në vërsetet Kur'anore:

إِنَّ اللَّهَ مَعَ الَّذِينَ اتَّقَواْ ***"S'ka dyshim se All-llahu është me ata që janë të devotshëm"*** *En-Ńahl 128,* pastaj: وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ ***"Dhe*** *(mua më shpallet)* ***se vërtet xhamitë janë veçantë për ta adhuruar All-llahun"*** *El-Xhin 18,* pastaj: نَاقَةَ اللَّهِ ***"Kini kujdes devenë e All-llahut"*** *Esh-Shems 13,* pastaj: فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ ***"Pra, le ta adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie"*** *Kurejsh 3,* etj.

Në fakt Allahu ekzistonte para vendit, është e lejuar ngritja, por mbetja e Tij ashtu sikur që ishte edhe para krijimit, dhe Ai është sikur që ishte, dhe ka qenë sikur që është tani. I lartësuar është Allahu nga ndryshimi, kalimi dhe lëvizja nga një vend në tjetrin, për faktin se këto janë shenja të risisë.

Nëse mendojmë se Ai është i vendosur në vend, atëherë i kemi dhënë një pjesë të botës, e kjo është shenjë e mangësisë, kurse Allahu nuk cilësohet me të kundërta. Allahu qoftë i lartësuar nga mendimet e tilla.[4]

[4] Kitab El-Tevhid –Imam Ebi Mensur El-Maturidi, redaktuar dhe përgatitur nga Dr. Fethullah Hulejf Aleksandri pa vit botimi, fq. 67-69.

Arshi është krijesë madhështore për të cilën di vetëm Ai që e krijoi me fuqinë e Tij, pa kurrfarë modeli. Allahu xh.sh. nuk ka nevojë për të, ashtu siç nuk ka nevojë për krijesat e tjera.

Arshi është trup-krijesë e kufizuar[5], ka fillim do të thotë, i parapriu mosekzistimi, siç janë edhe planetët e tjerë.

Nëse themi se Allahu qëndron në Arsh, atëherë Ai duhet të jetë:

Më i madh, më i vogël ose i barabartë. Nëse besojmë në këtë, atëherë i kemi dhënë Allahut vend, e ai i cili mendon dhe beson se Allahu ka vend, ai veç është larguar nga e vërteta, kur e dimë që Allahu është i zhveshur nga kahet.

Logjika e shëndoshë nuk pranon që një Zot, i Cili është i pa fillim dhe i pambarim të krijojë një krijesë dhe të vendoset në të. Nëse besojmë në këtë, atëherë Ai qenka i nevojshëm, e ai që ka nevojë për diçka, nuk është zot i vërtetë, sepse vetëm krijesat e të madhit Zot janë të nevojshme për Krijuesin e tyre, e jo Krijuesi për krijesat e Tij.

Ai ndërron në krijesat e Tij dhe nuk ndërrohet.

Të gjitha versetet kuranore që kanë të bëjnë me Arshin duhet komentuar dhe shtjelluar në mënyrë precize e jo tekstualisht, nga ata që janë të pajisur mirë me shkencat Islame.

Nëse disa versete kuranore kuptohen vetëm tekstualisht, kurse disa të tjera sqarohen dhe studiohen, atëherë kjo nuk është reale. Ose do t`i marrim të gjitha tekstualisht ose duhet sqaruar të gjitha. Nëse i marrim ashtu siç janë pa kurrfarë komenti do të hasim në kundërshtim, ndërkaq kundërshtimi në librin e Zotit nuk ka vend. Për t`i ikur kësaj duhet t`i sqarojmë që të gjitha në mënyrë precize duke iu larguar çdo dyshimi.

Nisur nga këtu në Kur'an kemi ajete të qarta (muhkem), të cilat janë të prera në kuptim dhe nuk përmbajnë kuptim tjetër, dhe jo të qarta (muteshabih) të cilat në vete përmbajnë më shumë se një kuptim. Allahu xh.sh. lidhur me ajetet e qarta dhe jo të paqarta na flet në suren Ali Imran dhe thotë:

[5] Tebsiretul edileh fi usul el din, Sipas drejtimit të Imam Ebi Mensur El-Maturidiut, Autor - Ebi Muajen Mejmun bin Muhamed El Nesefi, Redaktuar nga Kulud Selameh, Vëllimi i I –Damask 1990, fq. 171.

هُوَ الَّذِي أَنزَلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ مِنْهُ آيَاتٌ مُّحْكَمَاتٌ هُنَّ أُمُّ الْكِتَابِ وَأُخَرُ
مُتَشَابِهَاتٌ فَأَمَّا الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ زَيْغٌ فَيَتَّبِعُونَ مَا تَشَابَهَ مِنْهُ ابْتِغَاء الْفِتْنَةِ
وَابْتِغَاء تَأْوِيلِه وَمَا يَعْلَمُ تَأْوِيلَهُ إِلاَّ اللّهُ وَالرَّاسِخُونَ فِي الْعِلْمِ
يَقُولُونَ آمَنَّا بِهِ كُلٌّ مِّنْ عِندِ رَبِّنَا وَمَا يَذَّكَّرُ إِلاَّ أُوْلُواْ الأَلْبَابِ

"Ai është që ta zbriti librin ty e që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit, e ka të tjerë që nuk janë krejtësisht të qarta *(muteshabih).* ***E ata, që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar huti, e kinse kërkojnë komentin e tyre. Po, pos All-llahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: "Ne u kemi besuar atij*** *(atyre që janë të paqarta),* ***të gjitha janë nga Zoti ynë"! Por, këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes". Ali Imran 7***

Lidhur me Arshin kryesisht kemi të bëjmë me mendimet e dy grupeve dhe secila prej tyre i ka argumentet e veta pro dhe kontra.

1. Grupi i parë thanë:

Nga disiplina dhe nderi duhet të ndalemi në sipërfaqësinë e tyre-duhet t`i marrin ashtu si janë dhe çështja të mbetet në diturinë e Allahut xh.sh. Në këtë grup hyjnë shokët e Pejgamberit a.s. sahabët, e këtij mendimi iu bashkëngjitën edhe disa të mëvonshëm që veten e quajnë "selefi". Shokët e Pejgamberit a.s. nuk u thelluan në komentimin e verseteve që kanë të bëjnë me cilësitë e Allahut xh.sh. për disa shkaqe: Ata e njihnin mirë gjuhën arabe dhe ishin të vetëdijshëm se në gjuhën arabe përdoret alegoria, mënyra figurative dhe stili i lartë i Kur'anit, dhe nuk kishte nevojë për koment, sepse e kuptonin nga kontesti i fjalisë. Nga ana tjetër, ata ishin të angazhuar me përhapjen e fesë islame sa më shumë.

Metoda e selefitëve në kohën e tyre ka qenë më e vlefshme më e sigurt dhe më e përshtatshe. Shumë normale ishte që Imam Maliku r.a. kur u pyet për Istivan. (Istivaja-(të qëndruarit e Allahut mbi Arsh)

është e njohur, forma është e panjohur, besimi në të është obligim, kurse pyetja për të është bidat-risi).

Pra, Imam Maliku ka pasur mundësi të përgjigjet në këtë mënyrë, pasi ajo kohë ka qenë afër kohës së Pejgamberit a.s. dhe zgjerimit të rrezatimit të tij.[6]

Imam Ahmed bin Hanbel dhe Davud bin Alij El-Esfehani dhe një grup nga dijetarët e hershëm kanë qenë të vendosur në rrugën e të parëve të hershëm nga dijetarët e hadithit p.sh. Malik bin Enes dhe Mukatil bin Sulejman, që e kanë ndjekur rrugën e shpëtimit dhe kanë thënë: Besojmë në atë që është thënë në Kur'an dhe hadith dhe nuk paraqitemi me te'vil-shtjellim pasi që përfundimisht e dimë që Allahut nuk i ngjan asgjë nga krijesat dhe çdo gjë që parafytyrojmë është krijimtari e Allahut xh.sh. Janë ruajtur nga përngjasimi deri në kulminacion sa që kanë thënë: Kush e lëviz dorën kur lexon vërsetin kuranor: **لما خلقت بيدى** ***(që Unë vetë e krijova me duart e Mia)*** *Sad 75,* ose sinjalizon me gisht kur lexon hadithin:

قلب المؤمن بين اصبعين من اصابع الرحمن *(Zemra e besimtarit është mes dy gishtave nga gishtat e Allahut),* obligohet prerja e dorës së tij ose e gishtit në rastin e dytë. Dhe thonë se ne jemi ndalur në sipërfaqësinë e ajeteve dhe në komentimin e tyre për dy çështje:

1-Ndalesa është urdhëruar me Kur'an në ajetin:

فَأَمَّا الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ زَيْغٌ فَيَتَّبِعُونَ مَا تَشَابَهَ مِنْهُ ابْتِغَاء الْفِتْنَةِ وَابْتِغَاء تَأْوِيلِه
وَمَا يَعْلَمُ تَأْوِيلَهُ إِلاَّ اللّهُ وَالرَّاسِخُونَ فِي الْعِلْمِ يَقُولُونَ آمَنَّا بِهِ كُلٌّ مِّنْ عِندِ رَبِّنَا

"E ata, që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar huti, e kinse kërkojnë komentin e tyre. Po, pos All-llahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: "Ne u kemi besuar atij *(atyre që janë të paqarta),* ***të gjitha janë nga Zoti ynë", e ne jemi ruajtur nga lajthitja."***

[6] Të vërtetat e patundshme të besimit Islam, prof. dr. Muhamed Seid Ramadan El-Buti, përkthim nga Abdurrahman Asllani dhe Ibadete Imeri, Tetovë 2004, fq. 128

2-Shtjellimi është çështje e dyshimtë unanimisht nga dijetarët. E të thuash diçka në lidhje me cilësitë e Allahut me supozim nuk është e lejuar. Për faktin se ndoshta kemi shtjelluar ajetin në formën që nuk ishte synimi i Allahut xh.sh. e në këtë rast kemi rënë në lajthitje. Mirëpo, ne do të themi sikur që thanë dijetarët:

كُلٌّ مِّنْ عند ربِّنَا (të gjitha janë nga Zoti ynë). Besojmë në sipërfaqësinë e tyre dhe vërtetojmë brendinë e tyre, dhe diturinë tonë e kemi mbështetur në diturinë e Allahut, sepse nuk jemi të ngarkuar me këtë për arsye se nuk janë nga kushtet e besimit.[7]

Aliu r.a. thotë: Vërtetë Allahu e ka krijuar Arshin që ta shfaqë fuqinë e Tij, e jo vend për Qenjen e Tij.[8]

Imam Ebu Hanife[9] thotë: Allahun e mendojmë me lartësi e jo me ultësi. (Për shkakun se ultësia nuk përkon me Krijuesin dhe sunduesin e çdo gjëje.) Komente të Imam Ebu Hanifes do të shohim edhe më vonë.

Imam Malik bin Enes[10] thotë: "Vërtet Allahu është në qiell, kurse dituria e Tij në çdo vend. Gjithashtu Imam Maliku kur është pyetur për Arshin është përgjigjur:

الاستواء معلوم، والكيف مجهول، والايمان به واجب، والسؤال عنه بدعة (Istivaja-(të qëndruarit e Allahut mbi Arsh) është e njohur, forma është e panjohur, besimi në të është obligim, kurse pyetja për të është bidat-risi).

[7] El-Milel ve El-Nihal, Ebi El-Fet'h Muhamed bin Abdulkerim bin Ebi Beker Ahmed El-Shehrestani, recensuar nga Muhamed Sejid Kejlani-Pjesa e I-rë, Kajro 1976 fq. 104.

[8] www.sunna.info/lessons/islam_590

[9] El-Nuëman Bin Thabit El-Kufi i njohur si Ebu Hanifeh i titulluar me titullin Imam El-Eadham, i lindur në Kufe në vitin 80h, themelues i drejtimit më të vjetër dhe më të njohur Hanefij. I lindur në Kufe i shpërndarë në gjithë Irakun për t'u zhvilluar dhe ritur në gjithë botën. Ebu Hanife ishte i urdhëruar nga Halifeja Ebu Xhafer El-Mensuri që të jetë në krye të gjykatës, post të cilin nuk e pranon Imami i nderuar, burgoset me urdhrin e tij dhe vdes në burg në vitin 150h. Allahu e mëshiroftë.

[10] Malik Bin Enes El-Esbehi r. a. i lindur në Medinën e ndritshme në vitin 93h, dhe vdes në vitin 179h në vendlindjen etij. Imam Malik bin Enes është themelues i drejtimit të dytë për nga koha, nga katër drejtimet e njohura, i njohur si Malikij, i cili asaj kohe filloi zhvillimin e tij në vendlindjen e Imamit për t'u rritur në Hixhaz, Basra, Egjipt për të vazhduar në shtete të ndryshme të Afrikës dhe në thellësi të saj, Spanjë e vende të tjera të botës.

Imam Shafiu[11] thotë:" Vendosmëria mbi shehadetin: Nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi a.s. është i dërguar i Tij. Dhe Allahu xh.sh. është mbi Arshin e Tij. Në qiellin e Tij i afrohet krijesave të Tij në formën që dëshiron dhe zbret në qiellin e botës الى السماء الدنيا si të dëshiron.[12]

Imam Ahmed bin Hambeli[13] thotë: "Allahu është mbi qiejt e Tij, mbi Arshin i pa përzier me krijesat e Tij.

Imam Tahaviu[14] thotë: Arshi dhe Kursi[15] janë të vërteta. Allahu xh.sh. nuk është i nevojshëm për Arshin dhe çka ka pos Tij. Ai është gjithëpërfshirës ndaj çdo sendi dhe mbi çdo send.[16]

[11] Muhamed Bin Idris El-Shafi'ij El-Kirshi r. a. i lindur në Gaza në vitin 150h dhe vdes në Egjipt-Kajro në vitin 204h. Drejtimi i tij është i treti për nga koha nga katër drejtimet e njohura, i njohur si drejtimi Shafi'ij. Ky drejtim është i përhapur në shumë vende të botës.

[12] El-Akideh fi sifat limen erade El-Xhenat-Ebi Bekër bin Muhamed bin El-Hambeli-Bot. IV-të Amman-Jordan 1996, fq. 36-38

[13] Ahmed bin Hanbel El-Shejbani r.a. i lindur në Bagdad në vitin 164h dhe vdes në këtë qytet në vitin 241h. Sipas radhës drejtimi i katërt nga drejtimet e njohura të Ehli-Sunetit.

[14] Emri i plotë i këtij dijetari është: Iman Ebu Xhafer Ahmed bin Muhamed bin Selametu bin Selmetu bin Abdu Melik Zediju Elhaxheri El Masri et-Tahavi.
Taha - Tahavi quhet fshati në të cilin lindi ky imam, dhe sipas vendlindjes, ai u quajt et-Tahavi.
Ebu Xhafer et-Tahavi lindi në vitin 239 hixhri. Ai lindi në një familje me autoritet të madh për kohën, në një familje bujare e të ditur dhe me shumë dijetarë. Kur qe pajisur me dije të ndryshme fetare, Tahaviu në moshën njëzet vjeç ndërroi drejtimin (medhhebin) dhe filloi të studionte librat e drejtimit Hanefi. Imam Tahaviu ka qenë publicist i njohur. Ai u mor me akaid, me tefsir, fikh, hadith etj. historianët numërojnë më shumë se tridhjetë përmbledhje që shkroi imami, disa prej të cilave janë. Tahaviu vdiq dhe u varros në Egjipt në vitin 321 h. Allahu e mëshiroftë.

[15] Kursijeh=na vjen në kuptimin e **Diturisë** së Allahut, ky shtjellim na vjen nga Ibn Abasi r.a. Për më tepër shih. Sherh El-Akideh El-Akideh El-Tahavijeh – Imam El-Kadi Ali bin Ali bin Muhamed Ebi El-Izz El-Dimeshki, recensuar nga dr. Abdullah Bin Abdulmuhsin El-Turki dhe Shuajb El-Arnauti, pjesa e II-të, bot. IV, Bejrut 1992, fq. 371.
Të njëjtin tranşmetim e përcjellë edhe Imam Bejhekiu në librin e tij Kitab el-Esma ve El-Sifat وسع كرسيُّه السَّماوات والأرض "Kursija e Tij (dija) përfshijnë qiejt dhe tokën". El-Bekare 255, tránsmetojmë nga Seid bin Xhubejr nga Ibn Abasi r.a. i cili ka thënë:كرسيه=علمه Kursijeh=dituria e Tij.
Kitab El-Esma ve El-Sifat-Imam El-Hafidh ebi Beker Ahmed bin El-Husejn bin Ali El-Bejheki, Shtëpia botuese Ihja El-Turath el-Arabi Bejrut-Liban pa vit botimi, fq.392
Po ashtu këtë mendim e përmend edhe Abdullah Falih në "Muaxhem Elfadh El-Akideh" Botimi I-rë, 1997, Riad.

Besojnë në Levhi Mahfudh (pllaka ku janë të shkruara të gjitha sendet deri në Ditën e Gjykimit).

Arshi është i vërtetë, dhe Allahu është i pasur dhe nuk ka nevojë as për Arsh dhe për asgjë tjetër ç'ka mbi të dhe nën të.

Esharinjtë[17] bëjnë një zhveshje të tërësishme të Allahut xh.sh. nga çdo gjë që paramendohet dhe parashikohet në kokat e njerëzve për ngjashmërinë me gjësende.

Allahu xh.sh. nuk përbëhet nga atomi as është (shfaqje) aksidentale, nuk është trup, për Të nuk ekziston vend as kohë, nuk parashikohet kalimi prej një vendi në një vend dhe nuk ndodhet në anë të caktuara. Allahut xh.sh. nuk i përngjan kush nga krijesat, veçse Ai është Allahu që s'i ngjet askush dhe nuk është i nevojshëm për asgjë.[18]

Edhe pse punimi është kryekëput sipas shkollës Maturidite ne në fillim do të japim një mendim të kësaj shkolle.

Maturidinjët[19] e cilësojnë Allahun xh.sh. që është i pari - pa fillim, dhe i fundit - pa mbarim. Ai nuk përbëhet nga: aksidenca (shfa-

[16] Metn El-Akideh El-Tahavijeh-Imam Ebi Xhafer El-Tahavi El-Hanefi Bot. II-të, Bejrut fq. 19.

[17] Esharinjët janë pasuesit e Imamit të njohur e ai është: Ali bin Ismail bin Is-hak bin Salim bin Ismail bin Abdullah bin Musa bin ebu Burde bin ebu Musa El-Esharij.
Eshariu u lind më 260 h. në qytetin Basra të Irakut. Qendra e krijimtarisë së tij ka qenë në Bagdad; në të u zhvillua dhe aty vdiq në vitin 324 h.
Ebu Hasen El-Eshariu rrjedh prej një familjeje autoritative, që e ka rrjedhën nga shoku i Pejgamberit a.s., Ebu Musa El-Esharij.
Esharinjtë (sipas themeluesit të këtij drejtimi) janë zemra e Ehli-sunetit, të cilët nuk janë larguar nga mendimet e përgjithshme për asnjë moment, mirëpo ekzistojnë disa dallime në mes esharinjve dhe gjurmuesve në kuptimin e përgjithshëm të fesë. Këto dallime dhe mosmarrëveshje nuk janë të natyrës thelbësore për sa u përket kushteve dhe themeleve të besimit, por në kuptimin e akaidit dhe metodave të kuptimit të tij.

[18] El Firek el Islamijetu ve akaiduha dr. Muhamed Nebil Umeri, Amman, 1995, fq. 87.

[19] Maturidinjët janë pasuesit e imamit të madh Muhamed bin Muhamed bin Muhamed ebu Mensur El-Maturidiu, i cili jetoi në gjysmën e dytë të shekullit të tretë hixhrij dhe në gjysmën e parë të shekullit të katërt. Imam Maturidiu u lind në kohën kur po zhvilloheshin dialogë e debate të mëdha dhe të pafundme mes të muëtezilëve dhe shkollave të tjera filozofike.
Dr. Ejub Aliu thotë se Maturidiu u lind rreth vitit 238h. Nëse kemi dilema për vitin e lindjes, nga ana tjetër, të gjithë historianët pajtohen që Imam Ebu Mensur El-Maturidiu

qja), as nuk është i ndryshueshëm dhe nuk është në një anë të caktuar. Ai është Një, i Vetmi, nuk ka rival dhe Atij nuk i përngjet askush nga krijesat e Tij.

Allahu xh.sh. e ka cilësuar veten me cilësi të plota, të zhveshur nga çdo mangësi. Cilësitë e Tij janë të përhershme - pa fillim e pa mbarim. Cilësitë e Tij në asnjë formë nuk janë të ngjashme me cilësitë e krijesave të Tij. [20]

Imam Ahmed Ibn Tejmijeh, argumenton qëndrimin e tij se Allahu është i lartësuar mbi Arshin e Tij me argumente nga Kur'ani, dhe atë në shtatë kaptina të ndryshme: Suretu El-A'raf, Ajeti 54, Suretu Junus, Ajeti 3, Suretu Er-Rra'd, Ajeti 2, Suretu Ta Ha, Ajeti 5, Suretu El-Furkanë, Ajeti 59, Suretu Es-Sexhde, Ajeti 4, Suretu El-Hadidë 4. Pastaj me hadithin الجارية Robëresha (do ta shpjegojmë më vonë). Kur Pejgamberi a.s. e pyeti: أين الله *"Ku është Zoti"* (Robëresha sinjalizoi me gisht nga qielli). Në këtë ka argument se lejohet të bëhet pyetja. "Ku është Zoti". Komentuar nga dr. Salih El-Fevzani[21]

vdiq dhe u varros më 333 h. në Samerkand. Allahu e mëshiroftë. Nga ky mendim bën përjashtim vetëm Tash Kuperi, i cili thotë se Maturidiu ka vdekur në vitin 336h.
Vendlindja e tij ka qenë fshati Maturid ose Maturit, njëri nga fshatrat e Samerkandit. Ebu-Mensuri merr emrin Maturid sipas fshatit të lindjes. Nganjëherë quhet edhe Ebu Mensur El-Maturidi Es-Samerkandi, sipas krahinës së vendlindjes, kurse shokët e tij e quanin Huda (prijës-udhëheqës i diturisë), pastaj Imamul-Mutekelimin (Prijës i apologjetikëve) etj. Të gjitha këto pseudonime argumentojnë se ai gëzonte emër të nderuar në mesin e shokëve.
Ebu Mensur El-Maturidiu që nga fëmijëria mësoi prej dijetarëve të cilëve mësimet u kishin ardhur nga imam Ebu Hanifja.
Vlen të përmendet se Imam Maturidiu, Iamam Eshariu dhe Imam Tahaviu ishin bashkëkohanik, është mjaft indikativ fakti se këta imamë nuk u takuan kurrë në mes vete, vetëm se me mendimet e tyre.
Lidhshmëria ndërmjet maturidinjve dhe esharinjve në mendime është shumë e afërt, të dy drejtimet përdorin argumente nga Kur'ani dhe logjika e shëndoshë, kështu që me plot të drejtë konsiderohen si themelues të drejtimit "Ehli Sunetu vel xhemaatu".
Historiani Zubejdi thotë: "Kur të përmendet Ehli-Sunneti, do të thotë Esh'ariu dhe Maturidiu. Që të dy imamët ishin shumë të afërt në mendime, edhe pse nuk ishin takuar kurrë dhe as që dinin për mendimet e njëri-tjetrit.

[20] El-Firek el Islamijetu ve akaiduha dr. Muhamed Nebil Umeri, Amman, 1995, fq. 96

[21] Shih El-Akideh El-Vastijeh, të Imam Ahmed bin Tejmijjeh, Autor: Dr. Salih bin Fevzan bin Abdullah El-Fevzan Riad 1993, fq. 75 dhe 116

Imam Ibn Tejmijeh po ashtu pohon: Allahut nuk i ngjan asgjë nga krijesat, as në qenien e Tij, në cilësitë e Tij dhe as në veprimet e Tij. Nëse dikush pyet: Si qëndron Allahu mbi Arsh? thuaj ashtu sikur ka thënë: Rebiah, Maliku etj. r.a.

الاستواء معلوم، والكيف مجهول، والايمان به واجب، والسؤال عنه بدعة (Istivaja - (të qëndruarit e Allahut mbi Arsh) është e njohur, forma është e panjohur, besimi në të është obligim, kurse pyetja për te është bidat-risi. Për arsye se pyetja është e llojit që njerëzit nuk kanë njohuri dhe nuk kanë përgjigje për të.

Ai është Allahu mbi qiejt e Tij, mbi Arshin e Tij, i pastër nga krijesat e Tij, nuk ka asgjë nga Qenia e Tij në krijesat e Tij, dhe as në Qenien e Tij asgjë nga krijesat e Tij. E Ai është i plotfuqishmi i pasur nga Arshi, nga çdo krijesë dhe nuk është i varur nga asnjë krijesë, mirëpo Ai është mbajtës dhe pronar i Arshit.[22]

2. Grupi i dytë thanë se:

Kur`ani ka zbritur për mendjen e shëndoshë njerëzore, në mënyrë që të shtjellohet dhe studiohet dhe se mendja e njeriut është e obliguar që të merret me dituri dhe kuptime të qarta dhe shtuan; Duhet të shtjellohen në mënyrë precize me qëllim të zhveshjes nga dyshimi dhe personifikimi i Allahut xh.sh. Këta dijetarë thanë se këto versete nuk mund të kenë qëllimin sipërfaqësor, kur e dimë se Kur`ani u shpall në gjuhën e pastër arabe dhe në gjuhen arabe ekziston alegoria, pra nuk ka asgjë që na pengon në shtjellimin e tyre për zhveshjen e çdo dyshimi në Allahun xh.sh. Në këtë grup bëjnë pjesë studiuesit e mëvonshëm mysliman të cilët menduan dhe sakrifikuan për këtë drejtim.

E vërteta shkencore është se: Ata të cilët duan të dorëzohen si tradicionalistë le të dorëzohen dhe le t`i bindin zemrat e tyre me kuptimin sipërfaqësor, kurse të tjerët që duan t`i bindin zemrat dhe mendjet e tyre në shtjellimin e këtyre verseteve le t'i shtjellojnë, sikur të mëvonshmit.

[22] www.al-eman.com مجموع فتاوى ابن تيمية .

Metoda e halefëve në kohën e tyre është bërë fakt përfundimtar, prej të cilit nuk mund të largohet. E gjithë kjo për shkak të formimit të shumë shkollave dhe zhvillimit të debateve shkencore dhe për shkak të paraqitjes së retorikës, e cila mbështetet në norma të termave apo shprehjeve figurative, për shkak të alegorisë dhe metaforës. Në kohën e kodifikimit të shkrimeve, lulëzimit të shkencave, zgjerimit të rretheve të hulumtimit dhe të disiplinave të retorikës, këta nuk e kishin të lehtë, që të dorëzohen, pa i analizuar këto tekste dhe ato në dritën e arritjeve të disiplinave të retorikës dhe termave figurativ. [23]

Është e pavërtetë dhe e pa bazë që njëra nga dy grupet e cekura më lartë ta akuzojnë tjetrën me dalje nga vërteta në të pavërtetë- nga besimi në mosbesim, apo të përdorin mjete tjera në këtë apo në atë, sikur që shënoi historia e vërtetë. Gjoksi Islam është më i gjerë se e gjithë kjo.

Ne këtu nuk kemi të bëjmë me ato sekte, të cilat kanë devijuar e që quhen muatileh ose muxhesimeh dhe të cilët Allahun e parafytyruan, duke e përshkruar si trup e pastaj filluan t'i imagjinojnë formën dhe pamjen sipas dëshirës dhe shijes së tyre. Ata e bënin këtë duke u kapur pas përdorimit të jashtëm të këtyre teksteve, duke lënë pas shpine tekstet tjera që janë të prera e të qarta si dhe duke anashkaluar natyrën e kësaj gjuhe (arabe) e cila në vetvete ngërthen metaforën-alegorinë, terma figurative dhe stile të ndryshme të të shprehurit.[24]

Kush janë Selefitët dhe kush Halefitët?

Selefitët janë dijetarë të cilët kanë jetuar para përfundimit të shekullit të III-të hixhrij, dhe ata janë: Sahabët, Tabi'inët, Tebeitabi'inët, katër imamët e drejtimeve të njohura, (Hanefiu, Shafiu, Hanbeliu dhe Maliku), dhe dijetarët e mëdhenj të këtyre drejtimeve.

Halefët janë dijetarët të cilët jetuan pas përfundimit të shekullit III hixhrijë (e deri në ditët e sotme).

[23] Të vërtetat e patundshme të besimit Islam, prof. dr. Muhamed Seid Ramadan El-Buti, përkthim nga Abdurrahman Asllani dhe Ibadete Imeri, Tetovë 2004, fq. 128.
[24] Ibid 129.

Si selefitët ashtu edhe halefitët janë të mendimit që t'i shkoqisin ajetet e paqarta nga kuptimi i jashtëm. Përfundimisht duhet të besojmë se kuptimi i jashtëm nuk është qëllimi i Allahut.

Imam El-Subki thotë: Janë të pajtimit selefitët dhe halefitët që ajetet e paqarta të shtjellohen me shpjegim të përgjithshëm (ixhmalij) duke iu shmangur termave të kuptimit sipërfaqësor, i cili nuk i atribuohet Allahut xh.sh. për arsye të ekzistimit të ajeteve të prera që kanë të bëjnë me mospërgjasimin e asnjë sendi.

Pas kësaj marrëveshjeje që t'i shkoqisin ajetet nga sipërfaqësia e tyre, selefitët mbështetën mendimin se nuk duhet të shtjellohen ajetet (muteshabih) por mbështesin mendimin në sipërfaqësinë e këtyre ajeteve pasi e zhveshin Allahun nga çdo e metë. Shtjellimi i përgjithshëm përmban supozime, dhe të thuash–flasësh për cilësitë e Allahut me supozim nuk është e lejuar, sepse mund të shtjellosh atë që Allahu nuk e synoi dhe kjo mund të jetë shkak për lajthitje.

Rezultati përfundimtar mes dy grupeve, selefi dhe halefi është pajtimi i zhveshjes së Allahut xh.sh. nga çdo e metë me atë që përmbajnë tekstet sipërfaqësore dhe ajetet muteshabih të barten në dritën e ajeteve muhkem, sikurse janë[25]:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ***"Asnjë send nuk është si Ai... "*** *Esh-Shura: 11* pastaj:

وَلَمْ يَكُن لَّهُ كُفُوًا أَحَدٌ ***"Dhe Atij askush nuk i është i barabartë".*** *El-Ihlas: 4.*

Vlen të përmendet se Allahu e ka cekur shumë herë në Kur`an fjalën e Tij "t'ëviil" në kuptimin sqarim, shtjellim, komentin etj.

يَا أَبَتِ هَذَا تَأْوِيلُ رُؤْيَايَ مِن قَبْلُ

"O ati im kjo është <u>domethënia</u> e ëndrrës sime të mëparshme…" *Jusuf:100*

Që do të thotë se ky është komentimi dhe sqarimi i ëndrrës që e kam parë më herët.

Pastaj:

[25]Sherh Xhevhereh El-Tevhid, Imam Ibrahim El-Baxhuri, përgatitur nga prof. Abdulkerim El-Rrifai, Damask, 1391hixhri, fq. 153-154.

قَالَ هَذَا فِرَاقُ بَيْنِي وَبَيْنِكَ سَأُنَبِّئُكَ بِتَأْوِيلِ مَا لَمْ تَسْتَطِع عَّلَيْهِ صَبْرًا

***"Ai** (i Dijshmi) **tha: "Tash është koha e ndarjes mes meje dhe mes teje, e unë do të tregojë për <u>domethënien</u> e asaj që nuk munde të kesh durim!"** Kehf: 78*

Që do të thotë: do të lajmëroj me sqarim dhe komentim të këtij urdhri për të cilin nuk pate durim.

Në kaptinën Jusuf , verseti 6 thuhet:

وَكَذَلِكَ يَجْتَبِيكَ رَبُّكَ وَيُعَلِّمُكَ مِن تَأْوِيلِ الأَحَادِيثِ

"Ja kështu Zoti yt të zgjedh ty, të mëson <u>interpretimin</u> e ëndrrave...".

Që do të thotë: Ai ta mëson ty kuptimin, sqarimin dhe interpretimin e ëndrrave.

* Është shumë me rëndësi të theksohet se disa Sahabinj nga gjenerata e parë Islame kishin përdorur *"Te'ëviilin"* - shtjellimin e ajeteve kuranore , e vërtetë kjo e pakontestuar.

1. Ibni Abbasi ka përdorur "Te'vilin-shtjellimin dhe atë në versetin kur`anor :

يوم يكشف عن ساق ***"(Përkujto) ditën kur <u>ashpërsohet</u> çështja deri në kulm** (në kijamet)…"* (*El-Kalem:* 42), për të cilin Ibni Abasi tha:

يوم يكشف عن شدة që do të thotë: "ditën kur Shfaqet ashpërsia".

Këtë e cek Hafidh Ibni Haxheri në librin *"Fet-hul Barii"* pastaj, El Hafidh Ibn Xheriir Et-Taberiu në tefsirin e tij, i cili duke shpjeguar rreth kuptimit të këtij ajeti thotë: "Një grup nga sahabët dhe tabiinët nga komentatorët si shpjegim të këtij verseti thanë se çështja ka të bëjë me një gjë të **<u>ashpërsuar</u>**"[26]

Po ashtu i të njëjtit mendim është edhe Imam Maturidiu në Tefsirin e tij, Tevilat Ehli s-Suneh ku për ajetin në fjalë يوم يكشف عن ساق thotë: Kur të shfaqet vendi i premtuar, kur përjetohen vështërsitë dhe lëmëritë. الشدة= الساق , këmbë=ashpërsi, është quajtur këmbë për fa-

[26] Xhamiu El-Bejan fi tefsir El-Ku'an, Ebi Xheafer Muhamed bin Xherir El-Taberi, Shtëpia botuese El-Mearifeh, Bejrut-Liban 1992, Vëllimi 28-30, pjesa 12, fq. 24. Gjithashtu në web faqen, www. altafsir. com-xherir el-Taberi.

ktin se njerëzit fuqinë e tyre e kanë në këmbë, sepse me to bartin barra dhe ky është pseudonim i **forcës,** kjo është arsyeja pse përmendet e jo këmba për ta vërtetuar ate. Allahu xh.sh. e din më së miri.[27]

E këtë e pranuan edhe Ibn Tejmije dhe nxënësi i tij Ibën Kajjimi.

Besoj se këtë fakt duhet ta pranojnë edhe ata që thëniet e tyre i mbështesin te këta dy dijetarë, përndryshe çdo gjë jashtë kësaj do të konsiderohej fanatizëm.

Gjithashtu zotëriu ynë Ibn Abasi r. a. në versetin:

و السماء بنيناها بأيد و انا لموسعون

"Ne, me forcën tonë e ngritem qiellin dhe ne e zgjerojmë ate" *Edh-Dharijaat: 47*) nuk përdori komentimin bukfal të fjalës:

بأيد (Duar) por **بقوة** (Fuqi) siç është edhe në tefsirin e Taberiut. [28]

2. Poashtu Imami Ibën Hanbeli përdori "T'e'ëviilin - Shtjellimin.

Transmeton Bejhekiu në librin e tij: *"Menakib el Imam Ahmed"*, gjithashtu Hafidh Ibën Kethir në librin e tij *"El-bidajetu ve en-nihajetu"* thotë: Transmeton Bejhekiu nga Hakemi, nga Ebi Amri i biri Semakut nga Hanbeli se vërtetë Ahmed Ibn Hanbeli e ka shtjelluar fjalën e Allahut xh.sh. **و جاء ربك *"Dhe kur të vjen Zoti yt..."*** në kuptimin **جاء ثوابه** që do të thotë: ***"dhe kur të vie mirësia e Tij - sevabi i tij."***[29]

Rreth këtij transmetimi Bejhekiu tha se është i saktë dhe nuk ka dyshim në të.

3. Edhe te Imam Buhariu gjejmë se ka përdorur "Te'ëvilin – shtjellimin.

Bejhekiu në librin e tij *"El-Esmau ve-s-sifaat"* transmeton nga Buhariu për kuptimin e fjalës së Muhammedit a.s. *"ed-dahk"* që ka për

[27] Te'vilat Ehli El-Suneh, Ebi Mensur Muhamed bin Muhamed bin Mahmud El-Maturidi El-Samarkani El-Hanefi, redaktuar nga Fatimeh Jusuf El-Hajmi, botim I, 2004, Bejrut-Liban, Vëllimi i V, fq. 218.

[28] Xhamiu El-Bejan fi Tefsir El-Kur'an Taberiu, Vëllimi 21 fq. 545-546, Kajro 2001.

[29] El Bidajeh ve El Nihajeh-Hafidh ibn Kethir, Vëllimi 5 pjesa e 10-të Botim i I-rë 1988 Kajro faqe 342.

qëllim të qeshurit e Zotit xh. sh tha: *"Të qeshurit do të thotë mëshira e Zotit"* معنى لضحك = الرحمة[30]

Te`viilin-shtjellimin e përdorën pjesa dërmuese e dijetarëve të mëdhenj, nga ta:

1. En-Nadir bin Shumejl
2. El Imam Hisham bin Ubejdullah
3. Sulejman bin Ujejneh
4. El-Hafidh ibn Xheriir Et-Taberij
5. Ebu Mensuur el Matuuridij
6. Ebu Hasen El Esh'arij
7. Ibën Hibban
8. Imam Maliku
9. El Hafidh Et-Tirmidhijj
10. Imam Sufjan Eth-Thevrij
11. Imam Nesefiu etj. etj.

Këtu duhet të cekim edhe një çështje të rëndësishme.

Ata të cilët luftojnë t`eviilin dhe pohojnë se ai që e përdorë atë është në humbje dhe është bidat dhe ndryshim të Kuranit dhe hadithe-ve të Pejgamberit a.s. ata të njëjtën kohë përdorin T`ëvilin në disa versete kur`anore dhe hadithe të Pejgamberit a.s.

Për shembull ata përdorin T`eviilin ne citate:

و هو معكم *"Ai është me ju"* *(El-Hadiid: 4)*

و نحن اقرب اليه من حبل الوريد *"Ne jemi më afër tij se damari* *(që i rrah)* ***i qafës së tij."*** *(Kaaf: 16)*

اننى معكما أسمع و أرى *"Unë jam me ju, Dëgjojë dhe Shoh"* *(Taha: 46)*

ما يكون من نجوى ثلاثة الا هو رابعهم *"Nuk bëhet bisedë e fshehtë mes tre vetave e të mos jetë Ai i katërti... "* *(El-Muxhadele: 7)*

Si dhe versete tjera nga Kur`ani.

[30] Kitab El-Esma ve El-Sifat-Imam El-Hafidh ebi Beker Ahmed bin El-Husejn bin Ali El-Bejheki, Shtëpia botuese Ihja El-Turath el-Arabi Bejrut-Liban pa vit botimi fq. 470.

"Ne nuk do të merremi me qëndrimet e disave që veten e quajnë selefi e janë njohur vehabinj, të cilët, dashtë e pa dashtë, e krahasojnë Zotin me robërit e Tij. Ata kanë nevojë të mësojnë nga dijetarët e jo ta mbajnë veten si mësues me predikime të tilla. Për fat të keq, disa nga të rinjtë tanë, të cilët nuk kanë mësues të vërtetë, po merren me mësime të tilla...[31]

*Përse diku e përdorin Te'ëvilin e diku jo?!! A nuk është i gjithë Kur`ani nga Allahu ?!!!

Krijuesi i gjithësisë nuk cilësohet me vendosje në vend, për arsye se vendi është i krijuar. Vend është çdo send që gjendet në kahe, kohë dhe që përbehet nga shenjat e risisë.

Rrugët e risisë (ndodhisë)

Për argumentin e risisë - ndodhisë flasin librat (shkrimet) që kanë të bëjnë me shkencën e apologjetikës, të cilat flasin në një program dhe fotografi logjike te dijetarët që merren me këtë shkencë.

Program dhe argument

Bota është e krijuar. Çdo krijesë pa tjetër duhet ta ketë krijuesin e saj, atëherë bota ka krijuesin e saj dhe ai krijues pa tjetër të jetë i vjetër pa fillim dhe mbarim ose i krijuar(i ri). Është e pamundshme që Krijuesi i gjithësisë të jetë i ri, për arsye se nëse është i ri, krijesa do të kishte nevojë për krijues dhe krijuesi për krijesë, e kështu arrihet deri te rrethi dhe zinxhiri dhe secila prej tyre është e pabazë. Atëherë bie poshtë mendimi i cili thërret se krijuesi i gjithësisë është i rikrijuar. Pra, këtu konstatojmë se krijuesi dhe rregulluesi i gjithësisë është Allahu i pa fillim dhe pa mbarim dhe që nuk ka nevojë për krijesat e Tij.

Shprehje të cilat kanë nevojë për definicion për kuptimin e argumentit janë:

[31] Nyja e Besimit sipas Tahaviut-Vehbi S. Gavoçi, shtëpia botuese Dituria Islame, Prishtinë, 1995, fq 57

1. BOTA
2. ATOMI
3. AKSIDENTI – (Shfaqja)
4. TRUPI
5. RISIA
6. VJETËRSIA
7. RRETHI
8. ZINXHIRI

1. Bota dhe definicioni i saj

Imam Ebu Hamid El-Gazali në librin e tij الأقتصاد فى الا عتقاد thotë: "Nga bota kuptojmë: Çdo send që ekziston përveç Allahut xh.sh. nga kjo konkludojmë: Trupat në përgjithësi dhe shfaqjet e tyre, përveç Allahut të lartësuar".[32]

Taftazani në shpjegimin e **العقاءد النسفية** "El-Akaid El-Nesefije"[33] thotë:Bota është çdo send përveç Allahut, prej atyre që ekzistojnë për të cilat di Krijuesi. Thuhet, bota trupore, bota bimore, bota shtazore etj.[34]

Nga këto dy definicione ne mund të definojmë:

Çdo send që ekziston përveç Allahut quhet gjithësi, apo çdo send që gjendet në kohë, vend, kahe, lëvizje, të cilës i parapriu mosekzistenca, e që ka krijuesin e saj, i Cili e shpiku pa model të mëparshëm është botë (gjithësi). Ai (Zoti) është i zhveshur nga përzierja me të.

2. Atomi

Atomi është grimca më e imët e çdo elementi kimik, i cili përbëhet prej bërthamës dhe elektroneve.

Atomi është substanca e çdo trupi që ekziston.

[32] El-Iktisad fil Iëtikad-Imam El-Gazali, botim i I-rë , Bejrut-Liban 1988, fq. 19

[33] Mejmun bin Muhamed bin Muhamed bin Mekhul Ebu Muajen En-Nesefi, (438-508h) është ndër personalitetet më të njohura në shkollën Maturidite pas themeluesit të saj. Imam Nesefiu është autor i dy libtave të mëdhënjë dhe të njohur në drejtimin Maturidi: El-Tmhid li kavaid El-Tevhid dhe Tebsiretu El-Edileh.

[34] Sherh El-Akaid El-Nesefijeh-Sead El-Din Mesud bin Umer El-Taftazani, redaktuar nga Muhamed Adnan Dervish, pa vend dhe vit botimi, fq. 74-75

Atomi është i ndryshueshëm në vetvete apo çka qëndron në veten e tij.

Çdo send që ekziston pa tjetër duhet të jetë i ndryshueshëm ose i pandryshueshëm, e çdo i ndryshueshëm nëse nuk shpartallohet dhe nuk bashkëngjitet me asnjë send e quajmë atom njëjës, i cili nuk pranon ndarje. Në qoftë se bashkëngjitet me tjetër dhe pranon ndarjen atëherë e quajmë trup.

3. Aksidenca

Aksidenti është ai i cili qëndron me ndihmën e tjetërkujt-është i varur nga dikush tjetër, apo ai që nuk ndryshon në veten e tij.

Pra, kusht i ekzistimit të aksidenteve është atomi-ekzistimi i trupave.

Aksidenti është ai që i bashkëngjitet në ndryshueshmëri atomit, i cili qëndron me të, sikur që është: lëvizja, heshtja, të qeshurit, të qarët, e bardha, e zeza etj, këto aksidente nuk pësojnë ndryshime në veten e tyre, por bashkëngjiten në ndryshime me ndryshimin e trupit, i cili qëndron me të.

Aksidentet janë të varura nga substanca e trupave dhe trupat nuk mund të ekzistojnë pa aksidente.

4. Trupi

Me termin trup kuptojmë: çdo send që është i krijuar në kohë, vend dhe që ekziston në një nga gjashtë kahet të cilat janë: para, mbas, djathtas, majtas, lart dhe poshtë.

Trup është çdo send që ekziston në kohë, vend, kahe, që ka fillim e mbarim dhe pranon ndarjen, e quajmë trup.

5. Vjetërsia

Vjetërsia ka dy kuptime: i vjetër pa fillim, dhe i vjetër me fillim.

I vjetër pa fillim - është Ai të cilit nuk i parapriu mosekzistenca, apo Ai të cilit nuk i parapriu ekzistues, dhe quhet gjithashtu i amshueshëm.

I vjetër me fillim - është ai të cilit i parapriu mosekzistenca, apo ai të cilit i parapriu ekzistues.

I vjetër quhet edhe ai që ekziston në kohë më parë se tjetri p. sh. i ati është më i vjetër se i biri, e ky shembull i takon risisë.

Dallimi mes të vjetrit pa fillim dhe të vjetrit në kohë është - i vjetër pa fillim është ai që nuk i parapriu ekzistencës së tij asnjë send, për te nuk ekziston mosekzistencë, kurse i vjetër në kohë, do të thotë, se i paraprin mosekzistenca - pas mosekzistencës është gjendur në ekzistencë.

6. Risia

Me termin risi kuptojmë-ekzistencën të cilës i parapriu mosekzistenca, apo çka është gjendur ne ekzistencë, pasi që ka qenë në mosekzistencë.

Pra çdo ekzistencë pas mosekzistencës e quajmë risi.

7. Rrethi

Me termin rreth kuptojmë: ekzistimi i dy sendeve që secili prej tyre është shkak për tjetrin, apo ndalimin e një sendi tek i cili ndalet ai drejtpërsëdrejti apo me ndërmjetësim p.sh., ekzistimi i shkronjës (A) ndalet në ekzistimin e (B) dhe e kundërta, e ky ndalim është drejtpërsëdrejti. Ndalimi i (A) në (B) dhe ndalja (B) në (C) pastaj ndalja (C) në (A) ky është rrethi me ndërmjetësim.

8. Zinxhiri

Me termin zinxhir kuptojmë: radhitjen e çështjeve pa përfundim, p.sh., ekzistimi i një sendi është ekzistim i shkakut dhe ky shkak për ekzistimin e tjetrit, e kështu me radhe pa përfundim.

Secili nga rrethi dhe zinxhiri janë të pabaza. [35]

[35] El-Akidetu El-Islamijeh, prof. dr. Sallah Abdul Alim Ibrahim, botim i II Kairo 1991, fq. 26-31.

*Qëllimi ynë për definimin e këtyre definicioneve është që ta zhveshim Allahun nga çdo personifikim.

Allahu është zhveshur nga përzierja me botën, është i zhveshur nga atomi dhe aksidenca nga trupi dhe vjetërsia kohore. Ai është i vjetër pa fillim, i zhveshur nga risia, nga rrethi e zinxhiri.

Secili nga këto definime është shenjë e risisë, sepse ndodhia është prezente në botë, atome, aksidente, trupa, po ashtu vjetërsia kohore është ndodhi bashkë me risinë, rrethin dhe zinxhirin.

Një ashtu shkaku dhe lëvizja janë nga ndodhitë-risitë. Të gjithë trupat që ekzistojnë kanë shkaqet e tyre, pra çdo send që ekziston ka shkak dhe është i varur nga ai. Po ashtu edhe lëvizja është shenjë e risisë p. sh. era lëviz trupat, atëherë era është shkaktare për lëvizje dhe çdo lëvizje pa tjetër të jetë në kohë, vend dhe kahe, pra lëvizja, koha, vendi dhe kahja janë shenja të ndodhisë. Me lëvizje trupat kalojnë prej një vendi në një vend tjetër, e ndërrimi i vendit paraqet risinë.

Atëherë përfundojmë se Allahu është i zhveshur edhe nga shkaqet, lëvizjet, nga koha, vendi dhe kahet e caktuara.

Të gjithë trupave iu parapriu shkaku, kurse Allahu ekziston pa shkak. Ai është i pari pa fillim dhe i fundit pa mbarim. **هُوَ الأَوَّلُ وَالآخِرُ** ***"Ai është i pari që s'ka fillim dhe i fundit që s'ka mbarim... ".*** *El-Hadid: 3.*

Nga këtu mund të përfundojmë se Allahu është Qenie e domosdoshme. Ndërsa e gjithë ekzistenca me të gjithë trupat dhe sendet që ekzistojnë në të janë të mundshme dhe iu paraprin shkaku i mundshmërisë së tyre. Të gjitha ato sende që nuk ekzistojnë janë të pa mundshme, e mundshmëria e ekzistencës se tyre varet nga Qenia e domosdoshme.

Nëse Allahu nuk ka qenë i vendosur në vend para krijimit të vendit dhe nuk kishte nevoje për Arsh, atëherë nëse është vendosur në vend pas krijimit të vendit do të ndërrohej prej asaj që ishte deri atëherë, dhe do të lindte nevoja, ndërrimi dhe pranimi, e kalimi prej një vendi në tjetrin është nga shenjat e risisë. Kjo është e pamundshme për Krijuesin e vendit, Ai (Allahu) është krijues i vendit e jo i nevojshëm për të.

Ata që janë kundër këtij mendimi (kundërshtarët e mendimit të drejtë), e thonë se Ai (i lartësuar qoftë nga thëniet e tyre) qëndron në vend (i vendosur në Arsh) argumentojnë duke u mbajtur në sipërfaqësinë e disa vërseteve kuranore që flasin mbi Arshin e të tjera, si p.sh. Allahu xh.sh. në Kuran thotë:

الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَى

"*(E Ai është)* ***Mëshiruesi që qëndron mbi Arshin*** *(e mban sundimin mbi gjithçka që ekziston)****".*** *Taha: 5.*

Pastaj verseti:

أَأَمِنتُم مَّن فِي السَّمَاء

"A u garantuat ju prej Atij që është në qiell... *(Mbizotërues i qiellit)****"*** *El-Mulk: 16.*

Çka do të bëjnë me ajetin kuranor ku i Madhërishmi thotë:

وَهُوَ الَّذِي فِي السَّمَاء إِلَهٌ وَفِي الأَرْضِ إِلَهٌ

"Ai është që në qiell është Allah dhe në tokë Allah..." *El-Zuhruf: 84.*

Për këtë do ta sjellim Tefsirin e Kurtubiut, i cili e sqaron duke thënë: Allahu është i adhuruar prej banorëve të qiellit dhe banorëve të tokës. Ai meriton adhurimin në qiell dhe në tokë. Omeri r.a. dhe të tjerë thanë: Kuptimi i këtij ajeti është: Allahu është i adhuruar në qiell dhe në tokë.[36]

I ngjashëm me këtë mendim është edhe Imam Bejhekiu, ku ajetin në fjalë e komenton: Ai është i Cili adhurohet në qiell dhe në tokë, dhe them: në kuptimin e këtij ajeti na vjen ajeti tjetër, ku Allahu xh.sh. thotë:

وَهُوَ اللّهُ فِي السَّمَاوَاتِ وَفِي الأَرْضِ يَعْلَمُ سِرَّكُمْ وَجَهرَكُمْ وَيَعْلَمُ مَا تَكْسِبُونَ

[36] El-Xhamiu liahkam El-Kur'an, El-Imam Ebu Abdullah Muhamed bin Ahmed El-ensari El-Kurtubi, Vëllimi 15-16, pjesa 11-të, Bejrut-Liban 1993, fq. 80-81.

***"Ai është All-llahu** (që adhurohet e madhërohet prej çka ka) **në qiej e në tokë; Ai i di fshehtësitë dhe publikimet tuaja dhe Ai e di atë që bëni".** El-Enam: 3.*[37]

Për ajetin në fjalë وَهُوَ الَّذِي فِي السَّمَاءِ إِلَهٌ وَفِي الْأَرْضِ إِلَهٌ edhe Imam Maturidiu jep shpjegimin e tij, sikur do të thotë; Iky ajet iu drejtohet pabesimtarëve e Allahu e di më së miri: Ju vërtet e dini që Allahu adhurohet në qiell dhe në tokë, kurse putat tuaj që ju i adhuroni nuk i adhuron kush pos juve, atëherë si e keni lënë adhurimin e të Adhuruarit, i cili adhurohet në qiell dhe në tokë, e keni zgjedhur adhurimin e atij i cili nuk adhurohet vetëm me adhurimin tuaj? Mund të jetë edhe kuptimi tjetër: Ju e dini se vërtet Allahu xh.sh. është Zot në qiell dhe Zot në tokë, Zot mes tyre dhe Zot çka ka në to dhe Ai është Krijues i çdo sendi, duke u bazuar në thënien e Tij:

وَلَئِن سَأَلْتَهُم مَّنْ خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ لَيَقُولُنَّ اللَّهُ

***"Nëse ti i pyet ata: Kush krijoi qiejt e tokën? Me siguri do të thonë: 'All-llahu'!".** Llukman: 25*

Kurse putat që ju i adhuroni ata nuk e kanë krijuar këtë dhe nuk posedojnë asgjë nga kjo, atëherë si i keni marrë për zota pos Allahut?[38]

Për ajetin në fjalë Imam Nesefiu citon: Dëshiron ta përforcojë Zotësinë-mbretërinë e Tij në qiell e jo qenien e Tij, siç thuhet: filani është princ në Buhara dhe Samerkand, qëllimi është që pushteti i tij sundon atje jo qenia e tij. [39]

Kurse për ajetin: أَأَمِنتُم مَّن فِي السَّمَاءِ ***"A u garantuat ju prej Atij që është në qiell…"** El-Mulk: 16,* Përgjigjja e Maturidiut është:Vërtet qi-

[37] Kitab El-Esma ve El-Sifat-Imam El-Hafidh ebi Beker Ahmed bin El-Husejn bin Ali El-Bejheki, Shtëpia botuese Ihja El-Turath el-Arabi Bejrut-Liban pa vit botimi fq. 431.

[38] Te'vilat Ehli El-Suneh, Ebi Mensur Muhamed bin Muhamed bin Mahmud El-Maturidi El-Samarkani El-Hanefi, redaktuar nga Fatimeh Jusuf El-Hajmi, botim i I, 2004, Bejrut-Liban, Vëllimi V, fq. 449-450.

[39] Tebsiretul edileh fi usul el din, Sipas drejtimit të Imam Ebi Mensur El-Maturidiut, Autor - Ebi Muajen Mejmun bin Muhamed El Nesefi, Redaktuar nga Kulud Selameh, Vëllimi i I, Damask 1990, fq. 185

elli është nën sundimin e Allahut-krijesë e Allahut, Pronë e Tij e jo vend i Tij.[40]

Kurse për ajetin: وَجَاء رَبُّكَ وَالْمَلَكُ صَفًّا صَفًّا ***"Dhe kur të vijë Zoti yt dhe engjëjt qëndrojnë radhë-radhë".** El-Fexhr 22*

Allahu i madhërishëm nuk cilësohet me lëvizje dhe qëndrim, për arsye se lëvizja dhe qëndrimi janë të një qëllimi, nëse lejohet lëvizja, lejohet qëndrimi dhe që të dyja janë paraqitje e risisë dhe cilësi e krijesave, Allahu xh.sh. është i lartësuar nga këto...

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ

***"Asnjë send nuk është si Ai..."** Esh-Shura: 11*

Pastaj si do ta kuptojmë vërsetin Kuranor, i cili në sipërfaqësinë e tij thotë: Ti pyete fshatin-qytetin ku ishim ne po ashtu edhe karvanin me të cilin kemi udhëtuar.

A pyetet fshati!?A do të ishte më e drejt të thuhet: Pyeti banorët e fshatit-qytetit!

وَاسْأَلِ الْقَرْيَةَ الَّتِي كُنَّا فِيهَا وَالْعِيرَ الَّتِي أَقْبَلْنَا فِيهَا

***"Ti dërgo e pyeti** (banorët në) **gytetin ku ishim ne, po ashtu edhe** (ata me) **karvanin me të cilin kemi ardhur. "** Jusuf: 82*

Kjo formë e alegorisë është për respekt: Pyetni banorët e qytetit, të këtij lloji kemi edhe ajete të tjera si p. sh: ناقَةُ اللّه ***"kjo është deveja e All-llahut"** Hud: 64,*

وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّه ***"Vërtet xhamitë janë të Allahut"** El-Xhinn 18,* të gjithë këto ajete dhe të tjera vijnë në kuptimin e respektit dhe titullit.

Argumentimi dhe qëndrimi në sipërfaqësinë e këtyre vërseteve është pa vlerë dhe këto vërsete nuk kanë për qellim sipërfaqësinë. Në këto vërsete të cekura më lart qartë vërehet vendi dhe trupi nëse merren tekstualisht. Ne kemi thënë një herë e përgjithmonë që Zoti nuk ka nevojë për vend dhe nuk është trup.

[40] Imam Ehli Suneh vel xhemaah Ebu Mensur El-Maturidi ve arauhu el-Kelamijeh, Dr. Ali Abdul Fetah el-Magribi, Botim i I, 1985 Kajro, fq. 234

Ebu Muajen El-Nesefi i hedh poshtë të gjithë ata që mbahen në sipërfaqësinë e këtyre vërseteve dhe lidhur me këtë thotë: Është e domosdoshme të shtjellohen në mënyrë precize duke mbështetur mbretërinë e Allahut mbi çdo send, e kjo nuk kontradikton argumentet e Allahut dhe mendjen e njeriut e as vërsetin kuranor:

لَيْسَ كَمِثْلِه شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ البَصِيرُ ***"Asnjë send nuk është si Ai, Ai është dëgjuesi, shikuesi".*** *Esh-Shura: 11.*[41]

Allahu i madhëruar është ashtu sikur që ishte para krijimit të gjithësisë, e pas krijimit është ashtu si para krijimit dhe mbetet ashtu edhe pas shkatërrimit. Ai nuk ndryshon asnjëherë.

Arshi është nga krijesat më madhështore të Allahut, ne nuk kemi njohuri për formën e tij, në anën tjetër nuk mendojmë sikur që mendojnë disa mendjelehtë duke parafytyruar dhe imagjinuar se Allahu (i lartësuar qoftë nga thëniet e tyre) qëndron mbi të i vendosur. Ata me parafytyrimet e tyre të verbra dhe me dituri të cekët duke parafytyruar se po e cilësojnë Zotin meqë cilësoi Veten i dhanë vend, duke e ditur se Ai është krijues i vendit. Sipas imagjinimit të tyre ata nuk e dinë se i kanë dhënë vend dhe si duket ata nuk janë duke e ditur se Ai (lartësuar qofte nga parafytyrimet e tyre) është krijues i vendit, dhe nuk ka nevojë për të.

Allahu xh.sh. ekzistoi para se ta krijonte vendin, ne mund të themi se Allahu është i lartësuar përmbi çdo gjë dhe mbetja e Tij sikur që ka qenë, dhe Ai është tash sikur që ishte para krijimit të gjithësisë. I lartësuar qofte Ai që nuk ndërron me ndërrimin e krijesave, sepse ndërrimi është shenjë e risisë, sikur që kemi sinjalizuar më herët. Atij nuk i përngjan as një send dhe mbetet sikur që ishte para krijimit të vendit dhe kohës.

Allahu i madhëruar është mbizotërues i Arshit, po edhe çka ka mbi të dhe nën të.

Nëse themi Zot i çdo sendi, atëherë kemi lartësuar Allahun. Kur themi zot i Muhamedit apo i Ibrahimit kemi pasur për qëllim lavdrim-

[41] Kitab El-Temhid likavaid El-Tevhid, Imam Ebi Muajen El-Nesefi, shqyrtuar dhe redaktuar nga Xhibullah Hasen Ahmed, përgatitur nga dr. Muhamed Rebia Muhamed Xhevheri, botim i I, 1986 Kajro, fq. 161

in dhe nderimin e tyre. Me këtë mund ta krahasojmë Arshin për vlerën e tij madhështore. Allahu e veçoi Arshin, sepse është krijesë madhështore, sikurse çdo planet tjetër ashtu edhe Arshi është nën komandën dhe kompetencën e Allahut.

Imam Bejhekiu shënon nga Ibn Abasi r.a. për vërsetin

ثم استوى الى السماء ***"... pastaj vullnetin e vet ia drejtoi qiellit"*** *El-Bekare 29,* që do të thotë: *"Është ngritur urdhri i Tij në qiell".*[42]

Ebu Hanife thotë: Kush thotë "Nuk e di ku është Allahu, në qiell apo në tokë" është jobesimtar) për arsye se vetë thënia paragjykon vendin dhe personi i tillë është jobesimtar. Allahu xh. sh thotë:

الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَى ***"****(E Ai është)* ***Mëshiruesi që qëndron mbi Arshin*** *(e mban sundimin mbi gjithçka që ekziston)". Taha: 5,* nëse thotë e besoj këtë ajet, mirëpo nuk e di ku është Arshi, në qiell apo në tokë, edhe në këtë rast bie në kufër. Edhe kjo kthehet në kuptimin e parë, për arsye se nëse thotë: nuk e di ku është Arshi në qiell a në tokë, është, sikur të këtë thënë: nuk e di ku është Allahu në qiell apo në tokë.

Ebu lejthi fekih i njohur, Allahu e mëshiroftë, thotë: Në këtë çështje janë konfrontuar drejtime të ndryshme si Keramitët[43] Mushebihët[44]. Se vërtet Allahu qëndron mbi Arsh, i ngritur në vend të caktuar dhe Arshi është vendcaktimi i Tij, dhe e cilësojnë Allahun me zbritje, ardhje e shkuarje dhe thonë se Ai është trup jo sikurse trupat. (Allahu qoftë i lartësuar nga thëniet e tyre), duke argumentuar me thënien e Allahut: الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَى ***"****(E Ai është)* ***Mëshiruesi që qëndron mbi Arshin".***

[42] Kitab El-Esma ve El-Sifat-Imam El-Hafidh ebi Beker Ahmed bin El-Husejn bin Ali El-Bejheki, Shtëpia botuese Ihja El-Turath el-Arabi Bejrut-Liban pa vit botimi fq. 413.

[43] Keramitët i përkasin Muhamed bin Muhamed bin Kerram i cili ka vdekur në vitin 255. Nga mendimet e dështuara dhe të devijuara të tij është edhe mendimi që Allahu është trup i kufizuar i cili qëndron mbi Arsh, dhe Arshi është vendë i kufizuar i Tij. (Allahu qoftë i lartësuar nga thënjet e tyre)

[44] Mushebihët (personifikuesit) janë drejtim i devijuar fanatik që rrjedhin nga Rafidijët, i pari i cili foli për ngjashmërin e Allahut me krijesa është Hisham bin El-Hakem-El-Rrafidi. Mushebihët ndahen edhe në grupe: grup të cilët e cilësojnë qenjen e Allahut me qenjen e krijesave, dhe grupi tjetër bëjnë ngjashmëri në mes cilësive të Allahut dhe të krijesave.

Kurse ne do të reagojmë duke thënë: Arshi nuk ekzistonte, u krijua dhe nuk përjashtohet mundësia që të jet:1- Paraqitja e tij (Arshit)si krijesë madhështore e Madhërisë së Allahut xh.sh. në krahasim me krijesat e Tij. 2-Ose për nevojën që ka për t'u vendosur në të. Kjo nuk është e lejuar të thuhet për t'u vendosur në të, për arsye se: I nevojshmi nuk mund të jetë krijues, sepse është i nevojshëm dhe i nënshtruar për nevojë, në anën tjetër i nënshtruari nuk mund të jetë princ, e si mund të jetë zot! nëse kjo ide është e papranuar atëherë e pranuar do të jetë ideja (mendimi) i parë, dhe ai është: Madhëria dhe forca e pakufishme e Allahut xh.sh. ndaj krijesave, dhe jo nevoja e Tij për të.

Drejtimi i Ehli-sunetit[45] mendojnë që Allahu xh.sh. është mbi Arsh i lartësuar me Madhështin, sundimin dhe pronësinë e Tij, jo me ngritje lartësie të vendit, distancë dhe interval kohe.

Ebu Hanife Allahu qoftë i kënaqur me të thotë: (Allahun e mendojmë me lartësi e jo me ultësi) Për shkakun se ultësia nuk përkon me Krijuesin dhe sunduesin e çdo gjëje. Transmetohet në një hadith i njohur si hadith الجارية (El-Xharijeh)-Robëresha, (Një njeri erdhi te Pejgamberi a.s. me një robëreshë zezake dhe i tha: Jam i obliguar që ta lirojë këtë robëreshë, atëherë Pejgamberi a.s. e pyeti robëreshën: A je besimtare? Ajo tha: Po, Pejgamberi a.s. tha: Ku është Allahu? Robëresha sinjalizoi me gisht nga qielli, Pejgamberi a.s. tha: Liroje se vërtet kjo është besimtare.)[46]

Imam Ibn Tejmijeh për hadithin e shënuar "Ku është Zoti"thotë: Këtu është argumenti që lejohet pyetja Ku është Zoti?

[45] Ehlis-Suneh janë drejtim i shpëtuar dhe i drejt deri në Ditën e Gjykimit, ata janë të parët tanë të cilët ndoqën rrugën e Pejgamberit a.s., shokëve të Tij dhe brez pas brezi në mënyrë të besueshme deri te ne. Me këtë emër kan filluar të quhen që nga shekulli i II-të hixhri, atëherë kur me të madhe debatohej për çështje të ndryshme debate të pafunda dhe atëherë kur lindën drejtime nga më të ndryshmet, mu në atë kohë u emërtuan me këtë emër që më lehët ta dallonin masa e gjërë drejtimin e shpëtuar. Historiani Zubejdi thotë: "Kur të përmendet Ehli-Sunneti, do të thotë Esh'ariu dhe Maturidiu.
Për ne është e rëndësishme që myslimanët shqiptarë në trevat tona në formë masive i përkasim drejtimit Ehli-Suneh.

[46] El-Resail El-Sebah fi El-Akaid-Kitab Sherh El-Fikh El-Ekber, me tekst të Imam Ebu Hanifes dhe me shpjegim-sqarim të Imam Ebu Mensur El-Maturidiut, botim i III-të 1980 Indi, 17-20.

Ajo që shihet nga hadithi: Në të ekziston argumenti për ngritjen e Zotit përmbi krijesat e Tij, përmbi qiejt e Tij, dhe hadithi shënon anën e lartë. [47]

"Allahu nuk është i përcaktuar në vend, nuk përcaktohet me kohë, Atij nuk i ngjan askush". Për arsye se i vendosuri në vend na vjen në kuptimin e largësisë në largësi tjetër, në formë të imagjinuar apo reale. Kurse Allahu është i zhveshur nga çdo lloj parafytyrimi.

Çdo send që ekziston në hapësirë llogaritet me kohë dhe në kohë, kurse Allahu është i zhveshur edhe nga koha, sepse është Krijues i kohës, koha vjen në kuptimin e informatave të reja dhe përcaktim i lëvizjeve. Koha dhe lëvizja janë elemente të risisë. Kundërshtarët e mendimit të drejtë argumentojnë me sipërfaqësinë e vërseteve, në kahe, trup, fizionomi dhe gjymtyrë, kurse Allahu nuk është moment e as objekt i botës. Ata argumentojnë me vërsete nga Kur'ani dhe Hadithe të Pejgamberit a.s., e cilësojnë Allahun me anë duke u bazuar në vërsetin kur'anor: **الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَى** ***"(E Ai është) Mëshiruesi që qëndron mbi Arshin".*** *Ta-Ha: 5.*

Me fizionomi duke u bazuar në Hadithin e Pejgamberit a.s. të cilin e transmeton Imam Buhariu në koleksionin e haditheve të vërteta me numrin: 6227, po ashtu edhe Imam Muslimi me numër: 841; (Allahu e ka krijuar Ademin në formën e tij...) (dijetarët të cilët e përdorën te'vilin e kuptuan esencën e hadithit, e shpjeguan në këtë formë: Përemri tij i kthehet Ademit e jo Allahut xh.sh. që do të thotë se Allahu e krijoi Ademin në formën të cilën e kanë edhe sot pasardhësit e tij, pa u evoluar dhe pa pësuar ndryshime nga një formë në tjetrën, kurse ata që nuk e pranojnë te'vilin nuk e di se si do ta shpjegojnë!) etj nga hadithet, kurse gjymtyrët, bazuar në fjalën e Allahut xh.sh.
بل يداه مبسوطتان "... *Jo, duart e Tij janë të shlira... "* *El-Maideh: 64,* dhe hadithin të cilin e nxjerr Imam Muslimi me numër: 2654, nga Nga Abdullah bin Amri. "Zemra e besimtarit është mes gishtërinjve nga gishtat e Rrahmanit" etj. nga vërsetet dhe hadithet të cilat në sipër-

[47] Sherh El-Akideh El-Vasitijeh-Imam Ahmed bin Tejmijjeh, autor: dr. Salih bin Fevzan bin Abdullah El-Fevzan 1993 Rijad-fq. 115-116.

faqësinë e tyre thjesht shihet forma dhe trupi nëse nuk shtjellohen. Në këtë rast përgjigjja më e mirë dhe komplete për të gjithë do të ishte:

Argumentet kur'anore jo të qarta nuk kontradiktohen me ajetet e qarta, mirëpo jo të qartat është e obliguar të barten tek argumentet e qarta të cilat janë esenca e Kur'anit. [48]

Edhe njëherë do t'i marrim disa nga vërsetet kur'anore, të cila në shikimin e jashtëm na japin kontradikta të qarta:

الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَى

"Mëshiruesi që qëndron mbi Arshin" *Ta'Ha: 5*

و نحن اقرب اليه من حبل الوريد

*"**Ne jemi më afër tij se damari** (që i rrah) **i qafës së tij.**" Kaaf: 16,* etj.

أَأَمِنتُم مَّن فِي السَّمَاء

"A u garantuat ju prej Atij që është në qiell…" *El-Mulk: 16*

وَهُوَ الَّذِي فِي السَّمَاء إِلَهٌ وَفِي الأَرْضِ إِلَهٌ

"Ai është që në qiell është Allah dhe në tokë Allah..." *El-Zuhruf: 84.*

Atëherë, nëse këto ajete i marrim ashtu siç janë, me shpjegim sipërfaqësor me siguri do ta ngarkojmë Kuranin me kontradikta të hapura. Si do të ishte e mundur që të mos japim kurrfarë shpjegimi që Allahu fuqiplotë qëndron mbi Arshin e Tij dhe në të njëjtën kohë të jetë afër meje dhe ajo më afër se damari i qafës, përsëri duke mos dhënë kurrfarë interpretimi?![49]

Imam Gazaliu thekson: Allahu i Madhërishëm qëndron mbi Arshin e Tij, në kuptimin e dëshirës së Allahut me qëndrim. Dhe kjo nuk mohon cilësinë e Lartmadhërisë së Allahut dhe nuk sinjalizon diçka

[48] Sherh El-Akaid El-Nesefijeh-Sead El-Din Mesud bin Umer El-Taftazani, redaktuar nga Muhamed Adnan Dervish, pa vend dhe vit botimi, fq. 94-97.

[49] Të vërtetat e patundshme të besimit Islam, prof. dr. Muhamed Seid Ramadan El-Buti, përkthim nga Abdurrahman Asllani dhe Ibadete Imeri, Tetovë 2004, fq. 126.

nga rrugët e risisë dhe të shkatërrimit. Allahu xh.sh. me qëndrim në qiell dëshiron atë që e kuptojmë edhe nga ajeti kur'anor:

***"Mandej e mësyu qiellin** (krijimin e qiellit) **e ai ishte tym"** Fussilet 11,* e kjo nuk mund të jetë ndryshe vetëm se në kuptimin e sundimit dhe mbizotërimit. Në këtë sqarim kanë qenë të detyruar dijetarët e drejtimit të drejt, sikurse kanë qenë të detyruara drejtimet e tjera që ta bëjnë te'vilë ajetin kur'anor:

***"... dhe Ai është me ju kudo që të jeni... "** El-Hadid: 4.*

Për këtë ajet unanimisht janë të pajtimit që ta bartin në kuptimin e diturisë dhe përmbledhjes së çdo sendi. E nga ana tjetër, edhe Hadithin e Pejgamberit a.s.

قلب المؤمن بين أصبعين من أصابع الرحمان *"Allahu e ka krijuar Ademin në formën e tij..."*, në kuptimin e Fuqisë dhe Mbizotërimit, po ashtu edhe hadithin tjetër:

الحجر الاسود يمين الله في أرضه *"Guri i Zi është në të djathtë të Allahut në tokën e Tij"* (Këtë hadith e nxjerr Ebu Ubejd El-Kasim bin Selam). Në kuptimin e fisnikërisë dhe të respektit. Nëse merret sipërfaqësisht është e pamundshme, e në këtë formë edhe Isivaja, nëse merret si qëndrim dhe vendosje na paraqitet nevoja, atëherë vendqëndrimi ose duhet të jetë i njëjtë, më i madh ose më i vogël, e kjo është e pa pranuar, dhe na dërgon te pamundësia që është e pamundshme. [50]

Kushdo që e cilëson Allahun xh.sh. me ultësi dhe nën sende ai është kafir unanimisht nga dijetarët islam.

Pejgamberi a.s. thotë:

أمرتُ أن أقاتلَ النَّاسَ حتّى يشهَدُوا أن لا إلهَ إلا الله وأنّي رسولُ الله

(Jam i urdhëruar që t'i ndjek (luftoj) njerëzit derisa të thonë LA ILAHE IL-LALL-LLAH), dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij): e nuk ka thënë derisa të thonë se Allahu e ka vendin në qiell. Sepse përcaktimet e tilla iu përkasin jehudive, krishterëve etj.

[50] Kavaid El-Akaid , Imam El-Gazali. recensuar dhe komentuar nga Musa Muhamed Ali, Botim i II-të Bejrut , fq. 165-168.

Transmetimet mundë të jenë terminologjike dhe etimologjike, në mënyrën që e kupton transmetuesi.

Është transmetuar se robëresha është përgjigjur me shenjë për arsye se ajo ka qenë memece, dhe për këtë shkak ajo është përgjigjur me shenjë në drejtim të qiellit.

Nga ana tjetër, është vërtetuar në një hadith atë që e dëshiroi Pejgamberi a.s. nga njohja e imanit të saj me fjalën: ”Kush është Zoti yt”, dhe kjo është pyetja që e përcakton Njëshmërinë.

Imam Ahmedi, Ebu Davudi dhe Nisaiu nxjerrin hadithin nga Ebi Selmeh, nga Shurejd bin Suvejd El-Thekafij r.a. Që e kishte porositur nëna e tij që ta lirojë për të një robëreshë besimtare dhe e pyet Pejgamberin a.s. për këtë (njeriu) thotë: e kam një robëreshë zezake a ta liroj? Sille këtu, e thirra dhe erdhi, Pejgamberi a.s. e pyeti: Kush është Zoti yt? Përgjigjja e saj ishte: Allahu, pastaj e pyeti: Kush jam unë, u përgjigj: Pejgamberi i Allahut. Tha: Liroje, kjo është besimtare. Kështu e transmeton Bezari. Kjo është pyetja dhe përgjigjja që e përcakton Njëshmërinë dhe besimin.

Siç e vërejtëm nga ky hadith transmetuesi e ka transmetuar atë që e ka kuptuar nga shenja e saj, për shkakun se hadithi mund të transmetohet edhe me kuptim.

Në këtë rast qëllimi i Pejgamberit a.s. nuk ishte tjetër veç ta kuptojë nga robëresha se çfarë beson ajo, a beson putat të cilët ishin të njohur në kohën e Pejgamberit a.s. apo ishte besimtare e cila beson Allahun, andaj Pejgamberi a.s. e kuptoi që ajo është besimtare dhe urdhëroi lirimin e saj. Dhe mund të jetë që Pejgamberi a.s. e dinte që ajo është memece dhe e pranoi përgjigjen me shenjë.

*Qëndrim i përbashkët mes të parëve dhe pasuesve është që hadithi është transmetuar në formën: ”Ku është Zoti” në këtë rast nuk është qëllimi përcaktimi i vendit të Zotit e as Pejgamberi a.s. nuk pyet për vendin e njëanshëm të Zotit.[51]

[51] El-Akideh ve El-Fikru El-Islami-Dr. Muhamed Hisham Sultan, Botim i I-rë 1987 Ribat, fq. 84-85.

Me përgjigjen e robëreshës në drejtim të qiellit, ajo nuk argumenton dhe nuk arsyeton kahen dhe vendin e Allahut xh.sh.

Imam El-Bejadi në librin e tij Isharat el-Meram thekson: Pejgamberi a.s. dëshiroi që ta provojë a është e bindur në Krijuesin e gjithësisë, i cili është Allahu që kur ta lusë lutësi të drejtohet nga qielli. Robëresha ka qenë joarabe, kuptimi dhe të shprehurit e saj ishe i vështirë, e kjo ishte një nga arsyet që ajo shënjoi me gisht nga qielli, se i adhuruari i saj është Zot i qiellit.[52]

Ebu Hanife në librin الوصية thotë: (Vendosim që Allahu qëndron mbi Arsh pa pasur nevojë për të. Ai kujdeset për Arshin dhe çdo gjë përveç Arshit, pa pasur nevojë. Nëse është i nevojshëm për diçka si do të ishte e mundshme që ta shpikë këtë gjithësi dhe krijesat në të. Nëse është i nevojshëm për ulje dhe qëndrim, atëherë para krijimit të Arshit ku ka qenë Allahu xh.sh. Qoftë i lartësuar Allahu xh.sh. nga mendimet e tilla.) Them se kuptimi i besimit në Njëshmërinë e Allahut xh.sh. se vetëm Ai duhet adhuruar është zhveshje nga çdo rival dhe mangësi që mund t’i mvishet Atij. Është shumë e qartë dhe e argumentuar se Allahu është i zhveshur nga çdo mangësi dhe nevojë e mundshme, nga ulja, qëndrimi, nga vendi, nga koha etj. Ai është krijues i këtyre dhe gjithçka ka në ekzistencë pa pasur nevojë. Xhafer El-Sadiku r. a. pohon: Njëshmëria përbëhet nga tri elemente bazë:

1. Njohuria mbi Allahun që nuk përbëhet nga sendet.
2. Njohuria mbi Allahun që nuk është në sende, dhe
3. Njohuria mbi Allahun, i Cili nuk qëndron mbi sende.

*Kush e cilëson Allahun duke menduar se Ai është nga sendet, e ka cilësuar si të krijuar dhe bie në kufër,

*Kush mendon se Allahu është në sende, atëherë e ka cilësuar Allahun me risi (të krijuar) dhe bie në kufër.

[52] Isharat El-Meram min Ibarat El-Imam (Ebu Hanifeh), Autor:Imam Kemal El-Diin Ahmed El-Bejadi El-Hanefi. Botim i I-rë 1949 Kajro fq. 200.

*Dhe kush mendon se Allahu është i vendosur mbi sende edhe në këtë rast e ka cilësuar Allahun si të nevojshëm dhe bie në kufër.[53]

Përmendja e qëndrimit-lartësimit mundë të jetë e përkufizuar në dy pika:

1 - Bindja e fuqishme se vetëm Allahu është krijues dhe sundues i tërë ekzistencës.

2 - Përmendja e Arshit në kuptim të veçantë është për arsye të madhështisë së tij në krahasim me krijesat tjera.

Është thënë nga dijetarët: Arshi ka ardhur në kuptimin e kibles së zemrave me rastin e duave-lutjeve, sikurse Qabeja kible e trupave me rastin e namazeve. [54]

Ngritja e duarve në drejtim të qiellit me rastin e duave është adhurim i pastër sikurse drejtimi nga Kibla me rastin e namazit dhe vënia e fytyrës në tokë me rastin e sexhdes, duke e ditur që Allahu nuk është as në Qabe e as nën tokë Allahu e di më së miri.[55]

Besojmë në atë që dëshiroi Allahu xh.sh. dhe gjithashtu në të gjitha urdhrat, porositë që janë të cekura në Kur`an dhe në hadithet e Pejgamberit a.s. nga ato që i dimë dhe ato që nuk i dimë.

Akidja e besimtarit nuk mund të jetë e shumëllojshme e as të kundërshtohet me veten. Nisur nga kjo përmbajtja e akides nuk ka ndryshuar që nga dërgesa e Ademit a.s. e deri te dërgesa e vulës së Pejgamberëve, Muhamedit s.a.v.s. Ndërkaq, përmbajtja në të cilën kanë thirrur të gjithë Pejgamberët njëri pas tjetrit ka qenë: Besimi në ekzistimin e Allahut, besimi në Njëshmërinë e Tij dhe lartësimin e Tij,

[53] El-Resail El-Sebah fi El-Akaid- Kitab El-Xhevherh El-Menfijeh fi sherh Vesijeh, me tekst të Imam El-Eadham Ebi Hanifeh, Autor:Imami i njohur Mulla Husejn ibn Iskender El-Hanefi, Botim i III-të, Indi, fq. 10.

[54] Tebsiretul edileh fi usul el din, Sipas drejtimit të Imam Ebi Mensur El-Maturidiut, Autor-Ebi Muajen Mejmun bin Muhamed El Nesefi, Redaktuar nga Kulud Selameh, Vëllimi i I – Damask 1990, fq. 182.

[55] Kitab El-Temhid likavaid El-Tevhid, Imam Ebi Muajen El-Nesefi, shqyrtuar dhe redaktuar nga Xhibullah Hasen Ahmed, përgatitur nga Dr. Muhamed Rebia Muhamed Xhevheri, Botim i I-rë 1986 Kajro, fq. 164.

duke besuar se Allahu është i lirë nga vetitë e mangëta që nuk i takojnë Madhërisë së tij. [56]

Ai është i vetëm në lartësinë dhe madhërinë e Tij. Është i vetëm në vetveten e Tij dhe nuk i përngjan asnjë send në vetitë e Tij. Është i vetëm në emra dhe cilësi.

* Nga kjo e cila u cek deri më tani mund të konkludojmë këtë:

Allahu nuk është materie. Ne e dimë se materia nxë vend në hapësirë. E çdo send që zë vend në hapësirë është i krijuar dhe i paraprin mosekzistenca, pra ka fillim dhe do të ketë mbarim.

Pasi besuam se Allahu xh.sh. është i zhveshur nga materia, kahet, nga lloji dhe ngjyra, përfundojmë se Ai nuk ka vend të caktuar këtu ose atje pra Ai është sikur që ishte para krijimit të gjithësisë dhe se çdo send dhe vend është në kompetencën e Tij.

Nga gjithë kjo që u tha deri më tani nga ajetet kur'anore dhe hadithet e Pejgamberit a.s. me përmendjen e Arshit vërtetojmë se besimi në ekzistencën e Tij është obligim, ne nuk e dimë brendinë, kufizimin dhe pamjen e Tij, mirëpo e dimë që është krijesë madhështore e krijuar nga Allahu xh.sh. si kulm për krijesat e Tij e në anën tjetër adhurim për krijesat tjera me bartjen e Tij. Është obligim për çdo mysliman që ta dijë se Arshi është krijesë e vogël dhe e dobët sikur pluhuri para fuqisë së Allahut xh.sh.[57]

Allahu e di më së miri.

O Zot i qiellit dhe i tokës, Zot i Arshit të mrekullueshëm, Zoti ynë dhe i çdo sendi, Zot i farës dhe bërthamës, Ti je i pari pa fillim dhe i fundit pa mbarim, Ti krijove çdo send e pa Ty asnjë send. Të lutemi dhe kërkojmë faljen Tënde. Te Ti mbështetemi dhe te Ti pendohemi.

[56] Të vërtetat e patundshme të besimit Islam, prof. dr. Muhamed Seid Ramadan El-Buti, përkthim nga Abdurrahman Asllani dhe Ibadete Imeri, Tetovë 2004, fq. 50.

[57] Sahih Sherh El-Akideh El-Tahavijeh – Hasen Bin Ali El-Sekaf, Botim i I-rë 1995 Amman-Jordan, fq. 437.

Kasim Gërguri

ARSH
(Summary)

Praise be to Allah, the Lord of the Arsh, praise be to Allah, who governs all things, praise be to Allah, who chose Islam for us as a religion, may Allah's blessings and peace be upon his Prophet Muhammad, family and friends and most of all upon those who followed and follow him until judgment day.

The Arsh was and remains one of the most complicated issues Islamic scholars have dealt with. Many generations of Islamologues have dealt with this issue relying on the verses of the Quran. Arsh is mentioned in 7 chapters of the Quran.

قاسم غرفوری

العرش – عظمة خلقه

(خلاصة البحث)

الحمد لله الذي هو رب العرش العظيم.

الحمد لله الذي يحكم مخلوقاته.

الحمد لله لا يتدخل في شئون مخلوقاته.

الحمد لله الذي اختار الاسلام دينا للناس.

الصلاة و السلام على خاتم الانبياء محمد (صلعم) و آله و أصحابه و الذين اتبعوا هداه إلى يوم الدين.

قضية العرش كانت و سوف تبقى من القضايا الشائكة لدى علماء الاسلام. و قد تطرق إلى هذه القضية علماء المسلمين من كل الاجيال و كل واحد تناوله من وجهه نظره مستندين إلى الآيات القرآنية التي تذكر العرش في سبع سور.

SOCIOLOGJI E RELIGJIONIT

Dr. Qani Nesimi[1]

KONCEPTI I "*TJETRIT*" TEK OSMANËT DHE POZICIONI I SHQIPTARËVE NË TË

Thelbi apo esenca, e cila në vete ngërthen universalizmin dhe simbolikën e origjinalitetit, është ajo që diçka e bën të amshueshme dhe i jep vlerë. Shkencëtari i njohur Karl Poper në librin e tij *Mjerimi i historicizmit*[2] gjatë shtjellimit të rolit të esencializmit apo të *thelbit* dhe jo të nominalizmit, në përshkrimin dhe njohjen e historisë apo të së kaluarës, mes tjerash e potencon edhe atë se, *historia* është përshkrimi i ndryshimit, kurse *thelbi* është ajo çka mbetet e pandryshuar gjatë ndryshimit. Në njëfarë kuptimi, thelbi gjithashtu parakupton ndryshimin dhe që këtej historinë. Kështu që, ajo që mbetet identike apo e pandryshuar kur sendi ndryshon, është thelbi i tij (substanca), kurse ndryshimet që u nënshtrohet sendi ndriçojnë anë të ndryshme ose aspekte ose mundësi të sendit, pra edhe të thelbit të tij. Për këtë arsye thelbi mund të interpretohet si burim i potencialeve të brendshme të sendit dhe ndryshimet mund të interpretohen si realizim apo aktualizim i potencialeve të thelbit të tij. Thelbi i një njeriu, personaliteti i tij, mund të njihet vetëm kur ai e shpalos vetveten në biografinë e tij.

[1] Autori është ligjërues në USHT.

[2] Karl Popper, *Mjerimi i historicizmit*, Onufri, Tiranë, 1996, f. 46-47.

Duke e zbatuar këtë parim në sociologji, vijmë në përfundim se thelbi ose karakteri real i një grupi shoqëror mund të zbulojë vetveten dhe të njihet vetëm nëpërmjet historisë së tij. Por, në qoftë se grupet shoqërore mund të njihen vetëm nëpërmjet historisë së tyre, konceptet e përdorura për t'i përshkruar ato duhet të jenë koncepte historike. Pasi, disa koncepte sociologjike të tilla si *shteti* japonez ose *kombi* italian ose *raca* ariane, thotë Poper, zor se mund të interpretohen ndryshe veçse si koncepte të bazuara në studimin e historisë. Nisur nga ky koncept edhe "Tjetri" detyrimisht duhet që të trajtohet si thelb, e jo si formë. Mendoj se, trajtimi i tij si formë e jo si thelb do të ndikojë negativisht në të kuptuarit e tij.

"*Tjetri*" (other) është një shprehje në kuptimin e fjalës "*alienus*". Çdo gjë mund të jetë "Tjetri". Ngjyrat, traditat, ushqimet, gjinia, bindjet, veshjet, gjuha etj., mjaftojnë që njerëzit njëri-tjetrin ta vënë në pozitën e "*Tjetrit*". Ky klasifikim mund të fillojë prej pozicionit burrëgrua. Por, me një definicion kaq të gjerë, botën tonë nuk mund ta kuptojmë. Pra, shprehja "Tjetri", nuk duhet kuptuar kaq gjerë, por ajo në mënyrë direkte është e lidhur me definimin e marrëdhënieve të grupeve pakicë me ato shumicë, të atyre që administrohen dhe atyre që administrojnë. S'ka dyshim se, në fushën e shkencave sociale për t'u marrë me këtë temë *historia* është e pashmangshme. Për këtë mund të numërojmë dy arsye: e para është nevoja për njohjen epistimologjike. Neve, përvoja historike, komentimi i ngjarjeve historike, na e zgjeron diapazonin. Dhe e dyta, për të kuptuar shumë probleme me të cilat ballafaqohemi sot, ne duhet t'i drejtohemi të kaluarës, gjegjësisht historisë. [3]

Kështu, në vendet evropiane, si Gjermania, Polonia, shtetet skandinave etj., "Tjetri" si pjesë e strukturës sociale nuk ka qenë shumë i theksuar, sidomos në kohërat më të hershme, pasi në ato vende nuk ka pasur përplasje apo ballafaqim shumë të fortë mes konfesioneve apo mes kulturave. Aty në aspektin religjioz ka ekzistuar vetëm ai krishte-

[3] Ilber Ortayli, *Son Imparatorluk Osmanli - Osmanli'yi Yeniden Kesfetmek 2*, Timas, Stamboll, 2006, f. 81-82.

rë, kurse në aspektin kulturor ka qenë vetëm kultura romake. Nuk ka pasur as religjion e as kulturë tjetër për të ardhur në shprehje "Tjetri". Kurse në periudhën e mëvonshme, gjegjësisht në mesjetë, vjen në shprehje "Tjetri" me paraqitjen e elementit hebraik.[4] Hebrenjtë edhe në aspektin religjioz, edhe nacional, po edhe në atë gjuhësor përbënin elementin "Tjetri". Ata nga shoqëria vendëse e asaj kohe nuk u pranuan dhe nuk u toleruan që të jenë pjesë integruese e shoqërisë së tyre.

Ndërkaq në Gadishullin Ballkanik, ku shqiptarët janë autokton, "Tjetri", qoftë në aspektin kulturor dhe religjioz, qoftë në aspektin nacional dhe politik, ekstremisht vihet në dukje. Në vijën kulturore, nëse i qasemi vetëm kohës së erës sonë dhe nuk kalojmë në kohën e para erës sonë, Ballkani ka qenë nën ombrellën e kulturës romake, kurse me ndarjen e perandorisë në lindore dhe perëndimore, vijnë në shprehje edhe kultura bizantine. Në vijën religjioze Ballkani pagan, që në vitet e para të erës sonë ka qenë i ngjyrosur me krishterim. Letrat e Palit janë ato që na tregojnë këtë fenomen historik.[5] Më pastaj në këtë gadishull paraqiten bogomilët, maniheistët etj. Gjithashtu paraqitet besimi hebraik dhe besimi islam. Edhe pse besimi hebraik paraqitjen e vet në Ballkan e ka që në syrgjynosjen e parë dhe të dytë, por në mënyrë më të theksuar e ka në kohën kur ata deportohen nga Andaluzia. Ndërkaq besimi islam, si hallka e fundit e zinxhirit të traditës monoteiste primordiale ibrahimiane, në Ballkan paraqitet edhe më herët, por me ardhjen e osmanëve bëhet paraqitja më masive e tij në këtë vend.

Në suaza të historisë, historisë së religjioneve dhe të sociologjisë së religjioneve, marrëdhëniet e një individi ndaj një individi tjetër të një grupi ndaj një grupi tjetër, e një fetari ndaj një fetari të cilësdo fe apo fraksioni qoftë ai, në të kaluarën por edhe sot, kuptohen si ekskluziviste, inkluziviste dhe pluraliste.

Në aspekti ekskluzivist[6], të gjithë njerëzit, popujt, bindjet e tyre janë jo të vërteta, kurse "njerëzit e mi, populli im apo vetëm bindja ime

[4] Ibid, f. 82.

[5] *Veprat e Apostujve*, 16:12, 17:1 dhe *Timoteu I*, 4:10, Bibla, Lajmi i Mirë, Tiranë.

[6] Shih, Ivan Cvitkovic, Interreligijski odnosi u multireligijskom drustvu, *Znakovi Vremena*, nr. 7-8, Sarajevë, 2000 (www. Ibn-Sina.net); Mahmut Aydın, Hiçbir Din Diğerinden

është e vërtetë". Po ashtu, sipas kësaj pikëpamje të gjitha religjionet dhe konfesionet e tjera janë jo të vërteta, përveç "religjionit apo konfesionit tim", i cili është i drejtë dhe i vërtetë. Në epiqendër të kësaj bindjeje qëndron një egocentrizëm i ashpër, i cili përjashton çfarëdo lloji të mirëkuptimit apo të tolerancës për ekzistimin e "Tjetrit", qoftë në aspektin nacional, fetar apo ideologjik, kurse për dialogun bilateral nuk ka vend fare. Ky koncept i të kuptuarit dhe të trajtuarit të "Tjetrit" tek osmanët, që përbënin një shoqëri multietnike, gjatë historisë nuk ka ekzistuar, por edhe nëse diku ka ekzistuar ai nuk ka mundur të dominojë, pasi ai mund të ishte vetëm një incident, kurse incidentet nuk janë argumente për të marrë vendim dhe për të shkruar historinë. Sa i takon momentit të dytë, gjegjësisht aspektit inkluzivist, të gjithë popujt, nacionalitetet janë të vërtetë, por populli im është më i miri, më reali, më i vërteti. Gjithashtu, sipas këtij koncepti të gjitha bindjet, idetë, religjionet, konfesionet e tjera të shpallura pranohen si të tilla që kanë lidhje me dimensionin transcendental, por në rastin konkret "bindja, ideja, religjioni, konfesioni im" është më i drejtë dhe më real se të tjerat. Kurse sipas teorisë pluraliste, që është edhe aspekti i tretë i trajtimit të tjetrit, të gjithë njerëzit pa dallim, gjuhe, ideje, race, konfesioni apo religjioni, jetojnë, veprojnë, organizohen dhe e ndjekin rrugën e shfrytëzimit të së drejtës së tyre, gjuhësore, racore, konfesionale, kurse nuk përzihen në atë që i takon "Tjetrit". Mënyra e dytë dhe e tretë janë koncepte që mund të hasen edhe në kulturën e shoqërisë multietnike dhe multikonfesionale osmane.

Njohësi i mirë i kësaj problematike profesori A. Silajxhiq thekson se, myslimanët, mes tjerash, kulturës botërore i kanë dhuruar përvojën pluraliste, në fushën e respektimit të religjionit dhe të kulturës së tjetrit. Ai kur flet për këtë lloj të tolerancës në kohën e mesjetës, thekson se, përvoja pluraliste e kulturës, qytetërimit dhe religjion islam shihet edhe në atë se, në atë kohë (shekulli X, XI dhe XII) një njeri që ka jetuar në Isfahan apo në Bagdat, ka pasur mundësi të lexojë libra në

Üstün Değildir, *Dinler Tarihi*, 2004; (www.dinlertarihi.com/dosyalar/haberler/haberalt.htm); Qani Nesimi, *Dialogu obligim hyjnor*, Shkup, 2005, f.13-24.

arabisht dhe në persisht për hinduizmin, budizmin, krishterimin apo hebraizmin. Por, në të njëjtën kohë, një njeri i shkolluar në Paris apo në Bolonjë ka ditur shumë pak për hebraizmin, e të mos bisedohet për islamin, për çka ata kanë besuar se myslimanët kanë qenë paganë dhe pabesimtarë.[7]

Ardhja e shtetit Osman Ballkanin e gjeti në një pozitë shumë të vështirë sa i takon respektimit të së drejtës së "Tjetrit", gjegjësisht të drejtës nacionale dhe fetare të tjetrit. Këtu dominonte fryma asimiluese e inicuar dhe e realizuar nga serbët dhe grekët, të cilët vepronin në emër të ortodoksizmit, dhe nga katolikët, të cilët vepronin në emër të propagandës që më vonë do të quhet lëvizja uniate, sipas së cilës Kisha Ortodokse duhet penduar dhe bashkuar me Kishën Katolike. Kjo armiqësi me një fjalë ishte rezultati i skizmës së madhe (viti 1054) që ndodhi me ndarjen midis kishës Lindore dhe kishës Perëndimore. Ata të cilët më tepër vuanin nga kjo ishin ata që nuk pajtoheshin me konceptin e të të jetuarit dhe politikën e kishës krishtere, gjegjësisht kishës ortodokse. Në mesin e tyre mund të numërohen myslimanët e pakët në numër të Ballkanit para ardhjes së shtetit Osman, bogomilët dhe paganët.

Shteti Osman ishte një shtet multietnik dhe multikonfesional, kurse në asnjë mënyrë nuk ishte shtet njënacional. Shprehjet që përdoren për këtë shtet si ai ishte shtet turk e jo osman, se ata kanë qenë turq e jo osmanë, nuk janë për asgjë tjetër, vetëm se për ta minimizuar madhështinë, rolin dhe përkatësinë fetare të shtetit. Të thuash shteti turk është vetë shteti Osman, është gabim shumë i madh. I pari është shtet nacional me kulturë, gjuhë dhe nacionalitet të kufizuar. Ndërkaq shteti Osman, edhe pse është e vërtetë se element dominues në të ka qenë elementi turk, ka kuptim shumë më gjithëpërfshirës. Osmanë nuk janë vetëm turqit, por të gjithë popujt shtetformues në të: arabët, shqiptarët, kurdët, boshnjakët etj. Prandaj, nëse thuhet se shteti Osman është vetëm shtet turk, atëherë për shqiptarët është një nënçmim shumë i madh, sepse atyre u mohohet pjesëmarrja aktive në atë shtet, e kaluara

[7] Shih, Adnan Silajdzic, *Muslimani u traganju za identitetom*, Sarajevë, 2006, f. 90-92.

historike dhe besimi i tyre islam. Pasi është më se e ditur se kjo nuk është tjetër vetëm se një propagandë antishqiptare e realizuar nga qarqe të ndryshme. Kështu është rasti me politikën ortodokse progreke, e cila shqiptarët myslimanë i quan *turkoalvanoi* (shqiptarë turq).[8]

Një faktor relevant dhe vendimtar në Evropë dhe Ballkan, por që ka qenë jashtë kufijve të shtetit Osman, është prezenca e Kishës Katolike, gjegjësisht e papës si një dirigjent i jetës politike dhe fetare të evropianëve, periudhë kjo në të cilën Evropa e atëhershme vuante nga presioni i mentalitetit inkuizicionar i luftërave të kryqëzatave. Luftërat e kryqëzatave[9], kolonializmi klasik dhe anatemizmi i ushtruar ndaj botës "Tjetër" vërtetohet me anë të qëndrimit negativ që ka ndikuar në formimin e qëndrimit fetar te të krishterët ndaj islamit, sidomos te bota katolike. Gjatë këtij studimi është me rëndësi dhe me interes të theksohet se gjatë periudhës historike prej shek. XII e deri në shek. XV, është bërë një literaturë e tërë, përmbajtja e së cilës është përplot paragjykime dhe qëllime propagandistike[10] lidhur me personalitetin e të dërguarit të fundit (Profetit Muhamedit) dhe me autenticitetin e librit hyjnor- Kur'anit. Gjë kjo e cila nuk ndodh në shtetin Osman, kundër jomyslimanëve. Si shkrimtarë dhe autorë kryesorë të një literature të tillë antitjetër mund të përmenden: I. Damaskin, N. Vizantiski, B. Ereshki, E. Zigabenos (shek. XI dhe XIII), N. Çaunates (1138-1214) etj.[11]

[8] E. bej Vlora, *Kujtime 1885-1925*, Tiranë, 2003, f. 152, 335-336; Q. Nesimi, *Ortodoksizmi te shqiptarët*, Tetovë, 2005, f. 77-80.

[9] Duke u bazuar në pikëpamjet e lartpërmendura është e një rëndësie të veçantë të theksohet se, periudha e luftërave të kryqëzatave (1096-1453), sipas historianit turk profesor Inalxhikut, paraqet fytyrën e zezë të kishës katolike, bashkë me të edhe të politikës evropiane ndaj Islamit. Një gjë e tillë vërtetohet edhe me vendimin e papës ku më 25 nëntor 1366, deklarohet fillimi i luftës së kryqëzatave kundër Shtetit Osman. (Shih, H. Inalcik, *Osmanskata Imperija-klasićno doba 1300-1600*, f. 16).

[10] Në këtë moment është shumë me rëndësi të potencohet se bota e krishterë ka qenë e preokupuar me qëllime dhe ideja paragjykuese dhe propagandistike kundër bashkësive të tjera religjioze. (N. Solomon, Ko su jevreji, *Judaizam*, ed. R. Hafizovic, Sarajevë, 2005, f. 399-401).

[11] R. Hafizovic, *Muslimani u dijalogu s drugima i sa sobom*, Sarajevë, 2002, f. 71-72; R. Hafizovic, Uzajamno priznavanje Islama i Krscanstva, *Znakovi vremena*, nr. 4, Sarajevë, 1998, (http://ëë.ibn-sina.net/zv/znakovi_tekst.asp?tekst_id=42&broj_id=3); Fra L. Markovic, *Polemika ili dijalog s islamom?*, Livno, 1995, s. 29-53; A. Silajdzic, *Islam u*

Shikuar në aspektin religjioz, është me rëndësi të potencohet se, në atë kohë në Ballkan ekzistonte edhe një kishë tjetër e quajtur Kisha Bogomile (patarene, babun), e cila e mori emrin sipas priftit Bogomil. Kjo kishë ballafaqohej me atë që të shpëtojë veten nga asimilimi[12] që ushtrohej nga Mbretëria Hungareze dhe papa. Kështu që, ishte e detyruar[13] të kërkojë strehim dhe mbështetje në një fuqi që do ta mbrojë nga kjo situatë dhe ajo zgjodhi shtetin Osman, gjegjësisht të bëhet myslimane.[14]

Sipas historianit A.B.Kopanski, në fillim të shek. XIV politika serbe ka filluar konkretisht të zgjerohet në jug të Ballkanit, e cila pjesë më herët ka qenë nën Perandorinë Bizantine. Serbët prej bizantinëve kanë trashëguar dy ideologji religjioze. E para, idenë për superioritetin e krishterimit. E dyta idenë e armiqësisë ndaj "Tjetrit" (myslimanëve), e cila buronte nga frymëzimi i priftërinjve bizantinë që ata e kanë marrë në malin Atos. Ashtu që, mbreti serb, Stefan Dushani, vetveten e ka deklaruar: "Lider i të gjithë të krishterëve dhe kundër myslimanëve". Kurse mbreti Stefan Nemanja qysh në vitin 1169 e ka

otkrice krscanske evrope, Sarajevë, 2003, f. 37-51; M. P. Duric, Izmedu turskog islama i katoliçkog hrisçanstva, *Forum Bosne*, nr. 19, ed. R. Mahmutçehajic, Sarajevë, 2002, f. 155-156; B. Luis, *Muslimansko otkrice Evrope*, Beograd, 2004, f. 26-49.

[12] Si rezultat i situates së formuar bashveziri Mahmut Pasha ka dërguar ushtri kundër mbretit boshnjak, S. Toma, me të cilën e ka rrethuar territorin e Bosnjës. Gjatë rrethimit në qytetin Jajce, vetëm për një ditë 36.000 dhe më tepër pjestarë të bogomilizmit kanë kaluar në Islam. (A. B. Kopanski, *Balknalarda Osmanlı Barışı ve 'Batı Meselesi'*, f. 31).

[13] Në këtë drejtim kardinali I. de Torkuemada ka publikuar një edikt drejtuar kundër tre bogomilëve boshnjakë: D. Kuciniç, S. Tvrtkoviç i R. Vociniç. Në vitin 1463 nga ana e papës princi boshnjak S. Toma ka qenë i shpallur për mbret të katolikëve romakë në Bosnjë. *(Dei gratia rex Bossine).* (A. B. Kopanski, *Balknalarda Osmanlı Barışı ve 'Batı Meselesi'*, f. 30-31).

[14] A. B. Kopanski, *Balkanlarda Osmanlı Barışı ve 'Batı Meselesi'*, f. 30-31; A. B. Kopanski, Islamization of Albanians in the middle ages: the primary sources and the predicament of the modern historiography, *Islamic Studies*, 36: 2-3, Islamabad, 1997, f. 191-199; H. M. Handzic, *Islamizacija Bosne i Hercegovine i porijeklo bosnasko-hercegovackih muslimana*, Sarajevë, 1940, f. 8; *Islamska Misao H. Mehmeda Handzica, Izbor Radova*, Sarajevë, 1994, f. 179-180; A. Handzic, *Population of Bosnia in the Ottoman Period*, IRCICA, Stamboll, 1994, f. 4-13.

okupuar Bosnjën, kurse popullatën e cila nuk e ka pranuar besimin ortodoks (bogomilët) e ka maltretuar dhe torturuar.[15]

Për atë se si osmanët e konsideronin "Tjetrin" tregon edhe rasti historik kur mbreti hungarez J. Hunyadi dëshironte ta okupojë Serbinë, mbreti serb Gjorgj Brankoviq, me një letër të shkruar dërgon një delegacion te Hunyadi, kurse një delegacion tjetër me të njëjtën letër dërgon te sulltan Mehmeti Fatihu II. Brankoviq në atë letër ka shkruar: "Nëse shteti im (Serbia) bie nën sundimin tuaj çfarë do të ndodhë me besimin tonë ortodoks". Hunyadi përgjigjet: "Në çdo pjesë të Serbisë do të ndërtojë kisha katolike dhe do t'i prish kishat ortodokse". Kurse sulltan Fatihu përgjigjet: "Pranë çdo xhamie do të ndërtoj nga një kishë ortodokse". Pas kësaj përgjigje mbreti serb vendos të respektojë shtetin Osman.[16]

Osmanët i kanë hedhur themelet e shtetit të tyre botëror duke e bashkuar Anadollin dhe Ballkanin e krishterë nën patronazhin e tyre, të cilët me anë të idealit të tyre më të lart[17] kanë kontribuar edhe si mbrojtës të kishës ortodokse dhe të miliona të krishterëve të tjerë ortodoksë. Osmanët kanë garantuar të drejtën e jetës dhe të pasurisë edhe për të krishterët edhe për hebrenjtë, me një kusht që ata t'i nënshtrohen shtetit dhe të paguajnë tatim (xhizje).[18] Ai u ka lejuar që ata lirshëm t'i zbatojnë bindjet e tyre fetare dhe të jetojnë në përputhshmëri me ligjet e fesë së tyre, lirinë e të vepruarit për liderët fetarë, lirinë për ndërtimin dhe riparimin e kishave etj.[19] Kështu Osmanët, duke jetuar bashkë në një bashkësi me të krishterët, nga ana e tyre ata me një zemërgjerësi dhe me një tolerancë të madhe i kanë realizuar këto parime të shtetit. Në vitet e para të themelimit të shtetit Osman, politika e udh-

[15] A. Kopanski, *Balkanlarda Osmanlı Barışı ve 'Batı Meselesi'*, f. 13-14.

[16] A. Akgündüz, *İslam'da İnsan Hakları ve Beyannamesi*, Stamboll, 1997, f. 72; A. B. Kopanski, *Balkanlarda Osmanlı Barışı ve 'Batı Meselesi'*, Ankara, 2000, f. 22-25.

[17] Shih më gjërësisht për idealin më të lartë, gjëgjësisht luftën e shenjtë, I. Bardhi, Lufta e "shenjtë" në religjionet monoteiste f. 22.

[18] *Osmanlı Başbakanlık Arşivi Istanbul (OBAI), Kilise Defterleri (KD)*, nr. 8, f.5-6; *OBAI, Muhimme Defteri (MD)* 89, nr.265, f.86; 64, nr.538, f.210; nr.31, f.220; *OBAI, Gayrimuslimlere Ait Defterler (GD)*, nr. 18, f. 42.

[19] Shih, *Arkivi Shtetëror në RM, Sixhilli i Manastirit*, nr.13, f. 22; nr. 8, f.16; nr. 24, f.22.

ëheqësve ka qenë që të mundësojnë nënshtrim vullnetar të shteteve dhe të principatave krishtere dhe të fitojnë besimin e tyre para se të kapin armën.[20]

Kështu është rasti edhe me sinjorët (vasalët) shqiptarë, të cilët i kishin pronat e tyre dhe i takonin besimit krishterë. Shteti Osman, me kusht që ata të pranojnë autoritetin e tij, familjet vasale të krishtera shqiptare, si: balshajt, topiatët, dugagjinët, zakariotët, musakët, zenebisët, aranaitët, vullkashinët, kastriotët etj., gjegjësisht sinjorët e tyre i pranoi si legjitim, duke mos kërkuar që ata të ndërrojnë besimin e tyre. Sipas tahrir defter-it të vitit 835 hixhri (1431-1432), si vilajete të njohura shqiptare të asaj kohe mund të llogariten: vilajetet e Pavle Kurtikut, Balshajve, Aranitid Kondo Mitkos, Dimitri Gonimas; pastaj krahina e Ashtinit (Astin ili), krahina e Gjonit (Yovan ili), nahija e Bogdan Ripes. Gjoni ka qenë babai i Skënderbeut, kurse ka administruar me kastriotët. Pavlo Kurtiku, si një i krishterë ka poseduar një timar të madh në pjesën veriore të Elbasanit të sotëm. Ndërkaq, pas tij kanë vazhduar bijtë (Isa beu, Sinan beu, Mustafa), nipat (Husein) dhe familjar të tjerë të tij.[21] Pra siç kuptohet prej emrave të pasuesve të Pavlo Kurtikut, ata të gjithë kanë qenë myslimanë. I njëjtë ka qenë rasti edhe me vasalët e tjerë si: me djemtë e Karlos (Karli), djemtë e Zaganosit, djemtë e Gjonit etj.[22]

Sa i takon çështjes së trajtimit të "Tjetrit" në rajon dhe më gjerë, nga ana e osmanëve tregojnë edhe këta fermanë të mëposhtëm të sulltanëve. Në një edikt të sulltan Mehmet Fatihu II për të drejtat që u janë dhënë të krishterëve latinë (katolikëve) në Bosnjë thotë: "…Askush nuk ka të drejtë t'i pengojë kishat...çdo njëri është i sigurt në

[20] H. Inalxik, *Osmanska Imperija-klasicno doba 1300-1600*, f. 10-11.

[21] H. Inalcık, "Arnavutluk'ta Osmanlı Hakimiyetinin Yerleşmesi ve İskender Bey Isyanın Menşei, *Fatih ve İstanbul*, v.1, nr. 2, Stamboll, 1953, f. 154-156, 159-161; I. Ortaylı, *Osmanlı Barışı*, Stamboll, 2005, f. 117-120; N. Bozbora, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane***,** Tiranë, 2002, f. 45-47.

[22] Gjithë kjo është rezultat i sistemit gulam (devshirme), sipas të cilit të gjithë fëmijët e aristokracisë vendore kanë qenë të përgatitur për tu futur në admninistratën e Shtetit Osman. Fëmijët e tillë profesionalisht janë përgatitur në Enderun, e cila ka qenë një lloj shkolle në sarajin e sulltanit. (Shih, I. Ortaylı, *Osmanlı'yı Yeniden Keşfetmek*, f. 27-34, 173-177).

shtetin tim dhe kush dëshiron kur të dëshirojë mund të vijë dhe të vendoset këtu…asnjë nga vezirët e mi, nga populli im nuk ka të drejtë të sillet me nënçmim ndaj të tjerëve…jeta dhe kishat e tyre janë të mbrojtura me autoritetin tim..".[23] Sulltan Selimi I në hyrje të Jerusalemit ka qenë i pritur nga patriku ermen Serkisi III, ku të njëjtit sulltani (viti 1517) i jep një edikt: "..kishat, manastiret dhe vendet e tjera të shenjta me cilat kushte kanë vepruar deri tash do të vazhdojnë edhe më tutje, pa ndonjë ndryshim…askush prej vezirëve të mi nuk ka të drejtë të përzihet dhe të shqetësojë, të prishë ose të ndryshojë diçka…".[24] Historiani gjerman F. Babinger shprehet se, sulltan Mehmeti Fatihu II, përfaqësuesve të kishës ortodokse ua ka garantuar tre privilegje: asnjë kishë nuk do të shndërrohet në xhami[25], askush nuk ka të drejtë të përzihet në rituale kishtare dhe se të krishterët ortodoksë kanë të drejtë që t'i manifestojnë Pashkët.[26] Shteti Osman me platformën e vet shumë të qartë dhe të trashëguar nga e kaluara religjioze[27] dhe e bazuar në drej-

[23] G. G. Corm, *Prilog proucavanju multikonfesijonalnih drustava***,** Sarajevë, 1977, f. 70-71.

[24] Y. Ercan, "Ermeniler ve Ermeni Sorunu", *Osmanlidan Ermeni Sorunu*, ed. H. C. Guzel, Ankara, 2001, f. 83-84.

[25] Janë disa arsye që një kishë të shndrrohet në xhami: nëse kisha tregon dominimin politik dhe fetar të vendit në fjalë; nëse në një kishë është thirrur ezani, i cili nuk ka qenë gjithmonë rregull për shndërrimin e një kishe në xhami; nëse muslimanët kanë patur nevojë për realizimin e obligimeve të tyre fetare; nëse vendasit janë bërë musliman kisha e tyre është kthyer në xhami etj. (Shih, Ph. Mansel, *Dünyanın Arzuladığı Şehir 1453-1924 Konstantinopolis*, Stamboll, 1996, f. 48-49; A. Refik, *Onüçüncü Asr-i Hicride Istanbul hayatı (1786-1882)*, Stamboll, 1988, f. 20; *Osmanlı Başbakanlık Arşivi Istanbul, Mühimme Defteri*, v. 71, nr. 584 (989/1581); v. 52, br. 44 (991/1583); v. 62, nr., 209 (995/1587); v. 62, nr., 403 (996/1588); v. 62, nr., 209 (995/1587); v. 62, nr., 403 (996/1588). v. 62, nr., 209 (995/1587); v. 62, nr., 403 (996/1588).

[26] F. Babinger, *Fatih Sultan Mehmed ve Zamanı*, Stamboll, 2003, f. 105. Shih, M. Todorova, *Podbrani izvori za istorijata na balkanskite narodi XV-XIX vek*, Sofje, 1977, f. 47-49; S. Gerlah, *Dnevnik na edno ptuvane do Osmansliskata porta v Carigrad*, Sofje, 1976, f. 50.

[27] Disa dijetarë të kohës së sotme me plotë të drejtë theksojnë se, edhe pse perëndimorët sot islamin e shohin si një fe armike të modernitetit, islami tradicional është religjion i kompromisit, i cili është themeli i shoqërisë moderne. (Shih, S. Schwartz, *Dva Lica Islama*, Sarajevë, 2005, f. 51; M. A. Yamani, Islam And The West: The Need For Mutual Understanding, *The American Journal Islamic Social Sciences*, v. 14, nr. 1, New York, 1997, f. 88-89; A. Stojanovski, *Vranjski Kadiluk u XVI Veku*, Vrajë, 1985, f. 50).

tësinë universale-shpalljen hyjnore, arriti që në Ballkan dhe më gjerë, madje edhe te jomyslimanët, të formojë bindjen se ata janë më të preferuarit se të tjerët. Nga kjo lind edhe shprehja "më mirë një fes osman sesa një mertek katolik".[28]

Pozita adekuate në planin religjioz e superfuqisë së ardhshme qëndron në atë se shteti Osman është gjendur në vendin kufitar ku janë takuar, në një anë, dy religjionet më të mëdha monoteiste botërore, islami dhe krishterimi, kurse në anën tjetër, ekzistonte atmosfera e tendosur, e cila ishte rezultat i anatemizmit reciprok (skizma e madhe-1054) në mes të dy kishave të mëdha krishtere, katolicizmit dhe ortodoksizmit. Kurse pak më vonë krishterimi, sidomos kisha ortodokse, dhe hebraizmi do të marrin pozitën e tyre në strukturën sociale dhe ekonomike të shtetit Osman, gjegjësisht në kuptimin multikonfesional dhe multinacional të tij.

Sistemi millet në shtetin Osman, po ashtu është e një rëndësie të veçantë në trajtimin e "Tjetrit" nga ana e tyre. Ai paraqet një etnikum, i cili nuk kuptohej vetëm si një etnikum nacional, por ai në vete ngërthen një grup njerëzish që i tejkalojnë kufijtë nacionalë. Në konceptin osman termi millet, shikuar në aspektin historik, paraqet një fakt sui generis, që tregon se shteti Osman është një bashkësi origjinale kulturologjike dhe sociologjike. Ky sistem nuk mund të krahasohet as me statutin e pakicave në shtetet kolonizuese e as me strukturën e shoqërive federative. Sipas dijetarëve relevantë të fushës së historisë sistemi millet nuk mundet në asnjë mënyrë që të kuptohet si një sistem i pakicave, pasi ai i paraqet të gjithë përfaqësuesit e besimeve.[29] Për shembull si millet janë llogaritur katër grupe të mëdha në bazë religjioze: Myslimanët, Grekët (ortodoksë) bashkë me kishat tjera në Ballkan, Ermenët (Gregorianë dhe Katolikë) dhe Hebrenjtë.[30]

[28] I. Ortaylı, *Osmanlı'yı Yeniden Keşfetmek*, f. 66; A. B. Kopanski**,** *Balkanlarda Osmanlı Barışı ve 'Batı Meselesi'*, f. 39; D. Goffman, *Osmanli Dunyasi ve Avrupa 1300-1700*, Stamboll, 2004, f. 74.

[29] B. Braude, Millet Sistemi'nin İlginç Tarihi, *Osmanlı'dan Günümüze Ermeni Sorunu*, ed. Hasan Celal Güzel, Ankara, 2001, f. 316; I. Ortaylı, *Osmanlı Toplumunda Aile*, Stamboll, 2002, f. 15.

[30] I. Ortaylı, *Osmanlı Toplumunda Aile*, f. 15-17.

Rreziku i sistemit millet ka qenë vetëm për ata shqiptarë që kanë qenë të përkatësisë fetare ortodokse. Pasi, kisha ortodokse është e nacionalizuar, në rastin konkret në Ballkan, e sidomos aty ku jetojnë shqiptarët, dhe nëpërmjet të besimit ortodoks ata përhapin edhe nacionalizmin e tyre, duke mos e përfillur gjuhën, kulturën e tjetrit. Shqiptarët nuk kanë qenë në pozicion që të kenë primatin e besimit ortodoks në Ballkan, por ata si ortodoksë kanë qenë të njohur o nëpërmjet të Kishës Greke, o nëpërmjet të Kishës Serbe. Kështu raste edhe më të freskëta, të kohës më të re, për të cilat tregon Sami Frashëri[31], ka si në Tetovë, Prizren, Ohër, etj., ku shqiptarët ortodoksë nuk janë më shqiptarë, por ata janë të sllavizuar. E gjithë kjo është rezultat i asaj që shqiptarët kanë qenë pre e nacionalizmave të ndryshëm të veshur me petkun e fesë. Në këtë kuptim sistemi millet ka qenë me avantazh për grekët, pasi të gjithë ortodoksët janë quajtur me emrin grekë, jo në kuptimin nacional, por në kuptimin religjioz.

Ndërkaq, nga e gjithë kjo del se në shtetin Osman njerëzit në aspektin religjioz janë klasifikuar në myslimanë (muslimler) dhe në jomysliman (gajrimuslimler). Dallimi në mes tyre ka qenë në bazë të obligimeve që ata kanë pasur ndaj shtetit. Jomyslimanët kanë pasur edhe obligime edhe të drejtat e tyre. Së pari ata kanë pasur statutin e tyre politik: *dhimmi*[32] dhe *must'emen*.[33] Lirisht mund të themi se, asnjëherë të krishterët dhe hebrenjtë në shoqërinë multietnike osmane

[31] S. Frashëri, *Kush e prish paqën në Ballkan*, LogosA, Shkup, 2005, f. 60-61.

[32] Dhimmi është një term që tregon statutin politik të jomuslimanëve në shoqërinë osmane/islame, sipas të cilit trajtohet një jomusliman që jeton në Shtetin Osman dhe i posedon të gjitha të drejtat e tij me ligj shtetëror. Dhimmitë në shoqërine multietnike dhe multikonfesionale osmane/islame kanë qenë të lirë të bëjnë tregëti me mish derri, verë, ose të bëjnë ndonjë marrëveshje me kamatë. (Shih, B. Lewis, *Çatışan Kültürler, keşif çağında hıristiyanlar, müslümanlar, yahudiler*, Stamboll, 2002, f. 23; G. G. Corm *Prilog proucavanju multikonfesijonalnih drustava*, f. 203; A. Matkovski, *Dietot-krvninata*, Shkup, 1973, f. 22).

[33] Muste'menët janë jomuslimanë dhe nuk jetojnë në shtetin Islam/Osman, kur vijnë në këtë shtet ata kanë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Prandaj fjala must'emen ka kuptimin sigurim, besueshmëri. (Shih, H. Karaman, *Mukayeseli Islam Hukuku*, Stamboll, 1991, f. 243).

nuk janë trajtuar ashtu sikur shteti katolik në Spanjë i ka trajtuar hebrenjtë në shek. XIV-XV.[34]

Prej obligimeve të jomyslimanëve ndaj shtetit Osman janë haraçi dhe xhizeja. Fjala haraç është fjalë arabe dhe ka kuptimin e taksës, gjegjësisht taksës për tokën. Kurse xhizeja është një taksë që merrej prej pasurisë materialeve të cilën dhimmiu e posedon dhe është një marrëveshje mes shtetit osman dhe jomyslimanëve që jetojnë në atë shtet. Xhizeja është detyrim që paguhet për të fituar garancinë dhe mbrojtjen shtetërore, me të cilën një jomysliman që jeton në shtetin Osman do të jetë i liruar nga shërbimi ushtarak. Pra një jomysliman i krishterë do të paguajë xhizje për t'i shërbyer arkës së shtetit, kurse një mysliman një gjë të tillë e bën duke dhënë zeqatin, për të cilin jomyslimani nuk është i obliguar ta realizojë.[35] Dallimi mes haraçit dhe të xhizjesë është se nëse një jomysliman bëhet mysliman, prej xhizjes lirohet, kurse prej haraçit jo.[36]

Një çështje tjetër që duhet të përmendet është sistemi i devshirmesë. Devshirme ishte një sistem nëpërmjet të cilit zmadhohej numri i ushtarëve në shtetin Osman. Ligji për aktivizimin e devshirmesë daton nga koha e sulltan Muratit II, sipas të cilit ligj shteti Osman prej popullatës jomyslimane (krishtere), gjegjësisht prej çdo 40 shtëpive të krishtera ka marrë nga një fëmijë mashkull të moshës të caktuar prej 8 deri në 18-vjeç, kurse më e realizueshmja ka qenë prej moshës 14 deri në 18-vjeç. Ky ligj është praktikuar vetëm sipas nevojës së shtetit. Në çdo kadilluk, kudo që të ishte, në fillim popullata është lajmëruar për grumbullimin e devshirmesë. Pastaj fëmijët e krishterë me prindërit e tyre ose me shoqërimin e priftërinjve janë tubuar në vendin e caktuar. Me vete ata kanë pasur edhe *defter*ët ku kanë qenë të regjistruar emrat e fëmijëve devshirme. Të tillët u janë dorëzuar kompetentëve si kadiut, spahiut ose qehasë së fshatit. Të gjithë ata që janë marrë me devshirmenë janë paguar nga ana e shtetit.[37] Ky ligj në fillim është realizuar vetëm në pjesën evropiane të shtetit Osman (Ballkan), kurse ka fundi i shek. XV ka filluar të praktikohet edhe në popullatën e krishterë në Anadoll.[38] Sistemi devshirmesë një jomyslimanit ia mundëson që ai të marrë pjesë në ushtrinë dhe administratën osmane, kurse një myslimman nuk merret si devshirme, por ai shkon ushtar. Ky është një lloj balance që shteti Osman e ka bërë në mesin e njerëzve, pa dallim feje.

Pra, realizimi i devshirmesë, sipas dokumenteve osmane, në shtetin Osman ka luajtur rolin e avancimit të jomyslimanëve, gjegjësisht të të krishterëve në administratën dhe në hierarkinë shtetërore. Gjatë realizimit të këtij sistemi nuk mund të themi se nuk ka pasur incidente apo keqpërdorime, por sa i takon realizimit në vijën zyrtare ai ka qenë i qartë se kush mund të merret për devshirme, si mund të merret për devshirme etj.[39] Sa që marr guximin që të konstatoj se, përveç familjeve fanatike tradicionale dhe religjioze të asaj kohe, të tjerët, e sidomos funksionarët e asaj kohe kanë vrapuar dhe kanë intervenuar që fëmijët e tyre të jenë në listën e devshirmesë[40], pasi ajo ka qenë njëra prej formave më të volitshme për avancimin e fëmijëve dhe të familjeve të tyre në hierarkinë shtetërore. Kjo, në një farë forme, i ngjan situatës së sotme, ku shumë njerëz, e sidomos funksionarët, duke mos shikuar diversitetin kombëtar, religjioz apo gjuhësor, fëmijët e tyre i dërgojnë për studime dhe avancime profesionale nëpër qendra të ndryshme të botës së zhvilluar.

[34] Shih, H. Karaman, *Mukayeseli Islam Hukuku*, Stamboll, 1991, f. 243.

[35] H. Karaman, *Mukayeseli İslam Hukuku***,** f. 273; Ibni K. el-Xhevzi, *Ahkamu ehli'dh-Dhimme*, Kajro, 2003, f. 23-25; S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII, administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore*, Prishtinë, 1982, f. 397-398.

[36] J. Kardavi, *Gajrimuslimin fi'l-muxhteme'il-islamij*, f. 32; E. Mardin, Harac, *Islam Ansiklopedisi*, tom 5/1, Stamboll, 1988, f. 222.

[37] A. Özcan, Organizacija Vojske kod Osmanlija, *Historija Osmanske Drzave i Civilizacije*, Sarajevë, 2004, f. 416.

[38] A. Özcan, Organizacija Vojske kod Osmanlija, *Historija Osmanske Drzave i Civilizacije*, f. 414-415; İ. Ortaylı, *Osmanlı'yı Yeniden Keşfetmek*, Stamboll, 2006, f. 27-34; A. Ozcan, "Devşirme", *İslam Ansiklopedisi*, v. 9, Stamboll, 1994, f. 254-257; B. Braude i B. Lewis, Osmanlı Devleti İçerisinde Hıristiyanlar ve Yahudiler, *Akademik Araştırmalar Dergisi*, v. 2, nr. 4-5, Stamboll, 2000, f. 184-185.

[39] Shih, Q. Nesimi, *Odnosot na Osmanliskata Dr`ava kon hritijanstvoto na Balkanot ve XV i XVI vek, so poseben osvrt kon hristijanstvoto vo Makedonija*, punim doktorature i pabotuar, Instituti i Historisë Nacionale, Shkup, 2006, f. 72-80.

[40] Shih, Inalcık, "Arnavutluk'ta Osmanlı Hakimiyetinin Yerleşmesi ve İskender Bey Isyanın Menşei, f. 154-156, 159-161; Ortaylı, *Osmanlı Barışı*, f. 117-120; Bozbora, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane***,** f. 45-47.

Bibliografia

A. Dokumente arkivore

- *Gayrimuslimlere Ait Defterler (GD),* nr. 18, f. 42. *Osmanli Basbakanlik Arsivi Istanbul (OBAI).*
- *Kilise Defterleri (KD),* nr. 8, f. 5-6. *(OBAI).*
- *Muhimme Defteri (MD)* 89, nr.265, f.86;64, nr.538, f.210; nr.31, f.220: v.71, nr.584 (989/1581); v.52, nr.44 (991/1583); v.62, nr.209 (995/1587); v.62, nr.403 (996/1588); v.62, nr.209 (995/1587); v.62, nr.403 (996/1588). v. 62, nr. 209 (995/1587); v. 62, nr. 403 (996/1588). *(OBAI).*
- *Arkivi Shtetëror në RM, Sixhilli i Manastirit,* nr. 13, f. 22; nr. 8, f. 16; nr. 24, f. 22.

B. Literatura

- Ozcan, "Devşirme", *İslam Ansiklopedisi,* v. 9, Stamboll, 1994.
- Özcan, Organizacija Vojske kod Osmanlija, *Historija Osmanske Drzave i Civilizacije*, Sarajevë, 2004.
- Adem Handzic, *Population of Bosnia in the Ottoman Period*, IRCICA, Stamboll, 1994.
- Adnan Silajdzic, *Islam u otkrice krscanske evrope*, Sarajevë, 2003.
- Adnan Silajdzic, *Muslimani u traganju za identitetom*, Sarajevë, 2006.
- Ahmet Akgündüz, *İslam'da İnsan Hakları ve Beyannamesi*, Stamboll, 1997.
- Alekasandar. Matkovski, *Dietot-krvninata*, Shkup, 1973.
- Aleksandar Stojanovski, *Vranjski Kadiluk u XVI Veku*, Vrajë, 1985.
- Amet Refik, *Onüçüncü Asr-i Hicride Istanbul hayatı (1786-1882),* Stamboll, 1988.
- Ataullah B. Kopanski, *Balkanlarda Osmanlı Barışı ve 'Batı Meselesi'*, TDVY, Ankara, 2000.
- Ataullah B. Kopanski, Islamization of Albanians in the middle ages: the primary sources and the predicament of the modern historiography, *Islamic Studies*, 36: 2-3, Islamabad, 1997.
- B. Braude i B. Lewis, Osmanlı Devleti İçerisinde Hıristiyanlar ve Yahudiler, *Akademik Araştırmalar Dergisi*, v. 2, nr. 4-5, Stamboll, 2000.
- B.Braude, Millet Sistemi'nin İlginç Tarihi, *Osmanlı'dan Günümüze Ermeni Sorunu*, ed. Hasan Celal Güzel, Ankara, 2001.

- Bernard Leëis, *Çatışan Kültürler, keşif çağında hıristiyanlar, müslümanlar, yahudiler*, Stamboll, 2002.
- Bernard Luis, *Muslimansko otkrice Evrope*, Beograd, 2004.
- *Bibla*, Lajmi i Mirë, Tiranë.
- Daniel Goffman, *Osmanli Dunyasi ve Avrupa 1300-1700*, Stamboll, 2004.

A. Mardin, Harac, *Islam Ansiklopedisi*, tom 5/1, Stamboll, 1988.

- Eqrem bej Vlora, *Kujtime 1885-1925*, Tiranë, 2003.
- Fra Luka Markovic, *Polemika ili dijalog s islamom?*, Livno, 1995.
- Fransiz Babinger, *Fatih Sultan Mehmed ve Zamanı*, Stamboll, 2003.
- Goerge G. Corm, *Prilog proucavanju multikonfesijonalnih drustava***,** Sarajevë, 1977.
- H. M. Handzic, *Islamizacija Bosne i Hercegovine i porijeklo bosansko-hercegovackih muslimana*, Sarajevë, 1940.
- Halil Inalcık, "Arnavutluk'ta Osmanlı Hakimiyetinin Yerleşmesi ve İskender Bey Isyanın Menşei, *Fatih ve İstanbul*, v. 1, nr. 2, Stamboll, 1953.
- Halil Inalcik, *Osmanskata Imperija-klasićno doba 1300-1600*, Shkup, 2002.
- Halil. Inalcık, *Osmanlı Imparatorluğu'nun Ekonomik ve Sosyal Tarihi 1300-1600*, v. 1, Stamboll, 2000.
- Hayreddin Karaman, *Mukayeseli Islam Hukuku*, Stamboll, 1991.
- Ibni K. el-Xhevzi, *Ahkamu ehli'dh-Dhimme*, Kajro, 2003.
- Ilber Ortaylı, *Osmanlı Barışı*, Ufuk, Stamboll, 2005.
- Ilber Ortaylı, *Osmanlı Toplumunda Aile*, Stamboll, 2002.
- İlber Ortaylı, *Osmanlı'yı Yeniden Keşfetmek*, Stamboll, 2006.
- İlber Ortaylı, *Son Imparatorluk Osmani-Osmanlı'yı Yeniden Keşfetmek 2*, Stamboll, 2006.
- *Islamska Misao H. Mehmeda Handzica, Izbor Radova,* Sarajevë, 1994.
- Ismail Bardhi, Lufta e "shenjtë" në religjionet monoteiste, *Përmbledhje Punimesh*, V. 1, Nr. 1, FSHI, Shkup, 2002.
- Ivan Cvitkovic, Interreligijski odnosi u multireligijskom drustvu, *Znakovi Vremena*, nr. 7-8, Sarajevë, 2000 (www. Ibn-Sina.net);
- M. A. Yamani, Islam And The West: The Need For Mutual Understanding, *The American Journal Islamic Social Sciences*, v. 14, nr. 1, New York, 1997.
- M. Todorova, *Podbrani izvori za istorijata na balkanskite narodi XV-XIX vek*, Sofje, 1977.

- Mahmut Aydın, Hiçbir Din Diğerinden Üstün Değildir, *Dinler Tarihi*, 2004; (www.dinlertarihi.com/dosyalar/haberler/haberalt.htm).
- Marko P. Duric, Izmedu turskog islama i katoliçkog hrisçanstva, *Forum Bosne*, nr. 19, ed. R. Mahmutçehajic, Sarajevë, 2002.
- Norman Solomon, Ko su jevreji, *Judaizam*, ed. R. Hafizovic, Sarajevë, 2005.
- Nuraj Bozbora, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane***,** Tiranë, 2002.
- Ph. Mansel, *Dünyanın Arzuladığı Şehir 1453-1924 Konstantinopolis*, Stamboll, 1996.
- Qani Nesimi, *Odnosot na Osmanliskata Dr`ava kon hritijanstvoto na Balkanot ve XV i XVI vek, so poseben osvrt kon hristijanstvoto vo makedonija*, punim doktorature i pabotuar, Instituti i Historisë Nacionale, Shkup, 2006.
- Qani Nesimi, *Dialogu obligim hyjnor*, Shkup, 2005.
- Qani Nesimi, *Ortodoksizmi te shqiptarët*, Tetovë, 2005.
- Reshid Hafizovic, *Muslimani u dijalogu s drugima i sa sobom*, Sarajevë, 2002.
- Reshid Hafizovic, Uzajamno priznavanje Islama i Krscanstva, *Znakovi vremena*, nr. 4, Sarajevë, 1998. (http://www.ibn-sina.net/zv/znakovi_tekst.asp?tekst_id=42&broj_id=3).
- S. Gerlah, Dnevnik na edno ptuvane do Osmansliskata *porta v Carigrad*, Sofje, 1976.
- Sami Frashëri, *Kush e prish paqën në Ballkan*, LogosA, Shkup, 2005.
- Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII, administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore*, Prishtinë, 1982.
- Sulejman Schëartz, *Dva Lica Islama*, Sarajevë, 2005.
- Yavuz Ercan, "Ermeniler ve Ermeni Sorunu", *Osmanlidan Ermeni Sorunu*, ed. H. C. Guzel, Ankara, 2001.

Qani Nesimi

THE CONCEPT OF "*THE OTHER*" AMONG THE OTTOMANS AND THE POSITION OF THE ALBANIANS IN IT

(Summary)

The "essence", which in itself includes universalism and the symbolism of originality, is what makes things eternal and gives them value. Karl Popper, in his book, the *Poverty of Historicism*, while analyzing the role of essentialism in the description of history, among others, claims that *history* is the description of change, whereas, the *essence* is what remains unchanged. In a certain sense the essence too is affected by change. When a thing changes, what remains unchanged is its essence (substance). The changes, a certain thing undergoes, shed light on different aspects of it, including its essence.

تشانی نسیمی

مفهوم "الاخر" عند العثمانيين و موقف الالبانيين منه

(خلاصة البحث)

الجوهر الذي يحتوى في نفسه العمومية و رمز الاصولية هو الذي يعطى صفة الازلية و يجعله ذات قيمة. و حول هذا الموضوع يقول العالم الشهير كارل بوبر في كتابه: "خيبة امل التاريخ" حول مناقشته لموضوع دور الجوهر و ليس تناول وصف التاريخ أو الماضى هو يقول بأن التاريخ هو وصف التغيير أما الجوهر هو الذي يبقى بدون تغيير.

QYTETËRIMI ISLAM

Dr. Qazim Qazimi

PREMISAT HYJNORE TË QYTETËRIMIT ISLAM
- Mendime dhe ide rreth qytetërimit -

وَقَالُوا لَوْلا نُزِّلَ هَذَا الْقُرْآنُ عَلَى رَجُلٍ مِّنَ الْقَرْيَتَيْنِ عَظِيمٍ * (الزخرف/**31**)

***"Dhe thanë** (pabesimtarët): **Pse ky Kur'an nuk i është zbritur ndonjë njeriu të madh** (të shquar) **të këtyre dy qyteteve"** (Mekës dhe Taifit, vendbanime me qytetërim të hershëm).*[1]

Kur'ani-kerim ka prekur këtë çështje, problematikën e qytetërimit, dhe, në 10 ajete të sureve të ndryshme, në vështrim të rendit e stabilitetit, është theksuar qyteti me nocionin El-Karjetu - (**القرية**) në kuptimin e qytetërimit:[2]

Edhe Meka, si vendbanim i qytetërimeve të lashta, është quajtur Ummu El-Kura- (nëna e fshatrave) madje edhe djep i qytetërimit, thjesht për rolin që ka luajtur në qytetërimin islam dhe në atë botëror.

Shikuar historikisht, qytetërimi paraqet lëvizjen e pjesëtarëve të një shoqërie drejt një synimi të caktuar, respektivisht drejt realizimit të rolit të asaj shoqërie në skenën e historisë njerëzore, duke ruajtur baraspeshën midis faktorëve materialë dhe shpirtërorë.

[1] Kur'ani, sureja Ez-Zuhruf, ajeti 31.

[2] Nuhbetun Min El-Esatidheti, "Dirasatun Fi El-Hadareti El-Islamijjeti", fq. 60, Kajro, 1983.

Sa i përket fjalës QYTETËRIM në gjuhën shqipe përkon me shprehjen në latinishten e vjetër "CIVITAS", që është e prejardhur nga fjala latine "CIVITATEM"[3], që do të thotë - qytet. Dhe, sipas kësaj logjike, nëse kufizojmë qytetërimin vetëm me qytetin dhe banorët e qytetit, atëherë nga qytetërimi do të jenë përjashtuar gjysma e njerëzimit, pra popujt endacakë dhe ata që nuk jetojnë në qytete, prandaj ky përkufizim kaq i rrudhur paraqet elemente të një qytetërimi që është destruktiv dhe shkatërrues, ndërkohë që elementi tjetër i qytetërimit të gjithmbarshëm, është pozitiv dhe ndërtues.

Sot fjala QYTETËRIM, sikundër edhe fjala KULTURË, në masë të madhe përdoren në shumë sfera të jetës në biseda të lira, ligjërata, seminare, tribuna, kumtesa e vepra të ndryshme artistike. Shpesh ndodh të dëgjojmë për dikë të thuhet se është i qytetëruar, se është i kulturuar etj. Një kohë të gjatë, fjala KULTURË kishte një kuptim të ngushtë. Ajo kufizohej në marrëdhëniet dhe ndërlidhjet e njeriut në raport me natyrën dhe gjithë ajo që rezultonte nga kjo ndërlidhje, sipas skemës (njeriu-natyra-kultura). Në ditët e sotme, me fjalën KULTURË gjithnjë e më tepër nënkuptohet ngritja-avancimi i bashkësisë njerëzore nga gjendja e mëparshme e jetës primitive në një shkallë dhe formë më cilësore të jetesës. [4]

Në kontekstin e përgjithshëm, Kultura vlerësohet dhe përshkruhet si botë shpirtërore-jomateriale në jetën e shoqërive të ndryshme, ndërsa qytetërime cilësohet si një botë materiale, pasqyruese e vlerave kulturore.

Duhet kuptuar se as kultura dhe as qytetërimi nuk janë fenomene që ekzistojnë në natyrë nga vetvetiu, nuk janë fenomene që njeriu i gjenë të gatshme në natyrë e as në strukturën e vet biologjike. Qenia njeri, kulturën dhe qytetërimin i formon në bazë të mundësive të veta fizike, mendore, intelektuale dhe shpirtërore. Bazuar e këtë që u tha,

[3] Shih, Dr. Sejjid Husein Nasër, "Dialogu mes Civilizimeve", Logos-A, fq. 21, Shkup, shtator-2000.
- Shih edhe: Nuhbetun Min El-Esatidheti, "Dirasatun Fi El-Hadareti El-Islamijjeti", fq. 70, Kajro, 1983.

[4] Nijaz Shukriq, "Povijest Islamske Kulture i Civilizacije", fq. 27 Sarajevë, 1989.

të gjitha shoqëritë njerëzore, si ato "primitive", po ashtu edhe ato të avancuara "të qytetëruara" kanë kulturën e vet dhe, nuk ekziston ndonjë bashkësi njerëzore pa kulturë.

Për përkufizimin e nocionit QYTETËRIM janë dhënë me qindra mendime dhe komente të ndryshme, si nga gjuhëtarë, ashtu edhe nga mendimtarë, dijetarë e fetarë, por përkufizimet dhe shpjegimet e tyre nuk kanë përfunduar shumë larg njëri-tjetrit në aspektin kuptimor.

Sipas "Fjalorit të gjuhës shqipe", me fjalën qytetërim nënkuptohet *"Tërësia e arritjeve në fushën e kulturës materiale e shpirtërore dhe në zhvillimin shoqëror, që e karakterizojnë një formacion ekonomiko-shoqëror ose një popull a vend të caktuar; shkallë e lartë e këtij zhvillimi."*[5]

Ka mendime se qytetërimi është periudha e tretë e zhvillimit të shoqërisë së lashtë, pas egërsisë e barbarisë (Gr. Barbarus).[6] Por, nuk ka dyshim se njeri i qytetëruar është ai që ka fe dhe shkallë të lartë zhvillimi, në rend të parë pse ka marrë edukatë të mirëfilltë, arsim, kulturë, vlera morale, shpirtërore etj., si dhe di të sillet në një shoqëri të civilizuar, e cila është në një shkallë të zhvillimit të lartë shpirtëror, shoqëror, kulturor e material.

Sipas Ibni Haldunit "QYTETËRIMI është fazë e zhvillimit me të cilën njeriu përmirëson dhe avancon jetën e tij në etikë, shkencë, teknikë etj., dhe kjo është ajo fazë kur njeriu ndërron nga beduizmi-barbaria, në qytetërim."[7] Në kuadër të qytetërimit futet jeta e gjithmbarshme por edhe infrastruktura e një shteti-shoqërie.

[5] A. Kostollari, J. Thomaj, Xh. Lloshi, M. Samara, J. Kola, P. Daka. P. Haxhiilazi, H. Shehu, F. Leka, E. Lafe, K. Sima. Th. Feka, B. Keta, A. Hidi, Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, pjesa e dytë, fq. 1624, "Rilindja" Prishtinë, 1981.

[6] (barbarus), fjalë greke, emër me të cilin grekët dhe romakët e vjetër i quanin me përbuzje të huajt, jogrekët që nuk e flisnin greqishten, fazë e dytë e zhvillimit të shoqërisë pas egërsirës.

[7] Mukaddemtu Ibni Haldun, fq. 210-216.

Që dikush të bëhet musliman i qytetëruar, musliman i vërtetë, kjo nuk do të thotë të jetë detyrimisht hixhazik, beduin i shek. VII, të veshë xhelebijen (galabijen) ose "thevbin".[8]

Sejjid Kutubi, në veprën e tij "Mealem fit-Tariki"- (Shenja në Rrugë), një kapitull të kësaj vepre e ka emërtuar "Islami-Qytetërim i Vërtetë", ku konstaton: "*Shoqëria islame është e vetmja shoqëri në të cilën dominon një Hyjni dhe në të cilën njerëzit nga robërimi ndaj robërve kalojnë në robërim vetëm ndaj All-llahut. Në këtë mënyrë ata përjetojnë çlirim të vërtetë e të plotë, të cilin e synon qytetërimi njerëzor".*[9]

Malik bin En-Nebij, në librin e tij "Shurutu En-Nehdati", thotë: "QYTETËRIMI te ndonjë popull nuk mund të paraqitet në formë tjetër, përveç në formë të "Vahjit"-Dërgatës" [10]

Profesor Ebu El-Ala El-Mevdudiji, kur flet për qytetërimin, thotë se ai është një sistem i përkryer që përfshin idetë, mendimet, veprat, moralin në jetën individuale, shoqërore, ekonomike e politike të njeriut. E, për qytetërimin islam, thotë se është i përbërë nga një grup rregullash e ligjesh hyjnore, të cilat i ka paraparë Lartmadhëria e Tij-All-llahu xh.sh., për çështje dhe punë të ndryshme në rregullimin e jetës së njeriut, që me shprehje tjetër janë quajtur fe islame.[11]

Për Sami Frashrin, në "Medenijjet-i Islamijje" - (Qytetërimi Islam): *"Njeriu është i krijuar në gjendje të egër, por ama nuk është krijuar për të mbetur i egër. Megjithatë, tek ai është krijuar dhe ai ka një forcë të posaçme që s'e ka askush; mendjen dhe inteligjencën... Ajo që e veçon dhe e dallon njeriun nga kafshët e tjera, është shkalla dhe fuqia mendore… Ajo që shkaktoi dhe detyroi këtë dallim midis njerëzve, është një rrethanë karakterizuese, që quhet Qytetërim… Ja*

[8] Murad W. Hofmann, "Muslimanët midis Perëndimit dhe Lindjes","Univers" nr. 3. fq. 228, Tiranë 2002.

[9] Prof. Sejjid Kutub, "Shenja në Rrugë", fq. 145, pa shënim të vitit dhe vend botimi.

[10] Burimi i cituar fq. 18.

[11] Ed-Duktur Muhammed Alij Diavij, "Mukaddimatun Fi Fehmi El-Hadareti El-Islamijjeti", fq 17, Bejrut-Liban, 1983 m. (1403 h.).

pra, dallimi dhe ndryshimi midis njerëzve qëndron në shfaqjen e paraqitjen e këtij qytetërimi”.[12]

I brumosur nga Islami, Sami Frashëri dallimin mes njerëzve nuk e sheh në fizionominë-pamjen, ngjyrën apo vendbanimin e tyre, por në qytetërimin, barbarinë apo egërsinë e tyre. Ai, qytetërimin e gjen në fuqinë mendore, kulturore, shpirtërore dhe materiale të njerëzve. Për Samiun, mendja dhe inteligjenca e njeriut janë dy faktorët determinues dhe kryesorë që mundësojnë qytetërimin e tij. Sa i përket qytetërimit islam, ai shpreh bindjen se qytetërimi islam është produkt dhe fryt i fesë islame, ngase shumë ajete të Kur’anit dhe hadithe të Muhammedit a.s. bëjnë thirrje nxitin dhe propagandojnë dijen, që, sipas tij., është faktor kryesor i qytetërimit të një shoqërie. Kur’ani është ligjdhënës dhe udhërrëfyes i qytetërimit, ndërsa Muhammedi a.s. dhe as’habët e tij janë të parët që jetësuan parimet dhe futën në veprim parimet dhe ligjet e qytetërimit, të nxjerra nga Kur’ani.

Sipas prof. dr. Sejjid Husein Nasër, ligjërues në Universitetin “Gorge Uashington” në SHBA, filozof nga Irani dhe padron i qendrës “Sallyox” të Katnerberit, qendra më e madhe për mësime krishtere-islamike, *“Qytetërimi është një bashkim që reflekton parimet hyjnore.”*[13]

Qytetërimin, Semjuel Hantington-ligjërues në Universitetin e Harwardit në SHBA, e përkufizon si “shkallën më të gjerë të identitetit kulturor, si grupimin më të lartë kulturor të njerëzve. Tiparet e qytetërimeve janë gjuha, historia, religjioni (si veçori kryesore), doket, institucionet, si dhe vetë identifikimi personal.”[14]

Në shpjegimin e teorisë së tij, ai thekson rëndësinë që në botën bashkëkohore merr religjioni. Ta themi edhe këtë absurd lidhur me ngushtimin e kuptimit të fjalës qytetërim: “*Një kohë të gjatë në shekullin*

[12] Sami Frashri, “Qytetërimi Islam”, fq. 22-25, Logos-a, Shkup, 2003.

[13] Dr. Sejjid Husein Nasr, “Dialogu mes Civilizimeve”, Logos-A, fq. 25, Shkup, shtator-2000.

[14] Dr. Sllavejko Sosajkovski, “Dialogu mes Civilizimeve”, Logos-A, fq. 48, Shkup, shtator, 2000.

XX, të ishe i qytetëruar, nënkuptonte të dije si përdoret piruni kur hahet peshku ose si lidhet kravata.[15]

Tek arabët qytetërimi është e kundërta e beduizmit, e kundërta e jetës nomade nëpër shkretëtirë.[16] Sipas këtij kuptimi, njeriu i qytetëruar jetonte dhe bananonte në vend të urbanizuar, të qytetëruar, ku ka kulturë e dije, kurse i paqytetëruari, beduini bridhte nga një vend në një tjetër nëpër shkretëtirë, duke kërkuar për veten dhe familjen jetë më të mirë.

Shikuar nga këndi i historisë, asnjë qytetërim nuk është produkt dhe i krijuar krejt nga njeriu. Çdo qytetërim mendohet të jetë bazuar në idenë hyjnore. Nuk ka qytetërim i cili të mos jetë ndërtuar, ose së paku, të mos ketë mbështetje te religjioni-feja. Të kësaj natyre janë edhe qytetërimi islamik, qytetërimi perëndimor, qytetërimi kinez, qytetërimi indian, qytetërimi japonez, qytetërimi i majave apo qytetërimi afrikan etj., që janë shembuj tipikë për këtë. Asnjë qytetërim nuk është zhvilluar e rritur i pastër e i izoluar nga të tjerët.

Qytetërimet mund të përzihen e të përputhen, të rriten e të shkatërrohen, si dhe të zhvendosen nga një vend në një tjetër. Dikush qytetërimin e krahason me njeriun që lind, zhvillohet, plaket dhe, më në fund, ose ndërron vendin, ose vdes-zhduket. Gati të gjitha studimet e bëra shpien te konstatimi se qytetërimin e përfaqësojnë:

- Institucioni i pushtetit me të gjitha elementet e tij në favor të mirëqeverisjes, mbrojtjes së lirive të përgjithshme, implementimit të legjislacionit, të drejtave të njeriut, sigurisë qytetare dhe të kapitalit, si dhe mbrojtjes së dinjitetit njerëzor.
- Studimet dhe arritjet shkencore në shumë fusha të dijes, qofshin ata teorike apo empirike, që çojnë në ngritjen e mënyrës së jetesës dhe avancimin e saj në kuptim të mirëqenies individuale dhe të asaj së përgjithshmes shoqërore.
- Zhvillimi i arteve të ndryshme, ngase artet janë pjesë e qytetërimit dhe pasqyrë e një populli të qytetëruar.

[15] Shih, Dr. Sejjid Husein Nasr, burim i cituar fq. 23.

[16] Dr. Umer Sulejman Abdull-llah El-Eshkar, “Nahve thekafetin islamijetin esiletin”, bot. i 12të, fq. 27, “Daru En-Nefaisi” Jordan, 2002.

- Ruajtja e adeteve, traditës dhe trashëgimisë kulturore popullore të një vendi"[17].

Sipas konceptit shkencor, qytetërimi përfaqëson një progres, një përparim, një mënyrë të jetuari në mirëqenie, në siguri, në qetësi, si rrjedhim i përfitimit nga frytet e shkencave, dijeve, progresit teknik etj.

Sipas **Malik Bin En-Nebij** çdo shoqëri doemos kalon tri faza gjatë zhvillimit:

- Fazën e paraqytetërimit,
- Fazën e qytetërimit dhe
- Fazën e pasqytetërimit.[18]

Malik Bin En-Nebij e heton një lidhshmëri ndërmjet zhvillimit kognitiv të fëmijës dhe zhvillimit psiko-social të shoqërisë. Sipas tij, shoqëria kalon nëpër tri periudha, mu si fëmija që në fazën e parë i njeh gjërat, më tej personat dhe në fazën e fundit, botën e ideve. Pra, bëhet fjalë për:

1. Periudhën e gjërave
2. Periudhën e personave dhe
3. Periudhën e ideve.[19]

Qytetërimi sipas Islamit

Edhe pse për materien-baltën, nga e cila është krijuar njeriu, Kur'ani flet qartë e bindshëm, për mënyrën e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, nëpër periudha të ndryshme kohore e historike, nuk kemi qartësi të mjaftueshme e të argumentuar në Kur'an. Krejt çka dimë është ajo që ka cekur Kur'ani në ajetet 30-32 të sures "El-Bekare":

[17] Më gjerësisht shih: Nuhbetun Min El-Esatidheti, "Dirasatun Fi El-Hadareti El-Islamijjeti", fq. 70, Kajro, 1983.
[18] Mr. Ali Pajaziti, Malik Bin Nebij-Dëshmitari shekullit XX", "Edukata Islame" nr. 71, fq. 151, Prishtinë, 2003.
[19] Mr. Ali Pajazit, "Malik Bin Nebij-Dëshmitari i shekullit XX", "Edukata Islame" nr. 71, fq. 151. Prishtinë, 2003.

"30.** (Përkujto Muhammed)* ***Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës** (mëkëmbës)**"! Ata** (engjëjt) **thanë: "A do të vësh në te atë që bënë çrregullime dhe që derdh gjaqet, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe të adhurojmë plotësisht"! Ai** (All-llahu) **tha: "Unë di atë që ju nuk dini"!

31. E Ai** (Zoti)* ***ia mësoi Ademit të gjithë emrat** (e të gjitha sendeve),* ***pastaj ata ua paraqiti engjëjve dhe u tha: "Më tregoni për emrat e këtyre** (sendeve të emërtuara),* ***nëse jeni të drejtë"

32.** (Engjëjt)* ***"thanë: Ti je i pa të meta, ne nuk kemi dije tjetër përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet, Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti!"

Në këto ajete, Kur'ani hedh dritë mbi ngjarjen më të rëndësishme të historisë njerëzore, atë të krijimit të njeriut të parë-Ademit a. s.. Duke ditur se Kur'ani është fjalë e All-llahut, ai na pajis me diturinë më autentike, dituri e cila na mëson dhe na jep informacion jo vetë lidhur me krijimin e njeriut, por gjithashtu edhe mbi qëllimin e këtij krijimi. Natyrisht kjo dije autentike është shumë më thelbësore më e saktë dhe krejtësisht origjinale karshi spekulimeve të ndryshme, të ashtuquajtura shkencore, që propagandojnë teorinë e evolucionit dhe përsosmërisë së krijimit të njeriut.

Njeriu është një krijesë E All-llahut e krijuar prej materie - balte. Pjesa trupore e tij që bënë jetë kalimtare dhe shpirtit i cili është pjesë e frymës së Shpirtit të Krijuesit të gjithësisë, i cili është i amshueshëm. All-llahu i ka dalluar njerëzit me atë që e ka dalluar Ademin, u ka dhënë mendjen, dituri-inteligjencë, shpirt dhe i ka bërë mëkëmbës të Tij në sipërfaqe të Tokës. E gjithë kjo vërteton se njeriu është një lloj krijese me premisa hyjnore, i veçantë dhe i dalluar nga gjithë krijesat tjera në aspektin e krijimit shpirtëror, sepse All-llahu nuk i ka fisnikëruar ato më atë që ka fisnikëruar njeriun, me shpirt nga frymë e Tij dhe mendje-dituri nga dija e Tij, dhe mu për këtë, obligimet, përgjegjësitë dhe mëkëmbësia në tokë i takon vetëm njeriut.

Në botëkuptimin islam, dalja e njeriut në këtë botë ka nisur me Ademin a.s.. Ai është njeriu i parë, pejgamberi i parë dhe prijësi i parë

i përkryer, por nuk ka dyshim se ishte njeri i qytetëruar. Ai ishte qeliza e parë e një rendi shoqërie të qytetëruar që do të formohej me premisa hyjnore. Ai kishte marrë Dërgatë nga ana e Zotit për të rregulluar jetën shpirtërore dhe fizike të tij dhe të pasardhësve në sipërfaqen e dheut. Gjithnjë sipas Islamit, njeriu është një krijesë e veçantë, e ndershme, të cilën e ka dalluar i Madhi Zot ndaj shumë krijesave të tjera. Njeriut nuk mund t'i jepen as atributet e Zotit e as ato të kafshës. Nëse mohohet krejt hyjnorja e tij, kjo nuk do të thotë se verifikohet shtazarakja e tij. Njeriu është një lloj krijese e shkëlqyer, të cilin e ka nderuar i Lartmadhëruari me mendje, vullnet dhe shpirt.

Përgjegjësia dhe mëkëmbësia e njeriut në sipërfaqe të tokës

Islami e shpall dhe e ngreh lart fisnikërinë e njeriut. Ai e ka vënë njeriun në pozitë të mëkëmbësit të Zotit në sipërfaqe të tokës. Kjo përgjegjësi buron dhe hetohet nga brenda, nga zemra, nga besimi dhe bëhet pjesë e njeriut, ngase ai tani si krijesë e qytetëruar, nuk ka frikë ligjin policor, por ka një dashuri të madhe dhe respekt ndaj ligjeve hyjnore dhe një frikë tjetër të madhe, e cila është e mbrojtur me respektin dhe dashurinë për Zotin xh.sh. e, që këto janë elemente të qytetërimit.

All-llahu i Lartë, krijuesi dhe sunduesi i gjithësisë, dëshiroi të krijojë njeriun, më të nderuarin e krijesave, me qëllim që ai ta njohë ekzistencën e Tij, ta adhurojë, t'i bindet, ta rregullojë faqen e tokës dhe mëkëmbësia e Zotit në tokë - (خَلِيفَةُ اللهِ فِي ا لأَرْضِ) t'i dhurohet njeriut. Dhe, ky nderim që iu bë krijesës - njeriut ka vënë në dilemë melekët-engjëjt, të cilat, me gjasë, e kishin pritur që ai nder t'u jepet atyre:

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلاَئِكَةِ إِنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً قَالُوا أَتَجْعَلُ فِيهَا
مَنْ يُفْسِدُ فِيهَا وَيَسْفِكُ الدِّمَاءَ وَنَحْنُ نُسَبِّحُ بِحَمْدِكَ وَنُقَدِّسُ لَكَ
قَالَ إِنِّي أَعْلَمُ مَا لاَ تَعْلَمُونَ*(البقرة /30

"Dhe** (Përkujto Muhammed) **Kur Zoti yt u tha melekëve-engjëjve: "Unë do të bëj** (do përcaktoj) **në tokë një mëkëmbës "! Ata thanë: "A do të vësh në të atë që bën çrregullime dhe që derdh gjaqet, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe të shenjtërojmë" ! Ai** (All-llahu) **u tha: Unë di atë që ju nuk dini"![20]

Është All-llahu ai që e ka nderuar njeriun, i Cili në të ka fryrë prej shpirtit të Vet, i Cili i ka dhënë formën më të bukur, e ka bërë mëkëmbës të Vetin dhe ia ka dhënë në shërbim të gjitha të mirat dhe begatitë që i nevojitën atij, për ta bërë një jetë të qytetëruar, konform ligjeve hyjnore.

Termi *"Halif"* (zëvendës-mëkëmbës), i theksuar në Kur'anin famëlartë, është përdorur për identifikimin e dikujt që është i qytetëruar dhe është në gjendje të menaxhojë, që është administrues i çdo gjëje që është në tokë, por që vepron konform me normat dhe ligjet e një autoriteti më të lartë se vetë njeriu. Në këtë rast Autoriteti më i lartë është All-llahu, ndërsa "*halif*" është njeriu, të cilit All-llahu i dha të drejtën e sundimit e administrimit të Tokës me emrin e Tij, i mësoi emërtimin e të gjitha sendeve e të dijeve dhe i dha mprehtësinë e nevojshme për një qellim të tillë, duke kërkuar prej tij edhe llogaridhënie.

Tërë atë që e ka arritur njeriu për ta çuar përpara jetën e tij gjatë historisë, është produkt i mendjes, e cila ka premisa hyjnore. Atje ku mendja konsumohet, përparimi vazhdon në saje të veprimtarisë ndjesore të zemrës. Mirëpo edhe kjo, madje, nuk është e mjaftueshme për t'ia arritur të vërtetës absolute dhe qytetërimit të mirëfilltë. Me gjithë mendjen që i është dhuruar njeriut nga Krijuesi i tij, ai asnjëherë nuk do të qytetërohej dhe asnjëherë nuk do të gjente udhën e drejtë po të mos ishte udhëzimi hyjnor nga ana e Krijuesit.

[20] Kur'ani El-Bekaretu, ajeti 30.

Dhënia e Universit në Shërbim të njeriut

Krijuesi i Gjithësisë njeriun e ka veçuar në raport me krijesat e tjera edhe me nderimin që i ka bërë duke e favorizuar me dhënien dhe lënien e gjithësisë në shërbim të tij. Ai i ka lënë në dispozicion njeriut për t'i shfrytëzuar qiejt e Tokën dhe gjithë ato të mira materiale e begati që kanë ato në shërbim të mirëqenies së njeriut e për ta bërë atë të lumtur, dhe krejt kjo është bërë me qëllimin që ai të bëhet i qytetëruar, të njohë Krijuesin e tij, t'i falet Atij dhe të zbatojë ligjet e Tij hyjnore. Në Kur'an, në suren "Lukman", thuhet decidivisht:

أَلَمْ تَرَوْا أَنَّ اللَّهَ سَخَّرَ لَكُمْ مَا فِي السَّمَاوَاتِ
وَمَا فِي الْأَرْضِ وَأَسْبَغَ عَلَيْكُمْ نِعَمَهُ ظَاهِرَةً وَبَاطِنَةً...* (لقمان /**20**)

"A nuk e shihni ju** (o njerëz) **se All-llahu ua ka nënshtruar për të mirën tuaj gjithçka ka në qiej dhe gjithçka ka në tokë dhe i ka plotësuar e përsosur mirësitë e Tij mbi ju të dukshme e të fshehta…!"[21]

Universi i është dhënë në dispozicion njeriut, e njeriut i takon që mbështetur në dhuntinë tjetër nga All-llahu, atë mendore, t'i hulumtojë, t'i studiojë e t'i gjejë sekretet e gjithësisë dhe t'i shfrytëzojë gjërat që i sjellin atij qytetërim, mirëqenie dhe lumturi. Në kohën e fundit, kur popujt myslimanë, për fat të keq, janë tërhequr prej dominimit dhe fushës së udhëheqjes së botës njerëzore qytetëruese islame, e janë mbyllur në kornizat e veta lokaliste e kombëtare, si kundërreagim, janë aktivizuar ideologji dhe filozofi të mbrapshta shkatërruese.

Meqë njeriu është vënë me një sprovë të vështirë, All-llahu vendosi që të mos e linte që ai vetë të hulumtojë për të gjetur rrugën e drejtë, rrugën e qytetërimit, ngase ai nuk është krijesë e pa të meta. Një gjë e tillë mund të përmbushet vetëm me anë të institucionalizimit të profecisë. Boshllëku në natyrën e njeriut mund të mbushet vetëm du-

[21] Kur'ani, sureja Lukman, ajeti 20

ke ndjekur mësimet dhe porositë e profetëve, mësime të cilat e kanë origjinën e tyre tek shpalljet e All-llahut.

Kontaktet e fesë dhe qytetërimit islam me fenë dhe qytetërimin krishterë dhe atë hebraik fillojnë që nga koha e Muhammedit a.s.. Feja islame duke pasur parasysh vlerat e saja të theksuara që përmban dhe se Islami është përkryerja e shpalljeve hyjnore, njëkohësisht thekson lidhje mbi besimin hebraik dhe atë të krishterë... Me gjithë tolerancën që ka Islami nga ana tjetër, besimi i hebrenjve dhe të krishterëve në islam llogariten dhe përshkruhen si devijim, ndryshim i formës dhe mënyrës nga mësimi i hershëm i pastër monoteist i tyre. Dhe, ata akuzohen gjithashtu se kanë falsifikuar librat e tyre "Tevratin" dhe "Inxhilin" (Toren dhe Ungjillin).

Si një shembull i marrëdhënieve të suksesshme mes të hebraizmit, krishterimit dhe islamit, mund të përmendet edhe koha e jetesës së Muhammedit a.s. në Medinë nën hijen e qytetërimit islam. Hebrenjtë dhe të krishterit, gjatë kohës se Pejgamberit a. s. ndiheshin të nderuar, më qe feja e tyre pranohej nga muslimanët se ekzistonte, nga ana tjetër, jo të gjithë e njohën, pra nuk e pranuan të gjithë banorët e Medinës për Pejgamber Muhammedin a.s..

Në Kur'an decidivisht thuhet:

"As jehudët, e as të krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty deri atëherë kur të pasosh fenë e tyre. Thuaju: "Udhëzimi i All-llahut është udhëzim i drejtë. E nëse, pasi që të ka ardhur ty e vërteta, shkon pas mendimeve të tyre, nuk ka kush të ndihmojë e as të mbrojë nga All-llahu".[22]

Islami është një qytetërim që u ndërtua me emrin e All-llahut dhe mbikëqyrjen e Tij, u ngjyros me ngjyrën e All-llahut dhe u ngrit mbi bazën e besimit-imanit, dhe mu për këtë arsye, qytetërimi islam nuk mund të zhvishet nga natyra fetare. Besimi në Një Zot të vetëm (monoteizëm) është rruga e moralitetit njerëzor, i cili krahas deklarimit se besojmë, duhet të manifestohet edhe me vepra të mira dhe të vlefshme.

[22] Kur'ani, sureja El –Bekare, ajeti,120.

Është edhe një realitet që duhet cekur dhe duhet ta ketë në mendje çdo mysliman: qytetërimi islam nuk mund ta kryejë rolin e ndikimit në qytetërimin njerëzor- botëror, nëse bëhet imitues a vjedhës i qytetërimeve të tjera. Kështu, ai rrezikon dhe nuk mund ta ruajë identitetin e vet, e lëre më t'i shtyjë popujt e tjerë ta përvetësojnë atë! Ndikimin mund të arrijë vetëm nëse myslimani beson bindshëm se qytetërimi i tij është i pavarur, me identitet të posaçëm hyjnor qiellor, i vlefshëm për çdo kohë e vend, i ngritur mbi baza të forta, i mbështetur në Kur'anin dhe hadithet e Pejgamberit a.s..

Qazim Qazimi

THE HOLY PREMISES OF ISLAMIC CIVILIZATION- THOUGHTS AND IDEAS REGARDING CIVILIZATION

(Summary)

And they say (the nonbelievers): Why was not this Quran revealed to a man of importance in the two towns (Mecca and Taif, settlements with ancient civilizations)?

The Holy Quran has dealt with the issue of civilization. In a number of ayats the notion al-Qarya is used to denote civilization.

Mecca is entitled Umm al-Kura, the Mother of Villages, as well as the cradle of civilization. This is due to the role it played in Islamic and world civilization.

كاظم كاظمى

تأملات في الحضارة الاسلامية آراء و افكار حول الحضارة

(خلاصة البحث)

و قالوا لو لا نزل هذا القرآن على رجل من القريتين عظيم (الزخرف/31).

تطرق القرآن الكريم إلى قضية الحضارة في عشر آيات من سور مختلفة و قد ورد ذكر "القرية" بمعنى الحضارة.

و قد تم ذكر مكة بمثابة مكان للحضارات القديمة "بأم القرآ" باعتبارها مهدا للحضارة لدورها في الحضارة الاسلامية و العالمية أيضا.

FILOZOFI ISLAME

Nexhat Ibrahimi

VENDI I FILOZOFISË ISLAME NË SISTEMIN FILOZOFIK BOTËROR

- Skicë -

Fillimi i mendimit filozofik

Zhvillimi i mendimit njerëzor dhe krijimi i njeriut fillojnë para historisë së shkruar, me shfaqjen e ndjenjës së 'habisë' dhe të 'kuriozitetit' njerëzor: Kush jam unë?, Nga jam unë?, Përse ekzistoj unë?, Çfarë janë në të vërtetë sendet?, Si mund ta shpjegojmë procesin e ndryshimit të sendeve?! Faktet si lindja, vdekja, rritja dhe shkatërrimi ngrenë jo vetëm pyetje? Kudo që ka jetuar apo kudo që ka lëvizur njeriu, atë e ka përcjellë cilësia e të menduarit, e të kuptuarit dhe e gjykimit. Për historianin e filozofisë nuk është me rëndësi cilësia e pyetjeve të tyre të çmendura dhe përgjigjet idiote të tyre dhe e gjithë kjo nuk ka ndonjë interes të veçantë për ne sot.

Mirëpo, për mendimet e pashkruara të njeriut nuk kemi të dhëna, përveç atyre të zbuluara nga zbulimet arkeologjike, atyre të shpellave apo të dhënave nga librat që historia i quan të shenjta apo janë të shenjta. Por, me fillimin e paraqitjes së shkrimit, gjërat filluan të ruhen,

kurse rrjedhat historike kalonin më tej. Mendimi njerëzor që ka të bëjë me dijen mbi ekzistencën për fillimin dhe fundin e saj fillimisht qe përzier me bindjet fetare dhe këtë fillim filozofik do të duhej kërkuar ndër mendimet fetare në Orient [1], e jo drejtpërdrejt në Greqi, siç pretendojnë shumica e filozofëve evrocentristë.[2]

Historianët evrocentrisë të filozofisë besojnë se përmbledhjet më të vjetra të plota filozofike apo kryesisht filozofike lidhen për urtakët grekë të cilët kanë jetuar rreth gjashtë shekuj para Isait a.s.. Përmenden dijetarët e asaj kohe të cilët janë përpjekur ta njohin ekzistencën dhe fillimin dhe fundin e kozmosit. Duke iu shpjeguar paraqitjet dhe ndryshimet e shumta në ekzistencë, ata kanë shprehur mendime të ndryshme, herë-herë edhe kundërthënëse, por njëkohësisht nuk e kanë fshehur faktin se mendimet e tyre kanë qenë, pak a shumë, nën ndikimin e mësimeve fetare orientale dhe të kulturës orientale.

Filozofi Veljaçiq mendon se historia e filozofisë fillon më herët se ajo greke, madje ai pohon se "dy kulturat e mëdha aziatike, induse dhe kineze, e arrijnë zhvillimin të tyre kah mesi i mijëvjeçarit të fundit të erës së vjetër, në epokën e cila në historinë e kulturës quhet aksiale" dhe e cila shtrihet nga Kina e deri në Detin Mesdhe"[3]. Madje, edhe Hegeli evrocentrist kah fundi i jetës ishte më fleksibil në këtë aspekt, duke njohur ekzistimin e vlerave filozofike edhe para se ajo të fillonte në Evropë dhe jashtë Evropës.[4]

Mirëpo, gabimin që e kanë bërë hulumtuesit e historisë së filozofisë duke injoruar filozofitë tjera nga një anë dhe aftësia hapësinore dhe kontaktet fizike me Greqinë, nga ana tjetër, nuk do të na mjegullojë mendjen që të mos e pranojmë se "terreni më i mirë dhe më i përshtatshëm për zhvillimin dhe përparimin e filozofisë qe Greqia. Edhe Thalesi, edhe Anaksimandri dhe dijetarë e filozofë të tjerë do të sjellin

[1] Krhs.: Cedomil Veljacic, Razmedja azijskih filozofija, libri i dytë, Zagreb, 1978, fq. 484-487.

[2] Shih: Bertran Rasëll, Një histori e Filozofisë Perëndimore, libri i parë, Tiranë, 2004, fq. 3 e tutje; Zhan Hersh, Habia filozofike, Tiranë, (-), fq. 5 e tutje; Samuel Enoch Stumpf, Filozofia, Tiranë, (-), fq. 3 e tutje.

[3] Cedomil Veljacic, libri i parë, op. cit., fq. 10 e tutje.

[4] Sipas: Cedomil Veljacic, libri i parë, op. cit., fq. 10-11 dhe 12.

në Greqi dituri dhe përvoja të vlefshme nga udhëtimet e tyre në Lindje dhe në Egjipt. Natyrisht, mendimet e para as te grekët nuk qenë të sistemuara dhe klasifikuara sa duhet, as nuk ekzistonin kategori dhe metoda të veçanta, por tashmë kishte filozofi me plot kuptimin e fjalës. Të gjitha idetë quheshin shkencë, urtësi dhe njohje (kognitim)"[5] etj..

Shfaqja e sofizmit dhe skepticizmit

Në shekullin V p.e.r. përmenden dijetarët që në greqisht quheshin *sofistë*, respektivisht urtakët e ditur. Përkundër të dhënave që kishin për dijen, sofistët nuk besonin në të vërtetat e qëndrueshme dhe të pandryshueshme dhe asgjë nuk konsideronin përfundimisht të njohur dhe të besueshme.

Si transmetojnë historianët e filozofisë, sofistët me profesion ishin mësues të cilët e mësonin retorikën dhe udhëheqjen e debateve dhe i aftësonin avokatët për gjykata.

Puna i tyre i ngjan asaj të rrëfimit të një njeriu, i cili një ditë në shaka gënjeu se në atë shtëpi po ndahen ëmbëlsira. Njerëzit filluan të nxitojnë drejt shtëpisë në fjalë. Pak nga pak, njeriu që gënjeu filloi të mendojë dhe shpresojë në vërtetësinë e këtij pohimi. Më në fund edhe vetë u vendos në rend duke pritur ëmbëlsira pa para.

Siç duket, sofistët u bënë viktimë të fatit të njëjtë. Duke i aftësuar të tjerët që me metoda të rrejshme të dëshmimit dhe mohimit, gradualisht këtë pririe filluan të bëjnë pjesë të tyre, dhe këto pririe të bëhen për ta të vetmet të drejta. Fjala sofizëm, që fillimisht kishte kuptimin e njerëzve të ditur, me kalimin e kohës mori kuptim tjetër, kuptimin e mashtruesit etj.[6]

[5] A. M. Yazdi, Islamska filozofija, 1, Sarajevë, 2004, fq. 11-12.

[6] Samuel Enoch Stumpf, op. Cit., fq. 29-33. Nedim El-Dzisr, Vjerovanje u Boga u svjetlu filozofije, nauke i Kur'ana, Botimi II, Sarajevë, 1984, fq. 19-20.

Epoka e lulëzimit të filozofisë

Mendimtari më i njohur i cili u ngrit kundër sofitëve dhe i kritikoi qëndrimet e tyre ishte Sokrati. Ai veten e quajti filozofus (simpatizues i filozofisë). Kjo shprehje në arabisht e mori trajtën e njohur *fejlesuf*, nga doli edhe termi për filozofinë – *felsefeh*.

Pas Sokratit, erdhi Platoni, i cili në fillim ligjëronte sipas bindjeve të mësuesit, por më vonë ai formoi filozofi të veten, që kjo filozofi të kulmojë me Aristotelin, filozofin më të madh klasik.

Nga Sokrati shprehja *filozofi* përdorej si kundërshtim të shprehjes *sofizëm*, kurse përfshinte fizikën, kiminë, medicinën, astronominë, matematikën dhe teologjinë. [7]

Në atë kohë filozofia ndahej në dy grupe kryesore: teorike dhe praktike. Në grupin teorik bënin pjesë shkencat natyrore, matematika dhe teologjia. Në grupin praktik bënin pjesë: etika, ekonomia shtëpiake dhe politika.[8]

[7] Zhan Hersh, op. Cit., fq. 16-21.

[8] A. M. Yazdi, op. cit., fq. 14. Nedim El-Dzisr, Vjerovanje u Boga u svjetlu filozofije, nauke i Kur'ana, Botimi II, Sarajevë, 1984, fq. 12-13.



Fundi i filozofisë greke dhe epoka e krishterimit

Pas Platonit dhe Aristotelit, nxënësit e tyre një kohë kryesisht janë marrë me punë kompilative dhe me sistemimin dhe përpunimin e veprave të mësuesve të tyre. Puna e tyre, megjithatë, e ka mbajtur të freskët tregun shkencor-dituror. Por, nuk zgjati shumë dhe filloi dobësimi dhe stagnimi. Greqia mbeti e shkretë, sepse shkenca dhe dituria kaloi

në Aleksandri. Këtë primat Aleksandria e mbajti deri në fund të shekullit IV të e.r.[9]

Mirëpo, me zyrtarizimin e krishterimit në shekullin IV dhe me përhapjen e fesë krishtere, filloi kundërvënia ndaj shkencës dhe diturisë, që të marrë fund kjo në kohën e Justinianit në vitin 529 e.r., kur ky perandor i Bizantit urdhëroi mbylljen e shkollës së Athinës dhe Aleksandrisë. Dijetarët për të shpëtuar kokën ikën nëpër vende të ndryshme, kurse shkenca e dijes dhe e filozofisë u fik në Perandorinë Romake.

Dalja në skenë e Islamit

Po në këtë shekull, në pjesën tjetër të botës, ndodhi ngjarja më e madhe në historinë njerëzore. Lindi, u rrit, dhe veproi pejgamberi mysliman, Muhammedi a.s. (570-632). Ai filloi së pari të kërkojë që njerëzia të mësojë, lexojë dhe shkruajë, dhe atë "qoftë edhe në Kinë", madje "prej djepit deri në varrë", me çfarëdo çmimi.

Fidani produktiv islam, i mbjellë me dorën e Muhammedit a.s., në dritën e Shpalljes hyjnore, lëndën e parë të mendimit njerëzor e absorboi dhe me normat hyjnore, e ndryshoi në kritikë konstruktive dhe për një kohë të shkurtër e shpërndau hijen e tij në të gjitha kulturat e botës. Të trimëruar nga Muhammedi a.s. dhe nga pasardhësit e tij, myslimanët filluan të përvetësojnë dituri të ndryshme. Trashëgimia shkencore greke, romake, iraniane e të tjera janë përkthyer në gjuhën arabe. Këtyre përkthimeve iu dha kontributi mysliman me hulumtime të reja, për të arritur zbulime të jashtëzakonshme në algjebër, trigonometri, astronomi, fizikë dhe kimi.[10]

Faktor tjetër i zhvillimit të kulturës islame ishte politika. Drejtimi shiit mendon se edhe emevitët edhe abasitët duke favorizuar dituritë e huaja kishin për qëllim të afrojnë rreth vetes dijetarë për t'iu kundërvënë shkollës së ehli-bejtit. Mirëpo, mendojmë se një gjë e tillë nuk

[9] Samuel Enoch Stumpf, op. cit., fq. 105-125. Zhan Hersh, op. cit., fq. 22-60.

[10] Për periudhën e përkthimeve dhe të shkrimeve origjinale në shkenca të ndryshme dhe në filozofi shih veprën autoritative të: Ahmed Fuad El-Ehwani, Filozofia islame, Prizren, 2002, fq. 38-58.

qëndron dhe nuk është parim i atyre dinastive. Është e vërtetë se shkenca dhe filozofia islame filloi të prodhojë personalitete gjeniale, të cilët do të ofrojnë fryte të pasura për kulturën dhe qytetërimin botëror. Përkundër problemeve, kundërshtimeve dhe përkrahjeve, shumica e dijetarëve dhe filozofëve myslimanë kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm,[11] që do të çmohet deri në ditët tona.

Zhvillimi i filozofisë në epokën islame

Me përhapjen e Islamit në vende të reja, shumë qendra të shkencës Aleksandria, Xhundi Shapuri, Damasku etj., kaluan nën ombrellën islame. Filloi një erë e re, era e mirëkuptimit dhe e këmbimit të ideve e dijetarëve dhe librave e bibliotekave; filloi përkthimi i librave nga gjuhë të ndryshme: nga indishtja, persishtja, greqishtja, latinishtja, arameishtja, hebraishtja etj. në arabishte. Menjëherë pas periudhës së përkthimit filloi periudha e prodhimeve origjinale dhe lindja e një literature të pasur së pari nga mjekësia, astronomia, matematika, farmakologjia e që pastaj të fillojë edhe në filozofi dhe shkencat tjera.

Problemet dhe mangësitë e para rreth koncepteve dhe terminologjisë shkencore e filozofike me kalimin e kohës filluan të zgjidhen me punën e madhe të Kindiut, Farabiut, Ibn Sinait dhe të tjerëve më vonë. Këtë punë të tyre më vonë e kritikoi Gazaliu, F. Raziu etj., por e mbrojti Ibn Rushdi etj. E gjithë kjo ndihmoi që ideja filozofike të zhvillohet në kulminacion, e cila do të reflektojë me shekuj të tërë.[12]

Nga filozofia skolastike deri te Kanti

Pas përhapjes së krishterimit në Evropë dhe përqendrimit të fuqisë së Kishës dhe të Perandorisë Romake, qendrat shkencore deri atëherë aktive erdhën nën ndikimin e pushtetit dhe deri në fund të shekullit VI u mbyllën të gjitha shkollat. Kjo periudhë që zgjati rreth një mijë vjet,

[11] Shih një libër të shkëlqyeshëm për këtë temë: Sigrid Hunke, Dielli i Allahut shkëlqen mbi Perëndimin, Tiranë, 2007, fq. +423.

[12] Shih shkrimin tone me titull: Zhvillimi i terminologjisë filozofike islame në Mesjetë, botuar në: Terminologjia islame, Prishtinë, 2006, fq. 65-80.

e që quhet mesjetë, karakterizohet me epërsinë dhe dominimin e Kishës mbi shkencën.

Ndër autoritetet e dalluara të kësaj kohe e kemi Shën Augustinin, i cili nëpërmjet filozofisë së Platonit dhe të neoplatonistëve u përpoq t'i shpjegojë dogmat krishtere. Kjo periudhë është në dëm të filozofisë së Aristotelit, sepse konsiderohej si kundërshtar i mësimeve fetare. Si të tilla mësimet e tij qenë ndaluar.[13] Mirëpo, depërtimi i Islamit në Spanjë dhe më pak në pjesë të tjera të Evropës, nëpërmjet mësimeve filozofike të Ibn Sinanit dhe Ibn Rushdit, Evropa filloi të njoftohej me Aristotelin dhe trashëgiminë tjetër.

Kjo ndikoi që kundërshtimi i Aristotelit në Evropë të dobësohet e në disa vende edhe të marrë hov mësimi i tij, sidomos me Toma Akuinin, i cili quhej edhe averroist.[14]

Është e qartë se gjatë mesjetës filozofia në Evropë nuk u zhvillua, madje u dobësua. Nga ana tjetër, derisa filozofia në vendet myslimane zhvillohej në përmasat dhe llojet më të ndryshme, filozofia në Evropë ishte në shërbim të Kishës dhe zhvillohej vetëm ai segment që mbronte dogmat krishtere. Kjo periudhë quhej filozofi skolastike dhe janë zhvilluar pjesërisht logjika, teologjia, etika, politika, aspekte të astronomisë, gramatika dhe retorika.

Pas kësaj periudhe pason periudha e renesansës, e konflikteve brendafetare dhe nacionale, periudha e paraqitjes së protestantizmit, kështu që filozofia skolastike pësoi fund.[15]

Më pastaj kemi paraqitjen e interesimit për shkencë, Koperniku, Kepleri, Galileu e të tjerë e lëkundën shkencën e dikurshme, i lëkundën themelet e Papatit. Ky stagnim, kjo rënie shkaktoi paraqitjen e skepticizmit modern e më vonë edhe të lulëzimit të shkencave empirike në planin kulturor dhe paraqitjes së liberalizimit dhe demokracisë në planin politik.

[13] Gjerësisht: Samuel Enoch Stumpf, op. cit., fq. 129-145.

[14] Toma AkuIni ishte nën ndikimin e Averroesit dhe të filozofisë islame. Shih: Enoch Stumpf, op. cit., fq. 129-145.172 e tutje; Krhs. edhe: Cedomil Veljacic, libri i dytë, op. cit., fq. 400.

[15] Samuel Enoch Stumpf, op. cit., fq. 168-192.

Meqenëse Kisha shumë qëndrime të filozofëve i kishte përvetësuar si mësime fetare, me zbulimet e Kopernikut, këto hipoteza i refuzuan shkencëtarët bashkëkohorë. Ky refuzim i tyre rezultoi me krizën psikike të tyre në të vërtetat fetare, dogmat kishtare: si mund të jemi të sigurt që edhe bindjet tona të tjera nuk janë të gabueshme? Si të jemi të sigurt se teoritë e reja një ditë nuk do të refuzohen? Kjo ishte faza e dytë e skepticizmit në historinë e mendimit filozofik dhe në përgjithësi.

Paraqitja e skepticizmit nga një anë rrezikoi vlerat dhe të arriturat shkencore, por nga ana tjetër, ajo rrezikoi edhe vlerat fetare e morale. Asnjë vlerë etike, juridike, politike dhe fetare nuk mund të jetë e fuqishme para dhunës, krimit dhe persekutimit që e shkakton skepticizmi. Prandaj, lufta kundër skepticizmit është luftë e të gjithëve, e politikanëve, reformatorëve, filozofëve, teologëve etj.

Në shekullin XVII Kisha, duke parë gabimet e së kaluarës, filloi të lirohej, ta lërë të lirë arsyen dhe shkencën, duke e forcuar doktrinën e zemrës dhe të besimit. Por, filozofia dhe filozofët kërkonin bazë të fortë që të mbrohen nga hamendjet intelektuale dhe kthesat shoqërore.

Mirëpo, filozofia mori krahët me paraqitjen e Rene Dekartit, filozofit francez, Leibnicit, Spinozës dhe Malebranches, edhe pse jo në shkallën e dëshiruar dhe të nevojshme.

Krahas filozofisë racionale, në Angli filloi të zhvillohet edhe filozofia empirike, nëpërmjet Williamit, Francis Baconit, Hobbesit, John Locke, George Berkeley dhe David Hume etj. [16]

Një kohë të gjatë Kanti ka medituar për problemet e filozofisë. Në fund erdhi në përfundim se mendja teorike nuk ka forcë t'i zgjidhë problemet e metafizikës dhe se parimeve racionale në këtë fushë iu mungon vlera shkencore.

Kanti shprehimisht ka konfirmuar se çështjet sikurse janë ekzistenca e Zotit, amshueshmëria e shpirtit dhe vullneti i lirë nuk mund të

[16] Samuel Enoch Stumpf, op. cit., fq. 212 e tutje.

argumentohen racionalisht., por edhe bindja dhe besimi në to janë të domosdoshme për pranimin e sistemit etik.[17]

Me vdekjen e Ibn Rushdit, më 1198, filozofia islame mbeti mbrapa. Nuk kishte zhvillim, si për shkak të faktorëve të brendshëm ashtu edhe të jashtëm. Stagnimi brenda umetit mysliman nuk ishte në favor të filozofisë. Këtë gjendje e vështirësoi edhe vazhdimi i kryqëzatave dhe kolonializImi i vendeve myslimane. Vetëm herë pas here kemi ndonjë figurë më të rëndësishme myslimane: Ibn Halduni, Ibn Tejmije, Abdulvehabi, Afganiu, Abduhuja, Kevakibi, Ikballi etj. Që nga Ibn Rushdi filozofia islame nuk pati zhvillim të theksuar, pos ndonjë glosë e superglosë, ndonjë kompilacion. Kjo gjendje filloi të ndryshojë vetëm në fund të shekullit XIX dhe gjatë shekullit XX e XXI, me Afganiun, Abduhunë, Ikballin, Ehwanin, Abdurrazikun etj., por jo sipas pararendësve të tyre.

Vendi i filozofisë islame në tërësinë e filozofisë botërore

Trajtimi i vendit, rolit dhe konsekuencave të filozofisë islame në konstelacionin e filozofisë botërore kërkon përgjigje në disa çështje kruciale:

- Çfarë është kontributi i aktivitetit filozofik të myslimanëve gjatë të kaluarës?
- A kemi filozofi origjinale myslimane apo tërë ky angazhim është vetëm përshkrim dhe ndërmjetësim ndërmjet filozofisë klasike greke dhe filozofisë së re evropiane?
- Mos ka përfunduar filozofia islame me Ibn Sinain, El-Gazaliun, Ibn Rushdin e të tjerë në kuptim se pas tyre më nuk është paraqitur mendim origjinal?[18]

[17] Samuel Enoch Stumpf, op. cit., fq. 289 e tutje.

[18] Përgjigjja në këto pyetje kërkon punë, aftësi profesionale dhe hapësirë dhe kapërcen synimet e këtij shkrimi. Mirëpo, në botën muslimane, por edhe në qendrat tjera kërkimore-hulumtuese shkencore jomuslimane janë bërë hapa të mirë në këtë rrafshë dhe është e arsyeshme të shpresojmë se do të ofrohet përgjigje më serioze në këtë aspekt. Opinioni shkencor njeh disa ndërmarrje serioze në fushën e filozofisë islame, sikurse: M. M. Sha-

Filozofia në historinë islame përbën një pjesë të shkencave islame, të cilat ose a) kanë filluar në mesin e vetë myslimanëve sikur: shkenca e tefsirit dhe hadithit, jurisprudenca islame (fikhu), dogmatika islame, sintaksa dhe gramatika e gjuhës arabe e të tjera; ose b) kanë përvetësuar nga të huajt, sikurse ndodhi me medicinën, astronominë, gjeometrinë, algjebrën, logjikën ose c) vetë filozofia dhe kanë vazhduar të zhvillohet e kultivohet në mënyrë origjinale.

Historianët e shkencës janë të pajtimit se të gjitha shkencat e përvetësuara në botën islame janë zhvilluar dhe përkryer më tej dhe se myslimanët në këtë mënyrë luajtën rol thelbësor në zhvillimin e shkencës, kulturës dhe filozofisë së njerëzimit. Rasti i Ibn Sinait dhe Ibn Rushdit në medicinë e filozofi, i Farabiut në filozofi dhe muzikë e raste tjera, janë shembulli më i mirë se dijetarët myslimanë edhe kanë përvetësuar e integruar, por edhe kanë krijuar e prodhuar.[19]

Delis Avliri në lidhje me shkencat pohon se myslimanët morën nga Grekët e vjetër: *"Atë që arabët (myslimanët) e përvetësuan nga grekët nuk e përcollën më tej në formën e pandryshueshme deri te popujt tjerë. Duhet thënë se shkenca greke në mjedisin arab (mysliman) kishte vend dhe rol të veçantë. Arabët dhanë kontribut të rëndësishëm në astronomi, matematikë dhe dituritë tjera të përvetësuara nga grekët dhe indusët, duke iu dhënë konstituim dhe metodologji të re … Duhet thënë se arabët themeluan dhe zhvilluan algjebrën, trigonometrinë dhe gjeometrinë sferike. Ata ishin mjaft të shkathët në hartimin e tabelave astronomike".*[20]

rif, Historija islamske filozofije, I-II, Zagreb, 1988; Xhemil Saliba, Mu'xhem'ul-felsefij, I-II, Bejrut, 1414 h./1994 etj.

Në gjuhën shqipe shih: Sami Frashëri, Qytetërimi islam, Shkup, 2002; Nexhat Ibrahimi, Aspekte të kontributit të Sami Frashërit në islamologji, Referat i lexuar në: Konferenca shkencore Shemseddin Sami Frashëri – 100 vjet pas, 19-20 Nëntor 2004, Shkup etj.

[19] Grup autorësh, Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu, Sarajevë, 1987. Rozhe Garodi, Islami dhe Kultura, Sarajevë, 1990. Cedomil Veljacic, II, op. cit., fq. 400-401.

[20] http://www.ibn-sina.net/txt/tekstovi.asp?tekst_id=23. Nedim El-Dzisr, op. cit., fq. 34.

Përmbyllje

Njeriu filloi të meditojë që nga fillimi i ekzistencës së tij. Pas një kohe të gjatë, këto meditime rezultuan në diturinë të quajtur *filozofi*. Fillimet e para filozofia duhet t'i kërkojë në Lindje, që më vonë ato të marrin formën më të plotë me Greqinë e vjetër. Për shkak të konflikteve të brendshme, por edhe të paraqitjes së krishterimit, filozofia për një kohë humbi. Gjetjen e fillit dhe zhvillimin e saj e mundësuan myslimanët në shekujt 9 e pas, duke e përkthyer trashëgiminë e vjetër greke, iraniane, fenikase, semuriane, egjiptiane, induse etj., dhe duke e përpunuar dhe më pastaj për ta prodhuar edhe atë origjinale. Emrat e Kindiut, Farabiut, Ibn Sinait, Gazaliut, Ibn Rushdit, Ibn Baxhes, Ibn Tufejlit, Ibn Haldunit dhe plejadës së disa filozofëve të tjerë, janë për çdo respekt. Atë që e përjetoi filozofia në Evropë nga shekulli I e deri pas mesjete, myslimanët e pësuan nga shekulli XIII e deri në shekullin XIX sidomos, por edhe deri në ditët e sotme në masë më të vogël.

Megjithatë, filozofia e ka vendin e saj në mesin e diturive shkencore. Ajo mund ta luajë rolin pozitiv në doktrinën islame dhe në atë botërore dhe këtë po përpiqet ta bëjë. Së paku filozofia islame këtë rol po e luan. Muhamed Ikballi, Ali Sheriati, Muhammed Behiu, El-Ehwani, Sejid Husein Nasri, El-Attasi e të tjerë janë ambasadorë të vyeshëm në prezantimin e vlerave islame para vetë myslimanëve dhe jomyslimanëve.

Literatura:

- M. Yazdi, Islamska filozofija, 1, Sarajevo, 2004.
- Ahmed Fuad El-Ehwani, Filozofia islame, Prizren, 2002.
- Bertran Rasëll, Një histori e Filozofisë Perëndimore, libri i parë, Tiranë, 2004.
- Cedomil Veljacic, Razmedja azijskih filozofija, libri I-II, Zagreb, 1978.
- Grup autorësh, Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu, Sarajevë, 1987.

- http://www.ibn-sina.net/txt/tekstovi.asp?tekst_id=23.
- M. M. Sharif, Historija islamske filozofije, I-II, Zagreb, 1988.
- Nedim El-Dzisr, Vjerovanje u Boga u svjetlu filozofije, nauke i Kur'ana, Botimi II, Sarajevo, 1984.
- Nexhat Ibrahimi, Aspekte të kontributit të Sami Frashërit në islamologji, Referat i lexuar në: Konferenca shkencore Shemseddin Sami Frashëri – 100 vjet pas, 19-20 Nëntor 2004, Shkup.
- Nexhat Ibrahimi, Zhvillimi i terminologjisë filozofike islame në Mesjetë, në: Terminologjia islame, Prishtinë, 2006 (Tryezë shkencore në Akademi të Shkencave dhe të Arteve të Kosovës).
- Rozhe Garodi, Islami dhe Kultura, Sarajevë, 1990.
- Sami Frashëri, Qytetërimi islam, Shkup, 2002.
- Samuel Enoch Stumpf, Filozofia, Tiranë, (-).
- Sigrid Hunke, Dielli i Allahut shkëlqen mbi Perëndimin, Tiranë, 2007.
- Xhemil Saliba, Mu'xhem'ul-felsefij, I-II, Bejrut, 1414 h./1994.
- Zhan Hersh, Habia filozofike, Tiranë, (-)

Nexhat Ibrahimi

THE PLACE OF ISLAMIC PHILOSOPHY IN THE INTERNATIONAL PHILOSOPHICAL SYSTEM

(Summary)

The emergence of philosophical thought

The development of human thought began before the beginning of recorded history due to human curiosity. Mankind has always been characterized by the ability to think, understand and judge.

نجاد إبراهيم

مكانة الفلسفة الاسلامية في النظام الفلسفى العالمى

(خلاصة البحث)

موجز:

بداية التفكير الفلسفى و خلق الانسان يبدأن قبل التاريخ المكتوب، مع ظهور اساس "التعجب" و حب الانسان للاجابة: من أنا؟ مِنْ أين اتيت؟ لماذا اعيش؟ ما هي الاشياء التي حولنا؟ كيف يمكن تفسير الاشياء؟ الحقائق مثل الولادة و الموت و النضوج و الهلاك التي بدورها تطرح اسئلة أخرى. في أى مكان عاش الانسان و تحرك فيه أتبعه التفكير و الفهم و التحكم. لمؤرخ الفلسفة ليس المهم نوعية الاسئلة المجنونة و الاجابة الفكرية عليها، كل هذا ليس مهما في الوقت الحاضر.

STUDIME

Mustafa Mlivo

KUR'ANI PËRPARA SHKENCËS DHE CIVILIZIMIT

> **"Ne, ty të shpallëm Librin** (Kur'anin), **sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për myslimanët."** (Kur'ani, 16:89)

Ajo që na bën të besojmë fuqimisht, se Pejgamberi Muhammed (s.a.v.s.) na ka shpallur të vërtetën e pacenuar është fakti se Mesazhi i tij është i pasur me fakte shkencore të veçanta që shumë njerëz në kohën e tij madje as nuk mund t'i parafytyronin. Kujtojmë tani se jemi duke folur rreth një burri dyzetvjeçar, të lindur në Arabi, në mes të shkretëtirës, i cili s'kishte adhuruar kurrë ndonjë objekt në jetën e tij, ishte analfabet dhe s'ishte njohur kurrë për zotërimin e ndonjë njohurie shkencore, apo mjekësore të çfarëdolloj, i cili shpalli fakte shkencore, që kanë lidhje me biologjinë, kozmologjinë, mjekësinë etj., të cilat janë zbuluar në shekullin e 20-të...Askush, prej Pejgamberëve të mëparshëm nuk solli fakte të tilla të pazakonta. Muhammedi (s.a.v.s) njihej për mirësinë, ndershmërinë dhe qëndrimet e drejta dhe të ndershme, midis mekasve. Ai kurrë nuk kishte gënjyer dhe kurrë nuk e kishte thyer premtimin.

Sidoqoftë, duhet të sqarohet se besimi i myslimanëve nuk kushtëzohet prej faktit nëse faktet shkencore përkojnë me ato që gjenden në Kur'an, apo jo. Nëse, zbulimet shkencore pajtohen me ato që tashmë kanë qenë shpallur apo përmendur në Kur'an, kjo është shikuar si një pohim i asaj që tashmë është marrë si e vërtetë dhe kjo mund të jetë gjithashtu një pohim i atyre çështjeve që ndoshta mund të jenë jashtë mundësive të njohurive njerëzore, në cilëndo kohë të dhënë.

Është një mrekulli e përhershme që në Kur'an nuk gjendet asnjë mospërputhje me fakte të tilla të pakundërshtueshme. Pohimet, përkundrazi, kanë qenë të gjitha të përgënjeshtruara si të pasakta dhe, në shumë raste, rrodhën prej paragjykimeve apo diturisë së gabuar. Kjo është koha kur shkenca fizike mund të përdoret për të sqaruar apo shpjeguar kuptimin.

Gjithashtu, duhet shënuar se mbretëria e së padukshmes, që është "mbi" apo "super" natyrore, është diçka jashtë mundësive të shkencës dhe, si rrjedhim, nuk mund të matet, apo të zotërohet prej ndonjë instrumenti. Islami pohon besimin te Krijuesi Hyjnor, tek engjëjt, te shpalljet, te Bota e Përtejme dhe çështje të tjera, që janë padyshim përtej kufijve të arritjeve shkencore. Si rezultat, ky libër nuk lidhet drejtpërsëdrejti me këto çështje, por sidoqoftë parashtrohen pyetjet që vijojnë:

Nëse Kur'ani është aq i përpiktë rreth çështjeve shkencore, të cilat tani ne mund t'i matim; a nuk është e qartë se ai duhet të jetë prej një burimi që zotëron njohuri përtej asaj sonës?

A nuk është e qartë, se një burim i tillë, për më tepër, duhet të tregojë saktësisht çështjet e botës së padukshme, shpirtit njerëzor dhe Botës së Përtejme, që asnjë qenie njerëzore nuk mund t'i konfirmojë shkencërisht apo t'i mohojë?

Prandaj, ne duhet ta marrim parasysh seriozisht shpalljen madhështore të sjellë në Kur'an, me anën e Muhammedit (s.a.v.s), në lidhje me ekzistencën njerëzore dhe me atë se çfarë e pret njerëzimin.

1:1) SHUMËSIA E BOTËVE SA TOKA EKZISTOJNË?

Nëse ju hapni Kur'anin, në suren e parë, ju do të vëreni se ai fillon si vijon:

"Lavdërimi i qoftë All-llahut, Zotit të botëve." *(Kur'ani, 1:1)*

Nuk ekzistuaka vetëm një botë? Ekziston bota fizike, bota shpirtërore, bota bakteriale e të tjera. Kjo, siç kuptohet, është një prej vështrimeve me të cilën ne mund t'i kuptojmë "botët".

Sidoqoftë, një ajet tjetër kur'anor e bën të qartë se ekzistojnë shumë toka (shih Kur'anin 65:12). A është e mundshme të ekzistojnë toka të tjera, jashtë kësaj sonës?

Askush nuk parashikon të gjejë ndonjë tokë tjetër, brenda sistemit tonë diellor. Por, shkencëtarët thonë se ka të ngjarë që në galaktikën tonë të ekzistojnë shumë toka, jashtë sistemit diellor.

Ata thonë se përafërsisht 50 miliardë yje në Rrugën e Qumështit rrotullohen ngadalshmërisht sikurse edhe dielli. Kjo veçori tregon se planetët që janë satelitë të tyre, i rrethojnë këto yje.

Ylli Bernard, për shembull, besohet se duhet të ketë të paktën një shoqërues planetar. Të gjitha provat dëshmojnë faktin se sistemet planetare janë të shpërndara me tepricë në të gjithë universin. Sistemi diellor dhe toka nuk janë të vetmit.

Kur'ani, gjithashtu, përdor shumësin simbolik, numrin shtatë, për të treguar ekzistencën e një numri të madh qiejsh (shih Kur'anin 2:29, për shembull). Herë pas here, ne shohim se Kur'ani thotë diçka dhe më vonë shkencëtarët zbulojnë se ajo është e vërtetë.

Mund t'i rezistojmë ne të besuarit të këtij libri të Zotit? Zoti, thotë: ***"Ata, që e mohuan Kur'anin kur u erdhi, janë të marrë; ai është një libër ngadhënjyes*** *(i pashoq).* ***Atij nuk mund t`i vishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit."*** *(Kur'ani, 41:41-42)*

(10:61) PARACAKTIMI – NJOHURI E PËRHERSHME E ALLAHUT

Relativiteti i kohës sqaroi një çështje tepër të rëndësishme. Relativiteti është kështu ndryshore, që një periudhë kohe që sipas nesh ka një vazhdimësi prej bilion vjetësh, mund të vazhdojë vetëm një sekondë, në një tjetër dimension. Për më tepër, një periudhë shumë e madhe kohe, që shtrihet prej fillimit të botës deri në përfundim të saj, mund të mos vazhdojë madje as një sekondë por vetëm një çast në një tjetër dimension.

Ky është pikërisht thelbi i konceptit të paracaktimit – një koncept, që nuk kuptohet mirë prej pjesës më të madhe të njerëzve, veçanërisht materialistëve, të cilët e mohojnë atë plotësisht. Paracaktimi është njohuri e përhershme e All-llahut, për të gjitha ngjarjet e shkuara apo të ardhme. Pjesa më e madhe e njerëzve pyesin se si All-llahu mund të dijë tashmë ngjarjet, që ende nuk janë përjetuar dhe kjo i bën ata, të dështojnë në të kuptuarit e autencitetit të paracaktimit. Megjithatë, "ngjarjet, që ende nuk kanë ndodhur" nuk kanë ndodhur ende vetëm për ne. Koha, apo hapësira, nuk e kushtëzojnë All-llahun, por Ai vetë i ka krijuar ato. Për këtë arsye, e ardhmja dhe e tashmja, të gjitha janë të njëjta tek All-llahu; për Të çdo gjë tashmë është kryer dhe ka përfunduar.

Lincoln Barnett shpjegon se si, Teoria e Përgjithshme e Relativitetit e çoi drejt këtij fakti dhe dr. Ajnshtajn. Sipas Barnett-it, universi mund të jetë "i rrethuar në tërë madhështinë e tij, vetëm prej një intelekti kozmik". Vullneti, që Barnett e quan "intelekt kozmik", është urtësia dhe njohuria e All-llahut, i Cili mbisundon tërë universin. Pikërisht, ashtu sikurse ne shohim lehtësisht fillimin, mesin dhe fundin e një vizoreje dhe të gjitha njësitë si një tërësi, ashtu edhe All-llahu e di me përpikëri kohën, prej së cilës ne kushtëzohemi, si një moment të vetëm prej fillimit të saj, deri në fund. Përvojat e njerëzve ndodhin vetëm kur vjen koha e tyre dhe ata janë dëshmitarë të fatit, që All-llahu ka caktuar për ta.

Është gjithashtu e rëndësishme të tërheqim vëmendjen për përciptësinë e të kuptuarit të shtrembëruar të paracaktimit, që mbizotëron në shoqëri. Kjo bindje e shfytyruar e paracaktimit, i përmbahet një besimi supersticioz, se All-llahu ka paracaktuar një "fat" për çdonjërin, por që këto fate, mund që ndonjëherë të ndryshohen prej njerëzve. Për shembull, për një të sëmurë që kthehet prej pragut të vdekjes, njerëzit pohojnë përciptazi: "Ai mposhti fatin e tij". Por, askush s'është i aftë të ndryshojë atë që është paracaktuar për të. Personi që kthehet prej pragut të vdekjes nuk vdes, sepse atij nuk i ishte caktuar të vdiste atëherë. Gjithashtu, është e paracaktuar që këta njerëz që mashtrojnë veten duke thënë: "Unë e munda fatin tim", të thonë kështu dhe të mbrojnë një mendim të tillë.

Paracaktimi është dituri e përhershme e All-llahut dhe për All-llahun, i Cili e njeh kohën, si një moment të vetëm, dhe i Cili sundon mbi tërë kohën dhe hapësirën, çdo gjë është caktuar dhe përfunduar në një fund të paracaktuar. Ne, gjithashtu, kuptojmë prej asaj që është shpallur në Kur'an se koha për Allahun është një: disa ngjarje që duken se do të ndodhin në të ardhmen janë treguar në Kur'an në një mënyrë të tillë sikur tashmë ato të kenë ndodhur shumë kohë më parë. Për shembull, ajetet që përshkruajnë llogarinë që njerëzit do të japin përpara All-llahut, në Botën e Përtejme, janë treguar si ngjarje që tashmë kanë ndodhur shumë kohë më parë:

"Dhe i fryhet Surit dhe bie i vdekur ç'ka ka në qiej dhe ç'ka ka në tokë, përveç atyre që do All-llahu, pastaj i fryhet atij herën tjetër, kur qe, të gjithë ata të ngritur presin.

Toka është ndriçuar me dritën e Zotit të vet, libri është vënë pranë dhe sillen pejgamberët e dëshmitarët, e kryhet mes tyre gjykimi me drejtësi, e atyre nuk u bëhet padrejtë...E ata, që nuk besuan sillen në grupe te xhehenemi... E ata, që ishin të devotshëm ndaj Zotit të tyre, sillen në grupe te xhenneti...." *(Kur'ani, 39:68-73)*

Siç mund të shihet, ngjarjet që do të ndodhin pas vdekjes sonë (nga pikë-vështrimi ynë), në Kur'an tregohen si ngjarje tashmë të përjetuara dhe të shkuara. All-llahu nuk është i kufizuar prej kornizës së kohës relative, ashtu sikurse jemi të kufizuar ne. All-llahu i dëshiroi

këto gjëra në pakohëshmëri: njerëzit tashmë i kanë kryer ato dhe të gjitha ngjarjet janë përjetuar plotësisht dhe kanë përfunduar. Në ajetin e mëposhtëm është njoftuar se çdo ngjarje qoftë ajo e rëndësishme, apo e parëndësishme, është brenda diturisë së All-llahut dhe është regjistruar në libër:

"Ti nuk angazhohesh me asnjë çështje, nuk lexon nga ai pjesë nga Kur'ani dhe nuk bëni ndonjë vepër, vetëm se Ne jemi prezantuesit tuaj, kur ju e ndërmerrni atë. Zotit tënd nuk mund t'i fshihet as në tokë e as në qiell, as sa grimca, e as më e vogël se ajo, e as më e madhe, por vetëm sa është evidentuar në librin e sigurt." *(Kur'ani, 10:61)*

Nëse, ndokush mendon më thellë në dritën e gjithë asaj që u tha këtu, ai sigurisht e kupton në vetë shpirtin e tij këtë situatë befasuese dhe të jashtëzakonshme: se, të gjitha ngjarjet e ndodhura në tokë, janë thjesht një iluzion.

(13:2) ÇFARË E MBAN QIELLIN?
Forcat gravitacionale

Gravitacioni është forca universale e tërheqjes, që vepron midis të gjitha trupave lëndorë. Kjo, është prej forcave të largëta, më të dobëta të njohura në natyrë dhe kështu, nuk luan ndonjë rol në përcaktimin e cilësive të lëndëve të zakonshme. Sidoqoftë, për shkak të kufirit të saj të gjatë të shtrirjes dhe universalizmit, graviteti përcakton strukturën dhe lëvizjen e yjeve, galaktikave dhe të tërë universit. Trajektoret e trupave, në sistemin diellor përcaktohen prej ligjeve të gravitetit, ndërkohë që në Tokë të gjithë trupat kanë një peshë, apo forcë gravitacionale të drejtuar poshtë, proporcionale me masën e tyre; të cilën masa e Tokës e ushtron mbi to. Gravitacioni matet prej përshpejtimit që japin objektet në rënie të lirë. Në sipërfaqen e Tokës, përshpejtimi i gravitacionit është rreth 9.8 metër për sekondë. Kështu, për çdo sekondë, një objekti që është në rënie të lirë i rritet shpejtësia me afro 9.8 metra për sekondë. Sot, shkencëtarët flasin për forcat gravitacionale, që mbajnë trupat qiellorë të ndarë prej njëri tjetrit dhe i parandalojnë

ata prej përplasjes njëri me tjetrin. Si është e mundur, që kjo iu njoftua lexuesve të parë të Kur'anit? Zoti na tregon ne në Kur'an se Ai është i vetmi që mban qiellin (Kur'an, 55:7) dhe se Ai e mban atë të mos bjerë mbi tokë (Kur'an, 22:65). Por si pikërisht e realizon Zoti këtë?

Nëse autori i Kur'anit do të ishte një qenie njerëzore do të ishte tepër e lehtë për autorin të kopjonte përgjigjen e kësaj pyetjeje prej Biblës. Por, sot, askush nuk do ta besonte këtë përgjigje. Në Biblën e Re Amerikane, një fotografi e vizatuar tregon se si anëtarët e Biblës e imagjinonin botën. Në këtë pikturë, qielli "i përngjante një tasi të përmbysur dhe të mbështetur në shtylla" (Bibla e Re Amerikane, St. Botim i Formatit mesatar të Jozefit, fq. 4-5). Toka, në këtë pikturë, është e rrafshët dhe është, gjithashtu, e mbështetur në kolona. Pas përshkrimit të hollësishëm të pikturës, botuesit e Biblës nxjerrin përfundimin, duke e konsideruar këtë paraqitje të botës, si një "koncept parashkencor të universit".

Në kohën kur u shpall Kur'ani, çdokush mund ta besonte lehtësisht këtë përshkrim, i cili tashmë gjendej në Bibël. Vetëm në kohët e sotme moderne, njerëzit mundën ta mësojnë të vërtetën. Si mundet që autori i Kur'anit ta ketë shmangur këtë gabim? Zoti në Kur'an thotë se Ai i krijoi qiejt:

"Ai i krijoi qiejt pa shtylla, sikurse po i shihni." *(Kur'ani, 31:10)*

Përsëri, në Kur'an, thuhet:

"All-llahu është Ai, që ngriti qiejt, pa ndonjë shtyllë." *(Kur'ani, 13:2)*

Këto dy ajete e mohojnë të besuarit se kupa e qiejve ishte e mbështetur në shtylla të cilat ishin të vetmet që i pengonin qiejt të përplaseshin me tokën. Për të qenë i aftë për ta evituar këtë gabim parashkencor, autori i Kur'anit duhet të ketë qenë ose një shkencëtar modern, ose Zoti Vetë.

Mbi të gjithë trupat mbi sipërfaqen e tokës, ushtrohet forca tërheqëse gravitacionale e Tokës e drejtuar poshtë, që jep ndijimin peshës. Mbi sipërfaqen e Hënës, kjo tërheqje apo peshë, është vetëm një e gjashta e asaj në Tokë, pra pesha është në varësi të vendit ku ju jeni, ndërsa masa është një veti e brendshme e të gjitha objekteve.

Në shekullin e 17-të, Isak Njutoni, përshkroi gravitetin duke thënë se çdo trup i tërheq trupat e tjerë në Univers me një forcë që varet nga sasia e lëndës që gjendet në të dhe nga distanca që ata kanë. Kështu, gravitacioni është një forcë tërheqëse universale, që bën që objektet të 'përplasen' në kuptimin më të përgjithshëm dhe përpiqet të tërheqë së bashku objekte të tilla si yjet dhe galaktikat. Dhe pothuaj gati do t'ia dilte me sukses kësaj po të mos e kundërshtonin disa forca të tjera.

(16:8) PROCESI I VAZHDUESHËM I KRIJIMIT

"...E Ai, krijon çka ju tash, nuk dini...." *(Kur'ani, 16:8)*

"...All-llahu krijon, çka të dojë..." *(Kur`an, 24:45)*

Këto dy ajete, midis të tjerave, tregojnë se All-llahu nuk e ka përfunduar krijimin, më saktë, ai është një proces i vazhdueshëm. Kjo është tepër e rëndësishme nga pikëpamja shkencore, sepse ne gradualisht jemi duke filluar të vëzhgojmë dhe të kuptojmë fenomene të caktuara natyrore, të cilat janë ende në procesin e formimit. Një shembull i shkëlqyer është të vëzhguarit e galaktikave që shfaqen ende prej reve tepër të mjegullta. Një shembull tjetër është evolucioni i specieve me dëshmi të shoqëruara të tij të formave të jetës të panjohura dhe tepër të rralla "të ndërmjetme" të shndërruara në fosile. Këto dy shembuj, janë vetëm maja e ajsbergut; fragmenti vijues, i shkëputur nga libri i fizikanit Paul Davies-it 'Projekti Kozmik' shënon vetëdijen rritëse të krijimit të vazhdueshëm: "Një numër gjithnjë e në rritje shkencëtarësh dhe shkrimtarësh, kanë arritur të kuptojnë se aftësia e botës fizike, për të organizuar vetveten përbën një parim themelor, thelbësisht misterioz, cilësi të universit. Fakti, që natyra ka forcë krijuese dhe është e aftë të paraqesë një shumëllojshmëri të pasur progresiste të formave dhe të strukturave të ndërlikuara, sfidon shumë krijime të shkencës bashkëkohore." 'Enigma më e madhe e kozmologjisë' - shkruan Karl Poper, një filozof i njohur – 'mund të jetë se, universi është në një kuptim, krijues.'

(16:12) ORGANIZIMI I UNIVERSIT

Ajo, çka përmendet në Kur'an, rreth organizimit të Universit, është e rëndësishme, sepse këto thënie përbëjnë një fakt të ri të Shpalljes Hyjnore. Kur'ani e trajton këtë çështje në thellësi megjithëse kjo nuk është trajtuar në shkrimet e shenjta të mëparshme.

Është fakt i rëndësishëm që Kur'ani nuk përmban teoritë që mbizotëronin në kohën e shpalljes që kanë të bëjnë me organizimin e botës qiellore. Nëse Kur'ani do të ishte shkruar nga ndonjë qenie njerëzore, ai ose ajo, natyrisht duhej të përfshinin idetë që mbizotëronin në atë kohë. Por shumë prej këtyre ideve, më vonë, do të dilnin të pasakta. Si mundi autori i Kur'anit të dinte t'i përjashtonte këto ide, po të mos ishte autor Zoti, Vetë?

Ata, që thonë se Muhammedi (a.s.), e shkroi Kur'anin, mendojnë se arabët ishin tepër të ditur në fushat e shkencës dhe Muhammedi (a.s.) ishte njëri prej tyre. Por ky shpjegim, bazohet në supozimin e gabuar se arabët e njihnin shkencën, përpara se të shpallej Kur'ani. Në të vërtetë, shkenca në vendet islame, u përhap pas shpalljes së Kur'anit, jo përpara. Në çdo rast, njohuritë shkencore të kësaj periudhe të shquar, nuk mund të kenë qenë të mjaftueshme, që një qenie njerëzore të shkruajë disa prej ajeteve që gjenden në Kur'an. Astronomët bashkëkohorë janë në dijeni të faktit se, yjet dhe planetët mbahen brenda kufijve të largësive të përcaktuara prej njëra-tjetrës. Po të mos kishte ekzistuar ky fakt, përplasja midis tyre do të ishte e paevitueshme. Autori i Kur'anit, është gjithashtu në dijeni të kësaj. Në Kur'an, ne lexojmë:

"Dielli dhe Hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë." *(Kur'ani, 55:5)*

Përsëri lexojmë:

"Për ju nënshtroi diellin dhe hënën, që në mënyrë të zakonshme vazhdimisht udhëtojnë." *(Kur'ani, 14:33)*

Fraza *'që në mënyrë të zakonshme, vazhdimisht udhëtojnë'* është përkthim i fjalës arabe *daa`ib*, e cila këtu do të thotë: 'të dhënët tëri

pas diçkaje me kujdes, në një mënyrë këmbëngulëse, të pandryshueshme, në pajtim me zakonet e caktuara' dhe që në të vërtetë, është mënyra se si vepron dielli dhe hëna.

Një ajet tjetër Kur'anor, thotë:

"Edhe yjet janë të nënshtruar me urdhrin e Tij." *(Kur'ani, 16:12)*

Rregulli, në univers, është themelor për ruajtjen e tij. Zoti, i Cili i nënshtroi ata ndaj këtij rregulli, dinte rreth tij, përpara çdo shkencëtari.

(21:33) LËVIZJA ORBITALE E TRUPAVE QIELLORË

Kur ndokush shqyrton orbitat pambarim të ndërlikuara dhe përpikërinë matematikore, në univers, ai vetëm mund të mbetet gojëhapur nga habia. Të gjithë planetët rrotullohen rreth yjeve të cilët rrotullohen rreth qendrës së gravitacionit të galaktikave të vetë atyre. Këta ekuilibra tepër të përpiktë përmenden në ajetet që vijojnë:

"Dielli dhe hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë…" *(Kur'ani, 55:5)*

"Ai e ngriti qiellin dhe vuri drejtësinë". *(Kur'ani, 55:7)*

Orbitat e trupave qiellorë përmenden në ajetin:

"…Diellin dhe hënën, dhe secili prej tyre noton në orbitë." *(Kur'ani, 21:33)*

Shënojmë që ajeti i fundit, thotë: "Të gjithë" dhe jo "të dy", gjë që tregon se përmendja e Diellit dhe e Hënës është simbolike dhe se, që të gjithë trupat e tjerë qiellorë, iu binden të njëjtave rregulla.

DIELLI, HËNA DHE ORBITAT E TYRE

Sot e dimë që Hëna rrotullohet rreth Tokës, përafërsisht për 29.5 ditë. Dielli, gjithashtu, rrotullohet në orbitën e vet. Galaktika jonë, Galaktika e Rrugës së Qumështit, përfshin njëqind miliardë yje, të vendosura në një mënyrë të tillë, që galaktika i ngjason një disku. Ky disk, rrotullohet rreth qendrës së tij, si një disk gramafoni. Tani është e qartë se kur një disk gramafoni rrotullohet, çdo pikë në disk, do të

lëvizë rreth e qark dhe do të kthehet në pozicionin e tij origjinal. Ngjashmërisht, çdo yll në galaktikë lëviz, ndërkohë, që galaktika rrotullohet rreth aksit të vet. Si rrjedhim, yjet që janë larg prej qendrës së galaktikës, rrotullohen rreth aksit. Dielli është një prej këtyre yjeve.

Hollësitë, mbi orbitën e diellit, janë si vijojnë: Për të kryer një rrotullim, rreth aksit të vet atyre, galaktikës dhe diellit i duhen afërsisht 250 milionë vjet. Dielli udhëton afërsisht 150 milje në sekondë, për ta kryer këtë. Lart, është lëvizja orbitale e diellit, të cilën, tashmë, Kur'ani e ka përmendur 14 shekuj më parë. Dhe ky, është një zbulim i ri. Njohuria mbi orbitën e diellit është një arritje e astronomisë moderne.

Dy ajete, në Kur'an, i referohen orbitave të diellit dhe hënës. Pas përmendjes së diellit dhe hënës, Zoti thotë:

"…secili noton në një orbitë, me vetë lëvizjen e tyre…" *(Kur'ani, 21:33; 36:40)*

Si ka qenë autori i Kur'anit, në dijeni të kësaj? Madje, edhe pas shpalljes së Kur'anit, komentatorët e hershëm, nuk mundën të kishin një përfytyrim të orbitave të diellit dhe hënës. Në shekullin e 10-të, komentatori Tabari, nuk kish mundur ta shpjegojë këtë, kështu që ai tha: "Është detyrë e jona, të heshtim kur ne nuk dimë". Kjo tregon, pikërisht, se sa i paaftë ishte njerëzimi në të kuptuarit e konceptit të orbitave të diellit dhe të hënës. Prej kësaj është e qartë se nëse Kur'ani kishte shprehur këtu një ide tashmë të njohur prej njerëzve, komentuesit duhej ta kishin të lehtë ta kuptonin atë. Kjo përforcon atë që Zoti i tha Pejgamberit të Tij, paqja qoftë mbi të:

"Këto janë disa nga rrëfimet e panjohura *(për ty),* ***që po t'i shpallim ty, e që para këtij, nuk i ke ditur, as ti, as populli yt."*** *(Kur'ani, 11:49)*

(21:33) DIELLI – QARKULLIMI DHE RROTULLIMI

Kur'ani, gjithashtu, shqyrton diellin dhe mënyrën në të cilën ai udhëton në hapësirë. Përsëri, një person mund të mendojë mbi këtë temë. Kur dielli lëviz në hapësirë, ekzistojnë dy mundësi: ai mund të udhëtojë pikërisht siç mund të udhëtojë një gur nëse e flakim atë; ose ai mund të lëvizë në lidhje me vetë atë. Kur'ani shpalli më herët, se ai lëviz si pasojë e lëvizjes së vetë atij (Surja el-Enbija, 21:33). Për të treguar një gjë të tillë, Kur'ani përdor një formë të fjalës *"sabaha"*, për të përshkruar lëvizjen e diellit në hapësirë. Me qëllim që t'i sigurohet lexuesit një shpjegim i kuptueshëm i ndërlikimit të kësaj folje arabe, jepet shembulli i mëposhtëm.

Nëse njeriu është në ujë dhe përdoret folja *"sabaha"*, në lidhje me lëvizjen e tij, kjo mund të kuptohet se ai është duke notuar, duke lëvizur në përputhje me vetë veten e tij dhe jo si pasojë e ndonjë force të drejtpërdrejtë të ushtruar mbi të. Kështu, kur kjo folje përdoret lidhur me lëvizjen e diellit në hapësirë, në asnjë mënyrë nuk lë të kuptohet se dielli është duke udhëtuar në mënyrë të pakontrollueshme në hapësirë, si pasojë e të qenit i flakur apo diçka e ngjashme. Kjo thjesht, do të thotë që dielli është duke u rrotulluar dhe duke qarkulluar, ndërsa ai udhëton. Ndërkohë, kjo është e konfirmuar në Kur'an, por, a ishte kjo një gjë e lehtë për t'u zbuluar? A mundet, që ndonjë njeri i zakonshëm, të thotë se dielli rrotullohet?

Vetëm në kohërat moderne u bënë pajisje për të projektuar shëmbëlltyrën e diellit në një tabloid, kështu që çdokush mund 'ta vështrojë atë, pa qenë i errësuar. Dhe nëpërmjet këtij procesi është zbuluar, se jo vetëm ekzistojnë njolla në diell, por se këto njolla lëvizin një herë në çdo 25 ditë. Kjo lëvizje i është referuar lëvizjes së diellit rreth aksit të tij dhe përfundimisht provon, (ndërsa, Kur'ani e kish shpallur 1400 vjet më parë), se dielli, në të vërtetë, rrotullohet, ndërkohë që udhëton në hapësirë.

(21:104) TKURRJA E MADHE – NGJESHJA E MADHE

***"Atë ditë, kur Ne e palosim qiellin, sikurse palosja e fletëve në libër. Ashtu sikundër e kemi filluar krijimin** (tuaj), **e rikthejmë. Ky është obligim i Yni, e Ne e bëjmë këtë."** (Kur'ani, 21:104)*

***"Ata, nuk e çmuan All-llahun me atë madhështi që i takon, ndërsa, në ditën e kiametit, e tërë toka është në grushtin e Tij, e qiejt të mbështjellë në të djathtën e Tij. Ai, është i pastër nga të metat dhe Ai është i lartë, nga çka ata i shoqërojnë!"** (Kur'ani, 39:67)*

Sipas kozmologjisë moderne, Universi u krijua rreth 10 apo 15 miliardë vjet më parë, në një ngjarje të njohur si Big-Beng. Ai ka vazhduar të zgjerohet gjithmonë, qysh atëherë. Ajo, që ne nuk dimë, është nëse ai do të vazhdojë të zgjerohet gjithmonë. Nëse densiteti i materies në Univers është tepër i lartë, forcat gravitacionale, së fundi, do të shkaktojnë ndalimin e zgjerimit të universit dhe, atëherë, ai do të fillojë të tërhiqet në vetvete. Nëse ndodh kjo, Universi do të përfundojë në një ngjarje të dytë kataklizme, që kozmologjistët e quajnë "Big Crunch"

Teoria e Big Crunch-it, është një prej skenarëve për fundin e universit. Është shpallur se kur universi të ketë rreth 50.000.000 herë moshën e tij të sotme, apo 7.5 x 1017 (shtatëqind e pesëdhjetë kuadrilion) vite, ai do ta ndalë zgjerimin. Atëherë, gjithmonë po aq ngadalshmërisht sa herën e parë, por duke arritur shpejtësinë me të cilën ai zgjerohej, universi do të fillojë të mbyllet.

Pas shtatëqind e pesëdhjetë kuadrilionë vjetësh të tjera, universi do të bëhet një pikë pafundësisht e vogël e një densiteti dhe temperature të pafund.

Çfarë do të pasojë? Kush e di! Universi mund të vazhdojë të luhatet, midis Big Beng-ut dhe Big Crunch-it, përjetësisht. Ose, Big Crunch-i mund të jetë fundi i çdo gjëje. Sidoqoftë, një gjë është e sigurt. Nëse, një univers i ri do të krijohej, ai nuk do të kishte asnjë kujtim, të atij të vjetrit. Ai do të zhvillohej, pa përfillur asgjë nga ajo që ka ndodhur përpara.

(23:112,113) RELATIVITETI NË KUR'AN

Përfundimi drejt të cilit na çojnë gjetjet e shkencës moderne është se koha nuk është një ngjarje absolute, siç besohej prej materialistëve, por vetëm një perceptim relativ. Ajo që është më tepër interesante është se ky fakt i pazbuluar deri në shekullin e 20-të prej shkencës i është kumtuar njerëzimit në Kur'an, 14 shekuj më parë.

Ekzistojnë referime të ndryshme në Kur'an për relativitetin e kohës. Në disa ajete tregohet se njerëzit e perceptojnë kohën në mënyra të ndryshme dhe se, ndonjëherë, njerëzit mund ta perceptojnë një kohë tepër të shkurtër, si një periudhë tepër të gjatë.

Bashkëbisedimi që vijon i njerëzve që do të mbahet gjatë gjykimit të tyre, në Botën e Përtejme, është një shembull i mirë i kësaj.

***"Ai thotë: "E sa vjet keni kaluar në tokë? Ata thonë: "Kemi qëndruar një ditë, ose një pjesë të ditës, pyeti ata që dinë numërimin! Ai thotë: "Mirë e keni, sikur ta dinit, njëmend pak keni qëndruar."** (Kur'ani, 23:112-114)*

Në disa ajete të tjera, është shpallur se koha mund të rrjedhë me shpejtësi të ndryshme, në mjedise të ndryshme:

***"Ata kërkojnë prej teje t'ua ngutësh dënimin, po All-llahu nuk e thyen premtimin e Vet, pse një ditë te Zoti yt, është sa njëmijë vjet si llogaritni ju."** (Kur'ani, 22:47)*

***"Atje ngjiten engjëjt dhe shpirti** (Xhibrili), **në një ditë që zgjat pesëdhjetë mijë vjet."** (Kur'ani, 70:4)*

Këto ajete janë të gjitha shprehje të qarta të relativitetit të kohës.

Fakti që ky rezultat, i kuptuar vetëm kohëve të fundit prej shkencës, në shekullin e 20-të, iu komunikua njerëzve 1.400 vite më parë në Kur'an, është një tregues i shpalljes së Kur'anit prej All-llahut, i Cili rrethon të tërë kohën dhe hapësirën.

(24:35) REAKSIONET BËRTHAMORE NË YJE

Yjet e gjeneratës së parë përbëheshin vetëm prej hidrogjenit dhe sasi gjurmësh të heliumit (rreth 2% të masës së tyre), që u krijuan prej Shpërthimit të Madh (nëse ju pajtoheni me këtë teori). Yjet e gjeneratës së dytë dhe planetët më pas, "trashëguan" produkte të shkapërderdhura të yjeve të shuara (helium, karbon, azot, oksigjen etj) dhe i përfshinë ato në ndërtimin e tyre. Yjet e gjeneratës së tretë janë të ngjashme në të njëjtën mënyrë, vetëm ato përmbajnë më tepër produkte "mbeturinore". Duke qenë se karboni është i pranishëm, në pothuaj të gjitha yjet (Xhuxhët e Kuq janë të diskutueshëm, duke qenë se ata realisht mund të jenë gjenerata e parë e yjeve, që janë ende duke mbijetuar edhe sot e kësaj dite), ai mund të jetë përdorur në reaksionet termobërthamore, në temperatura të ndryshme.

Ekziston një zinxhir i gjashtë reaksioneve, që ndodh në 10000000^0K, në çdo yll vazhdues kryesor të gjeneratës së dytë.

Yjet masive, të formuar rishtas, fillojnë të tkurren nën tërheqjen e tyre gravitacionale. Si pasojë, zonat e tyre qendrore bëhen më të dendura dhe të nxehta. Kur lënda në qendër të yllit, është nxehur në mënyrë të mjaftueshme, për të qenë më të saktë, të paktën 7 milionë shkallë kelvin, fillojnë reaksionet bërthamore. Këto reaksione, që janë të ngjashme me ato që ndodhin në një bombë hidrogjeni, vazhdojnë gjatë gjithë jetës së yllit. Këto reaksione, qartazi, janë të ndryshme prej djegieve të zakonshme (si djegiet e drurit). Ajo, që në të vërtetë ndodh brenda yllit, është se hidrogjeni shndërrohet në helium, me një rrezatim tepër të fuqishëm energjie.

Kjo është saktësisht, ajo që thuhet në Kur'an, me fjalët:

"…Si të ishte yll flakërues…e vaji i tij ndriçon pothuajse, edhe pa e prekur zjarri." *(Kur'ani, 24:35)*

Ajeti përmend një yll, që është lëndë djegëse dhe një reaksion, i cili nuk djeg (zjarr). Pa thënien "reaksion bërthamor", ajeti është përshkrim tepër i përpiktë i asaj që ndodh brenda një ylli.

Këto reaksione bërthamore bëjnë që yjet të rrezatojnë të gjitha llojet e rrezatimeve në hapësirë, prej rrezeve X dhe rrezeve Gama në valë të shkurtra, deri në radiovalët, më të gjata. Pjesa e dukshme e këtyre valëve, që gjendet midis atyre ultra-violet dhe infra të kuqe, është ajo që ne e quajmë dritë e diellit.

(32:4) MATERIALI GALAKTIK NDËRYJOR

Kur'ani përmend mjaft kategori të çuditshme të objekteve të krijuara dhe pikërisht objektet midis qiejve dhe tokës. Kjo përmendje në Kur'an mund ta hutojë lexuesin e shekullit të 20-të të Kur'anit. Për shembull, një ajet thotë si më poshtë:

"E Tij është çdo gjë, që ekziston në qiej e në tokë dhe çdo gjë, që gjendet në mes tyre, edhe ç'ka nën dhe." *(Kur'ani, 20:6; ajete të tjera përfshijnë 25:59, 32:4 dhe 50:38)*

Çfarë gjendet, midis qiejve dhe tokës? Krijimi jashtë qiejve dhe jashtë tokës është *apriori* vështirë për t'u imgjinuar. Për të kuptuar këto ajete duhet t'i referohemi vëzhgimeve më të fundit, mbi ekzistencën e materialit kozmik jashtëgalaktikor dhe njëra, vërtet, të çon drejt ideve të ngritura prej shkencës bashkëkohore, mbi krijimin e universit.

Shkencëtarët na thonë se mjegulla fillestare u kondensua, më pas u shpërnda në pjesë-pjesë. Këto pjesë, këto masa galaktikore, më tutje, u shpërbënë në yje dhe nënproduktet tyre - planetët. Çdo herë, që ndodhte një ndarje, apo shpërbërje e tillë, mbetej material i tepërt, i veçuar nga elementet kryesore të formuara rishtas. Emri shkencor, për këto materiale ekstra, është 'material galaktik ndëryjor'.

A është i rëndësishëm ky material ekstra? Po! Ekspertët e astrofizikës, janë plotësisht në dijeni të një materiali të tillë, i cili ka "prirje për t'u interferuar me masa fotometrike". Materiali shtesë është kaq i rrallë, saqë ata mund t'i referohen si: pluhura, apo tymra, ose gaze. Tashmë, ata janë të okupuar plotësisht me shumën e përgjithshme të hapësirës, që sipas tyre mund t'i korrespondojë "një mase, ndoshta, më të madhe se sa masa e përgjithshme e galaktikave". Edhe njëherë,

ne duhet të përballemi me ndërlikueshmërinë e gjithë kësaj. Si mundet, që një njeri që kishte jetuar para 14 shekujsh, të kishte pasur njohuri, rreth materialit galaktikor ndëryjor? A ishte Muhammedi, paqja qoftë mbi të, ekspert i astrofizikës moderne? Apo, Kur'ani s'është gjë tjetër veçse Fjalë e Zotit? All-llahu, i Vetmi Zot i Vërtetë, në librin e Tij shpall:

"Shpallja e librit është prej All-llahut, të gjithëfuqishmit, të urtit. Ne të shpallëm ty librin, për hir të së vërtetës, andaj ti adhuroje All-llahun, duke qenë i sinqertë në adhurimin e tij!" *(Kur'ani, 39:1-2)*

(39:67) MADHËSHTIA E ZOTIT

"Ata nuk e çmuan All-llahun me atë madhështinë që i takon, ndërsa, në Ditën e Kiametit e tërë toka është në grushtin e Tij, e qiejt të mbështjellë në të djathtën e Tij. Ai është i pastër nga të metat dhe është i lartë nga çka ata i shoqërojnë!" *(Kur'ani, 39:67)*

Prej ajetit (39:67) mësojmë se madhështia e Zotit është larg të kuptuarit njerëzor – ajeti, shpall se të 7-të universet janë "përfshirë brenda dorës së Zotit".

Të përkrahur prej kodit matematik të vështirë kur'anor, ne mësojmë se universi ynë është më i vogli dhe më i brendshmi i shtatë universeve (41:12, 55:33, 67:5 & 72:8-12). Ndërkaq, përparimet tona shkencore, kanë treguar se galaktika jonë Rruga e Qumështit është 100.000 vjet dritë e përshkruar tej për tej dhe se universi ynë përmban një bilion galaktika të tilla dhe një bilion trilion yje, plus deciliona të panumërta të trupave qiellorë. Universi ynë është vlerësuar të bashkojë distancat, në më tepër se 20.000.000.000 vite drite.

Numërimi i Yjeve!

Nëse ne marrim vetëm një kuantilion (1.000.000.000.000.000.000) dhe thjesht i numërojmë ato prej zero deri kuantilion) duke i numëruar një, në një sekondë, ditë dhe natë, kjo do të merrte 32 bilion vite (shumë më tepër sesa mosha e universit). Ja, se sa kohë e gjatë, do të merrej pikërisht për t'i numëruar ato; por, Zoti "krijoi" ato. E tillë, është madhështia e Zotit!

Ne mund të vlerësojmë gjerësinë e universit tonë, nëse imagjinojmë se kalojmë në një hapësirë odisiane. Kur ne largohemi prej planetit Tokë, drejt Diellit me shpejtësinë e dritës, ne arrijmë Diellin, pasi kemi përshkruar 93.000.000 milje, në 8 minuta. Kjo, do të na marrë ne më tepër sesa 50.000 vite, duke ecur me shpejtësinë e dritës, për të dalë nga galaktika jonë. Prej kufijve të jashtëm të Rrugës së Qumështit, planeti ynë Toka, duket i padukshëm. Madje, edhe me teleskopë tepër të fuqishëm, nuk mund të diktohet "Toka" jonë e vogël.

Ne duhet të shpenzojmë më tepër se 2.000.000 vite udhëtimi me shpejtësi të dritës, për të arritur skajin tjetër të galaktikës. Të paktën 10.000.000.000 vite me shpejtësi drite, duhen të shpenzohen për të arritur kufijtë e jashtëm të universit tonë. Prej kufijve të jashtëm të universit tonë, madje edhe Rruga e Qumështit, ngjason me një pikël pluhuri, në një dhomë tepër të madhe.

Universi i dytë rrethon universin tonë. Universi i tretë është më i gjerë, sesa i dyti dhe kështu me radhë. Për më tepër përpikëri, universi ynë, duhet të konsiderohet si universi i shtatë, i rrethuar prej universit të gjashtë, i cili rrethohet prej universit të pestë dhe kështu në vazhdim. A mund ta imagjinoni ju shtrirjen e të parit, universit më të jashtëm? Nuk ekziston numër për të përshkruar perimetrin e universit të parë. E kjo hapësirë e paimagjinueshme, përfshihet "Brenda grushtit të dorës së Zotit". Prej kufirit më të skajshëm të universit më të jashtëm, ku është planeti Tokë? Sa e rëndësishme është ajo? Në grimcën shumë të vogël të quajtur Tokë, jetuan krijesa të tilla si: Maria, Jezusi dhe Muhammedi. Megjithatë, disa njerëz, këto qenie të pafuqishme njerëzore, i kanë shndërruar në zota!

Madhështia e Zotit shprehet jo vetëm prej faktit se Ai mban shtatë botët në dorën e Tij, por gjithashtu edhe prej faktit se ai kontrollon plotësisht çdo atom, madje përbërësit nënatomikë, gjithkund në universin e pakufishëm (6:59, 10:61, & 34:3).

(39:68) VRIMAT E ZEZA

Për ekzistimin e vrimave të zeza është bërë aluzion në ajete të tjera të Kur'anit të Shenjtë: 6:73, 18:99, 20:102, 23:101, 27:87, 36:51, 39:68, 69:13,14,15, 84:1,3,4.

Ajetet në Kur'an që flasin rreh të "fryrit të borisë" (fryrja e Surit) bëjnë një insinuatë të largët, të thithjes së materies në vrimat e zeza dhe rënies së saj në singularitet. *Sur* ka kuptimin "trombë", apo "bori" dhe kjo i përngjan teorive të formës së vrimave të zeza. Kur'ani përdor këtë fjalë, kur flet rreth Ditës së Shkatërrimit dhe Ringjalljes.

"Dhe i fryhet "Surit" kur qe, duke u ngutur prej varrezave, paraqiten te Zoti i tyre." *(Kur'ani, 36:51)*

"Dhe i fryhet Surit dhe bie i vdekur, ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë, përveç atyre që do All-llahu *(të mos vdesin),* ***pastaj i fryhet atij herën tjetër, kur qe të gjithë ata, të ngritur e presin*** *(urdhrin e Zotit).***"** *(Kur'ani, 39:68)*

Tani besohet se, në qendrën e çdo galaktike, gjendet një vrimë e zezë tepër masive, që është miliona deri bilionë herë më e rëndë se Dielli ynë. Vrimat e zeza masive i kapin yjet e afërt dhe i tërheqin ato, në një disk shtjellues në rritje. Në shumë prej këtyre sistemeve (të cilat janë quajtur AGN = bërthama aktive galaktikore), nxirret jashtë një rrymë, në mënyrë pingule drejt diskut, që shihet në valët optike dhe radiovalët. Në shumë zona qendrore, disku bëhet kaq i nxehtë (dhjetëra milionë gradë), saqë emetohen rreze X dhe rreze Gamma.

Anatomia e Vrimave të Zeza

Sipas përkufizimit, një vrimë e zezë është zona ku lënda mblidhet drejt një dendësie të pafundme dhe ku si pasojë, përkulja e kohë-hapësirës është në shkallën më të lartë. Përveç kësaj, fushat e fuqishme gravitacionale të vrimave të zeza, pengojnë të rrjedhë çfarëdo drite, apo rrezatimi tjetër elektromagnetik. Po ku ndodhet: "pika e moskthimit", në të cilën çdo materie apo energji është e destinuar të zhduket prej universit të dukshëm?

Horizonti i Ngjarjes

Duke zbatuar Ekuacionet e Fushës së Anjshtajnit për kolapsimin e yjeve, një astrofizikan gjerman deduktoi rrezen kritike për një masë të dhënë, në të cilën lënda mund të kolapsohet në një densitet të pafundmë, që njihet si singularitet. Për një vrimë të zezë, masa e së cilës është e barabartë me 10 diej, kjo rreze është afro 30 km, që llogaritet në një perimetër kritik prej 189 km.

Prapa këtij horizonti tërheqja e brendshme e gravitetit është e pakufishme dhe asnjë informacion rreth brendësisë së vrimës së zezë nuk mund të rrjedhë drejt universit të jashtëm.

Rënia në Singularitetin e Vrimës së Zezë.

"E kur të fryhet në sur, një e fryme.

Dhe kur të ngrihen toka e kodrat e t'i mëshojnë njëra-tjetrës me një të goditur.

Në atë kohë ndodh e vërteta *(kiameti).***"** *(Kur'ani, 69:13-15)*

Në qendër të një Vrime të Zezë qëndron singulariteti, ku lënda ngjishet drejt një densiteti të pafundmë, tërheqja e gravitetit është e fuqishme pafundësisht dhe kohë-hapësira ka përkulje të pafundme. Këtu nuk ka kuptim të flitet për hapësirën dhe kohën, akoma më pak për kohë-hapësirën. Në singularitet, koha dhe hapësira pushojnë së ekzistuari, ashtu si ne i njohim ato.

Çfarë ndodh, kur bie në Vrimën e Zezë?

Ajetet që bëjnë aluzion për tërheqjen e lëndës (tokës, yjeve apo lëndëve të gazta) kundrejt horizontit të ngjarjes dhe për rënien në honin e vrimës së zezë, janë si vijon:

"Kur të pëlcasë qielli.

Dhe kur toka të shtrihet në gjerësinë e saj.

E të nxjerr çka ka Brenda, e të çlirohet." *(Kur'ani, 84:1,3,4)*

Gjëra të çuditshme fillojnë të ndodhin. Hapësira fillon të tërhiqet, duke u bërë më e gjatë dhe më rrjepëse. Ju do t'i gjeni këmbët tuaja të tërhequra milje larg përpara jush, ndërsa trupi juaj shtrëngohet tërthor. Ju do të bëheni një pjesë spageti e gjatë e hapësirës, përpara se ju të

arrini horizontin e ngjarjes. Pastaj, trupi juaj do të grimcohet në pjesëza themelore dhe do të zhdukeni prapa vellos së errësirës.

Të Rrotulluarit dhe të Pulsuarit e Vrimave të Zeza.

Të rrotulluarit e vrimave të zeza. Efekti i rrotullimit të vrimës së zezë është të krijuarit e një vorbulle në hapësirë. Veprimi i të rrotulluarit, gjithashtu, ndikon në formën e horizontit të vrimës. Vrimat e zezë që nuk rrotullohen janë sferike, një vrimë rrotulluese e fryn horizontin e saj. Ekziston një kufi, për sa i përket shpejtësisë, me të cilën mund të rrotullohet një vrimë e zezë. Për një vrimë të zezë të një mase diellore, me një perimetër prej 18.5 km, shpejtësia maksimale e rrotullimit llogaritet 0.000062 të sekondës, për një rrotullim. Kjo jep një shpejtësi rrotullimi prej afro 299.800 km/s, shumë afër me shpejtësinë e dritës.

Pulsimi i Vrimave të Zeza

Kur një Vrimë e Zezë shikohet nga ana e jashtme e horizontit të saj, ajo mund të shihet si një përkulje e kohë-hapësirës me valëzimin e hapësirës kohë-kohë duke kërcyer përreth. Kjo shkakton pamjen se është vetë vrima e zezë rrotulluese që pulson. Llogaritjet e mëvonshme të bëra prej Teukolsky-t shtjelluan një grup ekuacionesh për të analizuar pulsimet e vrimës së zezë.

Jetëgjatësia e Vrimës së Zezë.

Vrima e Zezë, e barasvlershme me dy masa diellore, që emeton pjesëza duke e rritur temperaturën dhe gravitetin e saj dhe duke u pakësuar në masë parashikohet të ketë një jetëgjatësi prej:
12.000.000.000

që vlera gjeometrike (numerike) e fjalës Rafii në arabisht = 360. Kjo do të thotë se, Zoti është zotëruesi i shkallëve më të larta, 360 shkallë. Nuk ka shkallë më të lartë se kjo.

A u tregon kjo juve diçka? Zoti, Zotërues i shkallës më të lartë (pra 360) është në kontroll të çdo shkronje dhe fjale në librin e tij. Prej ku rrjedh vlera numerike e fjalës Rafii? Fjala Rafii është në arabisht fjalë më katër shkronja: Raa, Faa, Jaa dhe Ain.

Këtu janë vlerat numerike të shkronjave të Rafii-së, Raa=200, Faa=80, Jaa=10 dhe Ain=70. E tërë fjala ka vlerën 200+80+10+70=360.

Zoti i gjithëfuqishëm, i Cili kontrollon të tërë universin, zotëron të gjithë diturinë. Zoti i Gjithëfuqishëm është autor i Kur'anit. Tani, ju mund të kuptoni emërtimet që Zoti i dha vetvetes, në këto ajete:

"Ai është i pari që s'ka fillim dhe i fundit që s'ka mbarim, i dukshmi dhe i padukshmi, dhe Ai është më i dijshmi për çdo gjë." *(Kur'ani, 57:3)*

Ai është rrethuesi i gjithçkaje (Muhit). Ai zotëron shkallën më të lartë. I lartësuar, Një i Vetmi Zot, nuk ka zotë të tjerë, përveç Atij.

(41:12) KONSTANTJA KOZMIKE

Nuk ekziston asnjë arsye natyrore dhe e mjaftueshme, se përse, të gjitha konstantet universale, kanë vlerat që ato kanë. Nëse ato do të kishin vlera të ndryshme, jeta do të pushonte së ekzistuari. Sidoqoftë, ato kanë vlerat që kanë, pavarësisht nga ndonjë domosdoshmëri fizike. Marrim shembuj të tillë, si: konstantja e Plankut, shpejtësia e dritës, ngarkesa e elektronit dhe konstantja gravitacionale. Këto konstante, me përjashtim të konstantes gravitacionale, nuk kanë ndryshuar më tepër sesa 1%, që nga fillimi i universit dhe janë të njëjta ngado. Konstantja gravitacionale ka ndryshuar 10%.

Duhet të theksohet, lidhur me këtë çështje se këto konstante kanë ekzistuar qysh në fillim të universit shumë kohë përpara se të shfaqej jeta. Këto dhe ligje të tjera të çuditshme të natyrës nuk përfillin ndonjë arsye natyrore dhe të mjaftueshme për ekzistencën e tyre. Shpjegimi i vetëm i vlefshëm që mbetet është se një Projektues Inteligjent i vendosi ato:

"Ky është caktim i të plotfuqishmit, i të dijshmit." *(Kur'ani, 41:12)*

Në bazë të parimit të shkakut të mjaftueshëm, të shpallur prej G.W.Leibniz-it, "Asnjë fakt nuk mund të jetë i vërtetë, apo të ekzistojë dhe të mos ekzistojë një Shkak i Mjaftueshëm, se përse gjithçka është në gjendjen që është, dhe jo ndryshe".

"A nuk e dini ju, se All-llahu nënshtroi për të mirën tuaj, ç'ka në qiej e ç'ka në tokë …" *(Kur'ani, 31:20)*

NË TË VËRTETË, TË GJITHA KONSTANTET, NË QIELL DHE NË TOKË, KANË QENË TË KUSHTËZUARA PËR TË SIGURUAR QË JETA DHE NJERËZIMI TË VINTE PËR TË QENË NJË FAKT, DËSHMI E DHËNË.

NUK EKZISTON NDONJË SHKAK, SE PËRSE KONSTANTET KANË ATO VLERA QË ATO KANË, PËRVEÇ SE ATO JANË VENDOSUR PREJ NJË INTELIGJENCE ME NJË SYNIM DHE QËLLIM NË MENDJE.

ATO KANË QENË TË KUSHTËZUARA PËR TË SIGURUAR QË UNIVERSI TË EVOLUOJË, NË ATË MËNYRË QË EVOLUOI, PËR TË EKZISTUAR JETA DHE NJERËZIMI!

Ndërsa shkencëtarët përballen me një enigmë këtu, e cila rrezikon ngrehinën e punës së tyre, pasuesit e Kur'anit nuk përballen aspak me ndonjë enigmë të tillë. Zoti është shkaku i mjaftueshëm.

(77:8) GJIGANTI I KUQ DHE XHUXHI I BARDHË

Në kohën e shpalljes së Kur'anit (shekulli i 7-të), ende besohej se të gjithë yjet në qiell, duke përfshirë Diellin tonë, ishin të përhershëm dhe përbëheshin prej një materiali, që nuk zhduket apo shpërbëhet kurrë. Askush, në të vërtetë, nuk ishte në dijeni të natyrës së reaksioneve, që ndodhnin brenda yjeve, por iu desh të formulohej teoria atomike e shekullit të 20-të dhe ndërkaq, siç u përmend përpara, këto ishin bërë me dije në Kur'an Këto reaksione atomike ndodhin brenda

një ylli, për një kohë të kufizuar, dhe më pas ylli do ta shterojë përfundimisht energjinë, kur ai t'i ketë përdorur të gjitha burimet e tij. Kur arrihet kjo fazë, një yll i njëjtë me Diellin tonë, do të pësojë një varg ndryshimesh drastike. Së pari, ai do të zgjerohet për t'u bërë një gjigant i kuq. Planeti më i afërt, Mërkuri, do të gëlltitet dhe nxehtësia e madhe e dhënë prej Diellit në stadin e gjigantit të kuq do të bëjë që të gjitha detet dhe oqeanet në Tokë të vlojnë dhe të avullojnë duke shënuar fundin e jetës në tokë. Së fundi, ylli do të fillojë të mblidhet dhe të humbë shkëlqimin e tij dhe të përfundojë në një xhuxh të bardhë. Këtu, në Kur'an përdoren terma shkencorë tepër të përpikta:

"Kur yjet të shuhen". *(Kur'ani, 77:8)*

Përfundimit të jetëgjatësisë së yjeve, gjithashtu, i referohet edhe ky ajet Kur'anor:

***"Ai** (All-llahu) **nënshtroi diellin dhe hënën, që çdo njëri udhëton deri në një afat të caktuar."** (Kur'ani, 13:2)*

Në suren 81, në ajetet e saj hyrëse, përshkruhet përfundimi i kohës si vijon:

"Kur dielli të jetë mbështjellë

Kur yjet të jenë kolapsuar.

***Dhe kur detet të vlojnë, si zjarr i flakëruar."** (Kur'ani, 81:1,2,6)*

Është tepër i rëndësishëm fakti, se si ajeti thotë: "Kur yjet të jenë kolapsuar" dhe jo "kur dielli të jetë kolapsuar", sepse të vluarit e oqeaneve do të jetë pasojë e zgjerimit të Diellit (në fazën e gjigantit të kuq) dhe jo e shuarjes së tij, pasi oqeanet do të vlojnë shumë gjatë, përpara se dielli të fillojë të kolapsohet. Gjithashtu, termi "kolaps", i përdorur në Kur'an, është termi preciz i përdorur prej astronomëve të kohës së sotme, për të përshkruar këtë stad të jetës së yjeve.

Përktheu nga anglishtja:
Mimoza Sinani

Mustafa Mlivo

THE QURAN-ABOVE SCIENCE AND CIVILIZATION

(Summary)

We have revealed to you this book to provide explanations for everything, and guidance, and mercy, and good news for the submitters (Quran, 16:89)

What makes us believe that Prophet Muhammad revealed the undisputed truth is the fact that his message is rich with scientific facts, facts that his contemporaries could not even imagine. We must bear in mind that we are talking about a 40-year-old, who was born in the deserts of Arabia, who was illiterate and was not known to master any scientific knowledge. Yet, he revealed things that had to do with biology, cosmology, medicine, etc., which were discovered many centuries later. None of the previous Prophets had done so. Muhammad (PBUH) was well-known among the inhabitants of Mecca for his benevolence, honesty, as a righteous man, etc. He had never lied or broken a promise.

مصطفى مليفو

القرآن الكريم تقدم على العلم و الحضارة

(خلاصة البحث)

"و نزلنا عليك الكتاب تبيانا لكل شيئ

و هدى و رحمة و بشرى للمسلمين" (16:89)

الذي يجعلنا نؤمن بقوة بان النبى محمدا (صلعم) جاء بالحق هوان رسالته غنية بحقائق علمية خاصة حتى أن هذه الاشياء لم يخطر ببال أحد من الناس وقت نزول الوحى. نحن نتذكر الآن باننا نتحدث عن رجل في الاربعينات من عمره ولد في شبه الجزيرة العربية وسط الصحراء و لم يتعبد لصنم طوال حياته. كان اميا و

لم يسبق له أن تعلم علما من العلوم مثل: علم الاحياء و علم الفلك و علوم الطب و التي تم اكتشافها في القرن العشرين. لم يحدث ان احدا من الرسل قام باحضار حقائق مماثلة. و كان النبي (صعلم) مشهورا بكرمه و سلوكه و خلقه الكريم و لم يحدث أنه كذب أو خالف وعده.

TRASHËGIMI

Dr. Hasan Kaleshi

VAKËFNAMEJA DHE VAKËFET E SUNKUR ÇAUSH BEGUT NGA MANASTIRI

Vakëfnameja më e vjetër në Jugosllavi[1]

Në rrugën e sotme "Ivan Milutinoviç" në Manastir, - në anën e majtë të lumit Dragor, ku është ngritur një ndërtesë e madhe banimi, dhe në vendin i cili më herët është quajtur "Tereke pazari" (Tregu i drithit), - deri në vitin 1956 ka ekzistuar xhamia më e vjetër në Jugosllavi dhe një nga më të vjetrat në Ballkan. Këtë xhami e kanë quajtur "Eski xhami" (Xhamia e vjetër), ndërsa në dokumentet zyrtare rregullisht është quajtur *"Çaush bey camisi"*[2]. Ndërtuesi i kësaj xhamie ishte Sunkur begu i mbiquajtur Çaush beg.

Për Sunkur begun kemi të dhëna të pakta. Evlia Çelebiu e përmend vetëm xhaminë e tij (Çaush camii), duke shtuar se ajo është afër bezistanit dhe se është mjaft e vizituar.[3]

[1] Lexo: në ish-Jugosllavi (shënim i përkthyesit)

[2] Fakti se populli e quan xhami me një emër tjetër, kurse në dokumente e hasim me emër tjetër, nuk duhet të na habis, sepse kjo është dukuri e shpeshtë. Kishën e tillë të Levishës në Prizren deri sa ka qenë xhami, populli e ka quajtur "Xhuma xhami", kurse në dokumente e hasim "*Fet'hiye*", "*Fatih camisi*" "*Cami-i atik*".

[3] Evliya Celebi, *Siyāhatnāme*, V, str. 573.

Edhe pse gati secili banorë i vjetër i Manastirit e di saktësisht se ku ka qenë xhamia e Sunkur Çaush begut, megjithatë, për ndërtuesin e saj gati se nuk dihet asgjë. Kryetari i Bashkësisë Islame, Sabri efendiu, para njëzet vjetëve na ka treguar për ato që ai në të vërtetë i kishte lexuar në veprën "Historia e shkurtër e Vilajetit të Manastirit" të Mehmed Tevfikut.[4] Të dhënat të cilat i ofron Mehmed Tevfiku mund të përmblidhen si më poshtë:

Sunkur Çaush begu ka qenë një nga komandantët e ushtrisë gjatë kohës së qeverisjes së Sulltan Muratit II (1421-1451). Kur sulltan Murati qe nisur me ushtri kundër Skënderbeut, njëri nga komandantët në ushtrinë e Muratit kishte qenë pikërisht ky Çaush begu.[5]

Duke u kthyer nga lufta, Sunkur begut i kishte pëlqyer shumë pozita e Manastirit, andaj e kishte lutur sulltanin që t'ia lejonte që të qëndronte aty.

Në Vakëfnamenë tonë përmendet edhe emri i babait të Sunkur begut, Abdullahu. Sabri efendiu i sipërpërmendur më ka thënë se Çaush begu rrjedhë nga viset e Manastirit, se është marrë si devshirmë dhe është dërguar në Edrene. Në qoftë se kjo e dhënë është e saktë dhe nëse këtë e lidhim me emrin e babait të Sunkur begut, Abdullahun, që do me thënë "robi Zotit", mund të supozojmë se prindërit e Sunkur begut ishin me prejardhje krishtere, sepse, ata të cilët e pranonin Islamin, baballarët e tyre rëndom i quanin me këtë emër (Abdullah - shën. përkth.) ose me ndonjë kuptim të ngjashëm.

Nga të gjithë vakëfet e Çaush begut në Manastir, nuk ka mbetur asgjë. Me rastin e vizitës sonë Manastirit me qëllim hulumtimi në lidhje me temën tonë, pamë se ekzistonin vetëm rrënojat e imaretit në rrugën "Ilindeni". Imareti kishte pushuar së punuari në vitin 1941. Shumë qytetarë të vjetër të Manastirit e kujtojnë se në periudhën e Jugosllavisë së Vjetër aty ishte zier çorba dhe ajo u qe ndarë të varfërve.

[4] Ne kemi pasur në dorë tekstin në gjuhën turke të Tevfikut *"Manastir vilayeti tarihçesi"*, mirëpo kemi cituar përkthimin e saj në gjuhën serbe nga G. Elezoviç botuar në "Bratsvu", XXVII, sur. 213.

[5] Është interesante se në kronikat turke të hershme dhe të vonshme nuk ka asnjë shënim dhe asnjë të dhënë për Çaush begun.

Mehmed Tevfiku në veprën e sipërpërmendur thekson se Xhamia e Sunkur begut është ndërtuar në vitin 838 (fillon më 7.VIII.1434), sa kohë që nga Vakëfnameja e Çaush begut, e cila është e verifikuar po ashtu në të njëjtin vit, e shohim se xhamia atë vit (1434) kishte ekzistuar. Për këtë arsye, është e mundur që xhamia të ketë qenë e ndërtuar edhe më herët, kurse Mehmed Tevfiku të dhënat për ndërtimin e saj t'i ketë marrë nga Vakëfnameja.

Në pjesën e fundit të Vakëfnamesë, e cila është verifikuar në vitin 843 (fillon më 14.VI.1439), Çaush begu përmendet si haxhi. Kjo na jep të kuptojmë se Sunkur begu, - në ndërkohë, - që nga hartimi i Vakëfnamesë e deri tek hartimi i shtesës, d.m.th. midis viteve 1434-1439, kishte qenë në haxhillëk dhe se kishte vdekur pas vitit 1439.

Nga Vakëfnameja shihet se Çaush begu ka vakëfnuar këto objekte:

Në Manastir:

1 xhami
1 medrese
1 han
25 dyqane
2 troje - njëra para xhamisë e tjetra para tyrbes
1 tyrbe
7 mullinj
1 vresht

Në Edrene:

1 mesxhid
11 dyqane
17 dhoma

Në Vidin:

1 mesxhid
20 dyqane
1 mulli

Përveç këtyre, Sunkur Çaush begu ka vakëfnuar në të holla edhe 30.000 dërhem dhe tërë fshatin Popolzhan në nahijen e Florinit (Lerinit).

Në defterin kadastral nr. 16 nga viti 886 (fillon më 2.III.1481), i cili ka të bëjë me Shkupin dhe Manastirin,[6] në faqen 458 gjejmë regjistrimin e të hyrave dhe të dalave të vakëfeve të Çaush begut në Manastir, dhe ai regjistrim duket kështu:

Nga hamami[7], gjatë vitit, 6.667 akçe
Nga 44 dyqane[8], gjatë vitit, 2.500 akçe
Nga gjashtë mullinj, gjatë dy viteve, 2.368 akçe
Nga kopshti, gjatë vitit, 45 akçe

Në të dalat shënohen vetëm pagat e shërbyesve, të cilët përmenden edhe në Vakëfname. Nga shuma e lartpërmendur është caktuar që 3.000 akçe të përdoren për xhaminë në Edrene dhe 1.000 akçe për xhaminë në Vidin.

Për xhaminë e Çaush begut në Manastir nuk do të na mbetej kurrfarë gjurme, sikurse pamjen dhe përshkrimin arkitektonik të saj të mos e kishte dhënë arkitekti Krume Tomovski.[9] Sipas tij, xhamia ka pasur hajatin me dy qemerë dhe në mes kupolën. Minarja ka qenë në anën e majtë. Xhamia dhe minarja kanë qenë të ndërtuara me gurë dhe me tulla të radhitura herë me gurë herë me tulla.

Në të njëjtin punim, K. Tomovski, duke iu referuar Jovan Haxhi Vasiljeviçit[10], pohon se në vend jo vetëm të kësaj xhamie, por gati në vend të të gjitha xhamive në Manastir kanë ekzistuar kishat, të cilat

[6] Ky Defter gjendet në Arkivin e Kryeministrisë në Stamboll, kurse fotokopja, të cilën unë e kam shfrytëzuar, gjendet në Institutin për Historinë e Ekonomisë në Stamboll. Shfrytëzoj rastin të falënderoj drejtorin e këtij instituti Omer Lutfi Barkanin, i cili pati mirësinë dhe më vuri në disponim të gjitha fotokopjet e defterit, mikrolexuesin etj.

[7] Është interesant fakti se hamami nuk përmendet askund në Vakëfname dhe se për të askush në Manastir nuk di.

[8] Në Vakëfname përmenden vetëm 25 dyqane në Manastir.

[9] Arkivi i Krume Tomovskit, *Džamii vo Bitola*, "Zbornik na Tehničkiot fakultet, 1956/57, Skopje, 1956/7, sur. 46.

[10] J. H. Vasilijević, *Grad Bitolj, po kalendaru "Vardar" iz 1911. g.*, Cituar sipas Tomovskit.

turqit i paskëshin rrënuar, ose kishat i paskëshin shndërruar në xhami! Kështu, xhamia e Sunkur Çaush begut paskësh qenë kisha e Shën Spasit, xhamia e Hajdar Kadisë paskësh qenë kisha e Shën Nikollës, Xhamia e Re (Yeni cami) paskësh qenë kisha e Shën Gjorgjit, ajo e Ishak Çelebiut paskësh qenë kisha e Shën Vaskrsit.[11] Fakti se Jovan Haxhi Vasiljeviçi, - i cili ka herrur edhe historinë e Maqedonisë, - në secilën xhami sheh një ish-kishë, neve nuk na habit aspak, por neve na habit se si K. Tomovski, sot pa rezervë dhe pa ofruar fakte të reja pranon pohimin e Vasiljeviçit. Pohimet e këtilla dhe të njëjta të historianëve të paraluftës i gjejmë kur kemi të bëjmë me xhamitë dhe me përmendoret tjera islamo-osmane në qytetet tjera.

Mirëpo, kur hulumtimeve u qasemi seriozisht, nxjerrim konstatimin se të gjitha ato kështjella të shndërruara në xhami nuk kanë kurrfarë baze, dhe se ndonjë rast i veçantë, është shndërruar në rregull. Dihet saktësisht se osmanlinjtë me rastin e pushtimit të ndonjë qyteti më të madh shpeshherë kishën më të madhe të atij qyteti e shndërronin në xhami, sikurse është rasti me Aja Sofinë në Ohër, kishën e Shën Premtes në Prizren etj. Mirëpo, askund nuk kemi rrënim masiv të kishave ose shndërrim masiv të tyre në xhami. Fakti se me rastin e rrënimit të ndonjë xhamie janë gjetur gurë të ndonjë manastiri ose të ndonjë kishe, nuk mund të merret si ndonjë argument i prerë, sepse osmanët kanë përdorur gurët pa kurrfarë paragjykimi, d.m.th. nëse një kishë është rrënuar ose është lënë pasdore asaj i janë marrë gurët.[12] Shembulli më i mirë për këtë është xhamia e Sinan pashës në Prizren.[13] Përveç kësaj, kisha e shndërruar në xhami është dashur medoemos ta ruante formën e parë, sepse ndryshimet kanë qenë fare të vogla: fres-

[11] K. Tomovski, op.cit. str. 33.

[12] Si një nga argumentet se në Manastir ka ndodhur shndërrimi i kishave në xhami, K. Tomosvki thekson kontestin i cili kishte ndodhur para luftës midis Bashkësisë së Fesë Islame dhe asaj ortodokse rreth kësaj xhamie dhe se kontestin e kishte fituar Bashkësia Fetare Ortodokse. Mbase nuk ishte pritur që kontestin ta fitonte Bashkësia e Fesë Islame! Një kontest i tillë ishte zhvilluar edhe rreth xhamisë së Sinan Pashës në Prizren dhe kontestin po ashtu e kishte fituar Kisha Ortodokse, e cila kishte filluar rrënimi i xhamisë, mirëpo populli nuk kishte lejuar që xhamia të rrënohej.

[13] Hasan Kaleši, *Veliki vezir Kodža Sinan-paša...*, str. 110.

kat mbuloheshin me allçi dhe gëlqere, bëhej një hapje në mur për mihrab në drejtim të Qabesë, rrënohej kambana dhe ndërtohej minarja, dhe këto ishin të gjitha ato ndryshime. Në qoftë se kemi të bëjmë me shndërrimin e vërtetë të kishës në xhami, këtë të dhënë burimet osmane nuk e fshihnin fare. Të kujtojmë vetëm Evlia Çelebiun i cila na ofron një numër të konsiderueshëm të të dhënave për xhamitë të cilat më herët kishin qenë kisha.[14] Edhe në Vakëfnamenë e Sunkur begut dhe në ato të Ishak Çelebiut qartazi theksohet se xhamitë janë ndërtuar nga fillimi. Prandaj, pohimi se xhamia e Sunkur begut më herët ka qenë kishë apo është ndërtuar në vendin ku ka qenë kisha, ose duhet hedhur tej, ose duhet ofruar ndonjë argument tjetër, përveç fjalëve të popullit.

Vakëfnameja, tekstin dhe përkthimin me koment të së cilës po e ofrojmë këtu, nuk është origjinale, por përshkrim nga Sixhili i Gjyqit të Sheriatit në Manastir, nr. 99, i cili gjendet në Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë në Shkup.

Në qoftë se e marrim se deri më tash mbishkrimi më i vjetër i publikuar rrjedhë nga viti 842 (fillon më 24. VI. 1438),[15] kurse dokumenti më i vjetër, Vakëfnameja e Allaxha xhamisë në Shkup, nga viti 848 (fillon më 20. IV. 1444)[16], atëherë del qartë se *Vakëfnameja e Çaush begut është dokumenti më i vjetër arab ose osman i cili është hartuar tek ne dhe i cili është gjetur deri më tash.*

Teksti i Vakëfnamesë është në gjuhën arabe, i shkruar me shkrimin *rik'a*, përveç verifikimit, i cili është i shkruar me një farë përzierje midis shkrimit *rik'a* dhe *sijakat*. Teksti është i shkruar imtë dhe i vështirë për lexim, dhe sidomos në disa vende, në të cilat, si duket, ka gabuar përshkruesi, kështu që nganjëherë është vështirë të pranohet kuptimi. Për disa specifika të gjuhës nuk mund të flitet, sepse ajo,

[14] Në duart tona gjendet një përshkrim i një kronike arabe e cila bënë fjalë për monumentet osmane në Prizren, në të cilën qartë thuhet se Xhamia e Fatihut (Cuma camisi) ka qenë një nga kishat më të mëdha dhe se Fatihu e kishte shndërruar në xhami. (shih Hasan Kaleši, *Kada je crkva sv. Bogorodice Ljeviške u Prizrenu pretvorena u džamiju*).

[15] G. Elezović, *Turski spomenici*, i, str. 14.

[16] Po aty, str. 14 – 22.

kryesisht, është gjuhë standarde me të cilën është shkruar ky lloj i dokumenteve. Bie në sy edhe fakti se ka shumë gabime, sidomos në përdorimin e gjinisë tek foljet, në përdorimin e numrave, e në të shkruar, aty këtu, ka edhe disa ndikime osmane. Shumë shpesh përdoret "*teshdidi*" (dyfishimi i shkronjave - shën. përkth.), të cilin ne e kemi mënjanuar, për shkak të arsyeve teknike. Disa fjalë arabe shpeshherë janë shkruar në mënyrë fonetike si *zayr, zayid, kayin*, në vend të *zair, zaid, kain*, që rëndom është fenomen tradicional në tekstet osmane.[17]

Meqë Vakëfnameja e Çaush begut është më e vjetra në trevat tona, ajo padyshim ka ndikuar në formën e Vakëfnameve të tjera në këto treva. Në këtë përfundim na shtynë Vakëfnameja e Jusuf Çelebi Ohrizades, në të cilën laudatio-ja (tagmidi) gati është identik, sikundër është i njëjtë edhe përshkrimi i megjeve të një fshati.

Kjo Vakëfname e Çaush begut ka dy shtesa, respektivisht dy anekse (zeyl), të cilat i janë shtuar Vakëfnamesë më vonë. Si duket, Çaush begu, disa vjet pas hartimit të Vakëfnamesë, kishte vendosur t'i shtonte vakëfet e tij dhe që të mos hartonte vakëfname të re, asaj ekzistueses ia kishte shtuar këto dy shtesa. Se kemi të bëjmë me shtesa të vërteta, shihet nga përmbajtja, verifikimet e kadinjve dhe datat.

Përkthimi i Vakëfnamesë së Sunkur Çaush Begut

Manastir, midis datës 9 - 19 prill të vitit 1435.
Përkthimi i verifikimit:

I. E kam shikuar (këtë dokument) nga fillimi deri në fund dhe kam gjetur se ai është i bazuar në Sheriat, ndaj e kam firmosur dhe e kam zbatuar. Këtë (klauzolë) e ka shkruar i ngrati, Sylejmani i biri i Halilit, kadi i ushtrisë fituese[18], - lë t'u jenë të falura të dyve!

[17] Më gjerësisht për këtë dukuri në turqishte shih J. Deny, *Grammaire de la langua turque*, & 105, 116.
[18] Në origjinal Sulayman ibn Halil, al qadi bi l-askari l-manshur, d.m.th. kadiasker. Nuk kam mundur të gjejë kurrfarë të dhënash për këtë personalitet, edhe pse pozita e tij e kadiaskerit tregon se ka qenë personalitet me autoritet.

II. Ajo që ka kaluar (në dokument) është ashtu siç është ekspozuar[19], kurse gjendja është siç është shkruar. Këtë (klauzolë) e ka shkruar robi të cilit i duhet ndihmë nga Allahu xh.sh., i devotshmi Haxhi Ali Dede, kadi në Manastirin e mbrojtur.[20]

Përkthimi i Vakëfnamesë thotë:

Me Emër të Allahut mbrohem nga shejtani i mallkuar. Me Emër të Allahut të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit!

O Zoti im, Që i hap dyert, na i hap dyert më të mira! O Allahu im, bëna që të fillohet me të mira dhe të mbarohet më të mira, dhe bëna që pasojat e veprave tona të jenë të mira. Na bën që të vdesim mysliman dhe na bashko me të mirët, o Zotërues i gjithë botëve!

Faleminderit Allahut që mendja e dijetarëve është turbulluar në dashurinë e pafund ndaj Tij dhe ka humbur mendja e të urtëve në shkretëtirën e madhështisë dhe forcës së Tij, e shpirtrat e mendimtarëve janë fundosur në detet e forcës së Tij.

Më pastaj lë të jetë paqja dhe shpëtimi mbi të Dërguarin e Tij, - të cilin e ndihmoi Allahu i Gjithëdijshëm me muxhize të përhershme gjerë në fund të muajve dhe viteve, ndërmjetësuesit të cilit i pranohet ndërmjetësimi në dobi të mbarë njerëzve të cilët janë besimtarë dhe myslimanë "Atë ditë kur mëkatarët kapen për balli, për veshë dhe për këmbë"[21] - Muhamedin dhe familjen e tij të cilët flijuan shpirtrat e tyre për ngritjen e fesë islame dhe të cilët kaluan jetën e tyre në devotshmëri me ditë dhe me vite.

E më pastaj: Kjo botë e mjerë është çerdhe e së keqes dhe dëshpërimit, e jo shtëpi e gëzimit dhe haresë. Të mirat e saj janë hije të kalueshme, kurse banori i saj është një mysafir-kalimtar. Ato që i premton kjo botë nuk i zotëron, e rezultati i saj është shkatërrimi. Kurse vakëfi është vepër e mirë, dobitë e të cilit zgjasin deri në Kiamet. Ai është ndarje (e pasurisë) dobia e të cilit do të lajmërohet në Ditën e Gjyki-

[19] Dy fjalët e para janë të shkruara jo qartë. Unë konsideroj se ka elemente që të lexohet kështu siç i kam lexuar, andaj kështu edhe i kam përkthyer.
[20] Për këtë kadi të Manastirit nuk kam mundur të gjejë kurrfarë të dhënash.
[21] Kurani, LV, pjesa e dytë e ajetit 42.

mit.[22] Veprimi i tij nuk ndërpritet me vdekjen, sikundër që nuk ndërpriten as frytet e tij gjatë jetës, - siç ka thënë i pari i pejgamberëve, prijësi i të devotshmëve: "Kur vdes njeriu i ndërpriten shpërblimet nga të gjitha veprat, përveç këtyre triave: diturisë me të cilën shërbehen njerëzit, fëmijëve të mirë të cilët luten për të dhe nga sadakaja e përhershme, e kjo është vakëfi".

E, kur Allahu xh.sh. e udhëzoi atë i cili është krenaria e më të famshmëve dhe më të njohurve, atë i cili në vete unifikon veti të denja për lavd e respekt, zotërinë e komanduesve dhe të mëdhenjve, mareshalin e ushtrisë dhe armatës[23]; atë i cili ka grumbulluar cilësi të larta dhe të famshme, Sunkur begun birin e Abdullahut, të njohur si Çaush beg - lë ta ndihmojë gjithmonë Allahu! - kështu ky kishte mësuar se atë që njeriu e han e shkatërron, atë që e vesh e shqyen, e atë që e ka vakëfnuar e ruan. Për këtë arsye (Çaush begu) ka vakëfnuar, përshpirtënuar dhe e ka përcaktuar për hir të Zotit, me qëllim të fortë e jo të dobët, duke dëshiruar që të arrijë kënaqësinë e Allahut dhe duke kërkuar faljen fisnike, të gjitha ato që i ka përmendur se i posedon, se është dëshirë e tij edhe që mban në duart e tij në momentin e hartimit të kësaj Vakëfnameje dhe këto:

Të gjithë gjashtë dyqanet[24] dhe katërmbëdhjetë dhomat[25] e bashkëngjitura me dyqanet e përmendura, përtej rrugës "Kule Kapisi"[26] të Edrenesë së mbrojtur, kufijtë e të cilëve janë: rruga publike, pasuria e Hatixhesë, bija e Muhamedit, pasuria e Shahijes dhe Hanijes, vajzat e Mesudit dhe vakëfi i komandantit të njohur Firuz agë Subashit[27] në Edrenenë e mbrojtur dhe me pasurinë e bamirësit të përmendur.

[22] Në tekst yawa t-tammati wa l-mizan, d.m.th. në ditën e fatkeqësisë së madhe dhe të matjes (së sevape dhe mëkateve).

[23] Në tekst Zaimu l-guyūshi wa l-'askar.

[24] Në tekst hawānit.

[25] Në tekst huğarāt.

[26] Këto dyer kanë ekzistuar pran kullës së madhe. Janë quajtur "Kule Kapisi" për shkak se kanë pasur formën e kullave. Janë quajtur edhe Ketenciler Kapisi, për shkak se nëpër të ka hyrë në çarshi ketenxhiu. (Osman Nuri Peremeci, *Edirne Tarihi*, Stamboll, 1940, f. 40). Evlia Çelebiu nuk i përmend këto dyer.

[27] Firuz aga përmendet si një komandant i Bajazid Jeldirimit. Ka vdekur në vitin 1413. Ka ndërtuar xhaminë në Kalanë e Edrenesë. Një lagje e Edrenesë e ka mbajtur emrin e tij

Dy dyqane të tjera, përball rrugës "Kule Kapisi", në njërin prej të cilëve përgatitej çorba[28], kurse në tjetrin buka, kufijtë të cilëve ishin: vakëfi i Shah Melek beg Murshadit[29], vakëfi i Haxhi Mustaf al-Axhurrit dhe rruga publike në dy anë;

Edhe tërë dyqani i shitjes së pijeve[30] përtej rrugës së shtëpisë së bamirësit, i cili kufizohet me pasurinë e komandantit krenar, Umur begut i biri i Saruxh pashës[31] dhe me pasurinë e bamirësit të lartpërmendur dhe në dy anë me rrugën publike. Të gjitha këto i ka vakëfnuar për nevojat e mesxhidit, të cilin bamirësi i përmendur e ka ndërtuar jashtë Edrenesë[32], afër dyqaneve dhe dhomave të cituara.

(Pasha Livasi, f. 52). Ekziston edhe një Firuz aga i cili ka pasur mesxhid dhe dyqane në Edrene. Si duket xhamia e tij në Edrene është rrënuar, sepse nuk e gjejmë të përmendur në veprën e dr. Oktay Aslanape, *Edirne Osmanli Devri Abideleri*, Stamboll, 1949.

[28] Në origjinal: yu'malu fī ahadihimā ar-ruūs. Unë supozojë se kjo fjali ka kuptimin e lartcekur, por nuk jam i sigurt në këtë.

[29] Sipas të dhënave të cilat i ofron Ahmed Badi Efendiu (*Riyaz-I belde-I Edirne*, Beyazit Umumi Kytyphanesi, dorëshkrimet nr. 10391-10392, f. 54) një rrugë në Edrene është quajtur Shah Melek pasha Mahallesi, e cila gjendej në fillim të urës të quajtur Mihal Kyprysi, ndërsa në f. 44 përmendet edhe xhamia e Shah Melek pashës, e ndërtuar në vitin 832/1429. Në f. 97 përmendet edhe medreseja e tij e cila ka ekzistuar pranë xhamisë. Të dhënat për xhaminë i konfirmon edhe dr. Oktay Aslanape (vep. cit. f. 100). Mirëpo, për të nuk gjejmë të dhëna të tjera përveç se gjatë kohës së luftërave për trashëgimi ka luajtur rol të rëndësishëm dhe se gjatë kohës së sulltan Çelebiut, Mehmedit dhe Muratit II, arriti shumë dekorata. Xhamia është ruajtur deri më sot. Sipas Gekbilginit (Pasha Livasi 28, 56, 57), një lagje në Edrene është quajtur sipas emrit të gruas së tij (Shemelek pasha Zevcesi).

[30] Në tekst ğāmī'a l-hānūti l-fuqā'yyi. Për fjalën fuqa'i, tek Beloti qëndron "fabricant, marchand de bierre", ndërsa në fjalorin e Meninskit "qui potum venumdat"- d.m.th. ai i cili shet pije.

[31] Umur begu, i biri i Saruxha pashës, ka qenë vezir gjatë kohës së Mehmedit I. Një kohë të gjatë ka qenë sanxhakbeg i Çirmenit. Ka pasur vakëfe të shumta në Çermen, Jenixhe-Zagri, Tekirdag, Haskoj, Edrene dhe në disa vende të tjera. Në Çirmen ka pasur imaretin e vet, e në disa vende të tjera tyrbe. (Pasha Livasi, f. 261-265).

[32] Osman Nuri Permeci (vep. cit. f.58) e përmend këtë mesxhid të Çaush begut si dhe xhaminë dhe thotë se tani është e papërdorshme dhe e mbyllur. Është ndërtuar në vitin 841| 1445 në rrugën Horozël. Mirëpo, mendojë se kjo datë tek ai është gabim dhe se padyshim duhet shtyrë për dhjetë vjet më parë. Edhe mëhalla është quajtur Çaush beg mahallesi.

Bamirësi i përmendur ka vënë si kusht që nga të ardhurat e tyre imami i atij mesxhidi për çdo ditë të paguhet nga katër dërhem, myezini dy dërhem në ditë, dhjetë lexuesve të Kuranit, të cilët për çdo ditë do të lexojnë nga një xhyz nga Kurani fisnik t'u paguhet nga një dërhem në ditë.

Bamirësi i lartpërmendur po ashtu për nevoja të xhamisë të cilën e ka ndërtuar në qytetin e Manastirit[33], ka vakëfnuar tërë hanin të cilin bamirësi i përmendur e ka ndërtuar në qytetin e përmendur. Theksimi i kufijve të tyre është i tepërt, sepse poseduesi i tyre është i njohur në vendin e vet.

Edhe dhjetë dyqane të ngjitur njëri pas tjetrit, të cilët gjenden në mesin e tregut në qytetin e përmendur, të cilët nga të gjitha anët janë të kufizuar me rrugën publike;

Katër dyqane që gjenden në qytetin e përmendur, janë të ngjitur me tokë të bamirësit të lartpërmendur;

Gjithë kopshtin, i cili po ashtu gjendet në këtë qytet, para xhamisë, e i cili kufizohet me rrugën publike, tregun dhe në dy anë me xhaminë e përmendur.

Po ashtu, nga të ardhurat e tyre ka përcaktuar që imamit të xhamisë së përmendur t'i paguhen nga dy dërhem në ditë, hatibit të saj nga katër dërhem për çdo ditë, kurse myezinit të saj nga një dërhem për çdo ditë.

Bamirësi i lartpërmendur po ashtu për nevojat e tyrbes, të cilën e ka ndërtuar në qytetin e përmendur të Manastirit, ka vakëfnuar dy mullinj në një ndërtesë, të cilat i ka blerë nga Sinani, mbi burimin e quajtur Tobuk bunar.[34]

Te këta mullinj po ashtu ka vakëfnuar edhe mullirin tjetër, i cili në gjuhën osmane quhet "Kebe degirmeni"[35], i cili gjendet në nahijen e

[33] Në tekst fī madīnati Manaşdir.

[34] Në dorëshkrim: Tobuk (Tubuk), Bikar, Baykar, e mbase edhe mund të jetë binary në qoftë se e marrim si sagir nun. Unë e kam marrë se është bunar.

[35] *Kebe degirmeni* d.m.th. Valavicë zhguni. Kësi valavicash përmenden në shumë vakëfname.

Manastirit të mbrojtur, afër mullirit Voluk, i cili gjendet midis tyre e të cilin e ka blerë nga Jusuf Qatipi.

Dhe mullirin tjetër që gjendet brenda qytetit të cituar, të cilin e ka blerë nga Kor al-Kapsi, pran të cilit është ura e Deli Shahinit;

Dhe (ka vakëfnuar) në tërësi edhe mullirin tjetër në atë vend, afër dy mullinjve të përmendur, i cili po ashtu quhet "Kebe degirmeni";

(Ka vakëfnuar) Edhe gjithë kopshtin i cili gjendet afër tyrbes së përmendur;

Edhe gjithë vreshtin i cili gjendet afër Kemer Bunarit. Numërimi i mëgjeve të saj është i tepërt, sepse ajo është e njohur se e kujt është;

Dhe gjithë dhjetë dyqanet që gjenden në qytetin e mbrojtur të Manastirit. Të gjithë kufizohen me hanin e bamirësit të përmendur dhe në dy anë me rrugën publike.

Andaj ka caktuar si kusht që një e pesta e cila grumbullohet nga vakëfi i teqesë së përmendur t'i takojë atij të cilin e cakton myteveliu për shejh, me kusht që furnizimi i shërbyesve të tjerë të bie mbi barrën e shejhut dhe kjo nga një e pesta e lartpërmendur. Katër të pestat do të shpenzohen për ushqim të varfërve dhe të mjerëve të cilët kthejnë në këtë teqe.

Bamirësi i lartpërmendur për nevojat e hanit të vet të ndërtuar në qytetin e përmendur, po ashtu ka vakëfnuar një dyqan i cili është i ngjitur me hanin;

Bamirësi i përmendur për nevojat e mesxhidit, të cilin e ka ndërtuar në qytetin e Vidinit[36], po ashtu ka vakëfnuar njëzetë dyqane të bashkangjitur në mes veti, të cilët gjenden në Vidin, e që janë të kufizuar me rrugën publike dhe me mesxhidin e përmendur; edhe një vresht jashtë këtij qyteti, kufijtë e të cilit po të përmenden është e tepërt;

Ai ka përcaktuar si kusht që imamit të mesxhidit të përmendur t'i takojë për çdo ditë nga dy dërhem, ndërsa myezinit për çdo ditë nga një dërhem;

[36] Evlia Çelebiu (Seyāhatnāme, VI, 169) e përmend këtë xhami të Çaush begut, që d.m.th. se ka qenë mjaft e madhe, sepse ai i potencon vetëm xhamitë e mëdha. Ai po ashtu e përmend edhe hamamin e Çaush begut në Vidin, të cilat në këtë Vakëfname nuk përmenden.

Bamirësi i përmendur po ashtu shumë herë ka përcaktuar si kusht që ai vet të drejtojë dhe disponojë me të gjitha këto vakëfe gjithnjë derisa të jetë gjallë. E kur të vdes, atëherë këtë do ta bëjë biri i tij Mustafai. E kur të vdes Mustafai, atëherë këtë do ta bëjë djali i tij më i mençur, e më pastaj më të mençurit nga bijtë e bijve të tyre, gjeneratë pas gjenerate. E kur bijtë e bijve të vdesin, atëherë lë ta udhëheqin vajzat e tyre. E kur të vdesin bijtë dhe bijat, - Allahu i ruajt nga kjo! – atëherë le të udhëheqë robi më i mirë i liruar, pastaj biri më i mirë i robit të liruar dhe kështu me radhë siç u përmend më lartë.

(Vakëflënësi) po ashtu ka vënë kusht që teprica e të hyrave të një vakëfi të konsumohet për vakëfin tjetër, atëherë kur të ardhurat e vakëfit tjetër nuk janë të mjaftueshme për furnizim.

(Të gjitha këto i ka vakëfnuar) Si vakëf fuqiplotë dhe i bazuar në Sheriat dhe si përshpirtënim i qartë i cili gjithmonë duhet të respektohet në parimet e tij dhe të jetë ekzistues me kushtet e veta, gjithnjë "Derisa Allahu të mbetet Zotërues i vetëm i Tokës dhe gjithçka ekziston në të. Ai është trashëgimtari më i mirë".[37]

Atëherë e gjykoi gjykatësi, vendimi i të cilit është autoritar[38], - e ky është kadiu i cili është nënshkruar në krye (të dokumentit), Allahu xh.sh. lë ta ngrit pozitën e tij dhe lë ta ruaj nga ajo që e zhvlerëson, - për vlefshmërinë e dokumentit dhe për parevokueshmërinë (luzum), në mënyrën siç është paraparë me Sheriat. Prandaj, askujt nuk i lejohet të kërkojë çfarëdo komenti për ta ndërruar dhe ndryshuar atë. E kush bën diçka nga ato, të cilat të jetë i mallkuar nga Allahu, engjëjt dhe gjithë njerëzit. E shpërblimin pështirtënuesit do t'ia jep Allahu sikurse e ka shpallur. Allahu xh.sh. ka thënë: "Ai nuk lejon që të mos shpërblehet ai i cili bën vepër të mirë".[39]

Më tutje, bamirësi i lartpërmendur ka vakëfnuar tridhjetë mijë dërhem të farkuar në serinë e monedhave të sulltanit madhështor Murat hanit, i biri i sulltan Muhamed hanit - lë të bëhet e përhershme perandoria e tyre! - për të gjitha merematimet e të gjithë këtyre vakëfeve,

[37] Kur'ani XV, 23; XXI, 89.
[38] Në tekst: al-hākim an nāfidh al-hukm.
[39] Kurani, XVIII, pjesa e dytë e ajetit 31.

me kusht që myteveliu, në pajtim me Sheriatin, t'i fus në manipulime të ndryshme tregtare dhe të fitojë, e më pastaj fitimin ta harxhojë për mirëmbajtjen, nëse kjo është e mjaftueshme. E në qoftë se fitimi (interesi nuk mjafton), atëherë (lë të harxhojë) nga mjetet themelore aq sa është e nevojshme. (Këtë e ka përshpirtënuar) në mënyrë të rregullt dhe të bazuar në Sheriat.

Gjithë kjo është shkruar dhe për të është dëshmuar në dekadën e dytë të muajit ramazan të vitit 838 sipas hixhrit.[40]

Për ato që janë shkruar në dokument kanë dëshmuar:
Zotëriu ynë Kasimi, i biri i Ibrahimit, imam
Zotëriu ynë Hyseini, i biri i Abdullahut[41], myezin
Haxhi Ymeri, i biri i Muhamedit, rrobaqepës
Tregtari i njohur, Haxhi Hasani, i biri i Haxhi Ishakut
Haxhi Ahmed al-Qaramani
Shihabudin Shahini, i biri i Abdullahut
Sylejmani i biri i Mustafës
Zotëriu ynë Muslihudini, noter
Isai i biri i Ballabanit,
Zotëriu ynë Gaziu, imam
Zekerijai, kasap
Jusufi i biri i Aqida (?) Hanit
Sunkuri i biri i Abdullahut, noter
Hoshkademi i biri i Abdullahut
Jusufi i biri i Abdullahut
Ajdini i biri i Abdullahut
Behari i biri i Abdullahut
Jusuf al- Qatani
Haxhi Uvejsi i biri i Hyseinit

[40] Në mes 9-19 prill të vitit 1435.
[41] Në origjinal çdo kund në vend të emrit Abdullah shkruhet Abdul.

Fillimi i vakëfnamesë së Çaush beut sipas sixhilit të kadiut të Manastirit

Verifikimi i kadiut në fund të Vakëfnamesë:

Mua më është e qartë gjithë ajo që përmban kjo Vakëfname nga fillimi e deri në fund dhe këtë e konsiderojë të drejt në çështjen e themelimit të vakëfit dhe parimeve, ashtu siç është ekspozuar në të dhe si është përcaktuar vakëfi të cilin e përfshinë Vakëfnameja. E ka shkruar (këtë klauzolë) ai që lutet për falje tek Allahu xh.sh, Veliu i biri i Iljas al-Hyseinit[42], kadi i ushtrisë fitimtare, -së t'i fal Allahu të dy me mëshirën e Tij madhështore dhe me butësinë sekrete.

***

Kjo Vakëfname e Çaush begut ka dy shtesa, të cilat kanë lindur më vonë. Duket se Çaush begu, disa vite pas hartimit të Vakëfnamesë së parë, kishte vendosur të vakëfnonte edhe një sasi tjetër të pasurisë.



Fundi i vakëfnamesë së Çaush beut sipas sixhilit të kadiut të Manastirit

[42] Për këtë kadiasker nuk kam mundur të gjejë kurrfarë të dhënash.

***

Përkthimi i shtesës së parë thotë:

Pastaj bamirësi i lartpërmendur, i njohur si Çaush beg, - lë të vazhdojë prore madhështia e tij, - ka vakëfnuar sa ishte gjallë dhe me mendje të kthjelltë, të gjitha ato të cilat i ka përmendur më poshtë dhe të cilat janë të tijat:

Të gjitha tri dhomat dhe dy dyqane, në mes veti të bashkangjitur, që gjenden jashtë Edrenesë, para shtëpisë së bamirësit të lartpërmendur. Të gjitha këto janë të kufizuara me rrugën publike, me vakëfin e bamirësit të lartpërmendur, me pasurinë e të njohurit në mesin e komandantëve, Umur begut i biri i Saruxha pashës, dhe me pasurinë e Behaudin dhe Sinan Sajdalaniut me të gjitha rrugët dhe rrugicat, kufijtë dhe të drejtat brenda dhe jashtë - si vakëf i plotfuqishëm dhe i bazuar në Sheriat dhe si vakëfnim i qartë i cili duhet të respektohet, kështu u gjykua për vlefshmërinë dhe parevokushmërinë e tij nga ana e nënshkruesit, i cili u përmend më lartë, - lë të jetë e përhershme madhështia e tij! - dhe në bazë të kushteve të përmendura dhe përcaktimeve të theksuar në tekst të këtij dokumenti. Andaj ajo (shtesa) i është aneksuar Vakëfnamesë si argument në rast të ndonjë nevoje të ngutshme.

Kjo ka ndodhur në dekadën e fundit të muajit rebiul-ahir të vitit 841.[43]

Shtesa e përmendur është e plotfuqishme, andaj kam gjykuar për vlefshmërinë e saj. Këtë e ka shkruar i ngrati Ibrahimi i biri i Muhamedit të birit të Abasit, - lë të jenë të falur të dy! - me mëshirën e Zotit kadi në Edrene.[44]

Përkthimi i shtesës së dytë thotë:

Më pastaj, bamirësi ka vakëfnuar gjithë ato që u përmenden më lartë në këtë dokument sheriati, fundi i të cilit është lidhur me fillimin e

[43] Në mes 19-28 tetorit të vitit 1437.

[44] Ky i njejti kadi ka nënshkruar edhe vakëfnamenë e Saraf Haxhi Ahmedit për mesxhidin në Edrene në vitin 837 si dhe evladijetin e vakëfit të Sulejman hoxhës bir i Izedinit në Edrene në vitin 844 (Pasha Livasi, f. 271, 279).

kësaj shtese (aneksi), e ai është komandanti i madh dhe i respektuar, vizituesi i Qabesë, Haxhi Çaush begu i biri i Abdullahut[45] - lë të jetë e përhershme forca e tij! - atë që e ka thënë se e ka, se është e drejtë e tij dhe pasuri e tij, e të cilën e ka bartë në dokument si të drejtë dhe në ligj të bazuar, sulltani madhështor, perandori më i madh, halifeja në Tokë, sundues i robërve, sundues mbi sundimtarët e arabëve dhe persianëve, ruajtës i tokave, ndihmues i robërve të Zotit, respektues i vendeve të dalluar nga Zoti, ai i cili i nënshtron armiqtë e Zotit, ndihmues i dëshmorëve dhe luftëtar për fe[46], sulltan i deteve dhe tokave, shpata e fesë islame dhe e myslimanëve, sulltani fitimtar, Murati i biri i sulltanit fatlum Muhamedit, i biri i sulltanit dëshmor (shahid) Bajazid hanit, - lë t'i shtojë Allahu dashamirët e tyre! - (dhe këto):

Gjithë fshatin e quajtur Popolzhani[47] në nahijen e Florinit, vilajeti i Leshkerit[48], kufijtë e të cilit fillojnë nga burimi i cili është në skaj të ultësirës dhe përfundojnë tek rruga e afërt. Nga aty kufiri shkon pandërprerë gjerë ke lumi, e nga lumi gjerë ke toka e cila është pronë e kovaçit. E, nga ajo shkon gjerë ke rrjedha e lumit, e më pastaj e kalon atë pikërisht tek rruga, pastaj vazhdon pandërprerë gjerë ke toka e cila është pronë e dhimiut Dragomir, e nga ajo gjerë ke rruga që çon kah Manastiri. Prej aty ngritët në breg, e nga aty gjerë ke mali që gjendet në breg. Nga aty zgjatet gjerë ke toka e cila është pronë e dhimiut Dobri, e nga aty kalon rrugës së afërt dhe vazhdon gjerë ke mali. Nga aty, gjerë ke mali i cili është në lugun e lumit, e nga aty (nga lugu) arrin gjerë ke toka e cila i takon dhimiut Pazhan(?), e që gjendet në ultësirë; nga aty gjerë shkon gjerë ke mali i njohur si Kara Cali, e nga aty, gjerë kë ferrat të cilat gjenden në greminë; nga aty ngritët drejt bregut lartë dhe vazhdon gjerë ke ferrat të cilat gjenden në breg, e nga aty, gjerë ke plepat. Nga aty vazhdon gjerë ke ultësira e madhe, e pa-

[45] Shihet që Qaush begu në mes viteve 1435 dhe 1437 ka qenë në haxhillëk.

[46] Në origjinal nushratu l-guzati ëa l-mugahidin.

[47] Unë e kam lexuar Popolzhani mbase mund të lexohet edhe Poplezhani dhe Poplozhani etj. Mirëpo, është e qartë se ky është toponim me prejardhje sllave. Në trevën e Kërqovës edhe sot ekziston fshati Popolzhani.

[48] Në origjinal Fi nahiya Florina min ëilayati Leshkeri.

staj nga mesi i ultësirës së përmendur vazhdon gjerë në mal, e nga aty deri tek gurët të cilët janë të vendosur në breg. Nga aty shkon deri tek rruga e cila është në ultësirë, e nga aty vazhdon deri tek ura. Nga aty ngritët dhe vazhdon deri tek ferrat në rrugën e cila çon në Florinë. Nga aty deri tek mali, i cili është në breg, e nga aty deri tek gurët të cilët janë të vendosur në skaj të ultësirës; nga aty (nga gurët) shkon në burimin e përmendur në fillim të përcaktimit të mëgjeve. Këtë e ka vakëfnuar me të gjitha mëgjet e tij, rrugët dhe rrugicat, burimet dhe lumenjtë, kodrat dhe bjeshkët, me tokën e cila ujitet dhe e cila nuk ujitet, me objektet dhe ndërtimet, me drunjtë frytdhënës dhe jofrytëdhënës, me të gjitha të drejtat të cilat i ka vakëfi brenda dhe jashtë tij, ajo që është e ngjitur me të dhe që është i ndarë nga ai në të gjitha varianttet dhe në të gjitha gjendjet - për nevoja të mesxhidit/xhamisë[49], tyrbes dhe të dy mesxhideve të tjerë, e që të gjithë janë përmendur në tekstin e Vakëfnamesë se theksuar. (Të gjitha këto) i ka përkushtuar si vakëf të plotfuqishëm dhe të bazuar në Sheriat dhe si të tillë duhet respektuar.

Bamirësi i lartpërmendur, - lë të pranohet bamirësia e tij, - ka venë si kusht që të ardhurat e këtij fshati me kufijtë e përmendur të konsumohen në mënyrë të barabartë për nevojat e xhamisë, tyrbes dhe dy mesxhideve.

Po ashtu ka venë si kusht që përherë të respektohen të gjitha kushtet dhe rregullat e shkruar në Vakëfnamenë e përmendur.

Andaj fshati, mëgjet e të cilit u përshkruan, është shndërruar në vakëf në mënyrën siç e parasheh Sheriati, kështu që çdo periudhë kohore duhet të përforcohet, të gjithë fëmijët ta konsiderojnë të plotfuqishëm dhe për çdo çast të përforcohet. Ai nuk mund të shitet, as të falet, as të deponohet a të bëhet tramp, të ndryshohet a të trashëgohet "gjithnjë deri sa të mbetët Allahu Sundues i vetëm në Tokë dhe gjithçka që ka në të. Ai është trashëgimtari më i mirë".[50]

[49] Në tekst: masgid al-gami do të thotë faltore për xhemat. Për atë se cka është mesxhidi dhe cka xhamia dhe për dallimet në mes tyre krahaso EI masdjid.

[50] Qur'ani, XV, 23; XXI, 89: XXVI, 58.

E kush e ndryshon pasi ta ketë dëgjuar, atëherë mëkati bie mbi ata që e ndryshojnë. Zoti të gjitha i dëgjon dhe Ai është i Gjithëdijshëm. Kurse bamirësit, Allahu do t'ia jep shpërblimin për atë që ka bërë, për atë që ka dëshiruar dhe që ka dashur.

Datimi ka ndodhur dhe ky dokument është hartuar në dekadën e dytë të muajit rexhep në vitin 843 sipas hixhrit.[51]

Në fund të Vakëfnamesë është ky verifikim:

Atë që përmban kjo shkresë në çështjen e vendosjes së mbikëqyrësit[52] dhe të shërbimit mbikëqyrës, është konfirmuar tek unë.

E ka shkruar ai i cili ka nevojë për Allahun xh.sh., Muhamedi i biri Feramurzit[53], kadi në Edrene, - lë të jenë të falur të dy dhe lë të jenë të mëshiruar!

Marrë nga: Dr. Hasan Kaleshi
"Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji
na arapskom jeziku", Prishtinë, 1972, s. 65 -87.

Përgatiti:
Ismail Rexhepi
Sadik Mehmeti

[51] Në mes18-27 dhjetor të vitit 1439.

[52] Në origjinal nadhir- mbikqyrës, nga bëmirësi ose kadiu personi i caktuar që mbikëqyrte punën dhe shërbimin e mytevelisë. Në dokumente që ekzistojnë te ne, e edhe në vendet tjera që kanë qenë nën pushtetin osman, gjithnjë në mënyrë precize janë caktuar detyrat e mytevelisë dhe mbikëqyrësit, kështu që kurrë nuk janë ndërlikuar ato. Mirëpo, në disa vende fjala nadhir ka qenë sinonim për mytevelin. Konsideroj se edhe me këtë rast fjalën nadhir duhet kuptuar si drejtues, e jo siç është bërë zakon te ne mbikëqyrës. Në të vërtetë, në Vakëfname askund nuk përmendet nadhir, as që ekzistojnë farë kushtesh në lidhje me të.

[53] Për Muhammad b. Faramurz b. Ali Molla Husrev që ka qenë i njohur si shkencëtar i madh dhe personalitet me autoritet në lëmin e Sheriatit, shih GAL, II, f.226. Vepra e tij "Durar al-hukkam fi sharh gurar al-ahkam", e shkruar në gjuhën arabe dhe përkthyer në osmanishte, ka qenë shumë e popullarizuar dhe është gjetur gati në të gjitha bibliotekat e librave dorëshkrime. Në këtë vepër janë shkruar shumë glosa, gjë që fletë për popullaritetin e saj.

Hasan Kaleshi

THE WAQFNAME AND THE WAQFS OF SUNKUR ÇAUSH BEG FROM MANASTIR
(Summary)

The oldest waqfname in Yugoslavia

Until 1956, the oldest mosque in Yugoslavia and one of the oldest in the Balkans was situated on the left bank of the Dragor River in Manastir (at the place, which was previously known as “tereke pazari”). Later on, an apartment building was erected at this spot. The mosque was known as “Eski Cami” or the Old Mosque. In official documents it was known as the “Çaush bey camisi”. Its constructor was Sunkur beg (also known as Çaush beg).

حسن كاليشى

وثيقة الوقف و الاوقاف الخاصة بسنكور تشاؤش بك من مناستير
(خلاصة البحث)

أقدم وثيقة وقف في يوغسلافيا السابقة

في الشارع المسمى اليوم "ايفان ميلوتينوفيش" بمدينة "مناستير" في الجانب الايسر من النهر "دراغور" الذي تم فيه بناء عمارة سكنية و كان يسمى هذا المكان في السابق "سوق القمح" حتى سنة 1956 كان به أقدم جامع في يوغسلافيا السابقة و أحد أقدم الجوامع في شبه جزيرة البلقان. و كان بسمى هذا الجامع "أسكى جامع" أي الجامع القديم و كان يسمى في الوثائق الرسمية "جامع تشاؤش بك" الشخص الذي قام ببناء هذا الجامع إسمه "سنكور بك" و المعروف "بتشاؤش بك".

JURISPRUDENCA ISLAME

Abdullah Nasih Ulvan

ISLAMI - LIGJ I JETËS - (2)

Dëshmi për vlefshmërinë e Sheriatit

Ekzistojnë numër i madh i dëshmive të cilat konfirmojnë vlefshmërinë e Sheriatit dhe se dallohet me karakteristikën e përtëritjes, zhvillimit, plotësimit të nevojave të njerëzve, kontribuimit për një progres kulturor dhe kreativitetit material në çdo kohë dhe vend. Ato përfshijnë:

1. Dëshminë e realitetit dhe parimeve ligjore
2. Dëshminë e konferencave ndërkombëtare
3. Dëshminë e mendimtarëve të drejtë të Perëndimit

Dëshmia e realitetit

Teoritë juridike, për të cilat epoka jonë bashkëkohore dhe filozofitë juridike janë krenare, në të vërtetë u kanë paraprirë parimet, rregullat dhe jurisprudenca e Sheriatit islam pesëmbëdhjetë shekuj më parë. Juristi dhe profesori i njohur Abdul Kadir Udah në hyrjen e librit të tij "E drejta penale islame" ka shqyrtuar një grup të standardeve dhe parimeve legjislative të cilat nuk janë dekretuar në ligjet bashkëkohore.

- Prej tyre është parimi i drejtësisë. Ai thotë: Islami e urdhëron në tekste të qarta që të gjithë njerëzit janë të barabartë pa përjashtim. Nuk ka përparësi për një njeri ndaj tjetrit apo për një grup për shkak të racës apo ngjyrës. E as nuk ka epërsi për një sundimtar ndaj të sunduarve. All-llahu xh.sh. thotë:

"O ju që besuat, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur *(nga të këqijat)****…".*** *(el-Huxhuratë: 13)*

Megjithëkëtë, ligjet pozitive nuk e kanë dekretuar këtë parim deri në fund të shekullit të XVIII dhe e kanë kufizuar zbatimin e tij vetëm për raste të veçanta. Por, Ligji islam e ka zgjeruar aplikimin e tij duke përfshirë të gjitha rastet.

- Parimi i dytë është parimi i lirisë. Islami ka urdhëruar lirinë e mendimit, besimit dhe fjalës. Prof. Abdul Kadir ka shqyrtuar tekstet e sakta të cilat konfirmojnë këto liri.
- Parimi i tretë është shura apo parimi i konsultimit. Kur'ani e ka konturuar këtë parim në periudhën mekase. All-llahu xh.sh. thotë:

"…ata që konsultohen mes vete…". *(esh-Shura: 3)*

Gjithashtu e ka theksuar edhe në periudhën medinase:

"…e konsultohu me ta…". *(Ali Imran: 159)*

Sheriati ka dekretuar parimin e shurasë pesëmbëdhjetë shekuj më parë dhe i ka paraprirë ligjeve pozitive, të cilat janë bazuar në të pas Revolucionit Francez. Ligji britanik e ka dekretuar parimin e shurasë në shekullin e XVII, ndërsa SHBA në mesin e shekullit XVIII.

Gjithashtu ekziston edhe parimi i kufizimit të autoritetit të udhëheqësit. Ai është i bazuar në tri parime:

1. Kufizimi i autoritetit të udhëheqësit
2. Ndjekja penale nëse kryen ndonjë krim apo agresion
3. Umeti apo kombi ka të drejtë ta shkarkojë.

Ky parim përfshin tri elemente, të cilat kufizojnë autoritetin e udhëheqësit në kohën kur autoriteti i sundimtarëve në gjithë botën ishte absolut. Kështu, sheriati islam i detyron udhëheqësit që të veprojnë brenda kufijve dhe limiteve të caktuar. Nëse i kalojnë këta kufij, nënshtetasit e tyre kanë të drejtë të rebelohen kundër tyre.

Ekzistojnë parimet lidhur me shkrimin e borxheve dhe hyrjen në një kontratë. Për shembull, parimi i shkrimit të borxheve qoftë i madh apo i vogël, parimi që borxhliu duhet të diktojë kontratën pasi që ai është më i dobët nga dy kontraktuesit dhe parimi i ndalimit të fshehjes së dëshmitarit apo ndalimit të tij që të dëshmojë para gjykatësit.

Të gjitha këto parime janë përmendur në ajetin 282, të sures el-Bekare, i cili njihet edhe si ajeti i borxhit. All-llahu xh.sh. thotë:

"O besimtarë, kur merrni hua prej njëri tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë…". (el-Bekare: 282)

Ekzistojnë edhe rregulla tjera të cilat rezultojnë nga këto parime. Para katërmbëdhjetë shekujve kishte shumë akuza nga armiqtë lidhur me disa rregulla dhe parime të sheriatit islam. Megjithëkëtë, kundërshtarët në kohët e sotme janë drejtuar që t'i pranojnë këto rregulla dhe parime që të parandalojnë të keqen dhe të arrijnë drejtësinë për individët dhe shoqëritë. Prej këtyre rregullave do të përmendim:

1. **Divorci**: Vendet perëndimore janë detyruar ta pranojnë atë, madje edhe shumë ideologji të krishtera si në Itali etj. Në Holandë është mbajtur një konferencë për të drejtën private ndërkombëtare të quajtur "sesioni i njëmbëdhjetë", ku u diskutua traktati lidhur me përgatitjen e një dokumenti ku do të njihej divorci dhe ndarja ligjore në nivel ndërkombëtar.[1] Duke vepruar në këtë mënyrë, ata në fakt iu kthyen rregullave të Islamit.

2. **Kamata**: Ekonomistët perëndimorë kanë pohuar se luan rol jetik në zhvillimin e një ekonomie. Megjithëkëtë, ekonomistë tjerë të njohur kanë kritikuar idenë e kamatës në emër të ekonomisë, jo në emër të fesë siç është rasti i një ekonomisti britanik, i cili ka ardhur në përfundim se drejtësia e plotë nuk mund të arrihet vetëm se me largimin e normave të interesit. Prof. Schacht nga Gjermania thotë: "Përmes llogaritjeve të sakta matematikore, do të kuptojmë se paratë fitohen vetëm nga një grup i fajdexhinjve".[2] Është mirë për lexuesit të shohin shkrimet e prof. Isa Abdusë dhe Ahmed Nexhar dhe librin të titulluar "Ekonomia jonë" nga Muhamed Bekir es-Sadr, apo "Studime ekonomike" nga Ebu A'la el-Mevdudi, ku shpresojmë se lexuesi do të gjejë shpjegim të plotë lidhur me këtë çështje.

[1] Shih "Enciklopedia Islame e Jurisprudencës" nga prof. Xhemaludin Atije, fq. 145.

Dëshmia e konferencave ndërkombëtare

Konferencat ndërkombëtare më të njohura që janë mbajtur në shekullin XX në mbështetje të Sheriatit islam janë:

A - Më 1937, është mbajtur një konferencë ndërkombëtare për krahasimin e ligjeve në Holandë. Në të mori pjesë edhe ez-Az'hari esh-Sherifi, me dy përfaqësues të cilët paraqitën leksionet me titull: "Përgjegjësia penale dhe civile në Islam" dhe "Pavarësia e Seriatit islam". Ata argumentuan kundër thënieve të anshme të cilat thoshin se Sheriati islam buron nga e drejta romake.

Si rezultat i kësaj, konferenca nxori përfundime historike dhe të rëndësishme për juristët perëndimorë:

1. Sheriati islam është njëri prej burimeve të ligjit shoqëror.
2. Është mjaft qartë i definuar, jetik dhe përgjegjës që të zhvillohet.
3. Është i pavarur dhe jo i nxjerrë nga ligjet tjera.[3]

B - Më 1943 është mbajtur një konferencë ndërkombëtare për juristë në të njëjtin qytet, ku morën pjesë 53 shtete. Profesorë dhe juristë më të njohur nga e gjithë bota morën pjesë në këtë konferencë. Në përfundim të saj, kjo konferencë miratoi rezolutën vijuese: "Për shkak të fleksibilitetit dhe rëndësisë së Sheriatit islam, Shoqata e Juristëve Botërorë ka miratuar studimin krahasues të këtij legjislacioni dhe e ka mbështetur atë".[4]

[2] Shih "fi Dhilal el-Kur'an", nga Sejid Kutbi, vëll. 1, sure el-Bekare, ajeti 275.
[3] Nga libri "Legjislacioni islam" nga profesorët: es-Sajes, es-Subhi dhe el-Barbari.
[4] "El-Med'hal el-fikhi el-a'm" nga Mustafa ez-Zerka.

C - Më 1950, Departamenti i juristëve lindorë në kompleksin ndërkombëtar për krahasimin e ligjeve organizoi një konferencë për studimin e jurisprudencës islame në Fakultetin Juridik të Universitetit të Parisit. Kjo konferencë u organizua me titullin "Një javë e jurisprudencës islame". U ftuan shumë profesorë të juridikut nga fakultetet arabe dhe jo arabe, profesorë nga Universiteti i el-Az'harit, juristë francez e arabë si dhe orientalistë. Katër profesorë egjiptianë nga el-Az'hari dhe universitetet tjera dhe dy nga Siria morën pjesë në këtë konferencë. Kjo konferencë ndërkombëtare specifikoi që temat që do të paraqiteshin të trajtonin pesë pikat e mëposhtme:

1. Vërtetimin e pronës
2. Përshtatjen e interesit shoqëror
3. Përgjegjësinë penale
4. Opinionet e pavarura të shkollave juridike janë të ndikuara nga njëra-tjetra
5. Qëndrimin e Islamit ndaj kamatës

Ligjëratat u mbajtën në gjuhën frënge dhe për çdo pikë ishte caktuar një ditë e veçantë. Çdo ligjëratë u pasua me diskutime me ligjëruesin.

Gjatë diskutimit, një anëtar i cili ishte udhëheqësi i juristëve në Paris tha: "Nuk e di se si duhet të bashkërendojmë mes asaj që lidhet me pasivitetin dhe jurisprudencën islame dhe paaftësisë së saj që të jetë ligj legjislativ që i plotëson nevojat e shoqërisë moderne dhe mes asaj që jemi duke e dëgjuar në diskutime dhe ligjërime të cilat e dëshmojnë të kundërtën". Në fund, pjesëmarrësit e kësaj konference u pajtuan me raportin vijues: "Java e jurisprudencës islame dhe diskutimet e përqendruara rreth saj", përfundojmë që:

1. Parimet e jurisprudencës islame janë të vlefshme që të jenë të pavarura dhe të jenë ligj legjislativ.
2. Dallimi mes shkollave të ndryshme juridike lidhur me këto parime përfshijnë numër të madh të nocioneve, informatave dhe parimeve juridike, me të cilat jurisprudenca islame mund t'u përgjigjet pozitivisht të gjitha nevojave të jetës moderne dhe të bashkërendojë mes këtyre nevojave.[5]

Dëshmitë e këtyre konferencave ndërkombëtare dhe konferencave të specializuara janë dëshmi e qartë për kompetencën e përjetshme, përtëritjen, zhvillimin, gjithëpërfshirjen dhe vazhdimësinë e Sheriatit islam. All-llahu xh.sh. thotë:

"… po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më i mirë se ai i All-llahut?" *(el-Maide: 50)*

Dëshmitë e mendimtarëve të drejtë perëndimorë

Këto dëshmi janë të shumta. Nuk janë nga mendimtarët islamë dhe profesorët e jurisprudencës në universitete. Por, ata janë mendimtarë të njohur e të përgatitur në ligjin pozitiv. Këto dëshmi janë të mbështetura me dëshmi të qarta dhe pranim të kompetencës, mirësisë, prioritetit dhe epërsisë së Sheriatit islam.

Do të paraqesim disa nga dëshmitë e këtyre mendimtarëve të drejtë perëndimorë për ata njerëz të cilët besojnë në çdo fjalë që vjen nga Perëndimi.

- Profesori perëndimor Eziko Insabato thotë: "Sheriati islam dhe rregullat e tij mbipeshojnë ligjet evropiane. Veç kësaj, ai i jep botës ligj të fortë dhe të pandryshueshëm".
- Dekani i Fakultetit Juridik në Universitetin e Vjenës, Sherbli, në një konferencë të mbajtur më 1927 thotë: "Njerëzimi është krenar për një njeri si Muhamedi, sepse pavarësisht analfabetizmit të tij, arriti të sjellë një ligj, të cilin nëse e praktikojmë pas 2000 vjetëve, do të jetojmë në lumturi".
- Filozofi britanik Bernard Shaw thotë: "Muhamedi erdhi me një fe madhështore dhe me vlerë, pasi që përmban gjallëri të mrekullueshme. Gjithashtu ajo është e vetmja fe e cila është në harmoni me të gjitha fazat e ndryshme të jetës. Mendoj që Muhamedi duhet të quhet shpëtimtari i njerëzimit. Nëse një njeri sikur Muhamedi do

[5] "El-Med'hal el-fikhi el-a'm" nga Mustafa ez-Zerka.

të sundonte botën, atëherë ai do të zgjidhte të gjitha problemet e saj".

- Në librin e tij "Veçoritë e njerëzimit në histori", historiani britanik Wales thotë; "Evropa i detyrohet shumë Islamit, e më së shumti për ligjet e tyre administrative dhe tregtare të cilat janë të cituara nga ligjet e tij".
- Historiani francez Sidue thekson faktin që: "Ligjet e Napoleonit janë marrë nga libri i jurisprudencës islame "Sherh ed-Dardir ala metn Halil" të Imam Malikut.
- Gustavi transmeton që profesor Leiberi thotë; "Pa arabët, Renesanca e Evropës moderne do të shtyhej për disa shekuj".
- Në librin e tij "Arabët në Spanjë", Lane Pool thotë: "Evropa analfabete ishte injorante dhe pa të drejta, derisa Spanja ishte plot me dituri dhe kulturë".
- Edmon Burke thotë: "Ligji me të cilën erdhi Muhamedi është i disiplinuar dhe i organizon të gjitha klasat e njerëzve. Ai është një ligj shumë i saktë dhe Sheriati islam është legjislacioni më i drejtë, i cili nuk i ka paraprirë apo nuk do të pasohet me ndonjë sistem të ngjashëm".
- Më lart kemi cekur që një jurist i njohur ka thënë: "Jurisprudenca islame përmban të gjitha rregullat. Jam çuditur: pse ju (myslimanët) përfitoni sisteme dhe rregulla të cilat janë në përputhje me kohën dhe vendin tuaj?"

Këto thënie dhe të tjera, dëshmojnë qartë që Sheriati islam kujdeset për anën juridike dhe legjislative, si dhe pasurinë kulturore dhe shkencore. Ne u jemi mirënjohës mendimtarëve perëndimorë, të cilët e kanë pranuar këtë fakt. Një poet arab thotë:

"Të gjithë njerëzit dëshmojnë për vlerën e tij
Ne u jemi mirënjohës për
atë që armiqtë e Islamit dëshmojnë për të".

Pjesa 3

DALLIMI MES FESË SONË DHE TË TJERËVE

Disa prej atyre që janë të ndikuar nga invadimi intelektual ngrenë këtë dyshim:

Evropa ka arritur civilizimin dhe diturinë pas Mesjetës kur ndau religjionin prej shtetit dhe e largoi dominimin e tij nga qeveria dhe politika. Ne duhet të veprojmë në të njëjtën mënyrë që edhe ne të arrijmë shkëlqimin shkencor dhe dominimin politik.

Për t'iu kundërvënë këtij dyshimi jo të drejtë, themi që ka dallim shumë të madh mes dy feve. Që të informojmë lexuesin për dallimet, duhet së pari të shpjegojmë rrethanat të cilat e shtyn Evropën të ndajë fenë nga shteti. Pas kësaj mund të bëjmë një krahasim mes rrethanave dhe karakteristikave të Sheriatit islam. Në këtë mënyrë, do të kuptojmë dallimet e mëdha mes dy sistemeve. Karakteristikat e Sheriatit islam i kemi trajtuar në pjesën e parë.

Rrethanat që shtyn ndarjen e fesë nga politika apo shteti në Evropë janë:

1. Krishterimi, gjatë tre shekujve të parë thirri për besimin e mësimeve të Jezusit, do të thotë për dashuri dhe mëshirë. Gjithashtu i thirrën idhujtarët dhe çifutët, me mençuri dhe në mënyrën më të mirë, që të pranojnë Krishterimin. Veç kësaj, nuk kishte ndonjë kundërshtar e as kontradiktë apo pengesë për reforma, dituri apo renesancë. Gjatë këtyre shekujve, klerikët nuk ishin shpatë e drejtuar nga liberalët, mendimtarët, reformatorët dhe politikanët, por madje Krishterimi i përkrahte qëllimet dhe sistemet e shtetit, ngase mësimet e Jezusit, ashtu siç thotë Mateu thonë: "Të drejtat e Cezarit jepja Cezarit, dhe të drejtat e Zotit jepja Zotit". Kjo do të thotë që mesazhi i Jezusit gjatë kësaj kohe dallohej nga aspektet vijuese:

I. Ishte mesazh i mirësjelljes, parimeve morale dhe përmirësimit shpirtëror.

II. Nuk ndërhyri në politikën e shtetit e as nuk ishte i interesuar në regjimin dhe administratën e tij.
III. Ishte zbritur për të plotësuar mësimet e Musait a.s.
IV. Nuk përmbante sistemet klerikale që klerit i jepnin të drejtën të kontrollonin besimet dhe vetëdijen e njerëzve.

2. Kur perandori Konstandin deklaroi mbrojtjen e Krishterimit dhe klerit më 324 e.s., filloi një periudhë e re dhe ata morën një numër të madh privilegjesh. Perandori e liroi priftin nga shumë detyrime, si dhe pronat e kishës ishin të liruara nga taksat. Perandori Tudor, pasoi politikën e Konstandinit dhe u dha madje edhe më shumë privilegje. Formoi gjykata kishtare dhe i liroi klerikët prej të gjitha taksave. Në shekullin e V, klerikët u bënë klasa elite në shoqëri dhe e dominuan atë gjatë gjithë periudhës mesjetare. Mund të themi që historia e Krishterimit gjatë kësaj periudhe ishte historia e kishës dhe e klerikëve të saj. Dominimi i tyre është manifestuar në fushat vijuese:

I. Në fushën politike

Gjatë periudhës mesjetare, klerikët filluan të ndërhyjnë në politikën e shteteve të krishtera, duke emëruar mbretër kënd dëshirojnë dhe duke shkarkuar ata të cilët nuk i pëlqenin. Në librin "Shenjat e historisë të periudhës mesjetare", fq. 137 mund të lexojmë:

"Papa Gregori VII, më 1085 deklaroi që kisha kishte dominim në gjithë botën. Ajo rrjedh drejtpërdrejt nga Zoti dhe i siguron mbretërit e princërit me këtë dominim. Papa kishte fuqi absolute në gjithë botën. Ai emëronte peshkopët dhe i shkarkonte ata. Gjithashtu ai kishte të drejtë të shkarkonte mbretërit, pasi që ai ishte zot i tyre. Ai kërkon llogari për atë që bëjnë njerëzit, ndërsa ai vetë nuk bën të pyetet".

Në të njëjtin libër, fq. 140, thuhet: "Mizoria e papës është manifestuar kur ka shkarkuar perandorin, i cili është detyruar të qëndrojë i zhveshur dhe i zbathur në shi për tre ditë para portës së papës. Ai priti për lejen dhe faljen e mëkateve të tij, ashtu siç është praktikuar gjatë kohës së perandorit Henri V, kur u shkarkua më 1076 e.s. Nganjëherë

perandori duhej të gjunjëzohej para papës, ashtu siç bëri Frederiku kur u shkarkua nga papa më 1177.

II. Në fushën sociale

Klerikët u bënë klasa superiore. Ekzistonin gjykata të veçanta për ta, taksa të veçanta, nder i veçantë, prona të veçanta dhe burgje të veçanta, ku të burgosurit mund të kalonin tërë jetën. Gjithashtu papa nxori urdhrat më 1296, që asnjë taksë nuk do të paguhej për asnjë autoritet të kohës, dhe shkarkimi do të ishte dënimi për çdo autoritet i cili pranonte taksat. Kjo është përmendur në librin e përmendur më lart.

III. Në fushën intelektuale

Kisha ishte e paaftë të duronte kundërshtarët e saj në religjion dhe besim. Prandaj, klerikët ndërmorën luftërat (kryqëzatat) kundër myslimanëve, pasi që ishin të zemëruar me Islamin dhe myslimanët. Kryqëzatat përfunduan pas 200 vjetëve të shkatërrimit, rrënimit dhe vuajtjeve. Gjithashtu ndërmorën luftëra kundër të krishterëve heretikë, të cilët dyshuan në vërtetësinë e parimeve krishtere dhe korrigjuan interpretimin e Inxhilit. Ata shkatërruan qytete të banuara dhe të urbanizuara mirë. Nxitën luftë kundër pasuesve të Valdos, i cili kritikoi luksin dhe pasurinë e klerikëve. Si rezultat i kësaj, papa bëri luftë kundër tij e pasuesve të tij dhe lejoi çdo njeri injorant dhe kriminel të marrë pjesë në këtë luftë. Ata u sollën me mizori ndaj tyre. Ndërmorën luftë kundër Martin Luterit dhe protestantëve dhe kryen masakrën e tmerrshme më 1572, në të cilën u therën në mënyrën më të ashpër 100.000 protestantë. Kisha gjithashtu formoi kisha të kontrollit për të hetuar besimet e njerëzve të akuzuar, do të thotë myslimanët[6], çifutët, protestantët e ortodoksët si dhe sinqeriteti e besnikëria e tyre ndaj kishës. Gjithashtu kisha luftoi kundër mendimtarëve, filozofëve dhe reformuesve. Disa prej tyre i dogjën si Xhon Husi më 1415, Xherum el-Baragi, Xhoni i Arkut dhe Bruno më 1589 dhe shumë të tjerë.

[6] Muslimanët u detyruan të konvertohen në Krishterizëm

Burgosën të tjerë si Abilardi, Rogjer Bakoni, Galileo dhe të tjerë. Disa vdiqën në burg, derisa të tjerët u dogjën dhe të tjerët u dëbuan nga vendlindja e tyre.

Disa historianë konstatojnë se numri i viktimave të hetimit arrin 8 milionë, që nga formimi i gjykatave të kontrollit në shekullin e XIII e deri në largimin e tyre në shekullin e XVIII. Kisha jo vetëm që i ka ndjekur mendimtarët e shkencëtarët në trupin dhe ushqimin e tyre, por gjithashtu në librat e mendimet e tyre. Ata i dogjën librat e tyre dhe i konfiskuan publikimet e tyre. Kushdo që ka thënë që toka sillet rreth diellit apo se njeriu është i lirë në kuptimin e Librit të Shenjtë pa pasur nevojë në ndërmjetësimin e priftit, e kanë konsideruar si jobesimtarë.

3. Ishte gjë e natyrshme që njerëzit të shpërthejnë me zemërim pas këtyre vuajtjeve. Krishterimi burimor dhe Inxhili nuk i shkaktuan këto vuajtje, por ishin klerikët, të cilët ishin mizorë, egoistë, ndryshues të mësimeve të Jezusit, si dhe egoja e tyre që të jenë superiorë dhe të sundojnë njerëzit. Konflikti në fillim filloi mes kishës dhe perandorëve e mbretërve, e pastaj mes kishës dhe këshillave publik më 1301, kur Parlamenti britanik mori vendim që papa nuk ka asnjë të drejtë që të ndërhyjë në politikën e brendshme. I njëjti vendim u mor në Francë nga këshilli i klasave të kombit më 1302.

Shkrimtarë, mendimtarë dhe figura tjera filluan të revoltohen kundër sistemit të kishës. Për shembull:

- Revolucioni i të qytetëruarve kundër degjenerimit të kishës është nxitur nga Tomas Lindsej, Martin Luteri dhe Kalvini.
- Revolucioni i mendimtarëve kundër sistemit kulturor dhe shkencor të kishës filloi nga Rogjer Bakoni dhe Galileo.
- Revolucioni i filozofëve dhe shkrimtarëve kundër kishës e klerikëve filloi me Dekartin, Volterin dhe Zhak Ruson.

Më 1546, Luteri në një fjalim të mbajtur para fisnikëve gjermanë tha: “Është e turpshme për papën të kërkojë të drejtën e vendosjes në perandori, sepse Jezusi ka thënë: “Mbretërit janë të njollosur në tokë, por papa nuk është si mbretërit”. Prandaj, prifti i Romës duhet të bra-

ktisë të drejtat e pretenduara të tij në mbretëritë e Napolit dhe Sicilisë. E drejta e tij në Romë është e barabartë me të drejtën time. Papa duhet të lutet dhe duhet t’i lejojë princërit të sundojnë botën”.[7]

4. Më në fund, shpërtheu Revolucioni Francez më 1789, për të cilin klerikët thanë: “Kthehuni vendeve tuaja të origjinës, binduni kishës dhe mos i kundërshtoni mësimet e Jezusit”.

Qysh atëherë, Evropa ka deklaruar parimin e “ndarjes së fesë nga politika” dhe “largimin e klerikëve nga ndërhyrja në politikën e shtetit” dhe “Cezarit duhet t’i jepet e drejta e tij dhe Zotit e Drejta e Tij”.

Padyshim, ky ishte rezultati përfundimtar për kishën e cila i kaloi kufijtë e detyrës së saj themelore, kundërshtoi mësimet e Jezusit dhe mori të drejtat dhe sovranitetin e shtetit. Kjo ishte fshehtësia reale në luftën kundër kishës dhe thirrjes për ndarjen e fesë nga politika e shtetit dhe ndalimin e klerikëve nga ndërhyrja në qeveri.

Pa dyshim, sistemi dhe rregullat gjithëpërfshirëse të Islamit janë plotësisht të ndryshme nga ato të Krishterimit. Përgjegjësia e dijetarëve myslimanë është e ndryshme nga përgjegjësia e klerikëve në Krishterim.

Nëse Krishterimi burimor i jep Cezarit të drejtat e tij dhe Zotit të drejtat e Tij, Islami me ligjin e tij gjithëpërfshirës ka vendosur parimet e qeverisjes, mënyrës së jetesës dhe sistemeve të shtetit që e obligojnë çdo udhëheqës që me saktësi dhe në tërësi të zbatojë këto parime, rregulla dhe sisteme. Nëse largohet nga këto parime apo i zbaton vetëm disa prej tyre, do të pyetet para All-llahut Ditën e Gjykimit, do të jetë përgjegjës para njerëzve të tij, të cilët duhet ta shkarkojnë, përgjegjës para historisë dhe gjeneratave të ardhshme, të cilët duhet ta kujtojnë si një prej kriminelëve të njerëzimit.

Nëse Krishterimi burimor kufizoi detyrën e klerit në lartësimin shpirtëror, përmirësimin moral dhe pastrimin psikik, Islami i jep çdo myslimani të drejtën të rebelohet kundër udhëheqësit nëse devijon dhe duhet ta këshillojë nëse është i pakujdesshëm.

[7] Cituar nga "Shenjat e shtetit" të Ahmed Tevfikut, fq. 338.

Në Islam gjenden personalitete të shumta të cilët janë revoltuar kundër udhëheqësve të tyre dhe kanë kundërshtuar politikën e tyre si Se'id ibn el-Musejeb, Se'id ibn Xhubejr, Ahmed ibn Hanbel, el-Iz ibn Abduselam, Mundhir ibn Se'id, Selem ibn Dinar, Sejid Kutbi, Abdul-aziz el-Bedri, Mervan Hadid dhe të tjerë nga kohët e vjetra e bashkë-kohore. Këta personalitete kujtohen në histori si personalitetet e kujtimet më të mira dhe janë bërë ideal për gjeneratat e ardhshme për sakrificë dhe trimëri. All-llahu xh.sh. i mëshiroftë dhe i shpërbleftë me shkallën më të lartë të xhenetit.

Çdo njeri duhet ta dijë që çdo shoqëri myslimane është thirrëse për rrugën e All-llahut dhe Islamit. Prandaj, sipas këtij koncepti, myslimani i zbaton mësimet e Islamit, thërret në rrugën e All-llahut dhe thotë vetëm të drejtën kudo që është, duke mos i frikësuar askujt përveç All-llahut.

Juristët dhe dijetarët islamë janë të ngarkuar me përgjegjësinë e përhapjes së shpalljes së All-llahut dhe ndjekjen e mësimeve islame në bazë të asaj që janë gjëja më e mirë për njerëzit dhe janë të aftë që të sjellin argumente bindëse për jobesimtarët e devijuesit.

Në këtë mënyrë, çdo njeri i arsyeshëm e i mençur do ta kuptojë faktin që në Islam nuk ekziston i ashtuquajturi "kleriku" apo "njeriu fetar". Kjo është një fjalë kleri që vjen nga Perëndimi në shekullin e XVIII. Kundërshtarët e Islamit dëshirojnë të vendosin juristët dhe dijetarët myslimanë në të njëjtën nivel si klerikët dhe të kufizojnë detyrën e tyre vetëm në xhami dhe drejtimin e natyrës shpirtërore të njerëzve. Gjithashtu ata dëshirojnë që t'i largojnë nga kritika e udhëheqësve të tyre apo në ndërhyrjen e tyre në politikë apo mbajtjen e posteve në ministri apo çështje administrative, pasi që kjo nuk është brenga e tyre. Padyshim, armiqtë e Islamit dëshirojnë të arrijnë këtë qëllim.

Në përfundim, themi që në Islam nuk ekzistojnë të ashtuquajturit njerëzit e fesë apo klerikët si në Krishterim. Por, ekzistojnë njerëz të cilët janë të specializuar në jurisprudencë, gjuhë, biografinë e Muhamedit a.s., histori etj. Ky specializim nuk është pengesë për pjesëmarrjen e dijetarëve në qeverisje apo politikën e shtetit, sa kohë që

janë të aftë dhe kompetent në kryerjen e përgjegjësive të tyre. Në këtë mënyrë, ata janë njerëz të cilët mund të veprojnë mirë apo keq. Me fjalë të tjera, ai nuk është i pagabueshëm, pasi që pagabueshmëria u takon vetëm profetëve. Të gjithë njerëzit veprojnë mirë dhe keq. Transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: *"Të gjithë bijtë e Ademit janë gabimtarë, por më i miri prej tyre është ai që pendohet"*. Imam Maliku, kur vizitoi varrin e Muhamedit a.s. tha: "Të gjithë njerëzit bëjnë mirë apo keq, përveç këtij që është i pastruar në këtë varr". Me këtë i referohej varrit të Muhamedit a.s.

Dijetari i drejtë është ai që i zbaton të drejtat, që janë në përputhje me mësimet islame, e jo me teket e paragjykimet e tij. Ai duhet të jetë i kënaqur me administrimin islam, madje edhe nëse nuk përkon me interesin e tij. Ai duhet të pranojë kritikën dhe këshillën nëse vepron keq.

Sipas këtij koncepti, ai nuk i jep vetes të drejtën e shenjtërisë dhe madhështisë, përveç kur është në pajtueshmëri me mësimet islame.[8]

Përveç karakteristikave të lartpërmendura të Islamit, që dallohet me karakterin hyjnor, universalizëm dhe gjithëpërfshirje, ai gjithashtu dallohet me përtëritje, zhvillim dhe vazhdimësi. Ai e ekulibron jetën e kësaj bote dhe jetës tjetër. Ai e bën ekuilibrin mes interesit të individit dhe interesit të shoqërisë. Ai gjithashtu dallohet me përjetësi, vulë e shpalljeve dhe dominim, si dhe lehtësi, thjeshtësi dhe racionalizëm. Gjithashtu ai dallohet me arritjen e drejtësisë absolute për njerëzimin.

Përveç karakteristikave të mëparshme, realiteti i teorive bashkëkohore ligjore siç është teoria e barazisë, lirisë dhe konsultimit janë të bazuara në sheriatin islam. Konferencat ndërkombëtare si ato që janë mbajtur në Hagë dhe Paris, si dhe filozofët perëndimorë siç është Bernard Shou e Sheberli e dëshmojnë këtë fakt.

Përveç ato që cekëm më lart, Sheriati islam përfshin parimet, sistemet dhe rregullat me të cilat lidhen feja dhe politika e shtetit dhe ku Islami e çështjet e përditshme janë të ndërthura.

[8] Shih librin tonë "Edukimi i fëmijës në Islam", kapitulli "Përgjegjësia e edukimit shoqëror", fq. 425

Si e lidh Islami fenë dhe politikën?

Islami është fe pasi që bazohet në parimet vijuese:

- Mbështetet në besimin hyjnor, i cili e liron mendjen nga paragjykimi dhe thirrjet për besim në Njëshmërinë e All-llahut, i cili nuk ka shok.
- Mbështetet në adhurimin absolut, i cili e lartëson shpirtin, pastron moralin dhe e përmirëson punën.
- Mbështetet në parimet konstante të moralit, të cilat e zhvillojnë personalitetin e njeriut dhe e ngrenë në shkallë të ndershmërisë e respektit.

Islami është edhe politikë, pasi që shteti mbështetet në Islam në parimet vijuese:

1. Kryetari, perandori apo halifi, zgjidhet me vetëdëshirë nga njerëzit. All-llahu xh.sh. thotë:

"…ata që konsultohen mes vete…". *(esh-Shura: 38)*

Imam Ahmedi transmeton nga Muhamedi a.s. se ka thënë: "Cilido që zgjidhet udhëheqës pa konsultimin e myslimanëve, zgjedhja e tij konsiderohet e pavlefshme".

2. Qeveria: duhet të formohet vetëm nga njerëzit e aftë dhe kompetentë, pavarësisht pasurisë, fuqisë apo klasës shoqërore të tyre. Transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë*: "Kushdo që padrejtësisht emëron udhëheqës të myslimanëve, All-llahu do ta mallkon"*. Dhe në një version tjetër: *"Kushdo që cakton udhëheqës të ndonjë qyteti të myslimanëve derisa ka udhëheqës më të mirë, ai e ka tradhtuar All-llahun, të Dërguarin e tij dhe besimtarët"*.

3. Ligjet civile, politike dhe ekonomike: Islami ka vënë rregullat e plota, parimet e përgjithshme dhe ka lënë hollësitë e atyre parimeve dhe rregullave në kompetencë të interpretuesve të autorizuar që të arrijnë interesat e njerëzve në të gjitha kohët dhe vendet. Këto detaje nuk duhet kurrë të bien ndesh me ndonjë tekst të qartë të Kur'anit, synetit, analogjisë dhe konsensusit.

4. Rregullat për kriminelët dhe kodi penal: në Islam këto rregulla njihen me emrin "dënimet e urdhëruara" apo "hudud" dhe "dënimet e lira për t'u zbatuar". Sa u përket "dënimeve të urdhëruara", ato përfshijnë dënimin për largim nga feja, dënimin për vrasje, dënimin për vjedhje, për shpifje, për pirjen e alkoolit, për kurvëri dhe dënimin për plaçkitjen në rrugë. Islami i konturon dënimet e urdhëruara në Kur'an dhe hadithet profetike, ndërsa "dënimet e lira për t'u zbatuar"[9] nuk janë urdhëruar. Kjo duhet të aplikohet kundër kujtdo që bën dëme të pacaktuara. Kjo mund të jetë sharje, rrahje, burgim, dëbim apo gjobë.

5. Ushtri të fortë dhe mirë të përgatitur për luftimin kundër armiqve të Islamit, mbrojtjen e vendit të myslimanëve nga sulmi dhe ngritjen e fjalës së All-llahut. All-llahu xh.sh. thotë:

"E ju përgatituni sa të keni mundësi force *(mjete luftarake)* ***e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre*** *(që tradhtojnë)* ***e me të*** *(me përgatitje)* ***ta frikësoni armikun e All-llahut e armikun tuaj…".*** *(el-Enfalë: 60)*

6. Autoritet të pavarur gjyqësor, i cili gjykon njësoj mes udhëheqësit dhe njeriut të thjeshtë. All-llahu xh.sh. thotë:

"O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të All-llahut edhe nëse është kundër *(interesit)* ***vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmve…".*** *(en-Nisa: 135)*

Funksioni i autoritetit gjyqësor është të vendosë drejtësinë mes gjithë njerëzve pavarësisht fesë, racës apo ngjyrës së tyre. All-llahu xh.sh. thotë:

"…dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve…". *(en-Nisa: 58)*

7. Bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me ndershmërinë, drejtësinë, dashurinë e ndërsjellë dhe trajtimin e mirë.

"All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësinë me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej

[9] Dënimet e lira për t'u zbatuar aplikohen për ofendime, për të cilat nuk zbatohet dënimi i urdhëruar

shtëpive tuaja. All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë". *(el-Mumtehine: 8)*

8. Thirrjen për të mësuar shkencat e dobishme qofshin ato fetare apo shkenca të kësaj bote sa kohë që është në interes të Islamit dhe botës. All-llahu xh.sh. thotë:

"…thuaj: "Zoti im, më shto dituri". *(Ta ha: 114)*

9. Shpresë të vazhdueshme për të arritur lavdinë, fuqinë dhe dinjitetin për myslimanët. All-llahu xh.sh. thotë:

"…e tërë krenaria i takon All-llahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë". *(el-Munafikunë: 8)*

10. Mbrojtje të vazhdueshme të opinionit publik duke zbatuar sistemin hisba. Kjo do të thotë urdhëron gjithë atë që Islami urdhëron dhe ndalon gjithë atë që Islami ndalon, praktikimi i mësimeve islame, plotësimi i nevojave të njerëzve dhe mbrojtja e tyre nga dëmi e lëndimi. Umeti duhet të kujdeset për këtë sistem dhe të emëron person kompetentë në çdo qytet me qëllim të zbatimit të kësaj detyre me sinqeritet dhe besnikëri. All-llahu xh.sh. thotë:

"Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillë janë ata të shpëtuarit". *(Ali Imran: 104)*

Veç kësaj, çdo mysliman e myslimane duhet të mbështet këtë mbrojtje dhe të marrë përgjegjësinë për zhvillimin e tij. All-llahu xh.sh. thotë:

"Besimtarët dhe besimtaret janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zekatin, respektojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhënjyes, i urtë". *(et-Tevbe: 71)*

Ekzistojnë parime dhe fundamente shumë të rëndësishme të cilat konfirmojnë që Islami ndërthur fenë dhe shtetin, besimin dhe sistemin, adhurimin dhe politikën, Kur'anin dhe shpatën, si dhe qeverisjen e jetën e përditshme. Këto karakteristika të Islamit janë plotësisht të ndryshme nga parimet e Krishterimit.

Lexues i nderuar, më lart kemi shpjeguar qëndrimin e kishës ndaj shkencës e shkencëtarëve, mendimtarëve dhe reformuesve. E kemi parë se si klerikët i kanë shtrembëruar dhe ndryshuar mësimet e Jezusit; si janë dalluar me sjellje të këqija dhe mizore; si e kanë konsideruar veten superior ndaj të tjerëve dhe si e kanë marrë veten e tyre si Zot për njerëz. Ata nuk janë përgjigjur për veprimet e tyre.

Bazuar në këtë frymë vëllazërore dhe kooperuese mes fesë dhe shtetit, Islami ka vendosur kulturë të përjetshme dhe shtetësi të zhvilluar. Në histori lexojmë që ata që kanë marrë pjesë në ngritjen e kulturës islame kanë qenë prej racave dhe profileve të ndryshme, do të thotë shkencëtarë, filozofë, shkrimtarë, mjekë, historianë etj., të cilët kanë bashkëpunuar ndërmjet vete për të arritur një qëllim të vetëm.

Me pak fjalë, kohët e progresit, fuqisë dhe kulturës së Islamit ishin periudha të vëllazërisë islame mes fesë dhe diturisë. Juristët në atë kohë e siguruan shtetin me rregullat dhe ligjet e domosdoshme islame për të zgjidhur problemet e myslimanëve. Kjo karakteristikë e Sheriatit islam nuk mund të gjendet në asnjë fe apo sistem tjetër. Do të mbetet sheriati i botës derisa bota t'i kthehet All-llahut.

Pjesa 4

SHEMBUJ TË LAVDISË DHE TË CIVILIZIMIT

Cila ishte lavdia dhe nderi i parë që e arritën myslimanët kur besonin në gjithëpërfshirjen, universalizmin dhe përjetësinë e Islamit?

Cili ishte civilizimi dhe urbanizimi të cilin e arritën kur besuan Islamin dhe e themeluan atë si fe e shtet, adhurim e politikë, Kur'an e shpatë, qeveri dhe mënyrë jetese?

Madhështia dhe nderi të cilin e arritën

Kur sahabët dhe pasuesit e tyre besuan në këto karakteristika, ata dolën nga një mjedis i ngushtë në një botë të gjerë. Ata i siguruan njerëzit, nderuan njeriun dhe thirrën në Njëshmërinë e All-llahut. Gjithashtu vendosën rregullat e civilizimit e urbanizimit, përhapën diturinë dhe parimet e lirisë e të barazisë, dhe i nxorën njerëzit nga adhurimi i krijesave në adhurimin e All-llahut, nga një mjedis i ngushtë në atë të gjerë, dhe nga padrejtësia e feve të mëparshme në drejtësinë e Islamit.

Muhamedi a.s. vdiq pasi që Islami u përhap në gjithë Gadishullin Arabik, Jemen, Bahrejn dhe Nexhd. Gjatë jetës së katër halifëve të drejtë, dy perandoritë më të mëdha të asaj kohe Roma dhe Bizanti u pushtuan. Gjithashtu u pushtuan Pakistani, Armenia, Rusia, Siria, Egjipti, Barka, Tripoli dhe vende tjera afrikane. Të gjitha këto vende u pushtuan brenda 35 vjetëve. Në periudhën e emevijëve, shteti u zgjerua edhe më shumë duke përfshirë Afganistanin, Indinë dhe arriti në kufijtë e Kinës në lindje dhe të Spanjës në perëndim. Në periudhën e abasitëve, halifi Harun Rashidi përshkroi madhështinë dhe superioritetin e Islamit në gjithë botën dhe u drejtua një reje që kalonte mbi të duke thënë: “Kudo që lëshon shi, taksa e të mbjellave tua do të merret nga ne”.

Myslimanët e ruajtën pozitën e madhështisë e të lavdisë derisa halifati u abrogua nga Kemal Ataturku në vitin 1924. Që nga ajo kohë,

madhështia e lavdia ka humbur nga vendet islame, dobësia i ka kapluar dhe janë bërë vegël në duart e vendeve perëndimore, si Britania e Franca. Veç kësaj, kishte edhe shumë forca të liga masone, komplotues, kolonialistë tiranë dhe çifutë të ligë të cilët i luftuan myslimanët gjatë Luftës së Dytë Botërore. Nuk ka forcë e fuqi më të madhe se All-llahu.

Pavarësisht gjithë kësaj, lajme të gëzuara për gjallërinë dhe informimin kanë mbizotëruar në gjeneratën e re myslimane. Irani, për shembull u çlirua, Afganistani është çliruar nga Rusia. Kombet myslimane siç janë Pakistani, Turqia dhe Afrika Veriore filluan të zgjohen. Në vitet vijuese, të gjitha vendet myslimane do të çlirohen dhe do të bashkohen nën flamurin e halifëve të drejtë. Prandaj, myslimanët do të kënaqen me fitoren e All-llahut.

Civilizimi dhe urbanizimi të cilin e kanë arritur

Historia dhe filozofët perëndimorë të drejtë dëshmojnë që myslimanët me racat, ngjyrat dhe gjuhët e tyre të ndryshme kanë lënë një trashëgimi kulturore të civilizuar e gjithëpërfshirëse në epokat e arta të Islamit. Gjeneratat ende janë duke përfituar nga kjo. Gjithashtu historianët pajtohen që civilizimi islam është transmetuar në Evropë përmes rrugëve vijuese:

I. Përmes Spanjës
II. Përmes Sicilisë
III. Përmes kryqëzatave
IV. Shkollave të përkthimit në Spanjë, Francë dhe Itali
V. Përmes tregtarëve myslimanë të cilët e përhapën Islamin në shumicën e vendeve evropiane dhe aziatike.

Padyshim, **rruga e Spanjës** ishte rruga kryesore për civilizimin islam në të gjitha fushat shkencore, teknike dhe letrare.

Evropa ka vazhduar të përfitojë nga shkencat dhe civilizimi islam për shumë shekuj derisa kanë arritur kulmin e civilizimit material dhe shkencave teknike në kohën tonë moderne.

Islami është fe që thërret për shkencë dhe ofron çelësin për rilindje. Kur'ani është burimi kryesor i civilizimit. Pa të gjitha këto elemente, nuk do të ekzistonte asnjë gjeni apo mendje e zgjuar në mesin e paraardhësve tanë. Ata përhapën diturinë, shkencën, urbanizimin dhe civilizimin. Emrat e këtyre njerëzve ende qarkullojnë në Lindje dhe Perëndim. Njerëzit janë ende krenarë për ta dhe ende përfitojnë nga dituria e tyre.

Do të përmend disa nga këta shkencëtarë të shquar që rinia jonë të mund të kuptojë se si e kanë ngritur një kulturë të tillë madhështore në histori.

- Ibn Halduni: shkencëtar në histori, sociologji dhe ndërtimtari.
- Er-Rrazi: shkencëtar në mjekësi.
- Ibn Sina: shkencëtar në filozofi.
- El-Idrisi: shkencëtar në gjeografi.
- El-Havarizmi: shkencëtar në matematikë dhe astronomi.
- Ibn el-Hejthem: shkencëtar në fizikë dhe optikë.
- Ez-Zahravi: shkencëtar në kirurgji.
- Ebu Zekerija el-Avam: shkencëtar në botanikë.
- Ebu el-Bina: shkencëtar në aritmetikë.
- Ebu er-Rrejhan el-Bejruni: shkencëtar në historinë e lashtë dhe arkeologji.
- Imam el-Gazali: shkencëtar në kritikë, edukim dhe shërim të sëmundjeve psikologjike.
- Drejtuesit e katër shkollave të mendimit islam, imam Ebu Hanife, Maliku, Shafi'iu, ibn Hanbel: shkencëtar në jurisprudencë dhe ligje.

Njerëzit lexojnë për biografitë e tyre, transmetojnë diturinë e tyre dhe orientalistët lavdërojnë njohurinë dhe civilizimin e tyre madhështor. Ata ishin burime rrezatuese të udhëzimit dhe të mirësjelljes për njerëzimin në gjithë kohën që do të vijë.

Perëndimorët gjithashtu kanë dëshmuar për rilindjen kulturore dhe shkencore të Islamit, do të thotë mjekësi, kimi, fizikë, matematikë, filozofi etj.

- Në librin "Dielli i arabëve ndriçon Perëndimin", autori prof. Zigrid Hunka, pranon rolin e shkencave dhe civilizimit islam mbi kulturën dhe shkencat madhështore të Evropës në fusha të ndryshme".
- Në librin e tij "Debati mes shkencës dhe fesë", profesori Duvejber në Universitetin e Nju-Jorkut thotë: "Kur hilafeti u mor nga Me'muni më 813, Bagdadi u bë kryeqyteti madhështor i shkencës në botë. Ai grumbulloi libra të pafund dhe i shpërbleu dijetarët me pasuri e respekt". Pasi që numëron favoret e shkencave natyrore të myslimanëve, vazhdon të thotë: "Ata i promovuan shkencat e vjetra dhe themeluan shkenca të reja. Universiteti islam ishte i hapur për studentët evropianë, të cilët erdhën të studiojnë. Mbretërit dhe princat evropianë erdhën te vendet myslimane që të trajtohen dhe të shërohen".
- Në librin e tij "Historia e arabëve", Sidiloti thotë: "Myslimanët ishin të ditur në filozofi dhe arte në periudhën mesjetare. Ata i përhapën këto shkenca gjithkund. Renesanca dhe zhvillimi në Evropë buron nga këto shkenca".
- Në librin e tij "Civilizimi arab", Luponi thotë: "Nuk ka komb më udhëheqës dhe më aktiv se arabët. Të gjitha kombet të cilët patën kontakt me arabët, madje edhe për një periudhë të shkurtër, përfituan prej kulturës së tyre". Në të njëjtën libër në një vend tjetër thotë: "Ndikimi i arabëve të Lindjes nuk është manifestuar vetëm në fe, gjuhë dhe arte, por ata patën ndikim të madh edhe në sferën e kulturës shkencore".
- Prof. Leiberi, në të njëjtën libër të përmendur më parë thotë: "Pa arabët, renesanca bashkëkohore e Evropës do vonohej për disa shekuj".
- Në bisedën e tij për artet islame, shkencëtari Sheristi thotë: "Evropa e vlerësoi artin islam si një prej mrekullive të botës për disa mijëra vite".
- Orientalisti holandez Duzi thotë: "Nuk kishte asnjë njeri analfabet në Spanjë gjatë sundimit islam, derisa në Evropë të gjithë njerëzit ishin analfabetë me përjashtim të klasës së lartë të priftërinjve".

- Në librin e tij “Formimi i Njerëzimi”, Privolti thotë: “Ditura është gjëja më e rëndësishme që është marrë nga kultura islame në botën bashkëkohore. Të gjitha fushat në të cilat u zhvillua Evropa u ndikuan nga kultura islame. Këto fakte tregojnë që Islami është fe kulturore dhe konstruktive”.

Këto thënie dhe të tjera tregojnë sinqerisht dhe dëshmojnë me të drejtë për fuqinë e mësimeve islame, të cilat thërrasin për shkencë dhe kulturë. Kemi cekur thëniet e perëndimorëve vetëm për ata persona, të cilët besojnë në fjalën e një perëndimori nëse e shkruan atë.

Fjala përfundimtare
- Rinia është e ngarkuar me përgjegjësi të madhe -

Sot, bota është e zhytur në materializëm, shthurje, shkatërrim, padrejtësi, tirani dhe ide e mendime të ndryshme të liga.

Shumica e vendeve përpiqen të mbërthejnë kulturën njerëzore dhe të asgjësojnë vlerat njerëzore, moralin madhështor dhe mesazhet e profetëve, të skllavërojnë vendet e pazhvilluara, të dëbojnë njerëzit e pafajshëm nga vendet e tyre, të rrëmbejnë pasurinë e tyre dhe të shpërngulin fëmijët, gratë e tyre dhe të moshuarit.

Cila është zgjidhja, e cila e mbron botën nga këto fatkeqësi dhe katastrofa?

Cila është zgjidhja, e cila mund ta ruajë njerëzimin nga prishja intelektuale dhe shkatërrimi moral?

Cila është zgjidhja, e cila i mbron civilët paqësorë nga një luftë shkatërrimtare? Me fjalë të tjera, çdo të thotë të shpëtosh e të mbrosh njeriun?

Fatkeqësisht, mendimtarët e botës dhe filozofët e Lindjes e të Perëndimit thonë që: “Vlerat shpirtërore e shoqërore dhe sistemi politik i Islamit e meritojnë të bartin flamurin e mendimit, reformës dhe parimeve që të mbrohet njeriu nga fatkeqësitë e kequdhëzimit, korruptimit dhe katastrofës.

Do të përsëris thëniet e mendimtarëve të botës rreth Mesazhit Hyjnor të Islamit:

- Në librin e tij “Lidhjet e mendimit dhe shpirtit”, Iljaz Ebu Shebka thotë: “Rënia e kulturës arabe në Spanjë ishte një ogur i keq për Spanjën dhe Evropën. Lumturia mbizotëronte në Spanjë gjatë sundimit arab. Pas rënies, shkatërrimi zëvendësoi pasurinë, bukurinë dhe prodhimtarinë”.
- Filozofi britanik Bernard Shaw thotë: “Muhamedi erdhi me një fe madhështore dhe me vlerë, pasi që përfshin një vitalitet të mrekullueshëm. Gjithashtu është feja e vetme që është në harmoni me të gjitha fazat e ndryshme të jetës. Mendoj që Muhamedi duhet të quhet shpëtimtar i njerëzimit. Nëse një njeri si Muhamedi do të sundonte botën, do t’i zgjidhte të gjitha problemet e saj”.
- Dekani i fakultetit Juridik në Universitetin e Vjenës, në një konferencë të mbajtur më 1927 thotë: “Njerëzimi është krenar për një njeri si Muhamedi, ngase pavarësisht analfabetizmit të tij, njohu ligjin, i cili nëse e praktikojmë pas 2000 vjetëve, do të jetojmë në lumturi”.
- Edmon Burk thotë: “Ligji me të cilin erdhi Muhamedi është i disiplinuar dhe i organizon tërë klasat e njerëzve. Ai është një ligj i saktë dhe ligji islam është legjislacioni më i drejtë, i cili nuk është paraprirë apo do të pasohet me ndonjë sistem të tillë të ngjashëm”.

Prandaj, rinia duhet të bartë përgjegjësinë e mbrojtjes së njeriut nga materializmi, prishja dhe luftërat shkatërrimtare. Gjithashtu duhet t'i këshillojnë ata të cilët janë të ndikuar nga mendimi perëndimor e sekular dhe t'i informojnë për faktet e karakteristikat e Islamit.

Pas kësaj, do të luash rolin e thirrësve për mesazhin e Islamit, në mënyrë që prosperiteti dhe stabiliteti të mund të dominojë në botë, dhe drita e besimit dhe mësimeve të Kur'anit do të mbizotërojë përsëri mes njerëzimit.

Ligji islam, ashtu siç e kemi përmendur më lart, dallohet me karakterin hyjnor, universalizëm, gjithëpërfshirje, zhvillim dhe përjetësi.

- Dallohet me karakter hyjnor, pasi që është shpallje nga All-llahu xh.sh.
- Dallohet me universalizëm, pasi që është për gjithë njerëzimin.
- Dallohet me gjithëpërfshirje, pasi që është shpallur të jetë mënyrë e jetës.

- Dallohet me zhvillim, pasi që i plotëson nevojat e njerëzve në çdo kohë dhe vend.
- Dallohet me përjetësi, pasi që përmban mësimet të cilat janë të përshtatshme për të gjitha kohët, deri në fundin e botës.

O rini e dashur! A e dini se cila është epidemia e atyre që luftojnë Islamin? Ajo është keqkuptimi i Islamit. Po t'i kuptojnë drejt faktet dhe karakteristikat e Islamit, atëherë nuk do të tregonin ashpërsi ndaj Islamit, e as të ndjekin trendët e mendimit sekular dhe invadimit intelektual.

Sipas mendimit tim, nëse njerëzit e ndikuar nga invadimi intelektual, do të gjenin dikë që do t'i udhëzonte në rrugën e drejtë, do t'u tregonte faktet, t'u zbulonte parimet e harmonizuara të Islamit lidhur me kozmosin, jetën dhe njeriun, të largonte mbulesën nga sytë e tyre, dhe të largonte dyshimin nga zemrat e tyre, ata sigurisht se do të zmbrapseshin nga të gjitha akuzat e rreme dhe parimet mosbesuese. Ata gjithashtu do t'i kthehen besimit në Islam si fe dhe shtet, si besim dhe politikë, dhe do të bëhen thirrës e luftëtarë për hir të tij. Ata do t'i udhëzonin të gabuarit në rrugën e drejtë dhe ata të cilët janë larguar nga shoqëria dhe së bashku do të themelojnë shtetin e pritur islam nën flamurin e halifit të drejtë. Sigurisht, çdo gjë është e lehtë për All-llahun. O rini! Shtoni thirrjen tuaj për All-llahun që kombi mysliman të mund të zgjohet nga kjo thirrje: All-llahu është qëllimi ynë, Muhamedi është lideri ynë, Kur'ani është kushtetua jonë, xhihadi është rruga jonë, vdekja për hir të All-llahut është shpresa jonë më e madhe.

Nëse do të jenë vigjilentë, do të rikthejnë lavdinë dhe madhështinë e tyre të humbur. Nëse luajnë rolin me të cilin i ka ngarkuar All-llahu, me siguri se do t'ia kthejnë botës tiparet e stërgjyshërve tanë, trimërinë e udhëheqësve tanë të mëparshëm, fitoret si ato në Bedr, Kadisije, Jermuk, Hitin, mesazhin islam dhe mësimet kur'anore. All-llahu xh.sh. thotë:

"Dhe thuaj: "Veproni, All-llahu do ta shohë veprën tuaj, edhe i Dërguari i Tij e besimtarët, e më vonë do të ktheheni te Njohësi i të fshehtës dhe të dukshmes, e do t'ju njoftojë për atë që vepruat". *(et-Tevbe: 105).*

Përktheu nga arabishtja:
Fuad Morina

Abdullah Nasih Ulwan

ISLAM-THE LAW OF LIFE - (2)

(Summary)

There are a considerable number of facts that corroborate the importance of the Sharia. It contributes to cultural progress and material creativity. These facts include:

1. Facts provided by reality
2. Facts provided by international conferences
3. Facts provided by western scholars

عبدالله ناصح علوان

الاسلام – قانون الحياة (2)

(خلاصة البحث)

شهادات حول قيمة الشريعة

هناك عدد كبير من الشهادات التي تؤكد قيمة و اهمية الشريعة الاسلامية و مميزاتها بنموها و تطورها و تلبية متطلبات احتياجات الانسان الروحية و المادية و الثقافية في كل مكان و زمان.

و هي تشمل:

1- شهادة الواقعية و مبادئ القانون.

2- شهادة المناقشة في المؤتمرات الدولية.

3- شهادة و آداء المفكرين الغربيين.

JURISPRUDENCË ISLAME

Abdurrahman es-Sa'di

SI TË JETOJMË TË LUMTUR

Në këtë artikull do të mundohemi të shpjegojmë kuptimin e lumturisë së plotë, që është qëllimi final të cilin e kërkon i gjithë njerëzimi në jetën e kësaj bote. Ekzistojnë mendime dhe opinione kontradiktore lidhur me kuptimin e lumturisë dhe mënyrat e rrugët për të arritur atë. Disa mendojnë që lumturia arrihet me mbledhjen e parave dhe investimin e tyre. Të tjerët mendojnë që lumturia arrihet duke pasur trup të shëndetshëm apo siguri e qetësi në shtëpi. Të tjerë mendojnë që lumturia arrihet me mbledhjen e pasurisë nga burime të ligjshme dhe duke kërkuar dituri të dobishme dhe të tjerë të cilët besojnë që lumturia arrihet përmes besimit të drejtë, rrugës së qëndrueshme dhe qëndrimit të vendosur në këtë rrugë. Nuk ka dyshim se të gjitha këto veçori janë të inkorporuara në kuptimin e përgjithshëm të lumturisë, sa kohë që janë në përputhje me porositë dhe normat e vendosura nga Islami.

Ekzistojnë dy lloje lumturish: së pari, është lumturia e përkohshme, e kufizuar, e ndryshueshme dhe e caktuar e kësaj bote. Së dyti, është lumturia në botën tjetër, e cila është e pakufizuar dhe e përjetshme. Të dy këto lloj lumturish janë të lidhura me njëra-tjetrën, pasi që lumturia në këtë jetë plotësohet vetëm me arritjen e lumturisë së plotë dhe të përkryer në botën tjetër, e cila arrihet përmes kënaqësisë së All-llahut xh.sh. ndaj besimtarëve të vërtetë, që i frikësohen dhe i nënshtrohen vetëm Atij. All-llahu xh.sh. thotë:

"Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë *(në këtë botë),* ***e*** *(në botën tjetër)* ***do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre".*** *(en-Nahl: 97)*

Kështu, lumturia e vërtetë dhe e përhershme arrihet përmes bindjes së All-llahut xh.sh. dhe bindjes së të dërguarit të Tij, Muhamedit a.s. Në të kundërtën, vuajtja e mjerimi arrihet përmes mosbindjes së All-llahut xh.sh. dhe të Dërguarit të Tij a.s. All-llahu xh.sh. thotë:

"…e kush respekton All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, ai ka arritur një sukses të madh" *(el-Ahzabë: 71)*

"...e kush kundërshton All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg të së vërtetës" *(el-Ahzabë: 36)*

Komoditeti, kënaqësia dhe zhdukja e ankthit e depresionit nga zemra janë veçori që kërkohen të arrihen nga i gjithë njerëzimi, në mënyrë që të sigurojnë jetë të mirë, lumturi dhe kënaqësi për veten e tyre. Ekzistojnë aspekte fetare, natyrore dhe praktike për të arritur këtë qëllim, por këto aspekte ndërthuren vetëm te besimtarët e vërtetë. Të tjerët që nuk janë besimtarë, si ata që ndiejnë ndonjëherë një lloj lumturie për shkak të një filozofie që e kanë inkorporuar në jetët e tyre apo për arsye tjera, ende u mungojnë shumë aspekte të kënaqësisë dhe aspekte të dobishme të lumturisë që kanë destinim më të mirë e përfundim të lumtur.

Këtu, do të përmend disa prej këtyre mënyrave e rrugëve që ndihmojnë arritjen e lumturisë, të cilën e synon fuqishëm tërë njerëzimi. Një pjesë e njerëzimit arritën një pjesë më të mirë të lumturisë dhe jetuan një jetë të mirë me të, derisa shumë të tjerë dështuan të arrijnë ndonjë pjesë të lumturisë dhe si pasojë e kësaj jetuan jetë të mjerë. Një pjesë e njerëzimit ishte në mes, arritën pjesë të lumturisë sipas shkallës së suksesit që arritën (me Dëshirën e All-llahut xh.sh.). Vetëm All-llahu xh.sh. i drejton për në sukses dhe Vetëm nga Ai duhet të kërkohet gjithë ajo që është e mirë e drejtë dhe mbrojtja nga të gjitha të këqijat.

Besimi i drejtë dhe veprat e mira

Besimi i drejtë dhe bërja e veprave të mira janë themelet dhe rruga e mënyra më e mirë për të arritur lumturinë. All-llahu xh.sh. thotë:

"Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë *(në këtë botë),* ***e*** *(në botën tjetër)* ***do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre".*** *(en-Nahl: 97)*

All-llahu xh.sh. në këtë ajet kur'anor tregon që u ka premtuar atyre që ndërthurin besimin dhe veprat e mira që do të kenë jetë të mirë në këtë botë dhe shpërblime të mrekullueshme në këtë jetë e në jetën e Ahiretit. Prapa këtij premtimi qëndron një arsye e mirë. Ata që besojnë drejtë All-llahun x.sh. (rezultatet e të cilit përfshijnë veprat e mira që pastrojnë zemrën, sjellja e mirë në këtë botë dhe në botën tjetër) kanë bazat dhe burimet mbi të cilat mbështetet trajtimi i duhur me çfarëdo që arrijnë nga lumturia dhe kënaqësia, si dhe nga depresioni, ankthi dhe shqetësimi. Për shembull, besimtarët ndihen të lumtur dhe të kënaqur duke i pranuar këto dhe duke falënderuar dhe duke i përdorur ato në mënyrë të favorshme. Kjo sjellje e mirë u jep më shumë kënaqësi, ngjall shpresën në ata që këto të mira do të mbesin dhe do të bekohen dhe se ata gjithashtu do të presin shpërblimet e All-llahut xh.sh. për besimtarët falënderues. Në këtë mënyrë, ata fitojnë të gjitha llojet e mirësisë dhe bekimet që peshojnë më shumë se kënaqësitë e dhuratat burimore që i kanë arritur e të cilat japin këto frute e tipare.

Veç kësaj, besimtari i drejtë pranon gjithçka që e godet qoftë e keqe, depresion apo brengë, duke rezistuar çfarëdo që mund të rezistojë, përpiqet shumë që të dobësojë ndikimin e tyre dhe duron tërë atë që nuk mund të zmbrapset apo të kundërshtohet. Duke vepruar kështu, ata arrijnë lloje të ndryshme të të mirave, përvojë dhe fuqi për të rezistuar efektet e të këqijave. Ata shijojnë kënaqësi të mëdha si rezultat i durimit dhe presin ndihmën e All-llahut xh.sh. për të pakësuar vuajtjet dhe për t'i zëvendësuar ato me kënaqësi, lumturi e kompensim. Muhamedi a.s. i ka përshkruar besimtarët në hadithin vijues:

"E çuditshme është çështja e besimtarit. Çështja e tij është krejt mirë për të dhe nuk është e tillë për askënd tjetër. Nëse besimtarin e godet gëzimi, ai falënderon (All-llahun), e kjo i sjell dobi, kurse nëse e godet e keqja, ai bën durim (sabër) andaj edhe kjo i sjell dobi". (Muslimi)

Nga hadithi kuptojmë që shpërblimet e mirësitë e besimtarit dhe rezultatet e veprave të tij të mira shumëfishohen kur duron vuajtjet. Kjo është arsyeja se kur krahason dy persona të cilët marrin të njëjtën të mirë apo durojnë një fatkeqësi të ngjashme, ndryshojnë shumë në mënyrën se si i përgjigjen së mirës apo fatkeqësisë, sipas shkallës së besimit dhe veprave të mira që ka secili prej tyre. Besimtari i cili ka vepra të mira e pranon të mirën apo të keqen, në mënyrën që e sqaruam më parë, duke qenë falënderues dhe durimtar.

Kjo gjë i sjell atij lumturi e ngazëllim dhe i largon mërzinë, depresionin, shqetësimin, brengosjen dhe llojet e ndryshme të problemeve jetësore. Ai kështu jeton një jetë të mirë në këtë botë.

Ai i cili posedon karakteristikat e kundërta, të mirën e pranon me arrogancë, me teprim dhe tirani dhe si pasojë, sjellja e tij keqësohet dhe ai vepron sikur bisha kur e kap prenë e vet. Madje, ky lloj i njerëzve kurrë nuk është i kënaqur në zemrat e tyre, gjithmonë ndihet i shqetësuar e i mërzitur që mund të humbë gjithçka që ka lakmuar. Madje, ata gjithmonë dëshirojnë më shumë dhe nuk ndalen asnjëherë, megjithëse gjithçka që kanë dëshiruar mund edhe të mos arrihet. Edhe nëse arrijnë atë që kanë kërkuar të arrijnë, ende do të ndiejnë brengat që i cekëm më lart. Nga ana tjetër, ky lloj i njerëzve i pranon të këqijat me merak, frikë dhe mërzi. Prandaj, mos pyetni për poshtërsinë e vuajtjeve që kalojnë në këtë jetë dhe problemet psikike e psikologjike prej të cilave vuajnë, sepse ata nuk përpiqen për shpërblimet e All-llahut xh.sh. e as nuk kanë durim të duhur që mund t'i qetëson në kohët e vështira.

Islami i mëson dhe i nxit besimtarët që gjithmonë të ndihen të kënaqur me të mirat e All-llahut xh.sh. dhe me dhuntitë që iu ka dhënë. Nëse besimtari sprovohet me ndonjë sëmundje, varfëri apo ndonjë lloj tjetër fatkeqësish që e prekin gjithë njerëzimin, ai është i vetëkënaqur

për shkak të besimit të tij, i kënaqur me All-llahun xh.sh. dhe pranon gjithçka që e ka caktuar për të. Në këtë rast, besimtari në zemrën e tij nuk dëshiron ndonjë fat tjetër që nuk është caktuar për të dhe e krahason veten me ata që janë poshtë tij, më mirë se të krahasohet me ata që janë mbi të. Kjo gjë i sjell një lloj kënaqësie e rehatie më të madhe se ajo që ndihet nga ata që kanë të gjitha llojet e pasurisë së kësaj jete, por nuk janë të kënaqur. Këta të fundit janë plotësisht të mjerë kur sprovohen me varfëri apo humbje të pasurisë, pasi që nuk veprojnë sipas besimit të tyre, nëse kanë edhe pak.

Ekziston edhe një alegori tjetër që lidhet me lumturinë. Kur ndodh ndonjë e keqe, do të shohësh ata që kanë besim të drejtë që janë të qetë dhe përpiqen të zgjidhin frikën apo problemin me mendimet, qëndrimet dhe veprimet e duhura. Këto tipare i sjellin shpëtim njerëzve dhe e forcojnë vendosmërinë e tyre. Përkundrazi, ata të cilët nuk kanë besim janë të çrregulluar, shqetësohen, kanë mendime konfuze dhe bien pre e frikës kur i goditë ndonjë e keqe, duke ndërthurur frikën e jashtme dhe ankthin e brendshëm që nuk mund të shpjegohet siç duhet. Po të mos kishin një lloj fuqie natyrore për të vazhduar jetën (me efektet e përkohshme), ky lloj i njerëzve do të ndiheshin të lodhur dhe do të shprehnin lodhjen psikike, pasi që nuk kanë besim që i drejton drejt udhëzimit, veçanërisht në kohë dhe situata të vështira.

Megjithëse besimtari dhe jobesimtari, që të dy kanë aftësinë e trajnimit të vetes së tyre që të jenë guximtar përballë frikës apo fatkeqësisë, besimtari ka cilësi shtesë. Këto janë fuqia e besimit, durimi, besimi dhe mbështetja e plotë në All-llahun xh.sh. dhe pritja e shpërblimeve të Tij. Të gjitha këto e rrisin fuqinë e besimtarit dhe e zvogëlojnë efektin e shqetësimeve e vështirësive. All-llahu xh.sh. thotë:

"…nëse ndieni dhembje edhe ata ndjejnë dhembje sikurse ju, e ju shpresoni nga All-llahu çka ata nuk shpresojnë…". *(en-Nisa: 104)*

Prandaj, besimtarët arrijnë ndihmën e All-llahut xh.sh. dhe një mbështetje të veçantë që do t'i largojë vështirësitë dhe brengat. All-llahu xh.sh. thotë:

"…të jeni të durueshëm se All-llahu është me të durueshmit". *(el-Enfalë: 46)*

Mirësia ndaj krijesave

Të qenit i mirë me fjalë e vepra si dhe mbështetja e tjerëve me gjithë atë që është e mirë dhe e drejtë, janë prej mënyrave e mjeteve për të larguar depresionin, ankthin dhe brengosjen. All-llahu xh.sh. e mbron të dobëtin dhe të drejtin nga depresioni e mërzia, nëse janë të mirë dhe bujarë ndaj krijesave. Madje, besimtari merr pjesë të së mirës sipas mirësisë së tij, të gjeneruar nga sinqeriteti dhe pritja e shpërblimit të All-llahut xh.sh. Si rezultat i kësaj, All-llahu xh.sh. ia lehtëson rrugën e bujarisë dhe i zvogëlon ndikimin e vështirësive. All-llahu xh.sh. thotë:

"Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç *(bisedës)* ***kush këshillon për lëmoshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve. E kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e All-llahut, Ne do t'i japim më vonë*** *(në botën tjetër)* ***shpërblim të madh".*** *(en-Nisa: 114)*

Nga ky ajet kur'anor kuptojmë që të gjitha këto veprime janë të drejta dhe se drejtësia sjell gjithë atë që është e mirë dhe e dobishme si dhe mbron nga e keqja. Gjithashtu, All-llahu xh.sh. na tregon që besimtarin e drejtë e shpërblen me një shpërblim të madh, siç është largimi i depresionit, mërzisë dhe brengosjes.

Kërkimi i asaj që është e dobishme

Kërkimi i diturisë së dobishme dhe angazhimi në një profesion të dobishëm i zmbraps mundimet që rezultojnë nga shqetësimet dhe largon depresionin e zemrës, duke e larguar zemrën nga ajo që e mundon. Në këtë rast, brendia e njeriut do të ndihet e qetë dhe vitaliteti i tij do të rritet. Kjo gjendet si te besimtari ashtu edhe te të tjerët. Madje, besimtari është veçanërisht i pajisur me këtë besim, sinqeritet dhe kërkim të shpërblimit të Krijuesit kur është i zënë në kërkim të diturisë

apo kur është i kënaqur me punën që e bënë, qoftë ajo ibadet apo punë e kësaj bote të cilën e kryen me bindje në All-llahun xh.sh. E gjithë kjo ka efekt impresiv në largimin e mërzisë, depresionit dhe shqetësimit dhe është e rëndësishme veçanërisht pasi që brenga dhe depresioni shkaktojnë lloje të ndryshme sëmundjesh. Ilaçi i këtyre sëmundjeve përfshin harrimin e arsyes që ka shkaktuar brengën dhe depresionin duke qenë i zënë në kryerjen e ndonjë pune, ashtu siç cekëm më lart.

Përqendrimi në të tashmen

Kushtimi i vëmendjes ndaj punës, madje më shumë se mendimi për perspektivat e së ardhmes dhe largimi i pikëllimit për çfarëdo që ka ndodhur në të kaluarën, e ndihmon largimin e brengave dhe depresionit. Kjo është arsyeja se pse Muhamedi a.s. ka kërkuar mbështetjen e All-llahut xh.sh. nga brenga dhe depresioni (në një hadith të transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi). Mërzia për atë që ka kaluar, e cila kurrë nuk mund të kthehet dhe brengosja për të ardhmen, mund të kalohet vetëm atëherë kur njeriu ia kushton vëmendjen dhe vitalitetin e tij përmirësimit të gjendjes së tanishme. Kur dikush e bën këtë, do të jetë në gjendje të kryejë çfarëdo pune dhe do të ndihet i qetë në vend që t'i dorëzohet mërzisë dhe depresionit. Duhet ta përmendim faktin që Muhamedi a.s. sa herë që ka lutur All-llahun xh.sh. apo ka udhëzuar umetin e tij që ta bëjnë këtë, gjithashtu ka nxitur vitalitetin dhe përkushtimin lidhur me atë që dikush i lutet All-llahut xh.sh. si dhe shmangie e asaj për të cilën është lutur All-llahun xh.sh. që ta mbrojë prej saj. Lutja është kombinim i veprave, prandaj besimtarët kërkojnë atë që i ndihmon në çështjet e jetës dhe fesë, i luten All-llahut xh.sh. që përpjekjet e tyre të kenë sukses dhe kërkojnë ndihmën e Tij. Muhamedi a.s. thotë:

"Kujdesu për atë që të sjellë dobi. Kërko ndihmë nga All-llahu e mos u bëj i dobët. Nëse të godet diçka, mos thuaj: sikur të veproja kështu do të ndodhte kjo, por thuaj: All-llahu e ka caktuar dhe çka ka dashur Ai ka vepruar. Sepse "lev-i" (sikur të...) e fillon veprimin e djallit". (Muslimi)

Muhamedi a.s. çështjet i ka ndarë në dy grupe; një grup për të cilat njerëzit mund t'i kërkojnë të gjitha apo një pjesë, apo të zmbrapsin të gjitha apo një pjesë. Lidhur me këtë lloj, myslimanët përpiqen dhe e lusin Zotin e tyre t'i ndihmojë. Është edhe një pjesë tjetër, për të cilën përpjekjet e njerëzve nuk ndihmojnë në rezultatin përfundimtar dhe ky lloj kërkon që njeriu të jetë i kënaqur dhe t'i nënshtrohet asaj plotësisht. Nuk ka dyshim që kujtimi i këtyre fakteve është arsyeja kryesore prapa arritjes së lumturisë dhe largimin e mërzisë e depresionit.

Kujtimi i All-llahut xh.sh.

Dhikri apo kujtimi i All-llahut xh.sh. është një prej arsyeve më të rëndësishme për kënaqësinë e rehatinë e zemrës dhe ka efekt unik në zemrën lidhur me largimin e mërzisë e depresionit. All-llahu xh.sh. thotë:

"…pra ta dini se me të përmendur All-llahun zemrat stabilizohen". *(err-Rra'd: 28)*

Kujtimi i All-llahut xh.sh. ka efekte unike në kënaqësinë e zemrës dhe arritjen e gjithë asaj që myslimani kërkon nga shpërblimi dhe mirësia e Krijuesit të tij.

Falënderimi për të mirat e All-llahut xh.sh.

All-llahu xh.sh. e largon depresionin dhe mërzinë si kompensim për myslimanin i cili e falënderon Atë për të mirat e Tij të dukshme dhe të fshehura që ia ka dhënë atij-asaj. Kjo e ndihmon myslimanin të arrin nivelin e robërve të vlerësuar të All-llahut, nivelin më të mirë dhe më të lartë që ekziston atje. Edhe nëse myslimani vuan nga varfëria, sëmundja apo ndonjë fatkeqësie tjetër, atij këto mundime do t'i duken të vogla në krahasim me të mirat dhe dhuntitë e shumta të All-llahut xh.sh. që nuk mund të numërohen.

Madje kur besimtari tregon durim, kënaqësi dhe bindje para së keqes dhe vështirësisë me të cilën sprovohet, efekti i këtyre vështirësive do të zvogëlohet dhe efekti i tyre do të zbutet.

Shiko ata që janë poshtë teje dhe mos i shiko ata që janë mbi ty

Prej metodave dhe mënyrave më të mira për arritjen e lumturisë, është zbatimi i këshillës së Muhamedit a.s. në hadithin vijues:

"Shikoni (krahasoni veten tuaj me) ata të cilët janë poshtë jush, e mos shikoni ata që janë mbi ju. Kështu, nuk do të përbuzni të mirat e All-llahut xh.sh. që ju ka dhuruar". (Mutefekun alejh)

Kur besimtari i merr parasysh tiparet më të mira që janë përmendur në hadith, do të kuptojë që është segmenti më i rëndësishëm i krijimit lidhur me shëndetin dhe mjeteve të jetesës. Dhe kjo do ta bëjë që të heqë dorë nga brenga, depresioni dhe mërzia. Gjithashtu, kënaqësia dhe dëshira e tij e thjeshtë në dhuntitë e All-llahut xh.sh., të cilat ia ka dhënë para shumë tjerëve, të cilët nuk kanë atë që ka ai, do të shumëfishohen.

Sa më shumë që besimtari mendon për të mirat e tij të dukshme dhe të fshehta që ia ka dhënë, lidhur me çështjet e kësaj bote dhe ato fetare, aq më shumë do të kuptojë që me të vërtetë All-llahu xh.sh. i ka dhënë shumë mirësi dhe e ka mbrojtur nga lloje të ndryshme të problemeve. Nuk ka dyshim se e gjithë kjo e zmbraps mërzinë e depresionin dhe i zëvendëson me kënaqësi dhe lumturi të plotë.

Shmangia e mërzisë dhe kërkimi i lumturisë

Përpjekja për të shmangur çdo gjë që shkakton mërzi dhe kërkimi i mënyrave e rrugëve që sigurojnë lumturi janë prej mënyrave për të arritur lumturinë dhe për të shmangur mjerimin. Për shembull, çdo njëri duhet të përpiqet të harrojë fatkeqësitë që i kanë ndodhur, pasi që janë çështje e së kaluarës dhe të kuptojë që mendimi për të kaluarën është lloj i shakasë, budallallëkut dhe nganjëherë marrëzi e qartë. Arritja e kësaj kërkon fuqi dhe vendosmëri për të parandaluar zemrën të mendojë për të kaluarën dhe të brengoset për të ardhmen dhe çfarëdo varfërie apo fatkeqësie që mund t'i sjellë. Secili duhet të ndihet i sigurt që e ardhmja është e panjohur për të me çfarëdo mirësi, të keqe,

shprese apo dhembje që mund të bartë. E ardhmja është në Duart e të Madhërishmit dhe kurrsesi në duart e njerëzve. Por, njerëzit duhet të punojnë për të arritur atë që është e mirë për ta dhe të mbrohen nga mundimet e shqetësimet që mund t'i prekin.

Kështu, çdo mysliman duhet të ndihet i sigurt që kur ai apo ajo pushon të brengoset për të ardhmen dhe në vend të kësaj mbështetet në All-llahun xh.sh. që t'i sjellë gjithë atë që është e mirë dhe e rehatshme, gjatë gjithë kohës duke besuar në Vendimin e Tij, atëherë zemra e tij do të jetë e kënaqur dhe të gjitha gjërat do të rrjedhin si duhet. Veç kësaj, ai do të kalojë frikën dhe brengat e tij.

Lutjet e Muhamedit a.s.

Prej mënyrave më të mira për t'u përgatitur për të ardhmen është leximi i duasë së Muhamedit a.s.:

"O Zot, më rregullo çështjet e fesë sime, pasi që aty është imuniteti im (nga mëkatet). Më rregullo jetën, pasi që aty është jetesa ime. Më rregullo jetën në Ahiret, pasi atje është kthimi im. Dhe më bë jetën plot me të mira dhe vdekjen qetësi nga çdo e keqe". (Muslimi)

Gjithashtu, Muhamedi a.s. i është lutur All-llahut xh.sh. me këtë lutje:

"O Zot, të lutem për mëshirën Tënde. Të lutem, mos më lë vetëm qoftë edhe për një moment dhe më rregullo të gjitha punët. Vërtet, askush nuk është i denjë të adhurohet përveç Teje". (Ebu Davudi)

Kur besimtari i lexon këto lutje (që sigurojnë korrektësinë e çështjeve të tij fetare të ardhshme dhe të jetës së përditshme) me gjithë zemër, sinqeritet dhe duke u përpjekur shumë që të arrijë atë që kërkon[1], atëherë All-llahu xh.sh. do të t'i plotësojë gjithë atë që ka kërkuar. Dhe, si shpërblim depresioni i tij do të kthehet në kënaqësi e lumturi, me dëshirën e All-llahut xh.sh.

[1] Siç është shtimi i ibadetit, përmirësimi i sjelljes së tij, puna, fitimi i më shumë të hollave nga burime të lejuara, të qenurit i sjellshëm me prindër e kështu me rradhë.

Përgatitja për më të keqen

Prej mënyrave më të mira për të larguar brengën dhe mërzinë në kohë të vështira është që besimtari të provojë të zvogëlojë ndikimin e fatkeqësisë duke përgatitur veten sa më shumë që mundet për më të keqen që mund t'i ndodhë. Në këtë mënyrë, jo vetëm që brengat e mërzia e tij do të largohen, por gjithashtu do të zëvendësohen me gjallëri të fituar, duke u përpjekur të arrijë të mirën dhe të mbrohet nga e keqja.

Kur dhe nëse dikush preket nga frika, sëmundja, varfëria dhe pamundësia për të bërë atë që dëshiron dhe lakmon, duhet lënë që ai ose ajo t'i pranojë këto fatkeqësi me qetësi dhe përkushtim në rezistimin e më të keqes që këto fatkeqësi mund të sjellin. Kështu, ndërthuren tiparet e vendosmërisë dhe përpjekjet e palodhshme që e mbajnë atë të angazhuar më shumë se sa të ndien ankthin për shkak të fatkeqësive që e kanë prekur. Siç e cekëm, njeriu mund t'i arrijë të gjitha këto duke u përpjekur të rigjallërojë energjinë e tij, e cila është esenciale në rezistimin ndaj së keqes, mbështetjen në All-llahun xh.sh. dhe besimin në Të, dhe sigurisht këto tipare kanë vlerë të madhe në arritjen e lumturisë dhe rehatisë së zemrës. Veç kësaj, besimtari pret shpërblimin e All-llahut xh.sh. që sigurisht se do të vijë herët apo vonë.

Fuqia e brendshme e zemrës

Një prej ilaçeve më të mira për sëmundjet e zemrës dhe trupit arrihet përmes fuqisë së brendshme të zemrës që parandalon dorëzimin para fatkeqësisë dhe mendimeve të turbullta, të cilat zakonisht shoqërohen me pritjen e më të keqes. Kur dikush dorëzohet para brengave dhe zemra e tij ndikohet nga ndjenja e frikës nga sëmundja, zemërimi, konfuzioni, pritja e së keqes dhe humbja e gjërave që lakmon, atëherë zemra e tij do të jetë pranë depresionit, mërzisë dhe sëmundjeve të ndryshme që e prekin zemrën e trupin. Çrregullimi nervor mund të ndodhë si pasojë e kësaj, me të gjitha efektet dhe ndikimin e tij të dëmshëm që është dëshmuar te shumë njerëz.

Mbështetja në All-llahun xh.sh.

Kur zemra mbështetet në All-llahun xh.sh., ka besim në Të, refuzon t'u dorëzohet mendimeve të këqija e brengave dhe kërkon të mirat e dhuntitë e All-llahut xh.sh., të gjitha llojet e depresionit dhe mërzisë do të zhduken. Gjithashtu, lloje të ndryshme të sëmundjeve që mund të prekin trupin dhe zemrën do të largohen, duke fituar fuqi të brendshme të zemrës, kënaqësi dhe rehati që nuk mund të shpjegohet mjaftueshëm me fjalë.

Është fakt që shumë njerëz që ndihen të sëmurë dhe janë shtruar në spital ka ardhur si rezultat i dorëzimit të tyre ndaj brengave dhe depresionit. Sëmundje të tilla mund të shkaktojnë efekte të thella në zemra të forta, të dobësojë zemrën, duke i shtyrë shumë njerëz të bëjnë ndonjë marrëzi dhe budallallëk. Vetëm atyre që All-llahu xh.sh. u ka dhënë mirëqenie dhe sukses, të cilët përpiqen shumë kundër epsheve të tyre dhe kërkojnë mënyra për mbrojtjen e zemrave të tyre mund t'i rezistojnë këtyre brengave dhe të fitojnë imunitet ndaj këtyre llojeve të sëmundjeve. All-llahu xh.sh. thotë:

"...kush i mbështetet All-llahut, Ai i mjafton atij...". *(et-Talakë: 3)*

Prandaj, ai që beson All-llahun xh.sh. ka zemër të fortë që kurrë nuk shqetësohet nga mendimet apo brengat e turbullta, sipas njohurisë së tij që dorëzimi para fatkeqësive është shenjë e dobësisë së brendshme dhe e frikës. Gjithashtu ai e di premtimin e All-llahut xh.sh. për të përkrahur e ndihmuar ata që kanë besim në Të. Si rezultat i kësaj, ai ka besim në Të dhe ndihet i sigurt për realizimin e premtimit të Tij. Kjo ndodh kur brengat e frika e tij largohen dhe të gjitha vështirësitë kthehen në lehtësi, mërzia në kënaqësi dhe frika në qetësi. E lusim All-llahun xh.sh. që të në japë mirëqenie dhe fuqi të zemrës duke na bërë që ta besojmë drejt Atë, në mënyrë që të fitojmë premtimin e Tij për gjithë atë që është e mirë dhe e drejtë.

Sjellja e mirë ndaj njerëzve

Nga hadithi në vijim kemi dobi të shumta:

"Të mos urrejë besimtari besimtaren (do të thotë gruan e tij) nëse nuk i pëlqen ndonjë sjellje e saj, pasi që sigurisht do t'i pëlqejë ndonjë sjellje tjetër". (Muslimi)

Së pari, Muhammedi a.s. na këshillon që të sillemi mirë ndaj grua-as, të afërmve, shokëve dhe të gjithë atyre që kemi lidhje. Njeriu duhet të kuptojë që çdo njeri ka të meta apo sjellje të tillë që tjetrit nuk i pëlqen. Kur dikush ndihet keq për të meta të tilla, duhet të kujtojë mënyrën se si duhet t'i trajtojë këta njerëz dhe të ruajë marrëdhëniet e mira me ata. Veç kësaj, myslimani duhet të kujtojë tiparet e tyre të mira dhe të harrojë të metat e tyre të vogla në personalitetin e tyre. Dhe në këtë mënyrë miqësia, shoqëria dhe lidhjet e mira ruhen dhe arrihet qetësia e zemrës.

Së dyti, hadithi na ndihmon që me ndihmën e All-llahut xh.sh. të largojmë brengat dhe mërzinë, dhe na këshillon që të ruajmë lidhjet e mira, të jemi të kujdesshëm ndaj të drejtave e përgjegjësive të tjetrit dhe mbajtjen e lidhjeve të shëndosha me njerëzit. Përkundrazi, kur ndonjëri nuk e merr parasysh këshillën e Muhamedit a.s. nga ky hadith dhe në vend të kësaj i vëren të metat dhe i harron tiparet e mira të tjetrit, sigurisht se ai do të ndihet i brengosur dhe lidhjet e tij me njerëzit do të prishen. Në këtë rast, nuk do të jetë i shkëlqyer lidhur me të drejtat dhe obligimet që sjellin dhe kërkojnë lidhjet e tilla.

Është i çuditshëm fakti që disa njerëz të cilët kanë vendosmëri të fortë, durim dhe qetësi kur i prek ndonjë e keqe, por shqetësohen për gjëra të pavlera dhe qetësia e tyre prishet. Kjo u ndodh ngase qëllimin e tyre ia përkushtojnë trajtimit të problemeve kryesore, por harrojnë të përgatiten për probleme të vogla dhe kjo e metë u sjell efekte të padëshiruara dhe e prish qetësinë e rehatinë e tyre. Prandaj, njerëzit e vendosur e të mençur e përkushtojnë veten që të trajtojnë dhe t'u bëjnë ballë problemeve e brengave të mëdha e të vogla. Ata gjithmonë i luten All-llahut xh.sh. për ndihmë me atë rast, prandaj Ai nuk i braktis

apo nuk i lë të mbështeten në veten e tyre madje edhe për një moment. Në këtë mënyrë problemet e mëdha dhe ato të vogla shumë lehtë zgjidhen. Zbatimi i kësaj mënyre gjithashtu ruan qetësinë e brendshme të njeriut dhe kënaqësinë e zemrës së tij.

Kënaqja me momentet e lumtura

Njeriu i mençur e di që jeta më e mirë që mund të jetojë është ajo plot me lumturi e qetësi, madje edhe nëse është e shkurtër. Duke sjellë këtë në mendje, njeriu nuk duhet që momentet e lumtura të jetës t'i shkurtojë duke i përzier me brenga e shqetësime të ndryshme, por në vend të kësaj, duhet të jetë koprrac i vërtetë në prishjen e këtyre momenteve të çmueshme. Duhet të përmendim përsëri që kjo mënyrë e mirë, nëse zbatohet, do të ndahet mes të drejtit dhe të dobëtit, por besimtari do të marrë pjesën më të plotë dhe më mirë do të përfitojë nga kjo, shpjet dhe më shumë.

Kujtimi i të mirave gjatë fatkeqësive

Kur ndonjë e keqe e prek ndonjërin apo frikësohet se mund ta prekë, duhet të kujtojë shumë të mira fetare dhe të kësaj bote me të cilat është kënaqur, duke e krahasuar me të keqen që e ka prekur. Zbatimi i kësaj metode sjell dobinë e kuptimit të begatisë së të mirave me të cilat kënaqet njeriu dhe vogëlsinë e të keqes që e ka prekur.

Veç kësaj, njeriu duhet të krahasojë këtë më të keqen që mund t'i ndodhë atij dhe shumë zgjedhje që të shpëtojë nga ajo e keqe. Ai nuk duhet të bëjë që mundësia më e vogël të kalojë shumë të mira të mëdha. Në këtë rast, brenga e tij do të zvogëlohet, frika e tij do të largohet dhe tërë energjinë e tij do t'ia kushtojë trajtimit të çfarëdo të keqe që mund t'i ndodhë. Në këtë mënyrë, përpiqet që të përballojë gjithçka që mundet, apo së paku të minimizojë ndikimin e tij në të.

Vëreni të këqijat e njerëzve

Duhet të dini që çfarëdo që i mundon njerëzit mund t'ju shqetësojë edhe ju, veçanërisht shqiptimi i fjalëve të këqija nuk do t'ju dëmtojë ju, por do t'i dëmtojë ata[2], po të mos interesoheni vetë për të dhe lejoni që ky interesim të shkatërrojë mendimet tuaja. Në këtë rast, do të shqetësoheni (do të jeni të depresionuar, të pikëlluar dhe të fyer) ashtu siç do të jenë të shqetësuar edhe ata (nga All-llahu xh.sh. për mëkatet e tyre). Por, nëse ju nuk e mundoni veten (me veprimet dhe qëndrimet e këqija të njerëzve kundër jush), atëherë ata të paktën nuk do t'ju mundojnë juve.

Mbajtja e mendimeve të mira

Duhet të dini që cilësia e jetës suaj është e lidhur me cilësinë e mendimeve tuaja. Prandaj, kur mendimet tuaja janë të tilla që të sjellin përfitime në jetën e fenë tuaj, atëherë ju do të jetoni jetë të mirë e të lumtur dhe e kundërta sjell rezultate të kundërta.

Mos pritni falënderime

Prej metodave më të rëndësishme për të zmbrapsur depresionin është të pritni shpërblimin vetëm prej All-llahut xh.sh. për çfarëdo të mirë që ai apo ajo i bëjnë atyre që e kanë obligim dhe gjithë të tjerëve. Mirësia është një lloj i veçantë i sjelljes së mirë me All-llahun xh.sh. Prandaj, mos u brengosni për marrjen e falënderimeve nga kushdo që i keni bërë mirë, pasi që All-llahu xh.sh. ka përshkruar cilësinë e robërve të Tij të zgjedhur:

"Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim". *(el-Insan: 9)*

Kryesisht ky rast lidhet me sjelljen e mirë dhe mbrojtjen nga e keqja që mund ta godet familjen, fëmijët dhe të afërmit. Sigurisht, që

[2] Sepse All-llahu xh.sh. do të regjistron çdo gjë që i dëmton ata, do të shpërblen ju sipas punës së bërë dhe do t'i kompensojë ata.

gjendet komoditeti dhe qetësia në kryerjen e veprave bujare, duke marrë parasysh qëllimet e këtyre veprave.

Marrja me mendime të dobishme

Për të larguar veten nga arsyet e mërzisë dhe vuajtjes, duhet që të rë vëmendjen dhe mendimet tuaja t'i dedikoni gjithë asaj që sjell dobi dhe përpjekjes për t'i arritur ato dhe të mos angazhoni mendjen tuaj duke menduar gjëra apo mendime të dëmshme. Për më tepër, shfrytëzoni mirë kohën pa nguti në mënyrë që të mblidhni fuqinë tuaj për të kryer punët e rëndësishme që kërkojnë vëmendjen tuaj.

Përfundoni detyrat e menjëhershme

Përfundoni detyrat e menjëhershme, në mënyrë që të jeni të gatshëm që më shumë kohë dhe energji t'u dedikoni përgjegjësive që mund të sjellë e ardhmja. Në këtë mënyrë, punët e kaluara që duhet të përfundojnë në të kaluarën nuk do t'i shtohen çfarëdo gjëje që njeriu duhet të bëjë në të ardhmen, në mënyrë që të shmangim barrën e punës. Kur me vendosmëri vendos detyrat e tanishme, do të jesh i aftë të merresh me përgjegjësitë e ardhshme me mendime të freskëta dhe me një rezervë të mjaftueshme të energjisë.

Puna të ketë prioritet

Puno në aspektet më të dobishme dhe më të rëndësishme të punës, e pastaj në ato pak më të rëndësishme. Përqendro energjinë tënde në gjithçka që të pëlqen dhe ndihesh i etur për të bërë. Ndërsa duhet të veprosh të kundërtën për punët të cilat të shkaktojnë mërzi, depresion dhe bezdi. Për të ndihmuar kur të vendosësh, mendo thellë dhe kërko këshillë, sepse ata që kërkojnë këshilla kurrë nuk do ndihen të pikëlluar. Planifiko me kujdes çka dëshiron të bësh. Nëse e ndien se në bërjen e saj do të kesh dobi të mirë, atëherë përfundoje atë duke pasur besim në All-llahun xh.sh., pasi që Ai i do ata që kanë besim në Të.

Përktheu nga arabishtja:
Admir Temja

Abdur-Rahman As-Sa'di

HOW TO ACHIEVE HAPPINESS

(Summary)

This booklet explains the meaning of true happiness, which is the ultimate goal that all humankind searches for in the worldly life. There are conflicting views and opinions concerning the meaning of happiness and the ways and means to achieve it. Some believe that happiness can be achieved through money. Others believe that happiness can be achieved by having a healthy body and peace and security at home. Some believe that happiness can be achieved by searching for knowledge whereas others that it can be achieved through faith.

عبد الرحمن السعدى

كيف نعيش سعداء؟

(خلاصة البحث)

سوف نحاول في هذا المقال أن نشرح معنى السعادة الكاملة الذي هو الهدف النهائي لكل إنسان في هذا العالم. هناك آراء و مفاهيم متناقضة حول معنى السعادة و الطرق التي يمكن الوصول إليها. هناك من يرى بأن السعادة تتم عن طريق جمع الاموال و نوظيفها في مشاريع مختلفة. و هناك من يرى بأن السعادة ان يكون الانسان صحيح الجسم و ان يعيش في أمن ورخاء.

INTERVISTË E HUAZUAR

Alaga Dervisheviq

NGA BISEDAT E BOTUARA DHE TË PABOTUARA*

60 vjet të luftës intelektuale të akademik Smail Baliqit për boshnjakizmin, Bosnjën demokratike, islamin dhe myslimanët në Evropë

Akademiku Smail Baliq deri tani vonë ka qenë shkencëtari dhe hulumtuesi më i vjetër dhe më i njohur boshnjak në Diasporë (emigracion), ku ka shkuar si student në fillim të Luftës së Dytë Botërore.

Si hulumtues, shkencëtar, poliglot dhe ekspert për islamistikën, arabishten dhe turkologjinë, ka botuar më tepër se 20 libra dhe më se 300 punime shkencore dhe profesionale, numri më i madh i të cilave kishte temën e Bosnjës dhe kulturës boshnjake. Si ekspert është ftuar në tubimet më të rëndësishme shkencore dhe profesionale nga fushat e theksuara, në të cilat si ligjërues, kritik dhe polemik ka dominuar dhe ka qenë i çmuar nga ekspertë eminentë.

Autori i këtyre rreshtave ka pasur nderim që gjatë dhjetë vjetëve të fundit të shoqërohet dhe të korrespondojë me akademik Baliqin dhe t'i shënojë qëndrimet dhe pikëpamjet e tij në disa çështje të caktuara bashkëkohore të boshnjakëve dhe të islamit, si në Bosnjë, ashtu edhe në Evropë. Një pjesë e atyre bisedave është botuar në pesë vazhdime në revistën; "Nedjeljna Nova Bosnja" që është botuar në Hanau-Frankfurt, në dhjetor te vitit 1994, kurse pjesa më e madhe ka mbetur deri më sot e pabotuar, e që në formë integrale do të botohet në librin "Boshnjakët e dalluar në Diasporë".

Pjesa e tekstit të cilin po e sjellim këtu është përpilim i versionit të shkurtuar të intervistës së botuar dhe të bisedave dhe shënimeve të pabotuara deri më tani.

Disa pjesë të intervistës së botuar autori, me pëlqimin e Baliqit, i ka plotësuar me ekstrakte nga bisedat e mëvonshme.

* "Kujtime për boshnjakët", Vepra e S. Baliqit.

A.D.: *Doktor Baliq, si e keni përjetuar ju sundimin e ri në Jugosllavi dhe organizatën e myslimanëve të rinj, si kritikë dhe opozitë e pushtetit të atëhershëm, qëllimet e tyre, idetë, programet etj.?*

Vetëm populli i vetëdijshëm dhe i pranuar si komb mund të llogarisë në shtet.

S.Baliq: Unë fare nuk e kam përjetuar sundimin jugosllav, ngase në atë kohë kam qenë student në Vjenë. Kam mundur të parandiej vetëm diçka. E kam ditur se më mirë ishte të mbetesha jashtë, sesa të kthehesha, ngase kam qenë i udhëzuar në rrjedhat e fatit të disa kolegëve të mi, të cilët patën rënë në burg. Para së gjithash, mendoj në ata myslimanët e rinj, të cilët kanë qenë një grup gjimnazistësh më së shumti në Sarajevë dhe për koincidencë rrethanash kanë pasur më shumë mundësi të merren me çështje të fesë, sesa rinia tjetër. Ata të rinj në Islam shihnin rrugën e nevojshme për bashkësinë në të ardhmen dhe se mënyrë tjetër jetese nuk ka. Ata edhe problemin tonë nacional e shikonin nga pozicionet e tilla. Ata të rinj kanë qenë idealistë të llojit të vet, por në atë kohë nuk kam mundur të gjendem në vijën e lëvizjes së tillë sikurse ata. Sipas mendimit tim, ata kanë pasur pikëpamje të kufizuara në botën dhe jetën, çka sigurisht se nuk i është përgjigjur pjesës më të madhe të intelektualëve as në atë kohë, e posaçërisht më vonë. Ata kanë qenë në izolim, pastaj i kanë përjetuar ndjekjet, kanë qenë në burg, kurse dënimet që u janë shqiptuar kanë qenë absolutisht të paarsyeshme, barbare, por ashtu ka qenë atëherë, para së gjithash

myslimani edhe vetë ka mundur të ndiejë se ka qenë leckë e kuqe për qeverinë e re, ngase disa masa drastike nuk u morën në rreth të ngjashëm te kroatët dhe serbët. Mirëpo, popullit tonë thjesht nuk i ka rënë në sy, ata thjesht pranuan të jenë viktima, madje disa janë likuiduar, kurse shumë të tjerë janë burgosur. Këta të rinj janë meritorë për një kapital të caktuar moral, sepse trimërisht janë ngritur në mbrojtjen e Islamit, i cili ka qenë i vetmi orientim dhe preokupim i tyre, e që në atë kohë ka qenë tepër guxim. Nuk është besuar se do të vijë koha kur ata do të kenë mundësi që çështjen ta marrin në dorë dhe të vendosin për fatin e së paku një pjese të Bosnjës. Kjo që sot myslimanët e rinj kanë ardhur te ndikimi i fuqishëm nuk është tërësisht mirë për çështjen tonë. Ata është dashur të kënaqen me atë kontribut të cilin e kanë dhënë në ato procese, ata sot pak a shumë janë njerëz të moshuar dhe është dashur megjithatë të shërbehen me përvojat të cilat i ka arritur rrethi ynë gjatë kohës, madje edhe nën kushtet e rënda. Kanë ndodhur shumë ndryshime, bota nuk qëndron në një këmbë dhe mendoj se do të ishte mirë që ata të vendosen në hapësirat historike dhe t'u pranohet merita. Mendoj se nuk është koha që ata të konsiderohen vendimtarë vetëm për atë se ata nuk kanë qenë luftëtarë për të drejta nacionale shtetërore të myslimanëve boshnjakë, e që është tepër e rëndësishme për ne, për ekzistencën tonë dhe ekzistencën e shtetit tonë të vetëm, Bosnjë e Hercegovinës, ngase historia ka treguar se vetëm populli i vetëdijshëm e i pranuar si komb mund të llogarisë në shtet. Thjesht, kjo është përvojë civilizuese dhe historike, posaçërisht në Evropë, kurse boshnjakët janë popull evropian. Përveç kësaj, në nivelin internacional si përfaqësues të popullit nuk paraqiten fetë, por kombësitë dhe shtetet. Në shumëçka, myslimanët në botë, madje edhe këta myslimanët tanë të rinj, tani të moshuar, këtë ende nuk e kanë kuptuar.

A.D.: *Për të ekzistuar dhe për ta ruajtur fenë jemi detyruar të luftojmë për identitet nacional. Kur pranohet identiteti nacional, pranohet edhe ai shtetëror, e mandej shteti na ofron elementet dhe instrumentet për ta mbrojtur identitetin nacional, kulturor dhe fetar. Çka mendoni ju për pjekurinë nacionale të myslimanëve boshnjakë në të kaluarën, posaçërisht pas vitit 1945? Çfarë qëndrimi keni pasur atëherë, a jeni marrë me këtë, a keni pasur pikëpamje historike, politike, shkencore dhe kulturore për këtë çështje? A jeni deklaruar dhe a keni shkruar për këtë?*

Inteligjenca politike dhe shkencore myslimane ka kontribuar dukshëm në pranimin dhe vetëdijesimin nacional

S.Baliq: Mua më ka rënë në sy ai kurs, ato ndryshime në qëndrimin e njerëzve tanë, politikanëve, posaçërisht boshnjakëve, diku kah fundi i viteve '60 e këndej. Kam parë se gjërat silleshin kah vetëdijesimi ynë nacional, por jo në atë masë sa ka mundur të pritet nga jashtë. Ju që keni mbetur në vend me siguri mund t'i dini edhe shkaqet e tjera për këtë. Është fakt se është vërtetuar se ajo pjesë e inteligjencës myslimane, e cila ka qëndruar përtej largësisë së arritshme të atyre myslimanëve të rinj, në mënyrë efektive shumë më tepër i kanë kontribuuar vetëdijesimit dhe sajimit tonë të bazave kulturore etj., në vetëdijen tonë, tepër të rëndësishme për pjekurinë tonë si popull. Pak më parë ju folët për veprimtarinë e Alija Isakoviqit, Makë Dizdarit, Muhamet Haxhijahiqit, Muhsin Rizviqit, Mustafa Imamoviqit, Muhamet Filipoviqit, Atif Purivatrës dhe posaçërisht të udhëheqësit të atëhershëm të myslimanëve, politikanit Hamdia Pozdercit, i cili, siç po shihet sot, ka qenë një lloj patronazhi i inteligjencës tjetër myslimane dhe i të gjithë grupit të intelektualëve myslimanë të fundit të viteve '60 dhe fillimit të viteve '70. Më ka rënë në sy se në analizat të cilat atëherë jepeshin jashtë për gjendjen në vend nga disa shkencëtarë serbë, tehet më të

fuqishëm të sulmeve kanë qenë të drejtuara kundër të ashtuquajturit karakterizimit profan mysliman, në të cilin ne emigracioni boshnjak jemi mashtruar. Atëherë unë nuk kam mundur të mësoj se çka nënkuptohet me atë, mirëpo sot e kam të qartë se me çka ka pasur të bëjë. Kjo në anën nacionaliste serbe është vërejtur me kohë si rrezik për interesin strategjik të tyre në Bosnjë, i cili para së gjithash shkonte në mohimin e myslimanëve si komb, e me këto edhe të drejtën e tyre në shtetin e Bosnjë e Hercegovinës. Ata këtë neve këtu me shkathtësi na e kanë mbështjellë dhe interpretuar në formën e diktaturës komuniste dhe gjithë asaj që nënkupton me të. Ata shumë më tepër kanë reaguar në këtë sesa në qëndrimin dhe idetë e myslimanëve të rinj, të cilët kanë qenë të harruar dhe për ta më pak të rrezikshëm.

A.D.: *Profesor Baliq, u janë të njohura vërejtjet e udhëheqjes së atëhershme politike të BeH, për atë se komunistët e kanë menduar kombin mysliman dhe se atë emër ua kanë dhënë, për të mundur më vonë më lehtë për t'i prerë etj. Si e keni përjetuar atë në emigrim për proceset historike të boshnjakëve myslimanë në përfundim të viteve '60, të cilat kanë qenë vendimtare për vetekzistencën e boshnjakëve myslimanë në BeH dhe për ardhmërinë e tyre, ngase me Kushtetutën e vitit 1974 Bosnjë e Hercegovina është pranuar si shtet sovran sikurse të tjerat republika në Jugosllavi, e që nuk ka mundur pa pranimin përfundimtar të boshnjakëve si komb. Praktikisht kjo ka qenë fundament për t'u bërë BeH shtet i pavarur, përkatësisht në bazë të saj është mbajtur referendumi për pavarësi në vitin 1992. A pajtoheni se duke pasur parasysh aspiratat shekullore të hegjemonisë serbomadhe dhe kroatomadhe në Bosnjë e Hercegovinë, e që nuk ka shkuar pa eliminimin e myslimanëve si popull dhe në raport të bazuar në Jugosllavinë e atëhershme, edhe informimi e pavetëdijesimi si boshnjak, ngase ata në njëqind vjetët e fundit veten e kanë quajtur myslimanë, ashtu janë ndier dhe rruga e tillë ka qenë e vetmja mundësi për të ardhur deri te pranimi i kombit e me këtë edhe i shtetit pa marrë parasysh emrin? A pajtoheni ju se kjo ka qenë faza përgatitore dhe kalimtare*

drejt emrit tonë të vërtetë, për çka është e nevojshme masa kritike e inteligjencës për elaborimin historik shkencor, kulturologjik, gjuhësor dhe të lëmenjve të tjerë mbi një çështje të rëndësishme të tillë, siç është emri ynë nacional boshnjak, i cili si i tillë ka qenë i harruar dhe i zhdukur nga të përdorurit në njëqind vjetët e fundit?

Nacionalizmi i tepruar kurrë nuk mund të sjellë ndonjë drejtësi. Në mediet botërore identiteti ynë ka qenë i theksuar vetëm si një identitet fetar

S.Baliq: Tani këto të gjitha po i lidhi dhe po i palos në vendin e vet. Me fjalë të tjera, unë e kam pasur të njohur atë veprimtari në Sarajevë të një grupi autoritetesh shkencorë, kulturorë dhe politikë në përgatitjen për regjistrim të vitit 1971, kur myslimanëve përfundimisht u është pranuar nacionaliteti, që ka qenë e nevojshme të argumentohet me elemente të caktuara të natyrës politike, historike, kulturore, gjuhësore, fetare dhe shtetërore. Prof. Atif Purivatra ka qenë një lloj operatori që tubon ekipet të cilat e ndriçonin zhvillimin politik, historik, nacional, kulturologjik dhe gjuhësor të myslimanëve siç ishin: Alia Isakoviç, Makë Dizdari, Midhat Begiqi, Muhsin Rizviqi, të cilët punonin në çështjet letrare kulturologjike dhe gjuhësore. Profesor Çemërliqi punoi në aspektin juridik, të tjerët në atë historik, Husein Gjoza në aspektin fetar etj. Mua vetëm sot më është e qartë se në krye të tërë projektit ka qenë një politikan Hamdia Pozderaci, i cili sigurisht ka pasur konsensus për këtë çështje me politikanët e atëhershëm të të dy popujve të tjerë, para asaj, sigurisht i mbështetur nga vetë kreu partiak dhe politik në Beograd, posaçërisht Tito. Ata kanë përgatitur materialet e caktuara, libra të caktuar për të vërtetuar diç shkencërisht se myslimanët i kanë të gjitha kushtet si të tjerët për të qenë komb. Në realitet në bazë të kësaj, me regjistrimin e vitit 1971 myslimanëve për herë të parë iu mundësua të shprehen nacionalistë, dorën në zemër jo si boshnjakë, por si myslimanë, pjesëtarë të një nacionaliteti, që sigu-

risht me dy duart ka qenë e pranuar. Gjithashtu edhe unë atë e kam marrë si një ngjarje pozitive në zhvillimin historik të hapësirës sonë, ngase i është ofruar mundësia e zhvillimit të institutit vetjak, zhvillimit të kulturës vetjake. Edhe pse ajo nuk ka qenë arritje me të cilën ne ishim të kënaqur qind për qind, megjithatë ka qenë një hap përpara. Ajo ka qenë një fazë kalimtare. Ndryshe nuk ka qenë e mundur. Mirëpo, siç duket në Bashkësinë Islame disa njerëz këtë lëshuarje pe të regjimit e shfrytëzuan për qëllime të tjera, çka edhe është e kuptueshme, për t'i kontribuuar në forcimin e vetëdijes fetare myslimane, në të cilën ka kontribuuar shumë Hysein Gjoza, miku i madh i imi me të cilin shpesh jemi parë në Kajro në tubime të ndryshme. Kjo më ka mundësuar që falë atij kam qenë i udhëzuar mirë për gjendjen e Bashkësisë Islame në ish-Jugosllavi, kurse ai pos të tjerash ka dashur të më sjellë ndër të parët si profesor në Fakultetin e Shkencave Islamike, aq më tepër kam qenë i propozuar, por Beogradi më ka konsideruar për armik të shtetit. Ndërsa librin tim Branko Mikuliqi e ka shpallur kinse libër nacionalist, këtë disa më kanë thënë. Edhe pse unë gjithnjë e kam konsideruar se ne me komb jemi boshnjakë, kurse kur kjo është vendosur, siç e kemi parë në vitin 1971 nuk është miratuar ai emër por ai mysliman, në të cilin gjithsesi edhe ai ka pasur pjesë, atëherë unë kam mundur të jem nacionalist sipas atyre kritereve. Sa më përket mua, në asnjë mënyrë nuk kisha dëshiruar të bëhem nacionalist, dikur e kam pasur atë dobësi, kam qenë në prag të atyre ngjarjeve nacionaliste, mirëpo mandej për fat të mirë jam vetëdijesuar dhe e di se nacionalizmi i tepruar nuk mund të sjellë ndonjë drejtësi askujt. Pranimi i veçantisë popullore të popullsisë dhe traditës myslimane në Bosnjë e Hercegovinë ka qenë hap i madh në pranimin e veçantisë tonë nacionale dhe identitetit në përgjithësi. Mirëpo, një vendim i tillë i kësaj çështjeje do të thotë hapje e mundësive edhe për çështje të tjera. Ende vazhdimisht nuk është thënë se cilit emër pikërisht i takon ky popull, por për gjithmonë kanë mbetur myslimanë. Prandaj, serbët ende gjithnjë në anën e tyre kanë mbajtur të hapur mundësinë të shprehen si serbë, gjithashtu edhe kroatët. Në këtë kuptim kaq është bërë ky emër për në frenim e ndoshta edhe kurthë. Kurthë u bë në mënyrë speciale pas

ndodhive të tanishme në vend, pas holokaustit, pas përpjekjeve të shkatërrimit të një populli të tërë, sepse në mediet botërore identiteti ynë ka qenë i theksuar vetëm si një identitet fetar. Në Perëndim kurrë nuk i kanë emëruar myslimanët me emër nacional. Kur më vonë është folur për të ashtuquajturin konflikt në Bosnjë, sepse në realitet ky nuk ka qenë konflikt, por sulm ndaj një populli, konflikti paraqet dy partnerë të cilët kanë mundësi të njëjta për t'u konfrontuar, mirëpo kjo në Bosnjë nuk ka qenë konflikt, ngase njëra anë nuk ka dashur të bëjë disa shpjegime me palën tjetër, por thjesht ka ardhur dhe e ka sulmuar popullin tjetër.

Shumëçka me kalimin e kohës te ne është harruar, madje edhe ajo që boshnjakizmi dikur ka qenë i gjallë. Në kohën e sundimit turk, njerëzit e dinin kush janë dhe çka janë, dhe nuk ka pasur kurrfarë termi për shënimin e veçantisë nacionale përveç boshnjak. Kjo kështu ka qenë një kohë edhe të Austrisë, mirëpo këto dy Jugosllavitë i kanë kontribuuar asaj që gjeneratat vijuese më nuk kanë menduar në bazë të paraardhësve të tyre, të parëve të tyre, por pikërisht asaj rruge, ashtu siç ua ka imponuar politika që ata të deklarohen si serbë, kroatë ose të papërcaktuar, dhe për këtë shkak te populli ynë dikur u lajmërua edhe nocioni jugosllav.

Boshnjakizmi duhet të jetojë në mënyrë institucionale. Ai nuk guxon të shpjegohet me atë komponentin fetar, sepse ashtu nuk është as historik as natyror

A.D.: *Ju si një luftëtar i madh për boshnjakizëm, si orientalist e hulumtues i kulturës sonë, si e keni përjetuar Kuvendin boshnjak dhe rezultatet e inteligjencës së tubuar për herë të parë nga të gjitha strukturat tona, të bashkuara në një marrëveshje plebishitare definitive rreth kthimit të emrit tonë historik e nacional?*

S.Baliq: Kjo është gjithsesi një ndër fitoret më fisnike në disa vitet e fundit. Unë kam qenë i befasuar me shpejtësinë e formimit të këtij ko-

alicioni, si ka mundur të vijë deri tek ai kuvend dhe si ka mundur njëzëri të vendoset për t'u pranuar emri i vjetër i harruar boshnjak. Kjo ka qenë një shenjë shumë e mirë, kjo në një mënyrë na ka shpëtuar, tani mundemi qetësisht të paraqitemi para botës. Në realitet vazhdimisht ende bota e jashtme është e painformuar mjaft për të gjitha këto. Shumë njerëz nuk e dinë se ne thirremi boshnjakë. Unë në gjermanisht them Volksbosnier. Përkatësisht shprehja bosnier në gjermanisht më mirë tingëllon sesa boshnjak. Ndoshta është edhe kjo mirë të them se gjermanët interesant reagojnë me habi në të gjithë emrat e popujve të cilët përfundojnë me **ak**, si p.sh., polak, kozak ose emra të ngjashëm të cilët përfundojnë me sufiks të tillë. Kështu në këtë kategori i klasifikojnë edhe boshnjakët sipas këtij sufiksi që përfundon në **ak.** Krijohet paksa përshtypja sikur ka të bëjë me ndonjë popull të prapambetur.

A.D.: *Sipas mendimit tuaj, çka duhet të bëjnë individët, institucionet dhe shteti që boshnjakizmi të marrë formën e vërtetë dhe të ndërtojmë me elementet e vërteta, të cilat një komb duhet t'i ketë, për nga përmbajtja dhe cilësia?*

S.Baliq: Duhet kaluar një proces i pjekurisë, një civilizim ashtu të them, përmes shkollës medieve tona, tribunave, gazetave etj. Duhet t'u shpjegohet njerëzve, sepse ende ka shumë të panjohura. Para së gjithash nuk duhet të lejohet që boshnjakizmi të shpjegohet vetëm me komponentin fetar, sepse ashtu nuk është as historike as e natyrshme. Nëse kjo deri më tash është shpjeguar me të madhe sipas kushteve të komunizmit, mund pjesërisht edhe të kuptohet. Sikur të ishte shkuar rrugës tjetër, rezistencat mund të kishin qenë shumë më të mëdha. Në këtë mënyrë këtë e kanë kufizuar pak a shumë në kulturën islame dhe traditën islame, por prapë në anën tjetër i kanë bërë padrejtësi të madhe vetë islamit. Është zbrazur kuptimi mysliman nga përmbajtja e vërtetë e tij. Çka do të thotë kuptimi mysliman madje edhe nëse shkruhet me germë të madhe, mirëpo kur të thuash mysliman me atë duhet të kuptosh atë burrë ose grua, të cilët me dorëzimin e vet ndaj Zotit i mposhtën vështirësitë e tyre jetësore, e nëse ka ndonjë myslim-

an që këtë nuk e bën, por përkundrazi do të shkatërrojë Zotin, atëherë ajo është diç tjetër. Pastaj janë të rëndësishme institucionet kombëtare, si p.sh.: "Preporodi" dhe tani nuk është aq e rëndësishme momentalisht të formohen të reja, sepse ndoshta aq më tepër është fatkeqësi nëse ne themelojmë institucione të gjithanshme të reja, mandej edhe nëse bëhet fragmentarizmi. Përveç kësaj, në realitet ekziston një Amzë boshnjake, e cila dorën në zemër nuk është e strukturuar siç është Amza kroate ose ajo serbe. Këto dy institucione janë të natyrës së pastër kulturore, kurse Amza boshnjake ka disa obligime të caktuara sociale, duke pasur parasysh situatën në diasporë për t'u ndihmuar njerëzve. Edhe aty ka fragmentarizëm, një grup është ndarë dhe emërohet Amza e Bosnjë e Hercegovinës. Mirëpo, për këtë unë nuk mund të shprehem fare, sepse dihet se çka është Amza.

Islami në Bosnjë është specifik

A.D.: *Ju në Perëndim jeni të njohur për nga interpretimi dhe shtrëngimi i një versioni specifik të islamit të përshtatshëm për të arriturat civilizuese të Evropës Perëndimore dhe të kushteve të punës dhe jetesës në të cilat gjithnjë e më tepër po shtohet numri i myslimanëve. Euroislami ose islami për Evropën është një lloj i islamit bashkëkohor, i cili me vite është shfaqur në Bosnjën tonë. Juve u është e njohur situata me islamin edhe në ish-vendet komuniste në Rusi, të cilat gjithashtu janë pjesë e Evropës. A doni të na shpjegoni më hollësisht qëndrimin tuaj lidhur me këtë?*

Për mua Tito, edhe pse edhe ai ka pasur gabimet e veta, kur është në pyetje Bosnja dhe myslimanët, ka qenë personalitet simpatik dhe absolutisht pozitiv.

S.Baliq: Ka një veçanti në islamin e Bosnjës, kurse tradita jonë ka disa lidhje me jetën shtetërore. Mirëpo, mendoj se bektashinjtë kon-

kretisht neve na e kanë sjellë shembullin e islamit, siç e kanë përjetuar ata, ashtu kanë vepruar edhe myslimanët e parë tonë dhe kanë jetuar më vonë. Kuptohet se pastaj ka ardhur një proces i thellimit të islamit, i cili nuk ka qenë i përfunduar aq më tepër as kur kam qenë fëmijë. Profesori im Mehmet Hanxhiqi, e di ka luftuar me tërë forcën për ta zvogëluar ndikimin e dervishëve në jetën fetare të myslimanëve për arsye se dervishët kanë pasur qasjen e vet të posaçme të islamit. Nuk kanë qenë së paku një pjesë, të ngurtë në besimin e tyre, shpeshherë kanë qenë të hapur për botëkuptime të tjera, mandej kanë marrë ide sinkretike në pikëpamjet e tyre jetësore dhe Hanxhiqi ka qenë një ndër alimët tanë të fundit që është përballur me dervishët. Para tij atyre i janë kundërvënë edhe të tjerët qysh në shekullin XVII, por kjo nuk është kryer deri në fund. Pra, ne kemi qenë në një proces të vazhdueshëm dhe me ardhjen e trupave austro-hungareze dhe me takimin tonë frontal me Evropën Perëndimore kanë ardhur shtresa të njohurive të reja, ashtu që me këtë islami ynë u bë diç i veçantë në botën islame. Ashtu si edhe te kisha ortodokse, e cila ka pasur një sërë pikëpamjesh të huaja me çështjet themelore fetare. I njëjti Isa a.s. ose Isus krishti tek ithtarët e kishës boshnjake, gjatë ka qenë i konsideruar si një simbol dhe shembull i mirësisë. Ky mendim se ajo frymë e humanizmit, dhe mirësisë duhet të pasohet, kjo me fjalë të tjera ka qenë specifika e mësimit fetar të Bogumilve ose kishës boshnjake. Pra, Pejgamberin Isa a.s. ata nuk e kanë përjetuar si djalë të Zotit, por si dikë që duhet të pasohet. Ndërsa, kuptimi i ngjashëm është përfaqësuar aq më tepër edhe në Kuran ku në dy vende Isa a.s. përmendet si "ruh" që do të thotë sikur shpirt (frymë). Pra ai koncept paraislamik i Zotit ka mbetur përkatësisht është mbajtur pastaj edhe në islam edhe pse siç e dimë se çdo përzierje të ndonjë fuqie tjetër në nocionin e Zotit është shirk, përkatësisht mëkat i rëndë. Mirëpo, në krishterim posaçërisht të tipit lindor, në ortodoksizëm, krishti pranohet me fjalë të tjera si kujdestar. Ata kanë një proces i cili quhet teozis pra ekzistimi me Zotin. Teologjia kërkon nga njeriu të bëhet i ngjashëm me Zotin. Kjo nganjëherë shkon aq larg, saqë disa individë e konsiderojnë veten për Zot. Ndikimet negative të pikëpamjeve të tilla teologjike sot vërehen te ne në

Bosnjë dhe si të shpjegohet ndryshe qëndrimi i agresorit serb, i cili dikur është sjellë sikur të ishte vetë Zot, që krye në vete krijon ligje (vetë Karaxhiq në disa raste haptazi ka thënë: "Sot serbi është Zot", vër. A.D.) që shihni. Përveç kësaj, para se të vinte deri te kjo gjakderdhje në Kroaci dhe Bosnjë, revista beogradase "Duga" ka botuar një numër të veçantë me titull: "Povratak bogova" - "Kthimi i zotave". Unë kam qenë dy herë në Rusi dhe Tashkend. Kam qenë në Bullgari, në Samerkan dhe më kanë ftuar në atë kohë kur atje sundonte regjimi komunist dhe kështu kam mundur t'i kompozoj ato përvoja me islamin. Derisa në Jugosllavi nuk më duronin, atje më ftonin. Kam qenë i njohur dhe i pranuar. E di se edhe atje ka pasur modernizim të caktuar të islamit sa iu përket strukturave të ngjashme. Në popull ka mbetur fryma e traditës së vjetër, kështu që komunistët nuk kanë mundur të depërtojnë me pikëpamjet e tyre në thellësi të fshatit, para së gjithash zakonet popullore atje janë ruajtur shumë më tepër se te ne në Bosnjë. Në aspektin e shkollave dhe fakulteteve islame ne megjithatë kemi qenë një përjashtim në atë botë komuniste. Vetëm para shpartallimit të regjimit komunist u lajmëruan disa lëvizje islame, disa lidhje u krijuan. Ndonjë individ ka mundur të shkojë në Kajro për të studiuar. Kam pasur rast të vlerësojë qëndrimin e myftinjve të atjeshëm dhe funksionarëve përgjegjës të Bashkësisë Islame, të cilët kanë pasur mjaft pikëpamje të hapura e moderne, duke marrë parasysh qëndrimin ndaj femrës. Kjo tërësisht është kufizuar në qytete, në mjediset urbane, kurse fshati ka mbetur i paprekur. Andaj, kur është në pyetje krahasimi ynë në Bosnjë me myslimanët e ish-Bashkimit Sovjetik nuk ka dyshim se ne kemi qenë në fitim. Ne kemi fituar në numër të intelektualëve, në krijimtarinë kulturore në përgjithësi. Ne pothuajse kemi depërtuar deri te lartësitë superiore. Duhet të mendojmë vetëm në veprat e Mesha Selimoviqit, Makë Dizdarit, Skender Kulenoviqit, pastaj duhet përmendur edhe Kusturicën, pa marrë parasysh qëndrimet e tij politike, e për të sot nuk është koha, pastaj të Sushiqit, Karahasanit dhe Sidranit. Ata kanë shkruar gjëra të mira, ata janë intelektualë të cilët i kanë hije edhe Evropës. Mund të themi se dallimet në këtë pikëpamje përafërsisht janë ashtu siç kanë qenë edhe në natyrën e atyre dy sistemeve, si

për çështje demokratike, nacionale, politike, ashtu për të drejtat fetare e të tjera të qytetarëve në përgjithësi, çka mund të thuhet se ka qenë merita e Titos si politikan i aftë dhe mendjemprehtë. Ne duhet falënderuar edhe sistemin posaçërisht, i cili ka ekzistuar. Për mua Tito ka qenë një personalitet simpatik dhe absolutisht pozitiv, kur janë në pyetje Bosnja dhe myslimanët, edhe pse edhe ai i ka pasur mëkatet e veta.

Gjoza ka qenë shkencëtar i vërtetë dhe teoricien i islamit

A.D.: *A doni ta jepni vlerësimin e nivelit të njohjes së islamit të një alimi të njohur të atyre vendeve myslimane ruse dhe vendit tonë, si p.sh. Husein Gjozës ose dikujt tjetër që ne e kemi pasur e sidomos sot, e kjo nuk ka mundur të bëhet brenda natës, do të thotë ka ekzistuar ndonjë sistem i arsimit dhe zhvillimit të atyre ekspertëve islamë-alimëve?*

S.Baliq: Husein Gjoza është fenomen i veçantë. Ai është në përgjithësi njeri i cili ka pasur një qëndrim, një kuptim largpamës të islamit, i cili unë mendoj se ka mundur t'i ofrojë sot mësim tërë botës islame, në realitet me tezat e tij. Unë tashmë e kam përmendur në bisedë se ai sunetin e konsideron komentim të Kur'anit dhe njëlloj ixhtihadi, përkatësisht përpjekje të një njeriu mendimlirë për të gjetur kuptimin e rregullave fetare, të tregojë se cilës rrugë duhet shkuar dhe atë sipas kërkesave të kohës dhe hapësirës në të cilën jetohet. Shumë njerëz thonë se islami është i ngurtë dhe se Kur'anin para së gjithash duhet praktikuar fjalë për fjalë. Mirëpo, në islam ekziston një shkencë e cila i hulumton shkaqet e jashtme të disa ajeteve, pse kjo ose ajo është thënë, me çka në realitet pranon se Kur'ani është i lidhur me kohën dhe hapësirën. Prandaj do të ishte e lejueshme që edhe te ne myslimanët të bëhet analiza kritike historike. Pra, Kur'ani të lexohet duke marrë parasysh ose shikuar mbrapa si ka qenë dikur. Mendoj se kjo është shumë me rëndësi pa marrë parasysh atë që prapë ka një mundësi tjetër

për hapje. Përkatësisht prej shek. VIII-X bota myslimane ka përjetuar renesancën e saj. Në atë kohë ka qenë në jetë një shkollë teologjike liberale, e cila qëndronte me pikëpamje se vërtet Kur'ani është i krijuar si fjalë e Zotit, mirëpo Zoti atë fjalë e ka dhënë në një kohë të caktuar dhe për një hapësirë të caktuar. Nëse qëndrohet në këtë pikëpamje se Kur'ani është gjithashtu një libër që ka edhe dimensionin historik, atëherë disa dëshmi të Kur'anit mund t'i konsiderojmë sot si dokumente historike që janë gjetur aty, të cilat na mundësojnë të shohim se çfarë ka qenë Bashkësia Islame në periudhën e parë, por ato nuk duhet të kenë kuptim negativ për të gjitha kohët. Kur'ani e ka edhe dialektikën e vet të brendshme. Ka porosi të cilat kanë pasur vlerë për një kohë të caktuar e në Kur'an ka ajete të derogiruara, do të thotë të hequra nga rendi i ditës, ngase kanë ardhur të tjerat. Sipas kësaj, edhe ky është një argument për atë se Kur'ani është i krijuar respektivisht në një kohë të caktuar dhe se atëbotë mjaft prej tij është ndërruar. Aq më tepër për një kohë të shkurtër siç ka qenë jeta e Muhamedit a.s., e çka të themi se çka tërë është ndryshuar për këta 14 shekuj (Fjala mund të jetë për ndryshime të kushteve jetësore e shoqërore kurse në Kur'an asgjë nuk ka ndryshuar nga koha e Muhamedit a.s. vër. përk.). Unë mund të kem qenë optimist dhe gjithmonë kam vërtetuar se pikërisht islami i Bosnjës do të jetë shtysë e re dhe do të japë udhëzime dhe shembull për tërë botën myslimane.

Vehabitët dhe sektet e ngjashme janë të dëmshme për myslimanët në Bosnjë dhe në Evropë

Megjithatë, lajmet më të reja më kanë pikëlluar shumë, ngase po dëgjoj se atje këta tanët po qëndrojnë në akull të hollë të këtyre ndikimeve nga Lindja dhe se ato konsiderohen si kompetente. Mirëpo, edhe nëse diçka rrjedh nga arabët nuk do të thotë se ajo garanton kualitet. Islami është një fe universale dhe të gjithë ithtarët e tij kanë të drejtë të mendojnë, të meditojnë dhe t'i paraqesin qëndrimet e tyre. Ne kemi pasur një fillim ashtu të bukur, pjesërisht të detyruar nga këto përjetime të rënda të cilat i kemi pasur pikërisht në kohën e komu-

nizmit, përndryshe ne kemi qenë të detyruar të kërkojmë një rrugë për të ardhmen në Evropë, ku jemi të vendosur, rrugë e cila nesër do të mund të jetë e përdorshme edhe për Azinë dhe Afrikën, sepse edhe ato sot gjithnjë e më tepër po hapen duke iu falënderuar medieve që i kanë në dispozicion, televizioneve etj. Mirëpo, për këtë nuk guxojmë të lejojmë që këto elemente regresive të përhapen te ne e të ambientohen dhe duhet thjesht të pengohen ato, ngase kjo shpie në tragjedi. Nëse themi se konsiderohet se islami është të veshurit e sotëm të arabëve ose shprehia nga një mjedis arab dhe në përgjithësi nëse vihet theksi aq i madh në veshje dhe kërkohet nga femrat myslimane të mbulohen këtu në Evropë, atëherë për afat të gjatë kjo mund të jetë e dëmshme për myslimanët në Perëndim dhe me këtë edhe në Bosnjë. Posaçërisht kjo sot është aktuale në Gjermani me ato shamitë ose siç thonë gjermanët "kapftuh", përkatësisht mbulesë për kokë, ku sipas mendimit tim edhe më tej do ta acarojë gjendjen, për shkak se tërë kjo është nën ndikimin e këtyre elementeve konservative dhe të dëshirës së burrave që përmes grave të tregojnë identitetin e tyre. Në këtë mjerisht iu shkon për dore edhe një pjesë e ylemave islam në Perëndim, duke shpjeguar se ajo është e obligueshme për gratë myslimane, e që me fjalë të tjera do të thotë se ato gra myslimane që nuk mbajnë shami nuk janë myslimane. Këtu ka edhe të tjera dukuri dhe ndikime, e në lojë janë edhe mjetet materiale të qarqeve të caktuara, të cilat janë stimulim i atyre që sillen ashtu. Bashkësia Islame në Bosnjë dhe kjo në Evropë janë në sprovë të madhe që gjërat e tilla në mënyrë racionale dhe pragmatike t'i shikojnë, t'i shtrojnë dhe t'i zgjidhin.

Thjesht të gjitha këtyre risive u vihet akcenti në gjërat joesenciale në vend të atyre esenciale sikur islami dhe feja të ishte mbi kokë e jo në kokë. Aq më tepër mund të thuhet edhe unë e vërtetoj se ajo më parë ka qenë traditë krishtere dhe para islame, ju jeni të rinj dhe nuk e dini, në kohën time gjithmonë të gjitha të krishterat kanë mbajtur në kokë një mbulesë të tillë, e cila kryesisht ka qenë e zezë, kurse myslimanët jo, por kanë bartur avlija ashtu të hedhura lehtas pas koke, sa që njeriu ka mundur të shohë edhe bukuritë e femrës, e kjo mund të mësohet edhe nëpërmjet një kënge popullore. Dhe tani ata të orientit

duke ardhur në hajmet tona së pari kanë për t'iu dhuruar grave tona refugjate shamia apo mbulesa të tilla. Në këtë situatë të rëndë ata vijnë me tradita të tilla, me të cilat vetëm mund të kompromentohen në këtë vend.

***

Mendoj se ne duhet ta racionalizojmë teologjinë tonë islame dhe duhet t'i pranojmë disa elemente nga qasja mutezelite e Kur'anit. Më në fund nuk mund të kërkojmë nga Perëndimi t'i ndryshojë standardet dhe rregullat e sjelljeve për hir tonin

Përse Kur'ani këtë e porosit dhe ajo qëndron në arsyetimin, për t'u njohur se janë ithtarë të Bashkësisë Islame e për të qenë të sigurta nga shqetësimet. Prandaj, këto janë dy premisa. Unë tani them: Cila grua sot në përgjithësi në Evropë, madje myslimane, bart galabija të tilla me kaçuler. Dhe e dyta, cila grua është sulmuar këtu në këtë vend. Mendoj se ne duhet ta racionalizojmë teologjinë tonë islame dhe se duhet të marrim disa elemente nga qasja mutezelite të islamit. Ne kemi liri të plotë të vendosjes dhe se myslimani është përgjegjës edhe për të parit e tij, edhe për të dëgjuarit e tij dhe për të gjitha shqisat e veta. Një ditë duhet të japë llogari pse kështu ose ashtu është paraqitur (ka vepruar). Kjo do të thotë se ne jemi përgjegjës për veprat tonë. Nuk guxojmë të lëshohemi vetëm stihisë ose imitimit, sepse një religjiozitet i cili përbëhet nga imitimi absolutisht është i pavlerë. Ai nuk ka vlerë të brendshme, ai është vetëm formalitet.

Nga ana tjetër, në perëndim ekzistojnë standarde te disa profesione të caktuara, ku përveç tjerash në punë janë paraparë edhe rroba të caktuara me të cilat nuk mund fare të vishen myslimanet me shamia. Myslimanet shpeshherë thonë qysh po munden motrat e nderit, mirëpo ajo për motrat e nderit është profesion, i cili nënkupton veshje të

tillë, kurse myslimanja me shami nuk është profesion. Në qoftë se motra e nderit dëshiron të jetë stjuardesë ose police, edhe ajo duhet ta veshë uniformën e caktuar. Nëse qëndron këmbëngulës tek ajo se myslimanja në të gjitha situatat e paraqitjes në jetën publike duhet të bartë shaminë, me këtë vetë myslimanët i diskriminojmë gratë tona, ngase në atë mënyrë një numër i madh i vendeve të punës dhe profesioneve do të mbesin të paarritshme. Madje edhe sikur të ishte shamia e obligueshme me rastin e veshjes së myslimanes mëkati më i vogël është shkuarja pa të sesa të përjashtojë vetëm nga mundësitë e gjera të punës dhe fitimit, kur e dimë se edhe puna është farëz. Në fund nuk mund të kërkojnë nga Perëndimi t'i ndryshojë standardet dhe rregullat e sjelljeve për hir tonin, të cilët aty shumica jemi mysafirë me të gjitha të drejtat si qytetarë të vendit.

Bosnjën e mendoj si shtet juridik

A.D.: *Si e mendoni Bosnjën pas përfundimit të kësaj lufte?*

S.Baliq: E mendoj atë si shtet juridik, për këtë nuk duhet diskutuar. Siç thuhet në gjermanisht "Rechetstaat", në asnjë mënyrë vend të pastër nacional. Ne, sipas shumicës së popullit, mund të jemi vend boshnjak dhe aty kryesorët të jenë boshnjakët, mirëpo të gjithë qytetarët tjerë të Bosnjës duhet t'i kenë të gjitha të drejtat si ne dhe duhet të miratohet deklarata në këtë pikëpamje. Nuk duhet kurrsesi të lejohet që botëkuptimet të cilat gjenden në botën arabe, të ashtuquajtura fundamentaliste, të vijnë në shprehje te ne, kur njerëzve me dhunë iu imponohet ajo që ata nuk e duan, si p.sh., kur vajzave iu imponohet të bartin ferexhe ose shamia, për të cilën tashmë kemi folur siç veprojnë çifutët. Duhet garantuar liria e plotë e ndërgjegjes, liria e fjalës etj. Prandaj, nuk ka as nuk mund të ketë kurrfarë detyrimi as brenda rrethit të myslimanëve boshnjakë. Nëse dëshiron dikush të shkojë në xhami, le të shkojë, e nëse nuk do, ne nuk mund të veprojmë si arabët, që kanë policinë për moral, e cila i detyron njerëzit të shkojnë në xhami. Në realitet nganjëherë më pyesin të huajt edhe gjermanët se qysh

është kjo të ketë vende myslimane, ku njerëzit me dhunë dërgohen në xhami, kurse unë duke i arsyetuar edhe ato vende dija t'iu thosha: Shikoni, te ne përpara xhamia ka qenë si shkollë, siç është detyrimi i fëmijëve për të shkuar në shkollë, atje duhet të shkojnë në xhami.

Nga çifutët mund të mësojmë shumë

A.D.: *Në fund, profesor Baliq, një pyetje krejt praktike dhe aktuale. Ju jeni shumë kohë në diasporë, në migracion, përcillni organizimin e njerëzve tanë, lëvizjet, shoqërimin, problemet, tani kur atje ka shumë njerëz tanë, me refugjatë e me ata që kanë ardhur para 30 vjetësh. Si të veprohet që diaspora boshnjake të jetë më mirë e organizuar, që më tepër t'i ndihmojnë popullit në atdhe dhe shtetit dhe që ne vetë këtu të ndërtojmë ndonjë profil që më mirë të përfaqësojmë, të mësojmë më mirë, të punojmë më mirë dhe fëmijët t'i shkollojmë dhe që kulturën tonë, traditat dhe identitetin tonë nacional dhe fetar ta mbajmë dhe ta zhvillojmë?*

S.Baliq: Do të ishte mirë të kishim organizata qendrore, të cilat do të kishin autoritet të mjaftueshëm për t'i shtyrë qëllimet e tyre ashtu si duhet. Çifutët i kanë disa organizata, siç është "Kongresi çifut", i cili ka qasje kudo ku ata gjenden. Një trup i tillë na nevojitet shumë. Një trup i cili do të kishte në dispozicion mjetet financiare. Më tepër sakrifikim te njerëzit tonë të pasur do të ishte e nevojshme. Kam përshtypjen se momentalisht nuk ka kurrfarë strumbullari për të na shtyrë dhe për të na mbajtur me autoritetin e tij, askush askënd nuk e begenis, secili do t'i tregojë vaz tjetrit. Ka një hadith ku Muhamedi a.s. thotë: "Parashenjë e Kiametit është kur secili i tregon vaz secilit".

Përktheu nga boshnjakishtja:
Hajrullah Hoxha

Marrë: Behar-Çasopis za kulturu i drushtvena pitanja.
God. XIII. Broj 66/67.Zagreb 2004 god.

Alaga Dervisheviq

60 YEARS OF INTELLECTUAL STRUGGLE FOR BOSNIANISM, A DEMOCRATIC BOSNIA, ISLAM AND MUSLIMS IN EUROPE

(Summary)

Academician Smail Balic was one of the most eminent Bosnian orientalists in the diaspora. He went abroad as a student in the beginning of WWII.

Smail Balic was an eminent researcher, scientist, polyglot, an expert on Islamistics, the Arab language, Turkology. He published more than 20 books and more than 300 scientific articles, most of which dealt with the issue of Bosnia and Bosnian culture.

آلاغا درويشفيش

من الحوارات المنشورة و غير المنشورة

(خلاصة البحث)

(ستون سنة من العمل للآكديمى البوسنوى إسماعيل باليش عن البوسنوية و البوسنيا الديموقراطية و الاسلام و المسلمين في أوربا)

ان العالم إسماعيل باليش حتى الآن كان أدقم و أكبر باحث بوسنوى في المهجر حيث ذهب كطالب في بداية الحرب العالمية الثانية.

هو كباحث و عالم و خبير في مجال اللغة العربية و العلوم الاسلامية نشر أكثر من 20 كتابا و أكثر من 30 مقال علمية و اغلبها تتحدث عن البوسنا و الثقافة البوسنوية. و كخبير تم دعوته في أكثر من مؤتمر و ندوة علمية حيث تحدث عن المواضيع التي تخصص فيها.

TERMINOLOGJIA FETARE

GLOSARI ORTODOKS[1]

Agnec: agneza, agnezë:(fjalë me prejardhje nga gjuha sllave e vjetër): pjesa e mesme dhe më ndritshme e tharmit të bukës, ku është e shënuar emri i Krishtit, IS HS NI KA, që do të thotë "Krishti do të ngadhënjej", i cili paraqitet si viktimë në meshë dhe shërben për kungatë. Simbolikisht paraqet Jezu Krishtin, i cili si qengj - agnezë pranon mëkatet e botës mbi vete dhe viktimizohet për ta shpëtuar njerëzimin.

Akatist: (nga greq. ακάθιστος), të dëgjuarit duke qëndruar në këmbë: himni i falënderimit Himnografija ortodokse njeh akatist që i janë dedikuar trinisë së shenjtë. Kryqit të shenjtë si dhe shenjtorëve të tjerë.

Aksios: (nga greqishtja αξιος), lat. Dugnus - me dinjitet, liturgji me brohoritje e besimtarëve gjatë shërbesës fetare.

Amvon: amvonë, hype, pjesë e ngritur para altarit në kishë ku prifti qëndron gjatë leximit të Biblës dhe ligjërimit.

[1] Për këtë temë kryesisht jam mbështetur në tekstin: "Glosar religijsjikh pojmova", botim i Medjureligijsko Vijece Bosne i Hercegovine, Sarajev, 1999.

Anamneza: (greq. Ανάμνησις përkujtim, kujtim); pjesa kryesore e Kanonit Eukaristi, në të cilat përkujtohen çastet kryesore nga historia e shpëtimit, duke filluar prej Ungjillëzimit e deri te ardhja e dytë e Jezu Krishtit.

Anatema: mallkim, shkishërim, anatemë; veprim i fundit që ndërmarrin organet kishtare ndaj atyre që bien në herezi, përjashtimin e tyre nga bashkësia për shkak të mësimeve të tyre të gabuara.

Anafora: (nga greq. αναφορά) që ka kuptimin : ngritje, lartësim, lëvdim, glorifikim, ekzaltim: pjesa e mesme e liturgjisë ortodokse, që i përgjigjet Kanonit të Evharitis. Anafora përbëhet nga lutjet e mirënjohjes, shugurimit dhe thirrjes e përcjell me lëvizje dhe veprime simbolike gjatë kohës kur bëhet hapja e dhuratave të shenjta dhe të sekretit të shenjtë.

Antifon: këngë kishtare, e cila këndohet në mes dy koreve gjatë liturgjisë.

Antimins: (fjalë latine. Ante-mensa - në vend të sofrës): liturgji në ekran ku paraqiten vuajtjet e Jezu Krishtit dhe depozitimi i tij në varr e që vendoset në sofrën e shenjtë mbi altarin e kishës

Antroplogjia: (nga greqishtja ανθρωπος: njeri): mësimi i krishterë mbi njeriun, personalitetin dhe natyrën e tij. Si elemente kryesore të antroplpogjisë ortodokse mund të përmenden:

- Prejardhja hyjnore dhe ontologjia e përbashkët e gjinisë njerëzore.
- Njeriu si subjekt unik është krijuar në "pamjen" e Zotit
- Ripërtëritja e vazhdueshme e natyrës njerëzore në Jezu Krishtin dhe nëpër mes tij.

Apolegjija: (nga greq. απολογια), latinisht. Apologetium, apologji, mbrojtje, arsyetim: degë e teologjisë sistematike që përpiqet ta ar-

gumentojë ekzistencën e Zotit, nëpër mes argumenteve racionale apo argumenteve logjike.

Apostull: libri i shërbesave fetare, në të cilin gjenden veprat e apostujve dhe letër enciklike, pjesë të cilit lexohen gjatë shërbesave fetare.

Përcjellje apostolike: (lat.successsio apostolica - përcjellje, trashëgimi): mënyra në të cilën Kisha ruan unitetin dhe strukturën permanente të dymbëdhjetëshes së apostolizmit në kontinuitetin e saj historik.

Apofatika (nga greq. απόφασις - mospranim, kundërshtim; rrëzim, përgënjeshtrim): apofatika ose teologjia negative është modalitet i njohjes nëpër mes kundërshtimit dhe përparimit, e cila është njëra prej atributeve të Zotit, i cili mbetet i panjohur dhe i pa kuptueshëm sipas përmbajtjes së tij transcendentale. Për shkak të pamundësisë së zbulimit të përmbajtjes së Tij të fshehtë, Zoti nuk mund të njihet në atë mënyrë ashtu siç ne i njohim krijesat e krijuara të kësaj bote, do të thotë nëpërmes argumentimit, duke u mbështetur në konceptet dhe kategoritë e kohës dhe të hapësirë. Apofatika më tepër mëton në atë se çka nuk është Zoti, se sa në atë çka Ai është. Si metodë e njohjes, apofatika do të thotë përjetimin e ekzistencës së Zotit. Për ortodoksët, apofatika paraqet mënyrën adekuate të vrojtimit të jetës transcendentale dhe ekzistencën e Zotit.

Arqipeshkv: (nga greq. αρχιεπίσκοπος- kryeparë i një kishe ortodokse. Si për shembull arqipeshkvi parë serb ishte Sava Nemanjiqi (Shën Sava) më 1219. Këtë statut sot e kanë kisha greke, qipriote dhe ajo shqiptare.

Arhrijej: (nga gerq. αρχιερέας) - titulli më i lartë fetar, peshkop, kryemurg në një dioqezë. Si përshembull, secili peshkop është peshkop është edhe arhierej.

Kuvendi i arhierejve (peshkopëve): organi më i lartë ligjvënës dhe gjyqësor i një Kishe Ortodokse, të cilin e përbëjnë arhierejt (peshkopët). Kuvendi i shenjtë i peshkopëve zgjedh peshkopët e rinj, formon dioqeza të reja, zgjedh kryepeshkopin do të thotë patriarkun.

Sinodi i peshkopëve: organi më i lartë ekzekutiv administrues dhe mbikëqyrës në Kishën Ortodokse. Anëtarë të Sinodit të Shenjtë në Kishën Serbe është patriarku dhe katër peshkopë, të cilët ndërrohen vazhdimisht çdo dy vjet, ndërsa Patriarku është anëtar i përhershëm.

Arkimandrit: në radhë të parë do të thotë kryemurg përgjegjës për disa manastire. Sot titulli arkimandrit jepet, jo për shkak të mbikëqyrjes së manastireve, por aq më tepër për shkak të angazhimeve personale si dhe renomesë së eprorit të manastireve.

Askeza: (nga greq. ασκησις - ushtrim, shprehi; trimëri), lirim nga emocionet apo ndarja e shpirtit nga jeta e përkohshme, që të vihet deri te gjendja e gjakftohtësie duke arritur virtyte. Askeza është njëra prej elementeve përbërëse të ortodoksizmit shpirtëror dhe është e barabartë me aktiviteteve të virtyteve filozofike, shkallën e parë të ngritjes.

Autoqefaliteti: (nga greq. αύτοκεφάλη - autoqefale, e pavarur): pavarësia e një kishe ortodokse në krahasim me kishat tjera. Një kishë të jetë autoqefale duhet të plotësojë disa kushte, si për shembull: të ketë kuvendin e peshkopëve vendorë, ta zgjedh kryemurgun, arkimandritin apo patrikun, të ketë territor të caktuar si jurisdikcion si dhe të bëhet krezmimin me vaj të shenjtë…

Autonomija: një nivel më i ulët i pavarësimit të kishës. Kishat i shuguron Kisha nënë (Patriarkana e Stambollit), ajo është kishë autonome nuk e zgjedh kryepeshkopin e saj, dhe nuk ka të drejtë të shuguroj. Kishat autonome ortodokse sot janë: në Finlandë, Japoni dhe Maqedoni..

Bibla: {nga greq. βιβλίον, lat. Scriptura - libri, shkrimi): emërtimi latin i librit të shenjtë, përmbledhje të shkrimeve religjioze të Djathtës së Vjetër dhe të Re, të cilat kisha i ka tubuar dhe i ka zgjedhur si dhe ato që janë shkruar me inspirimin e Shpirtit të shenjtë, të cilat përmbajnë fjalë apo zbulesa që i janë shpallur Mojsiut, profet në Jezusin, të cilat kanë arritur nëpërmes apostujve. Bibla përmban shkrime të ndryshme të njëjtit kuptim të zbulesave. Tekstet dogmatike dhe ato profetike qëndrojnë pranë përshkrimeve historike, kronikat, lutjet, çështjet familjare, vizionet…Bibla është mbi të gjitha, fjalë e Zotit e shkruar sipas inspirimit të Shpirtit të Shenjtë, që demonstron shpëtimin e zbatuar në Jezu Krishtin. Libri i shenjtë-Bibla është libër fetar që përmban të vërtetën e Zotit në fillimin e krijimit, duke mos pretenduar që të jetë libër shkencor, apo libër i kosmologjisë, biologjisë apo historisë.

Zoti: (nga greq. θεός - θεότης, lat.Deus, Dominus Deus - krijesa më e lartë, ekzistenca e Zotit). Teologjia ortodokse i jep një koment apofatik të vërtetës së Zotit dhe ma tepër preferon kategorinë e fshehtësisë dhe përdorimin e termave më të lavdishëm kur flitet për Zotin - ai është emër mbi të gjithë emrat - (Filip.2.9)Shkrimi Areopadik mbi "Emrat e Zotit", tregon se Zoti as nuk mund të definohet, e as të kufizohet me gjërat e krijuara, për atë vet termi Zot është relativ, sepse ai ka të bëjë me marrëdhëniet e Tij me ekzistencën e nuk ka të bëjë me fshehtësinë e Tij transcendentale. Paraqitjen për Zotin e ka dhënë vet Ai në krijesat e Tij si dhe në ardhjen e birit të Tij. Me të gjitha teofanitë (paralajmërimet), me të cilat Dhiata e Vjetër është përlotë, megjithatë tërhiqet transcendentalja e Zotit. "Unë jam ai që jam" (Iz l. 3,14); ky emër është par exellancë emëri i Zotit.

Epifani: (nga greq. έπιφάνεια - epifani, ujët e bekuar. Manifestimi i Zotit, në veçanti paraqitja e trinisë së shenjtë me rastin e kryqëzimit të Jezu Krishtit në Jordani. Deri në shekullin e katërt, festa e epifanisë ka pasur të bëjë me disa ndodhi të historisë së shpëtimit: lindjes në trup të birit të Zotit, nënshtrimit të dishepujve dhe barinjve, pagëzimit në Jordani dhe mrekullisë së parë në malin Galile. Sot festa e Epifanisë festohet më 19 janar sipas kalendarit të ri dhe ka të bëjë në radhë të parë me pagëzimin e Jezu Krishtit në lumin Jordan.

Inspirimi: (nga greq. θεόπνευστος, lat. Inspiro, inspiratio-inspirim i shkrimit të librit të shenjtë si tërësi): veprim direkt i Shpirtit të Shenjtë, me anë të cilit shkruesi i Biblës është në gjendje të pranoj dhe saktësisht të argumentoj si dhe të shkruaj mësimin e fesë dhe të moralit.

Shënmëri: Zonja e bekuar, Zonja Shënmeri.Ungjijt e pranuar nuk japin shumë detaje për Zonjën Shënmeri. Ajo është vajza e vetme e Joakimit dhe Anes, e cila shërbente në tempull (faltore). Është e lindur në Nezaret të Galileut (Lk. 1,26,27). Virgjëresha Mërija ka pranuar lajmin e gëzuar nga engjëlli Xhebraili, se ajo do ta lind, se ajo do ta lind Jezu Krishtin (Lk.1.24-38). Mërija ishte me Jezusin në të gjitha ndodhitë e mëdha: synetimin, vendosjen në faltore (tempull), largimin në Egjipt, këshillën në faltore, në kohën e vuajtjeve, pas së cilës për të kujdeset apostulli Jovan. Mësimet ortodokse për Shën Mërinë mund të përmblidhen në disa emra, ata janë: gruaja, nëna e Zotit, Shën Mëria etj.

Bogumilizmi: mësim i krishterë, sekte dualiste e njërit nga Bogumilët (gjysmën e shekullit nëntë), në Bullgari, prej nga është përhapur edhe në Ballkan në shekullin e dymbëdhjetë.

Martesa, kurorëzimi: (nga greq. γάμος - συνάφεια, lat.*matrimonium* - martesë: njëra prej shtatë fshehtësive të shenjta dhe njëra prej traditave me rëndësi të natyrës së njeriut, të cilën Zoti e ka sanksionua prej fillimit të ekzistencës së njeriut. "Zoti tha: Nuk është mirë që njeriu të jetë vet; që atij t'i krijojmë ndihmës të përshtatshëm për të…. Prej brinjve të marrur prej Ademit, Zoti krijoi Ademit gruan e tij..." (Agjërimi, 2, 18-24). Martesa e krishterë dallon nga martesat tjera:

a) natyra e monogamike e martesës në aspektin fizik dhe shpirtëror në mes dy personave.

b) shenjtëria e trupit- sepse trupi është "faltore s shpirtit të shenjtë. (l. Ko. 6, 19).
c) Mirëkuptimi paralel në mes bashkëshortëve.
d) ripërtëritja e jetës nëpër mes lindjes së fëmijëve.

Ringjallja: (nga greq. ανασταία των νεκρων, lat.resurrectio mortorum)**:** mësim kryesor i Kishës Ortodokse është ringjallja e Jezu Krishtit "në ditën e tretë sipas Biblës", me ringjalljen e Jezu Krishtit është vërtetuar feja e jonë në ringjalljen e të vdekurve dhe jetën e botës tjetër. Kjo doktrinë e fesë është përfshirë si simbol i fesë në Stamboll;; në vitin 381. Ringjallja është festa më e madhe e të krishterëve, sepse ajo është simbol i ngadhënjimit të jetës mbi vdekjen.

Lutje: lutje e përditshme në kishë. Shënim i fillimit të ditës së re sipas kalendari kishtar.

Lajmërim: shpallje, lajmërim. Falënderim i shkurt për Zotin, të cilin e bënë prifti me zë të lartë, që të gjithë të pranishmit ta dëgjojnë e jo sikur lutjet tjera, të cilat bëhen me zë të ulët.

Gjenealogjia: (nga greq. γενεαλοία, ονομα των γενων, lat. Genealogia, libër i gjeneratave apo brezave, rrënja e familjes). Terminologjia që tregon për rrënjën familjare të Jezu Krishtit. Në Dhiatën e Re dy gjenealogji për Jezu Krishtin, gjenealogjia sipas Mateiit (Mt.1.1-17) dhe gjenealogjia sipas Llukës (Lk.5.23-38). Të dy këto gjenealogji kanë për qëllim të tregojnë se Jezu Krishti sipas lindjes trupore i përket popullit hebre dhe është me prejardhje nga Davudi.

Mëkati: para prindor, (lat. Peccatum originatum): mënyra e ndërprerjes së bashkësisë së parë në mes Zotit e njeriut dhe pasojat e atij veprimi. Mëkati është kryer me vullnetin e lirë të njeriu të parë nëpërmes mashtrimit të djallit, por ai nuk është i afërm i tij. Mëkati nuk është princip ontologjik. Ai është rezultat i keqpërdorimit të lirisë së njeriut ndaj Zotit.

Dhuratat (dhuratat nderi): buka dhe vena të përgatitura për kungimin e shenjtë.

Dintisi: ose pështpëritja, dy pllaka të drunjta të kapura të lyera në brendi me dyllë të kuq. Më vonë në këtë mënyrë janë përgatitur librat prej pergamenti apo prej letre, në faqet e të cilave janë shkruar emrat e të gjallëve e të vdekurve, njerëzve që kanë shërbyer kishën.

Diskos: i rrumbullakët, pjatë e metaltë në të cilën vendoset ajo pjesë e bukës së bekuar, e cila do të jetë e ndriçuar për kungim.

Dogma: (nga greq. δόγμα - δόγματα rregull, mendim, vendim): mësimi i fesë i formuluar në Kuvende, në të cilat Kisha njihet me përmbajtjen e plotë të zhvillimit ortodoks të mësimit apostolik, të sjellur në mënyrë të shkruar apo sipas traditës gojore.

Doksologjija: (nga greq. δόξα, festë familjare, lat. gloria festim, shenjtrim, lavdi, zulmë, famë, nam): Forma e lavdisë për të treguar fuqinë dhe madhështinë e Krijuesit, nëpërmes lutjes, adhurimit, liturgjisë, bisedave dhe dialogëve fetare. Në realitet Ortodoksizmi potencon strukturën doksologjike të dogmës dhe idenë se Kisha dhe Faltorja janë vende për falënderimin e Zotit: "Duke qëndruar në faltore duke tu lutur Ty, na duket sikur ne në qiell qëndrojmë", (un.Is,1-3).

Shpirti i shenjtë: (nga greq. Πνεύμα Lat. Spiritus - Shpirti i Zotit; (Jn. 4,24; 2. Kop. 3.17; Veta e tretë e Trinisë s ë shenjtë, prej të cilit anëtari i tetë Simboli fesë thotë: "Besoj në Shpirtin e shenjtë, Krijuesin e jetës, që vjen nga Ati, i cili së bashku me Atin, të Birin, të cilët bashkërisht nderojnë dhe bashkërisht falënderojnë, i cili ka folur nëpërmes të dërguarve".

Xhakon: (nga greq. διάκονος - shërbëtor, shërbyes): shërbëtor i kishës në mënyrë direkte i lidhur me peshkopin. Xhakonët u ndihmoj-

në peshkopëve dhe priftërinjve, si në bartjen e viktimave eukaristie të falënderimit, si dhe në disa çështje administrative.

Eukaristija: (nga greq. εύχαριστία mirënjohje, falënderim)**:** Sekreti i shenjtë është themeluar nga vet Jezu Krishti, nëpërmes lutjes së falënderimit dhe me bekimin e bukës dhe venës. (Lk. 22, 19-20). Eukaristia është themeluar në darkën sekrete të fundit të Jezu Krishtit me apostujt. Kisha dhe Eukaristia janë dy të vërteta të pa ndara të, sepse lidhja e Dhiatës së Re është i vulosur me gjakun e Jezu Krishtit. Sekreti i shenjtë i eukaristisë është pika më e shndritshme e liturgjisë. Për teologjinë ortodokse, Eukaristia nuk është thjeshtë akt klerikal, por është kuvend qendror i tërë jetës kishtare.

Egzarh: prijës kishtar me kompetenca zëvendësit të patriarkut apo vikarit, si dhe të dërguarit të ipeshkvit.

Egzegeza: (nga greq. εζήγησις - komentim, shpjegim): metoda me anë të së cilës vendoset teksti biblik në kontekstin e tij historik dhe kulturor dhe i kupton porositë e tij teologjike duke pasur kujdes në integritetin dhe unitetin e zbulimit biblik. Metoda egzegeza nuk është e pavarur, sepse bibla nuk mund të komentohet pa kriter, por në kishë dhe kishërisht.

Energjia: e Zotit, e pa krijuar (nga greq. ενέργεια - veprim, vepër, punë): mësimi i mbi energjinë e pa krijuar të Zotit formon karakteristikën kryesore të Ortodoksizmit. Teologjia ortodokse kupton dhuntinë si energji dhe veprim të Zotit, personalisht dhe të pa krijuar, nëpërmes të së cilës njeriu bëhet “i kunguar i natyrës së Zotit” (2 Petr. 1,4), Shën Grigorije Palama (+ 1359) bënë dallime në mes: a) qenies apo esencës së Zotit dhe b) energjive të pa krijuara të Zotit. Energjitë nuk e krijojnë inostasin, nuk kanë inostasin e tyre vetjak deh nuk mund të ekzistojnë të pa varura. Energjitë bashkohen në një inostas deh manifestohen nëpërmes inostasit, por ato vet nuk janë inostas.

Eklizijarh: nënshtrimi i rregullave të manastirit. Prej detyrave kryesore të eklizijarhut është ruajtja e gjërave të shërbesave fetare, librave dhe gjërave tjera me vlerë në kishë. Ndihmësi quhet paraekzijarh. Në parullë ato njihen për ato shërbime ata njihen me emrin si kishtar.

Dioqezë: (nga greq. επαρχεία lat. Diacesa): territor kishtar administrativ nën juridiksionin e peshkopit. Dioqezat e para në Kishën Ortodokse Serbe i ka themeluar Shën Sava në vitin 1219.

Epikleza: (nga greq. επίκλησις lat. invocatio - thirrje për shugurim): një pjesë e kanonit të Eukaristisë, në të cilin komunitetit, me një lutje klerikale, i drejtohet Atit Zot, ta dërgoj Shpirtin e Shenjtë për ti shndërruar dhuratat në trupin dhe gjakun e Jezu Krishtit për t'i shuguruar besimtarët. Në liturgjinë ortodokse shugurimi i dhuratave bëhet me lutjen e thirrjes së Shpirtit të shenjtë, i cili vjen me një herë pas fjalës së institucionit të Eukaristisë.

Peshkopi: (nga greq. επίσκοπος lat. Episcopus - mbikëqyrës, kujdestar): shërbyes më i lartë në kirearkinë kishtare, i zgjedhur ta kryej detyrën e prijësit të parë të fesë në kuvendin e dioqezës, mësues i Ungjillit dhe koordinatorit të shërbimit të Kishës vendore. Shërbimi ipeshkvnor është qendror dhe i domosdoshëm në kishë, sepse pa ipeshkvi, kisha vendore nuk mund të pranohet si kishë. “aty ku gjendet ipeshkvi, aty do të ketë fe dhe popull”, thotë Shën Ignatije.

Epitrahil: uniformë të cilën në liturgji i veshin priftërinjtë dhe ipeshkvit. Pa këtë uniformë asnjë prift nuk mund ta kryejë liturgjinë apo ndonjë shërbesë fetare. Vendoset në qafë dhe vendoset në pjesën e përparme të trupit.

Es-hatologjia: (nga greq. εσχατον i fundit, vendimtari): mësimi mbi gjërat e fundit të shpëtimit, mbi vendosjen e sundimit të Zotit, apo jetës së amshueshme, si kurorëzimi i veprës së veprës së Jezu Kri-

shtit, që do të ndodh në përfundim të historisë, “Ai do të vijë me tërë namin e tij dhe do të sundoj të gjallët dhe të vdekurit” (Ef. 1,20-23); 1 Sol. 5,1-11).Es-hatologjia nuk duhet të ngatërrohet me “përfundimin (kataklizmin) e botës” - nuk duhet të kufizohet në të. Es-hatologjia ka të bëjë me rendin e ri të ekzistencës, mbi gjendjen e transformimit përfundimtar.

Biografi: libra të cilët përmbajnë jetëshkrimin e shenjtorëve të radhitur sipas muajve gjatë vitit.

Altar i sakrificës: pjesa e altari në të cilin ku kryhet proskomidia.

Ylli i vogël: dy traka të ngushta metali, të cilat bashkohen në maje, në atë mënyrë që mund të ndahen (si shkronja X). Vendoset në diskos nëpërmes një trupthi që përgatiten për kungimin e shenjtë. Simbolikisht ajo paraqet yllin që ishte lajmëruar në qiell dhe ka lajmërua lindjen e Jezu Krishtit.

Igumen: kujdestar i manastirit ortodoks. Igumeni në marrëveshje me vëllazërinë e manastirit vendos murgjit tjerë në shërbim. Detyra kryesore e igumenit është mësues shpirtëror i fesë dhe jetës në manastir.

Ikona: (nga greq. εικών fotografia, paraqitje, ikonë); figura e shenjtë, e cila paraqet Jezu Krishtin, familjen e shenjtë, apo shenjtorët të cilët mund t'i fotografojmë për shkak të trupit që ata kanë pasur. Si paraqitje pikture, ikona mund të ketë aspektin e saj historik, estetik, arkeologjik, por ajo i përket shërbesave fetare. Kishat bashkërisht me Shkrimin e shenjtë dhe sekretin e shenjtë. Ajo nuk është vetë art, por edhe shpjegim vizual i krijesës së paparë të Krijuesit, e cila manifestohet në kohë dhe hapësirë.

Ikonomia: (nga greq. οικονομία lat. Dispensatio- demonstroj, udhëheq, plan): plani i Zotit në vendosjen e fatit të njerëzve; kthimi në vullnetin e Zotit**,** i cili bazohet në dashurinë e Tij ndaj njeriut.

Ikonostasi: parmaku që ndan hyrjen e faltores nga pjesa më e ndritshme - oltari. Në ikonostas gjenden ikonat e radhitura në vende të caktuara. Në ikonostas gjenden tri dyer, dera e altarit: në veri, në mes dhe në jug.

Inostas: (nga greq. υποστασιο): në filozofinë jelenite inostasi ka pasur kuptimin e vërtetësisë së ekzistimit të njeriut. Ka pasur kuptimin e “Natyrës”, “esencës”. Më vonë në teologjinë ortodokse të krishterë vjen deri te barazimi i inostasit dhe “fytyrës personale”. Për ortodoksët uniteti Zotit, një Zot dhe mësimet ontologjike, apo “shkaku” me trininë e Zotit krijon inostasin, do të thotë personaliteti i Atit.

Isihazmi: (nga greq. ησυχία - heshtje, qetësi, rregullim i brendshëm): tradita asketike me prejardhje murgjish (shek IV-V), që është organizuar si lëvizje shpirtërore e vërtetë e rilindjes ortodokse, me futjen e lutjes së Jezu Krishtit, si metodë për krijimin e paqes së brendshme, ku shpirti dëgjon dhe i hapet Zotit. Lutja e Jezu Krishtit përbëhet prej këtyre fjalëve: “Zotëri i ynë Jezu Krisht, bir i Zotit, më mëshiro mua mëkatarin. Themelues i vërtetë i isahazmit është Jovan Lestiviqnik (+ 649), autor i “Gamës së Parajsit”, në të cilën propozon lutjen monologe. Isaihija krijon gjendej ku praktikohen vlerat prej të cilave më kryesore: pastrimi i zemrës, pendimi, në veçanti përmbajtja, durimi.

Dalja: (nga greq. εκπόρευσις lat. Processio - dalje): mënyra në të cilën Shpirti i shenjtë ka ekzistencën inostase prej Atit, parime unike dhe burimit e përbashkëta të Zotit.

Rrëfimi: (nga greq. μετάνοια lat. Panitentia - ndryshim shpirtëror, pendimi): Sekreti i shenjtë në të cilin besimtari me fuqinë e shpirtit të shenjtë dhe me lutjen e kishës pranon faljen mëkateve që ka bërë pas

pagëzimit, në mënyrë që ai t'i ripërtjië marrëdhëniet e tij me Zotin dhe të pajtohet me bashkësinë liturgjike anëtar i së cilës është. Sekreti i rrëfimit përbëhet prej katër elementeve: a) pendimit, b) rrëfimin e mëkateve, c) lutjes për falje, ç) pajtimi me bashkësinë, e cila manifestohet me rrëfimin sekret. Pendimi ka karakter dhe mundet kryhet pavarësisht nga rrëfimi.

Ungjill: (nga greq. ευαγγέλιον lat. *Evangjelium* - lajm i mirë): në Dhiatën e re nën Ungjill, kuptohet: lajm i mirë apo zbulimi i falënderimit të Zotit në figurën dhe veprimin e Shpëtuesit Jezu Krishtit, si mesazh apo përmbajtje e zbulimit të predikimit dhe mësimit të saj. Ajo paraqet lajmin e mirë të paqes dhe të dashurisë, të cilin Zoti e ka sjellur në tokë, për të gjithë njerëzit dhe të gjitha kohët. Kjo është thirrje që përfshin të gjithë pa farë dallimi: "…..qofshin ata grekë, apo barbar, burra, gra apo fëmijë, të gjithë janë të barabartë, të varfër dhe të pasur, të ditur dhe të paditur, duke përfshirë edhe robët".(Jevsevija Cezarian, Ungjilli, libri I,1.6). Prej fillimit kisha ka kuptuar nën Ungjillin ka kuptuar tërë traditën gojore apo predikimet e Jezu Krishtit. Me kalimin e kohës, termini ka filluar të marrë formën e saktë dhe të caktuar të asaj tradite gojore, do të thotë përmbledhjen e librave të Dhiatës së re. Ekzistojnë katër tekste paralele të Ungjillit, të ruajtur në gjuhën greke dhe secili përmban Ungjillin në tërësi, të paraqitur nga autorë të veçantë: Ungjilli sipas Mateit, Ungjilli sipas Markut, Ungjilli sipas Llukës dhe Ungjilli sipas Jovanit.

Jektenija: Lutje e shkurt gjatë liturgjisë, të cilën e udhëheq prifti apo xhakoni, kurse të pranishmit përgjigjen. Si për shembull: Prifti: "Që tërë kjo ditë të jetë e përkryer, e shenjt, e qet, dhe pa mëkate, prej Zotit lutemi". Të pranishmit: "Të lutemi o Zot", ekzistojnë lutje të mëdha dhe të vogla, në veçanti ato për të vdekurit.

Jeleosvegjenje: (nga greq. είχέλαιον, ευχή lutja dhe ελαιον-vaj, lat. unctio): njëra prej shtatë sekereteve të shenjta të Kishës ortodokse, të cilën nëpërmes thirrjes së Shpirtit të Shenjtë nga ana e priftit, i së-

muri fiton shërimin e shpirtit dhe faljen e mëkateve. Vendi ku flitet në mënyrë direkte për këtë sekret të shenjtë, gjendet në enciklikën e apostullit Jakov 5,14-15: "A është i sëmur dikush në mesin tuaj? Le t'i thërras priftit e kishave dhe le të luten për ta, duke i lyer me vaj në emër të Zotit…"

Hierarkia: (nga greq. ιερά + αρχή udhëheqje e shenjtë apo pushtet): përfshin shërbimet të vërtetuara sipas hierarkisë, të cilat i kanë pushtetin të udhëheqin në kishë. Thënë drejt hierarkia përfshin peshkopët, arqipeshkvët, patriarkët me një fjalë jerarkët.

Jeroxhakon: xhakon me gradë murgu.

hieromanh: murg që kryen të gjitha detyrat e priftit (Sekretet e shenjta).

Kallogjer: emër i njohur për murg në Lindje, sipas fjalës greke καλο-γεροσς - plak i mirë.

Kamillaf: emërtim i serbizuar për kapelë pa rreth, në formë cilindri, me të cilin në fillim kanë mbuluar kokën vetëm murgjit, kurse më vonë edhe priftërinjtë në tërësi.

Kanon: κανών - masë, rregull, ligj): ka shumë kuptime:

a) Kanoni i Librit të shenjtë, apo lista e librave të pranuar nga kisha që janë shkruar sipas inspirimit të Shpirtit të Shenjtë dhe përmbajnë zbulesën e Zotit. Kisha në bazë të radhitjes ka caktuar Kanonin e shkrimit: Kanoni i Dhiatës së Vjetër dhe Kanoni i Dhiatës së re.
b) Kanonet kishtare, rregullat, dispozitat sa i përket etikës së krishterë, liturgjive, disiplinës, murgjërisë, organizimit kishtar dhe jurisdikcionit, të cilat i kanë aprovuar kuvendet e peshkopëve apo të nivelit vendor. Në mënyrë të përgjithshme kanonet para-

qesin ligjet kishtare, të cilat formojnë lëndën e të drejtës kanonike.

c) i mëngjesit përbë disa këngë, të formuara në bazë të nëntë këngëve biblike, të cilat këndohen në pjesën e dytë të mëngjesit që përfshijnë psalmet: 148, 149. 150), kurse formimi i i tyre i përshkruhet Shën Andreut (shek.VII-VIII).

Katafatika: teologji pozitive që lejon definimin e Zotit me terminët: Shumë i urtë, I përjetshëm, Krijues,….Teologjia kataftike nuk është në kundërshtim me anofatiken, në të kundërtën, njëra tjetrën e plotëson.

Luga: luga e art apo e praruar me ar me kryq, me anë të së cilës në liturgji pagëzohen besimtarët.

Kondak: një këngë e shkurt liturgjike që i dedikohet festës apo shenjtorëve.

Heshta: përdoret në liturgji për nxjerrjen e agnesit dhe trupthave tjerë. Me hesht prehen trupthat gjatë kungatës.

Krmqija: përmbledhje të kaononeve kishtare. Të përkthyer nga gjuha greke, në fillim është quajtur Nomokanon. Prej shekullit trembëdhjetë në Rusi, lajmërohet temini tjetër - Kormqaja. Nokomanon apo Krmqija është përmbledhje e rregullave kishtare (kononeve) dhe të zakoneve civile (noma), të cilët kanë të bëjnë me kishën.

Festa e familjare: festë solemne familjare, me të cilën festohet mbrojtësi i shtëpisë, shenjtori i caktuar. Në atë ditë i dedikohen lutje mbrojtësit, të jetë përfaqësues para trinisë së shenjtë. Për festë familjare më e rëndësishme është të ketë qirinj, grurë dhe ëmbëlsirë të bekuar. Festa familjare është karakteristike e popullit serb.

Kryq: (nga greq. σταυρός lat. crux - kryq): njëri prej simboleve të para të krishtera që përfaqëson sekretin e fesë së krishterë, vuajtjen dhe vdekjen, nëpërmes kryqëzimit të Jezu Krishtit.

Pagëzimi: (nga greq. βάπτισμα, lat. *Baptiso,* baptismum - i nënshtruar): Pagëzimi është njëra prej sekreteve të shenjta, të cilën Shpëtuesi vet e ka themeluar (Mt. 28,18-19), kurse apostujt e kanë praktikuar (Vepra 2,38; 10,48), si një veprim për hyrje në historinë e shpëtimit (Mt. 3,11). Ceremonia e pagëzimit është ceremoni e hyrjes në fenë e krishterë. Ai përfshin:

përgatitje me agjërim.
Largimin dhe mohimin e njeriut të vjetër.
Shpalljen botërisht të besimit të vërtetë (simbolin e fesë).
Spërkatjen me ujë të bekuar të pagëzimit.
Thirrjen e trinisë së shenjtë si dhe
Sekret i shenjtë në të cilën i pagëzuari i ri pranon vulën e dhuratës së Shpirtit të shenjtë.

Pagëzimi i fëmijëve praktikohet edhe pse fëmijët nuk kanë mëkate personale dhe nuk mund ta shprehin besimin e tyre për shkak të papjekurisë së tyre. Ndalohet pagëzimi i dytë apo përsëritja e tij, mirëpo fëmijët mund të pagëzohen përsëri nëse nuk dihet se a janë pagëzuar apo jo.

Ktitor: themelues i manastirit si dhe personi në emër, të cilit themeluesi i bart të drejtat e veta. Më vonë ktitor është quajtur edhe çdo mirëmbajtës i manastirit. Ktitor quhen edhe ata që e ndihmojnë manastirin me ndihma vjetore të vazhdueshme apo me ndihma të konsiderueshme.

Litija: (nga lat. *processio*): vargan i besimtarëve rreth tempullit, vendbanimeve dhe fushave për ndonjë festë të caktuar, në krye me priftërinjtë. Atëherë, populli dhe priftërinjtë i luten Zotit për popullatën e atij vendit për të lashtat e tyre.

Liturgjia: (nga greq. λειτουρία lat.*miniserium*, officium - shërbim, shërbimi publik): në fjalorin bashkëkohor liturgjia ka një domethënie të ngushtë, ajo ka të bëjë me aktin e pagëzimit të sekretit të shenjtë. Në fillim koncepti ka pasur të bëjë me shërbesat fetare, të cilat kisha i ka kryer bashkërisht, publikisht në vendet e lutjeve. Liturgjia ortodokse ka një karakter të thellë kishtar. Liturgjia nuk është vetëm një akt emocional dhe estetik, ajo nuk është vetëm një aspekt ceremonial, që arrin kulmin në Eukaristi, por ajo është përjetësim përmbajtjesor dhe paraqitje simbolike e shpëtimi. Liturgjia përveç aspekteve tjera ajo ka dy pjesë kryesore: Liturgjia e shpalljes së të (papagëzuarve), të cilën e kryen pjesa misionare e liturgjisë si dhe liturgjia e besimtarëve apo kuvendi eukaristi, që është pjesa e shenjtë. Liturgjia e shenjtë kryhet për çdo javë dhe për çdo festë. Në manastire varësisht prej tipeve të tyre, liturgjia kryhet për çdo ditë.

Metania: mbështetja e madhe që kryhet para shenjtorëve të mëdhenj, ikonave, relikteve duke u kryquar.

Metoh: në fillim, me këtë është emërtuar toka bujqësor koloni e një manastiri, në të cilën kanë jetuar vetëm murgjit dhe janë marrë me punimin e tokës. Sot metoh quhet pasuria, që është larg manastirit, por që i është lënë manastirit testament.

Metohija: pjesë e një pasurie të kishës, e cila përfshin disa fshatra, deri në njëzet. Qendra e "metohisë" është metohi, që ka marrë emrin sipas shenjtorit, të cilit i është dedikuar kisha në metoh

Miro: vaji i shenjtë me të cilin miros prifti i një kishe (arqipeshkvi, patriarku) së bashku me peshkopët bëjnë lyerjen me vaj të bekuar të besimtarëve (krezmimin).

Minej: (ekzistojnë dymbëdhjetë): libra të shërbesave fetare, në të cilat në mënyrë kalendarike janë të cekura datat e shërbimeve të shenjtorëve për çdo muaj veçmas).

Krezmim: (nga greq. το μύρον χρισμα, lat. *Christomatio*): sekreti i shenjtë në shpërndarjen e dhuratave të Shpirtit të Shenjtë, i cili bëhet nëpërmes thirrjes së Shpirtit të Shenjtë dhe me mirosjen me vaj të shenjtë, me anë të cilit i pagëzuari vuloset si "prift" dhe "mbret" nga i tërë personeli kishtar. Pagëzimi dhe krezmimi formojnë një veprim të shenjtë të veçantë.

Mitra: pjesë e veshjes gjatë shërbesës fetare, mbahet në kokë. Trashëguar nga tradita e mbretërve bizantin.

Mitropolit: Ipeshkvi që është i vendosur në selinë e kryeqytetit të një krahine dhe ka respekt nderi në mesin e peshkopëve.

Monakizmi: (nga greq. μοναχός - i vetmuar, i veçuar): mënyrë e jetës ungjillore, dedikuar lutjes, i tërhequr krejtësisht nga jeta dhe vendosjes në shërbim të plotë të Atit shpirtëror. Gjatë historisë monakizmi është zhvilluar në dy forma: a) forma anahoretike, e cila është tërheqje dhe largimi i plotë nga bota dhe b) jeta në kuadër të bashkësisë së organizuar ose në manastir.

Relikte: trupi apo pjesë e trupit të ndonjë shenjtori, i cili ruhet si i shenjt. Eshtrat e shenjtë janë burimi i energjisë së Zotit. Në Kishën e vjetër në Sarajevë ruhet dora e shenjtores Tekla.

Nafora: bukë e bekuar që përgatitet për kohë të liturgjisë dhe u ndahet besimtarëve në fund të lutjeve.

Nalonj: tetranod ekspozohet para portës së pallatit, që në të vendoset Ungjilli me rastin e leximit në Liturgjinë e shenjtë. Nalonji ekspozohet edhe me rastin predikimit të priftërinjve, apo në të vendoset ikona.

Bylyzik: lidhje e mëngëve të duarve te prifti dhe xhakoni që para liturgjisë fetare të jenë më të shtrënguara.

Nurija: emërtimi i famullisë në disa pjesë të gadishullit Ballkanik.

Adhurim: (nga greq. θέοσις, lat. *Deficatio*): pjesëmarrja e besimtarëve në adhurimin e Zotit nëpërmes energjisë së Zotit.

Mishërim: (nga greq. ενανθρώηπσις, lat. *Incarnatio* - hyrja e zotit në trupin e njeriut): mësimi i fesë të cilën e ka aprovuar kuvendi i Nikejit, sipas së cilit pamja e dytë e Trinisë së Shenjtë, i biri i Zotit është mishëruar nga Shpirti i Shenjtë dhe Shemëria dhe është bë njeri. Mishërimi paraqet një sekret të madh të fesë së krishterë: "Zoti lajmërohet në trup" (1. Tim. 3.6).

Të shpallurit, katekistët: njerëzit që përgatiten për pagëzim. Kisha u lejon të marrin pjesë në pjesën e parë të Liturgjinë, liturgjisë së të shpallurve, që ka karakter misionar të mësimit të fesë.

Altar:pjesa më e shenjtë e faltores, i cili është i ndarë nga pjesa tjetër e faltores me ikonostas.

Omusios: (nga greq. ομοούσιος, lat. *Consubstantialiter*): termin teologjik jo biblik, i aprovuar në Kuvendin e Nikejit (325) për t'u definuar mishërimi i Logosit me të Atin në një qenie me të Birin (Logosit) Atin.

Orar: veshje liturgjike e gjatë prifti, të cilën xhakoni e veshe në krahun e majtë. Një anë bie nën shpinë, kurse anën tjetër të rrobës xhakoni e mban me tre gishtërinjtë e dorës së djathtë, duke u dhënë shenj ndihmësve kur duhet të fillojnë të këndojnë. Orarin bartin xhakonët gjatë shërbesave fetare, ashtu siç bartin priftërinjtë uniformën.

Zbulesa: (nga greq. αποκάλυψις lat. *Revelatio* nga revelo, revelare - zbuloj): veprim me të cilin Zoti e zbulon veten botës së krijuar. Mësimi mbi Zotin nuk duhet kuptuar vetëm si informim i mësimit, se-

pse Zoti zbulohet edhe nëpërmes veprave, ndodhive, shenjave dhe mrekullive.

Palamizmi: është emërtuar nga Shën Grigorie Palami (1296-1359), teologjia mbi energjinë e pa krijuar të Zotit, e cila rrjedh nga qenia e Zotit si një burim i pa shtershëm. Energjia ekziston që nga fillimi bashkërisht dhe e bashkuar me qenien e Zotit.

Pëshpëritje: lutja për të vdekurit që bëhet pas dyzet ditëve, gjysmë viti dhe në krye të vitit.

Famulli: territori më i vogël administrativ kishtar në Kishën Ortodokse, në të cilin shërben famullitari i famullisë.

Patrisitika, patologjia: shkenca që merret me historinë dhe përmbajtjen e etërve të kishës. Ky mësim është konciz është i pranuar nga e tërë kisha. Predikimi patristike ka karakterin e sintezës dogmatike, në të cilën kanë punuar: apostujt meshkuj, apologjetët, nxënësit, shkruesit e kishës dhe etërit. Në fjalimin e rëndomtë, periudha klasike e patristikës përfundon me Shën Jovan Damaskin (753), por kjo nuk do të thotë se shpirti patristik nuk ka vazhduar.

Patriarku: prijësi Kishës autoqefale ortodokse në nivel të patriarkanës, të cilin e zgjedh Sinodi i Shenjtë i Peshkopëve dhe në këtë post ai mbete tërë jetën. Kisha Ortodokse Serbe në nivel të Patriarakanës është që nga koha e Car Dushanit. 1346.

pesëdhjetat: (nga greq. πενηκοστή lat.*pentecoste* - pesëdhjeta, dita e pesëdhjetë): ndodhia dhe festa e zbritjes së Shpirtit të Shenjtë apostujve në ditën e pesëdhjetë pas ringjalljes së Krishtit. Kjo ngjarje është përmendur në Dhiatën e vjetër si profeci mesianike (Joil 3,1; Vepra an. 2,1-21). Vëretë, sipas Dhiatës së vjetër dita e pesëdhjetë është festuar si ditë e pranimit Ligjit në Sinaj.

Ortodoksizmi: (nga greq. ορθός + δοζα - festa (feja) e vërtetë): mësimi që vazhdimisht është i lidhur me predikimet e apostujve nëpërmes seminareve dhe neopatristike. Ortodoksiszi identifikohet me vet predikimet apostolike ashtu siç është vërtetuar dhe zhvilluar në pajtim me kuvendet kishtare.

Predikimi: (nga greq. παράδοσις lat. *Traditio* - traditë, predikim). Kisha ortodokse rëndësinë më të madhe i ka kushtuar predikimit në kuptimin e tij të dyfishtë, duke kuptuar si: veprim të plotë të Krishtit në kohë, do të thotë si urdhër apostolik dorëzuar kishës, mënyrën e transmetimit të zbulesës së Zotit nëpër kohë nëpërmes kishës. Predikimi nuk është burim tjetër i Zbulesës, pranë Shkrimit të shenjtë, por ai është normë e vazhdueshme, kriter dhe ndërmjetës. Shkrimi i shenjtë dhe predikimi i shenjtë përbëjnë një tërësi.

Prezviter: (nga greq. πρεσβύτερος lat. *Presbiter* - prift, kujdestar, plak): shërbyes i rangut të dytë të klerit. Priftëririnjtë - prezviterët në bashkësitë e krishtera janë të caktuar për barinj të Shpirtit të Shenjtë (vepra ap. 20,28. Ata kanë rolin baritor. Priftërinjtë shugurohen nga peshkopi. Prifti pranon antimisin nga peshkopi i vet, emri i të cilit përmendet në Liturgji. Prifti është prijës fetar, predikues dhe bari (1 Tim. 4,13), udhëheq besimtarët në besim në Krishtin.

Froni ikonave ikonat kryesore në ikonostas: ikona e Jezu Krishtit, Shemërisë, Shën Jovanit Pgëzues.

Kuvend: (nga greq. σύνοδος lat. *Concilium* - kuvend - sinod), që nga fillimi Kisha ka vepruar në mënyrë kuvendare dhe ky realitet është treguar i dobishëm për ekzistencën e kishës.

Literatura e konsultuar:

1. Fjalor serbokroatisht-shqip, (Grup autorësh), Instituti Albanologjik, botim i dytë, Prishtinë, 1986.
2. Jovan Brija, Recnik pravoslavne teologije, Beograd 1977.
3. Azbuka Srpske pravoslavne crkve po Radoslavu Grujic, priredio Slobodan Mileusnic, Beograd 1993.
4. Emilijan Carnic, Cin svestene i bozanstvene Liturgije svetog Jovana Zlatustog, prevod sa grckog jezika, Dizeldorf 1976.

GJUHËSI

Abdulkadir Inxhiq

PËRSE ËSHTË ME RËNDËSI MËSIMI I GJUHËS SË KUR'ANIT?

"Ne u kemi sjellë njerëzve në këtë Kur'an shembuj nga çdo lëmi e nevojshme, ashtu që ata të marrin përvojë (mësim), **duke qenë Kur'ani arabisht që nuk ka kundërthënie, me qëllim që të ruhen prej rrugës së gabuar."** (Ez-Zumer, 27-28.)

"Ha, Mim. Zbritje prej Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Libër që ajetet e tij janë të shkoqitura, duke qenë Kur'an arabisht për një popull që di ta kuptojë. Është përgëzues dhe qortues, por shumica e tyre ia kthyen shpinën, andaj ata nuk e dëgjojnë." (Fusilet, 1-4.)

Gjuha arabe është njëra ndër gjuhët më të njohura botërore. Bën pjesë në grupin e gjuhëve semite, e cila ka morfologji dhe sintaksë më të zhvilluar, po ashtu vokabular më të pasur. E flasin më shumë se dyqind milionë njerëz përfshirë botën arabe, kurse në një farë mënyre e shfrytëzojnë dhe e studiojnë myslimanët në gjithë botën. Sipas studimeve të George Webera (Language tuday), gjuha arabe është gjuha e pestë në botë sipas shtrirjes, e cila vjen pas gjuhës kineze, angleze, spanjolle dhe hindu-urdishte. Kombet e Bashkuara në vitin 1974 arabishten e kanë pranuar si njërën ndër gjashtë gjuhët zyrtare në botë. Qeveritë e njëzet vendeve e përdorin arabishten si gjuhë zyrtare dominante në shtetet e tyre. Gjatë Mesjetës, gjuha arabe ka qenë gjuhë kryesore e kulturës dhe shkencës, e që ka rezultuar me shumë arabizma në nomenklaturën e gjuhëve evropiane në lëmin e filozofisë, astronomisë, astrologjisë, matematikës, algjebrës, medicinës dhe shkencave të tjera. Do t'i përmendim disa nga shkencëtarët më të shquar arabo-islam: Ibn Sina (në Perëndim i njohur si Avicenna) ka qenë "doktor i gjithë doktorëve". Xhabir ibn Haiyan (Geber) themelues dhe "babai i kimisë"; Ibn Rushdi (Averroes) llogaritet si njëri ndër bartësit e mendimeve islame, si edhe filozofisë dhe teologjisë euro-perëndimore; Ebu Merwan ibn Zuhr (Avenzoar) matematikani i njohur arab; Abdullah ibn Ahmed ibn el-Baitar mjeku dhe farmacisti më i shquar i Spanjës islame të Mesjetës. Kush i pari shpiku eksperimentet lidhur me astronominë? Shumica e njerëzve do të thonë: Galileo, Ptolemy ose ndonjë tjetër shkencëtar. Përgjigjja e vërtetë është se ata kanë qenë shkencëtarët islam Muhammed ibn Ahmed El-Biruni dhe Ahmed ibn Muhammed ibn Kesir El-Ferghani. Gjuha arabe, gjithashtu, paraqet edhe një ndër gjuhët më të rëndësishme në shumë vende të tjera të botës. Është me rëndësi të shënohet që gjykim të plot mbi ndodhitë dhe rastet politike të cilat mbizotërojnë në Lindjen e Mesme: Palestinë, Irak, Liban etj., mund të kenë në radhë të para ata që hulumtojnë gjuhën arabe, kulturën dhe traditën. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet deri te e vërteta të cilën mediat monolinguale rrallë u ofrojnë teleshikuesve të tyre mbi vuajtjet e viktimave të pafajshme arabe.

Pse Kur'ani është i zbritur në arabisht?

Përgjigjen në këtë pyetje do ta gjejmë në ajetet vijuese në të cilat Allahu, xh.sh., thotë:

***"Ne e bëmë atë** (Kur'anin) **të lehtë me gjuhën tënde vetëm që me të t'i përgëzosh të devotshmit, dhe me të t'i tërheqësh vërejtjen një populli që është kryeneç."** (Merjem, 97.)*

***"Elif, Lam, Ra. Këto** (ajete që t'u zbritën) **janë ajetet e librit të qartë. Ne e zbritëm atë Kur'an arabisht, ashtu që ta kuptoni."** (Jusuf, 1-2.)* Në komentimin e këtij ajeti në tefsirin e tij Ibn Kethiri shë-

non: “Sepse, gjuha arabe është gjuha më elokuente, më e gjerë dhe më e qartë, e që me të më mirë tregohen kuptimet të cilat fshihen në shpirtrat e njerëzve. Për atë Libri më i ndershëm është shpallur në gjuhën më të ndershme, të Dërguarit më të ndershëm, nëpërmjet melaqes më të ndershme në vendin më të ndershëm të botës. Zbritja e tij ka filluar në muajin më të ndershëm të vitit - në ramazan dhe në çdo pikëpamje është i kompletuar.

“Kështu Ne e shpallëm këtë Kur’an arabisht dhe përsëritëm në të vërejtjet, në mënyrë që ata të ruhen ose ai *(Kur’ani)* ***t’u sjellë atyre përvojë mësimi.”*** *(Ta Ha, 113.)*

“Prandaj, Ne të shpallëm ty Kur’anin arabisht që ta këshillosh kryefshatin *(Meken)* ***dhe ata përreth saj, dhe t’u tërheqësh vërejtjen për ditën e tubimit*** *(kiametit),* ***për të cilën nuk ka dyshim. Një grup për në xhennet, kurse një grup për në zjarr.”*** *(Esh-Shura, 7.)*

A do të flasin arabisht banorët e Xhennetit?

Duhet pohuar që as në Kur’an e as në hadithet autentike nuk përmendet gjuha me të cilën do të komunikojnë banorët e Xhenetit. Ajo që përmendet janë disa transmetime (athar) ndër të cilat është edhe ky që e transmeton Et-Taberani në (El-Evsat), El-Hakimi, El-Bejheki në (Shu’abu-l-imanu) dhe të tjerë që Ibn Abbasi, r.a., ka thënë: “I Dërguari i Allahut, s.a.v.s., ka thënë: Doni arabët për tri arsye: për arsye se unë jam arab, për arsye se Kur’ani është shpallur në gjuhën arabe dhe për atë që gjuha arabe është gjuhë e banorëve të Xhennetit.”

Ibn Xhevziu për këtë hadith thotë që është apokrif. Edh-Dhehebiu thotë: “Jam i mendimit që ky hadith është i shpikur (mawdu).” Gjithashtu, El-Albani në veprën e tij (Es-Silsileh ed-da‘ifeh) thekson që hadithi është i shpikur. Nga këto shembuj tregohet qartë që nuk ekziston argument autentik (sahih) për atë se me çfarë gjuhe do të flitet në Xhennet. Për atë shkak rekomandohet përmbajtja nga polemika, e që në vend të këtyre çështjeve të orientohemi në gjërat të cilat do të na sjellin mirësi në këtë botë. Shejh-l-islami Ibn Tejmijje, rahimehullah, është pyetur: “Në cilën gjuhë Allahu xh.sh., do t’ju flas njerëzve në

Ditën e Gjykimit? A do t’ju flas me gjuhën e arabëve? A është e vërtetë që gjuha e banorëve të Xhehennemit do të jetë persishtja, ndërsa gjuha e banorëve të Xhennetit gjuha arabe?” Ibn Tejmijje është përgjigjur: “I lavdëruar qoftë Allahu, xh.sh., Zoti i gjithë botëve. Nuk është e njohur se me cilën gjuhë do të komunikojnë njerëzit në Ditën e Gjykimit, ose më cilën gjuhë do t’i dëgjojnë (kuptojnë) fjalët e Allahut, i Lartësuar qoftë Ai. Për të nuk ka lajmëruar Allahu, xh.sh., as i Dërguari i Tij, s.a.v.s. Nuk është e vërtetë që gjuha e banorëve të Xhehenemit do të jetë persishtja, as që arabishtja do të jetë gjuhë e xhennetlinjve. Nga fjalimet e as’habëve nuk na është e njohur (Allahu qoftë i kënaqur me ta) diç që do të orientonte në të, sepse me dëshirë u janë përmbajtur fjalimeve mbi ato çështje duke menduar se çështjet e tilla dhe të ngjashme dhe diskutimet janë të panevojshme. Lidhur me këtë çështje ndërmjet dijetarëve të vonshëm kanë ekzistuar mospajtime. Disa prej tyre kanë përfaqësuar mendimin ashtu që gjuha e xhennetlinjve do të jetë arabishtja, ndërsa gjuha e xhehennemlinjve do të jetë persishtja. Ndërkaq, të tjerët, theksojnë që gjuha me të cilën njerëzit do të komunikojnë në botën tjetër do të jetë gjuha para-arabe, do të thotë, paragjuha e gjithë gjuhëve tjera me të cilën ka folur Ademi, a.s. Për mendimet e theksuara nuk ka bazë as argument, qoftë kjo në bazë të mençurisë apo të ndonjë teksti dhe lajmërimi. Allahu e din më së miri dhe Ai është më i Dituri. (Mexhmu’-l-fetava, 4/299)

Ndikimi i arabishtes në gjuhë të tjera

Si gjuhë e njërit prej religjioneve më të mëdha në botë dhe gjuhë zyrtare e shumë shteteve dhe dinastive të cilat sunduan në të kaluarën, gjuha arabe la gjurmë edhe në gjuhë të tjera të botës. Gjuha arabe (njëra ndër 6912 gjuhëve të cilat sot ekzistojnë në botë) është bërë, jo vetëm si gjuhë fetare e të gjithë myslimanëve, por edhe bartëse e kulturës islame dhe civilizimit në përgjithësi. Është e padiskutueshme se ndikimi i saj është shtrirë si në gjuhët e popujve myslimanë ashtu edhe te shumë të tjerë përgjatë Azisë, Afrikës dhe Evropës. Ndikimi i saj është shtrirë edhe në gjuhën tonë me ardhjen e turqve, të cilët me

islamin sollën edhe gjuhën arabe. Turqizma të shumtë që i shfrytëzojmë në gjuhën tonë, në realitet janë arabizma, të cilat i shfrytëzojmë në jetën tonë të përditshme. Kështu p.sh., fjalët: haxhar, sokak, kenifa... etj., kanë rrënjë arabe. Nuk duhet habitur me faktin që gjuha arabe ka ndikuar shumë edhe në gjuhën angleze (gjuhë e kohës bashkëkohore). P.sh., në SHBA gjuha arabe, pas gjuhës simbolike amerikane shënon rritjen më të madhe nga gjithë gjuhët tjera. Do t'i përmendim disa shembuj të fjalëve angleze me prejardhje arabe: admiral prej ameeral (komandant); algebra prej al-xhebr (shkenca e algjebrës); almanac prej al-manaakh (kohë, kalendar); amber prej anber ((Jantar) qelibar i verdhë, majordomus, administrator); camel prej xhemel (deve); carat prej qiraat (matës për flori); cotton prej qutn (pambuk); gazelle prej ghazaal (gazelë)… etj. (shih: Al-Mawrid). Gjithashtu, gjuha arabe ka lënë gjurmë edhe në gjuhën spanjolle të cilën e shohim nga shembujt vijues: alcazar prej el-qasr (kështjellë, saraj); acebibe prej ar. zebibe (rrush i thatë); aceituna prej az-zeitun (ulli); adalid prej dalil (udhëheqës); adarme prej dirhem (matje); alacenah prej hizanah (vitrinë); loco prej lowqa (marrëzi, budallallëk)… etj. (Shih: Ndikimi i arabishtes në gjuhë të tjera, The Free Dictionary).

Nga boshnjakishtja:
Mehas Alija

Abdulkadir Inxhiq

WHY IS IT IMPORTANT TO LEARN THE LANGUAGE OF THE QUR'AN?
(Summary)

We have put forth for men, in this Qur'an every kind of Parable, in order that they may receive admonition. (It is) a Qur'an in Arabic, without any crookedness (therein): in order that they may guard against Evil (Az-Zumar, 27-28).

Ha Mim: A Revelation from (Allah), Most Gracious, Most Merciful; A Book, whereof the verses are explained in detail; a Qur'an in Arabic, for people who understand; Giving good news and admonition: yet most of them turn away, and so they hear not (Fussilat, 1-4).

Arabic is a Semitic language. It has a highly developed morphology and syntax. It has a very rich vocabulary. It is spoken by more than 200 million people throughout the Arab world. It is used and studied by Muslims throughout the world. According to George Weber (Language Today), Arabic is among the most widely spoken languages in the world (Chinese, English, Spanish, Hindi/Urdu, Arabic). In 1974, Arabic was added as one of the official languages of the UN.

عبد القادر إنجيش

لماذا يجب تعلم لغة القرآن الكريم؟

(خلاصة البحث)

وَلَقَدْ ضَرَبْنَا لِلنَّاسِ فِي هَذَا الْقُرْآنِ مِنْ كُلِّ مَثَلٍ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ.
قُرْآنًا عَرَبِيًّا غَيْرَ ذِي عِوَجٍ لَعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ (الزمر: 27–28)
حم. تَنْزِيلٌ مِنَ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ.
كِتَابٌ فُصِّلَتْ آيَاتُهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ.
بَشِيرًا وَنَذِيرًا فَأَعْرَضَ أَكْثَرُهُمْ فَهُم لا يسمَعُونَ. (فصلت: 1–4)

تعتبر اللغة العربية أحدى أشهر اللغات العالمية و هي تنتمى إلى مجموعة اللقات السامية و التي تعتبر غنية بالمفردات و كذلك بالقواعد الصرفية و النحوية. يتحدث بها أكثر من 200 مليون إنسان في العالم العربي و يستخدمها المسلمون في كل انحاء العالم. و حسب الدراسة التي تمت من قبل "حورج فبيير" تعتبر اللغة العربية اللغة الخامسة أكثر انشارا و التي تأتى بعد اللغة الصنية و الانجليزية و الاسبانية و الهندو–الاردية. و قد دخلت اللغة العربية سنة 1974 كاحدى اللغات الست في هيئة لأمم المتحدة.

ESE

Tajib Salih *(Sudan)*

KOHA E SHPËRNGULJES NË VERI - (3)

-3-

Ishte një natë e zjarrtë prej netëve të korrikut. Nili atë vit kishte pësuar një vërshim të madh, që zakonisht ndodh një herë në njëzet apo tridhjetë vjet dhe bëhet legjendë për të cilën u tregojnë baballarët bijve të tyre. Uji kishte përmbytur pothuajse tërë sipërfaqen e tokës që shtrihej në mes brigjeve të lumit dhe anës së shkretëtirës, ku janë të vendosura shtëpitë. Arat kishin mbetur si ujdhesa në mes të ujit. Burrat endeshin në mes shtëpive dhe arave në barka të vogla, apo duke notuar. Mustafa Seidi, aq sa di unë, dinte të notonte. Më pati treguar babai im, në atë kohë, kur unë isha në Hartum, se ata kishin dëgjuar pas namazit të jacisë britmën e disa grave në lagje. Ishin nisur në drejtim të burimit të britmës dhe vërejtën se burimi ishte në shtëpinë e Mustafa Seidit. Kishte bërë traditë që ai të kthehej prej arës me perëndimin e diellit, mirëpo, gruaja e tij e kishte pritur kot. Kishte shkuar për të pyetur për të në çdo vend. I kishin thënë se e kanë parë në arë e disa tjerë kishin thënë se ata kanë menduar se ai është kthyer në shtëpi me burrat tjerë. I tërë fshati kishin shkuar në breg të lumit. Të gjithë burrat kishin marrë me vete fenerët e disa të tjerë edhe në barka. Tërë natën e kaluan duke kërkuar, por pa farë dobie. Kishin lajmëruar me

anë të telefonit edhe stacionin e policisë në tërë gjatësinë e bregut të Nilit deri në Kerme. Por, në kufomat që kishin bartur atë javë valët e lumit nuk ishte në mesin e tyre kufoma e Mustafa Seidit. Më në fund, ata kishin krijuar bindjen se ai me siguri ishte mbytur në ujë dhe se kufoma e tij mund të ketë përfunduar në barkun e ndonjë krokodili, të cilët janë të shumtë në ujërat e asaj ane.

Kurse mua më preokupon ajo ndjenjë që kisha përfituar natën kur e dëgjova rastësisht e që nuk isha i përgatitur, duke lexuar poezi angleze, kur ai mbante në dorën e tij një gotë rakie, ulur në kolltuk, kishte shtrirë këmbët, kurse drita e llambës po shndriste fytyrën e tij, kurse sytë e tij ishin të thelluar ashtu si m'u duk mua në horizonte në brendinë e shpirtit të tij. Errësira rreth nesh, që po mbretëronte jashtë dukej sikur të ishte fuqi djallëzore sikur donte ta ngulfate dritën e llambës. Nganjëherë më paraqitej befasisht ajo ide shqetësuese se Mustafa Seidi nuk ka ekzistuar fare dhe se ai në realitet ishte një gënjeshtër, një hije, një apo ëndërr, apo një ankth që u është paraqitur banorëve të fshatit, një natë të errët, të nxehtë, kur ata i hapën sytë e tyre me lindjen e diellit nuk e panë.

Kishte mbetur vetëm edhe një pjesë e natës kur u çova dhe dola nga Mustaf Seidi. Unë ndieja se isha lodhur shumë, ndoshta për shkak të ndejës së gjatë, megjithatë nuk dëshiroja të fli. Andaj, vazhdova të shëtis nëpër rrugicat e ngushta dhe të shtrembëta të fshatit, fytyrën time e përshkonte një erë e ftohtë e natës që frynte nga veriu, që sillte vesën, sillte aromën e këndshme të luleve si dhe erën e bajgave, si dhe aromën e tokës, e cila posa ishte ujitur me ujë pas një thatësie të gjatë, si dhe erën e kallinjve të misrit, që ishin në gjysmën e pjekjes së tyre si dhe aromën e drunjve të limonit. Fshati si zakonisht ishte i heshtur në ato orë të mbrëmjes, përveç të ndonjë zhurme të ndonjë motori të ujitjes në breg të lumit apo të lehurave të ndonjë qeni prej kohe në kohë, apo zëri të ndonjë gjeli të vetmuar, i cili mund ta ketë paralajmëruar agimin para kohe, të cilit i kundërvihet zëri i një gjeli tjetër. Pastaj, prapë mbretëron qetësia. Kalova pranë shtëpisë së vogël të birit të kryetarit të fshatit në udhëkryqin e rrugës dhe pashë brenda një dritë të dobët. Ndjeva veten të turpëruar, sepse unë pashë diçka që nuk ki-

sha të drejtë ta shihja. Nuk kisha të drejtë që në atë kohë të vonë të natës të isha zgjuar dhe të sorollatesha rrugëve të fshatit, kurse pjesa tjetër e fshatarëve të flenë me familjet e tyre. Unë njoh çdo rrugë dhe çdo shtëpi të këtij fshati. Po ashtu njoh edhe dhjetë kupolat në mes të varrezave në skaj të shkretëtirës mbi fshat. Po ashtu i njoh varret një nga një. I kam vizituar me babanë tim, i kam vizituar me nënën time dhe gjyshin tim. I njoh po ashtu banuesit e varrezave, të cilët kanë vdekur para se të lindej babai im, si dhe ata që kanë vdekur pasi që kam lindur unë. I kam varrosur së bashku me të tjerët së paku njëqind prej tyre. Kam marrë pjesë në hapjen e varrit dhe qëndroja skaj varrit në mesin e njerëzve, derisa vendoseshin gurët në varr dhe mbulohej varri me dhe. Veproja kështu me banorët e fshatit në mëngjes, në kulmin e vapës gjatë muajve të verës si dhe gjatë natës e në duart tona mbanim qirinj. Po ashtu i dijë edhe arat prej kohëve kur ato ishin të papunuara (banakiere), në kohën kur mbizotëronte thatësia dhe njerëzit i braktisnin dhe toka pjellore kthehej në shkretëtirë. Pastaj erdhën motorët për ujitjen e tokës si dhe shoqatat për bashkëpunim dhe u kthyen njerëzit që kishin braktisur vendin dhe toka u kthye ashtu siç ishte më parë prodhon misrin në stinën e verës e grurin në stinën e dimrit. Tërë këtë e kam parë prej momentit të lindjes sime. Por, asnjëherë nuk e kam parë fshatin në këto kohë të vona të natës. Patjetër ai yll i madh i kaltër që po shndriste ishte ylli i mëngjesit. Qielli duket më afër tokës në këtë kohë, para mëngjesit. Fshatin e mbulon një dritë e zbehtë që e bën të duket sikur ajo është e lidhur në mes qiellit dhe tokës. M'u kujtua dhe unë kaloja rrugicën e rërës, e cila ndan shtëpinë e kryetarit të fshatit dhe shtëpinë e gjyshit tim, atë pamje që kishte vizatuar Mustafa Seidi, e kujtova me të njëjtën ndjenjë turpi ashtu sikur më kaploi kur e dëgjova britmën e djalit të kryetarit të fshatit me gruan e tij. Dy kofshë të bardha të hapura.

Arrita te shtëpia e gjyshit tim dhe dëgjova duke lexuar lutjet e tij të zakonshme si parapërgatitje për namazin e sabahut. Ai nuk fle asnjëherë? Zëri i gjyshit tim arrin gjithkund. Ai është zëri i parë që dëgjoj para se të flejë dhe është zëri i parë kur zgjohem. Ai vepron në këtë mënyrë që sa e sa vite, sikur ai të jetë diçka statike në mesin e

botës që lëviz. Papritmas ndjeva se shpirti im po më dridhej ashtu siç ndodh zakonisht pas një lodhjeje të gjatë dhe meditimi të pastër, u avulluan mendimet e këqija, të cilat m'i kishte nxitur ndodhia e Mustafa Seidit. Fshati tani nuk është i lidhur në mes qiellit dhe tokës, ajo është stabile, shtëpitë janë stabile? Pemët janë pemë, qielli është i kthjellët, por ai është tepër larg. A ka mundur të më ndodhë mua ajo që i ka ndodhur Mustafa Seidit? Ai tha se është gënjeshtër? A mund të jem edhe unë gënjeshtër? Unë jam prej këtij vendi. A nuk është kjo një e vërtetë e mjaftueshme? Kam jetuar me ata, por unë kam jetuar me ata sipërfaqësisht. Nuk i dua e as nuk i urrej. I shtrija brinjët e mi në këtë fshat të vogël, të cilin e shikoja me imagjinatën time kudo që kthehem. Nganjëherë gjatë muajve të verës në Londër, pas rënies së shiut, sikur ndjeja aromën e tij. Në disa raste të shpejta para perëndimit të diellit më kujtohej ai. Në përfundimin e natës, zërat e njerëzve të huaj që arrinin në veshët e mi më dukeshin si të ishin zërat e të afërmve të mi. Unë, patjetër, se dukesha sikur të isha prej atyre shpezëve, të cilat nuk jetojnë vetëm në një vend të kësaj bote. Është e vërtetë se unë kam studiuar poezinë, por kjo nuk do të thotë asgjë. Ka qenë e mundur që unë të studioj inxhinierinë, mjekësinë apo bujqësinë. Të gjitha këto janë mjete për fitimin e kafshatës së gojës. Fytyrat atje i imagjinoja ngjyrë gruri, apo të zeza dhe më dukeshin si të ishin fytyra të njerëzve që po i njihesha. Atje sikur edhe këtu, nuk është më mirë apo më keq. Por, unë jam prej këtu, ashtu sikur bleta që qëndron në oborrin e shtëpisë sonë, është rritur në shtëpinë tonë e jo në ndonjë shtëpi tjetër. Çështja përse ato kanë ardhur në shtëpinë tonë këtë nuk e di si ta shpjegoj. A do të thotë kjo se ne duhet ta helmojmë të tashmen dhe të ardhmen tonë, ata do ta lëshojnë vendin tanë herët a vonë, ashtu siç kanë vepruar edhe shumë popuj tjerë gjatë historisë nga vende të ndryshme. Hekurudhat, anijet, spitalet, fabrikat, shkollat do të na mbeten neve. Do ta flasim gjuhën e tyre pa ndonjë ndjenjë faji apo ndjenje bamirësie. Do të jemi ashtu si gjithnjë, popull i zakonshëm. Nëse gënjejmë, me të e mashtrojmë vetveten.

Këto lloj mendimesh m'u sollën mua në shtratin tim. Më përcolli mua deri në Hartum ku u punësova në drejtorinë e arsimit. Mustafa

Seidi kishte vdekur para dy vjetëve, por unë takohem me të prej momenti në moment. Jetova njëzet e pesë vjet dhe unë nuk kisha dëgjuar e as nuk e kisha parë atë. Pastaj, rastësisht takohem me të në një vend ku ai nuk e kishte vendin. Mustafa Seidi, përkundër vullnetit tim, është pjesë e botës sime, ide në mendjen time, hije që nuk do ta lëshojë rrugën e vet. Dhe ja një ndjenjë e thellë e frikës, se është e mundur që të mos jetë modestia çdo send. Mustafa Seidi më pati thënë se gjyshi im e di sekretin. Pema rritet me modesti dhe gjyshi yt jetoi dhe do të vdesë me modesti. Kështu. Mirëpo, ai tallej prej modestisë sime? Në udhëtimin tim prej Hartumit deri në Ubejd ishte në kabinën time një nëpunës në pension. Kur u nis treni prej Kostit, biseda jonë kishte arritur te ditët e studimeve të tij. Prej tij kuptova se disa nga përgjegjësit e mi në Ministrinë e Arsimit ishin bashkëkohësit e tij të studimeve, e disa prej tyre ishin shokët e klasës së tij. Bashkëbiseduesi im vazhdoi të më tregoj se filani në Ministrinë e Bujqësisë ka qenë shok i tij, filan inxhinieri ka qenë në klasën para tij, filan tregtari që ka përfituar gjatë luftës, ka qenë prej krijesave më të marra prej krijesave të Zotit, ishte në të njëjtën klasë. Kirurgu më i njohur filani ka qenë alo i djathtë më i mirë në shkollën në kohën e tij.

Rastësisht vërejta se fytyra e tij po shndriste, sytë e tij po xixëllonin, m'u drejtua me një zë fantastik e plotë emocione: "Për çudi. Unë e paskam harruar pa e përmendur nxënësin më të zgjuar në klasën tonë, nuk më është kujtuar prej kohës kur e ka braktisur shkollën. Vetëm tani m'u kujtua. Po, Mustafa Seidin".

Përsëri, ajo ndjenjë se gjërat e thjeshta para syve tu bëhen jo të rëndomta. Pashë se dritarja e kabinës dhe dera e saj bashkoheshin, m'u duk sikur drita po reflektohej në syzat e njeriut, në një shpejtësi që nuk zgjat më shumë se një lëvizje të syrit, shndriste sikur të ishte ora katër pasdite. Bota, në ato momente dukej krejtësisht tjetër për oficerin në pension, sepse një përvojë e gjatë që ishte jashtë kujtesës së tij u kthye në veprim. Kur e pash fytyrën e tij për herë të parë m'u duk sikur ai të jetë në mesin e të gjashtëdhjetave të jetës së tij, kurse tani kur e shoh duke i kujtuar kujtimet e tij të largëta, më duket sikur të

jetë burrë që nuk mund të ketë më shumë se dyzet vjet asnjë ditë më tepër.

"Po, Mustafa Seidi ishte nxënësi më i zgjuar në shkollë në ditët tona. Ishim në të njëjtën klasë. Ulej në rreshtin para neve, në anën e majtë. Ja çfarë çudie, si nuk më është kujtuar deri më tash, edhe pse ai ishte një mrekulli e vërtetë në atë kohë? Ishte studenti më i njohur në Kolegjin e Gordonit. Lojtari më i njohur në ekipin e futbollit, kryetar i konviktit, oratori më i mirë i netëve letrare, autori më i mirë i gazetës së murit dhe aktori më i mirë i sektorit të dramës. Me gjitha këto aktivitete, ai ishte i tërhequr, mendjelartë, kohën e lirë e kalonte në vetmi, ose duke lexuar apo duke ecur në distanca të largëta. Të gjithë jetonim në konvikt në atë kohë në kolegjin e Gordonit, duke përfshirë edhe bijtë e treshes së kryeqytetit. Ishte gjeni në çdo send, nuk kishte asgjë, që nuk mund ta përvetësonte mendja e tij e habitshme. Mësuesit neve na flitnin me një gjuhë e atij i flisnin me një gjuhë tjetër. Në veçanti mësuesit e gjuhës angleze. Sikur ata i jepnin atij mësime të veçanta jo sikur nxënësve tjerë."

Njeriu heshti për një çast, ndjeva një dëshirë të fuqishme t'i tregoj se unë e njihja Mustafa Seidin dhe se kushtet e jetës më kishin njoftuar me të dhe se ai, një natë të errët e me vapë më kishte treguar për jetën e tij dhe se ai kishte kaluar ditët e fundit të jetës së tij në një fshat anonim në brigjet e lumit Nil, dhe se ai kishte vdekur i fundosur në ujë apo kishte bërë vetëvrasje dhe mua më kishte lënë testamentin për dy bijtë e tij. Por, unë nuk thash asgjë, derisa oficeri në pension vazhdoi tregimin e tij:

Mustafa Seidi kreu shkollimin e tij në Sudan, duke kaluar disa klasë, kurse ne mbetëm pas tij në kolegjin e Gordonit. Ai shkoi në shkollim në Kajro e pastaj në Londër. Ishte sudanezi i parë që dërgohej në shkollim jashtë vendit. Ishte i biri i anglezëve i përkëdhelur dhe të gjithë ne ia kishim zili dhe paramendonim se ai do të ketë një perspektivë të shndritshme. Ne shqiptonim fjalët angleze sikur ato të ishin arabe. Nuk mundnim të shqiptonim dy shkronja pa zanore. Kurse Mustafa Seidit i lakohej goja, zgjateshin buzët e tij dhe prej gojës së tij dilnin fjalët, ashtu siç dalin prej gojës së bijve të saj. E tërë kjo na bë-

nte neve të habitemi dhe të zemërohemi në të njëjtën kohë. Kështu, që nga zilia dhe habia e quanim “anglezi i zi”. Në kohën tonë anglishtja ishte çelësi i së ardhmes - askush nuk mund të prosperonte pa e njohur atë. Kolegji i Gordonit ishte shkollë fillore. Në të merreshin vetëm ato njohuri sa për t’i plotësuar nevojat elementare për shërbimet shtetërore të vogla- posa përfundova u punësova si arkëtar në qendrën e El-Fashir. Pas një përpjekjeje të madhe pranuan t'i nënshtrohem provimit të administratës. Kalova tridhjetë vjet zëvendës i oficerit. Paramendo. Vetëm dy vjet para se të shkoja në pension u gradova në rangun e oficerit. Inspektori i qendrës ishte anglez. Ai konsiderohej si zot. Qeveriste një sipërfaqe më të madhe se ujdhesat e Britanisë. Banonte në një pallat të madh e të gjerë, përplot shërbëtorë dhe të rrethuar me ushtarë. Silleshin ndaj neve sikur të ishin zota. Na detyronin, neve, nëpunësve të vegjël, bijve të këtij vendi të tubonim tatimet. Njerëzit hidhëroheshin prej neve dhe shkonin të ankoheshin tek inspektori anglez. Inspektori anglez, natyrisht, ishte ai që falte dhe mëshironte. Kështu kishin mbjellë te populli urrejtjen ndaj neve, bijë të vendit dhe dashurinë dhe respektin ndaj kolonëve të ardhur nga jashtë. Beso në këto fjalë të mia o biri im. A nuk është pavarësuar vendi ynë tani? A nuk jemi të lirë në vendin tonë tani? Je i sigurt se ata kanë lënë pas vetes njerëzit më të ulët. Njerëzit më të ulët janë ata, të cilët ishin në pozita kyçe gjatë sundimit të anglezëve. Ishim më se të sigurt se Mustafa Seidi do të ketë një perspektivë të madhe, babai i tij ishte prej El-Abajidve, fisit që jeton në mes Sudanit dhe Egjiptit. Ata ishin që kishin fshehur sulltanët e Pashës nga familja e halifes Abdullah e Et-Ta’ajushi, pastaj ishin në radhët e para të ushtrisë së Kishnerit kur e ripushtoi Sudanin. Thuhej se nëna e tij ishte robëreshë nga Jugu. Nga fisi Ezandi apo El-Barija, vetëm një Zot e di. Njerëzit, të cilët janë pa identitet, janë ata, të cilët kishin ushtruar poste të larta në kohën e anglezëve”.

Oficeri në pension kishte rënë në një gjumë të thellë kur treni kaloi pranë pendës së Sinnarit. Pendën e ujit, të cilën e ndërtuan anglezët në vitin 1926, në drejtim të Ubejdit, një hekurudhë, që shtrihet në drejtim të shkretëtirës, sikur ajo të jetë një urë e kodrave mes dy kodrave

të vështira në mes të cilave është një thellësi e pafund. I mjerë Mustafa Seidi. Ka qenë dashur të ketë një perspektivë sipas inspektorëve dhe oficerëve. Por, ai nuk ka as varr, ku do të pushonte trupi i tij, në këtë vend me një sipërfaqe prej një milion mila katrorë. M’u kujtua ajo që i kishte thënë gjykatësi para se t'ia shqiptonte gjykimin me rastin e Oveld Bili: “Ti zotëri Mustafa Seid, me gjithë njohuritë e shumta në shkencë, je njeri teveqel (i marrë). Në përbërjen tënde shpirtërore ke një pikë të errët, sepse ti ke humbur fuqinë më fisnike që Zoti ia ka dhuruar njeriut - e ajo është fuqia e dashurisë”. M’u kujtua po ashtu, se atë ditë, kur unë dola prej shtëpisë së Mustafa Seidit, hëna ishte ngritur sa është trupi i njeriut në horizont, në anën e lindjes, kurse unë thash vetmevete se hëna i paska prerë thonjtë. Nuk e di përse imagjinova unë se hëna i kishte prerë thonjtë?

Në Hartum, po ashtu m’u paraqit hija e Mustafa Seidit, më pak se një muaj të bisedës sime me oficerin në pension, sikur ai të jetë një xhind i liruar nga burgu, do të vazhdojë fështëritjet në veshët e njerëzve. Çka thotë? Nuk e di.

Ishim në shtëpinë e një të riu sudanez, ligjërues në universitet. Ishim, unë dhe ai shokë të studimeve në Angli. Në mesin e të pranishmëve ishte një anglez, i cili punonte në Ministrinë e Financave. Biseda zhvillohej rreth martesave të përziera. Biseda kishte kaluar nga karakteri i përgjithshëm në raste individuale. Pastaj në atë se kush ishin ata që janë të martuar me gra evropiane? Pastaj me angleze? Kush ishte sudanezi i parë që ishte martuar me angleze? Filani? Jo filani? Jo. Rastësisht u përmend Mustafa Seidi. Këtë e tha ligjëruesi në universitet dhe në fytyrën e tij vërejta një ndjenjë gëzimi ashtu siç e kisha parë më herët tek oficeri në pension. Ligjëruesi vazhdoi të flasë, nën qiellin e Hartumit të stolisur me yje në fillim të stinës së dimrit: “Mustafa Seidi është sudanezi i parë i martuar me angleze, por ai është edhe sudanezi i parë i martuar me një evropiane. Mendoj se ju nuk keni dëgjuar për të. Është shpërngulur para shumë kohësh. Është martuar në Angli dhe ka marrë nënshtetësinë angleze. Është për t’u habitur se askush prej nesh nuk e përmend atë, megjithëse ai ka luajtur një rol të rrezikshëm në komplotet e anglezëve në Sudan në fund

të viteve të tridhjeta. Ai ishte njeri më i besueshëm i tyre. Ministria e Punëve të Jashtme e Britanisë së Madhe e kishte shfrytëzuar në misione të dyshimta në Lindjen e Mesme. Ishte njëri prej sekretarëve të kongresit të mbajtur në Londër në vitin 1936. Ai tash është milioner dhe jeton si lord në një fshat të Anglisë".

"Dëgjova vetveten duke thënë pa vetëdije, me një zë të lartë: Mustafa Seidi ka lënë pas vdekjes së tij, gjashtë fidanë, tri lopë e një ka, dy gomarë, njëzet e një dhi, pesë dele, tridhjetë bletë, njëzet e tri pemë në mes të akacies dhe ferrëdetit si dhe njëzet e tri pemë të limonit dhe po aq pemë portokalli, nëntë okë grurë dhe po aq misër, një shtëpi prej pesë dhomave me një divan dhe një dhomë prej tullave të kuqe, në formë të gjatë, dritare me ngjyrë të gjelbra, kulmi i së cilës nuk është i rrafshët sikur shtëpitë tjera, por ai është trekëndesh sikur shpina e kaut dhe nëntëqind e tridhjetë e shtatë funta, tre grosh dhe pesë centë të holla të gatshme".

Në një moment që sikur të ishte shpejtësia e vetëtimës pastaj fshihet, pashë në sytë e të riut që ishte ulur para meje një ndjenjë të qartë të gjallë të dukshme, të frikës, këtë e hetova në shikimin e syve të tij, në dridhjen e qerpikëve dhe zgjatjen e nofullës së poshtme. Po të mos ishte i frikësuar përse më shtroi mua këtë pyetje: "A mos je ti i biri i tij?"

Më pyeti kështu duke mos ditur edhe ai vet përse i shqiptoi ato tri fjalë, dhe ai e dinte saktësisht se kush jam unë. Ai nuk ishte vetëm shok i imi në studime, ne ishim në Angli në të njëjtën kohë. Na kishin bashkuar raste të shumta dhe kishim pirë birrë më shumë se një herë së bashku në baret e Night Brig. Kështu pra në një moment jashtë kufijve të kohës dhe vendit, gjërat i duken diçka tjetër, jo reale. Çdo send i duket i mundshëm. Ai poashtu mund të jetë i biri i Mustafa Seidit, vëlla, apo i biri i mixhës së tij. Bota në ato momente të shkurtra, është aq sa një lëvizje qerpiku, shanset janë të pa kufijshme, sikur Ademi dhe Hava të kishin zbritur tash prej xhenetit.

Të gjitha mundësitë mbetën në të njëjtën gjendje kur qesha unë dhe u kthye bota ashtu siç ishte më parë. Persona që njiheshin në mes veti, emra të njohur, me profesione publike, nën qiellin e Hartumit të

stolisur me yje në fillim të stinës së dimrit. Ai qeshi po ashtu dhe tha: "Sa i marrë jam unë! Natyrisht se ti nuk je i biri i Mustafa Seidit e as i afërm i tij. Ti nuk ke dëgjua më parë për të në jetën tënde. Unë harrova se ju poetët, keni iluzione dhe imagjinata."

Mendova për diçka me neveritje, unë në sy të njerëzve konsiderohem poet e pranova këtë apo jo. Sepse unë kalova tre vjet duke hulumtuar për jetën e një poeti anonim prej poetëve të Anglisë. Pastaj u ktheva të ligjëroj letërsinë e periudhës së injorancës arabe në shkollat e mesme, para se të më caktojnë inspektor në ciklin e shkollave fillore.

Këtu ndërhyri bashkëbiseduesi ynë anglez dhe tha se ai nuk ka njohuri për saktësinë e të dhënave për rolin e Mustafa Seidit në komplotet e politikës angleze në Sudan. Atë që e din ai se Mustafa Seidi nuk ishte ekonomist në të cilin mund të mbështetesh: "Unë kam lexuar diçka që ai e ka quajtur ekonomia e kolonializmit". Shumica e shkrimeve të tij cilësohen si statistika që nuk mund të mbështetesh në to. Ai i takonte shkollës së ekonomistëve Fabanijve, të cilët mshihen pas perdes së përgjithësimit, duke ikur nga ballafaqimi me të vërtetat që mbështetën me numra. Drejtësia, barazia, socializmi. Vetëm parulla. Njeriu i ekonomisë nuk është shkrimtar si Çarls Dikenz, e as politikan si Ruzvellti. Ai është mjet që nuk ka vlerë pa të vërteta , numra dhe statistika. Maksimumin që mund ta bëjë ai është ripërtëritja e lidhjeve në mes një të vërtete dhe tjetrës, në mes numrit dhe tjetrit. Mirëpo, të bësh numrat të flasin diçka pa tjetrin, kjo është punë e qeveritarëve dhe njerëzve të politikës. Bota nuk ka nevojë për më tepër njerëz të politikës. Jo. Mustafa Seidi nuk ishte ekonomist i besueshëm".

E pyeta nëse ka pasur rastin të takonte Mustafa Seidin.

"Jo. Unë nuk e kam takuar. Ai e kishte lënë Oksfordin, para meje. Por, unë kam dëgjuar diçka për të aty këtu. Si duket ai ishte fuçi (bucele) e femrave. Kishte krijuar për vete një legjendë të llojit të vet. Njeriu i zi i bukur, i lazdruar në meset Bohimiane. Ishte si duket një lloj marketingu për një pjesë të aristokracisë, të cilët në vitet e njëzeta dhe në fillim të tridhjetave paraqiteshin si liberalë. Thua se ai ishte

mik i filan lordit apo lordit tjetër. Ishte i afërt më majtistët anglezë. Kjo për fat të keq edhe pse thuhej se ai ishte shumë i zgjuar. Nuk ka në fytyrë të tokës më të këqij se ekonomistët majtistë. Edhe pozitën e tij akademike - nuk e di saktësisht cila ka qenë ajo- mund ta parafytyroj se edhe atë ai me siguri e fitoi në këtë mënyrë. Sikur ata donin të thoshin: shikoni se sa jemi ne tolerantë, liberalë! Ky njeri afrikan e konsiderojmë si të jetë njëri prej nesh! Është martuar me vajzën tonë dhe punon me ne si të jetë prej nesh. Ky lloj i evropianëve nuk është pak i dëmshëm, nëse e kuptoni, nga ata të marrë, të cilët besojnë në superioritetin e njeriut të bardhë në jug të Afrikës, dhe në jug të shteteve të Bashkuara të Amerikës. E njëjta fuqi emocionale e ekstremiste, e cila drejtohet në skaj të djathtës apo të majtës. Sikur ai t'i përkushtohej shkencës do të gjente miq të sinqertë nga të gjithë popujt dhe do të kishit dëgjuar për të edhe këtu.

Me siguri do të kthehej dhe do t'i sillte dobi edhe këtij vendi me njohuritë e tij, në të cilin mbizotërojnë legjendat dhe mitet. Ja ju tani po besoni në mite të llojit të ri. Mitet e industrializimit, mitet e nacionalizimit, unitetit arab, mitit të unitetit afrikan. Ju jeni sikur fëmijë besoni se në thellësi të tokës ekziston një thesar, të cilin do ta nxirrni me anë të mrekullisë, do t'i zgjidhni të gjitha problemet dhe do të krijoni një parajsë. Iluzione. Ëndrra të ditës. Nëpërmes të vërtetave, shifrave dhe statistikave, mund ta pranoni realitetin tuaj të bashkëjetoni me të dhe ta ndryshoni brenda kufijve të mundësive tuaja. Ka qenë e mundur një njeri si Mustafa Seidi të luajë një rol të rëndësishëm në këtë aspekt, sikur ai të mos kthehej në një karagjoz në duar të një grupi të vogël të anglezëve të marrë".

Derisa Mensuri iu kundërvu duke i demantuar mendimet e Riçardit, unë isha thelluar në mendimet e mia, se cila ishte dobia e këtij dialogu? Ky njeri - Riçardi- është po ashtu jotolerant (fanatik). Secili është jo tolerant në një mënyrë apo tjetër. Ndoshta ne u besojmë miteve, të cilat i përmendi, por edhe ai beson në mitin e ri, mitin bashkëkohor, ai është miti i statistikave. Meqenëse duhet të besojmë në një zot, atëherë le t'i besojmë Zotit të Gjithëfuqishëm për çdo send. Kurse sa u përket statistikave! Njeriu i bardhë, vetëm pse ai na ka sunduar në

një periudhë kohore të historisë sonë, ai do të vazhdojë të ndjejë në vete ndjenjën e përbuzjes, ashtu siç ndien i fuqishmi ndaj të dobëtit". Mustafa Seid u kishte thënë atyre: "Unë kam ardhur invadues!" Një shprehje milodramike pa dyshim. Mirëpo, ardhja e tyre po ashtu nuk ishte tragjedi ashtu siç e paraqesim ne, por as begati siç e paraqesin ata. Ishte veprim milodramik, i cili me kalimin e kohës do të kthehet në mit të madh. Dëgjova Mensurin duke i thënë Riçardit: " E keni bartur te ne sëmundjen e ekonomisë suaj kapitaliste. Çka na keni dhënë neve përveç një numër kompanish kolonialiste që kanë pirë gjakun tonë dhe atë vazhdojnë ta bëjnë edhe sot?" Riçardi ia ktheu: " E tërë kjo tregon se ju nuk mund të jetoni pa ne. Ankoheshit prej kolonializmit, kur ne dolëm, krijuat mitin e kolonializmit të fshehtë. Si duket qëndrimi i ynë në mënyrë të dukshme apo të padukshme është i domosdoshëm për ju siç është buka dhe uji". Ata nuk ishin të hidhëruar. Ata polemizonin në këtë mënyrë dhe po qeshnin në një afërsi shumë të vogël të vijës së Ekuatorit, të cilët i ndante një humnerë historike tepër e gjerë.

-4-

Ju lutem zotëri, të mos u shkoj mendja se Mustafa Seidi më është bërë marrëzi, më shoqëron në shkuarjet dhe vajtjet e mia. Nganjëherë kalonin muaj pa m'u kujtuar se kishte vdekur, i fundosur apo kishte bërë vetëvrasje. Vetëm Allahu e di këtë. Me mijëra njerëz vdesin për çdo ditë. Sikur të ndalemi dhe të mendojmë përse ka vdekur secili prej tyre dhe si ka vdekur - çka do të ndodhte me ne të gjallët? Bota ecën me vullnetin tanë apo kundër vullnetit tanë. Unë sikur mijëra njerëz, ec, lëviz sipas zakonit të shumicës, në një karvan të gjatë, i cili ngjitet dhe zbret, pushon dhe udhëton. Jeta në këtë karvan nuk është e tëra sherr, ju me siguri e kuptoni këtë. Mund të jetë udhëtimi i mundimshëm ditën, shkretëtirat shihen para nesh si të jenë dete pa brigje (kufij). Më shkojnë rrëke djersët nga të nxehtit. Shteren fytet tanë nga të eturit. Arrijmë kufirin pas së cilit besojmë se nuk ka përparim. Pastaj perëndon dielli. Ftohet ajri. Miliona yje qëndrojnë në qiell. Atëherë, ha-

më dhe pimë. Dikush nga të pranishmit këndon. Disa prej neve falemi pas hoxhës. Disa prej nesh ngjiten në radhë ku vallëzojnë, këndojnë dhe rrahin shuplakë. Mbi ne qëndron një qiell i ngrohtë dhe i butë. Nganjëherë vazhdojmë udhëtimin tonë natën derisa të lodhemi. Derisa të dallohet peri i zi nga i bardhi e themi: "Në agimin e mëngjesit njerëzit falënderojnë udhëtimin".

Nëse vegimi nganjëherë na mashtron neve. Nëse pamjet tona në ethe për shkak të vapës dhe etjes na bëjnë të thellohemi në mendime, të cilat nuk kanë të bëjnë fare me realitetin. Atëherë, patjetër se fantazma e natës avullohet prej mëngjesit, kurse vapa e ditës freskohet me erën e natës. A ka ndonjë mjet tjetër përveç këtij? Kështu pra për çdo vjet kaloja dy muaj në atë fshat të vogël në brigjet e lumit Nil. Lumi pasi që rridhte prej jugu në veri, befasisht kthehet në një kënd që mund të jetë i drejtë dhe rrjedh prej Perëndimi në Lindje. Rrjedha këtu është e gjerë dhe e thellë, kurse në mes të ujit gjenden ujdhesa të vogla e të gjelbra, rreth të cilave sillen shpezë të bardha. Në dy brigjet shihen male të dendura të palmave si dhe ujëvare në formë të rrumbullakëta si dhe makina të ujit prej kohësh në kohë. Burrat me gjokset lakuriq, të veshur me done të gjata, korrnin apo mbillnin. Kur kalonte andej, anija si një kala notuese në mes të Nilit, drejtonin trupat e tyre kah ajo për një çast. Pastaj, prapë ktheheshin për ta vazhduar punën. Ajo kalonte në atë vend, në kohën e drekës, një herë në javë. Hija e saj reflektohej në valët e ujit dhe zhurma e motorëve të saj dëgjohej edhe në kasollet e fshatarëve të mi, që ishin duke pirë kafen e drekës. Prej larg shihej stacioni. Trotuari i bardhë në të ishte një grumbull drunj fik Egjipti. Në të dy anët e bregut shihet një lëvizje e qartë. Disa njerëz hipur në gomar e disa ecin në këmbë. Barka të vogla dhe barka me vela, lëvizin në bregun kundruall stacionit. Anija sillet rreth vetes, që motorët të mos jenë në rrjedhën e erës. Në pritje të saj janë një grup njerëzish burra e gra. Aty është babai im, xhaxhallarët e mi, të cilët kanë lidhur gomarët e tyre për drunjtë e fikut egjiptian. Kësaj here mes meje dhe atyre nuk na ndan asnjë kafshë. Unë vij nga Hartumi, pas një mungese prej shtatë muajsh. Unë i shoh ata me syrin e realitetit. Xhelabijat e tyre janë të pastra, por të pahekurosura. Shallet

e kokës së tyre janë më të bardhë se xhelabijat. Mustaqet e tyre disa i kanë më të gjata e disa më të shkurtra, të zeza e të bardha. Disa prej tyre kanë mjekra, kurse të tjerët që nuk kanë mjekra nuk i kanë rruar ato. Në mes gomarit të tyre dhe një gomari të zi që nuk e kisha parë asnjë herë më parë. Ata ishin habitur duke shikuar anijen si po i vendoste spiralet e saj, kurse njerëzit ishin grumbulluar në hyrje të saj. Ata më pritnin jashtë. Nuk nguteshin të më takonin. Më përshëndetën mua dhe gruan tim në shpejtësi, por ata e bombarduan vajzën time duke e puthur. Njëri pas tjetrit ndërroheshin duke e bartur atë në krah, derisa arritëm te gomari, i cili do të na bartë deri në lagjen tonë. Kështu veproja prej kohës, kur unë isha nxënës në shkollë asnjëherë nuk jam ndarë përveç mungesës së gjatë për të cilën iu kam treguar më herët. Në rrugë e sipër për në lagje pyes për gomaren e zezë, e babai im përgjigjet: "Një beduin e ka mashtruar axhën tënd, ia ka marrë atij gomaren e bardhë, të cilën e ke parë dhe mbi të ishin edhe pesë funta". Nuk e dija se cilin nga xhaxhallarët e mi e kishte mashtruar beduini, derisa e dëgjova zërin e axhës tim Abdul Kerimit duke thënë: "Betohem se kjo është gomarja më e mirë në fshat. Ky është kalë e nuk është gomar. Nëse do ta shes mund të fitoj tridhjetë funta". Xhaxhai im Abdurrahimi qeshet e thotë: "Nëse është pelë, atëherë është pelë shterpë. Nuk ka asgjë të mirë në një gomare që nuk lind." I pyes për prodhimin e hurmave në këtë vit, kurse unë e di përgjigjen paraprakisht. "Nuk ka asgjë prej saj: Përgjigjen në këtë, me të njëjtin zë dhe këtë e përsërisin për çdo vit. Unë e di se realiteti është krejt diçka tjetër. Kalojmë pranë një ndërtese me tulla të kuqe në breg të Nilit. I pyes për të. Përgjigjet axha im Abdul Menani: "Ambulancë. Ata kanë mundësi, por e kanë lënë në gjysmë. Qeveri, premtime të kota". I them atij se unë isha këtu vetëm para shtatë muajve dhe atëherë nuk kishte filluar puna në ndërtimin e saj. Por, kjo nuk ia ndërron mendimin xhaxhait tim Abdul Menanit, i cili thotë: "Tërë atë që bëjnë ata se për çdo dy apo tre vjet, vijnë te ne me një numër të madh të njerëzve, me kamionët dhe pllakatet e tyre. "Rroftë filani dhe të bjerë filani". Ishim të qetë gjatë sundimit anglez prej këtyre demonstrimeve". Rastësisht para neve kalon një grup njerëzish hipur në një kamion të vjetër duke

bërtitur: “Rroftë Partia Nacional-Demokratike Socialiste”. A janë këta njerëz “bujq”, të cilët emërtohen nëpër libra? Po, do t’i thosha gjyshit tim se revolucionet bëhen në emër të tij, dhe qeveritë vijnë dhe shkojnë për shkak të tij, do të qeshte. Vërtet, ideja mund të duket jo normale, ashtu sikur jeta dhe vdekja e Mustafa Seidit, në një vend sikur ky, duket e vështirë dhe e pabesueshme. Mustafa Seidi falte pesë kohët e namazit në xhami rregullisht. Athua përse e tepronte në luajtjen e këtij roli qesharak? A erdhi në këtë fshat të largët për të kërkuar qetësi? Ndoshta përgjigja ishte në atë sallonin e gjatë me dritare të gjelbra. Çka mund të presë? A mund ta gjej ulur në karrige të vetmuar në terr? Apo mund ta gjej të varur në litar duke u luhatur në tavan. Shkresën, që kishte lënë në një zarf të vulosur me një dyllë të kuq. Shtrohet pyetja, kur e kishte shkruar atë?

“Unë e lë gruan, djalin, pasurinë time në përkujdesjen tënde. Unë e di se ti do të jesh besnik për çdo gjë. Gruaja ime di për tërë pasurinë time. Ajo është e lirë ta përdorë atë. Unë kam besim të plotë në urtësinë e saj. Por, unë kërkoj prej teje ta kryesh këtë shërbim për njeriun, të cilin nuk ke pasur fatin të njihet me ty ashtu siç duhet - të marrësh nën mbikëqyrjen tënde anëtarët e familjes sime që të jesh këshillues dhe ndihmës për dy bijtë e mi dhe aq sa të kesh mundësi t'i largosh nga vështirësia e udhëtimit. T'u ndihmosh atyre të edukohen një edukatë normale dhe të bëjnë punë të dobishme. Unë po ta lë ty çelësin e dhomës sime të punës, me siguri ti do të gjesh aty atë çka kërkon. Unë e di se ti ke një dëshirë të madhe për ta hulumtuar të kaluarën time, për çka unë nuk shoh ndonjë arsye të veçantë. Jeta ime, cila do qoftë ajo, në të nuk ka këshillë apo urtësi për dikë. Sikur të mos ishte perceptimi im se njohja e banorëve të fshatit me të kaluarën time do të ishte pengesë për vazhdimin e jetës, të cilën e kisha zgjedhur për vete, nuk do të kishte pasur asnjë arsye për ta mbajtur sekret. Ti je i lirë në besën që ma dha mua atë natë. Je i lirë të flasësh çka të duash. Nëse nuk mund ta frenosh dëshirën tënde për ta hulumtuar të kaluarën time, do të gjesh në dhomën, ku nuk ka hyrë askush tjetër përveç meje, do të gjesh tregime në fleta, copëza të shpërndara dhe përpjekje për shkruarjen e memoareve etj. Shpresoj se do të ndihmojnë në kalimin e kohës

kur nuk ke ndonjë punë tjetër për t’u marrë me të. Unë të lë të lirë, në caktimin e kohës që t'i japish djalit tim çelësin e dhomës e të ndihmosh atyre ta kuptojnë të vërtetën e çështjes sime. Ajo që më intereson mua është, që ata ta kuptojnë se prej cilit lloj të njerëzve ishte babai i tyre - nëse kjo do të jetë e mundshme - nuk është qëllimi im që ata ta fitojnë një bindje të mirë për mua, fitimi i bindjes së mirë është e fundit që kam për qëllim. Ndoshta kjo do t’u ndihmojë atyre ta njohin të vërtetën e tyre, por në kohën kur njohja nuk paraqet rrezik. Në rast se ata rriten të kënaqur me ajrin e këtij vendi, aromat, ngjyrat, historinë, pamjet e njerëzve të tij, kujtimet e vërshimeve, të mbjellave dhe të korrat e tij, atëherë jeta ime do të zërë vendin e saj meritor, si një send që ka kuptim pranë kuptimeve të shumta që kanë një arsye më të thellë. Nuk e di si do të jetë mendimi i tyre për mua atëherë. Mund të ndjejnë dhembje për mua, apo do të kthehem në imagjinatën e tyre në një hero. Kjo nuk është me rëndësi. Me rëndësi është se jeta ime nuk do të vijë pas një të panjohuri si një shpirt i keq që mund t'i bëjë atyre ndonjë të keqe. Sa do të dëshiroja të isha me ata, t’i përcjella ata duke u rritur para syve të mi dhe do të jenë së paku shkak i ekzistencës sime. Unë nuk e di se cila prej dy veprimeve është më egoiste, mbetja ime apo shkuarja ime. Cila do që të jetë, unë nuk kam hile në të. Ti me siguri e kupton qëllimin tim nëse kthehesh me kujtesën tënde në atë që të thash ty atë natë. Nuk ka farë dobie prej mashtrimit të vetvetes. Ajo thirrje e largët ende më sillet në kujtesën time. Mendova se jeta ime dhe martesa ime këtu do ta heshtin. Ndoshta, unë jam i lindur i këtillë. Apo ndoshta fati im është i këtillë. Çfarë do qoftë kuptimi i tij. Nuk e di: unë e kuptoj me mendjen time se çka duhet bërë, atë që e kisha provuar në këtë fshat me këta njerëz të lumtur. Mirëpo, gjëra të panjohura në shpirtin tim dhe në gjakun tim më shtyjnë mua në hapësira të largëta, të cilat më paraqiten dhe nuk mund të injorohen. Medet për mua nëse dy bijtë e mi, njëri apo te dytë rriten dhe tek ata është prezent mikrobi i kësaj sëmundjeje, sëmundjes së shtegtimit. Unë të përcjell ty amanetin, sepse unë tek ti kam vërejtur kopjen e gjyshit tënd. Nuk e di se kur do të shkoj o miku im, por unë po ndiej se momenti i udhëtimit është afër. Pra, lamtumirë”.

Nëse Mustafa Seidi ka zgjedhur fundin e vet, me këtë ai ka bërë veprimin më të madh milodramik në tregimin e jetës së vet. Nëse varianti tjetër është i vërtetë, atëherë natyra ia ka dhuruar përfundimin, të cilin ai e donte për veten e vet. Paramendo. Kulmi i verës, në muajin korrik, lumi si rëndomtë vërshoi ashtu siç kishte vepruar për tridhjetë vjet me radhë. Errësira i bashkoi të gjitha elementet e natyrës në një element neutral, më të vjetër se vetë lumi dhe më pak të rrezikshëm. Kështu duhet të jetë përfundimi i heroit. A ishte ky fundi, të cilin e hulumtonte, ndoshta ai dëshironte këtë në veri. Në veriu më të largët. Në një natë me borë dhe acar, nën një qiell pa yje, në mesin e një populli, që askujt nuk i intereson për të. Fundi i agresorëve pushtues. Mirëpo ata, siç kanë thënë, bënë komplot kundër tij, prokurorët, dëshmitarët, mbrojtësit dhe gjykatësit që t'ia marrin atë. Kështu ai tha: "Prokurorët panë para vetes një njeri që nuk dëshiron ta mbrojë vetveten, një njeri, që kishte humbur dëshirën për jetë. Unë jam hamendur atë natë kur kam ulëritur xhinit në veshin tim. "Eja me mua… eja.". Jeta ime u kompletua atë natë dhe nuk kishte arsye për të mbetur. Mirëpo, unë u hamenda dhe u frikësova në momentin vendimtar. Kisha dashur që gjyqi të më dhuronte atë që unë nuk kisha mundur ta realizoj. Sikur ata e kuptuan qëllimin tim dhe kishin vendosur të mos ma plotësonin dëshirën time të fundit. Këtë nuk e bëri as koloneli Hemand, tek i cili kisha mbështetur shpresat e mia. Ai përmendi vizitën time tek ata në Liverpul dhe se unë kisha lënur tek ai mbresa të mira. Ai tha se konsideron veten liberal dhe nuk ka paragjykime ndaj askujt. Ai është realist dhe se ai ka qenë i bindur se një martesë e këtillë nuk do të jetë e suksesshme. Pati thënë po ashtu se e bija e tij An kishte rënë nën ndikimin e filozofive lindore në Oksford dhe ishte e hamendur në mes pranimit të Budizmit apo Islamit. Ai nuk është i sigurt nëse vetëvrasja e saj mund të jetë si shkak i një krize shpirtërore që ka përjetuar apo se ajo e ka zbuluar mashtrimin e zotëri Mustafa Seidit. An, ishte vajza e tij e vetme. Isha njohur me të, kur ajo ende nuk i kishte mbushur të njëzetat. E mashtrova atë dhe i thashë, të martohemi që martesa jonë të jetë urë në mes Veriut dhe Jugut. Dëshirën e saj të madhe për të ardhmen në sytë e saj të gjelbër ia ktheva në hi. Megjithatë, babai i saj qëndron në mes të gjykatores dhe me zërin e tij të qetë thotë se nuk mund të pohojë me vendosmëri. Kjo është drejtësia dhe mënyra e lojës, si rregullat e luftës dhe neutraliteti në luftë. Kjo është fuqia që vesh maskën e mëshirës". Me rëndësi është se ata e dënuan atë me vetëm shtatë vjet burgim. Ata refuzuan të marrin vendimin, të cilin duhej ai ta ndërmerrte me vullnetin e vet të plotë. Të dilet prej burgu dhe të shkonte në skaj të botës; prej Parisit në Kopenhage deri në Delhi e Bankok. Ai mundohej të zvarriste. Fundi i tij të jetë në një fshat të panjohur në brigjet e lumit Nil dhe njeriu nuk mund të vërtetojë se, a ishte kjo rastësi apo dëshirë e tij, që vetë t'i japë fund jetës së vet në këtë mënyrë?! Unë nuk kam ardhur këtu të mendoj për Mustafa Seidin. Ja këtu janë shtëpitë e fshatit të ngjitura njëra me tjetrën, të ndërtuara prej lloçit dhe qerpiçëve. Gomari ynë e shpejtoi të ecurit, sepse ai ndjeu erën e tërfojës, tagjisë dhe ujit. Këto shtëpi janë në skaj të shkretëtirës, sikur një popull në kohëra të vjetra, deshën të vendosën, pastaj fshin duart dhe shkuan shpejt. Këtu fillojnë disa gjëra e përfundojnë tjerat. Nga një anë e vogël, vjen një ajër i ftohtë dhe i freskët. Ai vjen nga ana e lumit, në mes të vapës së shkretëtirës. Sikur, ajo të jetë gjysma e së vërtetës në një botë me plot gënjeshtra. Zërat e njerëzve, të shpezëve, kafshëve përfundojnë të dobëta në veshë sikur ato të ishin djallëzore. Zhurma e vazhdueshme e makinës së ujit e forcon ndjenjën e të pamundurës. Dhe lumi, lumi, sikur të mos ishte ai, nuk do të kishte fillim e as mbarim. Ai rrjedh në drejtim të veriut. Nuk bën leqe, vetëm nëse atë e pengon ndonjë kodër, atëherë kthehet në lindje, apo ndonjë ultësirë dhe drejtohet në perëndim. Mirëpo, atë herët a vonë do të vendoste në rrjedhën e tij definitive në drejtim të detit në veri.

- vijon -

Tayeb Salih (Sudan)

SEASON OF MIGRATION TO THE NORTH (3)
(Summary)

It was a hot summer night. That year, there was a great flood, something that happens every 20-30 years (and becomes the stuff of legends, which are passed from father to son). The Nile had flooded the whole area between the river banks and the desert, where the houses are. Fields stood as islands in the midst of water. The men traveled from their homes to their fields in small boats or swam there. Mustafa Sa'eed could swim as far as I know. My father had told me, when I was in Khartoum, that they had heard the cries of women in our quarter.

الطيب صالح

موسم الهجرة إلى الشمال (3)
(خلاصة البحث)

كانت ليلة قائظة من ليالى شهر يوليو، و كان النيل قد فاض ذلك العام أحد فيضاناته تلك التي تحدث مرة كل عشرين أو ثلاثين سنة، و تصبح اساطير يحدث بها الآباء ابناءهم. و غمر الماء اغلب الارض الممتدة بين الشاطئ و طرف الصحراء حيث تقوم البيوت، و بقيت الحقول كجزيرة وسط الماء. و كان الرجال ينتقلون بين البيوت و الحقول في قوارب صغيرة، أو يقطعون المسافمة سباحة، و كان مصطفى سعيد حسب علمى يجيد السباحة. حدثنى أبى، فقد كنت في الخرطوم وقتها، أنهم سمعوا بعد صلاة العشاء صراخ نسوة في الحى، فهرعوا إلى مصدر الصوت فاذا الصراخ في دار مصطفى سعيد.

HISTORIOGRAFI

Amr Halid

Uthman bin Afani, Allahu qoftë i kënaqur me të

Letërnjoftimi i tij

Emri dhe prejardhja
Ai është Uthman bin Afan bin Ebij El-As bin Umeje bin Abdu Shams bin Abdu Menaf bin Kusaj. Me Pejgamberin alejhi selam takohet te gjyshi i gjashtë.
Babai i tij është Afan bin Ebij El-Asi, i cili vdiq në xhahiliet para ardhjes së Islamit. Nëna e tij, Urva bint Kerijb bin Rabia, e pranoi Islamin dhe jetoi në Medinë. I dha betimin Pejgamberit alejhi selam për Islam dhe vdiq në kohën e kalifatit të birit të saj, Uthmanit. Gjyshja e tij ishte Umu Hakim bint Abdul Mutalibi, halla e Pejgamberit alejhi selam.

Cilësitë e tij
Uthmani nuk ishte i gjatë shumë, por as i shkurtër, ishte mesatar. Kishte shumë flokë e mjekër të shpeshtë, gojë më të mirë se të gjithë njerëzit, pamje simpatike, lëkurë të butë, anonte nga ngjyra ezmere, këmbë të mbushura, kishte krahë të gjatë dhe trupi i tij ishte leshator.

Morali i tij
Uthmani ishte nga më të pasurit, ndoshta më i pasuri i kurejshëve. Megjithatë ishte shumë i sjellshëm, deri në atë

shkallë sa kur nënat i përkundnin në djep fëmijët e tyre, për ninulla u thoshin: “Të dashtë Rrahmani (Allahu) ashtu si kurejshët duan Uthmanin!” Për hir të moralit të tij të lartë dhe sjelljeve të tij, kurejshët e donin shumë.

Pronari i dy dritave
Gruaja e parë e Uthmanit ishte Rukija, bija e Pejgamberit alejhi selam, e cila vdiq. Pastaj Pejgamberi alejhi selam i dha atij edhe bijën tjetër, Umu Kulthumin. Të dyja bijat e Pejgamberit alejhi selam ishin të fejuara me dy bijtë e Ebu Lehebit, por pas shpalljes së Pejgamberit alejhi selam si Pejgamber, Ebu Lehebi filloi ta luftonte atë dhe thirrjen e tij dhe nisi ta mundonte Pejgamberin alejhi selam. Ebu Lehebi u tha dy djemve të tij që të ndaheshin nga vajzat e Pejgamberit alejhi selam dhe ata ashtu vepruan.
Dy vjet para hixhretit, Uthmani u martua me Rukien. Më pas u lindi edhe Abdullahu. Ajo vdiq në ditën e Bedrit. Pas vdekjes së saj, Uthmani u martua me motrën e Rukies, Umu Kulthumin, e cila vdiq në vitin e 9-të pas hixhretit. Uthmani u quajt “pronari i dy dritave” sepse u martua me dy bijat e Pejgamberit alejhi selam. Thuhet se arabët nuk kanë njohur dy bashkëshortë më të dashur se Rukija dhe Uthmani.
Pas vdekjes së Umu Kulthumit, ai u martua me Sahita bint Gazvanin e pastaj edhe me Fatima bint El-Velijdin dhe Umul Benin bint Ajine bin Hasin. Gruaja e fundit e tij ishte Naile bint El-Ferakisa, e cila ishte e krishterë, por pastaj pranoi Islamin para martesës së tyre.

Fëmijët e tij
Fëmijët e tij janë Abdullahu i madh, Abdullahu i vogël, Amri, Velidi, Saidi dhe Abdul-Meliku, kurse vajzat e tij janë Merjemeja, Umu Saidja, Aishja, Umu Amri dhe Umul-Benini.

Etapat më të rëndësishme në jetën e Uthmanit
Uthman bin Afani lindi gjashtë vite pas vitit të elefantit. Ai emigroi për në Abisini në moshën 47-vjeçare. Kalif i muslimanëve u bë në moshën 70-vjeçare, post në të cilin qëndroi

12 vjet. Ra dëshmor ndodhi në ditën e tetëmbëdhjetë të dhul-hixhes të vitit 35 pas hixhretit.

Pranimi i Islamit

Uthmani ishte një tregtar që interesohej shumë për tregtinë e vet. Pasi Muhamedi alejhi selam u shpall Pejgamber, Uthmani pa një ëndërr: "Një thirrës thërriste: "O ju që flini, zgjohuni! Muhamedi ka ardhur në Mekë!" U zgjua Uthmani, por nuk e kuptoi ëndrrën. Shkoj tek halla e tij, e cila ishte bërë muslimane, por e mbante sekret këtë, dhe i kërkoi t'ia komentonte atë ëndërr. Ajo i tha: "Muhamed bin Abdullahu është dërguar në Mekë. Atë e dërgoi Allahu xh.xh. me zbritje hyjnore (Kuranin), që të udhëzojë njerëzit tek Allahu."

Kur dëgjoi këto fjalë, ai shkoi menjëherë te shoku i tij i ngushtë, Ebu Bekri. Kur i tregoi hallin e tij, Ebu Bekri i tha: "Halla jote ka thënë të vërtetën." Pastaj shtoi: "A e di, o Uthman? Unë të shoh si njeri me sedër, që turpërohesh. E shoh se kjo cilësi nuk të shpie diku tjetër vetëm se në Islam."

Uthmani shkoi te Muhamedi alejhi selam dhe ai ia tregoi Islamin. Uthmani atëherë tha: "Pasha Allahun, nuk munda të pres më shumë, por deklarova shehadetin: "La ilahe il-la Allah, Muhamedu Resulullah!"

Uthmani ishte njeriu i tetë që hyri në Islam.

Hadithet në të cilat përmendet Uthmani

Përgëzimi me xhenet

Transmetohet se Ebu Musa El-Eshariu ka thënë: "E kërkova Pejgamberin alejhi selam në xhami dhe nuk e gjeta. Pyeta gratë e tij se mos ishte në shtëpi, por nuk e gjeta, Pastaj pyeta për të e më thanë se kishte shkuar në këtë drejtim. Shkova në atë drejtim derisa arrita te pusi, kur ja, Pejgamberi alejhi selam ishte aty. Ai kishte hyrë në pus, kishte marrë abdest dhe po rrinte në gur të pusit, kurse këmbët i kishte futur në pus dhe i kishte ngritur rrobat e veta. Ebu Musa El-Eshariu tha me vete: "Sot do të bëhem portier i Pejgamberit alejhi selam. Kështu, ai mori qëndrimin e portierit dhe qëndroi te hyrja e pusit. Pas pak erdhi Ebu Bekri dhe kërkoi leje të hynte te Pejgamberi alejhi selam. Ebu Musai i

kërkoi leje Pejgamberit alejhi selam. Pejgamberi alejhi selam i tha: "Lëre të hyjë dhe jepi sihariq me xhenet." Ai shkoi tek Ebu Bekri dhe i tha se Pejgamberi alejhi selam të lejon të hysh dhe të përgëzon me xhenet. Ebu Bekri erdhi dhe u ul pranë Pejgamberit alejhi selam dhe futi këmbët në ujë dhe përvoli rrobat. Pastaj erdhi Omeri. Ai kërkoi leje të hynte te Pejgamberi alejhi selam. Ebu Musai i kërkoi leje Pejgamberit alejhi selam se Omeri dëshironte të hynte tek ai. Pejgamberi alejhi selam i dha leje dhe i tha ta përgëzonte me xhenet.

Pastaj erdhi Uthmani, i cili kërkoi leje nga Pejgamberi alejhi selam. Pejgamberi alejhi selam i dha leje të hynte dhe e përgëzoi edhe atë me xhenet dhe me një fatkeqësi. Ebu Musai i tha: "Pejgamberi alejhi selam të jep leje të hysh dhe të përgëzon me xhenet dhe me një fatkeqësi që do të të ndodhë." Uthmani tha: "Allahu na ndihmoftë!" E shikoi Ebu Musain dhe hyri brenda. Nuk gjeti vend anash pusit të ujit që të ulej pranë Pejgamberit alejhi selam dhe Ebu Bekrit e Omerit, por shkoi e u ul në ballë të tyre dhe shtriu këmbët e tij në ujë..."

Një ditë, Pejgamberi alejhi selam po rrinte në Rouda dhe tha: "Ebu Bekri në xhenet! Omeri në xhenet! Uthmani në xhenet! Aliu në xhenet! Talha në xhenet! Zubejr bin Avami në xhenet! Abdurrahman bin Oufi në xhenet! Sad bin Ebij Vekasi në xhenet! Abdurrahman bin Oufi në xhenet dhe Said bin Zaidi në xhenet!"

Thotë Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të: "Pejgamberi alejhi selam ulej dhe vendoste këmbën e tij mbi këmbën e Uthmanit. I vinte shpallja nga Allahu xh.xh. dhe Uthmani e shkruante atë, kurse unë i fshija djersët në ballë Pejgamberit alejhi selam dhe Pejgamberi alejhi selam thoshte: "Shkruaj, o Utheim!"

Thotë Aishja: "Pasha Allahun, nuk do ta trajtonte (Pejgamberi alejhi selam) kështu, nëse ai nuk do ishte shumë i afërt te Pejgamberi alejhi selam!"

Një burrë prej të cilit edhe engjëjt turpërohen

Pejgamberi alejhi selam ishte një ditë në shtëpinë e tij dhe kishte përvjelë këmishën. Ebu Bekri kërkoi leje të hynte dhe ai i dha leje. Pejgamberi alejhi selam nuk e ndryshoi qëndrimin e vet. Pastaj Omeri kërkoi leje që të hynte te Pejgamberi alejhi selam dhe ai i dha leje.

Pejgamberi alejhi selam qëndroi ashtu siç ishte. Pastaj Uthmani kërkoi leje që të hynte dhe atëherë Pejgamberi alejhi selam e ndreqi pozicionin e tij dhe e lëshoi këmishën si më parë. Pejgamberi alejhi selam u ndal dhe bisedoi me Uthmanin, e pastaj ai doli. Kur Uthmani doli, Aishja e pyeti përse e shtriu këmishën dhe u ul kur hyri Uthmani. Pejgamberi alejhi selam i tha: "Oj Aishe, Uthmani është njeri me sedër, i turpshëm. Më vjen keq nëse vjen Uthmani e më sheh kështu, se i vjen turp të më flasë për atë që ka ardhur. Si të mos turpërohem nga ai prej të cilit edhe engjëjt turpërohen?"

Qëndrimet e tij ndaj Pejgamberit alejhi selam

Solid dhe i qëndrueshëm në të vërtetën

Uthmani ishte ndër më të pasurit e Mekës dhe shumë i dashur nga mekasit. Pranimi i Islamit prej tij shkaktoi frustrim në mesin e kurejshitëve. Ata filluan ta ndëshkojnë me qëllim që ta detyrojnë të kthehet në fenë e kurejshëve. Xhaxhai i tij, El-Hakem bin Ebij El-Asi, e lidhte Uthmanin me zinxhirë dhe i thoshte: "Do të të mbaj kështu derisa të kthehesh në fenë e të parëve të tu!" Por Uthmani i thoshte: "Pasha Allahun, nuk do të kthehem në fenë e baballarëve, edhe nëse më mban tërë kohën kështu." Kur e pa qëndrimin e tij solid e të pathyeshëm, ai e liroi dhe ia zgjidhi zinxhirët.

Pastaj kurejshët filluan t'i bëjnë probleme dhe bllokadë në tregti, se mos ndoshta do të kthehej në besimin e tyre, por Uthmani qëndroi solid dhe i pathyeshëm në të vërtetën.

Muhaxhiri i parë në rrugën e Allahut

Kur kurejshët e shtuan dhunën e tyre kundër muslimanëve, Pejgamberi alejhi selam u tha sahabëve të emigronin në Absini. Uthmani ishte i pari që emigroi në rrugën e Allahut bashkë me familjen e tij. Ai emigroi me bashkëshorten e tij Rukien dhe me vete mori edhe pasurinë e vet. Pejgamberi alejhi selam për këtë qëndrim të Uthmanit thotë: "Uthmani është muhaxhiri i parë me familjen e tij në rrugën e Allahut pas Pejgamberit të Allahut, Lutit alejhi selam."

Uthmani u kthye në Mekë dy vite para hixhretit të Pejgamberit alejhi selam në Medinë, ku i lindi edhe djali i tij, Abdullahu.

Pus uji në xhenet

Pas emigrimit të muslimanëve në Medinë, numri i tyre nisi të rritet dhe bashkë me këtë edhe kurthet e çifutëve kundër tyre. Një prej këtyre kurtheve ishte edhe kurthi i pusit të ujit që quhej "Ruma". Ky pus ishte i një çifuti dhe ky çifut merrte para nga muslimanët për ujin që ata merrnin aty. Kur nevoja e muslimanëve për ujë nisi të rritet, çifuti e rriti çmimin e ujit. Pejgamberi alejhi selam tha: "Kush e blen pusin "Ruma", ai do të ketë pus në xhenet!" Uthmani shkoi te çifuti dhe i ofroi që ta blinte ai pusin e ujit. Çifuti i tha se pusin e ujit e shiste për 50 mijë dërhemë, ndërsa Uthmani i tha se do ta blinte gjysmën e pusit për 12 mijë dërhemë, me kusht që një ditë të merrte ujë Uthmani dhe një ditë tjetër çifuti. Kjo ide i pëlqeu çifutit. Uthmani u tha muslimanëve që të merrnin ujë në ditën e tij sa të donin, pa asnjë pagesë. Muslimanët nuk shkonin të merrnin më ujë në ditën e çifutit, prandaj çifuti erdhi tek Uthmani dhe i ofroi që t'ia shiste pjesën e tij të pusit për 8 mijë dërhemë. Atëherë Uthmani u pajtua me ofertën e çifutit dhe garantoi një pus uji në xhenet. Urime Uthman!

Lufta e Bedrit

Kur pa Pejgamberi alejhi selam se kurejshët ishin nisur për në Bedër, tha: "Kush dëshiron të vijë me mua, le të më pasojë." Uthmani deshi të dilte me Pejgamberin alejhi selam, por ai e ndali dhe i tha të rrinte pranë bashkëshortes, Rukies, e cila ishte e sëmurë. Ajo vdiq në kohën kur muslimanët triumfuan në Bedër. Edhe pse Uthmani nuk mori pjesë në betejë, Pejgamberi alejhi selam ia ndau prenë njësoj si muslimanëve që morën pjesë në betejë.

Uthmani e qau shumë bashkëshorten e tij, Rukien, bijën e Pejgamberit alejhi selam. Një ditë Pejgamberi alejhi selam kaloi pranë Uthmanit dhe e pa se po qante shumë. Pejgamberi alejhi selam e pyeti përse po qante dhe ai i tha: "Po qaj për vdekjen e Rukies dhe për shkëputjen e miqësisë me Pejgamberin alejhi selam." Atëherë Pejgamberi alejhi selam i tha: "O Uthman, nëse do, po ta jap për martesë bijën tjetër, Umu Kulthumin." Uthmani u pajtua dhe jetoi me të deri në vitin e 9-të pas hixhretit, kur edhe Umu Kulthumi vdiq.

Marrëveshja e Hudejbies

Pejgamberi alejhi selam dhe sahabët e tij fisnikë u nisën për në Mekë për umre dhe jo për luftë. Ata arritën në vendin e quajtur Hudejbie, ku kurejshët i ndaluan të hynin në Mekë. Pejgamberi alejhi selam dërgoi një të deleguar te kurejshitët që t'i informonte se ata ishin nisur për umre. Pejgamberi alejhi selam i kërkoi Omerit të ishte ai i deleguari te kurejshët, por ai i tha se Uthmani ishte më i përshtatshëm për këtë mision, veçanërisht kur kurejshitët e donin dhe ai kishte njerëz që mund ta mbronin në Mekë. Pejgamberi alejhi selam i kërkoi Uthmanit të shkonte në Mekë që t'i bindte kurejshitët që t'i lejonin muslimanët të bënin umren. Kur Uthmani shkoi e filloi të fliste me Ebu Sufjanin, ai e shikonte Qabenë me mallëngjim, prandaj Ebu Sufjani i tha: "Mund të bësh tavafin, nëse do." Uthmani tha: "Nuk do ta bëj tavafin", ngase misioni për të cilin e kishte dërguar Pejgamberi alejhi selam ishte më i rëndësishëm se çdo gjë tjetër." Pejgamberi alejhi selam tha: "Pasha Allahun, edhe sikur të qëndronte në Mekë kaq e kaq vite, ai kurrë nuk do ta bënte tavafin derisa unë ta bëja atë."
Në mesin e muslimanëve u përhap lajmi se Uthmani ishte vrarë nga kurejshët. Atëherë, Pejgamberi alejhi selam kërkoi besën e muslimanëve që t'ia merrnin hakun Uthmanit. Muslimanët u ngritën dhe ia dhanë besën Pejgamberit alejhi selam nën një pemë. Secili vendosi dorën e tij mbi dorën e vëllait dhe Pejgamberi alejhi selam vuri dorën e tij dhe tha: "Ky është betimi i Uthmanit. Edhe ai po jep besën." Për këtë erdhi ajeti kuranor: "Vërtet, All-llahu qe i kënaqur me besimtarët kur ata nën hijen e atij druri të zotoheshin ty dhe Ai e dinte se ç'kishin zemrat e tyre, andaj u dhuroi qetësimin dhe së shpejti i shpërbleu me një fitore (çlirimin e Hajberit)" (El-Fet'h, 18)

Beteja e Tebukut

Kjo betejë quhet edhe beteja e vështirë, ngase ka ndodhur në kushte klimatike shumë të vështira. Beteja ndodhi pak para se të piqeshin të lashtat bujqësore. Numri i ushtrisë së muslimanëve arrinte në tridhjetë mijë ushtarë dhe ata kishin nevojë për ushqim, kafshë dhe gjëra të tjera. Ebu Bekri erdhi dhe solli tërë pasurinë e tij, ndërsa Omeri erdhi me gjysmën e pasurisë së tij, por prapë nuk ishte e mjaftueshme. Pejgamberi alejhi selam u ngrit në mimber dhe tha: "Kush përgatit ushtrinë e muslimanëve për betejën e vështirë, ai do ta ketë për shpërblim

xhenetin." Uthmani u ngrit dhe tha: "Unë po jap njëqind deve me shalë dhe tërë atë që ato kanë nevojë." Pejgamberi alejhi selam tha: "Allahu të shpërbleftë me mirësi! O Zot, fale Uthmanin dhe bëhu i kënaqur me të." Pastaj u ul Pejgamberi alejhi selam një shkallë nga mimberi i tij, ndërsa Uthmani tha: "Unë jap treqind deve me shalë dhe me tërë ato që ato kanë nevojë." Pejgamberi alejhi selam pas kësaj u lut për të dhe tha: "Nuk i bën më dëm Uthmanit asgjë në jetë pas kësaj." Kur Uthmani e dëgjoi këtë, tha: "O i Dërguari i Allahut, unë jap nëntëqind e pesëdhjetë deve me shalë dhe tërë atë që ato kanë nevojë, pesëdhjetë kuaj, shtatëqind copa ari dhe dhjetë mijë dinarë." Atëherë Pejgamberi alejhi selam filloi të përplaste duart e tij duke thënë: "O Zot, falja Uthmanit ato që ka bërë më parë dhe ato që do të bëjë më vonë."
Në të vërtetë, asgjë nuk i bëri më dëm në jetë. Ai vetëm përgatiti një të tretën e ushtrisë...

Vdekja e Pejgamberit alejhi selam

Kur Pejgamberi alejhi selam kaloi në fqinjësinë e Allahut xh.xh., Uthmani ishte njeriu që u mërzit më tepër për vdekjen e tij, deri në atë shkallë saqë sahabët e përshëndetnin, ndërsa ai vetëm i shikonte e nuk mund t'ua kthente përshëndetjen. Ai e donte Pejgamberin alejhi selam shumë. Ai u martua me dy bijat e Pejgamberit alejhi selam (njërën pas tjetrës). E sikur Pejgamberi alejhi selam do të kishte edhe një bijë të tretë, do t'ia jepte. Ai ishte personi nga i cili edhe engjëjt turpëroheshin. Allahu xh.xh. qoftë i kënaqur me të dhe e kënaqtë atë!

Qëndrimet e tij gjatë kalifatit të Ebu Bekrit

Uthmani ishte këshilltar i Ebu Bekrit gjatë kalifatit të tij. Së bashku me Omer bin Hatabin, Aliun, Talhan, Zubejrin, Sad bin Ebij Vekasin dhe Ebu Ubejde bin Xherrahun ishin trupi këshillues i kalifit të muslimanëve, Ebu Bekrit, Allahu qoftë i kënaqur me të. Ata e shoqëronin Ebu Bekrin me kërkesën e tij dhe nuk largoheshin nga ai asnjëherë.
Pasi Ebu Bekri i dha fund problemit të luftës kundër atyre që filluan të largoheshin nga Islami, ushtritë muslimane filluan të çlirojnë Irakun dhe Shamin. Ebu Bekri dërgoi Ebu Ubejden El-Xherrahun, Zubejrin, Sad bin Ebij Vekasin dhe Aliun në krye të ekspeditave, kurse Uthmanin dhe Omerin i mbajti në Medinë.

Më dha çmim më të lartë se ju
Në kohën e Ebu Bekrit, Medinën e zuri një thatësirë dhe uri e madhe. Njerëzit po vdisnin nga uria. Në këtë kohë erdhi karvani i Uthmanit nga tregtia, një karvan me një mijë kafshë të ngarkuara me ushqim. Sapo arriti karvani në afërsi të Medinës, tregtarët e Medinës filluan t'i jepnin ofertat e tyre Uthmanit, duke i thënë se i jepnin 12 për 10. Uthmani u tha: "Më ka dhënë çmim më të lartë dikush tjetër." Ata filluan ta ngrenë çmimin derisa arritën në 14 për 10, por Uthmani sërish u tha: "Më ka dhënë më shumë dikush tjetër." Në fund ata i ofruan 15 për 10, por prapë Uthmani u tha: "Më ka dhënë çmim më të madh se ky që po më ofroni, më ka ofruar për çdo dërhem dhjetë dërhemë." Tregtarët i thanë: "Pasha Allahun, ne nuk mund të të japim më shumë sesa të dhamë." Uthmani ua ktheu: "Dëshmoni se një mijë kafshë të ngarkuara me artikuj ushqimorë janë sadaka për banorët e Medinës."

Betimi i tij
Uthmani vazhdoi të jetë këshilltar i sinqertë i kalifit të parë, Ebu Bekrit, dhe i Omer bin Hatabit. E kur Omeri u godit tinëzisht nga Ebu Luluja, ai nuk deshi ta zgjidhte vetë kalifin e muslimanëve, por propozoi gjashtë persona nga mesi i të cilëve duhet të zgjidhej kalifi i muslimanëve. Ata persona ishin: Uthman bin Afani, Aliu, Abdurrahman bin Oufi, Talha, Zubejri dhe Sad bin Ebi Vekasi. Këta të gjashtë duhet të vendosnin se kush do të ishte kalifi i ardhshëm. Omeri urdhëroi Suhejb Er-Rumin që të ishte imam i muslimanëve derisa të zgjidhej kalifi i muslimanëve. Kalif i muslimanëve u zgjodh Uthmani, i cili u ngrit në mimber dhe mbajti një ligjëratë duke iu drejtuar njerëzve: "Dijeni se unë jam obliguar dhe pranova, por dijeni se unë do të ndjek rrugën e nuk do të jem bidatxhi. Do të ndjek urdhrat e Allahut xh.xh., traditën e Pejgamberit alejhi selam dhe traditën e kalifëve para meje. Dijeni se dynjaja është e gjelbër dhe tërheqëse për njerëzit, prandaj shumë njerëz anuan nga ajo. Mos anoni nga dynjaja e as mos u magjepsni prej saj, se ajo nuk është e sigurt dhe e besueshme. Në të nuk kalohet ndryshe vetëm se nëse e lë anash (duke mos qenë prioritet në jetë)."

Gjendja e përgjithshme e muslimanëve

Kur Uthmani u zgjodh kalif, gjendja ishte si më poshtë:
1- U zhduk shteti i Persisë;
2- U dëbuan bizantinët nga tokat e Shamit dhe të Egjiptit;
3- Morën fund të gjitha dukurive raciste, padrejtësive dhe diferencimit social;
4- Muslimanët dhe të tjerët jetuan të qetë e pa brenga, të garantuar nga garancitë e Islamit, ku liria e besimit ishte e garantuar për të gjithë;
5- U asgjësuan thirrjet raciste e fisnore;
6- Umeti islam tashmë admironte fitoret.

Mesazhet drejtuar umetit
Kur Uthmani mori postin e kalifit, ai i drejtoi umetit tre mesazhe, ku thuhej:

Mesazhi i parë
"O ju njerëz, vërtet ju jeni në kala dhe në jetën tuaj ende keni ymër, prandaj nxitoni në të mirë sa të mundeni. Dijeni se dynjaja është pleksur me mashtrim: **"Mos t'ju mashtrojë juve jeta e dynjasë, e mos t'ju mashtrojë për Zotin askush."** Merrni mësim prej atyre që kanë shkuar, se sa punëtorë ishin e mos u hutoni, ngase Allahu është vigjilent ndaj jush. Ku janë bijtë e dynjasë dhe vëllezërit e tyre? Ku janë ata që preferuan dynjanë, e ndërtuan atë dhe u kënaqën me të për një kohë të gjatë? A nuk u larguan nga kjo jetë? Hidheni dynjanë aty ku e ka hedhur Allahu dhe kërkoni ahiretin. Merrni shembull prej asaj që tha Allahu: "E ti (Muhamed) paraqitja atyre shembullin e kësaj bote, që është si një ujë (shi) që Ne e lëshojmë nga qielli, e prej tij bima e tokës zhvillohet e shpeshtohet sa që përzihet mes vete, e pas pak ajo bëhet byk (pas tharjes) që e shpërndajnë erërat. All-llahu ka fuqi për çdo send, pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote, kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë." (El-Kehf, 45-46)

Në mesazhin e dytë, të cilin ua dërgoi komandantëve dhe ushtarëve, thuhej:
"Ju jeni mbrojtësit e muslimanëve. Omeri ka vendosur për ju (rregulla dhe të drejta) me dijen tonë. Atë e bëri në publik, para nesh. Mos më lajmëroni për ndonjë ndryshim a ndërrim, lëreni që Allahu t'jua

ndryshojë veten tuaj e t'ju ndërrojë me dikë tjetër. Shikoni se si do të jeni. Vërtet, unë shikoj atë që Allahu më urdhëron të bëj."

Në mesazhin e tretë, të cilin ua drejtoi atyre që jetonin në vende të largëta, thuhej:
"Unë kam marrë punëtorë që të më përcjellin raportet çdo sezon. I kam urdhëruar në të mirë dhe i kam ndaluar nga e keqja. Nuk ka ndonjë kërkesë që bëhet te punëtorët e mi e që unë të mos i përgjigjem asaj. As unë e as fëmijët e mi nuk gëzojmë pagesë si populli im. E kush ka ndonjë ankesë, le të ma dërgojë në sezon."

Çlirimet në kohën e Uthmanit
Omeri i kishte dërguar ushtritë e muslimanëve në Irak dhe në Sham. Në dhjetë vitet e kalifatit të Uthmanit rrjedha e xhihadit të muslimanëve nuk u ndal. Ky xhihad u ndal vetëm në dy vitet e fundit të sundimit të Uthmanit. Çlirimet në kohën e Uthmanit përqendroheshin në tre fronte: Fronti lindor, fronti perëndimor dhe fronti detar.

Fronti lindor
Ushtria e këtij fronti u përqendrua në dy vende: Kufe dhe Basra. Në Kufe gjendeshin gjashtë mijë muxhahidë nën komandën e Said bin El-Asit, të cilët u nisën në drejtim të Teheranit të sotëm, Azerbajxhanit dhe Armenisë. Kur arritën në kufijtë e këtyre vendeve, komandanti i muslimanëve kërkoi nga kalifi i besimtarëve që t'i dërgonte Hasanin dhe Husejnin, Abdullah bin Abasin, Abdullah bin Mesudin, Abdullah bin Omer bin Hatabin dhe Abdullah bin Amr El-Asin. Për një vit ata çliruan Teheranin, Azerbajxhanin dhe Armeninë, në vitin 26 të hixhrit.
Kurse në zonën e Basrës ishin katër mijë muxhahidë nën komandën e El-Velijd bin Ukbe ibn Ukmbe bin Ebij Muit, i cili e keqtrajtonte Pejgamberin alejhi selam në Mekë. Kjo ushtri u nis në drejtim të Horasanit dhe të Afganistanit.

Fronti perëndimor
Në këtë front përfshiheshin Egjipti dhe Shami. Komandantë të këtij fronti ishin Muavi bin Ebu Sufjani në Sham dhe Amr bin El-Asi në

Egjipt. Më vonë vali i Egjipti u zgjodh Abdullah bin Sad bin Ebij Es-Sarhu.
Muaviu u nis në drejtim të Umejries, në jug të Ankarasë, kurse Abdullah bin Sain bin Ebij Es-Sarhu u nis drejt qytetit të Tunisit. Ushtria e muslimanëve ishte në kufijtë e Tripolit të Libisë në kohën kur vdiq Omer bin Hatabi, Allahu qoftë i kënaqur me të. Ushtria armike në Tunis numëronte 120 mijë ushtarë, kurse komandanti musliman Abdullah bin Said bin Ebij Es-Sarhu kishte vetëm njëzet mijë luftëtarë. Ai kërkoi nga kalifi i muslimanëve që t'i dërgonte disa sahabë të Pejgamberit alejhi selam, që me ndihmën e tyre të çlironin Tunisin. Kalifi i nis Hasanin e Husejnin, Abdullah bin Zubejrin dhe Ebu Dherr El-Gafariun. Allahu xh.xh. ua dha fitoren muslimanëve. Abdullah bin Zubejri kërkoi nga tridhjetë kalorës muslimanë që t'ia mbronin shpinën dhe u nis drejt vendqëndrimit të komandantit të ushtrisë armike. Ai e vrau atë, ushtria armike u shpërnda dhe muslimanët fituan.

Fronti detar
Muaviu kërkoi nga Omer bin Hatabi, kalifi i muslimanëve, që t'i jepte leje të ndërtonte flotën detare. Omeri e pyeti Amr bin El-Asin për detin dhe i tha t'ia përshkruante atë. Amri i tha: "Deti është diçka madhështore. Kur futesh në të, ndihesh i vogël. Ata që futen në det janë si krimbat në degë. Kur është i qetë, prehen zemrat. Kur tërbohet, tronditen mendjet. Të sigurtin në të e përshkon dyshimi." Omeri i tha: "Jo, pasha Allahun që dërgoi Muhamedin alejhi selam me të vërtetën, nuk i bëj të futen në të muslimanët!"
Kur Uthmani u bë kalif i muslimanëve, Muaviu sërish kërkoi leje nga kalifi që të ndërtonte flotën. Uthmani i dha leje ta ndërtonte, me kusht që mos të detyronte askënd që të hipte në anije. Flota detare u ndërtua dhe me të u çlirua Qiproja. Pastaj pasoi beteja e anijeve, ku muslimanët dolën fitimtarë.

Arritjet e Uthman bin Afanit

Tubimi i Kuranit
Pas betejës së Jemames dhe pas rënies dëshmorë të hafizëve të Kuranit, Omer bin Hatabi e këshilloi Ebu Bekrit ta mblidhte Kuranin në një vend.

Ebu Bekri në fillim hezitoi ta bënte këtë, por së shpejti u kuptua se ishte veprim i arsyeshëm dhe dha urdhër që të mblidhet Kurani në një vend.
Në kohën e Uthmanit, kufijtë e shtetit musliman ishin të gjerë, shumë popuj të rinj hynë në Islam dhe doli në pah problemi i gjuhëve. Rreth leximit të Kuranit nisën të paraqiteshin mospërputhje. Uthmani dërgoi dikë te Hafsa, bija e Omerit, dhe kërkoi nga ajo që t'ia jepte Kuranin dhe të shkruante prej tij disa kopje. Uthmani urdhëroi katër djem të rinj ta kopjonin në disa kopje dhe nëse gjatë kopjimit do të kishin ndonjë problem në lexim, le ta shkruanin në dialektin kurejshit. U shkruan shtatë kopje të Kuranit dhe u dërgua një kopje në Mekë, një në Sham, një në Kufe, një në Basra, një në Jemen dhe një në Medinë. Uthmani dha urdhër që kopjet e tjera, të cilat nuk përputheshin me këto kopje, të digjeshin.
Me mposhtjen e dy superfuqive të asaj kohe, Bizantit dhe Persisë, nuk ishte parësore armatosja e ushtrisë dhe gjendja e mobilizimit, por zgjidhja e problemeve sociale. Njerëzve të varfër tani u jepeshin pagesa të rregullta mujore nga buxheti i shtetit. Çdo muslimani i jepej një dërhem në ditë në muajin e Ramazanit, kurse nënave të muslimanëve dy dërhemë.

Parashenjat e fitnes

Kështu kaluan dhjetë vite të kalifatit të Uthmanit, vite që shquheshin për arritjet e mëdha, për stabilitetin ekonomik dhe për jetën luksoze të paparë nga muslimanët dhe ata që jetonin në shtetin musliman.
Por dy vitet e fundit të kalifatit të Uthmanit ishin dy vitet më të vështira të sundimit të tij. Në këto dy vite ndodhi fitneja që përfundoi me rënien e tij dëshmor. Kjo fitne iniciativën e pati në Kufe, në Basra dhe në Egjipt. Kalifit të muslimanëve nisën t'i drejtoheshin akuza me arsyetimin se kishte shkarkuar nga detyra disa vali me kërkesën e njerëzve. Njerëzit filluan të thoshin se kalifi u jepte të afërmve të vet nga pasuria e muslimanëve si dhe akuza të tjera të pabaza. Por cili ishte shkaku kryesor i këtyre akuzave? A mos ishte shkak dobësia e personalitetit të kalifit? A është e vërtetë që Uthmani u lejoi të afërmeve të vet të keqpërdorin pasurinë e muslimanëve?
E vërteta është se fitneja nuk ka të bëjë fare me personalitetin e Uthmanit. Stabiliteti i dhjetë viteve është argument i gjallë se ai ishte personalitet shumë i rrallë dhe kompetent. Nuk është çështje dallimi mes

personalitetit të Omerit dhe të Uthmanit, siç thonë disa njerëz, të cilët mundohen ta ilustrojnë kështu fitnen dhe shkaqet e saj.
Çdo populli i ndodhin ndryshime ekonomike e sociale dhe kjo detyrimisht shkakton edhe ndryshime në mendjet dhe sjelljet e njerëzve. Ky umet në kohën e Uthmanit në aspektin e kufijve gjeografikë, në standardin ekonomik dhe në nivelin kulturor arriti atje ku nuk kishte qenë ndonjëherë më parë. Umeti patjetër do të përjetonte ndryshim. Çlirimet dhe hapjet e territoreve të reja sollën një numër të madh muslimanësh të rinj nga shumë vende të botës. Shumë popuj të tërë pranuan Islamin, popuj të cilët kishin traditat dhe kulturën e tyre. Shumë prej tyre nuk dinin sa duhet për Islamin, madje kishte njerëz të tillë që kishin hyrë në radhët e Islamit qëllimisht për komplote. Disa persianë dhe bizantinë kishin pranuar Islamin me qëllim armiqësie, pasi ndjenin ende dhimbjen e humbjes së Bizantit ose të Persisë nga muslimanët. Ata u futën në radhët e muslimanëve me qëllim që ta shkatërronin shtetin islam nga brenda.
Fitneja filloi me një person që quhej Abdullah bin Sebe, i cili ishte nga Sana e Jemenit. Ai ishte çifut dhe hiqej sikur kishte pranuar Islamin. Ai shkoi në Medinë, pastaj në Sham, pastaj në Basra, në Kufe dhe më vonë edhe në Egjipt. Gjatë udhëtimeve të tij ai mbillte fitne. E vërteta është se Abdullah bin Sebe nuk ishte vetëm, atë e mbante dhe e përkrahte shteti i Bizantit. Abdullah bin Sebe shkonte kudo në vendet muslimane dhe në betejat e ndryshme. Ai ishte i pranishëm edhe në betejën e anijeve, pasi si dukej u jepte informacione bizantinëve nga fronti i muslimanëve. Dihej se ai ishte i varfër, e më vonë filloi t'u shpërndante pasuri njerëzve që e pasonin.
Abdullah bin Sebe është personi që personifikon hipokritin që hyri në mesin e muslimanëve me qëllim që të thurte komplote kundër muslimanëve. Ai shkoi së pari në Medinë e pastaj edhe në Sham, por nuk pati sukses të mbillte farën e fitnes atje. Për këtë qëllim, ai shkoi në Kufe e pastaj edhe në Basra, ku përmes dinakërisë dhe dhelpërisë arriti të mbillte fitne në mesin e njerëzve. Pastaj ai shkoi në Egjipt dhe filloi të shpifte kundër kalifit të besimtarëve. I tërë mundi i tij përqendrohej në sajimin e tregimeve dhe ngjarjeve që nuk ishin të vërteta. Ai përhapi fjalë se kalifi e kishte rrahur Amar bin Jaserin shumë, por e vërteta ishte se Amar bin Jaseri kishte pasur një konflikt me Ukde bin Ebij Lehebin, kurse kalifi i muslimanëve i kishte edukuar që të dy. Ai sajoi shumë

gjëra me qëllim që t'i nxiste njerëzit kundër kalifit. E vërteta është se Amar bin Jaseri qe ai që vuajti më shumë kur ia prenë ujin kalifit në çastet e fundit të jetës së tij.

Çështja e dërgimit të Ebu Dherrit në mërgim

Ndër akuzat që iu bë Uthmanit ishte edhe çështja e dërgimit të Ebu Dherrit në mërgim. Ebu Dherri ishte shumë i ashpër në të vërtetën, për të cilën ai nuk i frikësohej askujt përveç Allahut. Pejgamberi alejhi selam thotë: "As në maja të larta e as në lugina nuk mund të gjendet dikush që ka shprehje më të sakta e më të sigurta sesa shprehjet e Ebu Dherrit."
Në kohën e Uthman bin Afanit pasuria në duart e njerëzve u shtua dhe Ebu Dherri filloi t'u flasë e t'u thoshte se ai që ka më shumë se nevoja e tij e përditshme, është monopolist (mukteniz). Ai shkoi në Sham dhe filloi ta thoshte përherë Fjalën e Allahut: "Ata që depozitojnë arin dhe argjendin e nuk e shpenzojnë atë në rrugën e Allahut..." (Tevbe 34)
Muaviu vërejti se Ebu Dherri po u fliste njerëzve me ashpërsi dhe ndjeu se kjo mund të sillte ndonjë problem, prandaj i shkroi Uthmanit dhe Uthmani i dha urdhër Muaviut që ta kthejë Ebu Dherrin në Medinë në mënyrë të respektuar. Kur arriti në Medinë, Ebu Dherri tha: "Mos u ngute pak me mua, o Uthman." Uthmani i tha: "Desha që të jesh krahas sahabëve të Pejgamberit alejhi selam dhe pranë tij. U frikësova për ty nga injorantët në Sham." Ebu Dherri qau dhe tha: "Pasha Allahun, o Uthman, sikur të më kishe urdhëruar të vija duke ecur me kokë nga Shami në Medinë, do të të bindesha dhe do të të dëgjoja. Sikur të më kishe urdhëruar të vija në gjunjë nga Shami në Medinë, do të vija dhe do ta dëgjoja fjalën tënde. Pasha Allahun, o Uthman, ndoshta je frikësuar se mund të jem shkak i fitnes. Pasha Allahun, o Uthman, asnjëherë nuk e bëj atë. Desha të jem pranë teje dhe pranë Pejgamberit alejhi selam."
Pastaj ai kërkoi nga kalifi që t'i jepte leje të shkonte në Xheda dhe Uthmani ia dha lejen. Ebu Dherri vdiq rrugës për në Xheda.

Akuza se ka djegur mus'hafët

Në mesin e akuzave që i bëhen Uthmanit është se ai ka djegur mus'hafët, ndërsa Aliu për këtë ka thënë: "Pasha Allahun, Uthmani e bëri një gjë të tillë para të gjithë sahabëve."
Të gjithë e panë se ç'po bënte e askush prej tyre nuk e kundërshtoi, ngase ajo që ai bëri ishte në dobi të muslimanëve. Uthmani u akuzua se u

jepte të afërmve të vet shumë dhurata dhe i vendoste në pozita e poste. Realiteti është se pozitat dhe postet e Beni Umejes ishin pozita që i kishin para se Uthmani të vinte në post, që nga koha e Omerit. Muaviu, fjala vjen, u emërua vali i Shamit në kohën e Omerit dhe kjo është çështje aftësie e jo afërsie. Kurse sa i përket bërjes së dhuratave të afërmve të vet, Aliu tregon: "Allahu e mëshiroftë Uthmanin, pasi ai i mbante më shumë lidhjet e tij të gjakut, madje më shumë se çdo sahab." E nëse Uthmani u jepte dhurata, ato ua jepte nga pasuria e tij dhe të gjithë e dinë se sa i pasur ishte Uthmani.

Akuza për bidate

Prej kurtheve të liga të Ibni Sebes ishte se Uthmani kishte bërë bidate në fe. Ndër bidatet për të cilat akuzohej ishte se ishte ngritur në mimber. Dihet se Pejgamberi alejhi selam kishte një mimber prej tri shkallësh në xhami dhe ai ngjitej deri në shkallën e tretë. Kur u bë Ebu Bekri kalif i muslimanëve, ai u ndal e qëndroi në shkallën e dytë, kurse Omeri u ndal në shkallën e parë. E kur Uthmani u bë kalif, ai ngjitej në shkallën e tretë. Sikur edhe Uthmani të shkonte një shkallë më poshtë se Omeri, kjo do të thotë se ai duhej të qëndronte në tokë, në një kohë kur dihet se xhamia ishte zgjeruar dhe numri i njerëzve ishte shtuar shumë, prandaj ishte e domosdoshme që Uthmani të ngjitej në shkallën e tretë që ta shihnin njerëzit dhe ai t'i shihte ata.
Uthmani akuzohet se ka shpikur çështjen e dy ezanëve në ditën e xhuma. E vërteta është se numri i njerëzve ishte shtuar shumë në Medinë dhe me qëllim që të gjithë ta dëgjonin ezanin dhe të shkonin në namazin e xhumasë, Uthmani tha që të thirret edhe ezani i dytë.
Në mesin e shpifjeve ndaj Uthmanit është se ai ka ikur nga lufta e Bedrit, se ka ikur edhe nga lufta e Uhudit dhe se nuk kishte marrë pjesë në besëlidhjen Ridvan nën pemë, atëherë kur sahabët i dhanë besën Pejgamberit alejhi selam se do t'i luftonin kurejshitët në Hudejbie.
Sa i përket mospjesëmarrjes së tij në betejën e Bedrit, dihet se vetë Pejgamberi alejhi selam i kërko të rrinte pranë bashkëshortes së tij, Rukies, bijës së Pejgamberit alejhi selam, ngase ajo ishte e sëmurë për vdekje. Ndërsa sa i përket luftës së Uhudit, ai veproi siç vepruan shumë sahabë, të cilëve Allahu ua ka falur. Sa i përket besëlidhjes së Ridvanit, dihet se Uthmani ishte në Mekë i zënë rob nga kurjeshitët dhe vetë

Pejgamberi alejhi selam ngriti dorën e tij dhe tha se kjo dorë ishte për betimin e Uthmanit.
Abdullah bin Sebe u përqendrua në tri pika për ta shkatërruar shtetin musliman. Së pari, në mbjelljen e dyshimit për kalifin e muslimanëve, Uthmanin. Së dyti, në nxitjen e masës së gjerë që të rebeloheshin kundër valive dhe udhëheqësve të tyre.
Së treti, në kërkimin e izolimit të kalifit nga posti.
Të gjitha këto ai i bënte nën mbulesën e "urdhërimit në të mirë dhe ndalesës nga e keqja".
Fillimi i fitnes ishte në Kufe. Valiu i Kufes ishte El-Velijd bin Ukbe, i cili zbatoi ligjin ndëshkues të sheriatit kundër disa të rinjve të Kufes që kishin pirë alkool. Ata ranë dakord që të gjenin disa persona të afërm të tyre që ishin simpatizues të Sebes dhe të dëshmonin padrejtësisht kundër valiut, se gjoja edhe ai kishte pirë alkool. Atëherë Uthmani e largoi atë nga posti dhe e ndëshkoi me sheriat siç ndëshkohet ai që pi alkool. Si vali të Kufes ai emëroi Said bin El-Asin, por ata e refuzuan valiun e ri. Ky u kthye dhe e informoi Uthmanin se ata kërkonin për vali Ebu Musa El-Eshariun. Atëherë Uthmani emëroi Ebu Musain si vali të Kufes, që t'ua printe rrugën pretendimeve të tyre. Pastaj Uthmani u dërgoi një shkresë, pasi ua kishte plotësuar kërkesat e tyre.

Shkresa e Uthmanit

"Pas falënderimit të Allahut dhe salavateve mbi Pejgamberin alejhi selam: Unë kam emëruar vali tuajin atë që ju keni zgjedhur dhe kam larguar valiun e mëparshëm, Saidin. Për Allahun xh.xh., po ju shtroj juve ofertën time dhe ju ofroj durimin tim që të bëj përmirësime në mesin tuaj me përpjekjet e mia, por mos kërkoni prej meje ndonjë gjë që ju e doni e në të ka ndonjë gjë që kundërshton urdhrin e Allahut. Nëse jo, atëherë çdo gjë do t'jua jap, që të mos keni argument ndaj meje."
Abdullah bin Sebe filloi ta komentonte shkresën e Uthmanit larg asaj që Uthmani kishte dashur të thoshte, me qëllim që t'i nxiste njerëzit kundër Uthmanit. Ky lajm arriti në Medinë te kalifi. Sahabët e rangut të madh u mblodhën për ta këshilluar Uthmanin se si të vepronte në këtë aspekt. Ata e këshilluan që të dërgonte disa prej sahabëve të dalluar që të bisedonin me ta në mënyrë që t'i udhëzonin në rrugën e drejtë. Uthmani dërgoi Amar bin Jaserin në krye të disa sahabëve në Egjipt dhe

Muhamed bin Muselemen me dy sahabë në Kufe, kurse Abdullah bin Omerin në Sham. Në Basra ai dërgoi Usame bin Zejdin. Kur shkuan të gjitha delegacionet në vendet ku ishin dërguar, ata gjetën se çdo gjë është në rregull dhe nuk kishte ndonjë çrregullim. Siç dihet, rebelët kishin vepruar qëllimisht në këtë mënyrë me qëllim që të mos dukej ndonjë ndryshim në jetën e muslimanëve, ngase sikur sahabët do të bisedonin me dikë, ata do të ndryshonin mendimet e tyre, prandaj qëllimisht nuk lanë që të vërehet asnjë shenjë revolte ose rebelimi. Pas kësaj, Uthmani filloi t'i mblidhte valitë e tij nga vendet e ndryshme që të bisedonte me ta për gjendjen në vendet ku ata sundonin, pasi i kishte dërguar sahabët. Njëri prej valive i tregoi se si duket rebelët ishin duke përgatitur diçka në fshehtësi. Said bin El-Asi e këshilloi Uthmanin që të dërgojë në çdo vend nga një njeri për të zbuluar se kush qëndronte në krye të këtyre grupeve dhe të vritej. Uthmani i tha se ky ishte mendim i mirë, por nuk mund ta bënte një gjë të tillë sepse i kishte premtuar Pejgamberit alejhi selam se do të bënte durim ndaj tyre.
Gjendja mbeti e pandryshuar deri në vitin 35 pas hixhretit. Në muajin e haxhit, kur muslimanët nga të gjitha vendet muslimane u nisën për në haxh, rebelët u nisën për në Mekë me qëllim rebelimi, por shkuan atje në grupe të vogla që të mos bien në sy. Pastaj, në vend që të shkonin në Mekë për haxh, ata ndryshuan drejtimin e tyre dhe shkuan në Medinë që të rrethonin Medinën dhe të detyronin kalifin të jepte dorëheqje, ose edhe ta vrisnin atë. Këto grupe u nisën nga Egjipti, Kufeja, Basra dhe nga vendet e tjera. Secili prej këtyre vendeve kishte nga katër grupe, secili grup kishte 150 persona, gjithsej numri i tyre ishte një mijë e tetëqind veta. Rebelët iu afruan Medinës afërsisht 3 kilometra dhe shumica e sahabëve që jetonin në Medinë kishin shkuar në Mekë për haxh.
Deri në këtë kohë Abdullah bin Sebe punonte pas perdes. Ai arriti të bënte që secili grup të propozonte ndonjë person për kalif, fjala vjen banorët e Kufes donin të zgjidhnin Zubejrin, ndërsa Basra dëshironte Talhan, ndërsa grupi i Egjiptit dëshironin që kalif të zgjidhej Aliu. Qëllimi i Ibni Sebes nuk ishte vrasja e Uthmanit, por shkatërrimi i Islamit. Ai dëshironte që muslimanët të mos pajtoheshin mes tyre pas vrasjes së Uthmanit dhe të luftonin kundër njëri-tjetrit.
Uthmani dërgoi Ali bin Ebi Talibin që të fliste me ta dhe Aliu u tha: "Mirëbërësit nga radhët e muslimanëve e dinë se kjo ushtri është

mallkuar nga goja e Pejgamberit alejhi selam. Kthehuni nga këtu, ju nuk keni kujdesin dhe mirësinë e Allahut.” Kur panë se Aliu kishte veshur kapelën e Pejgamberit alejhi selam, kishte ngjeshur shpatën dhe me të ishin edhe disa sahabë që ishin gati t’i luftonin, nëse ata do të hynin në Medinë, atëherë bënë sikur po ktheheshin nga kishin ardhur.

Aliu mbeti në Medinë, ngase e ndiente se fitneja nuk do të përfundonte me kaq. E në të vërtetë ashtu ngjau. Banorët e Medinës u befasuan kur i panë rebelët nëpër rrugët e Medinës. Kur banorët e Medinës i pyetën përse ishin kthyer në Medinë dhe nuk kishin shkuar në vendet e tyre, ata thanë se kishin zbuluar se Uthmani kishte dërguar një të deleguar në Egjipt dhe i kërkonte atij që t’ua priste atyre krahët dhe këmbët e t’i vendoste në trungjet e hurmave kur të ktheheshin. Ata thoshin se letra kishte vulën e Uthmanit, prandaj ishin kthyer në Medinë. Nëse kjo që po thoshin rebelët e Egjiptit ishte e vërtetë, atëherë kush i lajmëroi ata të Kufes dhe të Basrës për këtë çështje? Kjo vërteton se komploti ishte thurur pas perdeve dhe letra e Uthmanit nuk ishte tjetër vetëm se shpifje e tyre. Rebelët filluan t’i afroheshin xhamisë së Pejgamberit alejhi selam dhe shtëpisë së kalifit. Atëherë kalifi mblodhi sahabët dhe ata i thanë se duhet t’i luftonin, por Uthmani e refuzoi mendimin e tyre. Në këtë çast hyri Zejd bin Thabit El-Ensariu dhe tha: “Ensarët kanë veshur rrobat e luftës. Ne ishim ensarët (përkrahësit) e Pejgamberit alejhi selam e sot dëshirojmë të jemi ensarët e kalifit. Le të jemi dy herë ensarë. Na lejo të dalim e t’i luftojmë.” Por Uthmani u tha: “Jo, pasha Allahun, nuk e bëj një gjë të tillë!”

Kurse Muavije bin Ebu Sufjani i dërgoi misionarë nga Shami dhe kërkoi nga kalifi që ai të shkonte në Sham, por Uthmani tha: “Nuk dua ta lë fqinjësinë me Pejgamberin alejhi selam e as nuk dua që të thonë se kalifi e la Medinën i frikësuar.” Ai kërkoi nga kalifi që të dërgonte ushtri që ta mbronin Medinën, por kalifi e refuzoi edhe këtë propozim me qëllim që të mos lejonte luftën mes muslimanëve në Medinën e Pejgamberit alejhi selam dhe nuk dëshironte t’i tmerronte banorët e Medinës.

Ali bin Ebi Talibi nisi të bënte përgatitje në Medinë dhe u përpoq ta bindte Uthmanin që të luftonin, por Uthmani e refuzoi opsionin e luftës. Atëherë Aliu dhe Talha i ofruan Uthmanit tre opsione të tjera: Ose të vishte ihramin, ose të shkonte në Sham, ose t’u jepte leje t’i luftonin, por prapëseprapë Uthmani nuk pranoi asnjë nga opsionet. Përgjigjja e

Uthmanit ishte siç thuhet në shkresën e tij: “Bismilahi Rrahmani Rrahim!

Kam marrë në konsideratë këshillimin tuaj. Çdo çështje ka derën e saj, edhe kjo çështje e ka derën e saj- butësi e tolerancë. Nëse kjo derë hapet, bën punë, atëherë le të hapet dhe atëherë askush nuk ka ndonjë argument kundër meje.”

Aliu tha: “O Zot, dëshmo se unë kam dhënë mundin tim!”

Kjo fjalë ishte njëzet ditë para se rebelët të hynin në Medinë.

Rrethimi i shtëpisë së kalifit filloi të ngushtohet deri në atë shkallë sa Uthmani nuk gjente ushqim për të ngrënë dhe ujë për të pirë. Uthmani i përbeu në Allahun që t’i jepnin ujë për të pirë, e ata i dhanë ujë të ndotur. Nënat e besimtarëve u përpoqën t’i dërgonin ujë për të pirë. Umu Habibeja, bashkëshortja e Pejgamberit alejhi selam, tentoi t’i dërgonte ujë, por ia këputën shalën e mushkës së saj dhe e rrëzuan nga mushka. Gruaja e Pejgamberit alejhi selam u rrëzua dhe banorët e Medinës e ngritën teksa ajo ishte pranë vdekjes. Në këtë kohë, djemtë e sahabëve, në krye të të cilëve ishin Hasani e Husejni, Abdullah bin Omeri dhe Abdullah bin Zubejri, ruanin derën e shtëpisë së kalifit nga rebelët e nuk i linin të hynin.

Uthmani dilte të falte namazin me muslimanët dhe një ditë filluan ta pengonin edhe kur shkonte për namaz. Një ditë, madje ata i hoqën edhe shkopin me të cilin ecte. Ai ishte shkopi i Pejgamberit alejhi selam, por ata ia thyen në këmbë dhe një copë e shkopit i hyri në kofshë dhe i filloi gjakderdhja. Uthmani pas këtij dëmtimi jetoi në një rrethim të rreptë, duke mos pasur mundësi të shkonte as në xhami për namaz.

Ligjërata e fundit e Uthmanit

Uthmani hyri në xhami dhe pyeti: “A ka në xhami sahabë të Pejgamberit alejhi selam?” I thanë se po dhe ai vazhdoi: “A është Aliu?” Thanë: “Po.” Pyeti: “A është Zubejri?” Thanë: “Po.” Tha: “A është Talha?” Thanë: “Po.” Tha: “A më dëgjon, oj nëna e besimtarëve, Aishe?” Heshtën njerëzit. Ai tha: “Ju betohem në Islam, a e dini se Pejgamberi alejhi selam ka thënë: “Kush e blen pusin e ujit Ruma që muslimanët të pinë ujë, ai person do të ketë pus të ngjashëm në xhenet”? E kam blerë atë me pasurinë time dhe muslimanëve ua kam dhënë ujin falas. Pejgamberi alejhi selam atëherë u gëzua dhe më tha se me këtë ke xhenetin. Ju përbej në Allahun dhe në Islamin, a e kam bërë këtë?”

Sahabët thirrën njëzëri: “Po, pasha Allahun!” Tha: “O Allah, të falënderoj! Sot ju më ndaloni të pi një pikë ujë dhe më jepni të pi ujë deti... A e dini se Pejgamberi alejhi selam ka thënë: “Kush e zgjeron shtëpinë e Allahut, ai do të ketë një shtëpi në xhenet”? Atëherë e bleva shtëpinë e filanit dhe zgjerova xhaminë e Pejgamberit alejhi selam. Sot ju më ndaloni e nuk më lejoni të falem në xhaminë e Pejgamberit alejhi selam. Ju përbej në Allahun xh.xh. dhe në Islam, a ju kujtohet kur Pejgamberi alejhi selam u ngrit në mimberin e tij dhe tha: “Kush e përgatit ushtrinë e Tebukut?” Nuk pat kush që ta bënte dhe unë thashë se do t’a përgatisja ushtrinë muslimane për në Tebuk. Atëherë Pejgamberi alejhi selam tha: “Nuk i bën dëm më Uthmanit asgjë, çfarëdo që të bëjë pas ditës së sotme.” Sahabët thanë: “Po, pasha Allahun, ashtu është.” Uthmani tha: “Ju përbej në Allahun e ju më ndaloni të dal në mimberin e Pejgamberit alejhi selam.”

Kur u zuri be në Allah dhe në Islam, njerëzit filluan të qanin dhe Ibni Zubejri tha: “A keni dëgjuar se Pejgamberi alejhi selam ka thënë: “Uthmani është i dashuri im në xhenet!” Zubejri tha: “Dëshmoj se Pejgamberi alejhi selam ashtu ka thënë.” Pastaj Uthmani tha: “Të përbej në Allahun dhe në Islamin! A të kujtohet, o Talha, kur Pejgamberi alejhi selam thoshte: “Le të marrë secili për dore atë që është afër tij”, e Pejgamberi alejhi selam më merrte mua për dore dhe thoshte: “Uthmani është ai që do të ulet pranë meje në dynja dhe në xhenet.” Talha ia ktheu: “Po, pasha Allahun!”

Uthmani tha: “Ju përbej në Allahun dhe në Islamin. A e keni dëgjuar Pejgamberin alejhi selam kur ishte në kodrën e Uhudit dhe tha: “Pusho, qetësohu o Uhud! Mbi ty sot janë Pejgamberi alejhi selam, Es-Sidiku, dhe dy dëshmorë. Es-Sidiku është Ebu Bekri, shehidi i parë ishte Omeri, ndërsa unë jam i dyti.” Thanë: “Po, pasha Allahun! Dëshmojmë për këtë.” Atëherë Uthmani tha: “Allahu Ekber! O Allah, të falënderoj, muslimanët dëshmuan për dëshminë (shehaden) time.” Pastaj tha: “Të përbej në Allah dhe në Islam, oj nëna e besimtarëve! A hyre në shtëpi kur isha duke ndenjur me Pejgamberin alejhi selam dhe ai kishte shtrirë këmbën e tij mbi kofshën time kur i vinte shpallje. Unë shkruaja shpalljen, kurse Pejgamberi alejhi selam thoshte: “Shkruaj, o Utheim!” Betohem në Allahun se, sikur të më vrisni mua, asnjëherë nuk do të duheni mes jush pas meje!” Pastaj tha: “Për çfarë doni të më vrisni? A mos mendoni se jam larguar nga feja, apo nuk ju jam përgjigjur në

ndonjë kërkesë kur ju është bërë ndonjë padrejtësi? Përse më vrisni? Dëshmoni, o sahabët e Pejgamberit alejhi selam, se unë jam i pafajshëm derisa ta takoj Pejgamberin alejhi selam.” Sahabët sërish kërkuan prej tij që ta mbronin, por ai tha: “Unë nuk do të jem i pari që derdh gjakun e muslimanëve pas Pejgamberit alejhi selam.”

Uthmani kërkoi nga njerëzit që të rrinin në shtëpitë e tyre dhe dërgoi një misionar tek rebelët, që të bisedonte sërish me ta. Ata ngulën këmbë që Uthmani duhej të jepte dorëheqjen dhe pastaj njerëzit do të zgjidhnin kë të donin. Uthmani nuk e dha dorëheqjen, ngase i kishte premtuar Pejgamberit alejhi selam kur i tha: “Ndoshta, o Uthman, njerëzit do të të veshin një këmishë. E nëse kërkojnë prej teje që ta heqësh atë, mos e hiq!”

Aliu dërgoi dy djemtë e tij, Hasanin dhe Husejnin, që ta ruanin kalifin. Gjendja vazhdoi të mbetet e njëjtë derisa erdhi dita e 18-të e Dhul Hixhes, ditë e enjte. Rebelët, pasi kuptuan se ushtria e Shamit i ishte afruar Medinës dhe se El-Ka’kah bin Amri nga Kufeja dhe Abdullah bin Ebi Sarhu ishte nisur nga Egjipti për t’i ardhur në ndihmë kalifit, vendosën të hynin në shtëpinë e kalifit.

Uthmani në natën e së enjtes kishte parë një ëndërr. Ai kishte parë Pejgamberin alejhi selam që po i thoshte: “A të etuan, o Uthman?” Tha: “Po, o i Dërguari i Allahut.” Tha: “A të uritën, o Uthman?” Tha: “Po, o i Dërguari i Allahut.” Tha: “A të rrethuan, o Uthman?” Tha: “Po, o i Dërguari i Allahut.” Tha: “A dëshiron që nesër të agjërosh e të bësh iftar te ne?” Tha: “Po, o i Dërguari i Allahut.”

Uthmani u zgjua atë ditë dhe buzëqeshte. Pastaj thirri shërbëtorin e tij dhe i tha: “Ta kam tërhequr veshin një herë para disa vitesh. Pash Allahun, tërhiqma edhe ti dhe merre hakun.” Atëherë shërbëtorit i erdhi keq, por Uthmani i tha: “Pash Allahun, tërhiqe!” Shërbëtori e tërhoqi veshin e Uthmanit me butësi, ngase i vinte keq, por Uthmani i tha: “Tërhiqe, se ndëshkimi në dynja është më i lehtë se ai në ahiret.”

Tragjedia

Erdhi çasti i fundit. Rebelët i vunë zjarrin derës së Uthmanit. Sahabët dhe njerëzit e tjerë filluan të shkojnë te shtëpia e Uthmanit, por Uthmani u bërtiste dhe u betohej t’i linin e mos t’i preknin, por të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Aty mbeti vetëm Hasani, Husejni dhe Abdullah bin Omer bin Hatabi. Rebelët nisën përpjekjet e tyre për të hyrë në shtëpinë e

Uthmanit dhe atëherë gruaja e tij deshi të zbulonte flokët e saj, se ndoshta kjo do t'i ndalonte të hynin në dhomën e tij, por Uthmani nuk e la. Rebelët u futën në shtëpinë e Uthmanit dhe e gjetën duke lexuar Kuran. Ai ishte agjërueshëm dhe po lexonte suren El-Bekare, ajetin 137: "Në qoftë se ata besuan ashtu siç besuat ju, ata vërtet kanë gjetur rrugën e drejtë, e nëse refuzojnë, atëherë ata janë kundërshtarë (opozitë), po ty (Muhamed) kundër tyre do të mjaftojë All-llahu. Ai është dëgjuesi, i dijshmi."

Një nga rebelët hyri tek Uthmani, e goditi me shpatë dhe i këputi dorën. Uthmani tha: "Allahu Ekber! Kjo dorë ka shkruar shpalljen hyjnore, Kuranin." Pastaj erdhi gruaja e tij, që ta mbronte, por e goditën edhe atë dhe ia prenë gishtat. Pastaj erdhi një njeri tjetër dhe e goditi me një hekur të mprehtë në krahun e tij dhe Uthmani tha: "Allahu Ekber! O Allah, të falënderoj!", dhe e mbylli Kuranin ku kishte pikuar gjaku i Uthmanit. Atëherë Uthmani tha: "O Allah, unë kam bërë sabër ashtu siç më ka porositur Pejgamberi Yt."

Uthmani u vra në ditën e xhuma, më 18 dhul-hixhe dhe u varros në El-Bekia. Ali bin Ebi Talibi qëndroi para varrit të tij duke qarë dhe tha: "O Uthman, lutem që të jem me ty ndër ata që Allahu xh.xh. tha: "Ne ua kemi hequr nga gjokset e tyre urrejtjen për vëllezërit e tyre." (El-Hixhr, 47)

ESE

Avni Aliu

POROSIA E KUR'ANIT PËR DURIM DHE VIGJILENCË

Allahu (xh.sh.), në Kur'anin famëlartë thotë: ***"O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigjilentë*** *(në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve)* ***dhe kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni".*** *(3:200)*

Ajeti shtron para besimtarëve këto porosi:

- të jenë të durueshëm në çështjet e veta personale,
- të jenë të vendosur dhe të qendrushëm në raporte që kanë të bëjnë me rrethin dhe mjedisin shoqëror,
- të jenë të përgatitur dhe vigjilentë kundër armikut, dhe
- të jenë respektues të urdhrave të Allahut, nëse duan të kenë sukses.

Është kjo thirrje fisnike që u drejtohet besimtarëve. Thirrje që nderon, shquan dhe i dallon ata; thirrje me një barrë të rënd që duhet ta bartin mbi supet e veta. Besimtarëve u bëhet apel për durim e qëndrueshmëri, apel për vigjilim dhe roje në kufij, apel për devotshmëri.

Rruga Islame është rrugë e gjatë, e zorshme, e mundimshme. Është rrugë jetësore që ka pikëfillimin dhe pikësynimin e vet, që ka baticat dhe zbaticat e veta, pengesat dhe vështirësitë, provimet dhe sprovimet me të cilat do të përballet çdo musliman gjatë të gjithë jetës. Prandaj lypset durimi. Durimi për të bërë rrugëtimin brenda vetes gjer tek ndërgjegjja. Që të rritet bima e shëndoshë, që të japë fruta të shijshme, duhet ndrequr shtrati i saj, duhet hequr gjithë ato egjra të padobishme që ia zënë hapësirën, frymën dhe dritën për t'u rritur. Njeriu mund të japë kontributin e duhur, mund të ndritë me veprën e vet rrethin dhe shoqërinë ku bën pjesë. Mirëpo, këtë mund ta bëj vetëm atëherë kur të lirohet nga të gjitha blloqet e terrueshme që ka brenda vetes së vet. Këtë mund ta bëj atëherë kur drita e Zotin depërton në zemrën e tij që t'i largojë tërë errësirën. Sepse kur drita e Zotit depërton, errësira patjetër duhet të humbet. Mënyra më e thjeshtë, më e sigurt, më e shpejtë dhe e vetme është - të lejosh që drita e besimit të pastër në Zotin të depërtojë në ty, në zemrën tënde dhe errësira duhet patjetër të humbet. Pejgamberi Muhammed a.s., tha: "Sytë e njeriut janë udhëzues, veshët e tij janë dëgjues, gjuha e tij është interpretuese, duartë e tij janë krahu i tij, këmbët e tij janë korrier për të dhe zemra në mesin e tyre është mbreti, nëse mbreti është i mirë edhe ushtria e tij është e mirë". Dhe për këtë duhet durimi. Prandaj Allahu xh.sh., urdhëron:

"O besimtarë! Bëhuni të durueshëm…" Urdhri i Allahut është i qartë. Jeta nuk është një lëndinë argëtimi. Ajo është një arenë lufte ku ndeshet e mira me të keqen, drita me terrin, e vërteta me gënjeshtrën, drejtësia me padrejtësinë. Në këtë luftë ngadhnjejnë të guximshmit, heronjtë e punës dhe të detyrës; ata që e kanë kuptuar qëllimin se përse janë ardhur në jetë. Ngedhnjejnë ata që i dorëzohen vetëm Allahut xh.sh., udhqëhiqen sipas udhëzimit të Tij. Ngadhënjejnë ata që e shijojnë jetën e kësaj bote me iman; ata që janë të vetëdijshëm se kanë nevojë për Zotin dhe ndihmën e Tij; ata që e dijnë se çdo gjë varet nga marrëdhënia e tyre me Zotin. Të tillët janë më të fortë, më të vendosur për të luftuar luhatjen, dobësinë, mëdyshjen, kundërshtimet dhe dëbimet ndaj së mirës. Njeriu me ndihmën e Allahut bëhet më i guximshëm për të ecur gjithmonë përpara, hapëvendosur dhe krenar, duke mos u dorëzuar para jetës dhe vështirësive, para të keqes dhe mëkatit, para djallit dhe tundimeve të tij. Po për këtë lypset durimi.

Durimin çfarë e kërkon Allahu xh.sh., prej nesh, është zor të kuptohet në tërësinë e tij me fjalë. Ju mund të pyetni pse? Sepse fjalët nuk mund ta zbërthejnë gjithë kuptimin e tij. Më së miri këtë mund ta kuptojnë ata që i kanë përjetuar vuajtjet dhe mundimet, peripecitë dhe vështirësitë në rrugën që e ka caktuar Allahu i Lartësuar. Durimin, në kuptimin e ajetit kuranor, besimtarët e kanë përjetuar në aspekte të ndryshme. Kanë përjetuar thellësisht shijen e kësaj thirrjeje. Kanë kuptuar se ç'kërkon Allahu xh.sh., prej tyre. Prandaj, gjithë ç'iu besua nga ana e Tij, me vuajtje dhe sakrifica të mëdha e jetësuan dhe e realizuan në jetën e tyre. Për ne është me shumë rëndësi t'i përgjigjemi thirrjes së Allahut të Madhërishëm kur thotë: ***"O besimtarë! Bëhuni të durueshëm…"*** Pra kërkohet prej nesh një durim që është i gjallë, që ka shpirt dhe jep fruta.

"…Dhe bëhuni të vendosur…"

Kjo nënkupton se besimtarët që kanë pranuar thirrjen e Allahut, Mëshirëplotë- duhet të tregojnë vendosmëri, qëndresë në luftë kundër djallit, armikut, i cili me marifetllëqet e veta tenton të zhdukë durimin e tyre. Besimtarët të bëjnë rezistencë dhe të mbrojnë durimin gjatë tërë luftës kundër tij. Besimtarët duhet të jenë më të fortë dhe kanë arsye, sepse janë në vijën e drejtë, kanë orientim të saktë, nga se udhëhiqen prej Zotit, inspirohet nga mësimet e Shpalljes së Tij. Janë të vetëdijshëm ndaj përpjekjeve të armikut i cili nuk pushon kurrë së vepruari, derisa ata të pranojnë stilin e jetës së tij, derisa të mos bëhen me mendje e me shpirt si ai. E kjo do të thotë humbje e besimtarit nga identiteti i tij, kjo do të thotë zhdukje totale e të qenët të tij, e unit dhe e qenësisë së tij. Prandaj, për t'u mbrojtuar nga ky shkatërrim fatal nevojitet vendosmëri për të patur siç e preferon Allahu xh.sh., në ajetin e më sipër.Besimtarët që përvetësuan qëndresën dhe vendosmërinë çfarë e kërkonte Allahu, u treguan të denjë dhe të suksesshëm në parime dhe në vepra.

Tregon Hababib ibn Erethi: "I jemi ankuar Pejgamberit të Allahut, derisa ai po qëndronte shtrirë nën hijen e Qabes, me mbulesën e vënë nën kokë si formë jastëku: -"O i dërguari i Allahut! A s'do kërkosh ndihmë për ne, a s'do t'i drejtohesh Allahut me një lutje për ne!?"

Muhammedi a.s., ju tha: -*"Në kohët e mëhershme, njeriut në tokë ia mihnin gropën dhe e futnin në të, pastaj i sillnin sharrën dhe i çanin kokën, por kjo nuk mund ta largonte dot nga feja e tij. Pastaj e krehnin me krehër të hekurt, i nduknin misht dhe nervat nga eshtrat, por asesi që ta largonin nga besimi i tij. Pasha Allahun, Ai do ta përforëcojë Islamin, kështu që Toka të jetë e lirë, që kalorësi të mund të udhëtojë prej Sane deri në Hadremevt, pa iu frikësuar askujt përveç Allahut, madje, as ujkut për tufën e vet. Mirëpo, ju po nxitoheni"*. (Shënon: Buhariu, Ebu Davudi dhe Nesaia.)

Nga ky hadith, ndërkaq, merret vesh se rruga që hap besimi kërkon vendosmëri dhe vetëmohim nga besimtari. Edhe Muhammedi a.s., bashkë me shokët e tij i përjetuan grushtat më të rënda të jetës. Por, ata nuk u përkulën. Vendosmëria dhe qëndresa e tyre për t'i sfiduar armikut ishte në shkallën kulmore. Guximi i tyre për të mbrojtur të drejtën dhe të vërtetën dhe vullneti i tyre për t'i jetësuar porositë e Zotit ishin të papërshkrueshme. Kështu, ata ngadhnjyen mbi armikun. Islami në teori është i fortë e në praktikë edhe më i fortë. Islami do vepra e jo fjalë. Vendosmëria ka vlerën e vet vetëm atëherë kur kthehet në vepër. Ajo dëshmohet atëherë kur njeriu përballet me vuajtje dhe durim. Qëndresa që nuk shndërrohet në vepër është qëndresë që i mungon sinqeriteti.

Muhamedi a.s., nuk ishte vetëm bartës i Shpalljes së Allahut të Madhëruar, nuk ishte vetëm thjesht misionar, por ai ishte edhe punëtor i palodhur. Ishte ndër të parët që me shpatë në dorë hidhej në beteja si prijës i ushtrisë muslimane, për të zëvendësuar skeptrin idolatrik dhe ligjet e pazbatueshme e të dalë mode të flijimeve. Ai shpalli fenë më të pastër të Zotit një dhe të vërtetë dhe solli udhëzime praktike dhe rregulla për moralin dhe sjelljen njerëzore. Ai ngriti fenë Islame që ka bashkuar në një vëllezëri të vërtetë shumë kombe e popuj që nuk shoqërojnë asnjë qenie me të Gjithfuqishmin. Ai shkatërroi dhe u dha fund gjurmëve të fundit të idhujtarisë të të gjitha llojeve duke rrënuar kështjellat dhe fortesat e tyre. Të gjithë muslimanët i bindet të Dërguarit të Allahut, e duan dhe e nderojnë atë si Pejgamberin e fundit të Islamit, por kurrë nuk e adhurojnë atë apo nuk i japin nder e cilësi hy-

jnore. Është një fakt i njohur në historinë e Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s., se para thirrjes së tij në Islam ai shihej dhe cilësohej nga bashkëkombasit e vet si një njeri tejet i qetë, i paqshëm, i besueshëm dhe me një karakter soditës dhe tërheqës; se ai ishte mbiquajtur nga njerëzit e Mekës "Muhammed el-Emin". Kur mekasit i dhanë Muhammedit a.s., këtë titull "Emin", ata nuk kishin as idenë më të vogël për misionin e tij.

Muhamedi a.s., para se të thirrej nga Zoti për të predikuar Islamin dhe për të shfuqizuar idhujtarinë - detyrë që e kreu me sukses - ishte njeriu më i qetë dhe më i drejtë në Mekë. Ai nuk ishte as luftëtar, as ligjvënës, por pasi mori misionin profetik, ai u bë folësi më i rrjedhshëm dhe arabi më i guximshëm. Ai i luftoi të pafetë, jo për interesin e tij vetjak, por për lavdinë e Allahut dhe për çështjen e fesë së Allahut. Ka qëndruar i uritur dhe i etur dhe kurrë nuk është ankuar. Atij iu treguan nga Zoti çelësat e thesareve të tokës, por ai nuk i pranoi ato, dhe kur vdiq, ai ishte, praktikisht, një njeri i varfër.[1]

Asnjë shërbëtor tjetër i Zotit, mbret a Profet qoftë, nuk i ka kryer një shërbim kaq madhështor, kaq të admirueshëm e kaq të çmuar Zotit dhe njerëzve: Zotit në çrrënjosjen e idolatrisë dhe zotërave falso nga pjesa më e madhe e botës dhe njeriut duke i dhënë fenë më të përkryer dhe ligjet më të mira për udhëzimin dhe sigurinë e tij. Ishte i parë kur duhej të sulmoheshin pozicionet e armikut. Në një betejë edhe është plagosur. Mori pjesë në njëzetetri luftëra, ndonëse ishte në moshën pesëdhjetë vjeçare. Ai ishte shembull i sinqeritetit, vendosmërisë, qëndresës dhe durimit. Ishte sombol i punës së palodhur. Ishte udhëheqës i secilit që synonte të arrijë deri aty ku ai kishte arritur. Jeta e Muhamedit a.s., është shembulli më i mirë për muslimanët të të gjitha kohërave. Dhe "nëse Muhamedit a.s., do t'i lejohej të rishfaqej sot në Mekë apo Medinë, ai do të mirëpritej nga muslimanët me të njëjtën dashuri e "bindje" që ai njohu gjatë jetës së tij. Ai do të shihte me ndjenjë të thellë kënaqësie se Libri i Shenjtë - Kur'ani që ai la, është i njëjtë dhe asnjë shkronjë nuk është ndryshuar në të; se këndohet e mësohet saktësisht njëlloj siç e bënin këtë ai dhe shokët e tij - sahabët. Ai do të ishte i kënaqur t'i përgëzonte ata për besnikërinë e tyre ndaj fesë dhe Njëshmërisë së Allahut; dhe për faktin se ata nuk e kanë shndërruar Pejgamberin në zot apo bir të ndonjë zoti"

[1] Safijjurrahman el Mubarekfur, "Nektari i vulosur i xhennetit", f. 555, Prishtinë, 2004.

"…dhe qëndroni vigjilentë…" Nga ky citat i ajetit të më sipër merret vesh se muslimanët thirren të qëndrojnë gjithmonë të zgjuar, vigjilentë në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve nga armiku. Sepse, "uji fle, armiku nuk fle",- e thotë populli. Armiku gjithmonë përpiqet që me anë dredhishë të vëjë pyka, të përgatitë kurtha nga brenda dhe nga jashtë. Ai dëshiron të krijojë gjendje të vështirë dhe kaotike ndër muslimanët, të shkaktojë huti e dëme dhe të asgjasonte thirrjen islame, që është e logjikshme, e drejtë, reale dhe paraqet program të natyrshëm e konkret për ndërtimin e jetës. "Terri dëshiron kaosin". Armiku kurrë nuk pushon kundër kësaj thirrjeje, qysh se muslimanët e kanë marrë përsipër që ta zbatojnë në jetë. Duke i përdorur shërbëtorët e vet, armiku me anë të tyre provokon dhe nxitë turbullira, rrëmujë e përleshje me qëllim shkatërrimi të thirrjes islame. Ata në mizërinë e tyre të neveritshme përpiqen të minojnë çdo gjë që është islame, gjithçka që është progresive dhe përparimtare. Këto marrëzira të armikut nuk kanë aspak të ardhme. Nuk mund të shuhet vula e një të vërtete që ka ardhur nga Zoti. "Feja e vërtetë rritet ngadalë dhe kur mbillet një herë, është vështirë të shkulet."- ka thënë Xh.H. Njuman.

Mirëpo, në situate të tilla Kur'ani i thërret besimtarët për një vëmendje më të madhe e për një kujdes më të shtuar, për të qenë vigjilentë e të gatshëm të veprojnë më kohën e duhur kundër çdo sulmi a veprimi të armikut. Këta besimtarë, në situata të tilla, shndërrohen në një ushtri të tërë për ta mbrojtur të drejtën, ligjin natyral të Zotit, sovranitetin e Tij që nuk njeh asnjë lëshim, drejtësinë, të vërtetën dhe, po të jetë nevoja do të vdisnin si ata të parët e tyre. Këta besimtarë shndërrohen e bëhen një fortesë e pathyeshme, gjithmonë e gatshme, gjithmonë e papushtueshme, kurrë e fatalizuar, plot guxim e trimëri për t'i qëndruar ballë çdo sulmi. Radhët e saj janë të ngjeshura, rrinë bri njëri-tjetrit, brryl më brryl, sup më sup me plotë shpresë dhe frymëzim nga mësimet Islame. Ata i mbanë IMANI; janë gjithnjë në

roje. Dhe këtë luftim, këtë qëndresë stoike ata e pranojnë për ta shpënë ligjin e Zotit përpara, për të vendosur rendin e Tij universal.

Jo rrallë, Muhammedit a.s., bënte roje, vëzhgonte terrenin dhe kthehej i lajmëronte shokët për gjendjen.

Natyra e kësaj thirrjeje është e tillë. Rruga e saj që dëshiron të vendosë programin e vet të fuqishëm dhe sistemin e vet të drejtë në Tokë, është e tillë. Prandaj gjithmonë ka hasur në rrezistencë të ashpër nga armiku. Mirëpo, Umeti, si Bashkësi e drejtë dhe madhështore, është gjithmonë e gatshme për vetëmohim dhe therrori.

Përcjellësi i gjithë kësaj veprimtarie të muslimanëve është, pa dyshim, devotshmëria. Devotshmëria për mulimanin është syri vigjilues, rojtari gjithmonë i zgjuar në vetëdijen e tij; e mbron të mos bie në gjumë, të mos bëhet viktimë e kurthave të armikut; e mbron të mos veprojë padrejtësisht, e mbron nga devijimet dhe sjelljet devijante; e mbron nga luhatjet dhe hamendjet; e mbron të mos shmanget për asnjë milimetër nga ajo që ia ka përcaktuar thirrja islame; e mbron të mos humbet në rrëmujën e ndjenjave dhe të pasioneve që dijnë të çojnë krye në momente dhe situate të ndryshme.

Njeriu ka dy duar për të punuar e për të kapur një send. Po ka edhe një dorë që e mbanë drejt. Devotshmëria është ”bërthama e çdo gjëje”, dora e ndërgjegjës, dora e shpirtit, që, kur kap mirë, më s’të lëshon të humbasish në gabime. Ky edhe është kulmi i arritjes së përsosurisë.

Pas një mori obligimesh, pjesa e fundit i ajetit në përkthim përfundon duke na lidhur prap me Allahun e Madhëruar. Sepse shpëtimi është vetëm prej Tij: ***“…dhe, kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni”.***

Këto fjalë të Kur’anit janë bukë për shpirtin e besimtarit, janë gjak për damarët e tij, janë shëndet për zemrën e tij, janë gëzim, janë jetë, janë shpëtim “leal-lekum tuflihuun” - që të shpëtoni.

Të vërtetën e thotë Allahu i Madhëruar.

PORTRETE

Prof. Ali Mustafa EL-MISRATI[1] -
HERODOTI I KULTURËS LIBIANE DHE SHQIPTARËT

U lind më 18.08.1926 në Aleksandri, ndërsa emri i tij i plotë sikurse ai e përmend është: Ali Mustafa Ali Ahmed El Misrati. U rrit ndërmjet Aleksandrisë dhe Kairos. Mësimet e tij të para i mori në shkollën "El Xheladin" në Bulak. Më pas vazhdoi shkollën e lartë në Universitetin e Ez'herit në fakultetin e "Bazave Fetare" të cilin e përfundoi në vitin 1946. Gjithashtu arriti të diplomohet në shkollën e lartë të pedagogjisë në fakultetin e "Gjuhës arabe" po në universitetin e Ez`herit në vitin 1949. Më pas punoi si mësues në shkollën egjiptiane të koptëve në Shibra.

Herën e fundit që u takova me të, dhe kjo gjatë pushimit prej gati një çerek ore në një seminar që u mbajt në Tripoli[2], m'u dha rasti të bisedoja me të dhe t'i je-

[1] Përshtatur dhe përzgjedhur nga Roland VISHKURTI \ Tripoli \ 08-02-2008.

[2] Është seminari shkencor me titull "Tripoli dhe roli i tij në përhapjen e kulturës arabe – islame" mbajtur në Tripoli – Libi gjatë periudhës 06-07/02/2008, ku ai u nderua me medaljen e arte nga Organizata Arabe për Edukimin, Kulturën, dhe Shkencën (ISESCO).

pja atij një biografi të shkurtër rreth jetës së tij në gjuhën shqipe, të cilën e kisha përgatitur prej disa muajsh, menjëherë me lëvizjet e tij të shpejta dhe të gjalla filloi të fliste dhe të më pyeste për shqiptarët. Natyrisht që u çudit kur unë i dhashë atë biografi të shkurtër që nuk i kalonte tetë faqe, megjithëse rreth nesh kishte dhe profesorë e studentë të tjerë pjesëmarrës në seminar, kur i mori në dorë ato fleta më tha: *"A e ke përmendur që origjina e gjyshërve të mi është nga Shqipëria?"*, unë iu përgjigja megjithëse unë e di një gjë të tillë, sepse më keni njoftuar në takime të kaluara, por këtë nuk e kam gjetur të shkruar në asnjë burim që flet për jetën dhe veprën tuaj, për këtë arsye nuk e kam shkruar këtë që ju përmendni, atëherë duke buzëqeshur më tha: *"Menjëherë shkruaje këtë që po dëgjon nga unë në biografinë time"*, dhe thirri me zë të lartë që ta dëgjonin dhe disa të pranishëm që ishin aty pranë: *"E dini ju që gjyshërit e mi kanë qenë shqiptarë"*. Ishin këto fjalë që më shtynë ta rishkruaj biografinë e këtij gjeniu të letrave arabe për shkakun e vetëm që të përmend atë që ai më kërkoi, se origjina e familjes së tij rrjedh nga Shqipëria, dhe se gjyshërit e tij të parë kanë qenë shqiptarë që emigruan në viset arabe, dhe kjo është një dukuri tashmë e njohur në historinë arabe ashtu dhe në atë shqiptare. Jo vetëm në Libi gjejmë familje me origjinë shqiptare por thuajse në të gjitha vendet arabe si në Egjipt, Siri, Palestinë etj.

Ai ka shkruar dhe vazhdon të shkruajë në fusha të ndryshme, por veçanërisht aktiviteti i tij është përqendruar në histori, biografi, tregime, gazetari si dhe në dorëshkrime nga trashëgimia kulturore.

Me shkrimin e tij me titull *"Këtu jam o atdheu im, këtu jam"*, titull i cili u bë kushtrim për rininë gjatë asaj periudhe të historisë, ai nisi botimin e shkrimeve të tij në gazetën "Tripoli Perëndimor" (Tarablus El Garb). Ishte ky artikulli i tij i parë që u botua më 13.03.1948, më pas u botua shkrimi i tij me titull "Lamtumirë, më pas kthehem", më 14.04.1948.

U kthye për t'u vendosur përfundimisht në Libi, më 15.07.1949, periudhë, në të cilën botoi artikullin e tij me titull "Kthim", gjithashtu gjatë kësaj periudhe ai ka mbajtur shumë ligjërata dhe aktivitete kultu-

rore e politike të cilat kishin si qëllim nxitjen dhe rritjen e ndërgjegjes te rinia që të përballen me ngjarjet që ndodhnin asokohe në Libi...

U anëtarësua në partinë "Kuvendi Kombëtar" për të mbrojtur çështjen libiane, parti të cilën e kishte themeluar Beshir Es Sa`davi në vitet `50-të. Gjatë kësaj periudhe ai u përndoq dhe u burgos. Më 25.03.1954 u emërua drejtor i radios "Tripoli Perëndimor", gjithashtu punoi si kryeredaktor i revistës "Këtu Tripoli Perëndimor", revistë e cila përfshinte fushën e letërsisë dhe artit. Më 1960 deri më 1964 u zgjodh anëtar i Asamblesë Parlamentare.

Në vitin 1965 mori çmimin e parë me shkrimin e tij rreth folklorit libian në konkursin e shkrimtarëve, të cilin e organizoi komisioni i lartë i arteve dhe letërsisë. Më pas ai u emërua kryetar i këtij komisioni. Nga viti 1959 deri më 1966 ai ishte nga themeluesit dhe udhëheqësit e Institutit libian të mendimit. Më 7.02.1964 ishte botuesi i gazetës javore "Populli", ku ishte dhe kryeredaktor i saj, gazetë e cila u ndalua (botimi i saj) disa herë. Në vitin 1972 u zgjodh deputet i Tripolit në parlamentin e unionit popullor. Mori dhe vazhdon akoma të marrë pjesë si përfaqësues i Libisë në seminare të ndryshme rreth letërsisë, kulturës dhe politikës.

Në vitin 1970 u nderua në festën e parë të shkencës për rolin e tij në ringjalljen e trashëgimisë kulturore arabe.

Mori pjesë në themelimin e disa qendrave dhe instituteve kulturore arabe.

Fitoi çmimin "Fatih" në letërsi dhe arte në vitin 1994 si nderim për aktivitetin e tij si shkrimtar.

Përveç shkrimeve të tij, programeve kulturore dhe serialeve radiotelevizive ai ka botuar më shumë se 55 libra.

Ndër librat e tij të botuar përmendim:

1. Personalitet nga Tripoli - botuar nga Shtp. bot. Maxhi , 1955.
2. Panorama letrare nga Libia - Shp. bot. Shtetërore , 1956.
3. Poet nga Libia - Ibrahim El Usta Umer- Shp. bot. Orient, 1960.
4. Nastradini në Libi - Libraria Orient, 1957.

5. Gazeta libiane gjatë gjysmë shekulli - Libraria Orient, 1958.
6. Shoqëria libiane nëpërmjet fjalëve të urta popullore - Tripoli , 1962.
7. Siçiliani Ibn Hamijdus - Sht. bot. Njohuritë, 1963.
8. Vela e grisur - Shp. bot. e librit arab, 1963.
9. Esed bin El Furat çliruesi i Sicilisë - Organizata e shkrimeve, 1964.
10. Një grusht me dhé - Shp. bot. El Gandur, 1964.
11. Ibn Galbun - Historiani i Libisë - Komisioni i lartë i letërsisë, 1966.
12. Marrëdhëniet historike dhe shoqërore ndërmjet Libisë dhe Turqisë, 1968.
13. Mbledhja e injorantëve - Libraria e mendimit, 1972.
14. Era e Nisrinit - Libraria tregtare, 1963.
15. Histori nga Libia - Shp. bot e shpejtë, 1977.
16. Shprehjet popullore, domethënie psikologjike dhe sociologjike, 1982.
17. Grimë prej xixëllonje - Shp. Bot. El Xhamahirije, 1992.
18. Dielli dhe sita - Shp. Bot. Dahvij, 1967.
19. Zogu i plagosur - Shp. Bot. El Xhamahirije, 1995.
20. Shembuj në hije, përkthime - Tripoli, 1978.
21. Personalitetet e gazetarisë në vendet arabe - (Vëll. VI) personalitete libiane, 1997.
22. Akoma xhaketa është e varur, tregime të shkurtra - Kajro, 2005.
23. Seriozitet në shaka dhe fantazi në realitet - Tripoli, 2006.
24. Dervishi i tha djalit të tij - Sirt, 2006.
25. Arka e mollëve - Sirt, 2006.

Punimet e tij janë përkthyer në disa gjuhë të ndryshme, si në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe në gjuhën kineze. Rreth Ali Misratit dhe shkrimeve të tij kanë shkruar shumë shkrimtarë, kritikë dhe akademikë arabë dhe të huaj. Ndër ta përmendim dekanin e letërsisë arabe Taha Husejnin, Enis Mensurin, Mustafa Mahmudin, Muhammed Ferid, Ni`met Ahmed Fuad, Nikolla Zijade, Abdullah Es Siman, Ali Fehmi Khushejm, Muhammed Verith, Husejn Mu`nis, Ebu

Kasim Keru, Enver El Xhundij, Muhammed Mahfudh nga Tunizia, Shiratof nga Rusia, Xhak Perik nga Franca, Arif nga Kina, Bakhman nga Gjermania, Abdul Kerim Xhermanos nga Hungaria, Rizintano nga Italia... e shumë letrarë e kritikë të tjerë.

Për aktivitetin e tij, për frymën e re që ai ka futur në letërsinë dhe historinë libiane, për botimet dhe dorëshkrimet e pabotuara, për seminaret dhe koncertet letrare e kulturore që janë organizuar brenda Libisë dhe jashtë saj, për të gjitha këto dhe mjaft të tjera që nuk janë përmendur, e bëjnë atë ta quajmë "Herodotin e kulturës libiane", sikurse e quan me të drejtë dhe dr. Abdullah Salim Mulejtan[3].

Çfarë thotë Ali Mustafa Misrati për veten e tij...[4]

Pasi përmend vendlindjen dhe vitet e shkollës të cilat i përmendëm në fillim të kësaj biografie ai vazhdon të thotë:

"Unë përshtatem me natyrën e studimeve dhe hulumtimeve, shkruaj artikuj dhe tregime që pasi i thur ato has shumë pengesa për t'i botuar dhe për t'ua paraqitur njerëzve, kjo për shkak të shkrimit tim të mallkuar, shkronjave të përdredhura, shprehjeve të dobëta si dhe gabimeve të shpërndara, ndaj të cilave pena ime tregohet e pavëmendshme për t'i korrigjuar dhe përmirësuar. Pena ime gulçon dhe shfryn atëherë kur ajo shikon letrën, ajo vrapon kur vështron bojën, dhe rrëshqet atëherë kur unë e shtrëngoj me gishtat e mi. Kjo nuk do të thotë se unë me mendimin tim kam përfshirë gjithçka apo jam thelluar -Zoti më faltë - kjo dëshmon se rrjedha e penës tek unë është përvojë e hidhur dhe mundim...

[3] Marrë nga Fjalori i letrarëve dhe shkrimtarëve bashkëkohorë libianë \ Abdullah Salim Mulejtan.

[4] Kjo është një paraqitje e karakterit të këtij gjeniu të letërsisë arabe, ku del në pah personaliteti i tij euforik dhe mjaft i gjallë, thjeshtësia dhe sinqeriteti janë diçka e pandarë nga personaliteti i këtij akademiku që tashmë i ka kaluar të 80-tat, kjo jo vetëm në shkrimet e tij, por dhe në jetën e tij të përditshme. Në shkrimet dhe artikujt e tij të ndryshëm ne hasim vazhdimisht shprehje që nxjerrin në pah anë nga personaliteti i tij... kjo që po përmendim është vetëm një përzgjedhje.

Shpejtësia gjatë shkrimit, nxitimi në ecje, shpejtësia gjatë të folurit, gjatë ushqimit, janë gjëra të cilat unë i vuaj, që më shqetësojnë vazhdimisht, dhe që më bëjnë konfuz dhe të hutuar. Nga këtu lëshimet që bën pena ime janë të shumta, po ashtu dhe gabimet drejtshkrimore. Nxitimi dhe të shpejtuarit mund të jenë të dobishme dhe të domosdoshme për të arritur shkallët e qytetërimit, mirëpo nxitimi në botën e artit, në strehën e poezisë, fushën e penës, dhe në hapësirën e letërsisë, në të gjitha këto të nxituarit është veti shumë e dëmshme, shkatërruese, është mallkim...

Përderisa shkrimi im është sikurse gjurmët e rosës në baltë, apo sikurse shenjat dhe shprehitë e hajmalive, e gjej veten më shumë duke mbajtur fjalime sesa duke shkruar, dhe kur flas ndihem më mirë sesa kur shkruaj, të ligjëroj është më e lehtë për mua sesa të shkruaj, sepse kufijtë e të shkruarit janë shumë të vështira për mua, janë të mallkuara, kjo është një e metë të cilën mundohem vazhdimisht ta riparoj dhe një gabim që mundohem ta përmirësoj dhe t'i jap kuptim, mirëpo me plot keqardhje me sa duket kjo është diçka e vështirë dhe e pamundur për mua. Gjithmonë unë jam i detyruar t'i korrigjoj vetë shkrimet e mia, sepse shkrimi im është i palexueshëm dhe i pakuptueshëm... gabimet dhe lëshimet e penës sime ndonjëherë arrijnë deri në marrëzi, mund të ketë prej tyre të dhimbshme, konfuze por dhe të çuditshme dhe origjinale...".[5]

Stili i Misratit dallohet për spontanitetin dhe lehtësinë e tij. Në të shumtën e rasteve të bie në sy mprehtësia dhe humori thumbues. Këtë stil ai nuk e shmang qoftë edhe në studimet, hulumtimet dhe tregimet e tij. Ai nuk është sikurse ata të diplomuar të Ez'herit, të cilët përdorin një stil të vështirë për t'u kuptuar dhe mjaft të paqartë. Ajo që e bën atë të veçantë janë shkrimet e tij të cilat prekin fusha të ndryshme të kulturës. Ai thotë:

"Mungesa e librit në bibliotekën arabe në Libi; ishte kjo ndjenë motiv i mjaftueshëm që shkrimet e mia të kenë këtë shumëllojshmëri.

[5] Ali Mustafa El Misrati \ Gabimet e penës \ Gazeta "Tripoli Perëndimor" Nr. 2862 \ Viti i X-të \ Datë: 07-12-1952 \ fq. 2.

Me këtë unë kisha dëshirë të mbushja një pjesë sado të vogël të këtij boshllëku. Kështu unë fillova të shkruaj për personalitetet libiane, historianët, u mora me studimin e dorëshkrimeve, gjithashtu fillova të shkruaj tregime dhe pjesë teatrale. Nuk e mohoj që unë e provova të shkruaj edhe poezi, mirëpo nuk është nga ajo poezi që ngrihet mbi këmbët e veta, mund ta quajmë poezi të gjymtuar... poezia ime nuk më pëlqen dhe nuk kam dëshirë t'ua paraqes atë lexuesve, kështu që e mbylla këtë drejtim dhe u dhashë pas fushave të tjera të letërsisë".[6]

Për shqiptarët ai thotë:

"Është një popull i vjetër që ka dhënë shumë, ka nxjerrë dijetarë e personalitete jo vetëm në Lindje por dhe në Perëndim, por në të njëjtën kohë është një popull që i është bërë shumë padrejtësi. Turqia shumë herë tregoi neglizhencë ndaj tyre, ndërsa arabët i harruan totalisht".

Ai nuk harron të përmendë dijetarë me origjinë shqiptare që kanë bërë famë në botën arabe, të cilët i ka takuar gjatë udhëtimeve të tij të shumta. Ai thotë që shumë prej tyre i njeh personalisht dhe i ka shokë e mban kontakte me ta. Ai përmend Sami Frashërin dhe Kamusin e Personaliteteve, libër të cilin ai ka shumë dëshirë ta përkthejë në gjuhën arabe, për Samiun, i cili ka qenë edhe kryeredaktor i gazetës "Tarablus El Garb", gazeta e parë libiane, ai thotë: *"Ai ka qenë me të vërtetë një dijetar i madh, ka qenë enciklopedi për kohën e tij, për fat të keq ka autorë arabë që janë bazuar totalisht në veprën e tij Kamus el A'lam, por që nuk e përmendin një gjë të tillë".*

Padyshim nuk mund të harroj "*burrin madhështor*" siç e quan ai Muhamed Ali Pashën, të cilin e përmend me një simpati të madhe, si dhe mjaft personalitete shqiptare për të cilët ai shpreson t'iu përkushtojë një ligjëratë për të treguar rolin e tyre në shërbim dhe përhapje të kulturës islame në botë, në të njëjtën kohë ai shpreh dëshirën e tij të

[6] El Misrati, shpirti dhe zemra \ Grup autorësh \ Katër stinët \ Nr. 58 \ Viti XII-të \ 02-1992 \ fq. 25-31.

madhe që një ditë shpreson t'i realizohet për të vizituar "Tokën Shqiptare" siç e quan ai me gjuhën e tij.

Më tej ai thotë:

"Bisedat e mia nuk janë asgjë pa ndjenjën e humorit. Humori është i rrënjosur në personalitetin dhe karakterin tim. Të qeshurit është diçka e domosdoshme gjatë bisedave të mia, kjo ndoshta për shkakun nga që unë kam aftësi për të krijuar kushtet e përshtatshme për humor. Mund të ndodhë që humori tek unë të jetë shprehje ironike, kritikë e ashpër ose qëndrim ndaj diçkaje që nuk më pëlqen... kjo nuk mund të jetë çudi duke marrë parasysh vendin ku jam rritur në lagjen "Bulak" nga ku lind i gjithë humori egjiptian... në këtë lagje lindin dhe shpërndahen të qeshurat për t'u bërë më pas përzierje e jetës dhe natyrës njerëzore në atë vend.

Gjithmonë më shikon duke vrapuar sikur jam duke ndjekur diçka që s'e kam arrirë, mbaj letra të cilat ndoshta nuk i mbush së shkruari, gjithmonë mbaj nën sqetull një libër që ndoshta nuk e përfundoj së lexuari, por mundet që librit t'i grisen fletët nga leximi i shumë përsëritur. Mbaj me vete të holla të cilat shumë shpejt i shpenzoj. Të hollat në dorën time janë sikurse uji në pupël... përfundojnë shpejt... të tjerët më shohin bujar deri në qindarkën e fundit dhe shumë dorështrënguar deri në palcë për sa i përket bibliotekës sime apo pajisjeve të mia kulturore dhe artistike".

Për shkrimet dhe aktivitetin e tij kulturor ai është nderuar me shumë çmime dhe tituj si në rangun e botës arabe ashtu dhe jashtë saj, por ai mendon se nderi më i madh që i është bërë është seminari shkencor me titull "Ali Mustafa El Misrati, letrar dhe dijetar" të cilën e organizoi Këshilli për Kulturën, ku ai tha: *"Shpresoj që të jem letrar dhe dijetar në historinë e letërsisë arabe".*

ANALIZA

Mr. Qemajl Morina

RRUGËTIMI PREJ AFËR KATËR DEKADASH I REVISTËS "EDUKATA ISLAME"

Të nderuar të pranishëm,

Kam nderin, që në emër të Redaksisë së revistës "Edukata Islame" të ju përshëndes të gjithëve dhe të ju falënderoj për kohën që keni ndarë, për të marrë pjesë në këtë tubim tonin. Qëllimi i këtij takimi është që bashkërisht të bëjmë një analizë të përgjithshme, si në aspektin përmbajtjesor, por edhe teknik, të revistës tonë dhe tujës dhe të shohim se cilat janë mundësitë për mënjanimin e të metave dhe lëshimeve të mundshme, të cilat janë të pashmangshme në veprimtari të këtilla, por edhe hapjen e horizonteve të reja dhe begatimin e saj në të ardhmen. Thënë shkurt, ne e konsiderojmë këtë tubim, një mbledhje të zakonshme të redaksisë, në një formë më të zgjeruar, në të cilën do të dëgjohen vërejtjet, kritikat, por edhe sugjerimet, propozimet dhe idetë e reja nga kolegët, bashkëpunëtorët dhe përgjegjësit më eminentë të Bashkësisë Islame.

Më vjenë mirë, që ky takim i yni koincidon, vetëm një muaj pas shpalljes së Kosovës shtet sovran dhe të pavarur, nga ana e Parlamentit të Kosovës. Kjo ëndërr e kamotshme, e cila ka qenë dëshirë, jo vetëm e jona, por edhe e shumë brezave që ishin para ne, e që falë ndihmës zë Zotit të madhërishëm , sot u bë realitet.

Para se të flas lidhur me preokupimet e tashme të revistës “Edukata

Islame”, besoj se është e udhës t'i bëjmë një vështrim rrugëtimit të saj, prej afër katër dekadash, apo thënë saktësisht prej 37 vjetësh. Thënë realisht, kjo periudhë kohore, për një revistë, nuk është shumë e gjatë, por duke i marrë parasysh rrethanat dhe specifikat tona nuk është edhe e shkurt.

Rëndësia e kësaj reviste qëndron në atë, se me të, iu vunë themelet e periodikut dhe publicistikës islame në Kosovë. Andaj, të rralla janë ato revista, jo vetëm te ne, por edhe në botë që kanë një privilegj të tillë

Numri i parë i revistës "Edukata Islame" doli në vitin 1971, si organ i Shoqatës së Ulemave, për të vazhduar kështu deri në numrin 61-62, të vitit1997.

Prej numrit 63-64 të vitit 1998 e deri më sot, kjo revistë del si Organ i Kryesisë Bashkësisë Islame të Kosovës, kur "Edukata Islame" pësoi një ndryshim si në aspektin e përmbajtjesor, por edhe në formatin dhe dizajnin e saj. Duke e marr formën e një reviste bashkëkohore islame.

Është e madhe, prandaj, rëndësia kulturore-arsimore e posaçërisht ajo edukative e kësaj reviste, natyrisht po qe se ajo vështrohet në kontekst të rrethanave të kohës së fillimit të saj, në vitet e shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, kur qe marrë vendimi për botimin e saj. Vetë ideja për botimin e revistës ishte më shumë dashje dhe vullnet i mirë, sesa mundësi me një mbështetje reale të potencialit të kuadrove të asaj kohe.

Andaj, kur ne sot, pas një periudhe kohore, prej afër katër dekadave i bëjmë një vështrim dhe vlerësim, në radhë të parë ajo i takon iniciatorit, të kësaj nisme, i cili pati kurajën të merë një hap të tillë të guximshëm. Iniciator, i kësaj nisme ishte Mulla Sherif ef. Ahmeti, myderriz i shumë brezave, që kaluan nëpër duart e tij në Medresenë "Aluaddin" të Prishtinës. Ai nuk ngurroi, që për numrin e parë të revistës të kërkojë ndihmën edhe të nxënësve të medresesë, që edhe ata të kontribuojnë me shkrime. Andaj, fal iniciativës së tij, m’u dha rasti, që shkrimin e parë ta botojë në numrin e parë të revistës "Edukata Islame".

Nëse kryeredaktori është përgjegjësi kryesor për mirëvajtjen e një gazete apo reviste, atëherë, me rastin e "Edukatës Islame", kjo meritë, për themelimin dhe zhvillimin e saj i takon kryeredaktorit të parë të saj, Mulla Sherif ef. Ahmetit, i cili me meritë mban edhe stazhin më të gjatë të kryeredaktorit. Ai kreu këtë detyrë prej numrit të parë të revistës deri në numrin 49, prej vitit 1971 deri në vitin 1987. Do të thotë se për 16 vjet ishte

në krye të saj. Për çka vërtet, ai edhe meriton atributin e doajenit të publicistikës islame të gjuhës shqipe në Kosovë. Me siguri, kontributi i tij jo vetëm në publicistikën islame, por edhe në të gjitha lëmenjtë e jetës islame do të jetë objekt shqyrtimi në përkujtimin e dhjetë vjetorit të vdekjes, që do të organizohet më 14 prill nën patronatin e Kryesisë së Bashkësisë Islame, Fakultetit e Studimeve Islame dhe Medresesë së Mesme "Alauddin", për cka shpresojmë se kontributin e vet, do të japin të gjithë ata që e njohën myderrizin tonë të nderuar, në radhë të parë ish-nxënësit, dhe ish-studentët e tij, si dhe të gjithë intelektualët tjerë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Shqipëria dhe diaspora. Këshilli Organizues ka parapa që me atë rast, përveç sesionit shkencor mbi jetën dhe veprën e tij të organizoj një ekspozitë dhe një akademi solemne ku do të shfaqet një film dokumentar i përgatitur enkas për këtë rast, ku pasqyrohet jeta dhe veprimtaria e tij. Andaj, më lejoni që në emër të Këshillit Organizues të shfrytëzoj këtë rast, që të gjithë ata që kanë njohuri për jetën dhe veprimtarinë e ti të paraqiten me kumtesat e tyre.

Kryeredaktor i dytë i revistës "Edukata Islame", ishte Hajrullah ef. Hoxha, i cili ishte në krye të saj, prej numrit 50-54, prej vitit 1988-1990. Edhe pse, si kryeredaktor pati një stazh të shkurtër, ai vazhdimisht ishte një shtyllë e kësaj reviste, krah i djathtë i të gjithë kryeredaktorëve. Ai edhe sot e kësaj dite, edhe pas pensionimit, është anëtar i redaksisë dhe në vazhdimësi është prezent me shkrime në faqet e saj.

Kryeredaktori i tretë, ishte Resul ef. Rexhepi, i cili udhëhoqi atë prej numrit 55 deri 64, prej vitit 1992-1998. Gjatë mandatit të cilit, "Edukata Islame" u pasurua mjaft si në aspektin përmbajtjesor, por edhe e ndryshoi formatin e saj, duke hyrë në mesin e revistave bashkëkohore islame.

Pas një pauze prej tre vitesh, fati i saj i mëtutjeshëm u shqyrtua në njërën nga mbledhjet e Kryesisë së Bashkësisë Islame, në vitin 2001. Ku për shkak të rolit të saj në afirmimin e jetës islame, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë, rëndësisë së saj historike si revistë e parë islame në Kosovë, u maur vendim për aktivizimin e saj, me ç'rast u caktua edhe redaksia e re. Dhe prej asaj kohe revista "Edukata Islame" vazhdoi daljen e saj deri në ditët tona.

Në rrugëtimin e saj të gjatë, "Edukata Islame", përjetoi natyrisht rriten e saj si në aspektin përmbajtjesor, por edhe atë vëllimor. Nëse numri i parë i

saj numëronte 59 faqe, numri i fundit arrin në 388 faqe. Nëse temat e shtjelluara në numrat e parë të saj dukshin modeste, tani ajo në përmbajtjen e saj ka tema me tematikë të ndryshme. Mirëpo, kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se ka vend për vetëkënaqësi.

Me gjithë vështërsitë dhe sfidat, me të cilat u ballafaqua "Edukata Islame" gjatë periudhës së kaluar, ajo arriti jo vetëm të mbijetojë, por edhe të trasojë rrugën e saj duke tubuar rreth vetes një numër të konsideruar dashamirësh të fjalës së shkruar islame në gjuhën shqipe. Ajo ishte tribunë e shprehjes së mendimit islam. Prandaj, sot me plotë të drejtë mund të thuhet se "Edukata Islame" gjatë periudhës së kaluar ishte histori e gjallë e kulturës sonë islame. Ajo është kronikë e jetës sonë shpirtërore. Për këtë arsye, çdo hulumtues dhe studiues i zhvillimit të jetës islame në këto troje, e ka vështirë ta bëjë atë pa iu referuar "Edukatës Islame".

Revista "Edukata Islame" kontribuoi që fjala e shkruar islame në Kosovë të mos mbetet monopol vetëm i saj, por me kalimin e kohës filluan të shihnin dritën edhe revista tjera. Kështu, në vitin 1986, nis të botohej, revista e përmuajshme "Dituria Islame", pastaj revista, "Nur el-Kuran", organ i Shoqatës së nxënësve të Medresesë së Mesme "Alaudin", kurse me hapjen e Fakultetit të Studimeve Islame, revista "Zgjimi Islam", organ i Unionit të Studentëve të FSI-së, si dhe një seri botimeve të veçanta, qoftë në kuadër të Shoqatës së Ulemave apo të Kryesisë së Bashkësisë Islame.

E sotmja dhe e ardhmja nuk mund të ndërtohen pa u mbështetur në të kaluarën. "Edukata Islame" e pa dritën dhe rriten e saj në kohërat më të vështira. Atëherë, kur komunizmi ishte në kulmin e fuqisë së tij. Megjithatë, ajo mbijetoi, falë vullnetit dhe përpjekjeve të atyre besimtarëve të përkorë dhe idealistëve të islamit, brenda Bashkësisë Islame dhe jashtë saj, të cilët kishin besim të plotë, se fjala e shkruar islame në gjuhën shqipe, megjithë peripecitë do të triumfoj. Por, vetëm duhej durim dhe angazhim i pareshtur. Dhe koha e vërtetoi se ata patën të drejtë.

Të nderuar të pranishëm, dashamirë të fjalës së shkruar,

Tash më mbetet të flasë për periudhën më të re, por edhe më të vështirë të revistës "Edukata Islame ", që fillon me numrin 65, të vitit 2001, kur pata privilegjin, por edhe përgjegjësinë që të jem në krye të saj. Është shumë vështirë që njeriu të flet për vetveten apo punën e vet, për këtë, besoj se ju

do ta keni fjalën si vrojtues dhe lexues, si dhe brezat që do të vijnë më vonë. Por, një gjë duhet ta them, se ishte fat i mirë i imi, por edhe i revistës, që ne patëm një redaksi të konsoliduar mirë, emra të njohur të pendës, të profileve të ndryshme, të cilët nuk prituan asnjë herë që temat e parashtruara për botim t'i lexojnë, t'i analizojnë mirë para se ato të botohen. Po ashtu, pas botimit, në çdo mbledhje të redaksisë është bërë një analizë i temave të botuar dhe është dhënë vlerësimi i meritуar me qëllim që lëshimet eventuale të mos përsëriten në numrat vijues.

Besoj se përvoja e "Edukatës Islame" në hapjen e saj jashtë, kornizave të Bashkësisë Islame është treguar shumë i suksesshëm dhe duhet të zgjerohet edhe në segmente tjera të Bashkësisë Islame. Redaksia në përbërjen e saj ka akademikë, profesorë universiteti, të cilët me përvojën e tyre të gjatë i dhanë një gjallëri dhe shpirt të ri revistës, si në aspektin përmbajtjesor dhe estetik. Për çka unë i falënderoj për punën dhe kontributin e dhënë në pasurimin dhe begatimin e saj.

Ajo që vlen të theksohet, se redaksia është përpjekur, aq sa ka pasur mundësi të bëjë freskimin e revistës me tema dhe rubrika të reja nga reportoari i tematikës islame.

Çdo revistë apo gazetë hulumton për bashkëpunëtor të rinj dhe penda të reja, të cilët e pasurojnë atë. Në këtë aspekt, jemi angazhuar edhe ne, duke botuar kohë pas kohe pjesë të temave të diplomave të studentëve tanë, me qëllim që atyre t'u ofrohet mundësi për paraqitje dhe një lloj stimulimi që ata të vazhdojnë në këtë drejtim.

Prej, rubrikave të reja jemi përpjekur që kohë pas kohe të kemi recesione, kronika të ngjarjeve kulturore, simpoziumeve apo konferencave shkencore si dhe shënime bibliografike.

Në qendër të vëmendjes së revistës ka qenë trashëgimia jonë kulturore shpirtërore dhe materiale në periudha të ndryshme të historisë sonë, si dhe portretet e figurave tona fetare dhe kombëtare në të gjitha trojet shqiptare.

Sa i përket planeve të redaksisë në të ardhmen, ne besojmë se ne po jetojmë në shekullin e specializimeve të ngushta, andaj është koha që kjo të ndodh edhe në shtypin islam në kuadër të Bashkësisë Islame. Besoj, se "Edukata Islame" duhet të profilizohet në një revistë më tepër edukativo arsimore me karakter pedagogjik, në veçanti kur ne kemi dy institucione të specializuara në këtë aspekt Fakultetin e Studimeve Islame dhe Medresenë "Alauddin". Ne shpresojmë se me pa-

varësimin e Kosovës, në një të afërme të afërt do të realizohet edhe kërkesa e jonë e kamotshme për inkorporimin e lëndës së edukatës fetare në shkolla publike. Andaj, kjo kërkon një revistë të specializuar, që do të merrej me këto çështje. Këtë mision mund ta kryej "Edukate Islame", në ndërkohë të themelohet ndonjë revistë tjetër, e cila do të merrej me çështje teologjike islame, apo pse edhe të mos ketë më shumë se një revistë që do të merrej me aspektet të caktuara të profileve të ngushta të shkencave islame, siç është lëmi i hadithit, tefsirit, jurisprodencës etj.

Puna në një revistë, është punë e përbashkët, ku marrin pjesë një numër faktorësh, prej përgatitjes e deri te arritja e saj tek lexuesi është një hallkë zingjirore, e cila nëse nuk funksionon si duhet mund të shfaqen defekte, andaj unë me këtë rast falënderoj të gjithë, duke filluar prej autorëve të punimeve, apo bashkëpunëtorëve, redaksinë, stafin teknik e deri tek distrubuesit si dhe lexuesit tanë.

Dhe krejt në fund, më lejoni t'u përkujtoj fjalën e Allahut të madhërishëm në fillim të kaptinës "El-Kalem", ku thotë: ***"Nun, betohem në penën dhe në atë që shkruajnë".***

Njerëzit vdesin; ngjarjet harrohen; objektet, sado të mëdha qofshin ato, i shkatërron dhëmbi i kohës. Mbetet vetëm fjala e shkruar dëshmi e kontributit dhe përpjekjeve të njeriut për kryerjen e misionit të tij në këtë botë kalimtare.

Ju falënderoj edhe një herë për durimin që patët dhe ju përshëndes me përshëndetjen islame

Esselamu alejkum.

ANALIZA

Akademik Jashar Rexhepagiq

DISA OPSERVACIONE MBI REVISTËN "EDUKATA ISLAME"

Në bazë të analizës së përmbajtjes dhe fizionomisë së revistës shkencore dhe kulturore islame - të Edukatës Islame, mund të nxirren disa të dhëna dhe rezultate teorike të cilat, ndoshta, do të kontribuojnë që kjo revistë në të ardhmen të jetë sa më e dobishme, më funksionale dhe në nivel të lartë shkencor, kulturor dhe në frymën e fesë, traditës, kulturës dhe disiplinave shkencore-fetare islame.

Vetë titulli i revistës "Edukata Islame" edhe deri tani na ka obliguar që në çdo numër të prezantohen tekste të ndryshme që i takojnë karakterit të kësaj reviste. Evidente është që në disa numra, në varësi prej artikujve të cilët i kishim në disponim, ka pasur më shumë përmbajtje nga këto tri fusha, kurse në disa numra të tjera të revistës kanë dominuar artikujt dhe punime të ndryshme gati kryekëput nga disiplina të fesë islame, sidomos nga tefsiri (komentarin e Kur'anit), nga e drejta sheriate, nga historiku i fesë dhe kulturës islame, nga Hadisi (të folurit dhe tradita gojore e Muhamedit), disa punime nga Ahlaku etj.

Jo vetëm sipas përmbajtjes të llojllojshme por edhe çdo numër në aspektin vëllimor kishte punime të reja, në të shumtën origjinale, disa nga Kosova, ose nga vende të ndryshme të Evropës, të vendeve të Azisë apo të ndonjë shtetit tjetër nga bota islame. Një nga ato tekste të rralla dhe shumë interesante u botua me titullin: *Islami në Australi dhe në Zelandën e re* (Edukata Islame, nr. 8112006, f. 307-325).

Nuk është tej çmim nëse do të themi se pak a shumë çdo numër mund të konsiderohet si një libër ose së paku një librushkë, nga e cila hasim në shumë gjëra të reja, më pak të njohura dhe të gjurmuara në kohën më të re, sidomos në shkencat islamologjike.

Pasi kjo revistë botohet në trevat kosovare, do të ishte normale që në *çdo numër të saj të ketë së paku* 2-3 *punime nga edukata, shkenca, kultura, figurat apo institucionet fetare dhe arsimore islame të Kosovës.* Fakt është se në disa numra është çmuar ky qëndrim parimor. Kështu, p.sh. në Edukatën Islame, nr. 8112006 janë prezente edhe këta tituj:

- Disa përparësi të arsimit në Kosovën e re, evropiane dhe moderne (f.11-15),
- Mahmud Pashë Rrotlla nga Prizreni - vakëfnameja e tij (f. 151-189),
- Xhamitë monumentale në Prizren (f. 191-213),
- Dr. Hasan Kaleshi, Dokumentet më të vjetra të vakëfit në gjuhën arabe në Jugosllavi1, recensioni.

Në anën tjetër kemi disa numra që janë pa asnjë tekst kushtuar edukatës islame nga ndonjë rajon, objekt apo figurë të Kosovës. Gjithashtu jashtëzakonisht pak kemi gjurmime dhe rezultate mbi temat nga Shqipëria. Parashtrohet pyetje: përse sidomos për Kosovën kemi aq pak artikuj, studime, vlerësime dhe kontribute të tjera të pjesëmarrësve, në veçanti nga radha e autorëve që merren me çështjet islamike, arabistike dhe më gjerë orientalistike. Arsyet janë disa, por dallohen këto:

1. *Arsyeja kryesore është që ende kemi pak gjurmues që zotërojnë arabishten dhe osmanishten*, të cilët me njohuri dhe dëshirë kishin hulumtuar shumë tema nga treva e Kosovës dhe më gjerë. Ato çështje meritojnë studime të posaçme. Për shembull, për çdo xhami e vjetër, sidomos për ato të shek. 15 dhe 16, si dhe shumë nga koha më e re, duhet të dijmë historikun, ndikimin (arsimor, fetar) dhe rëndësinë e tyre. Shumë medresa ka pasur në Kosovë. Shumë medresa ka funkcionuar në Prizren, jo vetëm ajo e Mehmed-pashës. Po edhe për këtë shkollë të mesme dhe të lartë kemi pak shënime e ajo, si dhe Medreseja e Madhe e Gjakovës dhe ajo më e vjetër nga shek.16 në Prishtinë, si dhe medresa e vjetër e Sanxhak-beut, Mehmed-begut, i cili në fillim të shek. 16 themeloi në Pejë një medrese dhe teqeje, gjë që dëshmon edhe Vakëfnameja e tij e vitit 1516, meritojnë jo vetëm ndonjë vlerësim analitik po edhe studime të veçanta serioze dhe vepra monografike.

Në revistën "Edukata Islame", në ato numra të parë bukur dhe në detaje

ishte shkruar për zhvillimin dhe rolin e Medresesë së Mesme "Alaudin".

2. Në "Edukatën Islame" *fare pak janë autorë nga institucionet islame* (nga Fakulteti i Studimeve islame, nga Medreseja "Alaudin", po edhe nga Bashkësia Islame e Kosovës), *po ashtu nga disa degë të Fakultetit filologjik dhe të Fakultetit filozofik si dhe nga institutet kërkimore-shkencore.*

Me siguri se nga shumë aspekte do të ishte e dobishme, që pranë Institutit Albanologjik të ekzistonte dhe vepronte edhe sektori i orientalistikës.

Kjo revistë me plotësime të duhura do të ishte më e pasur dhe në nivel më të lartë shkencor dhe profesional. Titullin e revistës "Edukata Islame" nuk duhet kuptuar ngusht se në te nuk mund të botohen edhe punimet nga gjuha, letërsia, historia kulturore, arsimi, etj., por edhe ato tema me lidhshmëri të ngushtë me të mësuarit dhe edukatën islame.

3. Disa nga individët arsimor janë pa përvojë, ndërsa të tjerëve u mungon njohja e metodologjisë së punës edukativo-islamike dhe kjo po ashtu mund të konsiderohet si arsye apo shkas pse nga shumë profesorë, imamë etj. me vite të tëra nuk kemi ndonjë artikull, shqyrtim apo së paku vlerësimin e librit që me vite të tëra ata e përdorin në disiplinën e vet.

"Edukata Islame" pa dyshim meriton shumë lëvdata, por për të ardhmen mendoj që më me rëndësi është të ndalemi edhe në disa sugjerime konkrete, siç janë:

a) që revista të ketë më pak përkthime, sidomos nga gjuha boshnjake;
b) që në këtë revistë shumë pak kemi gjurmuar trashëgiminë tonë islame e kulturo-historike. Sa shumë kemi intelektualë islamikë nga etnosi shqiptar që po ashtu meritojnë gjurmime dhe së paku të shkruhet për ta në rev. *Edukata Islame.* Për Ali-efendi Gjakovën, të cilin Samiu në Enciklopedinë e vet, së bashku me Hoxha Tahsinin, e vlerëson në nivelin më të lartë, deri më tani nuk kemi as shënime elementare për veprimtarinë e tij. Në Kosovë do të shtonim se sidomos nëpër teqe dhe në disa biblioteka të qyteteve e me siguri edhe në ato personale, ka *shumë libra dhe dorëshkrime* në gjuhë orientale dhe nga fusha të ndryshme, që do të ishin me interes shkencor, fetar e kulturor në çdo numër të *Edukatës Islame.* Të përshkruhet së paku nga një vepër që është ruajtur deri më tani. Një nga kjo fushë që e botoi kjo revistë (nr. 76, 2005, f. 65-73) ka titullin *"Teqeja në Rahovec dhe dorëshkrimet e saj"*. Sipas njohurive të gjertanishme mund të thuhet, me krenari, se ndër ato vepra të ruajtura janë edhe disa që kanë vlerën e lartë shkencore, filozofike, letrare, fetare, medicinale, etike, pedagogjike etj. dhe janë në nivelin e kulturës së përgjithshme islame;

c) që në çdo numër të revistës të kemi më shumë vlerësime dhe recensione të librave dhe botimeve tjera islame, si dhe nga tubime të rëndësishme shkencore e islamike;
ç) Në revistë *duhet të kemi* mundësisht *rubrikën e veçantë* ose kohë pas kohe të botuara *dokumente osmane në gjuhë arabe etj.* (si p.sh. deftere, ndonjë vakëfname e re, ndonjë ixhazetname, ndonjë dorëshkrim të vjetër të autorëve nga këto treva). Në atë mënyrë do të pasqyrohet edhe tarihu islam në vendin tonë;
d) Po ashtu, në këtë revistë duhet kultivuar *rubrikën e përhershme mbi kulturën, shkencën dhe edukatën në vendet e ndryshme islame.* Këtë rubrikë kohë pas kohe e kemi patur, por jo vazhdimisht;
dh) Çdo punim (artikull, recension etj.) në mënyrë të obligueshme nevojitet të recensohet. Kur është në pyetje studimi delikat dhe serioz, atëherë duhet caktuar dy recensorë, ndër ata njëri të jetë specialist i degës së ngushtë;
e) do të ishte mirë që në faqet e revistës të kemi edhe ndonjë temë aktuale, si p.sh.: *Universitetet islamike në të cilat kanë studiuar dhe studiojnë sot shqiptarët,* ose tema: *Historia dhe rëndësia e Universitetit "El-Azhar"*, ose: *Mektebi,* arab. maktab, *në të kaluarën edhe sot,* dhe tema të tjera të ngjashme;
f) Koha është që nga ky vit, në bazë të punimeve të revistës, *të botojmë gjatë vitit së paku* 1-2 *libra*, që do të ishin *botimet e "Edukatës Islame"*. Ato libra nuk do të ishin voluminoze (me rreth 80-100 faqe), në të cilat do të përfshiheshin temat më aktuale dhe shumëdimensionale. (p.sh. *Çështja e mësimfesë në arsimin e Kosovës,* ose tema: *Specifikat e pedagogjisë islamike,* ose çështje: *Edukata morale islame* etj.);
g) Gati në çdo numër të Edukatës Islame, nga arsyet informative dhe aktualiteti fetar një pjesë e tekstit duhet t'i kushtohet Bashkësisë Islame, p.sh. vendimet e saja, raportet në fund të vitit, vizitat e rëndësishme të delegacioneve apo individëve etj.;
gj) Sidomos lektori duhet të kujdeset maksimalisht për fjalë dhe nocione të ndryshme, për përdorimin e termave adekuate të shkencave të ndryshme (filozofike, historike,

teologjike, etj.), dhe në veçanti për përkthime sa më të sakta;

h) Në shumë revista praktikojnë që në fund të regjistrohen shënime të shkurtëra për autorët e teksteve, p.sh. emri dhe mbiemri i autorit, profesioni i tij, institucioni në të cilin punon dhe vendbanimi i tij;

i) Në fund, me ndihmën e Bashkësisë Islame duhet që në fillim të vitit kalendarik të sigurohen mjetet e duhura financiare për botimin e rregullt të revistës dhe për botimin e edicioneve të veçanta të saj (mundësisht dy librave në vit).

ANALIZA

Nexhat Ibrahimi

REVISTA EDUKATA ISLAME - përgjigje sfidave të kohës*

I.

Në botën bashkëkohore *edukimi* dhe *arsimimi* paraqesin koncepte të ndërlikuara dhe të ndërvarura. Zgjerimi i dijes njerëzore, sidomos në fushën e diturive natyrore dhe teknike, mundëson përmirësime dhe transformime (sasiore) në aspekte të ndryshme dhe, njëkohësisht, nxit frikë dhe rrit rreziqe të shumta. Në dituritë moderne dhe në njëmendësinë teknike të botës deri në kufijë të paimagjinuar po në këtë kohë, rritet edhe fuqia dhe pafuqia e njeriut.

Në këtë pozitë të paparashikueshme inkonstante rritet çështja e përgjegjësisë së njeriut në botën moderne. Po ashtu, në sistemin arsimor në fuqi, çdo ditë e më tepër relativizohet dimensioni moral i jetës njerëzore në Tokë. Me këtë rritet dallimi ndërmjet *dijes* (profanes) dhe *të shenjtes* (sakrales) në sistemin arsimor, duke u liruar nga rrënjët religjioze të tyre. Humanizmi shekullarist e ngadhënjeu fenë dhe shkollat i shndërroi në "kisha shekullare".

Universalizimi dhe globalizimi i arsimimit dhe edukimit sot zgjeron edhe fushat e ndikimit të dijes në formësimin e botës dhe jetës.

Po ashtu, zgjerimi enormë i dijes në botën aktuale rrit mosdijen njerëzore. Shumica e njerëzve nuk kanë mundësi t'i mësojnë njohuritë e reja nga laboratoret, institutet dhe qendrat hulumtuese. Ky imtësim e thellim i dijes, e copëton tërësinë e botës dhe të jetës në pjesë të palidhura, dhe, edhe pse rrit informacionet, megjithatë ndikon në mjegullimin e së vërtetës. Madje, termi "e vërteta" në shkencë është fjalë "demode".

Pra, në aspekt të arsimimit dhe të edukimit, muslimanët sot në përmasat botërore gjenden para sfidave komplekse. Ata gjenden ndërmjet kujtesës së tyre të zgjuar për traditën e tyre të madhe fetare, kulturore dhe arsimore dhe mosgjeturisë para të arriturave qytetëruese-teknologjike perëndimore.

Në pamundësi që të "ikim" nga kjo anije në mes të detit, në pamundësi për përgjigje të plotë, sepse pjesërishmëritë nuk mjaftojnë, na mbetet që të ofrojmë argumentet, dijen, këshillat tona për të cilat pretendojmë se i posedojmë dhe se kemi të drejtë.

II.

Si të bëhet ky ofrim i vlerave, ky demonstrim provash, ky prezantim ideshë nga ana jonë?

Përgjigjja është tejet e rëndë dhe vërtetë komplekse. Ndryshimet e mëdha politike, ekonomike, gjeo-strategjike dhe kulturore, Kosovën në përgjithësi dhe Bashkësinë Islame në veçanti, e sjellin në pozitë çfarë e ka pasur mbase pas largimit të Perandorisë Osmane më 1912, kur Kosovën, pjesën më të madhe të trojeve shqiptare dhe rajonin e okupoi Serbia dhe blloku ortodoks. Sipas mendimit tim, me rëndësi parësore është edukimi dhe arsimimi, ndaj Bashkësia Islame gjendet para mundësive dhe sfidave serioze.

Meqenëse ky diskutim nuk ka për qëllim dhe as nuk mund të elaborojë çështje kaq komplekse dhe multidisiplinare, do të fokusohemi në rolin dhe mundësinë që mund të ofrojë revista jonë e respektuar, Edukata Islame.

Duke u mbështetur në traditën e emrit të saj dhe asaj që me fjalën *edukatë* nënkuptojmë, revista **Edukata Islame** do të duhej të shtronte ide, sugjerime e pse jo edhe projekte konkrete në këtë rrëmujë idesh e veprimesh të provenienacave të ndryshme. Por, këto porosi apo ide duhet të jenë intelektuale dhe thellësisht të studiuara. Mendoj se roli i revistës **Edukata Islame** duhet kërkuar jo në kthimin formal e shterpë në burime, jo kthim në rrënjët shpirtërore, shoqërore, politike dhe qytetëruese, jo në kthimin fizik dhe sipërfaqësor në burime, por as në kultivimin e shtresimeve të dëmshme kohore. Edukimi dhe arsimimi nga revista **Edukata Islame** duhet të bëhet duke u udhëhequr nga burimet dhe kujtesa konstitutive dhe interpretuese dhe duke shfrytëzuar të gjitha me-Todat diturore. Duhet pasur parasysh edhe këtë se procesi i vetëdijësimit nuk bën të shtrihet vetëm në rrafshin

emocional, as shpirtëror, por tërësisht në të gjitha aspektet dhe sferat.

Mendoj se revista **Edukata Islame** në rrugëtimin e saj të ardhshëm duhet të bazohet në disa faktorë relevantë:

- Politika redaktuese e revistës duhet të vazhdojë të bazohet në vlerat e mirëfillta fetare. Feja në revistë duhet të jetë natyra themelore që njëmendëson raportin njeriu-Zoti. Dinamika e fesë në revistë duhet të rrjedhë nga njëmendësia e gjallë e fjalëve hyjnore, që përfshinë në veprimin e vet të mëvonshëm rritjen kozmo-historike të njeriut dhe botës. "Teologjia" në revistën Edukata Islame duhet të luajë rolin që diturisht të verifikojë dhe ndriçojë të gjitha format kreative të fesë dhe të përcaktojë të gjitha drejtimet në të cilat lëviz gjeniu i saj shpirtëror i gufuar, duke nxitur kështu edhe rritjen vetjake, praninë dhe kongjenialitetin në çdo çast historik dhe në çdo brez.

- Politika redaktuese duhet të jetë gjerë e hapur për botën e njeriut bashkëkohor dhe seriozisht t'i qaset shqyrtimit të të gjitha përvojave që fryma njerëzore i ka sajuar në vetë/zhvillimin e saj. Kjo është e nevojshme që të mund t'i kuptojë *shenjat e kohës së vet*, rrjedhat e transformimeve më të reja në të cilat hynë bota aktuale, sepse vetëm kështu teologjia denjësisht mund ta kultivojë praninë e Porosisë hyjnore dhe pejgamberike në shenjat përkatëse dhe ta ndërtojë atë në perspektiva të reja të botës bashkëkohore.

- Nëse shqiptarët, pra edhe revista **Edukata Islame,** dëshirojnë të marrin pjesë barabarësisht në kulaçin botëror, duhet të edukojnë teologë, intelektualë dhe ekspertë të atillë të cilët do të dijnë të integrojnë në pikëpamjet e tyre çdo gjë që është pozitive në përvojën aktuale botërore, në çka bën pjesë edhe parimi i personalitetit dhe individualitetit të njeriut modern, në të cilin duhet futur vlerat etike, estetike dhe aksiologjike të Islamit, nga të cilat njeriu modern gjatë kohë është i privuar.

Në fund, revista **Edukata Islame** do ta arrijë synimin e vet nëse do të dijë të shqyrtojë dhe të korrespondojë me rrethanat e ndryshuara në Kosovë e rajon, me rrethanat e ndryshuara politike dhe ekonomike, të korrespondojë konformë ndryshimeve politike-juridike të fesë dhe të Bashkësisë Islame në Kosovë, nëse do të dijë të korrespondojë dhe komunikojë me nevojat e besimtarëve dhe të organeve e institucioneve të Bashkësisë Islame, me mediumet e shkruara dhe elektronike në vend dhe me gjerë, nëse do të dijë të komunikojë me pluralizmin, ekonominë e tregut, nëse do të dijë t'u përgjigjet integrimeve evropo-perëndimore dhe sfidave të vlerave tradicionale dhe sektare ndër muslimanët

në Kosovë, në trojet gjithëshqiptare dhe me gjerë.

Të nderuar, tema është e gjerë dhe mund të thuhet edhe shumëçka, por mendoj se revista **Edukata Islame** është në binarë të mirë të rritet në një institucion në vete, në personalitet në vete, të ketë identitetin e vet. Për ta arritur këtë synim asaj i duhet ndihma e të gjithë neve.

---

* Disktuim rasti më 26.03.2008, i mbajtur në Kryesinë e BIK në Prishtinë, në Tryezën lidhur me ecuritë e revistës Edukata Islame.

RECENSIONE

Shevki Sh. Voca

NJË VEPËR E VEÇANTË PËR HISTORINË TONË KOMBËTARE E SHKRUAR PAK MË NDRYSHE

"NGA PERANDORIA OSMANE NË SHQIPËRI e shkruam historinë me tolerancë..." (OSMANLID'DAN ARNAVUTLUK'A tarihi hoşgörüyle yazdik...)

Vepra në fjalë është botim i përmbledhjes së kumtimeve të mbajtura gjatë zhvillimit të punimeve të "Konference Shkencore Ndërkombëtare" e mbajtur në Tiranë më 2 e 3 qershor 2005., nën organizimin e Zyrës së Administratës Turke për Bashkëpunim e Zhvillim pranë Kryeministrisë (TIKA), dhe Zyrës Rajonale në Tiranë, me titull "Toleranca në aktet administrative osmane", ("Osmanli Idari Yazişmalarinda Hoşgörü"). Karakteristikë e këtij libri është botimi i saj në dy gjuhë; në gjysmën e parë të librit gjenden kumtesat e botuara në gjuhën shqipe, ndërsa gjysma tjetër e këtyre kumtesave është në gjuhën turke dhe ka 481 faqe me materiale shkencore, plus shtojca me disa faqe në fund të librit, e ilustruar me fotografi të pjesëmarrësve të kësaj konference.

Në këtë Konferencë me kumtimet e tyre u angazhuan njëzet studiues, që vinin nga Turqia, Maqedonia, Kosova, Greqia dhe nikoqirët nga Shqipëria.

Kumtimet e mbajtura në Konferencë, që siç thotë në parathënien e veprës prof. as. Nevila Nika, u kushtohen

dëshmive të tolerancës dhe mirëkuptimit, të nxjerra nga burimet osmane, duke iu referuar një baze të re të dhënash, në ç'mënyrë ato japin pa dyshim një ndihmesë akoma më të madhe në kuptimin më realist të historisë. Ndoshta këtu është me vend të themi se nëpërmjet tyre gjithkush ka mundësi të gjejë një shpjegim më shkencor të shkaqeve se si mundi një super-shtet si Perandoria Osmane shumëkombëshe shumëgjuhëshe dhe shumë fesh të mbijetojë kaq gjatë, gati për pesë shekuj me radhë. (N. N.).

Kumtesa e parë e prezantuar në këtë libër është i studiuesit të njohur prof. dr. Shaban Sinani, me titull: "Burime për pozitën e kishës në ish-Perandorinë Osmane", në të cilën mes tjerash autori shpjegon për aktet e administratës së lartë osmane (fermane, berate) të cilat urdhëronin ndërtime dhe meremetime manastiresh, qelash e kishash katolike. Ato gjithashtu informojnë për raportet e ish-Perandorisë Osmane me rendet (urdhëratë) e të krishterëve romanë në Shqipëri, për regjistrimin e kishave dhe të pasurive të tyre, deri për konfirmimin apo emërimin e funksionarëve të lartë kishtarë (ipeshkvij, abatë etj.), ku autori më pas i radhit disa prej fermanëve të sulltanit dhe korrespodencat e ipeshkvit të Shkodrës e të tjerë... Ndërsa një kategori të veçantë fermanësh që janë me mjaft rëndësi për të kuptuar dhe analizuar raportet midis pushtetit perandorak dhe të kishës ortodokse, apo siç thotë ky autor qëndrimi më i saktë ndaj besimit të të tjerëve, janë fermanët me karakter nominimi, konfirmimi, apo rikonfirmimi në detyrë të prelatëve të lartë të kishës në fjalë. Fermanë të tillë, shkruan më tej autori, njoftojnë se autoritetet perandorake jo vetëm që e njihnin pushtetin e kishës, por i jepnin fuqi shtetërore juridike atij pushteti, brenda autonomisë së vet.

Autori i shkrimit në vazhdim "Pronat e të krishterëve dhe pozita e faltoreve të tyre në fermanët sulltanorë" është prof. dr. Aleksander Meksi, i cili përveç tjerash kur bëhet fjalë për interesat e pronësisë individuale në mes tjerash thekson fermanin e vitit 1737 ku, ndër të tjera, i tërhiqet vëmendja për cenime të së drejtës pronësore të një krishteri. Ndërkaq, që autori përmend edhe ferman tjerë si ai i datës 1690, ku urdhërohen spahinjtë e Delvinës që të mos kërkojnë taksa nga pronat kishtare, pastaj rastin e Kamenicës (1699), ku gjithashtu urdhërohet në moscenimin e pronave kishtare, e deri te një ferman i sulltan Abdyl Mexhidit i vitit 1852, ku bëhet fjalë për një urdhër, në të cilën thuhet që të mos preken me taksa banorët e krish-

terë të kalasë së Elbasanit... Petrika Thëngjilli nga Universiteti i Tiranës sjell punimin "Ligji dhe drejtësia në fermanët", në të cilën pos tjerash ofron të dhëna interesante të shek. XVII për mbrojtjen që i bënte Perandoria Osmane rajës së fshatrave të Elbasanit dhe të Shpatit nga fajdexhinjtë me rastin kur raja ishin ankuar kundër fajdexhinjve të këtyre dy qyteteve të cilët i kishin gjobit me kamata të larta për borxhin e huazuar. Sulltani kishte urdhëruar gjykimin e fajdexhinjve në Stamboll në praninë e përfaqësuesve të të ankuarve. Shteti gjithashtu, vazhdon autorja, rajën e mbronte edhe nga prerja e parave falsë të cilat zhvlerësonin monedhën dhe përkeqësonin nivelin e jetesës. Ndërsa në gjysmën e dytë të shek. XVII (1677), sulltani i kishte bërë me dije kadiut të Vlorës, meqenëse myteselimi njëfarë Aliu, në kundërshtim me ligjin e shenjtë u kishte bërë zullum të vobektëve dhe u kishte rënë në qafë këtyre, u pushua nga puna. Të mos lejoni njeri të veprojë në kundërshtim me ligjin e shenjtë dhe me urdhrin tim të nderuar. Jo rrallë sulltani shkarkonte edhe kadi nga detyra etj. Ndërsa as. prof. dr. Nevila Nika, në një studim relativisht të shkurtër, me temën "Probleme të familjes dhe pronësisë në dokumentet e administratës osmane", trajton problemet lidhur me familjen si një qelizë thelbësore e një shoqërie, si dhe problemet e pronësisë, ku vihet në pah dokumenti i mëhershëm që bën fjalë pikërisht për një problem të tillë që është fermani i sulltan Bajazitit të II, i vitit 1484, me anë të të cilit ai i dhuronte si favor për shërbimet e tij, Iljaz bej Mirohorit, një timar në katundin Vithkuq... Shkrimi "Fermanët sulltanorë si forma të dhënies së të drejtës ndër shqiptarët" të autorit Kaliopi Naska, bën fjalë për fermanët si dokumente që kryesisht dalloheshin mbi të gjitha tipat e tjerë të dokumenteve për përkryeshmërinë e tyre nga pikëpamja kompozicionale, gjuhësore, kalo-grafike dhe përmbajtjesore. Autori thekson se brenda 600 fermanëve të Shqipërisë zbulohet një realitet që na lejon të kuptojmë se ka tolerancë në këto akte etj. Ndërkaq, në qendër të kumtesës së studiuesit të njohur të çështjes kombëtare prof. dr. Gazmend Shpuza, është punimi me titull "Bashkëjetesa ndërfetare midis shqiptarëve", ku autori me fakte dhe argumente shtjellon çështjen e kësaj dukurie të popullit tonë, e cila me siguri është ndër të radha në botë. Ajo çka i dallon dukshëm shqiptarët e të dy besimeve nga të tjerët e veçanërisht nga fqinjët thotë autori, është bashkëjetesa e ngushtë ndërfetare që ka mbijetuar me

shekuj. Ai citon studiuesin e mirënjohur Aristidh Kola, i cili në librin e tij "Arvanitët" (Athinë, 1986) mes tjerash me të drejtë thekson, që nuk ka ekzistuar asnjë rast i kthimit të fesë me dhunë nga ana e turqve, duke e konsideruar këtë si "gënjeshtër qëllimkeqe". Më tej ai ngul këmbë që "ndërrimi i fesë së shqiptarëve me dhunë është pjellë e fantazisë dhe shpikje e murgjve dhe nuk është aspak e hijshme që ta pretendojnë këtë historianët" (A.K.). Pason shkrimi "Elita kulturore shqiptare në letërsinë shqipe me alfabet arab", me autorë dr. Genciana Abazi Egro, nga Instituti i Gjuhësisë Tiranë. Autorja, pasi zë në gojë letërsinë shqipe të krijuar në viset shqiptare nga komuniteti mysliman kryesisht gjatë shek. XVIII., për çka thotë se është një segment letrar më pak i studiuar në historinë e letërsisë shqipe, dhe pasi sqaron fenomenin e këtij emërtimi letrar, ajo thekson se letërsia shqipe me alfabet arab është produkt i elitës së re myslimane të krijuar në trojet shqiptare, pas vendosjes së turqve osmanë në Shqipëri. Ajo lindi në radhë të parë si nevojë shpirtërore e kësaj elite për të krijuar dhe shprehur në shqip etj. "Administrata e Perandorisë Osmane nuk i ndryshoi me forcë toponimet e popujve të krishterë të Ballkanit", është kumtesa e studiuesit të njohur kosovar prof. dr. Ilijaz Rexha nga Prishtina, i cili na jep të dhëna mjaft interesante për tolerancën e administratës osmane, e cila kishte sistemin e saj specifik administrativ-juridik, me ç'gjë ajo qysh në fillim u tregua tolerante ndaj institucioneve që i kishte hasur në territorin e ish-Perandorisë Bizantine dhe shteteve tjera të Ballkanit, duke mos i ndryshuar ligjet tradicionale dhe zakonore të popujve të krishterë. Duke u bazuar në burimet shkrimore dhe arkivore, autori thekson se shihet qartazi që administrata osmane nuk kishte vepruar ashtu siç kishte vepruar administrata e mëhershme mesjetare sllave, ku shumicën e toponimeve të popujve autokton të Ballkanit, e sidomos ato të popullit shqiptar, i ndryshoi në mënyrë arbitrare, duke i sllavizuar tërësisht etj. Ndërsa nga Instituti i Historisë Nacionale të Maqedonisë nga Shkupi, vjen prof. dr. Ahmet Sherif me punimin "Vakëfet dhe roli i tyre në Perandorinë Osmane", i cili prezanton rolin e rëndësishëm të vakëfeve që ka pasur në jetën e përditshme në zhvillimin e jetës arsimore, kulturore dhe fetare-shpirtërore të popullatës gjatë Perandorinë Osmane. Autori shpjegon se vakëfet e para në vendet e Ballkanit, janë paraqitur menjëherë pas depërtimit dhe pushtimit të Osmanlinjve. Va-

këfet paraqitnin komplekse të mëdha të përbëra nga objekte të shumta fetare, bamirëse dhe objekte me karakter profan të cilat ndërtoheshin me ndihmën e tyre, thekson mes tjerash studiuesi A. Sherif. “Fermanët sulltanorë dëshmi të tolerancës ndërfetare në shtetin Osman” është kumtesa e prof. dr. Nezir Bata i Universitetit të Tiranës, i cili pasi jep shpjegime rreth përmbajtjes së vlerave estetike dhe artistike të konsiderueshme të fermanëve të cilat shprehen edhe në aspektin stilistikor, kaligrafik, dekorativ etj., dhe që shtrihen në një hapësirë kohore për një periudhë gati 600-vjeçare, dhe në një hapësirë gjeografike që sjellin të dhëna për historinë e mbi 20 shteteve të pavarur të formuara pas shkatërrimit të Perandorisë Osmane, ai shpjegon për tolerancën e kësaj perandorie ndaj popullsive dhe grupeve jomyslimane gjë që tregon edhe fakti që emrat dhe fetë e vendeve Ballkanike vazhduan të ekzistonin gjatë gjithë sundimit osman. Fermanët në vazhdim thotë autori, tregojnë se politika e taksave e ndjekur nga shteti osman ishte shumë e kujdesshme. Tema tjetër e radhës “Forma dhe përmbajtja e fermanëve sipas burimeve arkivore” e dr. Entela Muça, nga Arkivi shtetit të Tiranës, jep të dhëna interesante për Perandorinë Osmane rreth saktësisë në organizimin dhe funksionimin e saj, duke filluar nga elementet që në pamje të parë duken jo fort të rëndësishme e deri në hallkat më të ndërlikuara, nga elementi më i thjeshtë e deri tek ato të hartuara nga vetë padishahu, dhe vazhdon duke theksuar që krijimit të këtyre dokumenteve u është kushtuar kujdes deri në detaje më të imta. Më pas fillon me sqarimin e dokumenteve veç e veç prej asaj që i përkiste vetë padishahut, të atyre me urdhra shtetërore, dokumente brenda qytetit dhe zyrave, dokumente me raporte dhe lutje-kërkesa e shumë të tjera. Autorja pastaj sqaron problemet e trajtuara në fermanët sipas degës së veprimtarisë, e cila reflektohet në përmbajtjen e tyre që i ndan në shtatë grupe duke dhënë shpjegime të duhura veç e veç. Prof. dr. Nevzat Yalçintaş, në punimin me titull “Islami drejtësia dhe Osmanët”, jep të dhëna interesante studimore lidhur me përcaktimin e drejtësisë në Islam, ku duke zbërthyer drejtësinë, e cila thotë autori, ka prejardhje hyjnore ndalet në pika të shkurtra në drejtësinë në nivel të individit, drejtësinë si themel i sistemit social etj. Pastaj kalon në vlerat më të ndrituara të qytetërimit dhe të kulturës osmane që i bën osmanët të njohur, si për shembull: drejtësia, shteti ligjor, barazia, liria e plotë fetare, punët botore

dhe kështu me radhë. Ndërsa dr. Mehmet Aykaç-koordinatori i punës sociale pranë Ambasadës Turke në Tiranë, i cili kishte zgjedhur kumtesën me temën “Këndvështrimi i shtetit osman mbi qeverisjen dhe shërbimin (shembuj nga urdhëresat)”, në të cilën përqendrohet për listën e amaneteve të zotërimeve; Arkivat Osmane, Urdhëresat. Pastaj bën fjalë për urdhëresat që ruhen në arkivat e Shqipërisë, dhe për shembuj që vinin nga urdhëresat lidhur me Shqipërinë, urdhëresa që i është dërguar gjykatësit të ligjit të Beogradit, në të cilën bëhet fjalë për ligjin e sulltan Sylejmanit, që i mbron të drejtat e popullit, i cili jeton në zonën e Beogradit, që lidhet me Shqipërinë e pushtuar në luftën e Kosovës të vitit 1389, e deri te një urdhëresë e të drejtave të njeriut dërguar gjykatës së Beogradit, në vitin 1558. Me një material mjaft joshës për interesin e historisë sonë kombëtare, shkruar më ndryshe nga ato deri më tani, me përjashtim të disave, vjen prof. dr. Muzafer Tufan, me trajtesën e tij që mban titullin “Toleranca Osmane që mbrojti identitetin e popullit shqiptar”, i cili me një shpjegim të thellë dhe të qartë që siç shprehet prof dr. Nevzat Yalçintasi, tregon një profesionalizëm mbi historinë e popujve të Ballkanit, me të cilën pa dyshim jep një ndihmesë shumë të madhe për këtë çështje. Në fund të kësaj trajtese përveç të dhënave tjera autori ka lënë vend, me ç’gjë pasurohet edhe më tepër ky shkrim, për prezantimin e të gjithë kryeministrave, kryesekretarëve dhe kapitenëve të flotave osmane me origjinë shqiptare. Në çka përmenden 9 kapiten flotash, 5 kryesekretar dhe 35 kryeministra.

Nocioni i mirëkuptimit është një nocion që ka një histori, kulturë dhe filozofi fetare. Kështu e fillon punimin e tij as. prof. dr. Ahmet Hikmet Eroğlu nga Universiteti i Ankarasë, Fakulteti Teologjik, me titull “Mirëkuptimi i shtetit osman ndaj atyre që nuk ishin mysliman” dhe vazhdon me zbërthimin e kësaj trajtese duke u përqendruar në politikën që ndiqte shteti osman lidhur me popujt jomyslimanë, pastaj me mirëkuptimin e treguar ndaj njerëzve jomysliman në certifikatat e tyre, duke bërë fjalë për shtetin osman e cila ishte e organizuar sipas atij sistemi që quhej sistemi popullor, e që ky sistem popullor thekson më tej autori ka qenë një sistem i mbështetur jo në racë, por në besim. Në një sistem të tillë njerëzit janë organizuar sipas besimeve të tyre, në ç’mënyrë ata edhe i kanë vendosur kontaktet me shtetin. Pedagogu në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Turke në Universitetin e Shkupit, dr. Fadil Hoxha sjell kumtesën

"Rreth poetëve shqiptarë në poezinë e Divanit Osman", në të cilën pasi që jep sqarime rreth etimologjisë së fjalës *tezkire* nga gjuha arabe *"ziker"*, që do të thotë diçka që shërben, që bëhet shkak për të kujtuar e që në fushën e letërsisë ka një gamë shumë të gjerë të përdorimit, ai në qendër të objektivit të këtij shkrimi e vë njëfarë Ali Emiri, i cili në veprën e tij "Tezkire-i Shuarayi Amid" flet për autobiografinë e gjithsej 212 poetëve të ndryshëm, të cilët me shkrimet e tyre kanë kontribuar në poezinë e Divanit Osman, në mesin e të cilëve bën fjalë edhe për 20 poetë të njohur shqiptar, që kanë vepruar brenda kufijve të Shqipërisë, prej të cilëve nëntë janë nga Shkodra, katër nga Tirana, tre nga Kruja dhe nga një prej Peqini, Ulqini, Kavaja dhe Zileja. Ndërsa në vijim të kësaj kumtese autori i prezanton edhe emrat e tyre. Dr. Giyasettin Aytaş sjell trajtesën me temën "Analizat thelbësore të nocionit të mirëkuptimit në dokumentet e periudhës Osmane dhe Shqipëria". Autori pasi ndalet në përgjithësi mbi nocionin "mirëkuptim" ai ndalet edhe mbi rëndësinë që ka ky nocion për shtetin dhe individin. Dr. Aytaş në këtë punim më tepër përqendrohet rreth rolit të tarikatit bektashi në Shqipëri, për ç'gjë thotë se shtrirja e bektashizmit në Shqipëri është më tepër një fryt i gjendjes politike, historike, fetare, kulturore, ekonomike dhe ushtarake etj., dhe më pas e jep historikun e informacioneve të para të bektashizmit në Shqipëri, duke e përcjellë me disa urdhëresa të sulltanëve. Trajtesa tjetër e radhës "PAQJA, SIGURIA DHE DREJTËSIA NË MODELIN OSMAN" me nëntitull *Rikthimi i Paqes Kundra Dhunës Globale*, i autorit nga Turqia, dr. Hilmi Demir, i cili me punimin e vet mundohet të japë shpjegime për bazat juridike dhe morale të modelit Osman, e cila për t'u sjellë paqen dhe vlerat fetare dhe filozofike mbështetjen e gjente te një siguri dhe drejtësi e mirëfilltë. Në shembujt që i sjell autori më vonë shihet se në rajon roli kryesor do të jetë i politikës paqedashëse Osmane dhe Shqiptare. Përveç kësaj autori në këtë kumtesë duke bërë krahasime bën fjalë edhe për fenomenin e globalizmit që po e përjetojmë sot. Ndërsa shkrimi "Gjendja administrative e zonës së Shqipërisë së Jugut në periudhën klasike dhe mënyra e drejtimit të Perandorisë Osmane në Shqipëri" i autorit dr. Önder Bayir, përveç titullit më të gjatë prej të gjitha kumtesave tjera të mbajtura në këtë konferencë, ajo gjithashtu, edhe për nga përmbajtja është më e gjata me rreth 50 faqe. Këtë trajtesë autori e ka ndarë në tri pjesë që ofrojnë të dhëna mjaft të pasura, duke filluar prej gjendjes administrative të zonës së Shqipërisë së jugut në periudhën klasike me regjistrat e zonave që supozohet të jenë banuar nga shqiptarët, pastaj kalon në njësite administrative të Livasë së Vlorës në Ejaletin e Rumelisë sipas regjistrit nr. TD 99 të vitit 926 H., e deri te mënyra e qeverisjes së Perandorisë Osmane në Shqipëri, në të cilën përfshihen aktiviteti i lidhjeve publike, jeta fetare, arsimi, administratë-financa etj., të cilat përcjellën me faksimile dokumentesh. Ndërkaq, që kumtesa e fundit në këtë libër është e dr. Mustafa Balçit, pedagogut në Universitetin e Tiranës, me titull "Stili zyrtar osman në fermane". Autori pas sqarimit etimologjikë të fjalës ferman, që vjen nga persishtja dhe ka kuptimin urdhër, urdhëresë, ai kalon për të sqaruar kuptimet e përafërta që hasen në burime të ndryshme. Ndërsa që në vazhdim na bie në sy një estetikë e shumëanshme, të cilin autori për interesa studimi e ka ndarë në këtë mënyrë:

Anën figurative me nën grupe si: a) shkrimet, b) vendosja mbi fletë c) zbukurimet, dhe anën letrare si: a) semantikë dhe b) vokale etj. pastaj jepen edhe disa sqarime lidhur me këto.

Me siguri se shfrytëzimi i kësaj vepre nga ana e studiuesve (lexo historianëve) paraqet një interes të madh dhe të veçantë, që në të ardhmen të shkruhet dhe të flitet pak më objektivisht rreth së kaluarës sonë kombëtare e posaçërisht të kohës së qëndrimit pesëqindvjeçar turk në vendet Ballkanike.

RECENSIONE

Nexhat Ibrahimi

STRUKTURA PERFEKTE E ISLAMIT

Një meditim rreth veprës: Dr. Milazim Krasniqi,
Islami i keqkuptuar dhe fatkeqësia botërore
"Zëri Ynë", Prishtinë, 2007 fq. 150.

"... kundërshtarin të cilin dikush nuk e pëlqen, së pari e paraqet në formë të shtrembëruar,
e pastaj përpiqet ta shkatërrojë sikur përbindëshin".
(J.W.Goethe, Dichtung und Wahreit, band 16, s.1)

I. Hyrje

Dr. Milazim Krasniqi dhe botuesi "Zëri Ynë", kohëve të fundit na dhuruan edhe një vepër të çmueshme, me titull **"Islami i keqkuptuar dhe fatkeqësia botërore".** Libri me problematikën që trajton dhe analizon, ngërthen të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen nga pikëpamje kulturore, filozofike dhe historike, me theks të posaçëm në përditshmërinë politike dhe në konstelacionin kompleks të së vërtetës. Tre kapitujt e veprës, si në vertikale ashtu edhe në horizontale, paraqesin një kontinuitet të disa veprave të mëparshme dhe një observim edhe më të thelluar dhe më studioz.

Duke e pasur parasysh kohën në dispozicion dhe konsideratën për durimin tuaj do të përpiqem që observimet e mia t'i shtroj të rrëgjuara dhe vetëm disa sosh, duke rrezikuar të keqkuptohem. Mirëpo, shpresoj se leximi i veprës nga ana juaj do ta plotësojë pafuqinë time të shpreh tërë atë që dëshiroj për këta pak minuta.

II. Themelet e përhershme të njerëzimit

Do të filloj me tezën e autorit se **"... më vonë u binda se Islami nuk kishte nevojë të mbrohej ... sepse struktura e tij jo vetëm që nuk ka asgjë të përbashkët me totalitaren e me terrorizmin, por në të vërtetë është një strukturë aq perfekte sa kushdo që e studion me qëllim të sinqertë, mbetet i mrekulluar..."**, për të theksuar se ky trend është i pranishëm në shumë periudha historike, sidomos ato të dekadencës myslimane, kur në vend të prezantimit (teblig) të Islamit dhe vlerave të tij, intelektualët myslimanë janë përpjekur të dëshmojnë Zotin, të dëshmojnë pafajësinë e Islamit e të tjera, duke rënë në defansivë madje edhe konfuzion ideor, duke u barrikaduar brenda formulimeve juridike e teologjike dhe për ta ndalë frymën e ixhtihadit dhe të mësuesve të parë. Duke e braktisur tezën e dëshmimit racional të Zotit, ne jemi mbrojtur nga një lloj antropomorfizmi, sepse Zoti i dëshmuar është Zoti i krijuar, i personifikuar (sikurse në krishterim apo në disa sisteme filozofike) apo siç e thotë këtë Karl Jaspers **"...Zoti i dëshmuar nuk është Zot, por do të ishte vetëm një nga gjësendet në botë. Dëshmitë e ashtuquajtura mbi ekzistimin e Zotit burimisht fare nuk janë dëshmi, por rrugë të vetëdijesimit ideor. ...".**

Ndonëse nga një kënd tjetër, prezantimin e Islamit si problem e thekson edhe autori duke thënë se **"myslimanët duhet të jenë maksimalisht të kujdesshëm se si e prezantojnë Islamin, sepse Islami nuk është produkt i mendjes së tyre dhe nuk është dekor nacional i asnjë kombi. Islami është Shpallje e Allahut Fuqiplotë dhe me Shpalljen e Tij nuk mund të abuzohet duke bërë interpretime parciale dhe sipas interesave të çastit..." nga "të vetëzgjedhurit", "të vetëshpallurit si liderë" (fq. 22)** dhe për këtë arsye autori fton që si kundërpërgjigje të mos jetë dhuna, por **"të afirmohet vazhdimisht struktura perfekte e Islamit Hyjnor..."(fq. 23).**

III. Struktura ideale e Islamit

Duke e lexuar veprën e dr. Milazimit, mësojmë se **"Islami është tradita tokësore e Mesazhit, ruhi i saj historik, leximi i saj meta-logjik në**

diskursin logjik tokësor, aktualizimi etik brenda teatrit natyror të etikës së njeriut dhe njëmendësimi estetik brenda portretizimit të gjithmbarshëm historik të atij synimi fondamental të fesë si të tillë që njeriu të rritet deri te masa (fotografia) e Frymës hyjnore."

Duke e lexuar veprën më tej ne mësojmë se **"Imani (besimi) është intuitë qiellore e natyrës burimore njerëzore, kurse Islami është institucion i tij historik. Imani është feligj (el-hakikatu) sipas Frymës hyjnore, kurse Islami është feligj (esh-sheri'atu) sipas natyrës makrokozmike dhe mikrokozmike."**

Mësojmë gjithashtu se **"Imani si veprim shënon nxjerrjen e frymës (ruh) sonë jashtë në botë dhe portretimin e gjeniut tonë të brendshëm të besimit në pëlhurën e njëmendësisë sonë të përditshme jetësore. Mirëpo, kjo mund të arrihet vetëm me angazhimin dhe fuqinë tonë mendore të kapërcimit tonë metafizik, por barabartë me këtë edhe me fuqinë e virtytit tonë të njëmendët në fushën e feligjit (el-islam) dhe të religjionit praktik (ed-din) dhe këtë gjithnjë me urtësinë e besimit. Praktika e amshueshme e mendimit (hadith) dhe mendimi i praktikës (sunna) të të cilave përgjithnjë janë dhënë në përsosmërinë shpirtërore dhe morale të personalitetit të Pejgamberit a.s. dhe në jetën e tij të virtytshme të besimtarit dhe të pejgamberit."**

Duke e lexuar veprën ne mësojmë se Islami afirmon parimin se siguria është një nga parimet themelore të jetës njerëzore dhe faktor i domosdoshëm në zhvillimin dhe përparimin e jetës në përgjithësi. Vetë Qabja është vend i sigurisë: ***"Dhe tempullin e Qabesë e bëmë vendtubim dhe vend të sigurt për njerëzit. …".*** *(El-Bekaretu, 125).* Islami këtë siguri e kërkon edhe për çdo shtëpi dhe komunitet dhe është në kundërshtim të rreptë me ata që e thyejnë sigurinë në shoqëri, bëjnë dhunë dhe krijojnë përçarje.

Autori këtë strukturë perfekte, siç e quan Islamin, e ndërton mbi disa parime boshtore:

1. Në **maksimën e tewhidit dhe njeriun** si qenien më të përsosur, por pa ingerenca sovrani;
2. Në **institucionin e pejgamberisë**, si shembullin më të mirë praktik të aplikimit të porosisë hyjnore;
3. Në **dijetarët e sinqertë**, si shtresë drejtuese, këshilluese e udhëzuese, por jo në pozitë kleri e ndëshkuesi;
4. Në **dëshmorët - shehidët,** si shtresë e sakrifikuar për ideale të larta, për interesa të shumicës;

5. Në **besimtarët** - shtyllë dhe shembull praktik të Islamit;
6. Në **individët** - si subjekte integruese në shoqërinë myslimane. (fq. 25-80).

IV. Dhuna si model i pafesë

Kapitulli i dytë i veprës me dy nëntitujt e tij trajton **dhunën** dhe format e dhunës, burimin dhe gjenezën e dhunës. Si përmbledhje të saj mund të theksojmë se autori dhunën e nxjerr si prodhim të mosbesimtarëve dhe të ideologjive të tyre.

Do të theksoj se në një shkrim të para disa vitesh, dhunën në botën aktuale nuk e kam quajtur konflikt ndërmjet qytetërimeve, siç bëri S. Huntingtoni apo F. Fukujama, por e kam thënë se konflikti aktual në botë është **"jo ndërmjet feve, por ndërmjet fesë dhe pafesë, ndërmjet besimtarëve dhe jobesimtarëve."** Këtë e dëshmojnë shumë prova, sikurse **"lufta tashmë disashekullore kundër fesë nëpërmjet shekullarizimit, laicizimit dhe formave të tjera antifetare, qëndrimi perëndimor *liria nga vetë feja* (freedom from religion) në vend të *liria e fesë* (freedom of religion) çon drejt luftës ndërmjet fesë dhe pafesë, të kamufluar si luftë ndërmjet feve."**

Vepra e dr. Milazimit më kujton mendimin e intelektualit të madh francez, Rozhe Garodin, i cili duke analizuar frymën perëndimore, thotë:

"Qytetërimi perëndimor gjendet i mbyllur në rrethin të cilin e ka ndërtuar vetë. Rezultatet pozitive të këtij qytetërimi mbahen brenda tij, kurse ajo që është negative mund të gjendet në hapësirë të hapur. Mendimi perëndimor zë fill dhe ushqehet në përgënjeshtrimin e të tjerëve, sikur ata të cilët jetojnë duke pirë gjakun e të tjerëve dhe në rastin kur nuk mund të gjejnë gjak të huaj për të pirë, ai ia pinë gjakun vetvetes. Për këtë arsye, qytetërimi perëndimor do t'i kthehet vetvetes dhe ky do të jetë njëri nga faktorët e shkatërrimit të tij."

Këtë gjendje autorja bashkëkohore Karen Armstrong, në veprën e saj **The Battle for God** (Beteja për Zotin), e përshkruan si më të rëndë se më herët edhe pse kultura bashkëkohore na ka siguruar të drejta më të mëdha, liri më të madhe, shëndet më të mirë etj., por, siç thotë ajo, duke **"na çliruar nga robërimi ndaj Zotit të mbinatyrshëm, kultura bashkëkohore zbulon brishtësinë, lëndueshmërinë dhe mungesën e dinjitetit tonë."**

Në këtë aspekt, si pasojë e moszbatimit të programit hyjnor, si pasojë e moskoordinimit të raporteve ndërmjet individit dhe kolektivit, autori i veprës thekson se do të pasojë **"shkatërrimi i atyre vendeve, banorët e të cilëve janë punëkëqij."** (fq. 90). E kundërta, nëse njerëzit e zbatojnë institucionin e **shurës** (konsultimit) **në çështje të mëdha, duke u mbështetur në Allahun, atëherë mund të pengohet arritja në pushtet e tiranëve.** (fq. 206).

Këtë gjendje të parashkatërrimit e kanë vërejtur edhe vetë perëndimorët, sikurse Osvald Spengler, Martin Hajdeger e sidomos Garodi, Bikaji, Hofmani, Animari Shimel etj. Ata duke vërejtur njeriun e humbur në vakuumin moral, në nihilizmin dhe etjen spirituale, kërkon rrugën e moralit dhe burimin e spiritualizmit. Disa klithin: **"Ja, këtu është rruga e drejtë"**, mirëpo, në atë zhurmë dhe rrëmujë ideore, në atë pavlerë e tirani dhe racizëm të evrocentrizmit, këta zëra të arsyes nuk dëgjohen.

V. Kthimi vlerave burimore

Në kapitullin e tretë, të fundit autori me 4 nëntituj përpiqet të riafirmojë nevojën tashmë të ngritur për kthimin drejt burimeve. Kjo është aktuale thuajse në të gjitha fetë, pra edhe në krishterim por edhe në Islam dhe emërtohet me shprehje të ndryshme: fundamentalizëm, revivalizëm etj. Si do ta quajmë, tendenca për kthim drejt burimeve është aktuale, por kjo nga faktori ndërkombëtar bëhet problematike vetëm për myslimanët. Perëndimi duke përdorur standarde të dyfishta, fundamentalizmin e krishterë e hesht, e pranon si normal, por atë mysliman e quan të rrezikshëm dhe si pasoje kemi një varg luftërash.

Autori thekson se vetëm me sigurimin e të drejtave të plota sipas Islamit, ku bëjnë pjesë të drejtat dhe detyrimet e njeriut ndaj Zotit, pastaj të drejtat dhe detyrimet ndaj vetes, ndaj njerëzve të tjerë, ndaj shtazëve, bimëve etj., mund të sigurojë njëfarë paqeje dhe të **"minimizojë vlerat e paganizmit, të politeizmit e të ateizmit në fatet e shoqërive njerëzore."** (fq. 139)

Fakti se të tri fetë tradicionale (Judaizmi, Krishterimi dhe Islami) e kanë njohur Absolutin, e kanë besuar Atë dhe njeriu ka ekzistuar vetëm në kuadër të këtyre të drejtave e jo me të drejta absolute dëftojnë se sa herë që njeriu në emër të ndonjëfarë ideologjie ka shkelë kompetencat e tij, ka ardhur deri te rrëmuja në të gjitha fushat e jetës. Kjo gjendje është drastike

sidomos gjatë viteve të fundit, kur njeriu shekullarist uzurpoi të drejta absolute për vetveten. Kjo është me pasoja të rënda sidomos për Islamin dhe myslimanët.

Për dallim prej mesjetës kur Islami nuk njihej nga Evropa, apo njihej vetëm me dioptri bardhë e zi, në këtë kohë "Islami u bë i njohur në Perëndim, por jo edhe i kuptuar" Pasojat janë të ngjashme, dhunë, dhunë dhe vetëm dhunë.

I bashkohem shpresës së autorit se një Islam i interpretuar drejt botës mund t'i ofrojë paqen.

Në vend të përmbylljes

Para vetes kemi një vepër të çmueshme, të mrekullueshme, leximi i vëmendshëm i së cilës do të krijojë te lexuesi përfytyrime dhe disponim të ndryshëm, varësisht nga këndi i akcesit dhe perceptimi i gjuhës dhe i porosive të veprës. Megjithëkëtë, vepra ofron impulse dhe reflekse të shumta, të cilat do të kuptohen vetëm pas disa leximeve; në vepër do të vërehet sinqeriteti dhe dashuria e autorit për të kaluarën njerëzore që të ndërtojë të ardhmen, mbi vlera universale, hyjnore dhe botërore, do të vërehet ftesa e autorit për mirëkuptim, bashkim rreth vlerave, për tolerancë dhe integrim bashkëkohor.

Vepra e Dr. Milazim Krasniqit, *Islami i keqkuptuar dhe fatkeqësia botërore*, është një punë e mirë e autorit, është një kontribut origjinal drejt mirëkuptimit ndërmjet feve, kulturave e qytetërimeve, por edhe një nder për gjuhën tonë, sepse me këtë dëshmojmë se edhe ne mund t'i ofrojmë botës ide dhe mësime të vlefshme. Vepra i bën më serioze temat të cilat përditësisht shqyrtohen në mediume të shkruara dhe elektronike, por shpesh pa përgjegjësi, sipërfaqësisht dhe me mënyrë fushate; ajo nuk është as vepër kabinetike dhe e mbyllur në sistemin e nocioneve, të cilat me ftohtësinë e tyre dhe nga lartësia shpesh nuk arrijnë te lexuesi dhe lexuesi nuk e njeh atë.

Për këtë arsye, botuesit i sugjerojmë që të sigurojë një përkthyes të mirë në anglishte apo arabishte, dhe në bashkëpunim me autorin, kjo vepër t'i prezantohet edhe lexuesit botëror. Për këtë hap janë të gjitha kushtet.

Më lejoni që ta falënderoj autorin për këtë punë të mirë, botuesin për botimin e veprës dhe të gjithë personelin për përpjekjet e tyre për botimin e veprës.

Juve, të nderuar pedagogë, profesorë, kolegë e të tjerë ju falënderoj për durimin që patët.

BIBLIOGRAFI

Dr. Feti Mehdiu

BIBLIOGRAFIA E DR. HASAN KALESHIT[1]

Prof.dr. Hasan Kaleshi, 1922-1976 për atë periudhë jo të gjatë të veprimtarisë së tij shkencore ka dhën kontribut shumë të çmueshëm për shkencën në përgjithësi e për historinë e kulturës shqiptare dhe orientale në veçanti. Nga kjo bibliografi mund të shihet se Hasan Kaleshi që nga viti 1949, kur boton shkrimin e pare në Jeta e Re, në Prishtinë e deri në vitin 1976 kur ndërroi jetë, vazhdimisht të arriturat shkencore në hapësirën shqiptare ia prezentonte opinionit shkencor evropian e botëror. Ai me pjesëmarrjen në Konferenca shkencore në Gjermani, Stamboll, Bullgari, Itali, Greqi, e gjetiu jepte zërin se në hapësirën shqiptare shkenca ka zënë fillë dhe po ec drejt të arriturave shkencore botërore. Me prezentimin e botimeve shkencore te shqiptarët, që e bënte në gjuhën Gjermane, por edhe atë turke, angleze, serbe etj., u bë një dritare e shkencës shqiptare kah Evropa e bota.

Përveç kësaj ai në Leksikonet që botoheshin në Gjermani arriti të prezentojë rreth njëzet figura të historisë e të kulturës shqiptare dhe shumë libra që botoheshin në gjuhën shqipe, sidomos nga fusha e

[1] Kjo bibliografi është botuar sëpari në librin : *Hasan Kaleshi, Vepra-1*, Shkup, 1996 që u botua me rastin e 20 vjetorit të vdekjes së Hasan Kaleshit. Ky version është ripunuar dhe plotësuar për këtë rast dhe shënon tridhjetëvjetorin e vdekjes së prof. Hasan Kaleshit.

historisë, i vuri në tryezën e opinionit shkencor botëror, kurse veprat që lindnin në orientin islam i vuri përpara studjuesve dhe lexuesve shqiptarë.

Kjo bibliografi, për të cilën mendojmë se mund të jetë më e kompletuara që botohet deri tash, pa ngul këmbë se është e përkryer, do t'i shërbejë hulumtuesve dhe studiuesve të ri të vazhdojnë aty ku e la Hasan Kaleshi.

Në fillim, për arsye praktike, në mënyrë që të mos përsëriten titujt e organeve të shtypit ku botonte Hasan Kaleshi, gjermanisht, frengjisht, serbisht, turqisht, etj., po japim shkurtesat që janë përdor në bibliografi.

Pas shkurtesave kemi sjellë veprat e Hasan Kaleshit dhe pas kësaj vijnë të gjitha studimet dhe përkthimet e tij sipas kronologjisë që janë botuar.

Shkurtesat

1. BLGS - Biografiche Lexikon zür Gesichte Südosteuropas, München.
2. BNKS - Bigorski Naučni Kulturni Sobiri, Gostivar
3. BFF - Buletini i Fakultetit Filozofik - Prishtinë
4. BMK - Buletini i Muzeut të Kosovës - Prishtinë
5. FPA - Federata Panshqiptare e Amerikës - New York
6. GINI - Glasnik na Institut za nacionalna istoria - Skopje
7. GND - Godišnjak naučnog društva, NRBiH, - Sarajevë
8. GMKM - Glasnik Muzeja Kosova i Metohije - Prishtina
9. GJA - Gjurmime Albanologjike - Prishtinë
10. IA - Islam Ansiklopedisi, Istanbul
11. LIW - Lexikon der Islarnischen Welt, Stutgart - Berlin - Mainz
12. MK - Mlada Kultura - Beograd
13. KN – Književne Novine - Beograd
14. NIN - Nedeljne Informativne Novine - Beograd
15. FV - Flaka e Vëllazrimit - Shkup
16. JR - Jeta e Re - Prishtinë

17. PKJIF - Prilozi za književnost, jezik, istorju i Folklor, Beograd
18. POF - Prilozi za Orijentalnu filologiju - Sarajevo
19. RBI - Revija Balkanološkog Instituta u Sarajevu
20. SL - Studenski list - Beograd
21. SM - Socijalna Misao- Beograd
22. SF - Südost - Forschungen - München
23. SK - Starine Kosova - Prishtinë
24. TDK - Türk Dil Kurumu - Istanbull
25. TTK - Türk Tarih Kurumu
26. UV - Univerzitetski Vesnik - Beograd
27. VAK - Vjetar i Arkivit të Kosovës - Prishtinë
28. ZAM - Zbornik na arkeološki muzej - Skopje
29. ZFF - Zbornik Filozofskog Fakulteta, Beograd dhe ZFF-Prishtinë
30. ZR - Zani i Rinisë – Prishtinë

1. BOTIME TË VEÇANTA:

1. Hasan Kaleši - Mehmed Mehmedovski, *Tri vakufnami na Kačanikli Mehmed Paša*, Skopje 1958, (me faksimile, dhe rezime në gjuhën frënge p.p 1-100, bot. Institut za Nacionalna Istorija).
2. Mahmud Tejmur, *Beleg na čeloto*, Izbor i prevod od arapski dr. Hasan Kaleshi str. 160, Skopje, 1964 (bot. "Kočo Racin")
3. Mahmud Tejmur, *Haxhi Qelebiu dhe tregime tjera,* përktheu nga arabishtja dr. Hasan Kaleshi, Prishtinë, 1968, 160 faqe (bot. "Rilindja" edicioni: Shkrimtarë botëror.)
4. Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku, Priština, 1972, str. 356, n. 8, rezyme në gjuhën shqipe dhe gjermane. (bot. Zajednica Naučnih Ustanova Kosova, studije, knj. 23).[2]

[2] Në kohën kur u botua për një interval shumë të shkurtër për këtë vepër janë botuar shumë recensione në gjuhë të ndryshme në disa revista jashtë Kosovës: Në Beograd, Mynchen, Kuvajt, Damask... kurse në gjuhën shqipe është prezantuar në revistën *Edukata Islame, Prıshtınë, nr. 81*, 2006.

5. Hasan Kaleshi *Dr. Ibrahim Temo: Frymëzues revolucionar dhe mendimtar nga Struga,* New York, 1982, f. 62. (Pergatiti Idriz Lamaj).
6. Hasan Kaleši - Kamil a-Buhi, *Srpskohrvatsko – arapski rječnik*, Sarajvo, 1988, p. 706. (bot. Starješinstvo islamske zajednice BiH, Hrvatske i Slovenije)
7. Hasan Kaleshi, *Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame*,[3] Prizren, 1411(1991), 112.f.
8. Dr. Hasan Kaleshi, *Vepra - 1*: Studime, Publicistikë, Shkup, 1996, f. 232. (Përgatiti për shtyp Feti Mehdiu, shtypin e financoi Safet Purellku. Botoi: Logos-A, Shkup.)

2. BOTIME sipas kronologjisë …

1949

1. *Disa vrejtje mbi gjuhën në shtypin tonë*, JR. nr. 2, Prishtinë, f. 109-114.

1950

2. *Nove inspiracije albanskih književnika,* KN. III, nr. 40, Beograd, 3-X-1950.

1951

3. *Edhe nji herë mbi punimin e Glisha Elezoviqit*, "Glasne osobine arbanaškog dijalekta Debra i njegove okoline", *Rilindja* 9 XII. 1951, Prishtinë.
4. H. Kaleshi - K. Halimi, *Glasne osobine arbanaškog dijalekta Debra i njegove okoline*, UV, no: 53, Beograd.

[3] Shih botimin në: *Seminari i Kulturës Shqiptare për të huaj, nr. 2,* 1976, Prishtinë, f. 151-216.

5. *Još jednom o raspravi Gliše Elezovića*, "Glasne osobine arbanaškog dijalekta Debra i njegove okoline, UV, br. 57. 21 X 1951 Beograd.
6. *Nji punim shkencuer jo kritik i Glisha Elezoviqit*, (me Kadri Halimin), J.R. no: 5, Prishtinë, f. 309-320.
7. *Poezija për fëmijë e Zmajit në përkthimin e Anton Çetës*, JR. no: 4, Prishtinë,[4] f.261-267.
8. *Kundër plagijateve*, JR., no: 5, Prishtinë, f. 289-297.
9. *Iz klasične arapske poezije*, NIN, 23 XII 1951 Beograd.
10. *Interesimi i Vuk Karaxhiqit për poezin popullore shqiptare*, JR. no: 6, f. 369-385.
11. *Përkthimet dhe problemi gjuhësuer*, JR. no: 4 Prishtinë, f.224-234.
12. *Neodgovornost ili plagijat*, SL. br. 4, 1 VI 1951, Beograd.
13. *Zmajeva dečja poezija na šiptarskom jeziku*, KN., 10 VI 1951, Beograd.
14. Halimi Kadri - Kaleši Hasan, *Jedan prilog albanskoj dialektologiji*, UV, 20 IX 1951, Beograd.
15. Arapska poezija, NIN, nr. 51, 1951, Boegrad.
16. Iz arapske lirike: Abdullah al-Alajli, *"Šta je večnost"*, NIN, nr. 51, 1951
17. Ibn Ar-Rumi, *"Pijanka"*, NIN, nr. 51, 1951.

1952

18. *Stara turska poezija*, NIN, nr. 65, 1952, Beograd.
19. Iz stare turske lirike: Fazil Bey, *Persijanke*, NIN, nr. 65, 1952, Boegrad.
20. Nebi, *Ti si izvestila moje suparnike*, NIN, nr. 65, 1952.
21. Sultan Selim, *Lavovi drhte jer slute*, NIN, nr. 65. 1952, Beograd,

[4] Në bibliografinë e Jetës Re-1949-1974, (Prishtinë, 1976), gabimisht është dhënë si autor i këtij vështrimi Hasan Mekuli: Krahaso Mustafa Memić *Velika medresa i njeni učenici u revolucionarnom pokretu* Skopje, 1984, faqe 257 te shënimet për gjeneratën e njëmbëdhjetë.

22. Fuzuli, *Hteo bih da imam hiljadu puta život*, NIN, nr. 65, 1952
23. Baki, *Rob je moje srce*, NIN, nr. 65, 1952,
24. *Me rastin e përkthimit të Kunorës së Maleve*, JR, no: 5-6, Prishtinë, f. 337-352.
25. *Disa shënime mbi përkthimin e vargjeve*, FV, 15 VII 1952, Shkup.
26. Henrik Berić, *Ilyrico-Albanica I-II*, JR, no: 4, Prishtinë, f. 273-278 (me Hilmi Thaçin).
27. Dr. Henrik Barić, *Bolla Hysein aga*, (me Hilmi Thaçin), JR, no: 5-6, Prishtinë, f. 384-388
28. Dr. Henrik Barić, *Mbi origjinën e gjuhës shqipe*, JR, no: 3, Prishtinë, f. 205-211, (me H. Thaçin)
29. Fjaluer serbokroatisht - shqip, Instituti i Studimeve, Tiranë 1947, JR, no: 3, f. 227-232, Prishtinë.
30. *Letërsija bashkohore e shqiptarëve të vendit tonë*, FV, 17 IX 1952, Shkup, fq. 5-7.
31. *Pak fjalë mbi botimet tona*, JR, no: 1, Prishtinë, f. 30-33.
32. *Savremenata književnost na šiptarite na našata zemja*, Savremenost, april 1952 Skopje.

1953

33. *Gorski vjenac na šiptarskom*, Stvaranje, III, str. 141-146, 1953 Cetinje.
34. *Dositej Obradoviqi në Shqiperi*, FV, 31 XII 1953 Shkup.
35. *Diçka mbi numrin pesë të Jetes së re*. FV, 15 XII 1953, Shkup.
36. Ivo Andrić i njegova dela, *Predgovor zbirci pripovedaka*, (me Hilmi Thaçin), Prishtina, "Mustafa Bakija" 1953.
37. *Iz savremene turske poezije*, MK II, no: 16, 17 XII 1953, Beograd.
38. *I mjeri Nasradin*, JR no: 4, f. 298-306, 1953 Prishtinë.
39. *Vilhelm Telli në gjuhen shqipe*, FV, 31 VII 1953, Shkup.
40. *Të rrijm shtrembët e të flasim drejtë*, FV, no: 276, f. 6-8, 1953, Shkup.
41. Iz "Antologije savremene turske poezije", *Stvaranje* br. 7-8, Cetinje 1953, (Radio Beograd, 140, 1952).

42. Ahmed Hašim, *Rode na Svetlosti mesećine*, Stvaranje nr. 7-8, Cetinje.
43. Jašar Nabi, *Čekam*, Stvaranje, nr. 7-8, 1953, str. 473.
44. Ahmed Muhib, *Igračica u sutonu*, Stvaranje, nr. 7-8; 1953, st. 472), (Radio Beograd, 140, 1952).
45. Jahja Kemal, *Princeza Melika*, Stvaranje, nr. 7-8, 1953, st. 470-471.
46. Ivo Andrić, *Tregime të zgjedhuna*, (me Hilmi Thaçin), 1953 Prishtinë, "Mustafa Bakija".

1954

47. *Osvrt na savremenu tursku književnost*, *Susreti*, 1954, nr. 5, Cetinje.
48. *Jahja beg Dukagjini poet i madh turk i shek. XVI*, FV, nr. 294, 1954, Shkup.
49. *Mbi veprat e Sami Frashërit*, FV, 15 XI 1954 - Shkup, f. 8.
50. *Nji veshtrim mbi letërsin moderne turke*, FV, viti IX, no: 285, 1954, Shkup.
51. Ahmed Kudsi, *Vajzat e mbetuna në shtëpi*, FV, nr. 285, 1954.
52. Jashar Nebi, *Pres*, FV, nr. 258, f. 5; nr. 294, f. 8, 1954.
53. Ahmet Hashim, *Lejlekët në dritën e hënës*, FV, nr. 285, f. 5, nr. 294, f. 6, 1954, Shkup.
54. Fazi1 Nexhip, *Epshi*, FV, nr. 285, 294, 1954.
55. Sabahudin Ajdin, *Natë Sarshoshi*, FV, nr. 285, 1954.
56. *Savremena turska književnost*, *Jedinstvo*, 13,20,27 i 28 VII, 1954, Priština. (X, 27 (1954), 28 (1954).
57. *Osvrt na savremenu tursku književnost*, *Susreti*, br. 5, Cetinje 1954, str. 389-399.
58. Orhan Veli Kanik, *Za otadžbinu*, *Susreti*, nr. 5, 1945.
59. Faruk Nafiz, *Košma*, *Susreti*, nr. 5, 1954.
60. Edibogulu Baki Suha, *Grob1je*, *Susreti*, nr. 5, 1954.
61. Melih Dževdet Andaj, *Nisam svako večer ovakav*, *Susreti*, nr. 5, 1954.

62. Džahit Sitki Tarandži, *Hoču otadžbinu*, *Susreti*, nr. 5, 1954.
63. *Tanzimat Devri Edebiyati*, Birlik 1954, Skopje.
64. Kaleshi Hasan - Thaçi Hilmi. "*Albanologija - Albanistika*", Rilindja, 21 III 1954, Pristinë.
65. *Suzi Çelebi nga Prizreni, poet i madhë turk i shek. XVI-XVII*, FV, nr. 292, 1954, Shkup.
66. *Çështja gjuhesore*, *Rilindja*, 8 dhe 15 VIII, 1954, Prishtinë.
67. Faruk Nafiz, *Putnik i kočijaš*, NIN, nr. 172, 1954,
68. Faruk Nafiz, *Košma*, NIN, nr. 172, 1954.
69. Kudret Dževdet Solak, *Želja*, NIN, nr. 172.
70. Nedzip Fazi1, *Kovčeg*, NIN, nr. 172.
71. Kemal Jahja, *Stihovi posvećeni prijatelju*, NIN, nr. 172.
72. Orhan Veli Kanik, *Ne umem da kažem*, NIN, nr. 172.
73. *Përgjegje nji kritike insolente* (bashkë me Hilmi Thaçin), JR, no: I, 1954, Prishtinë, f. 48-57.
74. *Anegdotat e Sami Frashërit*, FV, 29 XII 1954, nr. 288, Shkup.
75. *Nga poezija bashkohore turke*, FV, 14 IX 1954, Shkup.
76. Omer Seyfedin, *Ylberi*, *Rilindja*, 2 XI 1954, (X, 70) Prishtinë.
77. Frasheri Sami, *Akti i pestë i tragjedisë* "Sejdi Jahja", FV, 15 XI 1954, Shkup.
78. Frasheri Sami, *Gjave*, FV, 29 XI 1954, (nr. 297), Shkup
79. El Mutenebbi, *Kësaj zemre vena s'i sjell qetësi*, FV. nr. 287, 1954, Shkup. (shih në: **Poezi arabe**,[5].)
80. Abul-Atahija, *Syri im derdh lot për Utben pa nda*, FV, nr. 287, 1954, Shkup. (në: **Poezi arabe**,[6]).
81. Abu Nuvas, *Eja këtu mbushma bardakun e m'thuaj se asht safi venë*, FV, nr. 287, 1954, Shkup. (në: **Poezi arabe**,[7])
82. Ibnu-l-Mu'tez, *Mos vajto devet ngjyrë hini as karavanët që shkuen*, FV, nr. 287. (**Poezi arabe,** f. 22)[8],

[5] *Poezi arabe*, Shkup, 1983, f. 126. Zgjodhi dhe përgatiti Feti Mehdiu. Botoi biblioteka "Valët", edicioni Flaka e Vëllazërimit, Shkup.
[6] Po aty.
[7] Po aty.
[8] Po aty.

83. Ibn el-rumi, *Ahengu*, FV, nr. 287. (në: **Poezi arabe,**[9]**)**
84. Abdullah al-alaj li, *Ç'asht amshimi?,* FV, nr. 287, 1954,
85. Xhubran Halil Xhubran, *Helm në mjaltë*, FV, nr. 295, 1954, Shkup.
86. Fahri Dželaletin, *Nasilnik*, NIN, nr. 172, 1954 Beograd.
87. Golub Zvonimir, *Petnaeset stoleća arapske poezije*, *Otkrića* - 1954, str. 630-633.
88. Jakup Kadri Karaosmanolu, "Tudjinac", (Rec) *Susreti* br. 10, 1954, Cetinje.
89. Refik Halit, *Sarë Balë*, FV, nr.288, 1954, Shkup.

1955

90. *Veprat e Sami Frashërit*, FV, 4. III. 1955, Shkup.
91. *Gramatika shqipe e Fadil Tiranasit*, *Përparimi*-5, Prishtinë 1955, f. 270-273.
92. Kaleshi Hasan - Thaçi Hilmi, *"Quod Iicet Jovi, non licet Jovi"*, JR, nr. 1-2, Prishitnë, 1955, f.48-55.
93. *Neki problemi časopisa* "Jeta e re", *Jedinstvo,* 7 IV 1955, Prishtinë.
94. *Për shkurtimet e për disa çështje tjera të Jetës së Re*, FV, 9.VI.1955, Shkup.
95. *Ivo Andriqi dhe veprat e tij,* (Parathënie me Hilmi Thaçin), "Mustafa Bekija" - 1955, f. 5-20, Prishtinë.
96. *Kosova e Metohija në udhëpërshkrimin e Evlija Çelebis*, *Përparimi* 7-8, f. 422-434, Prishtinë 1955.
97. Sait Faik, *Milioner Riza*, *Politika.* 17.VIII 1955 - Beograd.
98. Dr. Henrik Barie: *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1955, f. 100, (me H. Thaçin).

[9] Po aty.

1956

99. *Savremena egipatska književnost*, Jedinstvo (XII, 18) 1.V.1956, Priština.
100. *Yeni Misir Edebiyatina kisa bir bakiš*, *Birlik*, nr. 295, 30.VIII.1956, Skopje.
101. *Tue lexue nji fletore të mykun dorshkrimesh*, FV, 17.IV.1956, Shkup.
102. Tefik el Hakim, *Ditari i gjykatsit hetus*, FV, 30. IV 1956, Shkup.
103. *Nji veshtrim mbi letërsinë bashkohore egjyptjane*, FV, nr. 330, 13 VII 1956, Shkup.
104. *Nji veshtrim mbi letërsinë bashkohore shqiptare*, FV, 15.VIII.1956, Shkup.
105. *Nji legjend orijentale mbi prejardhjen e shqiptarëve*, FV, 2 VI 1956, Shkup.
106. Kaleshi Hasan - Mehmedovski Mehmet: *Vakufnamata na Hava, čerkata na Ethem Çelebi od Skopje*, ZAM - Skopje, 1955, knjiga 2 str. 20-36, (me faksimile dhe resume).

1957

107. *Prilog poznavanje arbanaske književnosti iz vremena preporoda*, GND, NRBiH, Balkanološkog Instituta u Sarajevo 1957, I knjiga, str. 352-389.
108. *Jedna Prizrenska i dve Vučitrnske kanunname*, GMKM, knjiga II, Pristina 1957, str. 289-300, (rezyme në frengjisht dhe shqip).
109. *Tursko-blgarski recnik, izdanje na Blgarskata akademija na naukite vo Sofija* 1952, PoF, VI-VII, *1956/57* - Sarajevu, str.317-118.

1958

110. Hasan - Eren, *Türkçe gök kelimesinin türeveleri*, TTK, basımevi, Ankara 1958.
111. *Mevlud kod arbanasa*, ZFF, Beograd 1958, str. 349-358, (resume në gjuhën frenge).

1959

112. Hasan Kaleshi - Ismail Redžep: *Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine*, POF; Sv. VIII-IX, Sarajevo *1958/59*, str. 143-168.

1960

113. *Nji prizrenas që ka shkrue në gjuhen arabishte*, ZR, gusht 1960, Prishtinë.
114. Prizren Dergisi, *Sesler*, nisan, 1960 Skopje.
115. K. Hasan - Eren, I., *Türkçede -MM- MB- Dissimilationu*, TTK, basımevi, Ankara 1960.
116. K. Hasan - I. Eren, *Anadolu Aızlarında Rumca Islavca ve arapça kelimeler*, TTK basımevi, Ankara 1960.
117. Evlija Çelebi, Putopis, odlomci o jugoslavenskim zemljama, preveo i uvod napisao Hazim Sabanovič, knjiga I-II – Svijetlost Sarajevo 1957, POF *1960/61* - Sarajevo, str. 295-297.

1961

118. *Najstarija vakufnama u Jugoslaviji*, POF, SY. X-XI Sarajevo 1960-1961, str. 55-73 + 3 table
119. *Shenime nga e kalumja e Prizrenit gjatë periodës turke*, *Përparimi*, nr. 7-8, Prishtinë 1961, f.497-510.
120. *Iz savremene arapske poezije*, KN, 25 VIII 1961, Beograd.
121. *Prve orijentalne biblioteke u jugoslovenskim zemljama*, *Bibliotekar* nr. 4, Beograd 1961, str. 279-282.

122. Barič Henrik, *Istorija arbanaškog jezika*, Sarajevo, 1959, str.74. rec. Južnoslovenski filolog, Beograd, 1961-1962, p.454-455.
123. Agah Sirri Levend: Gazavetnameler ve Mihailolu Ali Beyin Gazavetnamesi- Ankara 1956, POF X-XI, *1960/61* Sarajevo, str. 297-300.

- Savremena poezija iz Iraka:

124. Abdal-Vehab al-Bajati, *Proleće i deca*, KN, 25.VIII.1961, Beograd.
125. Abu-l-Kasim as-Sabi, *Srećа*, KN, NS-152, 25.VIII,1961, Beograd.
126. Adonis, *Na početku leta*, KN, NS.:152, 25.VIII, 1961; Boegrad.
127. Ilija Abu Madi, *Talisman*, KN, NS, 152, 25.VIII.1961, Beograd.
128. Harun Hašim Rašid, *Sa izbeglicama*, KN, NS, 152, 25.VIII.1961, Beograd,
129. Mahmud Hasan Ismail, *Nova zona*, KN, NS, 152, 25.VIII.1961, Beograd.
130. Tadž as-Sirr al-Hasan, *Cveće na stazi uspomena*, KN, NS, 152, 25.VII.1961, Beograd.
131. Džebran Halil Džebran, *Pesma je tajna srca*, Radiotelevizija IX, 5, 1961, Str. 4.
132. Abu Kasim aš-Šabi, *Moje pijane pjesme*, Radio-televizija, IX, 5, 1961, str. 4-5.
133. Abdu-l- Vehab al-Bejati, *Pesma Bagdadu*, Radio-televizija IX, 5, 1961, str. 5.
134. Sulejman al-Isa, *Naše sutra*, Radio -televizija IX, 5, 1961, str.5.
135. Evlija Çelebi - Putopis, POF X-XI Sarajevo 1961, str. 295-297.
136. Ekrem Haki Ayverdi Yugoslavyada turk abidaleri ve vakflar, *Vakflar Dergisi* III Ankara 1956, POF X-XI, 1961 Sarajevo, str. 309-312.
137. Dr. Šawqi Dif. - al adab al arabi al mu'asir fi Misir, (1850-1950), Kairo, 1957, POF, X-XI, Sarajevo 1961, str. 292-294.

1962

138. *Kada je crkva sv. Bogorodice Ljeviške u Prizrenu pretvorena u džamiju*, PKJIF, Sy. 3-4, Boegrad, str. 253-261.
139. Çağdaş arap şiiri, *Birlik*, 25.1.1962 Skopje, (özel iIave).
140. *Oriyental Filolojisine dairek dergisinin yeni sayiIar*, *Birlik* 2 VII 1962, Skopje.
141. Evlija Çelebi, *Syahatname Jugoslavya hakında parçalar Çeviren*, onsozu yazip yourumluyan Hazim Şabanovic I ve II kitab, Sarajevonun "Svjetlost" yayınları, *Birlik*, Skopje 31 maj 1962.
142. *Jugoslavyada iIk oriyental kütüphaneleri Birlik* "Özel ılave", 27 XII 1962, Üskup.
143. *Moderna arapska pripovetka i Mahmud Tejmur*, *Susreti* 9-10, 1962, Titograd, str. 679-709.
144. *Savremena arapska poezija*, KN, 26 I 1962 Beograd.
145. Sulejman el-Isa, *Sutra*, KN, NS, 163,26.1.1962, Beograd
146. Abu-l-Kasim as-Sabi, *Senka smrti*, KN, NS, 163, 26.1.1962
147. Belend Hajdari, *Moj život*, KN, NS, 163,26.1.1962
148. Kemal Abdul-Halim, *Napusti moje nebo*, KN, NS, 163, 26.1.1962,
149. Kemal Neset, *Pitao sam pustinju*, KN, NS, 163,26.1.1962
150. Nizar Kabbani, *Zarobljena novcem*, KN, NS. 163, 26.1.1962.
151. *Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda*, GjA, nr. I, 1962, Prishtina, str. 91-118, (resume në frëngjisht).
152. K. Hasan - Eren I., *Anadolda Kafkasya Turkleri*, TTK basımevi Ankara, 1962.
153. *Novija egipatska književnost*, *Mogučnosti* IX, 1962.

1963

154. Hana al Fahuri, *Istorija arapskoj literaturi*, knjiga I-II, Moskva 1959-1961,zj, V, 1-4, str. 107-111, Beograd 1963.

1964

155. *Arnavut Edebiyatında Türk Etkileri*, *Birlik*, 27 XII 1964,
156. *Arnavut Edebiyatında Türk Etkileri*, Türk kurultayında bilimsel Bildirileri 1963, Ankara 1964, str. 61-74.
157. Kaleshi Hasan - Thaçi Hilmi, *Për gjuhen e popullit kunder gjuhes individuaIiste*, *Rilindja* 9 V 1964, Prishtinë.
158. *Turkische Angaben über den Kanun des Leka Dukagjini*, die kultur Südosteuropas, ihre Geschicht und ihre Ausdrucksfermen, Otto Harrossowitz, Wiesbaden 1964, str. 103-113.

1965

159. *Jedna arapska vakufnama iz Ohrida iz 1491 godine*, POF, XII-XIll (1962-63), Sarajevo 1965, str. 15-44, (rezime në gjuhën gjermane).
160. Gutto Saša, Orhan Hançerlioğlu, Ali, Novi Sad, 1961. POF, XII-XIll, Sarajevo 1965, str. 364-365.
161. Melanges Taha Huasin, *Offerts par ses amis et ses disciples a' I'ocasion de son 70 -lee anni versaire*, Kairo, J962,POF, XII-XIll, Sarajevo 1965, str. 375-378
162. I.J. Kračkovskij, Izabrannye sočinenija, Akademija Nauka SSSR, Moskva - Lenjingrad, I tom, 1955, II tom 1956, II tom, 1956, IV tom 1957, POF, XII-XIII, Sarajevo 1965, str. 378-379.
163. Dr. Šauqi Dayf, At-tatawwur vat tegdid fi š'-šir al-amawi, Kairo, 1959. POF, XII-XIII, Sarajevo 1965, str. 379-381.
164. Hana al Fahuri, *Istorija arapskoj literatury*, I Knjiga, Moskva, 1959, II Knjiga, Moskva, 1961, POF, XII-XIII Sarajevo 1965, str. 381-385.
165. Mahragan Halil Matran, Kairo, 1960, p. 234, POF XII-XIII, Sarajevo 1965, str. 385 - 387.
166. Ibn Hazim, *Golubičin đerdan ili o ljubavi i ljubavnicima*, Novi Sad, 1962, POF, XII-XIII, Sarajevo 1965, str. 387-388.

167. Kasim Dobrača. Katalog arapskih, turskih i perziskih rukopisa Gazi Husrevbegove biblioteke u Sarajevu, SY. IX *1962, Bibliotekar* V-VI, Beograd 1965, str. 455-459; *Der Islam,* Band, 43, Heft 3, Berlin, august, 1967.
168. *Nove pojave u savremenoj arapskoj poeziji*, Savremenik, XI 1965, knjiga XXI-4, str. 339-352.
169. Abu-l-Kasim aššabi, *Zalutala pesma, Savremenik,* nr. 4, 1965
170. Abbas Mahmud al-Akkad, *Muzika, Savremenik,* nr. 4, 1965
171. Nazik al-Malaike, *Guja; Ja, Savremenik,* nr. 4, 1965, str. 358-359
172. Abdel-Vehab el-Bajati, *Seoski vašar, Savremenik,* nr. 4, 1965, str. 358-359
173. Muhamed al-Fajturi, *Crna bujica*. *Savremenik,* nr. 4, 1965, str.359-361,
174. Muhjidin Faris, *Zeleni mir, Savremenik,* nr. 4, 1965, str. 361-362,
175. Džordž Ganen, *Ja te nosim u mojim očima, Savremenik,* nr. 4, 1965, 362-363,
176. *Buyuk Turk ozan Fazil Husni Daglarca.ile bir konušma*. *Birlik,* nr. 647, 4.11.1965 (Ozel ilave) Uskup.
177. *Yugoslavyada ilk tiirk kiitiiphaneleri,* Tiirk Kiiltiiru, nr. 38, Ankara, 1965, 168-171, *Birlik,* 27.xII.1965, Uskup.
178. *Arapska književnost u "Afričkim svitanjima"*, KN, NS, 250, 29 V 1965 Beograd.
179. *S arapskog i na arapski*, KN, NS, 240, 9 I 1965 Beograd.
180. *Još jednom o arapskoj književnosti* u "Afričkim svitanjima", KN 15 VI 1965, Beograd.
181. *Veliki vezir Kodža Sinan paša, njegove zadužbine i njegova vakufnama*, GjA br. II, 1965 Pristina, str. 105-144, (rezime në anglisht), (Rec. në Revue des etudes Sud-est Europennes, tome IV 1966, no: I-II, Bucurest 1966, fq. 314).
182. Prof. Dr. Semavi Eyice, Bellten XXIX, nr. 114, Ankara 1965.
183. Katalog rukopisa Gazi Husrev - begove biblioteke, *Bibliotekar,* nr. 5-6, 1965 Beograd.

1967

184. **المخطو طات العربية في يوغسلافيا، المجلة معهد المخطوطات العربية المجلد الثانى عشر، الدزء الثاني نوفمبر، 1966، القاهرة**

185. Kaleshi dr. Hasan - Jürgen dr. Hans, *Vilajeti i Prizrenit*, Përparimi nr. 2, fq. 165-193; *Perparimi* nr. 3, fq. 274-310, Prishtinë 1967.
186. *Kuran remek - delo arapske književnosti*, *Izraz* 2, 1967 Sarajevo, str. 183-203; I njëjti në librin*: Iz Kurana Časnog svetu celom opomene*, Beograd, 1967. (Vuk Karadžić).
187. *Legjendat shqiptare për Sari Salltukun*, *Përparimi* nr. 1, Prishtinë 1967, fq. 85-103.
188. *Njiqinde shqiptarë - shkrimtar të njoftun në letersinë turke*, *Rilindja,* 1 VIII 1967, Prishtinë.
189. Abdulah Škaljić, Turcizmi u srpskohrvatskim jeziku, Sarajevo, 1965. (Die turzismen in serbocroatizshen), Ural Altaische, Jahrbücher, Band 30, Lond 1-2, p 121-130, Wiesbaden.
190. Katalog, arapskih, turskih i persiskih rukopisa Gazi Husrevbegove biblioteke u Sarajevu, *Der Islam,* Band 43, III, Avgust 1967 Berlin.
191. Das Wilajet Prizren, Beitrag zür Geschichte der Türkischen statsreform auf dem Balkan im 19 Jahrhundert, von Hasan Kaleshi und Hans-Jürgen Körnrumpf, SF, Band XXVI, R. Odendbourg, München 1967.
192. Georges T. Petrovitch, Scanderbeg Bibliograpfie raisonne – Paris 1881. Nacdruck cingleitet von Franc Babinger, München 1967.
193. Letër prej RAB, *Kajro në një atmosferë paralufte*, *Rilindja* Nr. 2937, 4.VI.l967, f, 4, Prishtinë.

1968

194. *Rezistenca e popullit shqiptar në epokën e Skënderbeut sipas kronikave të vjetra turke*, *Jehona* no: 3, 1968 Shkup, f. 46-61.
195. *Veprat leksikografike dhe enciklopedike të Sami Frashërit*, *Jehona* 8-9, Shkup f. 44-61.
196. Selami Pulaha, Luftat shqiptaro-turke në shek. XV, Burime Osmane, Tiranë 1968, SF, München 1968.
197. *Sami Frashëri popullarizues i shkencave moderne*, *Jehona* nr. 10, Shkup, 1968, f.25-43.
198. Filip Hiti, Istorija arapa, Sarajevo 1967, *Republika, 4,* Zagreb 1968, str. 229.
199. *Lufta shqiptaro-turke në shek. XIV -XV, sipas tri kronikave* turke, *Përparimi* nr..2, 1968 Prishtinë, f. 267-303.
200. Prizren Dergisi, *Sesler,* IV, Skopje 1968, str. 75-79.
201. Burime të zgjedhura për Historinë e Shqiprisë, vëllimi i II, shek. XIV-XV, Tiranë 1962, 410. f. in 8, GjA, I 1968 Prishtinë, fq. 254.
202. Glasnik Muzeja Kosova i Metohije IX 1964 - Prishtinë, GjA, I, 1968, Prishtinë, f. 285-288.
203. Konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë 1965, GjA, I, 1968 Prishtinë, f. 273-275.
204. Stavri N. Naçi, Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatlive në gjysmën e dytë të shek. XVIII/1757-1796), GjA, I, Prishtinë 1968, f. 260.
205. *Veprat filologjike dhe dialektologjike të Sami Frashërit*, *Jehona* X-XII, 1968, Shkup.
206. Gerhard Grim, Johan Georg von Han, (1811-1869), Wiesbaden, Otto Harrassovitz 1966,385 f. in 8°, (Albanischen Forsohungen) GjA, I, Prishtinë 1968, f. 261-264.
207. Südost -Forschungen, Band XXVI, 9 Oldanburg, München 1967, GjA, I, 1968, Prishtinë, f.290-291.
208. *Sami Frasheri në letersinë dhe fiIologjinë turke*, GjA I, 1968, Prishtinë, f. 33-116, (resyme në gjuhën frënge).

209. Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëllimi i III, shek. XVI-XIX (1506-1839), Universiteti Shtetnor i Tiranës, Tiranë 1962, 336 fq. Gj A, I, 1968, Prishtinë, f. 254-255,
210. Kutbu d-din Muhammad Ahmad, od Dahrawaili al Makki Gazawat al Garakisa-wa-I-Atrak fi Geni übi I-Gazire, Menshurat dal' al-Jamama li I-bahth wa t-targama wa n'nashr 1967, ar Rijad, al MamIaka al Arabija as-Su'udija 69+542 f. in 8°, GjA, I, 1968 Prishtinë, f. 256-257.
211. Zeitschrift Für Balkanologie, Jahrgang, Heft - I, Otto Harrassovitz, Wiesbaden 1967, Gj A, nr. I, 1968, Prishtinë, f. 288-290.
212. Dr. Franc Babinger, In memoriam, GjA, nr. 2, 1968. Prishtinë, f. 255-257.
213. Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shek. e XVII, Tiranë 1965, 525 f, GjA, nr. 2, 1968, Prishtinë, f. 273-275.
214. Vostočnije istočniki po istorii narodov jugo-vostočni centralnoi Evropi, Moskva 1964, GjA, nr. 1, 1968, Prishtinë, fq. 272-273.
215. *Jedna zabluda o bogorodici Leviškoj*, *Jedinstvo, 1.1.1968* Pristina.
216. *Veprat filologjike dhe dia1ektologjike të Sami Frasherit*, *Fjala* no: 7 shtator 1968 Prishtinë.
217. *Sesler, Eine Zeitschrift für Literatur und Kunst der türkischen Minderheit in Jugoslawen*, *Der Islam,* Band 44, Berlin, juni 1968.
218. *Prizren Kitabeleri*, *Vakıflar Dergisi* - 1968, Ankara 1968, (me I. Erenin dhe Muamer Egin).
219. *Rezistenca e shqiptarëve në epokën e Skënderbeut*, *Rilindja* 16-19, janar 1968, Prishtinë.
220. Peter BartI, Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unobhongigkcitsbe wegung 1878-1912, Wiesbaden, 1968, p. 208, GjA 2, 1968, f. 275-276.

1969

221. Ewald Wagner, *Abu Nuwas Eine studie zür arabischen Literatur der fruhen, Abasiden zeit*, Wiesbaden 1965, p. 532, Band XVII, POF, XIV-XV, 1964-1965, 1969, Sarajevo, fq. 449-450.
222. Studia albanica monacensia, München 1968, JIČ-I-II, 1969, Beograd.
223. *Arnautça sozcüklerin Oluşmasında türkçenin Etkisi*, *Sesler* 1969, Skopje, str. 34-43.
224. *Aspects of the Balkans Continuity and Change Contributious to the International Balkan conference heldat UCLA, octobar 23*-28 1969, Ed by, Henrik Birnbaun and Speros Vryonis Jr. The Hague Paris, Mouton 1972,447 Slavistic Printigs and Reprintigs - 270.
225. Selami Pulaha, Luftat shqiptaro-turke në shek. e XV, burime osmane, Tiranë 1968, JIČ, III, Boegrad 1969, str. 77-78.
226. Körnrumpf - Hans Jürgen: Ahmed Xhevat pasha në Shqipërinë veriore dhe Mal të Zi, përktheu H, Kaleshi, GjA nr. 2, 1969 Prishtinë, f. 185-217, (resume në gjuhen gjermane).
227. *Sami Frashëri Gazetar, Jehona* nr. 1-2, 1969 Shkup, f. 54-64.
228. Mahmud Tejmur: *Me terrin e nates*, (fragment), *Rilindja* 19 VI 1969, f. Il, Prishtinë.
229. *Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll*, GjA nr. I, 1969 Prishtinë, f. 77-117, (resume në gjuhën frenge).
230. *Prve turkso-srpske stamparije na Kosovu, Počeci štampe jugoslovenskih naroda*, Jugoslovenski Institut za novinarstvo, Beograd 1969, str. 223-229.
231. *Çfar të dhënash na japin kronikat osmane mbi luftat shqiptaro-turke në shek. e XV*, Simpozijumi për Skenderbeun, 9-12 maj, 1968 Prishtinë, 1969, f. 171-180.
232. Luftat shqiptaro-turke në shek. e XV, burime osmane, Tiranë 1968, SF, Band XXVIII, Mynchen 1969, f. 430.

233. Mahmud Tejmur, Abu Arab, *Rilindja*, 16.1.1969, f. 11. Prishtinë.
234. Popovci Surija, Gradjanskopravni odnosi u zakonika Leke Dukadjinija, SF, Band XXVIII, München" 1969, str. 432.
235. Peter Bartl, Die albanischen zur Zeit nationalen und hangigkeitsberwegung 1878-1912, Otto Harrossowitz, Wiesbaden 1968, p. 208 rec. Albanischen Forschungen, JIČ, I-II, 1969 Beograd, fq. 251-253; Edhe në: POF, XIV-XV, 1964-65, Sarajevo 1969, str. 467-469.
236. Selami Pulaha, Luftat shqiptaro-turke në shek. e XV, burime osmane, Tiranë 1968, 426 fq. GjA, nr. I, 1969 Prishtinë, fq. 298-300.
237. Agah Sirri Levend, Şemsettin Sami, TDK yayinlari 287, Ankara 1969, GjA, nr. 1, 1969, fq. 300-303.
238. Georges T. Petrovitsch, Scanderbeg (Georges Castriota), Essai de bibliograpfie, Raisonne, Paris 1881. Rishtypur nga Rudolf Trofenik, München 1967, parathanja nga Franc Babingeri, GjA, nr. 2, 1969 Prishtinë, fq. 222-223.
239. Studia Albanica monacensia, In memoriam Georgii Castrioti Scanderbegi 1468-1968, München 1968, pp. 175, GjA, nr. 2, 1969 Prishtinë, f. 227-230.
240. *Univerzitet u Prištini treba da bude motor i regulator naučne aktivnosti na Kosovu, Jedinstvo,* 13 novembar 1969 Pristina.
241. *Türk yazını ve filolojisinde Sami Fraşeri*, *Sesler,* IV, 1969 Skopje.
242. *Doğu Berlinde tutulan XII uluslararası Altaistik Konferansi*, *Sesler* IV, Skopje 1969.
243. *Alcunti dati delle oronache ottomane sul1e guerre Albano-Turche del XV secolo, Centro Internazionale di studi albanesi*, presso J'Universita di Palermo, V Convegno internazionale di studi Albanesi, Palermo 1969, str. 203-220.
244. *Zur Geograpfie und Infrastruktur des Kaza Pirot, (Şehirköyu), vor 100 jahrn, von Hasan Kaleshi - Hans Jürgen Körnrumpf*, SF, Band XXVIII, R. Oldenbourg, München 1969.

245. Cronici turceti privind tari1e romane, Extrase VI. I see. XV, miljucul sec. XVII. Volum intocmit di Mihail Eubolu i Mustafa Mehmet. Edituar Academie Republici Socialiste Romania, Bucureşti, 1966, p. 559, Zeisehrift für Balkanologie, Rudolf Trofenik, München 1969-70.
246. *Hasan Kaleshi - Ismet Drmaku, Cronici turceti privind tarile romane*, Vol. I Chroniques turques concernant les paysroumains vol. I Bucurešti 1966 str. 554, JIČ, I-II, Beograd 1969, str. 243-244.
247. Nuredinovic Bisera, Bibliografija jugoslovenske orijenta1istike, 1945-1960, Sarajevo, 1968, pp. 242. SF, Band XXVIII, R. Oldenbourg, München 1969, str. 361-362.
248. Filip Hiti, Istorija arapa, Sarajevo, 1967, POF XIV-XV, 1964-65, Sarajevo 1969, str. 443-445.
249. Bisera Nuredinovic, Bibliografija jugoslovenske orijentalistike, 1945-1960, Orijentalni institut u Sarajevo, posebna izdanja VI, Sarajevo 1968, 242 str. *Bibliotekar*, 4, Beograd, juli-avgust 1969.

1970

250. *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike*, Tiranë 1969, JIČ, I, 1970 Beograd.
251. V Convegno internazionale di Studi Albanesi, Palermo 1969, JIČ, I, 1970 Beograd.
252. *Dokumente të Arkivit të Vjenës mbi mësimet e shqipes në Arbnesh të Zarës*, VAK, II-III, 1970 Prishtinë, f. 151-208.
253. Publikacije posvečena 500 godišnjici Skenderbegove smrti, JIČ, III-IV, 1970 Boegrad, str. 105-120.
254. Kaleshi dr. Hasan - Eren Ismail: *Četrnaest turskih fermana manastira Dečana*, GMKM, X, 1970 Prishtina, str. 305-344, (rezyme në frangjisht)
255. *Veprat turqisht dhe persisht të Naim Frashërit*, GjA, 1-2, 1970 Prishtinë, f. 143-153, (rezyme në frangjisht).

256. *Le role de Chemsedin Sami Fraschery dans la formation de deux langues litteraires turc et Albanaise*, II Congres International des studes Sud-est Europenes, Athene 1970.
257. Dr. Jasar Redzepagic, Razvoj prosvete i školstva albanske narodnosti na teritoriji današnje Jugoslavije do 1918 godine, Prishtina, 1968, str. 386. GjA, 1-2, 1970 Prishtinë, f. 326-333.
258. Beitrage zur Südosteuropa - Forschung. Anlasslich des II Internacionalen Balkanologenkongres in Athen, München 1970, 210. GjA, 1-2, Prishtinë 1970, f. 347-349.
259. Ishak Çelebi von Bitola und seine Stiftungen, La Macedoine et les Macedonians dans le passé, INI, Skopje 1970, str. 149-162.
260. *Le role Chemsedin Sami Frachery dans la formation de deux langues literaires Turc et Albanais, Balcanica* I, Beograd 1970, p. 197-216.
261. *Turski uticaji u tvorbi reči u albanskom jeziku*, ZFF Priština, knjiga VII-a, 1970, str. 165-199.
262. *Nji shoqeri e panjohur e shqiptarëve e Stambollit, Rilindja*, 31 dhjetor 1969 - 1.2 janar 1970, Prishtinë, 1970.
263. *Albanska Aljamijado književnost*, POF XVI-XVII, 1966-67, Sarajevo 1970, str. 49-77, (rezyme në gjuhën gjermane).
264. Taha Husein, Instituto universitario orientale, Napoli 1964, POF, XVI-XVII, Sarajevo 1970, str. 373-374.
265. Profesor dr. Alois Schmaus, GMKM, X, 1970 Priština, str. 489-492.
266. *Neodržive podele*. *Politika* 21 III 1970 Beograd, str. 14.
267. O *novom izdanju Kur'ana* Časnog, Glasnik VIS-a, nr. 3-4, 1970, Sarajevo, str. 181-182.
267-a.Arkivi i Wienës dhe rëndësia e tij për historinë shqiptare, Rilindja, dt. 12.02.1970.

1971

268. *Naučni rad i biblioteke Kosova*, *Bibliotekar* III, 1971 Beograd str. 370-377.
269. *Koj je graditel i koga je izgradjen Kuršumli an vo Skopje*, GINI, XV-3, Skopje 1971, str. 189-201,
270. Profesor dr. Alois Schmaus 1901-1970, GjA, 1, 1971 Prishtinë, fq. 87-89.
271. *Hasan Kaleshi - Ismet Dermaku, Dokumenta nga arkivi i Vjenës mbi Lidhjen e Pejës*, VAK, IV-V, 1971 Prishtinë, fq. 149-206, (rezyme në S-kroate dhe frenge).
272. *Albanische legenden um Sari Sultuk, Actes du premier congres international des etudes Balkaniques et Sud-est Europeenes*, editions de I academie Bulgare des sciences, Sofia 1971, p. 815-828.
273. Einige Beispiele für den Einflusa der türkischen sprache bei Zusammengesetzten Wortern im Albanischen, Serta Slavica, Dr. Rudolf Trofenik, München 1971, pp. 330-337.
274. Peter Bartl, Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unadhängingkeitsbewegung, (1878-1912), Wiesbaden, Otto Harrossowitz, 1968, 208 str. Albanischen forschungen 8, Der Islam januar 1971, band. 47, pp. 353355.
275. *Burimet lidhur me studimin e Sami Frashërit*, BFF, - VIII, Prishtinë, 1971, f. 35-52, (rezyme në gjuhën frenge).
276. *The importance of turkish influence upon word formlation in Albanien*, *Balcanica*, II, Beograd 1971, pp. 271-293.
277. *Nji burim turk mbi kryengritjen e shqiptareve më 1909-1912*, GjA, serija historike I, Pirshtinë 1971, f. 197-234, (rezyme në gjuhën frënge).
278. Lehfeldt Werner: Das serbokratische aljamiado-Schriftum der bosanisch-herzegovinischen Muslime. Transkniptionsprobleme, München, R. Trofenik 1969, pp. 193, SF, Band XXX, München 1971, pp. 429-430.

1972

279. Ndikimet orientale në tregimet popullore shqiptare, BMK,-X, 1972 Prishtinë, f. 9-51, (rezyme në gjuhën angleze).
280. Dr. Ivan Božić, Doba Balšića, Zeta u despotovini Vladina Crnojevića, GMK, XI, 1972 Prishtinë, str. 364-366.
281. Heidrun Kel1ner, Die albanischen Minderheit in sizelen, Otto Harossowitz, Wiesbaden 1972, 133,80 367-370.
282. Türk folklor ve etnografya bibliografaysi, GMK XI, 1972 Prishtina str. 382-384.
283. Hasan Kaleshi - Ismail Eren, Prizrenac Mahmud Paşa Rotul, njegova zadužbina i vakufname, SK, VI-VII, 1972/73, str. 23-65, Prishtine (rezyme në gjuhën frënge).
284. Andrej Andrejević, Aladža Džamija u Foči, SK, VI-VII, Prishtinë 1972/73, str. 261-263.
285. Orientalische Einflüsse ind en albanichen Volkserzahungen, SF, Band XXXI, R. Oldenbourg, München 1972, pp. 267-301.
286. Omer Lutfi Barkan - Ekrem Hakki Ayverdi: Instanbul Vakıflar Tahri defteri 953 (1546) tarihli, Istanbu11970, 504 str. in 40 *Balcanica* III, 1972 Beograd, str. 552-554.
287. *Një polemikë indirekte midis Fan S. Nolit dhe dr. Franc Babingerit*, FV, 17.V .1972, f. 15.
288. *Osmanlı imperatorluğunda sosyalist basımın başlangıçları*, Tan, nr: 123-133 (dt. 24.2.1972 -24.4.1972) f. 7, 1972, Prishtine.

1973

289. *Početoci na socijalističkiot pečat vo Osmanskoto carstvo*, GINI, Skopje nr. 2,1973, str. 109-127.
290. *Şemsetin Sami Fraşerinin siyasi Görüşleri,* VIII Türk Tarih Kongresi, Kongreye sunulan Bildiriler, II cilt, Ankara 1973.
291. Pertev Nail Baratav: Turk folkloru, (Turk hailk bilimi II, 100 sorunda Türk Folkloru: In maslartöreve törenler oyunlar), Istanbul, Gerçek Yayinevi, *Çevren*, 1973 Prishtine.

292. *Kosova nën pushtetin turk*, në librin: *Kosova dikur e sot*[10], Beograd 1973, str. 129-176.
293. *Spomenici islamske arhitekture i orijentalni rukopisi*, në librin: *Kosova dikur e sot*, 1973 Boegrad, str. 467-478.
294. *Autorët e Kosovës në gjuhet orienta1e*, në librin: *Kosova dikur dhe sot*, Boegrad, 1973, f. 381-388.
295. *Neki problemi izučavanja kulturne istorije Pologa za vreme turskog perioda*, BNKS Gostivar, 21-22 X 1971, Skopje 1973, str. 177-189.
296. *Rreth artikullit tim "Kosova nën pushtimin turk"*, që u botua në Monografinë "Kosova", *"Rilindja"* dt. 14.IV.73, f.11.

1974

297. *Şemsettin Sami Fraşerinin siyasi görüşleri, Çevren,* no 2, 1974 Priştine s. 14-22.
298. Peter BartI: Der Westba1kan zwischen, spanischer Monarchie und Osmanischen Reich. Zur Turkenkrigs problematik an der Wende von 16 zum 17 Jahrhundert, Wiesbaden 1974, p. 258, (Albanischen Forschugen 14), *Balcanica* V, Beograd 1974, str. 459-461.
299. Hans Jürgen Körnrumpf: Osmanische Bibliographi mit besondere Berucksichtigung der Türkei in Europa, Handbuch der orientalistik, Erste Abteilung, Erganzungsband VIII, Leiben - Köln 1973, p. 1374, *Balcanica* V, Beograd 1974, str. 461-462.
300. Der Einfluse der Türkischen auf die wortbildung den Albanischen Schriften zur Goschichte und kultur des altan Orientes 5, Academie der Wischenschaften der DDR, Verlang-Berlin 1974 str. 279-286.
301. Forma Stiftunagen (vakuf), LIW, 200/1, I Band, W. Kahlhammer, Stutgard - Berlin - Mainz 1974, str. 183-188.

[10] Kosovo nekad i danas. Artikujt e botuar në këtë monografi janë në të dyja gjuhët: Shqip dhe serbokroatisht.

302. Andrejević Andrej: Aladža džamija u Foči, Beograd 1972, SF, Band XXXIII, München 1974, str. 422.
303. Oblast Brankovića, Opširni katastarski popis iz 1455 godine, Sarajevo 1972, Orijentalni institut, XXII, 378 str. (Monumenta Turcica II, 2/1, II, 2/2) SF, Band XXXIIl, München 1974, str. 407.
304. Aspects of the Balkans Continuity and change. Contributions to the International Balkan Conference hald at UCLA. October 23-28. 1969. Ed. by Henrik Birubaun and Speros Vryonis, Jr. The Hague Paris: Souton 1972,447 S. (Slavistic Printings and Reprintigs 270), SF, Band XXXIII, München 1974, str. 331-334.
305. Islamiche Arhandlungen, Aus des Institut für Geschichte und kultur des Nahen Orients an der Universitat München I vol. Kolekcioni: Esitrage zur Kenntais Südost-Europas und des Nahen Orients 1. XVII, München 1974.
306. Arnavutçada Osmanlıca - Türkçenin Ekleri, Çevren, nr. 4, 1974, Priştine, s. 26-32.
307. *Frashëri Abdul*, BLGS, Band I, München [11]1974, str. 335-337.
308. *Draga Nexhip*, BLGS, Band I, München 1974, str. 424-426.
309. *Dukagjini*, BLGS, Band I, München 1974, str. 444-446.
310. *Frashëri Naim*, BLGS, Band I, München 1974, str 540-542.
311. *Frashëri Sami*, BLGS, Band I, München 1974, str. 546-548.
312. Redzepagić Jašar: Razvoj prosvete i školstva albanske naradnosti na teritoriji današnje Jugoslavije do 1918 godine, Prishtinë 1968. Büher und Zeitschriftenschau, München 1974, str. 441-443.
313. Türkler gelişmiş bir uygar1ığı zenginliktir, *Tan* 27, 4. 1974, Priştine, s.11.
314. *Turski pokuşaji za revidiranje zakonika Leke Dukadjinija i ukidanje autonomije albanskih plemena u XIX veku, Običajno*

[11] Të gjithë artikujt e botuar në këtë leksikon, në gjuhën gjermane, në vitin 1996 janë botuar edhe në gjuhën shqipe në librin: Riza Sadiku, *Hasan Kaleshi, Jeta dhe vepra*, Kërçovë, 1996.

pravo i samouprave na Balkanu i u susednim zemljama, Beograd 1974, str. 389-410, (resume në frengjisht).

315. *Počeci Socijalističke štampe u Otomanskom Carstvu*, *Počeci socijalističke štampe na Balkanu*, Beograd 1974, str. 189-204.
316. *Tirana,* IA, 12/1, Istanbul, 1974, p. 376-379.
317. *Arnavut öykülerinde doğunun etkileri*, *Çevren,* no 3, s. 10-25, 1974 Prishtinë.

1975

318. Ethnogenese und Stasbildung in Südosteuropa - Arbetiskreises der Deutschen Forschungsgeneinschaft zum III, Internationalen Südosteuropa - Kongres Association Internationale d'etudes du sud est Europen, Götingen 1974, SF Band XXXIV, 1975 München, str. 280-288.
319. Zirojević Olga: Tursko vojno uredjenje u Srbiji, (1459-1683), Istorijski institut Beograd 1974, SF, Band XXXIV, 1975 München, str. 423-426.
320. Istorija Beograda (Hrsg), SAND, odel. ist. nauka, III Bande, Prosveta - Beograd 1974, SF, Band XXXIV München 1975, str. 347-348.
321. Pulaha Selami: Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodres i vitit 1485, 2 Bande, Akademija e shkencave të RS të Shqipërisë, Instituti i historisë Tiranë 1974, SF, Band XXXIV, 1975 München, str. 423-426.
322. Das Türkische Vordringen auf dem Balkan und Die Islamisierung faktoren für die Erhaltung der ethnischen und nationalen Eyistenz des albanischen Vo1ks, Südosteuropa untar dem Halbmond, (Prof. Georg Stadtmüler zum 65, Geburtstag gewidmet), Dr. Rudolf Trofenik, München, 1975 pp. 125-138.
323. Arnavut dilinde Kullanılan Osmanlıca - türkçe ekler, I Türk Dili Bilimsel Kurultayına sunalan Bildiriler, TDK Yayınlari 413, Ankara 1975, str. 141-150.

324. Bojanić Dušanka, Turksi zakoni i zakonski propisi iz XVI-XVII veka za smederevsku, krusevačku i vidinsku oblast, Istorijski institut Beograd 1974, SF, Band XXXIV, München, 1975, str. 350.
325. Ferizaji nën sundimin turk, në librin *Ferizaji dhe rrethina* (Monografi), Beograd 1975, (i njejti edhe në gjuhën serbokroate).

1976

326. *Napredne ideje novih ideologa Albanskog nacionalnog pokreta u drugoj polovini XIX veka o saradnju Balkanskih naroda,* Istorijski institut, Zbornik radova, 1, Beograd 1976, str. 225-242.
327. *La toponymie ottomane dans les pays yougoslaves actueles*, Studi praottomaini e ottomani, Atti del Conyagne di Napoli, (24-26 septembre 1974), Instituto orientalo, Napoli 1976, pp.129-133. 5.
328. Müşterk Türk-Arnavut Savaşları üzerine söylenen Arnavut Türküler, I uluslararası Türk Folklor kongresi Bildirileri, II cilt, Ankara 1976.
329. *Gucia Ali Pasha*, BLGS, Band II, München 1976, str.101-103.
330. *Haxhi Qamili*, BLGS, Band II, München 1976, str. 131-133.
331. *Haxhi Zeka*, BLGS, Band II, 1976 München 1976, str.133-136.
332. *Hima Dervish*, BLGS, Band II, München 1976, str. 161-164.
333. *Kelmendi Ali*, BLGS, Band II, München 1976, str. 393-394.
334. *Kolonja Shahin*, BLGS, Band II, München 1976, str. 441-443.
335. *Konica Faik*, BLGS, Band II, 1976 München 1976, str. 450-453.
336. "*O strukturi stanovništva Kosovskog vilajeta u drugoj polovini XIX veka*", *Obeležja* III, Priština 1976. str. 108132.
337. *O Seobama Srba sa Kosova krajem XVII i početkom XVIII veka*, etničkim promenama i nekim drugim pitanjima iz istorije Kosova, *Obeležja*. IV, 1976, str. 193-216.

338. Dr. Ibrahim Temo Gründer des jungtürkichen Komitetes Einheit und Fortschrift. Ein Beitrag zur Erhelung der role der Albaner in der jüngturkischen Bewegung, Südost-Forschungen, Band XXXV, München 1976, str. 93-141.
339. Burimet lidhur me studimin e Sami Frashërit, *Përpjekja e jonë,* nr. 5-6, 1976, New York-New Yersy.
340. Max Demeter Peyfuss, Die Aromunische Frago-ihre Entwicklung von dan Ursprungen bis zum Frieden von Bukaret, (1913) und die Haltung Östereich-Ungar, Wien er Archiv für Geschichte Slawentums und Osteuropos, Bond VIII Hermann Böhlaus Nechf, Wien, Köln-Graz, p. 166, *1974, Balcanica* VI, 1976 Beograd, str. 343-344.
341. Dr. Ibrahim Temo, Osnivač mladoturskog komiteta, "Ujedinjenje i napredak", POF, Sarajevo 1976, str. 211-244, (resyme në gjuhën angleze).
342. XV Asırda, XVII, Asrın Nihayetine kadar Yugoslav topraklarında şark Medeniyeti, *Çevren* no: 9, s. 13-36, *Çevren,* no: 10, s. 23-41, 1976 Priştine.
343. *Faik Konica dhe marrëdhëniet e tij me Austrohungarinë,* FPA - *Vatra.* New York, 1976, f. 25-47.
344. *Albanische Marchen. Herausgegeben und ubersetzt* von Martin Camaj und Uta Schier - Oberdorffer, Eugen Diederichs Verlag, Düsseldorf Köln, 1976. *Balcanica,* VII, 1976, Beograd, str. 430.
345. Roli i shqiptarëve në letërsitë orientale, *Seminari* i *kulturës shqiptare për të huaj, 2/1976,* Prishtinë, f. 151-217. (boton Fakulteti Filozofik).
346. *Të përpiqemi për një afirmim sa më të madh të shkencës Kosovare* (intervistë me Q. Mehmedin), *Bota e Re,* nr. 5-6 (prill) 1976, f. 7. Prishtinë.
347. Islamkundliche Abhandlungen - Hans Joakim Kissling zum 60. Geburtstag Gevidmet Von Seinen Schülem, Dr. Rudolf Trofenik, München, 1974, *Çevren,* nr. Il, 1976, s. 147-151, Priştine.

Botime pas vdekjes së prof. dr. Hasan Kaleshit[12]

1977

348. *Die Albaner in Kosovo im 15. Jahrhundert, Akten des internationalen albanologischen koloquiums* Innsbruck, 1972, zum Gedachtnis an NORBERT JOKL, p. 513-524, Harausgegeben von Harmann M. Ölberg, Insbruck, 1977.
349. Ilija Abu Madi, *Talisman* në librin: Arapska poezija, Beograd, 1997, str. 102.
350. Orijentalna kultura u jugoslovenskim zemljama do kraja 17. veka, (Osmanska moc ve stredni a jihovychodni Evrope v 16-17 stoleti), Praha, CSI 1977, vol 2, p. 456-528.

1979

351. Arnavutların millibekasının esas amilleri olarak türklerin Balkanlar fethi ve islamiyetin yayılması. I. Milletlerarası *Turkolojl kongresi, İstanbul. 15-20.* X. 1973. *İstanbul, 1979.*
352. Luarasi, Kristo (Kristo Papa Stefani Luarasi) (1875-1934), BLGS, band, III, Münich pp. 47-48.
353. Luarasi, Petro Nini (1865-1911), BLGS, band, III, München, pp. 48-50.
354. Përmeti, Turhan Pascha (1839-?), BLGS, band, III, München, pp. 425-427.
355. Preveza, Abidin Pascha (1848-1906), BLGS, band, III, München, pp.477-479.
356. Prishtina, Hasan Bey (?-1873), BLGS, band, III, München, pp. 485-489.

[12] Këto botime janë, në radhë të parë referatet që Prof. Kaleshi i kishte prezantuar në Simpoziumet shkencore në botë, por edhe përkthime të punimeve të tij nga gjuhët tjera në gjuhën shqipe etj.

1980

357. Rustemi, Avni (1895-1924), BLGS, band, IV, München, pp. 67-69.
358. Sinan Pasha (Koca Sinan, Fâtih-i Yemen Sinan Paša) (?-1596), BLGS, band, IV, München, pp.128-130.
359. Tahsini, Hasan (Hoxha Tahsini) (1812-1881), BLGS, band, IV, München, pp. 266-268.
360. Temo, Ibrahim (1865-1943), BLGS, band, IV, München, pp. 282-286.
361. Vasa, Pashko (Vasa Pascha, Vasa Pascha Shkodrani, Wassa Efendi) (1825-1892), BLGS, band, IV, München, pp. 387-389.
362. Vlora, Eqrem Bey (1885-1964), BLGS, band, IV, München, pp. 425-428.
363. Vlora, Ferit Pascha (Avlonyal, Ferid Pascha, Ferid Pascha, Mehmed Ferid Pascha) (1851-1914), BLGS, band, IV, München, pp. 428-430.
364. Vlora Ismail Qemal (Kemal) Bey (1844-1919), BLGS, band, IV, München, pp. 430-433.
365. Vlora, Süreya Bey (Avlonyalı, Süreya) (1860-1940), BLGS, band. IV, München pp. 433-436.
366. Kur'ani kryevepër e letërsisë arabe, I, *Edukata islame, 27/1980*, Prishtinë, f. 64-75.
***... II, *Edukata Islame*, 28-29, 1980, Prishtinë, f. 27-35.
***...III, *Edukata Islame*, 30, 1981, Prishtinë, f.66-72.
***... IV, *Edukata Islame*, 31, 1981, Prishtinë, f.49-55.
367. *Dr. Ibrahim Temo themeluesi i Komitetit të Turqve të rij "Bashkim e përparim"*, Përpjekja e jonë, Nr. 9-10/1981 New York - New Jersy. Përktheu nga gjermanishtja: Fejzi Domni.

1992-1995

368. *Kur'ani kryevepër e letërsisë arabe*, në librin – *Kurani kryevepër*, Prishtinë, 1992, f. 77-125.
369. *Faik Konitza dhe marrëdhëniet e tij me Asutro-Hungarinë*, *Jeta e Re*, nr. 3, 1995, f. 376-352,[13] Prishtinë.

2003

370. *Dorëshkrimet arabe në Jugosllavi*, EDIS-nr. 70, Prishtinë, 2003, fq. 55-72 (përktheu Q. Morina).
371. *Gjendja e monumenteve islame të Kosovës në vitet e pesëdhjeta të shekullit njëzet*, Edis, nr. 76, Prishtinë, 2005, f. 75-90. (përktheu Q. Morina).
372. Hasan Kaleshi - Ismail Eren, *Mahmud Pashë Rrotulla nga Prizreni, përshpirtënimet dhe vakfnameja e tij*, Edis, nr. 81, Prishtinë, 2006, fq. 151-190 (Përkthyen: Ismail Rexhepi dhe Sadik Mehmeti).
373. *Veziri i madh Koxha Sinan Pasha - përshpirtnimet dhe vakëfnameja e tij*, Edis, nr. 82, Prishtinë, 2007, 95-140, (Përktheu: Ismail Rexhepi dhe Sadik Mehmeti).

---

[13] Në përpilimin e kësaj bibliografije, përveç hulumtimeve individuale, janë konsultuar edhe këto burime:
- *Bisera Nurudinović*, Bibliografija Jugoslovenske Orijentalistike 1945-1960, Sarajevo, 1968.
Bibliografija Jugoslovenske Orijentalistike 1961-1965, Sarajevo, 1981.
Pregled izdanja orijentalnog instituta sa bibliografijom radove u njima, POF, XXV, 1975, Sarajevo, 1976.
- *Sevdie Ahmeti, Amedan Jani, Musa Gërguri*, Jeta e Re - Bibliiografia 1949-1974, Prishtinë, 1976.
- *Emine Abdixhiku, Jonuz Fetahaj*, Bibliografia e Përparimit 1946-1986, Prishtinë, 1986, Përparimi nr. 4, 1986.
- *Palok Daka*, Bibliografia e Studimeve dhe artikujve për gjuhën Shqipe 1945-1974, Tiranë, 1975.
- *Isak Shema -Ibrahim Rugova*, Bibliografia e kritikës letrare shqiptare '44-'74, Prishtinë, 1976.
- *Zejnil Fajic*, Bibliografija Glasnika Vrhovnog Islamskog Starješinstva u SFRJ 1933-1982, Sarajevo, 1983.
Bibliografia e prof dr. Hasan Kaleshit është botuar edhe më përpara por ky është verzioni më i kompletuar që përfshin edhe punimet e botuara pas vdekjes të prof. dr. Hasan Kaleshit deri në vitin 2007

PËRMBAJTJA

Qemajl Morina
Kosova shtet sovran dhe i pavarur **5**

Kasim Gërguri
ARSHI - krijesë madhështore **11**

Dr. Qani Nesimi
Koncepti i "tjetrit" tek osmanët dhe pozicioni i shqiptarëve në të ... **49**

Dr. Qazim Qazimi
Premisat hyjnore të qytetërimit islam
- mendime dhe ide rreth qytetërimit - **67**

Nexhat Ibrahimi
Vendi i Filozofisë Islame në sistemin filozofik botëror **81**

Mustafa Mlivo
Kur'ani përpara shkencës dhe civilizimit **95**

Dr. Hasan Kaleshi
Vakëfnameja dhe vakëfet e Sunkur Çaush Begut nga Manastiri . **123**

Abdullah Nasih Ulvan
Islami - ligj i jetës - (2) **145**

Abdurrahman es-Sa'di
Si të jetojmë të lumtur **171**

Alaga Dervisheviq
Nga bisedat e botuara dhe të pabotuara **189**

Glosari ortodoks **209**

Abdulkadir Inxhiq
Përse është me rëndësi mësimi i gjuhës së Kur'anit? **231**

Tajib Salih
Koha e shpërnguljes në veri - (3) **239**

Avni Aliu
Porosia e Kur'anit për durim dhe vigjilencë **259**

Prof. Ali Mustafa EL-MISRATI
Herodoti i kulturës libiane dhe shqiptarët **267**

Mr. Qemajl Morina
Rrugëtimi prej afër katër dekadash i revistës "Edukata Islame" . **275**

Akademik Jashar Rexhepagiq
Disa opservacione mbi revistën "Edukata Islame" **281**

Nexhat Ibrahimi
Revista Edukata Islame - përgjigje sfidave të kohës **287**

Shevki Sh. Voca
Një vepër e veçantë për historinë tonë kombëtare
e shkruar pak më ndryshe **291**

Nexhat Ibrahimi
Struktura perfekte e Islamit **299**

Dr. Feti Mehdiu
Bibliografia e Dr. Hasan Kaleshit **305**

Përmbajtja **337**